

**PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE
TË GJYKATËS EUROPIANE
PËR TË DREJTAT E NJERIUT
KUNDËR SHQIPËRISË
2010-2021**

**Vëllimi III
2020-2021**



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë, 2022

ISBN:

ISBN 978-9928-01-140-4 (Kolana)

ISBN 978-9928-01-143-5 (V.3)

Adresa

Rruga: "Nikolla Jorga"

Tel/fax: +355 42 427005, 04 2427006

E-mail: info@qbz.gov.al,

Web: www.qbz.gov.al

PËRMBAJTJA

Çështja “Strazimiri kundër Shqipërisë”	5
Çështja “Agim Beshiri kundër Shqipërisë”	34
Çështja “Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë”	76
Çështja “Kati kundër Shqipërisë”	90
Çështja “Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë” (Versioni i korrigjuar, 2016)	91
Çështja “Kasmi kundër Shqipërisë”	105
Çështja “Robert Vevecka kundër Shqipërisë”	121
Çështja “Gjergo dhe Babicenko kundër Shqipërisë”	129
Çështja “Tërshana kundër Shqipërisë”	157
Çështja “Fatbardh Budo kundër Shqipërisë”	184
Çështja “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”	186
Çështja “Ruci dhe Bejleri kundër Shqipërisë” dhe 191 kërkesa të tjera	257
Çështja “Sokol Sheti kundër Shqipërisë dhe Merita Gjashta kundër Shqipërisë”	316
Çështja “Ilir Beqja kundër Shqipërisë”	318
Çështja “Renaldo Bregu kundër Shqipërisë dhe Natasha Nokshiqi kundër Shqipërisë”	319
Çështja “Myslym Nela kundër Shqipërisë”	325
Çështja “Edmond Zhupa kundër Shqipërisë”	327
Çështja “Dorian Matlija kundër Shqipërisë”	329

SEKSIONI I DYTË
ÇËSHTJA
“STRAZIMIRI KUNDËR SHQIPËRISË”¹
(kërkesa nr. 34602/16)

VENDIM
Strasburg
21 janar 2020

Neni 3 – Trajtim çjerëzor – Trajtim poshtëruar – Kushte të këqija në rastet e ndalimit me arrest dhe trajtim mjekësor i papërshtatshëm për një person të sëmurë mendor, i cili i nënshtrohet një trajtimi mjekësor të detyrueshëm me urdhër gjykatë – “Braktisje terapeutike”

Neni 5 §1 (e) – Arrest ose ndalim i ligjsbëm – Arresti në një institucion për ekzekutimin e dënimeve penale të individit të sëmurë mendor, i cili është përjashtuar nga përgjegjësia penale – Dështimi i autoriteteve për një kohë të gjatë për të ndërtuar një institucion mjekësor të posaçëm të integruar në sistemin shëndetësor, në shkëlqje të ligjit të brendshëm – Problem strukturor

Neni 5 §4 – Përsheptimi i shqyrtimit – Vonesë në procedimet e apelit për tre vjet, i cili i atribuohet tërësisht autoriteteve

Neni 5 §5 – Kompensimi – Mungesa e të drejtës së zbatueshme për kompensim në lidhje me shkëlqet specifike të neneve 5 §§1 dhe 4

*Ky vendim do të bëhet i formës së prerë sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 §2 të Konventës.
Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.*

Në çështjen Strazimiri kundër Shqipërisë², Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar

Marko Bošnjak

Valeriu Griçco

Egidijus Kūris

Ivana Jelić

Arnfinn Bårdsen

Darian Pavli, gjyqtarë

dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit

Pasi diskutuan me dyer të mbyllura më datë 10 dhjetor 2019,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 34602/16) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë, më datë 11 qershor 2016, mbështetur në nenin 34, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Arben Strazimiri (kërkuesi).

2. Kërkuesi u përfaqësua nga znj. E. Skendaj, nga Komiteti i Helsinkit i Shqipërisë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga Agjenti i saj, në atë kohë, znj. Alma Hicka nga Avokatura e

¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 94. Tiranë, 2020. f.5531

Shtetit.

3. Kërkuesi u ankua se kushtet e arrestit t tij dhe trajtimi i papërshtatshëm mjekësor, që ai ka marrë, kanë qenë në kundërshtim me nenin 3 të Konventës. Gjithashtu, ai u ankua se: i) izolimi i tij në burg nuk është urdhëruar “në mbështetje të një procedure të parashikuar me ligj” dhe nuk ka qenë e “ligjshme”, sipas interpretimit të nenit 5 §1 të Konventës, ii) nuk i është dhënë mundësia që ligjshmëria e ndalimit të tij të shqyrtohej “pa vonesë” nga një gjykatë sipas parashikimit në nenin 5 §4, dhe iii) ai nuk ka pasur të drejtën e zbatueshme për kompensim për shkeljet e pretenduara sipas nenit 5, mbështetur në nenin 5 §5 të Konventës. Së fundmi, ai u ankua për mungesë të një mjeti efikas dhe se ishte diskriminuar për shkak të sëmundjes së tij mendore, në kundërshtim me nenit 13 dhe 14 të Konventës, respektivisht.

4. Më 5 tetor 2016, Qeveria u njoftua për ankesat në mbështetje të neneve 3, 5 §1, 4 dhe 5, neneve 13 dhe 14 të Konventës, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës u deklarua e papranueshme sipas rregullit 54 §3 të Rregullores së Gjykatës.

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Kërkuesi ka lindur në vitin 1973. Në momentin kur ai paraqiti kërkesën e tij, ai mbahej i ndaluar në Qendrën Spitalore të Burgut të Tiranës (Qendra Spitalore e Burgut). Ai është diagnostikuar me skizofreni paranojake.

A. Procedimet gjyqësore në lidhje me trajtimin e detyruar mjekësor të kërkuesit

1. Grupi i parë i procedimeve

6. Kërkuesi u arrestua në muajin prill 2008, në flagrancë teksa përpiqej të kryente një vrasje. Në vijim, ai u gjykua për vrasje të paramenduar të mbetur në tentativë.

7. Më 25 mars 2009, Gjykata e Rrethit Tiranë konstatoi se kërkuesi, i cili kishte kryer veprën penale të vrasjes me paramendim të mbetur në tentativë, duhej të përjashtohet nga përgjegjësia penale për shkak të sëmundjes së tij mendore dhe kërkoi trajtimin e detyruar për kërkuesin në një institucion mjekësor, në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal. Vendimi mbështetej në një raport mjekësor të ekspertit, të datës 23 maj 2008, në të cilin konstatohej se “kërkuesi e kishte kryer veprën nën ndikimin e sëmundjes së tij, dhe për pasojë si nuk do të bëhej përgjegjës për veprimet e tij, dhe se kërkuesi kishte nevojë për trajtim të detyruar spitalor, duke qenë se konsiderohej si ‘një person i cili përbën rrezik të lartë social’”.

8. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Tiranë mori në konsideratë faktin se:

“1. Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi trajtimin e detyruar mjekësor për kërkuesin, pa shtrim në spital, nën kujdesin e familjes së tij, në një vendim të datës 13 janar 2006;

2. Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi shtrimin e përkohshëm të kërkuesit në pavijonin e psikiatrisë së Qendrës Spitalore të Burgut, me anë të vendimit të datës 8 mars 2007;

3. Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi lirimin e tij nga burgu me anë të vendimit të datës 27 dhjetor 2007.”

9. Më datë 8 prill 2009, mbështetur në urdhër-ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Tiranës, të datës 25 mars 2009, kërkuesi u dërgua në Burgun e Krujës.

2. Grupi i dytë i procedimeve

10. Në një datë të papërcaktuar, në vitin 2010, kërkuesi kërkoi revokimin e vendimit të datës 25 mars 2009. Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi një tjetër kontroll mjekësor për gjendjen e shëndetit mendor të kërkuesit. Raporti mjekësor i datës 7 korrik 2010, konstatoi se:

“1. Kërkuesi vuante nga skizofrenia paranojake;

2. Gjendja e tij nuk ishte e qëndrueshme;

3. Rekomandohej të vijohej me trajtimin e detyruar mjekësor të pacientit, me shtrim spitalor.”

11. Më 27 tetor 2010, mbështetur në raportin mjekësor të sipërpërmendur, Gjykata e Rrethit Tiranë urdhëroi vijimin e trajtimit mjekësor të detyruar me shtrim spitalor. Në vijim, gjykata deklaroi se familjarët e kërkuesit nuk kishin demonstruar se ata mund të ofronin kushte të cilat do të ishin të përshtatshme, duke marrë në konsideratë rrezikun shoqëror të kërkuesit për shkak të

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

sëmundjes së tij. Më 11 mars 2011, Gjykata e Apelit Tiranë, e la atë vendim në fuqi.

12. Më 30 mars 2011, prokurori lëshoi një urdhërezekutimi për vendimet e gjykatave.

13. Më 20 qershor 2011, kërkuesi u transferua në Qendrën Spitalore të Burgut, ku mbahej në kohën kur ai paraqiti kërkesën e tij.

3. Grupi i tretë i procedimeve

14. Më 16 janar 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë shqyrtoi *proprio motu*, sipas nenit 46 të Kodit Penal, trajtimin e detyruar mjekësor me shtrim spitalor të kërkuesit. Pasi mori në konsideratë dy raporte të ndryshme mjekësore, gjykata urdhëroi vijimësinë e trajtimit të detyruar me shtrim spitalor të kërkuesit, me arsyetimin se kjo gjë justifikohet me gjendjen shëndetësore të kërkuesit, pamundësinë e familjes së tij për të siguruar kushte të përshtatshme për gjendjen e tij shëndetësore, si edhe përpjekjet e dështuara të kërkuesit për të kryer vetëvrasje. Ky vendim u la në fuqi në apel më 3 prill dhe 30 maj 2013 nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, respektivisht.

15. Më 15 prill 2013, prokurori lëshoi një urdhërezekutimi për vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 3 prill 2013.

4. Grupi i katërt i procedimeve

16. Në një datë të papërcaktuar, përfaqësuesi i kërkuesit bëri një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë për revokimin e trajtimit me shtrim në spital të kërkuesit, duke argumentuar se gjendja e tij ishte përmirësuar, si edhe për trajtim pa qenë i shtruar në spital. Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi një kërkesë të përfaqësuesit të kërkuesit që të shtoheshin dy ekspertë të pavarur në ekipin e ekspertëve nga Instituti Mjekoligjor, i cili ishte i ngarkuar të paraqiste një raport mjekësor në gjykatë. Ekipi i ekspertëve paraqiti dy raporte mjekësore të ndryshme.

17. Raporti i parë mjekësor, i datës 9 dhjetor 2013, paraqiste ndër të tjera, si më poshtë:

“1. Z. Strazimiri vuan ende nga skizofrenia paranojake.

2. Gjendja e tij aktuale e shëndetit mendor nuk është e qëndrueshme; ai demonstroi simptoma psikotike të pakontrolluara.

3. Trajtimi më i mirë për të, duke pasur në konsideratë mbrojtjen e jetës së tij dhe të jetës e shëndetit të të tjerëve, është trajtimi i detyruar mjekësor me shtrim në spital.

4. Mbështetur në gjendjen e tij aktuale mendore dhe nivelin aktual të rrezikut që ai paraqet për shoqërinë, një masë e tillë është ende e nevojshme.”

18. Raporti i dytë mjekësor, i datës 12 dhjetor 2013, i hartuar nga dy ekspertët e pavarur mjekësorë të propozuar nga përfaqësuesi i kërkuesit parashtronte, ndër të tjera, si më poshtë:

“1. Z. Strazimiri vuan ende nga skizofrenia paranojake.

2. ...

3. Në kushtet e gjendjes së tij aktuale shëndetësore, z. Strazimiri nuk mund të nxirret ende për mjekim të lirë. Megjithatë trajtimi më i mirë për të, është trajtimi i detyruar mjekësor si pacient i cili nuk është i shtruar në spital.

4. Në mbështetje të gjendjes së tij aktuale psikiatrike dhe nivelit të rrezikut për shoqërinë, trajtimi i detyruar mjekësor në një institucion psikiatrik, më konkretisht Qendra Spitalore e Burgut, nuk është i nevojshëm.”

19. Gjykata e Rrethit Tiranë shqyrtoi të dyja raportet mjekësore dhe më 3 shkurt 2014, ajo urdhëroi vijimin e trajtimit me shtrim spitalor, duke deklaruar se:

“Z. Strazimiri i është nënshtruar trajtimit të detyruar pa qenë i shtruar në spital... gjë e cila rezultoi joefikase, duke qenë se ai tentoi të vraste A.R. ... Mbështetur në raportet e ekspertit të përgatitur gjatë këtyre viteve, dokumentet e paraqitura gjatë këtij grupi procedimesh dhe provat e disponueshme në dosjen e çështjes, gjykata konstaton se kjo vepër u krye si rezultat i transkurimit të mjekimit nga ana e z. Strazimiri... Për pasojë, trajtimi i detyruar pa shtrim spitalor të pacientit nuk ofron ndonjë siguri se z. Strazimiri nuk do të kryejë vepra të tjera penale ndaj palëve të treta dhe/ose akte vetëvrasjeje.

Ekspertët e caktuar nga z. Strazimiri nënvizuan nevojën për marrjen e mjekimit me përpikëri,

si edhe ofrimin e kujdesit familjar për të trajtuar sëmundjen; në rast të kundërt gjendja e tij shëndetësore do të përkeqësohet.

Gjykata vëren se në seancën e datës 3 shkurt 2014, pavarësisht se z. Strazimiri ishte i qetë, ai goditi me grusht në fytyrë, pa asnjë arsye të dukshme, oficerin e policisë së burgut, i cili po e shoqëronte. Ky veprim demonstroi faktin se z. Strazimiri vijon të jetë i dhunshëm dhe i rrezikshëm për palët e treta, edhe pse ai mbikëqyret nga një personel i specializuar.

...

Në vitin 2012, z. Strazimiri tentoi të kryente vetëvrasje, edhe pse ishte në mbikëqyrje mjekësore strikte dhe në kushte të posaçme të përshtatshme për shëndetin e tij mendor, diçka të cilën familja e tij nuk do ta kishte përballuar.

Z. Strazimiri ka deklaruar se po pret me padurim lirin e tij për të përdorur alkool dhe lëndë narkotike.

...

Familjarët e kërkuarit nuk kanë provuar se ata mund të përballojnë trajtimin e duhur mjekësor në raport me nivelin e rrezikut që ai paraqet për shoqërinë për shkak të shëndetit të tij mendor.”

20. Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi se trajtimi i detyruar mjekësor në një institucion mjekësor ishte e vetmja masë në përpjesëtim me rrezikun që paraqiste kërkuari, nevojën për vëmendje të vazhdueshme për jetën dhe shëndetin e tij, dhe mbrojtjen e familjarëve të tij dhe pjesëtarëve të komunitetit.

21. Ai vendim u la në fuqi në apel, më 11 qershor dhe 25 shtator 2014, nga Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë, respektivisht.

22. Më 20 qershor 2014, prokurori urdhëroi ekzekutimin e vendimit të Gjykatës së Apelit, të datës 11 qershor 2014.

a) Grupi i pestë i procedimeve

23. Më 17 shtator 2014, kërkuari, në mbështetje të neneve 3 dhe 5 të Konventës, Kushtetutës, Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale dhe ligjit për shëndetin mendor paraqiti një ankesë në Gjykatën e Rrethit Tiranë duke kërkuar që kjo e fundit të ndërpriste trajtimin e tij poshtërues dhe çnjerëzor dhe izolimin e tij në Qendrën Spitalore të Burgut, dhe ta kalonte për trajtim në një institut të posaçëm mjekësor në varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ai pretendonte se kushtet në të cilat mbahej i ndaluar, si edhe trajtimi mjekësor për të, në mjediset e burgut, ishin konsideruar si çnjerëzore dhe poshtëruese nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtërues (“KPT”). Ai iu referua një protokoll për diagnozën dhe kujdesin terapeutik të skizofrenisë të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas të cilit sëmundja e tij do të trajtohej në një mënyrë efektive duke kombinuar mjekimin me terapi të tjera mbështetëse.

24. Më 20 nëntor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë konstatoi se, mbështetur në të dhënat përpara saj, avokati i kërkuarit nuk kishte nënvizuar ndonjë shembull specifik për trajtim çnjerëzor dhe poshtërues, përveçse mungesës së trajtimit mjekësor, ose se kërkuari ishte privuar nga liria e tij në mënyrë të paligjshme. Gjykata e rrëzoi ankesën si dukshëm të pabazuar, duke pohuar se:

“Në mbështetje të provave të marra gjatë këtij grupi procedimesh dhe veçanërisht në një shkresë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (“Shërbimi i Burgjeve”), rezulton se:

- Më 23 shtator 2009, z. Strazimiri, për shkak të rikonstruksionit të Qendrës Spitalore të Burgut, u dërgua në Burgun e Krujës, për të vuajtur trajtimin e detyruar mjekësor. Burgu i Krujës është një institucion i specializuar, i cili ofron shërbime shëndetësore në 24 orë (të ofruara nga doktorë dhe infermierë)...

- Që prej datës 26 qershor 2011, z. Strazimiri është transferuar në një pavijon të specializuar, të ndërtuar për trajtimin e personave me sëmundje mendore, në Qendrën Spitalore të Burgut.

- Grupi i pacientëve, ku bën pjesë edhe z. Strazimiri, duhet të jetë nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi i Burgjeve kanë negociuar për kalimin e tyre në Ministrinë e Shëndetësisë. Faktikisht, shumica e këtij grupi pacientësh, të cilët i nënshtrohen një mase mjekësore janë vendosur në Burgun e Krujës dhe 20% prej tyre janë vendosur në Spitalin e Burgut.

Sipas një letre nga Spitali i Burgut, rezulton se ‘z. Strazimiri është shtruar në spital dhe vijon të marrë trajtim të specializuar në Spitalin e Burgut duke përfshirë terapinë respektive sipas diagnozës... dëshirojmë t’ju informojmë se Spitali i Burgut i ka vendosur në një pavijon të posaçëm të gjithë personat të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyruar. Kjo ka ndodhur, sepse kjo kategori pacientësh nuk mund të qëndrojnë me pacientë të tjerë, të cilët janë të shtruar për shkaqe shëndetësore dhe do të qëndrojnë përkohësisht deri në rehabilitimin e tyre ose në përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Edhe pse kjo kategori pacientësh është vendosur në një pavijon të posaçëm, administrata e Spitalit të Burgut ka marrë të gjitha masat për të garantuar respektimin e të drejtave të tyre, në mbështetje të rregullores së Spitalit të Burgut, miratuar nga Ministria e Drejtësisë. Është me vend të përmendet e drejta e tyre për ushtrime në mjedise të jashtme..., për këshillim në grup dhe individual, për përfshirjen në aktivitete të ndryshme socio-kulturore, për të paraqitur një ankesë; të interesuarit mund të angazhohen në bibliotekë; dhe kanë të drejtën për këshillim ligjor.

...
Është e vërtetë se ligji për shëndetin mendor (ligji nr. 44/2012) parashikon se personat të cilët i nënshtrohen trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykatë duhet t’i nënshtrohen kësaj mase në institucione të specializuara shëndetësore, të cilat janë pjesë e sistemit të integruar shëndetësor. Megjithatë, ai nuk parashikon se këto institucione duhet të jenë llogaridhënëse për Ministrinë e Shëndetësisë. Sipas seksionit 29, Ministria e Shëndetësisë është e detyruar të ofrojë ndihmë të specializuar.

Është po aq e vërtetë se institucione të tilla nuk ekzistojnë në Republikën e Shqipërisë. Gjithsesi, Shteti ka marrë masat e nevojshme për ta kontrolluar situatën deri në ndërtimin e institucioneve të specializuara. Bashkëpunimi midis Shërbimit të Burgjeve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë ka vijuar me qëllim adresimin e këtij problemi.

...
Gjykata konstaton se ankesa e z. Strazimirit nuk është e mbështetur në prova dhe në ligj. Për këtë arsye, ajo vendos ta rrëzojë atë.”

25. Më 22 dhjetor 2015, Gjykata e Apelit Tiranë, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 20 nëntor 2014.

26. Më 11 janar 2016, kërkuesi apeloj në Gjykatën e Lartë ndaj të dyja vendimeve. Rezulton se Çështja është ende pezull në Gjykatën e Lartë.

B. Procedimet ndaj ekzekutimit të vendimeve të gjykatës, të cilat urdhëronin trajtimin e detyruar mjekësor për kërkuesin

27. Më 17 korrik 2014, kërkuesi e kundërshtoi urdhrin e ekzekutimit të prokurorit për vendimin e Gjykatës së Apelit të datës 11 qershor 2014 (*shih paragrafin 22 më sipër*). Kërkuesi argumentoi se përderisa ai nuk ishte as i dënuar dhe as i paraburgosur në pritje të gjykimin, mbajtja e tij në një institucion të vuajtjes së dënimit, i tillë si Qendra Spitalore e Burgut, nën varësinë e Shërbimit të Burgjeve, ishte në kundërshtim me legjislacionin e brendshëm, më konkretisht me nenin 46 të Kodit Penal dhe seksionin 45 të aktit për ekzekutimin e vendimeve penale dhe po ashtu në kundërshtim me vendimet e gjykatës të cilat urdhëronin mbajtjen e tij në një institucion të posaçëm mjekësor. Ai parashittoi se një masë e tillë ishte një shkelje e legjislacionit vendës nga KPT-ja dhe Avokati i Popullit.

28. Më 20 tetor 2014, Gjykata e Rrethit Tiranë e rrëzoi ankesën e tij si haptazi të pabazuar, duke konstatuar se urdhri i ekzekutimit ishte lëshuar në mbështetje të legjislacionit të brendshëm. Më 14 prill 2015, Gjykata e Tiranës e la atë vendim në fuqi.

29. Më 21 prill 2015, kërkuesi apeloj ndaj të dy vendimeve në Gjykatën e Lartë. Rezulton se ky grup procedimesh është ende pezull përpara asaj gjykatë.

C. Ankesat penale të kërkuesit

1. Grupi i parë i procedimeve

30. Më 24 korrik 2014, kërkuesi paraqiti një ankesë në prokurorinë e Tiranës, duke pretenduar se urdhrat e prokurorit, të cilët e kishin vendosur fillimisht në Burgun e Krujës dhe më pas në Qendrën Spitalore të Burgut, shkelnin ligjin (*shih paragrafët 9, 12, 15 dhe 22 më sipër*). Gjithashtu, kërkuesi bëri një

kërkesë që prokuroria të hapte një çështje dhe të fillonte procedimet penale ndaj zyrtarëve publikë, të cilët kishin qenë përgjegjës për shkeljen përmendur më sipër. Në vijim, ai pretendonte se trajtimi i papërshtatshëm ndaj tij në ato institucione, i mbështetur nga konstatimet e KPT-së, ishte çnjerëzor dhe poshtërues.

31. Më 30 shtator 2014, prokuroria u përgjigj se duke qenë se nuk ekzistonte asnjë institucion mjekësor i posaçëm në vend, i cili të kujdesej për individët që vuanin nga çrregullimet mendore, që i nënshtroheshin trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykate, vendosja e kërkuarit në institucionet në fjalë nuk kishte qenë në kundërshtim të ligjit. Në vijim të përgjigjes së tij, më 29 tetor 2014, prokuroria i ofroi kërkuarit informacione të cilat i kishte marrë nga Shërbimi i Burgjeve, ku shpjegohej se një numër i caktuar individësh që i ishin nënshtuar trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykate ishin vendosur në Burgun e Krujës me anë të vendimit të prokurorit, të datës 23 shtator 2009, për shkak të rinovimeve që po bëheshin në Qendrën Spitalore të Burgut. Shërbimi i Burgjeve deklaronte se kjo kategori njerëzish duhej të ishte nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe se negociatat midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit të Burgjeve për transferimin e tyre në Ministrinë e Shëndetësisë ishin në proces.

32. Pas një anekese të Prokurorit të Përgjithshëm, prokuroria regjistroi një anekese penale në mbështetje të udhëzimeve të ofruara nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale të Prokurorisë së Përgjithshme. Më 26 janar 2015, Prokuroria vendosi të mos niste procedime penale në lidhje me anekesën e kërkuarit, duke konstatuar se ai nuk kishte qenë objekt i trajtimit çnjerëzor ose poshtërues ose i një privimi të paligjshëm të lirisë së tij. Prokurori pranoi se në vend nuk ekzistonte asnjë institucion i specializuar që të kujdesej për nevojat e personave të sëmurë mendorë, të cilët i nënshtroheshin trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykate. Personat e sëmurë mendorë do të vijonin t'i nënshtroheshin kësaj mase në mjediset e përshtatura nga autoritetet për këtë qëllim, deri në ndërtimin e një institucioni të specializuar.

33. Më 10 qershor 2015, Gjykata e Rrethit Tiranë, pas apelimit të kërkuarit ndaj vendimit të prokurorit, e rrëzoi apelimin. Rezulton se procedimet janë pezull në Gjykatën e Apelit.

2. Grupi i dytë i procedimeve

34. Më 23 korrik 2015, kërkuari paraqiti një anekese në prokurori, duke i kërkuar kësaj të fundit të niste procedimet penale ndaj administratorëve dhe menaxherëve të Spitalit të Burgut dhe Burgut të Krujës me pretendimin për kryerjen e veprimeve arbitrare, me pretendimin për mosmarrjen e masave për t'i dhënë fund paligjshmërisë, me pretendimin për mbajtjen në arrest pa një vendim, dhe me pretendimin për shkeljen e barazisë së qytetarëve sipas neneve 250-253, të Kodit Penal.

35. Më 3 shtator 2015, prokurorët vendosën të mos ndërmermin procedime penale për këto vepra. Nuk rezulton që kërkuari të ketë paraqitur një apelim ndaj vendimit të prokurorit.

D. Raporti i ekspertizës mjekësore në lidhje me gjendjen shëndetësore të kërkuarit

1. Raporti i datës 11 shtator 2015

36. I pjesë të këtyre vërejtjeve, kërkuari paraqiti një raport të ekspertizës mjekësore, të datës 11 shtator 2015, i cili ishte urdhëruar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal, për të shqyrtuar gjendjen mjekësore të kërkuarit. Ekspertëve mjekësorë u kërkuua t'u përgjigjeshin pyetjeve të mëposhtme:

“1. A vuan ende nga ndonjë çrregullim mendor z. Strazimiri?

2. Nëse po, prej cilit?

3. Cila është gjendja e z. Strazimiri, në këtë periudhë?

4. Nëse ai vuan ende nga çrregullime mendore, cila është mënyra më e mirë për ta trajtuar, duke pasur në konsideratë mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të tij, dhe atë të të tjerëve:

a) Trajtimi i detyruar pa shtrim në spital

b) Trajtimi i detyruar me shtrim në një institucion mjekësor?

5 A është ende i nevojshëm trajtimi i detyruar mjekësor i urdhëruar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, në vendimin e saj të datës 25 mars 2009?”

37. Konstatimet e ekspertëve të mjekësisë ishin si më poshtë:

“Pacienti vuan ende nga skizofrenia paranojake, një sëmundje kronike, pa ndonjë lehtësim në rastin e tij. Ekziston një rrezik i lartë për shfaqje dhune për shkak të sëmundjes së tij.

Simptomat psikotike aktive janë ende të dukshme, edhe pse vihet re një ndryshim pozitiv në krahasim me raportin e fundit mjekësor. Fakti se procesi i tij i të menduarit varet nga, dhe ndryshon si rezultat i faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, mbart një rrezik për një sjellje të paparashikueshme.

Sipas dosjes së tij mjekësore, ai manifeston shpesh sjellje disforike, të paktën çdo dy muaj, duke kërkuar injeksione urgjente dhe ndërkohë, ai trajtohet me një kombinim antipsikotikësh në një dozë të lartë.

Përveç psikozës që ai manifeston aktualisht dhe historisë së tij të agresivitetit dhe sjelljes së paparashikueshme, ai manifeston edhe mosndjekje dhe mosrespektim të planit të trajtimit të tij mjekësor, duke paraqitur në këtë mënyrë vështirësi në trajtimin e tij si një pacient i cili nuk është i shtruar në spital.

Për këtë arsye, rekomandohet trajtim i detyruar me shtrim në spital.”

2. Raporti i datës 14 shkurt 2017

38. Si pjesë të vërejtjeve të tij, kërkuesi paraqiti një raport mjekësor të datës 14 shkurt 2017, të urdhëruar nga Gjykata e Rrethit Tiranë në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal për të kontrolluar gjendjen mjekësore të kërkuesit si pjesë e një grupit të veçantë procedurash, rezultati i të cilave nuk i është bërë i njohur Gjykatës. Ekspertët e mjekësisë u ngarkuan me detyrën për t’iu përgjigjur të njëjtave pyetje, të paraqitura në paragrafin 36 më sipër.

39. Konstatimet e ekspertëve mjekoligjorë ishin si më poshtë:

“Z. Strazimiri ka vuajtur për shumë vite nga skizofrenia paranojake. Kjo sëmundje ka kushtëzuar gjykimin dhe sjelljen e tij, duke përbërë një rrezik të lartë për sjellje të paparashikuara.

Sipas vlerësimit HCR20 (historik, klinik, menaxhim risku), i cili është një mjet për të matur rrezikun për një sjellje të dhunshme... ky pacient ka përmbushur tre komponentët e HCR dhe është klasifikuar si rrezik i lartë social.

Në këtë kontroll, në mbështetje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, u konstatua se me doza të larta dhe politerapeutike (antipsikotikësh), menaxhimi klinik i sëmundjes siguronte të mos kishte as përsëritje dhe as përkeqësim. Duke marrë në konsideratë faktin se ka pasur një ndryshim të dukshëm në një nga tre komponentët të [HCR], ia lëmë gjykatës të vendosë për masën e duhur mjekësore.

Përfundime

1. Arben Strazimiri vuan nga një sëmundje mendore.

2. Arben Strazimiri vuan nga skizofrenia paranojake.

3. Arben Strazimiri aktualisht shfaq simptoma të lehtësuara të sëmundjes.

4. Sipas progresit aktual të sëmundjes, pavarësisht aspekteve pozitive, nuk mund të rekomandojmë trajtim të detyruar pa shtrim në spital, duke ia lënë gjykatës të vlerësojë masën mjekësore.

5. Duke qenë se një nga tri elementet ka shfaqur ndryshime, ia lëmë vlerësimit të gjykatës të vendosë për masën mjekësore.”

3. Raporti i datës 27 mars 2017

40. Përfaqësuesi i kërkuesit mori një ekspert mjekoligjor të pavarur për të realizuar një vlerësim për gjendjen mjekësore të kërkuesit. Eksperti u ngarkua me detyrën për të realizuar një vlerësim krahasues për trajtimin mjekësor të kërkuesit gjatë viteve të tij në izolim të detyruar në qendrat mjekësore të burgut. Raporti i ekspertit iu referua Protokollit të Organizatës Botërore të Shëndetit për Trajtimin Mjekësor të Skizofrenisë Paranojake, dhe nënvizoi se deinstucionalizimi dhe forma të ndryshme të psikoterapisë përfaqësonin praktikën standarde për trajtimin efikas të këtij tipi patologjie. Në lidhje me gjendjen e kërkuesit në datën e vizitës (27 mars 2017), eksperti vërejti se ai kishte paraqitur çrregullimet e tij mendore. Për më tepër, raporti i ekspertit nënvizonte se pothuajse i gjithë mjekimi i parashikuar në protokoll i ishte dhënë edhe pacientit,

teksa ai nuk i ishte nënshtruar asnjë prej psikoterapive të vlerësuara si thelbësore për shërimin e tij (të tilla si: terapia në grup, terapi familjare, rehabilitim social dhe profesional, dhe kështu me radhë). Në Qendrën Spitalore të Burgut mungonin kushtet bazë mjekësore dhe personeli i trajnuar mjekësor për të realizuar atë trajtim. Për këtë arsye, aplikimi te pacienti i pothuajse të gjitha llojeve të mjekimit të disponueshëm në planin për trajtimin e kësaj patologjie, e shoqëruar me një mungesë totale psikoterapie dhe regjimi në burg (në të cilin përfshiheshin gjithashtu periudha izolimi), rrezikonin ndjeshëm që të sillnin efektin e kundërt dhe të ulnin ndjeshëm mundësitë e një shërimi të mundshëm të pacientit. Eksperti mjekoligjor sugjeronte me këmbëngulje që kërkuesi të transferohej në një qendër mjekësore të përshtatshme dhe, gjithashtu, të rishikohej në detaje plani për trajtimin e tij.

E. Korrespondenca me institucionet shtetërore

41. Më 21 janar 2015, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit Strategjik për Çështjet e Jashtme në Ministrinë e Drejtësisë i dërgoi një shkresë përfaqësuesit të kërkuesit, duke theksuar midis të tjerash, si më poshtë:

“Problemet në lidhje me trajtimin e personave (të sëmurë mendorë), që i janë nënshtruar trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykatë janë trashëguar dhe kanë mbetur të paadresuara për një periudhë për më shumë se 10 vjet, për shkak të mungesës së një “institucioni të specializuar” në sistemin shëndetësor, i cili do të ofronte trajtim të detyruar për këtë kategori njerëzish sipas ligjit për shëndetin mendor (ligji nr. 88/2012) dhe ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale (ligji nr. 8331/1998).”

Një memorandum mirëkuptimi i lidhur midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë i ishte bashkëngjitur shkresës, duke listuar sipërmarrjet e secilit institucion për trajtimin personave të sëmurë mendorë.”

42. Më 28 prill 2016, pas një kërkese nga përfaqësuesi i kërkuesit, Qendra Spitalore e Burgut ofroi më shumë informacione për kushtet në këtë institucion. Shkresa nënvizonte, ndër të tjera, sa më poshtë:

“1. Njëqind e gjashtë njerëz aktualisht marrin trajtim me shtrim spitalor, prej të cilëve dyzet e katër janë në trajtim të detyruar mjekësor dhe njëzet e dy janë me shtrim të përkohshëm. Të gjithë individët, të cilëve iu është privuar liria dhe të cilët vuajnë nga probleme shëndetësore, janë të shtruar në këtë institucion.

2. Kapaciteti i institucionit është nëntëdhjetë e nëntë [pacientë], sipas miratimit me anë të urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit të Burgjeve nr. 303, i datës 23 mars 2016.

3. Numri i personelit mjekësor është dyzet e gjashtë...

4. Individët nën trajtim të detyruar mjekësor marrin shërbimin e kujdesit shëndetësor në standardet më të mira të mundshme. Ata vendosen me individë të cilët i përkasin së njëjtës kategori, duke respektuar parimet e përgjithshme. Ata janë nën kujdesin e një psikiatri, i cili punon me kohët të plotë për institucionin... Trajtimi i tyre me mjekime është në përputhje me protokollin e mjekimit për mjekimet psikotropike të klasave të ndryshme... Në lidhje me infrastrukturën e përgjithshme, pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm, nuk është e mundur të bëhet më shumë për shkak të numrit të kufizuar të shtretërve dhe një kërkese në rritje të vazhdueshme. Zgjidhja përfundimtare do të ishte krijimi i standardeve duke ndjekur shembullin e vendeve më të zhvilluara dhe... çelja e një institucioni mjekoligjor të posaçëm.

5. Personat me probleme të shëndetit mendor trajtohen me programe individuale trajtimi për personat me çrregullime psikologjike dhe psikiatrike me qëllimin për të përmirësuar gjendjen psikoemocionale...

Midis aktiviteteve rehabilituese dhe terapeutike, duhet të përmendet: këshillimi individual dhe në grup, aktivitetet socio-kulturore... ushtrimet në natyrë... dhe lojërat që luhen në një tavolinë/kornizë...”

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE E BRENDSHME

A. Kuadri legjislativ për personat me sëmundje mendore

1. Kushtetuta

43. Kushtetua parashikon, për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, si më poshtë:

Neni 25

“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor apo poshtërues.”

2. Kodi i Procedurës Penale (KPP).

44. Kodi i Procedurës Penale parashikon, për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, si më poshtë:

Neni 46

Masat mjekësore të detyrueshme

1. Në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik.

2. Kur është vendosur ose duhet vendosur masa mjekësore e detyrueshme për të pandehurin, gjykata urdhëron që i pandehuri të ruhet në një institucion psikiatrik.

3. Gjatë hetimeve paraprake, prokurori i kërkon gjykatës të vendosë për shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik dhe kur vonesa paraqet rrezik, urdhëron shtrimin e përkohshëm deri në marrjen e vendimit nga gjykata

KAPITULLI V

KOMPENSIMI PËR BURGIM TË PADREJTË

Neni 268

Kushtet e zbatimit

1. Ai që është deklaruar i pafajshëm me vendim të formës së prerë ka të drejtën e kompensimit për paraburgimin e vuajtur, me përjashtim të rasteve kur është provuar që vendimi i gabuar ose moszbulimi në kohën e duhur i faktit të panjohur është shkaktuar tërësisht ose pjesërisht prej tij.

2. E njëjta e drejtë i takon edhe të dënuarit që ka qenë i paraburgosur, kur me vendim të formës së prerë vërtetohet se akti me të cilin është caktuar masa është nxjerrë pa qenë kushtet e parashikuara nga nenet 228 dhe 229 [të KPP-së].

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 zbatohen edhe në favor të personit për të cilin është vendosur pushimi i çështjes nga gjykata ose prokurori.

4. Kur me vendim të gjykatës është vërtetuar se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, për shkak të shfuqizimit të dispozitës përkatëse, e drejta e kompensimit nuk njihet për atë pjesë të paraburgimit të vuajtur para shfuqizimit.

Neni 269

Kërkesa për kompensim

1. Kërkesa për kompensim duhet të bëhet, ndryshe nuk pranohet, brenda tre vjetëve nga data në të cilën vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes ka marrë formë të prerë.

2. Masa e kompensimit dhe mënyra e llogaritjes, si dhe rastet e kompensimit për arrestin në shtëpi caktohen me një akt të veçantë.

3. Kodi Penal

45. Kodi Penal parashikon, për sa ka të bëjë me çështjen konkrete, si më poshtë:

Neni 46

Masat mjekësore dhe edukuese

Masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale, ...

Masat mjekësore janë:

1. Mjekimi i detyruar ambulator;

2. Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor;

...

Vendimi gjyqësor për masat mjekësore... është i revokueshëm në çdo kohë kur zhduken

rrethanat për të cilat ai është dhënë. Në çdo rast, gjykata është e detyruar që pas kalimit të një viti nga dita e dhënies së vendimit, të marrë në shqyrtim vendimin e saj.

Rregullat për revokimin e vendimit gjyqësor që përmbajnë masa mjekësore parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.”

4. Kompensimi për burgim të padrejtë (ligji nr. 9381 i datës 28 prill 2005)

46. Sipas seksionit 3 të këtij Akti, burgimi i paligjshëm konsiderohet periudha e: 1) e paraburgimit në rastin kur prokuroria ka ndërprerë hetimin ose gjykata ka liruar të akuzuarin ose ka pushuar çështjen; 2) burgimit pas dënimit nga një gjykatë teksa më vonë dënimi është rrëzuar, është dhënë një vendim lirimi ose Çështja është pushuar me anë të një vendimi të formës së prerë; 3) koha e tejzgatur e vuajtjes së burgimit krahasuar me kohën e dhënë në vendimin e formës së prerë; 4) paraburgimit në rastin kur, me anë të një vendimi të formës së prerë, është provuar se vendimi është lëshuar në shkelje të neneve 228 dhe 229 të KPP-së; 5) paraburgimit përtej afatit statutor; 6) burgimit të paligjshëm për shkak të një gabimi në urdhrin e ekzekutimit, dhe 7) arrestit në shtëpi të parashikuar në paragrafët 1, 3, 4 dhe 5.

5. Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve (ligji nr. 8328, i datës 16 prill 1998, i ndryshuar – në vijim “Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”)

47. Ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim fillimisht u zbatua për të gjithë individët e dënuar me burgim me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë. Ndryshimet e vitit 2014, të cilat hynë në fuqi më 29 maj 2014, e shtrinë zbatueshmërinë e tyre edhe për individët në paraburgim. Për sa ka të bëjë me çështjen përpara Gjykatës, ligji për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim, i ndryshuar në vitin 2014, parashikon si më poshtë:

Neni 10

Individualizimi i trajtimit

“Trajtimi i të paraburgosurit dhe të dënuarve duhet të bëhet sipas kriterit të individualizimit në përputhje me gjendjen dhe karakteristikat individuale të secilit të dënuar.

Individualizimi i trajtimit bëhet duke vlerësuar nevojat individuale psikologjike, shoqërore, të moshës, gjinore, gjendjen shëndetësore, orientimin seksual ose identitetin gjinor, situatën kulturore dhe ekonomike, mjedisin ku ka jetuar i paraburgosuri ose i dënuari, faktorët e riskut dhe motivimin për t’u përfshirë në veprimtaritë që organizohen në institucion.

Vëzhgimi bëhet në fillim të trajtimit dhe rezultatet e tij verifikohen vazhdimisht gjatë ekzekutimit, duke bërë përshtatjet e duhura në bashkëpunim me të dënuarin.”

Neni 11

Programi dhe realizimi i trajtimit

“Pas procesit të vlerësimit bëhet programimi i trajtimit, në bashkëpunim me të paraburgosurin ose të dënuarin.

Për çdo të paraburgosur dhe të dënuar hartohet plani i riintegrit, ndërsa për kategoritë e veçanta të të paraburgosurve dhe të dënuarve hartohet programi individual i trajtimit duke mbajtur parasysh edhe nevojat specifike të tyre. Rëndësi e veçantë i kushtohet trajtimit psikosocial... të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

...

Vëzhgimi, programimi dhe realizimi i trajtimit bëhen nga administrata e institucionit me anë të personelit të vet, në bashkëpunim me organet dhe institucionet shtetërore përkatëse.

...”

Neni 16

Institucionet mjekësore të posaçme dhe seksionet mjekësore të posaçme

“Institucionet mjekësore të posaçme jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale dhe seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale shërbejnë për mjekimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me çrregullime të shëndetit mendor.

Vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës.

Vendosja e personave në seksione mjekësore të posaçme kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës ose të urdhrorit të ekzekutimit të prokurorit. Në rastet që nuk presin, vendosja e personit të paraburgosur ose të dënuar urdhërohet nga drejtori i institucionit ku ndodhet i paraburgosuri ose i dënuari, duke vënë në dijeni menjëherë prokurorin.

Dalja nga institucionet mjekësore të posaçme bëhet me vendim të gjykatës në vijim të propozimit të drejtuesit të institucionit, kërkesës së të paraburgosurit dhe të dënuarit ose kujdestarit ligjor të tij, si dhe me iniciativën e gjykatës, duke respektuar afatin maksimal të një viti për rivlerësimin e gjendjes së personit.

Për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes nga institucionet mjekësore të posaçme, i paraburgosuri dhe i dënuari, mbrojtësi ose kujdestari i tij kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve nga marrja dijeni.

Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetin mendor.

Në institucionet mjekësore të posaçme dhe seksionet mjekësore të posaçme respektohen të gjitha të drejtat e të paraburgosurve dhe të dënuarve, sipas këtij ligji, si dhe të drejtat e pacientit.

Ministri i Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të procedurave që lidhen me trajtimin e kësaj kategorie personash.”

Neni 33/1

Kujdesi shëndetësor për kategori të veçanta

“Shërbimi shëndetësor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale organizohet pa diskriminim...

Trajtimi i personave me çrregullime të shëndetit mendor mbështetet në ligjin për shëndetin mendor. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë seksioneve mjekësore të posaçme të institucioneve ose në qendrën spitalore të burgjeve.

...

Drejtorja e Përgjithshme e Burgjeve merr masa për të mundësuar ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme në institucione dhe, në pamundësi të tyre, në institucione të specializuara jashtë sistemit të burgjeve.”

6. Ligji për shëndetin mendor

48. Ligji për shëndetin mendor, i cili hyri në fuqi në vitin 1996 (ligji nr. 8092, i datës 21 mars 1996) nuk përmbante parashikime për trajtimin e personave të burgosur me sëmundje mendore, të cilët përjashtoheshin nga përgjegjësia penale për shkak të çrregullimeve të shëndetit mendor.

49. Ligji për shëndetin mendor 1996 u zëvendësua me një ligji të ri për shëndetin mendor, i cili hyri në fuqi më 31 maj 2012 (ligji nr. 44/2012). Për sa ka lidhje me çështjen përpara Gjykatës, ligji për shëndetin mendor 2012 parashikon si më poshtë:

Neni 28

Institucionet mjekësore të posaçme

“1. Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239, të Kodit të Procedurës Penale.

2. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e

sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 29

Shëndeti mendor në institucionet e ekzekutimeve penale

“1. Të dënuarit dhe të paraburgosurit që gjenden në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe që vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, gëzojnë të drejtën për trajtim të veçantë shëndetësor pranë këtyre institucioneve ose në Qendrën Spitalore të Burgjeve.

2. Trajtimi dhe përkujdesja për shëndetin mendor, sipas pikës 1, të këtij neni, ofrohet në mënyrë jodiskriminuese dhe sipas standardeve shëndetësore që zbatohen edhe për kategoritë e tjera të personave me çrregullime të shëndetit mendor.

3. Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet shërbimeve të shëndetit mendor, ofron, sipas nevojave, të gjithë asistencën e nevojshme për diagnostikimin, kurimin dhe rehabilitimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, sipas pikës 1 të këtij neni.”

7. *Ligji për ekzekutimin e vendimeve penale (ligji nr. 8331/1998, ndryshuar me ligjin nr. 10024/2008)*

50. Neni 13, i ligjit për ekzekutimin e vendimeve penale parashikon se prokurori lëshon një urdhër ekzekutimi për vendimet penale. Neni 46 përcakton se “masat mjekësore në lidhje me trajtimin e detyruar ekzekutohen në një institucion të specializuar mjekësor, sipas përcaktimit të Ministrisë së Shëndetit, me kërkesë të prokurorit”.

8. *Mjediset për personat me çrregullime mendore*

51. Sipas planit të veprimit për zhvillimin e shërbimeve të shëndetit mendor për periudhën 2013-2022, sipas përcaktimeve në faqen e internetit të Ministrisë së Shëndetësisë², rrjeti i godinave civile për shëndetin mendor përbëhen nga spitalet psikiatrike, pavijonet e psikiatrisë në spitalet civile, qendrat komunitare të shëndetit mendor dhe qendrat rezidenciale (të përkujdesjes).

B. Legjislacioni tjetër i brendshëm

Kodi i Procedurës Civile

52. Më 5 nëntor 2017, hynë në fuqi një sërë ndryshimesh në Kodin e Procedurës Civile (ligji nr. 38/2017). Nenet përkatëse mbi kohëzgjatjen e procedimeve parashikojnë si më poshtë:

“Kapitulli X – Gjykimi i kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përsheptimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit

Neni 399/1 Objekti

1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë krye, hyjnë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.

...

Neni 399/9 - Pranimi i kërkesës

1. Gjykata vendos pranimin e kërkesës, kur vërtetohet shkelja e afatit të arsyeshëm, sipas nenit 6/1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore.

....”

C. Praktika gjyqësore dhe raportet e brendshme

1. *Vendimet e Gjykatës së Lartë*

53. Në vendimin e saj nr. 00-2014-1950, të datës 14 korrik 2014, Gjykata e Lartë përcaktoi kategoritë e ndryshme të njerëzve, shëndeti mendor i të cilëve do të ndikonte në rezultatin e procedimeve penale, duke përfshirë: individët të cilët nuk ishin përgjegjës penalisht në kohën e kryerjes së një vepre penale, por ishin subjekte të procedimeve penale, dhe ndaj të cilëve gjykata vendos një masë mjekësore të detyrueshme; individët të cilët ishin pjesërisht përgjegjës në kohën e

² <https://shendetesia.gov.al/ep-content/uploads/2018/08/pv1/pdf>

kryerjes së një vepre penale dhe ishin subjekte të procedimeve penale, të masave të sigurisë dhe që në fund u dënuan me një dënim më të ulët; individët të cilët kishin përgjegjësi penale përpara kryerjes së një vepre penale dhe, pas kryerjes së veprës, kanë pasur çrregullime ose sëmundje të shëndetit mendor dhe që ishin në pritje të gjykimit penal sipas të cilit do të urdhërohej edhe trajtimi mjekësor, në përputhje me nenet 43-46, të Kodit të Procedurës Penal, ose sipas ligjit mund të urdhërohej pezullimi i procedurave penale; individët e dënuar për një vepër penale (ata kanë pasur përgjegjësi penale në kohën e kryerjes së veprës dhe gjatë gjykimit), të cilët vuanin nga çrregullime të shëndetit mendor teksa vuanin dënimin me burgim, çrregullimet e shëndetit mendor të të cilëve do të ishin një pengesë për ekzekutimin e vendimit penal dhe sipas të cilit mund të urdhërohej lirimi përpara kohe nga burgu.

54. Gjykata e Lartë gjykon se në mbështetje të nenit 46, të Kodit Penal, një gjykatë mund të japë urdhrin për masa mjekësore vetëm për personin i cili nuk ka përgjegjësi penale për kryerjen e një vepre penale dhe është përjashtuar nga përgjegjësia penale për shkak të shëndetit të tij/saj mendor. Lloji i masës mjekësore që urdhërohet do të ishte në varësi të gjendjes psikiatrike të autorit të veprës, rrezikut që ai ose ajo paraqet për shoqërinë, dhe nevojës për trajtim. Neni 16, i ligjit për të drejtat dhe trajtimin e individëve të dënuar me burgim dhe të paraburgosurve parashikonte vendosjen e individëve në paraburgim dhe atyre të dënuar me burgim me çrregullime të shëndetit mendor në institucione të posaçme mjekësore, [që duhet të ndërtohen] jashtë sistemit penal, për të marrë trajtim mjekësor në zbatim të një vendimi gjykatë.

55. Gjykata e Lartë i përsërit këto parime në vendim e radhës nr. 00-2016-347, të datës 2 mars 2016.

2. Raportet e Avokatit të Popullit

56. Kërkuesi paraqiti katër raporte të përgatitur nga Zyra e Avokatit të Popullit, në rolin e tij si Mekanizmi Kombëtar Parandalues, i krijuar sipas protokollit fakultativ të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të tjera të Ashpra, Çnjerëzore dhe Poshtëruese.

Raportet në lidhje me Qendrën Spitalore të Burgut

i) Raporti i datës 22 janar 2015

57. Më 22 janar 2015, Avokati i Popullit nxori një raport pas një vizite në Qendrën Spitalore, më datë 9 dhjetor 2014. Raporti vërente se Qendra Spitalore e Burgut kishte një kapacitet prej nëntëdhjetë e nëntë vendesh, teksa në kohën e vizitës kishte një total prej nëntëdhjetë e shtatë të burgosurish, duke përfshirë pesëdhjetë e një individë, të cilët merrnin “trajtim të detyruar”, me urdhër gjykatë dhe me “shtrim të përkohshëm”. Nuk kishte ndarje midis individëve në paraburgim dhe atyre me burgim. Të shtruarit ishin vendosur në tri pavijone të ndryshme sipas natyrës së sëmundjeve nga të cilat vuanin.

58. Në lidhje me kushtet materiale, godina ishte në një gjendje të avancuar rrënim, me lagështirë të përhapur gjithandej në mure dhe një mungesë të plotë ngrohje qendrore. Ekipi inspektues mori ankesa për gjendjen e higjienës dhe kushtet sanitare, si edhe për mungesën e një sistemi për ngrohje qendrore. Dushet ishin në një gjendje emergjente për riparim. Kishte mungesë të produkteve bazë të higjienës, të cilat siguroheshin nga familjarët. Edhe pse nuk kishte probleme me furnizimin me ujë, të shtruarit raportuan, sidoqoftë se, kishte pasur raste kur nuk kishte ujë të ngrohtë për të bërë një dush.

Në lidhje me sigurinë, godina ishte e pajisur me kamera CCTV (kamera të videove televizive me qark të mbyllur), të instaluar në mjediset e jashtme dhe të brendshme të godinave.

59. Të shtruarit mund t'i takonin familjarët e tyre katër herë në muaj në një hapësirë të caktuar specifikisht për këtë qëllim. Pavijoni i psikiatrisë përbëhej nga dhjetë dhoma, në të cilat mungonin mobiliet. Dyshekët dhe çarçafët e shtretërve ishin të gërricur. Ekipi inspektues u informua se dëmet në mobilie dhe në çarçafët e shtretërve mund t'u atribuoheshin të shtruarve. Megjithatë, sipas Avokatit të Popullit, ky pretendim nuk ishte i mjaftueshëm për të justifikuar faktin se të shtruarit mbaheshin në kushte poshtëruese dhe çnjerëzore. Ndriçimi natyral ishte i dobët për shkak të dritareve të vogla, ndërsa ndriçimi artificial nuk ishte i mjaftueshëm.

60. Për sa i përket realizimit të ndonjë aktiviteti, nuk kishte librari dhe as vende lutjeje. Personeli psiko-social pohoi se realizimi i aktiviteteve ishte i rrallë për shkak të mungesës së mjediseve të përshtatshme dhe gjendjes shëndetësore të të shtruarve. Aktivitetet në grupe të vogla në lidhje me çështjet sociale dhe aktuale organizoheshin dy herë në muaj. Këshillimi individual kryhej një herë në muaj me secilin të shtruar, ndërkohë që nuk kishte këshillim në grup. Terapia artistike dhe orët e kopshtarisë zhvilloheshin me raste. Planet për trajtim individual fokusoheshin më së shumti te njerëzit, të cilët kishin bërë përpjekje të kryenin vetëvrasje ose te të varurit nga droga. Ndërhyrja e personelit psiko-social nuk koordinohet në mënyrë të kënaqshme me personelin mjekësor.

61. Të gjithë të shtruarit ishin të kënaqur me ofrimin e kujdesit shëndetësor. Doktorët kryenin konsulta të përditshme çdo mëngjes. Në farmaci kishte pasur mungesë mjekimesh, të cilat ishin sjellë pas alokimit të burimeve buxhetore shtesë.

ii) Raporti i datës 5 janar 2016

62. Më 5 janar 2016, Avokati i Popullit nxori një raport pas vizitës në Qendrën Spitalore të Burgut, më datë 25 nëntor 2015. Raporti nënvizonte se Qendra Spitalore e Burgut kishte një kapacitet prej nëntëdhjetë e nëntë vendesh, ndërsa në kohën e vizitës kishte 103 të shtruar, duke përfshirë gjashtëdhjetë individë të cilët ishin subjekte të një urdhri gjykatë për “trajtim të detyruar” dhe “shtrim të përkohshëm”.

63. Raporti përmbante pothuajse të njëjtat gjetje si ato të përshkruara në raportin e datës 22 janar 2015.

3. Protokoll i për diagnozën dhe kujdesin terapeutik të skizofrenisë

64. Protokoll i për diagnozën dhe kujdesin terapeutik të skizofrenisë, i cili u referua nga kërkuesi gjatë grupit të pestë të procedimeve gjyqësore (*shih paragrafin 23 më sipër*), fillimisht u publikua në muajin dhjetor 2010 dhe u miratua nga Ministria e Shëndetësisë. Paragrafët më poshtë janë disa pjesë të shkëputura në lidhje me trajtimin e sëmundjes.

“1.3 Rëndësia e trajtimit të duhur të skizofrenisë

... Skizofrenia është një nga shkaqet kryesore të paaftësisë në të gjithë botën. Është sëmundja e tetë kryesore për njerëzit nga moshë 15 deri në 45 vjeç, sipas një studimi të realizuar nga Organizata Botërore e Shëndetit. Trajtimi optimal i pacientëve duhet të jetë shumëplanësh. Një gjë e tillë kërkon kombinimin e terapive më të mira farmakologjike me terapitë më të mira jofarmakologjike. Veçanërisht kur përmirësimi ndodh si rezultat i administrimit të dozave të vogla [të mjekimeve], duke përdorur antipsikotikë (neuroleptikë) (antipsikotikë atipikë të rinj ose të vjetër), pacientët mund të marrin pjesë në një sërë programesh rehabilitimi psiko-socialë. Qëllimi i një kursi të suksesshëm trajtimi do të jetë reduktimi i simptomave, parandalimi i një episodi psikotik në të ardhmen dhe riintegrimi i individit në jetën sociale. Një plan trajtimi, i cili kombinon mjekimin me terapitë mbështetëse konsiderohet një plan efikas.”

III. MATERIALET PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE

A. Raportet nga Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (KPT)

1. Raporti i datës 22 janar 2003 (CPT/Inf (2003) 9)

65. Më datë 22 janar 2003 u publikua raporti i KPT-së për një vizitë periodike në Shqipëri nga data 4 deri në datën 14 dhjetor 2000. Raporti nënvizonte se shumica e personave të sëmurë mendërisht të cilët ishin deklaruar se nuk kishin përgjegjësi penale duhej të ishin vendosur në një spital psikiatrik të sigurisë së lartë. Në vend të kësaj, për shkak të mungesës së një institucioni të tillë, ata ishin pranuar në Qendrën Spitalore të Burgut.

2. Raporti i datës 22 janar 2003 (CPT/Inf (2003)11)

66. Në Raportin e tij të datës 22 janar 2003, pas një vizite të posaçme në Shqipëri nga data 22 deri më 26 tetor 2001, KPT-ja nënvizoi se për sa i përket zbatimit të ligjit për shëndetin mendor 1996 “Ligji, i cili përfshin një sërë garancish me qëllimin për të ruajtur të drejtat themelore të pacientëve, nuk ishte zbatuar ende në Shqipëri, siç duket për shkak të mungesës së vullnetit dhe bashkëpunimit midis palëve të ndryshme (kryesisht anëtarë të profesioneve mjekësore dhe gjyqësore). Siç edhe është

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

deklaruar më herët (*shih KPT-në (2001) 29, paragrafi 138*), një ngërç i tillë mund të cenojë themelet e shtetit të së drejtës në Shqipëri dhe përjetëson imazhin e një psikiatrie me bazë azili, e cila besohet se kishte mbetur në histori. Për këtë arsye, KPT-ja mirëpret vendimi e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë për të ngritur një komision interministerial për të shqyrtuar këtë çështje me departamentet e tjerë përkatës, duke përfshirë Ministrinë e Drejtësisë. KPT-ja dëshiron të marrë informacione të përditësuara mbi ecurinë e kësaj çështje”.

3. Raporti i datës 12 korrik 2006 (CPT/Inf (2006)22)

67. Në raportin e tij të datës 12 korrik 2006, pas një vizite të posaçme në Shqipëri, nga data 13 deri më 18 korrik 2003, KPT-ja përsëriti të njëjtat gjetje, ashtu si edhe në raportin e datës 22 janar 2003, në lidhje me zbatimin e ligjit për shëndetin mendor 1996.

4. Raporti i datës 12 korrik 2006 (CPT/Inf (2006)24)

68. Në raportin e tij, të datës 12 korrik 2006, pas një vizite periodike në Shqipëri nga data 23 maj deri më 3 qershor 2005, KPT-ja nënvizoi se “ishin shumë të shqetësuar për faktin se për shkak të mungesës së lehtësirave të përshtatshme alternative, individët të cilët nuk ishin deklaruar përgjegjës penalisht, mbaheshin ende në mjediset e burgut [më konkretisht Qendra Spitalore e Burgut]”. KPT-ja i bëri thirrje autoriteteve shqiptare të ndërmerrnin hapa pa u vonuar më shumë për t’i vendosur personat, të cilët nuk ishin deklaruar përgjegjës penalisht, në një godinë më të përshtatshme”.

69. KPT-a theksoi se “Ligji për shëndetin mendor 1996 nuk po zbatohet ende, pavarësisht rekomandimit specifik të dhënë në mënyrë të përsëritur nga KPT-ja në të gjitha raportet për vizitat e tij të mëparshëm dhe pavarësisht garancive dhënë nga autoritetet shqiptare në përgjigjen e tyre për vizitën e vitit 2003”.

5. Raporti i datës 6 shtator 2007 (CPT/Inf (2007)35)

70. KPT-ja realizoi një vizitë të posaçme në Shqipëri nga data 28 deri më 31 mars 2006, në lidhje me dështimin e vazhdueshëm të autoriteteve për të zbatuar ligjin për shëndetin mjekësor 1996. KPT-ja konstatoi se vazhdonte të ishte e njëjta gjendje.

6. Raporti i datës 21 janar 2009 (CPT/Inf (2009)6)

71. Në Raportin e tij të datës 21 janar 2009, pas një vizite të posaçme në Shqipëri në periudhën 16 deri më 20 qershor 2008, KPT-ja iu referua konsultimeve me autoritetet në lidhje me “situatën e individëve të cilët janë deklaruar të papërgjegjshëm penalisht dhe në këtë mënyrë i janë nënshtruar masave mjekësore për “trajtim të detyruar mjekësor në institucionin mjekoligjor” (sipas nenit 46/1, të Kodit Penal). Faktikisht, të gjithë individët në fjalë (shtatëdhjetë e tetë në kohën e vizitës) mbaheshin ende në Qendrën Spitalore të Burgut, për shkak të mungesës së mjediseve të përshtatshme jashtë sistemit të burgjeve”. KPT-ja inkurajonte autoritetet “të bënte të gjitha organizimet e nevojshme për të siguruar hapjen e [një] institucioni mjekoligjor pa vonesë”.

7. Raporti i datës 20 mars 2012 (CPT/Inf (2012) 11)

72. Në raportin e tij, të datës 20 mars 2012, pas një periudhe periodike në Shqipëri nga datat 10 deri më 21 maj 2010, KPT-ja “ngrinte pyetjen e pranisë në Qendrën Spitalore të Burgut, më shumë se 13 vjet pas vizitës së tij të parë në Shqipëri, të pacientëve psikiatrikë të deklaruar të papërgjegjshëm penalisht dhe të nënshtruar ndaj një mase për trajtim të detyruar sipas [nenit 46/1], të Kodit Penal dhe të pacientëve psikiatrikë, të nënshtruar një shtrimi spitalor të përkohshëm sipas nenit 239 të KPP-së. Këta pacientë ende mbaheshin në Qendrën Spitalore të Burgut, në vend që të ishin në një institucion mjekësor të specializuar ose në një godinë psikiatrike, sipas... parashikimit në legjislacionin përkatës shqiptar. Deri më sot, autoritetet shqiptare nuk kanë mundur të gjejnë një zgjidhje të kënaqshme për këtë problem, dhe ka pasur shumë pavendosmëri për ndërtimin e një godine të posaçme në Durrës ose në Krujë”.

73. KPT-ja nënvizoi se “Qendra Spitalore e Burgut nuk ishte e mbipopulluar... të gjitha dhomat... kishin një lavaman dhe një strukturë sanitare të ndarë. Gjithashtu, ato ishin të përmasave të arsyeshme dhe ndriçoheshin mjaftueshëm me dritë natyrale, si edhe ndriçim artificial. Për më tepër, dhomat ishin të pajisura me mjaftueshëm mobilie. Në përgjithësi, gjendja e përgjithshme e higjienës dhe e pastërtisë në [Qendrën Spitalore të Burgut] mund të përshkruhej, në përgjithësi, si e kënaqshme... në lidhje me

stafin dhe trajtimin, me përjashtim të dukshëm të kujdesit psikiatrik, numri i stafit të kujdesit shëndetësor në [Qendrën Spitalore të Burgut], në tërësi mund të konsiderohej si i kënaqshëm... kishte një mungesë të theksuar stafi për sa i përket kujdesit psikiatrik. Një psikiatër i vetëm – dashamirësia dhe energjia e të cilit duhet të theksohen – ishte përgjegjës për mbi 70 pacientë psikiatrikë (nga 87 pacientët e pranishëm në spital), prej të cilëve 60 ishin deklaruar të papërgjegjshëm penalisht dhe subjekte të një urdhri të detyrueshëm trajtimi. Një mungesë e tillë e mjekëve, gjatë turneve, duhet të marrë një përgjigje të shpejtë dhe vendimtare nga autoritetet shqiptare. [Qendra Spitalore e Burgut] duhet të përfitojë nga të paktën dy mjekë psikiatër me kohë të plotë. KPT-ja rekomandon marrjen e masave urgjente për këtë situatë.”

8. Raporti i datës 3 mars 2016 (CPT/Inf (2016) 6)

74. Më 3 mars 2016, u publikua raporti i KPT-së në lidhje me një vizitë periodike në Shqipëri nga data 4 deri më 14 shkurt 2014. Pas vizitës në Qendrën Spitalore të Burgut dhe Burgut të Krujës. KPT-ja nënvizoi se “ishite një çështje shqetësuese fakti se pavarësisht rekomandimit specifik të bërë në mënyrë të përsëritur nga KPT-ja, që prej vitit 2000, 17 pacientë psikiatrikë të deklaruar pa përgjegjësi penale vijuan të mbaheshin në mjediset e burgut në shkelle të legjislacionit vendës, për shkak se nuk ishte ndërtuar ende një institucion i specializuar mjekoligjor psikiatrik. Gjithashtu, dy të tretat e pacientëve psikiatrikë nën trajtim të detyruar me urdhër gjykate (76 nga 104 pacientë), gjatë vizitës së bërë në vitin 2014, mbaheshin në Burgun e Krujës në kushte, të cilat sipas këndvështrimit të Komisionit, kishte mundësi të ktheheshin në një braktisje terapeutike. Në fakt, godina prej mbi një vit nuk kishte asnjë mjek psikiatër, stafi i infermierëve ishte reduktuar ndjeshëm dhe nuk ofrohej asnjë aktivitet rehabilitues i denjë.”

75. Në vijim, KPT-ja nënvizonte se kushtet materiale në Qendrën Spitalore të Burgut në tërësi ishin të kënaqshme. Megjithatë, mungesa pothuajse totale e ngrohjes ishte e papranueshme. Pacientët përfitonin vetëm prej dy orëve me ushtrime në mjediset e jashtme, por ata ishin të izoluar për pjesën tjetër të ditës, pa iu ofruar ndonjë veprimtari me një qëllim të caktuar. Niveli i stafit të kujdesit shëndetësor në përgjithësi kishte mbetur i kënaqshëm. Gjithsesi, KPT-ja theksonte se ishte “totalisht e pamjaftueshme që Qendra Spitalore e Burgut të kishte vetëm një mjek psikiatër për t’u kujdesur për 60 pacientë psikiatër në total (duke përfshirë 26 pacientë mjekoligjorë, nën një urdhër për trajtim të detyruar). Situata është përkeqësuar më tej nga fakti se mjeku psikiatër ishte *de facto* përgjegjës edhe për trajtimin e të gjithë pacientëve psikiatrikë në Burgun e Krujës.” KPT-ja i bëri thirrje autoriteteve të merrnin masa urgjente për të përforcuar trajtimin psikiatrik në Qendrën Spitalore të Burgut.

76. KPT-ja konstatoi se trajtimi psikiatrik në Qendrën Spitalore të Burgut vijonte të mbështetej kryesisht në farmakoterapi dhe nuk kishte vërejtur ndonjë mungesë të mjekimeve psikotropike. Në mungesë të aktiviteteve terapeutike psiko-sociale, KPT-ja rekomandonte që aktivitete të tjera profesionale dhe psiko-sociale të zhvillohen më tej në Qendrën Spitalore të Burgut dhe t’i ofrohej një numri maksimal pacientësh psikiatri, veçanërisht atyre të cilët ishin subjekte të urdhrit për trajtim të detyruar.

9. Raporti i datës 24 maj 2018 (CPT/Inf (2018) 18)

77. Pas një vizite të posaçme në Shqipëri nga data 2 deri më 9 shkurt 2017, në raportin e tij më 24 maj 2018, KPT-ja shprehu “shqetësimin serioz se pavarësisht rekomandimit specifik të bërë në mënyrë të vazhdueshme që prej vizitës së vitit 2000 dhe në kundërshtim me legjislacionin vendës, pacientët psikiatrik mjekoligjorë vazhdonin të mbaheshin [në Qendrën Spitalore të Burgut dhe Burgun e Krujës] nën kushte, të cilat sipas këndvështrimit të KPT-së, lehtësisht mund të konsideroheshin si çnjerëzore dhe poshtëruese për shumë pacientë. Faktikisht, kushtet e jetesës në të dy godinat ishin përkeqësuar edhe më shumë që prej vizitës së vitit 2014 (veçanërisht, për sa i përket nevojës për riparim dhe mbipopullimit), kishte një mungesë pothuajse totale të ngrohjes dhe përdorim të limituar të ujit të ngrohtë, ndërsa niveli i kujdesit psikiatrik mbetej qartazi i pamjaftueshëm. Në tërësi, delegacioni krijoi edhe një herë përshtypjen e “braktisjes terapeutike” për shumë pacientë psikiatrikë mjekoligjorë.” KPT-ja i bëri thirrje autoriteteve shqiptare që të përgatisnin pa vonesa të mëtejshme një plan të detajuar për krijimin e një godine psikiatrike mjekoligjore, si edhe

të ndërmerrnin hapat e nevojshëm për të garantuar ndërtimin e përshtetshëm të një godine të tillë.

78. KPT-ja konstatoi se kushtet materiale ishin përkeqësuar për sa kishte të bënte me nevojën për riparim dhe higjienën si në Burgun e Krujës edhe në Qendrën Spitalore të Burgut. Një sërë qelish në Qendrën Spitalore të Burgut ishin të mbipopulluara dhe KPT-ja u trondit nga mungesa pothuajse totale e ngrohjes që prej vitit 2014. Ai bëri një sërë rekomandimesh për autoritetet që të merrnin masa për të përmirësuar kushtet e jetesës, si edhe për të reduktuar nivelet e mbipopullimit më Spitalin e Burgut.

79. KPT-ja i pranonte vështirësitë me të cilat përballej administrata e burgut për rekrutimin e specialistëve në fushën e psikiatrisë, por sidoqoftë, ai shprehu shqetësimin se pavarësisht rekomandimit specifik të dhënë pas vizitës së bërë në vitin 2014, trajtimi psikiatrik në Qendrën Spitalore të Burgut nuk ishte rritur. Ende kishte vetëm një mjek psikiatër për 84 pacientë psikiatrikë (dhe gjashtë të burgosur me një çrregullim mendor).

10. Raporti i datës 17 shtator 2019 (CPT/Inf (2019) 28)

80. Në raportin e tij, të datës 17 shtator 2019, pas vizitës periodike në Shqipëri nga data 20 deri më 30 nëntor 2018, KPT-ja “shprehu shqetësimin serioz se pavarësisht rekomandimit specifik të bërë vazhdimisht nga Komisioni që prej vizitës së vitit 2000 dhe në kundërshtim me legjislacionin vendës, pacientët psikiatrikë mjekoligjorë vijonin të mbaheshin në Qendrën Spitalore të Burgut dhe në Burgun e Krujës, në kushte të papranueshme. Faktikisht, kushtet e jetesës në këto dy godina ishin përkeqësuar edhe më shumë që prej vizitës së vitit 2014 (veçanërisht për sa i përket nevojës për riparim dhe mbipopullimit), teksa niveli i kujdesit psikiatrik mbetej qartazi i pamjaftueshëm. Në përgjithësi, Komisioni krijoi përshtypjen e një “braktisje terapeutike” për shumë pacientë psikiatrikë mjekoligjorë.”

81. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Drejtësisë kishin theksuar se “Qeveria ishte plotësisht e angazhuar për krijimin e një godine mjekoligjore për kujdes psikiatrik, si një çështje për t’u trajtuar me prioritet dhe se po vijonin konsultimet me donatorët e mundshëm në lidhje me bashkëfinancimin për ndërtimin e saj në aftësi të Tiranës, megjithatë KPT-ja vërejti se hapja e një godine të përkohshme për akomodimin e personave të sëmurë mendërisht “ishte shumë e vonuar dhe se kishte ende një mungesë të theksuar qartësisë në lidhje me rolin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, menaxhimin dhe stafin e godinës në të ardhmen.”

B. Raporti i Komisioneres së Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut

82. Komisionerja e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (Komisionerja) dhe delegacioni i saj vizituan Shqipërinë nga data 21 deri më 25 maj 2018. Në përmbledhjen e raportit, Komisionerja pohonte si më poshtë:

“Komisionerja është e shqetësuar për faktin se pavarësisht angazhimit të autoriteteve për orientimin drejt deinstitutionalizimit, ka ende persona me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psiko-sociale, duke përfshirë fëmijët në institucionet për kujdesin social në Shqipëri. I bëhet thirrje autoriteteve të hartojnë dhe të zbatojnë, me përfshirjen aktive të personave me aftësi të kufizuara, një plan të detajuar për deinstitutionalizimin dhe zëvendësimin e institucioneve me shërbime të bazuara në komunitet, duke garantuar se asnjë person i deinstitutionalizuar me një aftësi të kufizuara nuk do të mbetet pa mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme. Heqja dorë nga rastet e reja të vendosjes së personave me aftësi të kufizuara në mjedise institucionale dhe garantimi se këtyre personave u ofrohen shërbime të mbështetura në komunitet, do të ishte një hap i rëndësishëm në drejtësinë e duhur.”

LIGJI

I. KUNDËRSHTIMET PARAPRAKE TË QEVERISË

83. Qeveria parashitroi se pretendimet e kërkuarit duhej të kundërshtoheshin për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme. Ata pohuan se kërkuari kishte aplikuar në gjykatat vendëse për rivlerësimin e shëndetit të tij mendor dhe për rishqyrtimin e trajtimit të detyruar me shtrim spitalor. Si përgjigje, Gjykata e Lartë kishte marrë dy vendime të formës së prerë më 30 maj 2013 dhe 25 shtator 2014. Çdo ankesë për ato grupe procedimesh, të cilat kishin përfunduar me vendimet e formës së prerë të

Gjykatës së Lartë, do të duhej të rrëzohej nga Gjykata nën cilësimin për tejkalim afati.

84. Në lidhje me dy grupet e tjera të procedimeve në të cilat kërkuesi kishte aplikuar në gjykatat e brendshme për të ndaluar trajtimin e tij poshtërues dhe çnjerëzor, Qeveria parashtrroi se ato ishin ende pezull në Gjykatën e Lartë dhe për këtë arsye duhej të rrëzoheshin si të parakohshme.

85. Si pjesë e formularit të tij të aplikimit, kërkuesi parashtrroi se në sistemin e brendshëm nuk kishte mjete efikase për ankesat e tij në lidhje me Konventën. Ai argumentoi se gjykatat e brendshme kishin lejuar që e njëjta situatë të vijonte, dhe pavarësisht ankesave të tij të pasuksesshme, ai vazhdonte të ishte viktimë e një praktike e cila shkelte Konventën.

A. Shterim i mjeteve të brendshme

86. Gjykata përsërit se rregulli i shterimit të mjeteve të brendshme i detyron ata persona të cilët kërkojnë të paraqesin çështjen e tyre kundër Shtetit përpara një organi gjyqësor ose arbitror ndërkombëtar për të përdorur fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi ligjor vendës. Rregulli mbështetet në prezumimin se ekziston një mjet efikas i disponueshëm për shkeljen e pretenduar në sistemin e brendshëm, pavarësisht nëse dispozitat e Konventës janë të inkorporuara në ligjin e brendshëm ose jo. Në këtë mënyrë, është një aspekt i rëndësishëm i parimit se makineria e mbrojtjes e krijuar nga Konventa është suplementare në sistemet e brendshme në mbrojtje të të drejtave të njeriut (*shih Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë [DHM], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, §220, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)*). Në të njëjtën kohë, është detyrë e Qeverisë të pretendojë mosshterimin për të bindur Gjykatën se mjeti ishte efikas, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në kohën e caktuar, që do të thotë, se ishte i arritshëm, mund të ofronte korrigjim për pretendimet e ankuesit dhe ofronte një perspektivë të arsyeshme suksesi (*shih Grori kundër Shqipërisë”, nr. 25336/04, §108, 7 korrik 2009*).

87. Duke u rikthyer në faktet e çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi përdori mjete të brendshme të ndryshme pa asnjë dobi, duke kërkuat lehtësim nga gjykatat vendëse për shkeljet e pretenduara të neneve 3 dhe 5 të Konventës. Qeveria nuk provoi se në kohën kur kërkuesi paraqiti kërkesën në Gjykatë ose më pas, kishte pasur një mjet tjetër, të disponueshëm në teori dhe praktikë, i cili të mund të ofronte korrigjim.

88. Në vijim, Gjykata vëren se dy grupet e procedimeve në të cilat kërkuesi kundërshtonte kushtet dhe ligjshmërinë e burgimit të tij, ishin pezull përpara Gjykatës së Lartë që prej muajit prill 2015 dhe janar 2016, dhe se nuk ishte dhënë asnjë vendim. Në këto rrethana, dhe duke qenë se kërkuesi ishte ende në burgim, në momentin kur paraqiti kërkesën e tij, Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesit sipas neneve 3 dhe 5 të Konventës nuk mund të konsiderohen si të parakohshme në lidhje me procedimet gjyqësore të pritshme, dhe as nuk mund të konsiderohen të papranueshme për shkaqe mosshterimi (*shih, për shembull, Hadžić dhe Suljić kundër Bosnje-Hercegovinës, nr. 39446/06 dhe 33849/08, §32, 7 qershor 2011*).

89. Për këtë arsye, kundërshtimi i Qeverisë duhet të pushohet.

B. Pajtim me afatin kohor gjashtëmujor

90. Gjykata përsërit se kërkesat në nenin 35 §1 në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme dhe periudha gjashtëmujore fillojnë që prej datës së vendimit të formës së prerë në procesin e shfrytëzimit të mjeteve të brendshme. Në rastin kur për kërkuesin nuk është i disponueshëm asnjë mjet efikas, periudha fillon që prej datës së akteve ose masave për të cilat është bërë ankesë, ose që prej datës kur njoftohet ai akt ose efektet e tij mbi ose dëmi ndaj kërkuesit (*shih Varnava dhe të tjerët kundër Turqisë [DHM], nr. 16064/90 dhe 8 të tjerë, §157, GJEDNJ 2009*). Gjykata, në vijim, pohon se rregulli gjashtë-mujor nuk zbatohet për situatat në vijimësi (po këtu, §159). Në të tilla raste, periudha gjashtëmujore fillon që prej ndërprerjes së asaj situatë (*shih Iordache kundër Rumanisë, nr. 6817/02, §50, 14 tetor 2008*). Koncepti i “situatës në vijimësi” i referohet një situatë e cila vihet në lëvizje nga aktivitete të vazhdueshme nga ose për Shtetin për ta kthyer kërkuesin në viktimë (*shih Petkov dhe të tjerët kundër Bullgarisë (vendim), nr. 77568/01, 178/02 dhe 505/02, 4 dhjetor 2007*).

91. Tashmë, Gjykata do të shqyrtojë rregullin gjashtë-mujor për burgimin e kërkuesit në Burgun e Krujës dhe në Qendrën Spitalore të Burgut.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

1. Në lidhje me kohën e kaluar në Burgun e Krujës

92. Gjykata thekson se si rezultat i trajtimit mjekësor të detyruar me urdhër gjyqate, më 25 mars 2009, kërkuesi u vendos në Burgun e Krujës, ku qëndroi deri më 20 qershor 2011, kur u transferua në Qendrën Spitalore të Burgut. Megjithatë, kërkuesi e paraqiti kërkesën e tij në Gjykatë, më 11 qershor 2016, pothuajse pesë vjet pasi ishte larguar nga Burgu i Krujës. Shumica e procedimeve gjyqësore ndodhën pas transferimit të tij nga ajo godinë. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se kjo pjesë e kërkesës u paraqit përtej afatit sipas parashikimeve në nenin 35 §1 të Konventës, dhe për këtë arsye e rrëzon atë.

2. Në lidhje me kohën e kaluar në Qendrën Spitalore të Burgut

93. Gjykata vëren se më 20 qershor 2011, kërkuesi u transferua në Qendrën Spitalore të Burgut, në mbështetje të dokumenteve në dosjen e çështjes, ku edhe ka qëndruar që prej asaj date (*shih paragrafin 13 më sipër*). Në një sërë rastesh, në vitin 2013 dhe 2014, kërkuesi kundërshtoi pa sukses izolimin e tij në Qendrën Spitalore të Burgut, kushtet në të cilat mbahej dhe trajtimin mjekësor të pretenduar si të papërshtatshëm që i ofrohej (*shih paragrafët 14, 16, 23 dhe 27 më sipër*). Dy grupe procedimesh gjyqësore të ndërmarra nga kërkuesi kanë mbetur pezull në gjykatat vendëse që prej muajit prill 2015 dhe janar 2016. Kërkuesi ka ngritur të njëjtat ankesa në kërkesën e tij për Gjykatën.

94. Gjykata konstaton se, në lidhje me natyrën e vazhdueshme të izolimit të kërkuesit në Qendrën Spitalore të Burgut, ku mbahet që prej vitit 2011, kushtet e pandryshuara të izolimit, mungesa e trajtimit të duhur mjekësor për të cilin ankohet dhe procedimet gjyqësore të mbetura pezull, ankesat e tij në mbështetje të neneve 3 dhe 5 i referohen një "situate vijimesie" (*shih, për shembull, Alimov kundër Turqisë, nr. 14344/13, §57-62, 6 shtator 2016; Fetisov dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 43710/07 dhe 5 të Tjerë, §75, 17 janar 2012, dhe Svijska kundër Letonisë, nr. 66820/01, §116 GJEDNJ 2006-III (ekstrakte)*).

95. Rrjedhimisht, kundërshtimi i Qeverisë duhet të pushohet.

C. Përfundim

96. Gjykata vendos se pretendimet e kërkuesit nuk janë qartazi të pabazuara sipas interpretimit të nenit 35 §3 (a) të Konventës. Në vijim, ajo konstaton se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 3 TË KONVENTËS

97. Kërkuesi pretendonte se mungesa e trajtimit të duhur mjekësor e marrë gjatë arrestit të tij, e kombinuar me kushtet e këqija të arrestit, shkaktuan shkelje të nenit 3 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

"Askush nuk mund t'i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese."

A. Parashtrimet e palëve

1. Kërkuesi

98. Kërkuesi parashitroi se izolimi i tij në Qendrën Spitalore të Burgut, i kombinuar me trajtimin e papërshtatshëm mjekësor të marrë, sollën një trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Në këtë këndvështrim, autoritetet kombëtare nuk kishin bërë dallimin midis karakterit ndëshkues të një dënimi në burg dhe natyrës jondëshkuese të një urdhri për trajtim të detyruar mjekësor. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme të kërkuesit, gjykatat e brendshme i kishin rrëzuar pretendimet e tij, mbështetur në argumentin se trajtimi jashtë spitalit i pacientit, kur është fjala për kërkuesin, do të përbënte një rrezik për interesin publik, ndërsa konstatimet e autoriteteve monitoruese të brendshme dhe ndërkombëtare, për kushtet e arrestit, nuk cilësoheshin si mjaftueshëm të dhëna për të provuar pretendimet e tij.

99. Kërkuesi, në mbështetje të raporteve të Avokatit të Popullit dhe raporteve të KPT-së (shi paragrafët 56-63 dhe 65-81 më sipër), pretendonte se Qendra Spitalore e Burgut nuk kishte pasur mjaftueshëm personel për t'u kujdesur për të gjithë paciente e tij. Ai parashitroi se autoritetet nuk kishin marrë ndonjë hap për të verifikuar pretendimet e tij për keqtrajtim. Raportet mjekësore të përgatitura nga autoritetet nuk kishin ofruar një analizë të përshtatshme dhe të detajuar për ndryshimet midis protokollit mjekësor detyruës për të trajtuar sëmundjen mendore të kërkuesit në një klinikë

psikiatrike civile dhe trajtimit në Qendrën Spitalore të Burgut. Raportet mjekësore nuk kishin bërë komente për ndikimin që trajtimi për kërkuesin në mjedisin e burgut kishte pasur në gjendjen e shëndetit të tij mendor. Një pamundësi e tillë i kishte veshur gjykata e brendshme me të diskrecion të pakufizuar për të spekuluar mbi gjendjen e shëndetit mendor të kërkuesit gjatë izolimit të tij të detyruar në mjediset e burgut. Raportet mjekësore nuk përmendnin implikimet e mundshme trajtimi i tij në Qendrën Spitalore të Burgut do të kishte mbi shëndetin mendor të kërkuesit, dhe kjo jo për shkak të mungesës së psikoterapisë së domosdoshme. Në çdo rast, kërkuesi pretendonte deinstitutionalizimin (procesi i zëvendësimit të spitaleve psikiatrike afatgjata, me shërbimet më pak të izoluara të komunitetit për shëndetin mendor) kishte qenë trajtimi i duhur mjekësor për sëmundjen e tij.

2. Qeveria

100. Qeveria parashtroi se kërkuesi ishte vendosur në institucionet e posaçme të mjekimit sipas vendimeve të gjykatave të brendshme. Ai kishte marrë trajtim mjekësor në përputhje me gjendjen e tij. Kjo mbështetej nga fakti se ai kishte bërë kërkese në gjykatat e brendshme për ndryshim ose revokim të masës, me argumentin se gjendja e tij ishte përmirësuar. Në vijim, Qeveria iu referua informacionit të ofruar avokatit të kërkuesit nga Qendra Spitalore e Burgut, e cila deklaronte se institucioni kishte 106 persona, nga të cilët dyzet e katër i ishin nënshtruar trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykatë, me një staf të kujdesit mjekësor prej dyzet e gjashtë personash (*shih paragrafin 42 më sipër*). Si rezultat, pretendimet e kërkuesit ishin të pabazuara.

101. Në vijim, Qeveria parashtroi se gjykatat vendëse kishin marrë në konsideratë gjendjen e kërkuesit. Gjykatat e brendshme kishin dhënë vendime pas marrjes së opinionit të ekspertëve të mjekësisë, të cilit me anë të këshillave të tyre ishin në favor të vijimit të trajtimit të kërkuesit. Në këtë lidhje, Qeveria iu referua specifikisht vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë, të datës 3 shkurt 2014 (*shih paragrafin 19 më sipër*). Sipas mendimit të tyre, kërkuesi nuk kishte paraqitur asnjë provë për të kundërshtuar gjetjet e ekspertëve mjekësor.

102. Qeveria parashtroi se masat e marra ndaj kërkuesit kishin qenë në përputhje me ligjin për shëndetin mendor, i cili parashikonte se individët që i nënshtroheshin trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykatë mund ta vuanin këtë masë në institucionet mjekësore të cilat nuk ishin domosdoshmërisht nën varësinë e Ministrisë së Shëndetësisë. Ata mbështeteshin në nenin 29 të ligjit për shëndetin mendor 2012 (*shih paragrafin 49 më sipër*), ku parashikohej se të burgosurit dhe individët në paraburgim, të cilët vuanin nga probleme të shëndetit mendor kishin të drejtën merrnin trajtim të posaçëm mjekësor në këto institucione ose në Qendrën Spitalore të Burgut. Në mbështetje të kësaj dispozite, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë kishin lidhur një memorandum mirëkuptimi në lidhje me bashkëpunimin e tyre në të ardhmen.

B. Vlerësim i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme

103 Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të parashikuara në vendimin e kohëve të fundit të Dhomës së Madhe në çështjen *Rooman kundër Belgjikës* ([DHM], nr. 18052/11, §§141-48, 31 janar 2019). Veçanërisht, Gjykata i referohet paragrafëve si më poshtë (referencat janë hequr):

“147. Në këtë situatë, “përshtatshmëria” e ndihmës mjekësore mbetet elementi më i vështirë për t’u përcaktuar. Gjykata thekson se fakti i thjeshtë se një i arrestuar është kontrolluar nga një doktor dhe i është rekomanduar një formë e caktuar e trajtimit nuk mund të çojë automatikisht në konkluzionin se ndihma mjekësore ishte e përshtatshme. Autoritetet duhet të garantojnë edhe se janë mbajtur të dhëna të detajuara në lidhje me gjendjen shëndetësore të të arrestuarit dhe trajtimit të tij ose të saj teksa është në arrest, se diagnoza dhe kujdesi janë të menjëhershme dhe të duhurat, dhe se kur është e nevojshme për shkak të natyrës së një gjendje mjekësore, mbikëqyrja është e rregullt dhe sistematike dhe përfshin një strategji terapeutike të detajuar me synimin për trajtimin e duhur të problemeve shëndetësore të të arrestuarit ose për parandalimin e përkeqësimit të tyre, në vend që të adresohen ato në një bazë simptomatike. Gjithashtu, autoritetet duhet të tregojnë se janë krijuar kushtet e nevojshme për dhënien e trajtimit i cili duhet të ndiqet. Për më tepër, trajtimi mjekësor i

ofruar në mjediset e burgut duhet të jetë i përshtatshëm, që do të thotë, në një nivel të krahasueshëm me atë që autoritetet Shtetërore janë angazhuar të ofrojnë për të gjithë popullatën në tërësi. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se çdo të arrestuari duhet t'i garantohet i njëjti trajtim mjekësor që është i disponueshëm në mjediset më të mira jashtë ambienteve të burgut (...).

148. Në rastin kur trajtimi nuk mund të ofrohet në vendin ku personi mbahet i arrestuar, duhet të jetë i mundur transferimi i të arrestuarit në spital ose në një njësi të specializuar (...)."

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

104. Fillimisht, gjykata është e mendimit se problemet e shëndetit mendor të kërkuesit, në fillim të trajtimit të tij të detyruar mjekësor me urdhër gjykate, nuk janë kundërshtuar. Ai është vendosur në një trajtim mjekësor të detyruar me vendim gjykate në një institucion mjekësor sipas raporteve mjekësore të ndryshme të cilat vërtetojnë se ai vuante nga skizofrenia paranojake. Për këtë arsye, kërkuesi është mbajtur në gjendje arresti në Burgun e Krujës dhe në Qendrën Spitalore të Burgut që prej muajit prill 2009.

105. Duke qenë se kërkuesi ka paraqitur pretendime në mbështetje të nenit 3 të Konventës për kushtet materiale të arrestit të tij dhe papërshtatshmërisë së trajtimit mjekësor që ai merrte, Gjykata do të përqendrojë shqyrtimin e ankesës sipas nenit 3, tek ata elementë për periudhën e vuajtur në Qendrën Spitalore të Burgut, duke pasur në konsideratë gjetjet e saj në paragrafët 93-95 më sipër.

Gjatë shqyrtimit të nenit 3, duhet të merren në konsideratë efektet kumulative të kushteve të arrestit, kohëzgjatja e arrestit dhe papërshtatshmëria e trajtimit mjekësor (*shih Dybeku kundër Shqipërisë*”, nr. 41153/06, §38, 18 dhjetor 2007).

106. Në lidhje me kushtet materiale në Qendrën Spitalore të Burgut, Gjykata mban në konsideratë konstatimet e Avokatit të Popullit në vitin 2015 dhe 2016, në lidhje me gjendjen e avancuar të rrënimt të atij institucioni, lagështirën e shpërndarë gjithandej dhe mungesën pothuajse të plotë të ngrohjes qendrore, KPT-ja, në vijim të vizitave të tij të posaçme dhe periodike në vitin 2017 dhe 2018, i nxirrte këto konstatime në dy raportet e tij të fundit të datës 24 maj 2018 dhe 17 shtator 2019, duke deklaruar se kushtet e jetesës ishin përkeqësuar më tej në krahasim me vizitat e tij të mëparshme. Gjykata konstaton përkeqësimin e kushteve të jetesës, duke përfshirë mungesën e ngrohjes qendrore në Qendrën Spitalore të Burgut, e cila kishte vijuar për një kohë shumë të gjatë. Shqetësues është edhe fakti se pacientët, si kërkuesi, përfitonin nga aktivitetet e papërshtatshme jashtë dhomave, siç konstatohet në raportin e KPT-së së datës 3 mars 2016 (*shih paragrafin 75 më sipër*). Gjykata nënvizon se kërkuesi, pasi është mbajtur në arrest në Qendrën Spitalore të Burgut që prej muajit qershor 2011, është ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përkeqësimi i përgjithshëm i kushteve të jetesës dhe i regjimit të cilit i nënshtrohej.

107. Në lidhje me trajtimin e kërkuesit, janë përgatitur një sërë raportesh të ndryshme mjekësore gjatë procedimeve të brendshme, të cilat tregojnë se kërkuesi vijonte të vuante nga skizofrenia paranojake, prej së cilës po ndiqte një mjekim. Veçanërisht sipas raporteve mjekësore të datës 11 shtator 2015 dhe 27 mars 2017, kërkuesi kishte marrë në mënyrë të vazhdueshme mjekimin e rekomanduar nga doktorët (*shih paragrafët 37 dhe 40 më sipër*).

108. Gjykata rikujton parimet e saj të përgjithshme në paragrafin 103 më sipër (*shih edhe Blokin kundër Rusisë [DHM]*, nr. 47152/06, §146, 23 mars 2016). Megjithatë, nuk ka asnjë tregues se ka ekzistuar një strategji e detajuar terapeutike me qëllimin për të trajtuar kërkuesin. Nga ana e saj, Qeveria nuk ka provuar se kërkuesi ka marrë kujdesin mjekësor të përshtatshëm, veçanërisht trajtimin terapeutik të nevojshëm sipas gjendjes së tij. Ajo nuk paraqiti një plan të individualizuar trajtimi të përgatitur për kërkuesin ose të provonte administrimin e trajtimit terapeutik në të mirë të tij ose dhënien e kujdesit të duhur psikiatrik.

109. Për më tepër, Gjykata e vendos theksin në gjetjet e KPT-së, të paktën që prej vitit 2014, në lidhje me nivelin e pamjaftueshëm të kujdesit psikiatrik dhe “përshtypjen e braktisjes terapeutike” të shumë pacientëve psikiatrikë, veçanërisht të atyre që i nënshtroheshin trajtimit të detyruar mjekësor me urdhër gjykate, si kërkuesi. Për më tepër, raporti mjekësor i datës 27 mars 2017 përqendrohej në mungesën e plotë të ofrimit të psikoterapisë (*shih paragrafin 40 më sipër*). Gjykata është e mendimit se i

takon autoriteteve të vendosin, në mbështetje të rregullave të njohura të shkencës mjekësore, për metodat terapeutike që duhet të përdoren për të ruajtur shëndetin fizik dhe mendor të pacientëve nën çrregullimet e shëndetit mjekësor (*shih Dybeku, cituar më sipër, §47*). Megjithatë, Gjykata nuk mund të pranojë se pacientët, si për shembull kërkuesi, t'i jenë nënshtruar një gjendje të "braktisjes terapeutike". Kjo është edhe më e sigurt, përderisa Ministria e Shëndetësisë ka përgatitur dhe miratuar një protokoll për diagnozën dhe kujdesin terapeutik të skizofrenisë, i cili urdhëron një kombinim programesh të trajtimit farmakologjik dhe këshillim psiko-social (*shih paragrafin 64 më sipër*).

110. Së fundmi, Gjykata nënvizon se kërkuesi është ankuar disa herë përpara gjykatave të brendshme për papërshtatshmërinë e trajtimit mjekësor dhe kushtet e arrestit të tij duke artikuluar se një institucion mjekësor i posaçëm do të ishte mjedisi i duhur ku ai do të mbahej në arrest. Faktikisht, gjykatat dhe autoritetet e brendshme, veçanërisht prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë, kanë pranuar mungesën e një institucioni të posaçëm mjekësor për personat e sëmurë mendërisht që i janë nënshtruar një trajtimi mjekësor të detyruar me urdhër gjykate. Në rastin e individëve të sëmurë mendërisht, Gjykata është e mendimit se vlerësimi në lidhje me faktin nëse trajtimi ose dënimi në fjalë është i papajtueshëm me standardet e nenit 3, duhet të marrë në konsideratë cenueshmërinë e këtyre individëve dhe, në disa raste, pamundësinë e tyre, për t'u ankuar sipas rastit ose aspak, për mënyrën se si ndikohen nga cilido trajtim i posaçëm (*shih, për shembull, Murray kundër Holandës [DHM], nr. 10511/10, §106, 26 prill 2016*).

111. Në këto rrethana, Gjykata është e mendimit se efektet kumulative të përkeqësimit të kushteve të jetesës në Qendrën Spitalore të Burgut, ku kërkuesi është mbajtur në izolim që prej vitit 2011, dhe trajtimi i pamjaftueshëm psikiatrik dhe terapeutik për kërkuesin në Qendrën Spitalore të Burgut, kanë sjellë trajtimin çnjerëzor dhe poshtëruës.

112. Në përputhje me këtë situatë, ka pasur një shkelje të nenit 3 të Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 §1 TË KONVENTËS

113. Kërkuesi u ankua se kufizimi i tij në burg nuk ishte i ligjshëm ose në respektim të një procedure të parashikuar nga ligji. Ai mbështetej në nenin 5 §1 të Konventës, pjesët respektive të të cilit parashikojnë:

"1. Çdokush ka të drejtën e lirisë e të sigurisë personale. Askujt nuk mund t'i hiqet liria, me përjashtim të rasteve që vijnë dhe në përputhje me procedurën e parashikuar me ligj:

...

e. kur ndalohet ligjërisht për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve ngjitëse, të personave të sëmurë mendërisht, alkoolistëve, narkomanëve ose endacakëve;

..."

A. Parashtrimet e palëve

114. Kërkuesi parashtrroi se gjykatat e brendshme kishin urdhëruar trajtimin e detyruar mjekësor në një institucion mjekësor. Megjithatë, autoritetet e brendshme e kishin vendosur atë në një institucion të ekzekutimit të vendimeve penale. Vendimet e mëpasshme nuk morën në konsideratë faktin nëse autoritetet e brendshme i ekzekutuan në mënyrë efikase vendimet e mëparshme gjyqësore në lidhje me natyrën e institucionit ku dërgohej kërkuesi për të vuajtur trajtimin e detyruar mjekësor me urdhër gjykate. Ata nuk merrnin në konsideratë as mungesën e pëlqimit nga familja e kërkuesit në lidhje me izolimin në spitalin e burgut. Në vijim kërkuesi nënvizoi se Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi i Burgjeve kishin pranuar se ndërtimi i klinikave të ndalimit për individët e sëmurë mendërisht do të kishin qenë mënyra më e përshtatshme për të siguruar zbatimin efikas të vendimeve të gjykatave të brendshme të cilat urdhëronin trajtimin mjekësor me shtrim spitalor.

115. Qeveria e kundërshtoi atë argument. Ajo parashtrroi se kërkuesi ishte izoluar në mbështetje të urdhrave të gjykatës në përputhje me një procedurë të parashikuar me ligj. Gjykatat e brendshme caktuan ekspertë mjekësor për të realizuar vlerësimet e gjendjes shëndetësore të kërkuesit në përputhje me nenin 46 të Kodit Penal. Në përgjigje të kësaj, ekspertët mjekësor dolën në përfundimin se gjendja e kërkuesit nuk ishte e stabilizuar dhe se izolimi ishte me vend.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Parimet e përgjithshme

116. Gjykata i referohet parimeve të përgjithshme të parashikuara në vendin e Dhomës së Madhe në çështjen *roman* ([DHM], cituar më sipër, §§205-14). Veçanërisht, Gjykata i referohet paragrafëve të mëposhtëm (referencat janë hequr):

“208. Analiza e praktikës gjyqësore, veçanërisht e zhvilluar gjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit, tregon qartazi se tashmë duhet të merret në konsideratë fakti se ekziston një lidhje e ngushtë midis “ligjshmërisë” së arrestimit të personave që vuajnë nga çrregullimet mendore dhe përshtatshmëria e trajtimit të dhënë për gjendjen e tyre mendore. Megjithatë kjo kërkesë nuk parashikohej ende në vendimet e para të dhëna në këtë fushë (...), nga e cila rezulton se funksioni terapeutik i izolimit të detyruar nuk garantohej si i tillë sipas Nenit 5, praktika gjyqësore aktuale tregon qartazi se administrimi i terapisë së përshtatshme është bërë një kërkesë në kontekstin e konceptit më të gjerë të “ligjshmërisë” së privimit të lirisë. Çdo ndalim i personave të sëmurë mendërisht duhet të ketë një qëllim terapeutik, me qëllimin e posaçëm dhe për aq sa është e mundshme, të kurojë ose të lehtësojë kushtin e shëndetit mendor, duke përfshirë, ku është e mundur, duke sjellë një reduktim ose kontroll ndaj rrezikshmërisë së tyre. Gjykata ka theksuar se pavarësisht ambientit në të cilin vendosen këta persona, ata kanë të drejtën t’iu ofrohet një mjedis mjekësor i përshtatshëm, shoqëruar me masat reale terapeutike, me qëllimin për t’i përgatitur për lirimin e tyre, në fund (...).

209. Për sa i përket objektivit të trajtimit të ofruar, Gjykata është e mendimit se niveli i kujdesit të kërkuar për këtë kategori të arrestuarish duhet të shkojë përtej kujdesit bazë. Aksesi te profesionistët e shëndetit, konsultimet dhe ofrimi i mjekimit nuk mund të mjaftojnë që një trajtim të konsiderohet si i përshtatshëm dhe në këtë mënyrë i kënaqshëm sipas nenit 5. Megjithatë, roli i Gjykatës nuk është analizimi i përmbajtjes së trajtimit që ofrohet dhe administrohet. Ajo që është e rëndësishme është që Gjykata të mund të verifikojë nëse një program i individualizuar ofrohet duke marrë në konsideratë detajet specifike të shëndetit mendor të të arrestuarit me qëllimin për ta përgatitur atë për riintegrimin e mundshëm në të ardhmen në shoqëri (...). Në këtë fushë, Gjykata i jep një farë tolerance autoriteteve për sa i përket formës dhe përmbajtjes së kujdesit terapeutik ose programit mjekësor në fjalë.

210. Në vijim, vlerësimi i faktit nëse një ambient i caktuar është “i përshtatshëm”, duhet të përfshijë shqyrtimin e kushteve specifike të arrestit që mbizotërojnë në të, dhe veçanërisht trajtimin e ofruar për individët që vuajnë nga çrregullime psikologjike. Në këtë mënyrë, çështjet e shqyrtuara në praktikën gjyqësore ilustronë se është e mundur që një institucion i cili është *a priori* i papërshtatshëm, si për shembull një strukturë burgu, gjithsesi mund të konsiderohet si i kënaqshëm nëse ofron kujdesin e duhur (...), dhe nga ana tjetër, një institucion psikiatrik i specializuar, i cili normalisht duhet të jetë i përshtatshëm, mund të rezultojë i paaftë në ofrimin e trajtimit të nevojshëm (...). Këta shembuj e bëjnë të mundur daljen në përfundimin se trajtimi i duhur dhe i individualizuar është një pjesë esenciale e nocionit të “institucionit të përshtatshëm”. Ky përfundim vjen nga konstatimi tashmë i pashmangshëm se privimi i lirisë, i parashikuar në nenin 5 §1 (e) ka një funksion të dyfishtë: nga njëra anë, funksioni social i mbrojtjes dhe nga ana tjetër një funksion terapeutik i cili lidhet me interesin individual të personit me një mendje të sëmurë në marrjen e një forme të përshtatshme dhe të individualizuar terapie ose linje trajtimi. Nevoja për të garantuar funksionin e parë nuk duhet të justifikojë *a priori* mungesën e masave të synuara për ofrimin e funksionit të dytë. Sipas kësaj, në mbështetje të nenit 5 §1 (e), një vendim i cili nuk lejon lirimin e një individi në izolim të detyruar mund të bëhet i papajtueshëm me objektivin fillestar të arrestimit parandalues në gjykim, në rast se personi në fjalë është arrestuar për shkak të rrezikut që ai ose ajo mund të përsërisë veprën, por në të njëjtën kohë privohet nga masat e tilla si – terapia e përshtatshme – të cilat janë të nevojshme për të demonstruar se ai ose ajo nuk është më i rrezikshëm (...).”

2. Zbatimi i parimeve të mësipërme në çështjen konkrete

117. Është e padiskutueshme se arresti i kërkuesit sjell një privim lirie dhe se neni 5 është i zbatueshëm. Në lidhje me privimin e lirisë së individëve të cilët vuajnë nga çrregullimet mendore, një individ nuk mund të konsiderohet se ka një “mendje të sëmurë” dhe i privuar nga liria e tij ose e saj,

në rast se nuk përmbushen tri kushtet e mëposhtme minimale: së pari, ajo ose ai duhet të provohet në mënyrë të besueshme të ketë një mendje të sëmurë; së dyti, çrregullimi mendor duhet të jetë i një lloji ose niveli që urdhëron izolimin e detyruar; së treti, vlefshmëria e izolimit të vazhduar varet nga vijimësia e një çrregullimi të tillë (*shih Winterwerp kundër Holandës, 24 tetor 1979, §39, seritë A nr. 33, dhe Stanev kundër Bullgarisë [DHM], nr. 36760/06, §145, GJEDNJ 2012*).

118. Gjykata, në lidhje me tri kushtet e vendosura në praktikën gjyqësore të *Winterwerp*, për sa i përket privimit të lirisë së “personave me një mendje të sëmurë”, nënvizon se kërkuesi vuan nga skizofrenia paranojake, siç është dëshmuar që prej të paktën vitit 2009. Gjendja e tij mjekësore ishte e tillë sa e nxiti Gjykatën e Rrethit Tiranë të urdhëronte trajtimin e detyruar mjekësor të kërkuesit më datë 8 prill 2009, në përputhje me një “procedurë të parashikuar nga ligji”. Nuk është paraqitur asnjë provë e cila mund të verë në dyshim përfundimet e autoriteteve për rrezikshmërinë e kërkuesit dhe nevojën për izolimin e tij. Arrestimi i kërkuesit ishte, për këtë arsye, një masë e trajtuar në nenin 5 §1 (e) të Konventës, ç’ka është e padiskutueshme nga palët.

119. Për t’u siguruar se arresti i kërkuesit – i cili është një person me “mendje të sëmurë” – ka qenë i ligjshëm, Gjykata, duke marrë në konsideratë gjetjet e saj në mbështetje të nenit 3, do të vlerësojnë se sa i përshtatshëm është institucioni në të cilin është ndaluar kërkuesi, duke përfshirë faktin nëse arresti i vazhduar i kërkuesit ka pasur “qëllim terapeutik, me synimin specifik, dhe për sa është e mundur, për kurimin ose lehtësimin e gjendjes së shëndetit të tij mendor, duke përfshirë ku është e mundur, reduktimin ose kontrollin e rrezikshmërisë” (*shih Rooman [DHM], cituar më sipër, §208*). Për këtë qëllim, Gjykata “do të verifikojë nëse është vendosur një program i individualizuar, duke marrë në konsideratë detajet specifike të shëndetit mendor të të arrestuarit me synimin për ta përgatitur atë për një riintegrim në të ardhmen në shoqëri” (*shih Rooman [DHM], cituar më sipër, §209*).

120. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, që prej datës 20 qershor 2011, kërkuesi, i cili ishte përjashtuar nga përgjegjësia penale, është mbajtur nën arrest në Qendrën Spitalore të Burgut, i cili është një institucion i ekzekutimit të vendimeve penale dhe jo pjesë e integruar e sistemit shëndetësor. Është për t’u shqetësuar fakti se që prej vitit 2000, KPT-ja është kritikuar vazhdimisht për vendosjen e “personave me mendje të sëmurë”, të përjashtuar nga përgjegjësia penale, në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale. Në të gjithë raportet e tij, veçanërisht në raportet për vitin 2018 dhe 2019, KPT-ja ka qenë i mendimit se Qendra Spitalore e Burgut nuk ishte një institucion i përshtatshëm për mbajtjen në arrest të individëve të sëmurë mendorisht, të cilët ishin nën një trajtim të detyruar mjekësor me urdhër gjykate, sipas nenit 46 të Kodit Penal dhe janë përjashtuar nga përgjegjësia penale.

121. Për më tepër, Gjykata nuk mund të anashkalojë vërejtjet e Avokatit të Popullit, i cili shpjegon se mbajtja nën arrest i individëve të sëmurë mendorisht, të përjashtuar nga përgjegjësia penale, në institucionet e ekzekutimeve penale, ishte në shkëlqim me ligjin e brendshëm. Në të vërtetë, në nenin 28 të ligjit për shëndetin mendor parashikohet se individë të tillë – si kërkuesi – duhet të vendosen në institucione mjekësore, të cilët duhet të jenë pjesë e sistemit të integruar shëndetësor në vend të sistemit penal. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka bërë të njëjtin konstatim në vendimin e saj të datës 14 korrik 2014 (*shih paragrafin 54 më sipër*). Fakti që autoritetet shqiptare për një kohë të gjatë nuk e ndërtuan një institucion të tillë, në kundërvajtje të dukshme me detyrimet statutoare të brendshme që prej vitit 2012, është tregues i një problemi strukturor, i cili rezulton të jetë i paadresuar.

122. Gjithashtu, Gjykata vëren se autoritetet nuk morën në konsideratë mjete alternative për vendosjen e kërkuesit jashtë institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, për shembull, në një institucion civil për shëndetin mendor (*shih paragrafin 51 më sipër*), siç propozohet në raportin e ekspertizës mjekësore të datës 27 mars 2017 (*shih paragrafin 40 më sipër*) dhe i mbështetur në raportin e Komisionerit (*shih paragrafin 82 më sipër*) me qëllimin për të shkuar drejt deinstitutionalizimit. Në vendimet e tyre, gjykatat e brendshme u kufizuan vazhdimisht në konstatimin se familja e kërkuesit nuk kishte mundësi të ofronte kushtet e duhura për sëmundjen e tij.

123. Veç kësaj, trajtimi i kërkuesit kryesisht mbështetej në farmakoterapi me anë të administrimit të mjekimeve psikotropike. Gjykata nuk është e bindur se kërkuesit i është ofruar mjedisi i duhur

terapeutik, i përshtatshëm për një person të ndaluar me probleme mendore. Në lidhje me këtë situatë, Gjykata, duke nënvizuar se në periudhën në fjalë, në Qendrën Spitalore të Burgut gjendej vetëm një mjek psikiatër për tetëdhjete e katër pacientë, nuk është e mendimit se kërkuesi ka marrë trajtimin e duhur psikiatrick. Raportet e KPT-së ngrenë shqetësime serioze për “braktisjen terapeutike” të pacientëve të sëmurë mendorë në, midis vendeve të tjera, Qendrën Spitalore të Burgut. Gjykata i referohet konstatimeve të saj në paragrafin 108 më sipër, sipas së cilit, Qeveria nuk ka ofruar një kopje të planit të individualizuar të trajtimit të përgatitur për kërkuesin, duke përfshirë kujdesin terapeutik që ai ka marrë gjatë gjithë gjendjes së tij të arrestit.

124. Në këtë situatë, Gjykata është e mendimit se privimi i vazhduar i lirisë së kërkuesit nuk ishte i ligjshëm dhe ishte në shkelje të kërkesave të nenit 5 §1 (e) të Konventës. Për këtë arsye, Gjykata arrin në përfundimin se ka pasur një shkelje të nenit 5 §1 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 §1 TË KONVENTËS

125. Kërkuesi u ankua se për sa i përket apelimit të tij, pezull përpara Gjykatës së Lartë që prej datës 11 janar 2016, atij nuk i ishte dhënë mundësia të shqyrtonte ligjshmërinë e ndalimit të tij me arrest në mënyrë të përshpejtuar nga gjykata. Ai mbështetej në nenin 5 §4 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“

4. Çdo person, të cilit i është hequr liria me arrestim ose me burgim, ka të drejtë të bëjë ankim në gjykatë me qëllim që kjo e fundit të vendosë, brenda një afati të shkurtër, për ligjshmërinë e burgimit të tij dhe të urdhërojë lirinë, në qoftë se burgimi është i paligjshëm.

”

126. Qeveria e kundërshtoi ankesën e tij. Ajo parashitroi se kërkuesi kishte nisur procedimet ligjore ndaj arrestit të tij në shtator 2014 dhe kishte marrë një vendim nga Gjykata e Apelit Tiranë më 22 dhjetor 2015 (*shih paragrafin 25 më sipër*), i cili kishte qenë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Apeli i kërkuesit në Gjykatën e Lartë ishte ende pezull. Për këtë arsye, Qeveria argumentonte se procedimet kishin qenë në linjë me kërkesat e Konventës për një shqyrtim të përshpejtuar të ndalimit të kërkuesit.

127. Gjykata përsërit se neni 5 §4 i Konventës, në garantimin e për individët e ndaluar e të drejtës për të ndërmarrë procedime për të kundërshtuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre, gjithashtu thekson të drejtën e tyre, me nisjen e këtyre procedimeve, për një vendim të përshpejtuar gjyqësor në lidhje me ligjshmërinë e ndalimit dhe urdhërimin e ndalimit të tij, nëse provohet të jetë i paligjshëm. Çështja nëse është respektuar e drejta për një vendim të përshpejtuar, duhet të përcaktohet në kuadër të rrethanave të secilës çështje dhe – siç është Çështja për kërkesën për “afat të arsyeshëm” në nenin 5 §3 dhe 6 §1 të Konventës – duke përfshirë kompleksitetin e procedimeve, realizimin e tyre nga autoritetet e brendshme dhe nga kërkuesi dhe çfarë rrezikohet për këtë të fundit (*shih midis të tjerëve, Inseber kundër Gjermanisë [DHM], nr. 10211/12 dhe 27505/14, §251-52, 4 dhjetor 2018*).

128. Në lidhje me parashtrimin e Qeverisë, se vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë i datës 22 dhjetor 2015 ishte i formës së prerë, Gjykata vëren se ky vendim ishte i hapur për apelim, një mundësi të cilën kërkuesi e shfrytëzoi, dhe rezultoi se është pezull përpara Gjykatës së Lartë. Në mbështetje të konstatimeve të saj në *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§33-34, 29 Shtator 2019), Gjykata konstaton se ky vendim nuk ishte bërë *res judicata* dhe për këtë arsye kundërshtoi vërejtjet e Qeverisë. Megjithatë në të vërtetë neni 5 §4 nuk garanton asnjë të drejtë, si të tillë, për një apelim ndaj vendimeve që urdhërojnë ose zgjasin ndalimin, sipas qëllimit dhe synimit të kësaj dispozite kërkesat e saj duhet të respektohen nga gjykatat e apelit, në rast se një apelim është kundër një vendimi (*shih Hutchison Reid kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 50272/99, §78, GJEDNJ 2003-IV*).

129. Asgjë nuk sugjero se kërkuesi, i cili ka paraqitur apelimin e tij në Gjykatën e Lartë, më 11 janar 2016, shkaktoi vonesa në shqyrtimin e tij. Gjykata është e mendimit se në mungesë të arsyeve të parashtruara nga Qeveria, vonesa prej më shumë sesa tre vitesh për këtë grup procedimesh përpara Gjykatës së Lartë i atribuohet plotësisht autoriteteve. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se periudha

përpara Gjykatës së Lartë nuk mund të konsiderohet e pajtueshme me kërkesën për “shpejtësi” në nenin 5 §4, e cila kërkon shqyrtim të posaçëm për procedimet. Në këtë mënyrë, ka pasur një shkelje të këtij neni.

V. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 5 §5 TË KONVENTËS

130. Kërkuesi u ankua se nuk kishte pasur një mjet efikas kompensimi në lidhje me ankesat mbështetur në nenin 5. Ai mbështetje në nenin 5 §5 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

Neni 5

“5. Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim.”

131. Qeveria argumentoi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e ndryshme të parashikuara në legjislacionin e brendshëm.

132. Gjykata thekson se neni 5 §5 i Konventës respektohet kur është e mundur të zbatohet për kompensim për privimin nga liria të zbatuar në kushte të cilat bien në kundërshtim me nenin 5 §§1, 2, 3 ose 4. E drejta për kompensim e parashikuar në nenin 5 §5, në këtë mënyrë presupozon se është shkelur një nga paragrafët e tjerë, ose nga një autoritet i brendshëm ose nga institucionet e Konventës (*shih Stanev [DHM], cituar më sipër, §182*).

133. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata vëren se, nëse sipas konstatimeve të saj ka pasur një shkelje të nenit 5 §§1 dhe 4, do të zbatohet paragrafi 5. Gjykata duhet të përcaktojë nëse ligji shqiptar i ka ofruar ose i ofron aktualisht kërkuesit një të drejtë të zbatueshme për kompensim për shkelje të nenit 5 §1 dhe 4 të Konventës në këtë çështje.

134. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 §1, neni 268 i KPP-së dhe kompensimi për aktin për burgim të padrejtë parashikon të drejtën e një personi për kompensim sipas shkallëve specifike. Ky i fundit nuk rezulton të parashikojë kompensim për ndalim të paligjshëm të personave të gjendur në një situatë specifike të kërkuesit. Nuk rezulton se një e drejtë e tillë u siguroi sipas ndonjë parashikimi tjetër të legjislacionit shqiptar dhe Qeveria nuk ka parashtruar praktikë gjyqësore për të kundërtën e kësaj.

135. Në lidhje me shkeljen e nenit 5 §4, Gjykata vëren se Qeveria nuk iu referua parashikimeve ligjore për të drejtën e kompensimit. Gjykata vëren se në nëntor 2017, në fuqi hyri një mjet i ri në lidhje me një shkelje të pretenduar të kërkesës për kohë të arsyeshme, sipas parashikimit të nenit 6 §1 të Konventës (*shih paragrafin 52 më sipër*). Edhe pse mjeti i ri u bë efikas pas hyrjes në fuqi të zbatimit më 11 qershor 2016, Gjykata, duke pasur parasysh mungesën e praktikës ligjore, nuk mund të arrijë në përfundimin se mjeti i ri do të zbatohet për kërkesën e “përshpejtimit” sipas nenit 5 §4 të Konventës, sipas të cilit kërkuesit nuk mund t’i kërkojë ta shterojë atë. Për këtë arsye, nuk rezulton që të jetë siguruar e drejta për kompensim sipas legjislacionit shqiptar.

136. Gjykata arrin në përfundimin se kërkuesi nuk kishte një të drejtë të zbatueshme, sipas parashikimit të nenit 5 §5 të Konventës, në lidhje me shkeljet e neneve 5 §§1 dhe 4. Për këtë arsye, ka pasur një shkelje të nenit 5 §5 të Konventës.

VI. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS NË LIDHJE ME NENIN 3 TË KONVENTËS

137. Kërkuesi u ankua se nuk ka pasur mjete efikase sipas ligjit të brendshëm për ankesat e tij, në mbështetje të nenit 3 të Konventës. Ai u mbështet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

138. Kërkuesi argumentoi se, edhe pse legjislacioni i brendshëm formalisht i siguronte mbrojtje të garantuar nga Konventa, në praktikë gjykatat e brendshme nuk kishin siguruar lehtësim për ankesën e tij sipas nenit 3.

139. Qeveria parashtrroi se kërkuesi i kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme, duke ndërmarrë shtatë grupe procedimesh përpara gjykatave të brendshme.

140. Gjykata është e mendimit se për sa u përket gjetjeve të saj në mbështetje të nenit 3, të Konventës, është e panevojshme të shqyrtohet në mënyrë të më veçantë ankesa sipas nenit 13, të Konventës.

VII. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME NENIN 3 DHE 5 TË KONVENTËS

141. Në vijim, kërkuesi u ankua se ai ishte diskriminuar për arsye të sëmundjes së tij mendore. Ai u mbështet në nenin 14 të Konventës, në lidhje edhe me nenin 3 dhe nenin 5 §1 të Konventës, i cili parashikon si më poshtë:

“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”

142. Kërkuesi pretendonte se sjellja e autoriteteve në çështjen e tij kishte qenë diskriminuese, përderisa ai ishte vendosur për trajtim në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale ë vend të një klinike ndalimi në gjendje arresti, për pacientët psikiatrikë, si rezultat i së cilës ai kishte marrë trajtimin e papërshtatshëm mjekësor.

143. Qeveria parashtrroi se autoritetet i kishin siguruar kërkuesit të njëjtin trajtim, si edhe ai për individët e tjerë në të njëjtën situatë. Të gjithë individët të cilët ishin përjashtuar nga përgjegjësia penale dhe i ishin nënshtruar një trajtimi mjekësor më urdhër gjykate, ishin vendosur në të njëjtat institucione si kërkuesi. Qeveria iu referua edhe praktikës gjyqësore të vendosur nga Gjykata, e cila parashikon se vetëm ndryshimet në trajtimin e mbështetur në karakteristika të identifikueshme, ose në “status”, mund të sjellin diskriminim sipas interpretimit të nenit 14.

144. Gjykata është e mendimit, se për sa u përket konstatimeve të saj sipas neneve 3 dhe 5 të Konventës, është e panevojshme të shqyrtohet e ndarë ankesa sipas nenit 14 të Konventës.

VIII. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 I KONVENTËS

145. Neni 146 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”

146. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Neni 46

147. Gjykata thekson se konstatimet e shkeljes në vendimet e saj janë esencialisht deklarative (*shih, midis të autoriteteve të tjera Verein gegen Tierfabriken Schweiz (VgT) kundër Zvicrës (nr. 2), [DHM], nr. 32772/02, §61, GJEDNJ 2009 dhe E.D. kundër Belgjikës, nr. 73548/13, §167, 6 shtator 2016*). Sipas nenit 46 të Konventës, një konstatim shkelje vendos mbi Shtetin përgjegjës një detyrim ligjor jo vetëm t’u paguajë personave konkretë shumë e akorduara me anë të justifikimit të drejtë sipas nenit 41, por edhe të përzgjedhë, objekt mbikëqyrej nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose individuale, nëse është me vend, për t’u miratuar në rendin e tyre ligjor të brendshëm për t’i dhënë fund dhunës së konstatuar nga Gjykata dhe për të korrigjuar me sa është e mundur pasojat [shih, midis të tjerëve, *Broniowski kundër Polonisë* [DHM], nr. 31443/96, §192, GJEDNJ-V; *Dybeku*, cituar më sipër, §63; dhe *Slavomir Musiał kundër Polonisë*, nr. 28300/06, §106, 20 Janar 2009).

148. Gjykata është e mendimit se Shteti përgjegjës duhet të marrë masa të një karakteri të përgjithshëm në mënyrë të menjëhershme për të siguruar kushtet e duhura të jetesës dhe shërbimet e kujdesit të duhur shëndetësor për personat e sëmurë mendërisht, të cilët janë të privuar nga liria në

rrethanat e një trajtimi të detyruar mjekësor me urdhër gjykate. Shteti përgjegjës, objekt i mbikëqyrjes së Komisionit të Ministrave, mbetet i lirë të zgjedhë mjetin me anë të cilit do të përmbushë detyrimin e tij ligjor sipas nenit 46 të Konventës (*shih Scozzari dhe Giunta kundër Italisë, [DHM], nr. 39221/198 dhe 41963/98, §249, GJEDNJ 2000-VIII*).

149. Gjykata është e mendimit se Shteti përgjegjës duhet të krijojë “institucionin e duhur” duke pajisur godinat ekzistuese ose ndërtesën e një godine të re të specializuar për strehimin e personave si kërkuesi për përmirësimin e kushteve të jetesës. Një godinë e tillë duhet të respektojë qëllimin terapeutik të kësaj forme privimi lirie, me synimin për të kuruar ose lehtësuar gjendjen e shëndetit mendor të të ndaluarve, duke përfshirë ku është e mundur, një reduktim ose kontroll mbi rrezikshmërinë e tyre dhe lehtësimin e riintegritimit të tyre në shoqëri. Trajtimi farmakologjik duhet të kombinohet me forma të tjera të njohura për trajtimin terapeutik, si pjesë e një plani të individualizuar trajtimi për secilin individ. Për këto qëllime, autoritetet duhet të sigurojnë edhe rekrutimin e një numri të mjaftueshëm punonjësish të kualifikuar të kujdesit për shëndetin mendor, në këto godina. Për më tepër, autoritetet duhet të marrin në konsideratë, ku është e mundur, mundësinë e trajtimit të shëndetit mendor pa shtrim spitalor.

150. Për sa ka të bëjë me masat individuale, autoritetet duhet të sigurojnë me urgjencë administrimin e formave të përshtatshme dhe të individualizuara të terapisë për kërkuesin, dhe të marrin në konsideratë mundësinë për ta vendosur atë në një mjedis alternativ jashtë institucioneve për ekzekutimin e vendimeve penale.

B. Neni 41

1. Dëmi

151. Kërkuesi pretendonte të merrte 48,666 euro për dëm monetar dhe 15,000 euro për dëmin jomonetar. Kërkuesi u shpreh se shpërblimi i drejtë që duhej t'i paguhej, duhej të përlllogaritej në bazë të kompensimit për secilën ditë të gjendjes së arrestit sipas parashikimit në aktin për kompensimin e ndalimit të paligjshëm.

152. Qeveria i kundërshtoi pretendimet e kërkuesit, me argumentin se ishin të pabazuara.

153. Gjykata u shpreh se në çështjen konkrete nuk tregohet nëse ekziston një lidhje shkakore midis shkeljeve të neneve 3 dhe 5 të Konventës dhe dëmit monetar të pretenduar nga kërkuesi. Për këtë arsye, ajo i kundërshton pretendimet e tij për këtë aspekt.

154. Megjithatë, ajo konstaton se kërkuesi pa dyshim pësoi dëme të natyrës jomonetare në lidhje me ndalimin e tij të vazhduar të detyruar pa trajtimin e duhur për gjendjen e tij shëndetësore, në shkelje me nenet 3 dhe 5 §1 të Konventës. Duke e përlllogaritur me drejtësi, Gjykata i akordon atij 15,000 euro për dëmin jomonetar.

2. Kostot dhe shpenzimet

155. Kërkuesi paraqiti si pretendim 10,000 euro për kostot dhe shpenzimet e shkaktuara përpara gjykatave të brendshme dhe për ato të shkaktuara përpara Gjykatës. Ai paraqiti një tabelë me kostot dhe shpenzimet e shkaktuara nga përfaqësuesit e tij.

156. Qeveria parashtroi se këto pretendime ishin të tepruara dhe të pabazuara.

157. Pasi shqyrtoi dokumentet në dosjen e çështjes, Gjykata vëren se kërkuesi nuk ka paraqitur një listë të plotë dokumentesh, të tilla si faturat ose kontratat në mbështetje të shumave në total të kostove dhe shpenzimeve të shkaktuara në procedimet e brendshme. Megjithatë, Gjykata konstaton se, për sa u përket dokumenteve në dosjen e çështjes, kërkuesi duhet të ketë pasur disa kosto dhe shpenzime gjatë procedimeve përpara gjykatave vendëse dhe kësaj Gjykate. Sipas rastit, në situatën konkrete, duke iu referuar informacionit që ka në zotërim, Gjykata e mendon të arsyeshme t'i akordojë kërkuesit shumën prej 2,500 euro.

3. Interes i papaguar

158. Gjykata e mendon me vend që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës i duhen shtuar tri pikë përqindje.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA NË MËNYRË UNANIME:

1. E deklaroi kërkesën të pranueshme.
 2. Vendos se nuk është shkelur neni 3 i Konventës, në pjesën që ka të bëjë me ndalimin e kërkuarit dhe trajtimin mjekësor të papërshtatshëm në Qendrën Spitalore të Burgut.
 3. Vendos se është shkelur neni 5 §1 i Konventës.
 4. Vendos se është shkelur neni 5 §4 i Konventës për sa ka të bëjë me mosshqyrtimin e përshpejtuar të apelimit të kërkuarit të datës 11 janar 2016.
 5. Vendos se është shkelur neni 5 §5 i Konventës.
 6. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet nëse është ankesa sipas nenit 13 të Konventës, së bashku me nenin 3 të Konventës.
 7. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa sipas nenit 14 të Konventës, së bashku me nenet 3 dhe 5 të Konventës.
 8. Vendos:
 - a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 §2, të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes:
 - i. 15 000 euro (pesëmbëdhjetë mijë euro) plus çdo taksë e cila mund të tarifohet, për dëmin jomonetar,
 - ii. 2 500 euro (dy mijë e pesëqind euro), plus çdo taksë e cila mund të jetë e tarifueshme për kërkuarin, për kostot dhe shpenzimet;
 - b) se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës, plus tri pikë përqindje.
 9. Pushon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për kompensim të drejtë.
- Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 21 janar 2020, sipas rregullit 77 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith
Sekretar

Robert Spano
Kryetar

SEKSIONI I DYTË
“AGIM BESHIRI KUNDËR SHQIPËRISË
DHE 11 KËRKESA TË TJERA”³
(kërkesa nr. 29026/06)

VENDIM
(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një dhomë, më 17 mars 2020, e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar

Marko Bošnjak

Valeriu Griçco

Ivana Jelić

Arnfinn Bårdsen

Darian Pavli

Peeter Roosma, gjyqtarë

dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit,

Duke marrë në konsideratë kërkesat më sipër të paraqitura në data të ndryshme, të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur;

Duke marrë në konsideratë vendimin pilot dhënë në çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, nr. 604/07 dhe 3 të tjerë, 31 korrik 2012;

Duke marrë në konsideratë vërejtjet e parashtruara nga Qeveria e paditur, si edhe vërejtjet e parashtruara nga kërkuesit si përgjigje për të parat,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj, në atë kohë, znj. S. Mëneri nga zyra e përfaqësuesit ligjor të asaj kohe, znj. E.Hajro, znj. L. Mandia dhe znj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit, dhe më pas nga z. A. Metani nga Avokatura e Shtetit.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Konteksti

1. Hyrje

2. Nga viti 2006 deri në vitin 2011, Gjykata dha një sërë vendimesh, në lidhje me moszbatimin e vendimeve administrative ose gjyqësore të formës së prerë, të cilat njohin të drejtën e kërkuesve përkatës për kompensim në vend të rikthimit të pronës së konfiskuar ose thënë ndryshe, të marrë nga ish-regjimi komunist. Ajo konstatoi një shkelje të nenit 6§1 dhe të nenit 13 të Konventës, si edhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës ndaj autoriteteve për mosrespektim të vendimeve të formës së prerë (*shih Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë*”, nr. 7352/03, 22 gusht 2006; *Ramadhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*”, nr. 38222/02, 13 nëntor 2007; *Drizja kundër Shqipërisë*”, nr. 33771/02, GJEDNJ 2007-V (ekstrakte); *Hamzaraj kundër Shqipërisë* (nr. 1), nr. 45264/04, 3 shkurt 2009; *Nuri kundër Shqipërisë*”, nr. 12306/04, 3 shkurt 2009, *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë dhe Italisë*, nr. 35720/04 dhe 42832/06, 29 shtator 2009; dhe *Eltari kundër Shqipërisë*, nr. 16530/06, 8 mars 2011).

3. Në vendimet *Ramadhi* dhe *Drizja*, Gjykata ftoi Qeverinë e paditur, sipas nenit 46 të Konventës, të prezantonte një mjet, i cili do të siguronte korrigjim me të vërtetë efikas për shkeljet e Konventës të identifikuar në këto vendime. Në vendimet *Hamzaraj* (nr. 1) dhe *Nuri* i *Ramadhi*-t, si edhe ftoi Qeverinë e paditur, në mbështetje të nenit 46, të miratonte masat e përgjithshme, siç përcaktohet në

³ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 103*. Tiranë, 2020. f. 5856

vendimin *Ramadh*. Gjykata bëri konstatime të ngjashme në vendimet e mëpasshme në çështjet *Vrioni dhe të tjerët*, cituar më sipër, dhe *Eltari*, cituar më sipër.

4. Në vendimin për çështjen *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, 7 dhjetor 2010, Gjykata pranoi të përdorte hartat e vlerësimit të pronave të vitit 2008 për përllogaritjen e dëmit monetar, sipas nenit 41 të Konventës, ku përcaktohet si më poshtë:

“36. Në përllogaritjen e shumës së dëmit monetar, Gjykata është e mendimit, se, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike të kontekstit shqiptar, është me vend që të shmanget metoda e përllogaritjes e përshkruar te *Driza* (cituar më sipër, §137), sipas së cilës shuma e kompensimit duhet të korrespondojë me vlerën e sipërfaqes së tokës në kohën e vendimeve të autoriteteve të brendshme. Gjykata vëren se në periudhën në fjalë, hartat e vlerësimit të pronës nuk ekzistojnë. Gjykata, në mbështetje të nenit 46, urdhëroi që shteti i paditur duhej të miratonte këto harta me urgjencë (*shih Driza, cituar më sipër, §126*), pikërisht me qëllimin për të përllogaritur shumën e kompensimit financiar që duhej të jepej dhe për të shmangur çdo spekulim.

37. Gjykata vëren me interes se autoritetet kanë miratuar hartat e vlerësimit të pronës për të gjithë territorin e Shqipërisë. Çmimi i referencës, sipas përcaktimit të Qeverisë, reflekton vlerën reale të tregut dhe ishte i indeksuar në interesa dhe në inflacion, në kohën e miratimit të hartave. Për këtë arsye, Gjykata do t'i mbështesë gjetjet e saj për përllogaritjen e dëmit monetar në hartat e vlerësimit të pronës, të miratuara për rajonin e Tiranës në vitin 2008.”

2. *Vendimi pilot Manushaqe Puto dhe të tjerët*

5. Si rezultat i një numri kërkesash në rritje, në lidhje me mosekzekutimin e tejkzgjatur të vendimeve të formës së prerë, Gjykata vendosi të bënte një rekurs për procedurën e vendimit pilot dhe përzgjodhi çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët* – cituar më sipër, e cila përfshinte katër kërkesa – si përfaqësuese të këtij problemi. Në vendimin e saj pilot të datës 31 korrik 2012, Gjykata konstatoi se ishte shkelur neni 6§1 i Konventës, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1, për mosekzekutimin e tejkzgjatur të vendimeve administrative, të cilat akordonin kompensim. Gjykata, në mbështetje të nenit 13 të Konventës, ishte e mendimit se nuk ekzistonte mjet efikas i brendshëm, i cili lejonte një korigjim të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm.

6. Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës për kompensim të drejtë, Gjykata, duke iu referuar hartave për vlerësimin e pronës, të miratuara nga Qeveria në vitin 2008 (*shih paragrafin 4 më sipër*), u akordoi kërkuarve një shumë, në total prej 2,992,400 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar dhe një shumë, në total prej 12,050 eurosh, për kostot dhe shpenzimet.

7. Në mbështetje të nenit 46 të Konventës, Gjykata, mbi baza plotësisht treguese, propozoi një listë me masa të përgjithshme të cilat duhej të ndërmerreshin nga Qeveria e paditur, duke përfshirë, por pa u kufizuar, “përpilimin e një baze të dhënash” të vendimeve administrative, duke përfshirë “ndryshimet e bëra me anë të një shqyrtimi gjyqësor”, ku njiheshin të drejtat e pronës dhe akordohej kompensim; krijimi i një “skeme të qartë kompensimi”, e cila “do të përdorte forma alternative kompensimi të parashikuara nga ligji” dhe “kërkonte një shqyrtim të modalitetve për pagesën e kompensimit financiar”; vendimmarrje transparente për dhe publikimin e llojit dhe të akordimit të kompensimit, si edhe “rishikim dhe përditësim transparent të hartave të vlerësimit”; “rëndësia e përcaktimit të afateve realiste, statutore dhe detyruese për çdo hap të procesit” dhe akordimin e “burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe materiale”.

8. Gjykata vendosi të pezullonte procedimet në lidhje me të gjitha kërkesat e reja të paraqitura përpara saj pas dhënies së vendimit pilot, në të cilin kërkuarët ngrinin ankesa të diskutueshme që kishin lidhje vetëm me mosekzekutimin e tejkzgjatur të vendimeve të formës së prerë për pronat për ekzekutimin e të cilave shteti ishte përgjegjës, për një periudhë prej 18 muajsh pas datës në të cilën vendimi pilot është bërë i formës së prerë, më konkretisht më 17 dhjetor 2012.

9. Megjithatë, Gjykata vendosi të vijonte me shqyrtimin e kërkesave të paraqitura përpara dhënies së vendimit pilot, pa paragjykuar pushtetin e saj në asnjë moment për të deklaruar të papranueshme cilëndo çështje ose për ta hequr atë nga lista pas një zgjidhje miqësore.

3. *Komunikimi dhe miratimi i vendimeve pasuese, në lidhje me çështjet vijuese post-Manushaqe Puto dhe të tjerët*

10. Më 20 dhjetor 2013, në përputhje me orientimin në vendimin pilot (*shih paragrafin 9 më sipër*), Gjykata vendosi të njoftonte Qeverinë e paditur për 64 çështje pasuese, të cilat ishin paraqitur përpara dhënies së vendimit pilot dhe të cilat ishin objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës.

11. Më 8 prill 2014, në përputhje me orientimin në vendimin pilot (*shih paragrafin 9 më sipër*), Gjykata miratoi vendimin e saj të parë pasues, në çështjen *Karagozji dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 25408/06 dhe 9 të tjerë, 8 prill 2014), në të cilin ajo konstatoi një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës për mosekzekutimin e tejzgjatur të autoriteteve të vendimeve administrative të formës së prerë, të cilat i jepnin kompensim kërkuesve në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji në vend të rikthimit të pronës. Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata i akordoi kërkuesve, për sa kishte të bënte me dëmin monetar dhe jomonetar, një shumë në total prej 8,154,000 eurosh dhe në lidhje me kostot dhe shpenzimet, një shumë në total prej 9,000 eurosh. Gjykata refuzoi të merrte në konsideratë hartat e vlerësimit të pronës për vitin 2013, të paraqitura nga Qeveria për përlogaritjen e dëmit monetar, për arsyt si më poshtë:

“64. ... Gjykata vëren se hartat e vlerësimit të pronës [2013] u paraqitën si pjesë e informacionit të përgjithshëm, përtej afateve kohore, pas përmbylljes së procedurës me shkrim. Qeveria nuk bëri parashtrime eksplicite në lidhje me përdorimin e këtyre hartave për secilën kërkesë. Qeveria nuk përcaktoi vendndodhjen e secilës sipërfaqe toke, në zonat respektive, kadastrave, sipas hartave të vlerësimit të pronës për vitin 2013 dhe çmimit të referencës që duhej të zbatohet për secilën kërkesë. Për më tepër, Qeveria nuk përcaktoi nëse çmimi i referencës reflektonte vlerën reale të tregut dhe nëse ‘e kishte interesin dhe inflacionin të indeksuar’.”

12. Ndërkohë, Gjykata ka dhënë vendime pasuese në çështjet e mëpasshme vijuese.

i. *Silqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]) nr. 37295/05 dhe 42228/05, 10 mars 2015). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, i akordoi kërkuesve një shumë në total prej 1,498,400 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe nuk dha asnjë dëmshpërblim për kostot dhe shpenzimet.

ii. *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 30264/08 dhe 3 të tjera, 16 korrik 2015). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuesve një shumë në total prej 121,700 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar dhe një shumë në total prej 3,000 eurosh për kostot dhe shpenzimet.

iii. *Luli kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 30601/08, 15 shtator 2015). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, i akordoi kërkuesit 27,000 euro për dëmin monetar për pjesën e tij të pronës. Në vijim, ajo vendos se, në mungesë të pretendimeve për kompensim të drejtë për një sipërfaqe tjetër toke, shteti i paditur duhet të sigurojë, me anë të mjeteve të duhura, ekzekutimin e vendimit të brendshëm dhënë, në favor të kërkuesit për atë sipërfaqe toke.

iv. *Sbarra dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 25038/08 dhe 11 të tjera, 10 nëntor 2015). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuesve një shumë në total prej 5,262,550 eurosh për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe një shumë në total prej 5,650 eurosh për kostot dhe shpenzimet. Gjykata refuzoi të merrte në konsideratë hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014, të ofruar nga Qeveria për përlogaritjen e dëmit monetar, për arsyt e mëposhtme (referencat janë hequr):

“82. Në rastin konkret, Gjykata duhet të përcaktojë nëse duhet t’u referohet hartave për vlerësimin e pronës së viti 2008 ose atyre të vitit 2014 për përlogaritjen e dëmit monetar. Pasi ka shqyrtuar argumentet e palëve, Gjykata bën vërejtjet e mëposhtme.

83. Vendimi pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, në lidhje me mospagimin e kompensimit nga autoritetet në vend të rikthimit të pronës, u dha nga Gjykata më 31 korrik 2012. Ky vendim u bë i formës së prerë më 17 dhjetor 2012. Në paragrafin e tij 121 dhe në parashikimin në fuqi nr. 7, Gjykata vendosi të mos i pezullonte procedimet e çështjeve dorëzuar përpara daljes së atij

vendimi, por të vazhdohej me shqyrtimin e tyre pasi vendimi të bëhej i formës së prerë. Në lidhje me këtë situatë, ankimet aktuale u paraqitën në Gjykatë nga 15 maj 2008 deri më 19 dhjetor 2011. Qeveria u njoftua më 25 janar 2010 dhe 20 dhjetor 2013 (...).

84. Gjykata merr në konsideratë argumentet e Qeverisë, në favor të kërkesës për hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 për përlllogaritjen e dëmit monetar. Ajo mbështet faktin se vlerësimet e pronës janë (supozohet të jenë) përditësuar çdo vit në bazë të një metodologjie, e cila u miratua me vendim të Qeverisë në vitin 2012. Megjithatë, Gjykata nuk u bind nga propozimet e Qeverisë.

85. Fillimisht, hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 u miratuan pas paraqitjes së ankimeve aktuale, të cilat po shqyrtohen në përputhje me udhëzimet e dhëna në vendimin pilot. Sipas Gjykatës, referenca të harta e vlerësimit të vitit 2014, do të linte vend për pabarazi gjatë trajtimit të kërkuësve për sa i përket çmimit të referencës.

86. Së dyti, Gjykata do t'u referohej rezervave të shprehura gjatë takimit parlamentar të datës 7 maj 2012, për shkakun se shitblerjet e regjistruara në ZRPP, nuk i reflektonin në përgjithësi dhe domosdoshmërisht vlerën reale të tregut, si rezultat i evazionit të taksave mbuluar nga palët sipas kontratës së shitjeve. Për pasojë, Gjykata mendon se referimi i plotë në çmimet e shitjeve të shitblerjeve të regjistruara nuk do të ishte aspak në zbatim të parimit se kompensimi, në rastet e shpronësimit të paligjshëm, duhet të jetë në përputhje me vlerën e tregut, për këtë arsye Gjykata ka ndërmarrë edhe masa për të parandaluar dhe luftuar evazionin e taksave.

87. Së treti dhe e lidhur ngushtë me arsyen e dytë, Gjykata është e shqetësuar, se çmimet e pronës në disa qytete, veçanërisht në zonat të cilat po njohin një zhvillim relativisht në rritje, si për shembull qendra e Tiranës, kryeqytetit, kanë shënuar një rënie të ndjeshme. Gjykata nuk është në pozicionin të spekulojë arsyet për një rënie të tillë, por nuk është e bindur se ato reflektojnë në mënyrë objektive vlerën aktuale të tregut dhe se ishin “të indeksuar me interesin dhe inflacionin” për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga pamundësia për kompensim gjatë gjithë këtyre viteve (...).”

v. *Rëzta dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 5207/10 dhe 9 të tjera, 16 korrik 2015). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuësve një shumë, në total prej 10,697,900 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe një shumë, në total prej 3,200 eurosh, për kostot dhe shpenzimet.

vi. *Alëçka dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 33148/11 dhe 5 të tjera, 7 prill 2016). Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuësve një shumë, në total prej 799,600 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe një shumë në total prej 1,700 eurosh për kostot dhe shpenzimet.

vii. *Halimi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 33839/11, 7 prill 2016. Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuësve një shumë, në total prej 754,300 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe një shumë, në total prej 850 eurosh, për kostot dhe shpenzimet.

viii. *Karagozji dhe të tjerët kundër Shqipërisë* ([Komiteti]), nr. 32382/11, 7 prill 2016. Duke gjykuar në mbështetje të nenit 41 të Konventës, Gjykata, sipas hartave të vlerësimit të pronës së vitit 2008, u akordoi kërkuësve një shumë, në total prej 5,919,000 eurosh, për dëmin monetar dhe jomonetar, dhe një shumë, në total prej 850 eurosh, për kostot dhe shpenzimet.

13. Nga data 22 shtator 2014 deri më 22 prill 2016, në përputhje me orientimin në vendimin pilot (*shih paragrafin 8 më sipër*), Gjykata vendosi të njoftonte Qeverinë e paditur për 53 çështje pasuese, të cilat ishin objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar.

14. Në vijim të zbatimit të vendimit pilot të *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, më 5 dhjetor 2015, Kuventi miratoi ligjin për trajtimin e pronës dhe përfundimin e kompensimit të pronave (ligji për pronat 2015), i cili në vijim të publikimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më 24 shkurt 2016 (data e hyrjes në fuqi).

B. Kërkesat konkrete

15. Kërkesat konkrete u paraqitën në Gjykatë në periudhën midis vitit 2006 dhe 2014 dhe kanë lidhje me mosekzekutimin e tejzgjatur të vendimeve administrative të formës së prerë, të cilat njihnin të drejtën e kërkuësve për kompensim në një prej mënyrave të parashikuara nga ligji në vend të

rikthimit të pronave, të cilat ishin konfiskuar ose shtetëzuar nga ish-regjimi komunist. Në këto kërkesa, ngriheshin pyetje të ngjashme me ato të shqyrtuara nga Gjykata në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*.

16. Një listë e detajuar kërkesish – duke përfshirë kombësitë e tyre – përfaqësuesish dhe datash për paraqitjen e secilës kërkesë gjendet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi. Më poshtë gjendet një përshkrim i fakteve relevante për secilën kërkesë.

17. Kërkesa nr. 29026/06: më 13 shkurt 1996, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave Durrës (Komisioni) lëshoi dy vendime, të cilat njihnin të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për dy sipërfaqe toke me përmasat 1,272 m² dhe 3,000 m². Duke qenë se sipërfaqet ishin të zëna, ai vendosi se kërkesve do t'iu jepej e drejta të kompensoheshin në natyrë. Një vendim i tretë i lëshuar në po të njëjtën datë u njihte kërkesve të drejtën ndaj një sipërfaqe toke me përmasa 843 m², si dhe ndaj ndërtesave të ndërtuara në to. Ndërtesat ose ishin të zëna ose të dhëna me qira familjeve, ose i ishin shitur familjeve të tjera nga autoritetet lokale. Vendimi i tretë nuk përmend ndonjë të drejtë për kompensim.

18. Kërkesa nr. 3165/08: më 17 nëntor 1995, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 450 m². Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë nga një bllok apartamentesh, ai vendosi se kërkesit do të kompensoheshin me njërën nga mënyrat e parashikuara në ligj. Më 22 dhjetor 2007, Agjencia për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronës (Agjencia), e cila kishte zëvendësuar Komisionin në vitin 2006, rrëzoi kërkesën e kërkesve për kompensim financiar për mungesë fondesh.

19. Kërkesa nr. 56956/10: më 12 dhjetor 1995, Komisioni i Bilishtit njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke me përmasat 13,315.25 m². Duke qenë se sipërfaqja ishte e zënë, kërkesit do të kompensoheshin me obligacione.

Më 16 nëntor 2009, Agjencia rrëzoi kërkesën e kërkesve për kompensim financiar, sepse ajo nuk ishte në përputhje me kërkesat statutorë, më konkretisht, nuk përmbante të gjitha dokumentet mbështetëse.

20. Kërkesa nr. 29127/11: më 20 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke me përmasat 5,000 m², nga të cilat u rikthyen 524 m². Ai vendosi se kërkesit do të kompensoheshin për pjesën e mbetur prej 4,360 m² në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji dhe njohu të drejtën e kërkesve për parablerjen e dy ndërtesave, me sipërfaqe prej 2,600 m² dhe 1,760 m² në rastin e privatizimit.

21. Kërkesa nr. 8904/12: më 30 qershor 2009, Agjencia e Tiranës njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sërë sipërfaqesh toke, me përmasë në total 410,184 m², nga të cilat u rikthyen 13,300 m². Në vijim, Agjencia i njohu të drejtën e kompensimit për sipërfaqen e mbetur prej 396,884 m².

22. Kërkesa nr. 6311/12: më 23 tetor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 1,071 m². Duke qenë se toka ishte e zënë me ndërtesa, Komisioni vendosi se kërkesi do të kompensohet në një prej mënyrave të parashikuara nga ligji. Në vitin 2005, kërkesi mori kompensim financiar për 200 m².

23. Kërkesa nr. 5915/4: më 19 qershor 2007, Agjencia njohu të drejtat e ankuesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 240,000 m². Ajo vendosi që kërkesit të kompensoheshin për 183,500 m² në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, duke qenë se 56,500 m² iu ishin rikthyer me anë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë në vitin 1996.

24. Kërkesa nr. 53846/14: më 14 korrik 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke me përmasa 65,000 m². Duke qenë se prona ishte e zënë, ai vendosi që kërkesit të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Gjithashtu, Komisioni njohu të drejtën e kërkesve për parablerje ndaj një sërë ndërtesash të pozicionuara në sipërfaqen e tokës në rast se ato privatizoheshin.

25. Kërkesa nr. 57152/14: palët u dakordësuan se më 29 qershor 1994, siç u plotësua dhe u sqarua nga dy vendime pasuese të dhëna më 14 tetor 1994 dhe 21 tetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të

drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar ndaj një sipërfaqe toke prej 1,011 m², prej së cilës u rikthye 224 m². Ai vendosi se kërkuarët do të kompensoheshin për pjesën e mbetur prej 787 m², në një nga mënyrat e parashikuara në ligj.

26. Kërkesa nr. 67059/14: më 23 shtator 1996, Komisioni i Elbasanit njohu të drejtat e kërkuarve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 330 m². Duke qenë se toka ishte e zënë, ai vendosi që kërkuarët të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

27. Kërkesa nr. 72755/14: më 12 korrik 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtën e kërkuarve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 113,000 m² prej së cilës u rikthyen 10,000 m². Ai vendosi se kërkuarët do të kompensoheshin për pjesën e mbetur prej 103,000 m² në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

28. Kërkesa nr. 537/15: më 22 shtator 1995, Komisioni i Kavajës njohu të drejtat e kërkuarve ndaj pronës së trashëguar për një sipërfaqe toke prej 28,000 m². Ai vendosi se kërkuarët do të kompensoheshin për 20,800 m² ose me anë të kompensimit në natyrë ose me obligacione ose në ndonjë mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE E BRENDSHME

A. Ligji dhe praktika e brendshme në kohën e miratimit të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*

29. Një përmbledhje e pjesëve me interes nga ligjet për pronën, të cilët hynë në fuqi nga viti 1993 deri më 2012, është paraqitur në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, §§24–50.

B. Praktika dhe ligji i brendshëm pas dhënies së vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*

1. Ligji për pronat 2015

30. Ligji për pronat i vitit 2015 shfuqizoi ligjin për pronat të vitit 2004.

a) Raporti i Komisioni Parlamentar

31. Përpara miratimit të tij, projektligji u shqyrtua nga Komisioni i Përhershëm Parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (Komisioni Parlamentar), i cili lëshoi një raport për shqyrtimin e projektligjit, i cili u pasqyrua në faqen e internetit të Kuventit⁴. Komisioni Parlamentar gjykoj se projektligji ishte në përputhje me Kushtetutën. Ai e miratoi projektligjin dhe votoi në favor të paraqitjes së tij për shqyrtim në Parlament në një sesion parlamentar.

32. Raporti nënvizonte se në zbatim të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, autoritetet: i. kishin nderuar një regjistër elektronik me vendime të dhëna nga viti 1993 deri në 2014, të cilat ose e kishin rikthyer pronën në natyrë ose kishin njohur të drejtën e pronarëve për kompensim; ii. kishin vlerësuar faturën financiare për shtetin; dhe iii. kishin përgatitur një mjet të brendshëm, i cili do të ofronte një zgjidhje përfundimtare për procesin e rikthimit dhe kompensimit të pronës brenda një afati të arsyeshëm.

33. Raporti u referohej të dhënave statistikore të ofruara nga Qeveria, sipas së cilave: i. nga viti 1993 deri në vitin 2013 u dhanë rreth 53,000 vendime, të cilat njihnin të drejtat e pronës për 186,823 hektarë nga të cilët 74,420 hektarë ishin rikthyer dhe 73,400 hektarë do të ishin objekt kompensimi; ii. nga viti 2005 deri në vitin 2014, 15.9 hektarë ishin objekt i pagesës së kompensimit financiar dhe 900 vendime ishin subjekt i pagesës për kompensim të pjesshëm në vlerën prej 4.1 miliardë lekësh shqiptarë (ALL) (rreth 32,826,200 euro – në një normë mesatare vjetore rreth 3.6 milionë euro); dhe iii. 10,131 pretendime për njohjen e të drejtave mbi pronën ishin pezull për shqyrtim për 148,210 hektarë.

34. Komisioni Parlamentar miratoi skemën e re të kompensimit të propozuar në projektligj. Ai gjykoj se, në lidhje me të dhënat statistikore të paraqitura nga autoritetet dhe me normën për pagesën e kompensimit, do të duheshin 4,588 vjet të paguhej kompensimi për hapësirën, në total prej 73,400 hektarësh, për të cilën vendimet vendëse kishin njohur të drejtën e pretenduesve për kompensim.

35. Si pjesë e shqyrtimit të projektligjit, Komisioni Parlamentar hapi një konsultim publik për

⁴ <https://www.parlament.al/ProjektLigje/ProjektLigjeDetails/1882>

projektligjin dhe kërkoi opinionet nga një sërë institucionesh të ndryshme ndërkombëtare dhe të brendshme, si edhe opinionet e grupeve të interesit dhe të shoqatave.

b) Relacioni i Qeverisë

36. Relacioni për ligjin për pronën i vitit 2015, i cili u dorëzua nga Qeveria më 8 prill 2016, përcaktonte se formula e kompensimit e parashikuar në një legjislacion të mëparshëm nuk kishte qenë efikas. Metodologjia e re e kompensimit e përcaktuar nga ligji për pronat 2015 synonte zgjidhjen e dhënies së kompensimit të drejtë për ish-pronarët, të cilët ishin shpronësuar gjatë regjimit komunist, si edhe garantimin e barazisë për të gjithë ish-pronarët, e drejta për kompensim e të cilëve ishte njohur, duke dhënë kompensim të drejtë, duke pasur parasysh situatën socio-ekonomike të shtetit.

37. Sipas relacionit, ishte plotësuar vetëm 2.5% e procesit për rikthimin dhe për kompensimin e pronave. Që prej vitit 1993, autoritetet kishin dhënë në total 53,115 vendime, duke rikthyer 74,420 hektarë në natyrë dhe duke njohur të drejtën për kompensim për 73,359 hektarë. Nga viti 2005 deri në vitin 2014, ishte dhënë kompensim financiar për 15.9 hektarë. Relacioni përcakton se 10,131 pretendime për pronën ishin pezull për shqyrtim në Agjenci. Arkivat e Agjencisë zbuluan se 26,357 vendime të paekzekutuara kishin njohur të drejtën për kompensim.

38. Duke iu referuar hartave të vlerësimit të cilat ishin në fuqi në periudhën në fjalë, autoritetet vlerësuan se fatura financiare për kompensimin, në lidhje me 26,000 vendimet do të shkonte në vlerën prej 814 miliardësh ALL (6,517,200,000 euro). Në lidhje me shpërndarjen e burimeve buxhetore vjetore nga shteti në shumën prej 300 milionësh ALL (2,435,840 euro), procesi i kompensimit do të plotësohej pas 2,713 vitesh. Në këto rrethana, autoritetet përgatitën një skemë të re kompensimi, e cila, sipas tyre, do të përbënte kompensim të drejtë, sipas praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate. Një nga objektivat e ligjit për pronat të vitit 2015 do të ishte përcaktimi i shumë financiare, në lidhje me vendimet e mëparshme që njihnin të drejtën për kompensim pa specifikuar shumën e kompensimit (vendime pa kuant). Në kundërshtim me procesin e kompensimit, i cili ishte zhvilluar në të shkuarën dhe mbizotërohej nga çështje që kishin lidhje, për shembull, me shumën e kompensimit të paguara dhe urdhrin prioritar për pagesën e një kompensimi të tillë, formula e kompensimit, sipas propozimit në ligjin për pronat 2015, do të përpiquej që t'i trajtonte të gjithë ish-pronarët në mënyrë të barabartë. Siç parashikohej, qartësia dhe transparencja në vendimmarrje do të ishin në plan të parë si disa prej objektive të ligjit. Publikimi i vendimeve do të rriste transparencën dhe përçonte besimin në publik.

39. Relacioni nënvizonte se autoritetet nuk kishin përgatitur kurrë një skemë përfundimtare kompensimi, e cila do të krijonte pritshmëri legjitime për dhënien e në një shume të caktuar (financiare). Skema e prioritizimit, e cila ishte paraqitur dhe zbatuar nga autoritetet, ishte e përkohshme dhe Gjykata e Strasburgut e deklaroi joefikase. Qeveria ishte e mendimit se skema e propozuar e kompensimit nuk do të përbënte një ndërhyrje në të drejtat e ish-pronarëve mbi pronën. Ajo do të ruante trajtimin e barabartë të ish-pronarëve dhe Qeveria do të ndërmernte të shlyente detyrimin e saj brenda një kohe të arsyeshme, në lidhje me çfarëdo dëmshpërblimi.

c) Përmbledhje e ligjit për pronat 2015

i. Qëllimi dhe fusha e veprimit të kërkesës

40. Sipas neneve 1 dhe 2, qëllimi i ligjit për pronat 2015 është: i. finalizimi i pretendimeve mbi pronën, në lidhje me pronat të cilat janë shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar që prej datës 29 nëntor 1944, sipas statuteve të brendshme ose në zbatim të akteve/vendimeve ligjore, vendimeve gjyqësore penale, ose të shpronësuar me anë të çdo mjeti tjetër të paligjshëm nga regjimi komunist; ii. rregullimi dhe dhënia e kompensimit të drejtë me anë të kompensimit; iii. ndërtimi i një fondi kompensimi, prej të cilit do të paguhej kompensim për ish-pronarët; iv. ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë, të cilat kanë njohur të drejtën për kompensim; dhe v. finalizimi i procesit të kompensimit, brenda afateve të parashikuara në ligj, me anë të një fondi kompensimi.

41. Disa prona do të ishin jashtë fushës së veprimit të zbatimit të dispozitave të ligjit për pronat 2015, të tilla si pronat që: i. ishin përfutur si rezultat i zbatimit të ligjit për reformën agrare, të ndryshuar; ii. ishin shpronësuar kundrejt pagesës së kompensimit të drejtë; dhe iii. i ishin dhuruar shtetit në mbështetje të vlefshmërisë së dokumenteve zyrtare.

42. Ligji për pronat 2015 përdor termin “subjekt i shpronësuar” për t’iu referuar ish-pronarëve dhe trashëgimtarëve të tyre ligjorë. Për ruajtjen e konsistencës me praktikën gjyqësore të saj të mëparshme, Gjykata do të vijojë të përdorë termin “ish-pronar” për t’iu referuar “subjektit të shpronësuar”.

ii. Krijimi i një autoriteti të ri

43. Ligji i pronës i vitit 2015 themeloi Agjencinë për Trajtimin e Pronës (ATP), e cila do të ishte përgjegjëse për zbatimin dhe ekzekutimin e ligjit dhe zëvendësoi (ish-) Agjencinë, e cila ishte krijuar në vitin 2006 (*shih paragrafin 18 më sipër*). ATP-ja është llogaridhënëse te ministri i Drejtësisë dhe koordinon punën e saj me një sërë institucioneve shtetërore. Organizimi dhe operimi i saj rregullohet nga vendimi i Këshillit të Ministrave (*shih paragrafin 78 më sipër*). Ligji për pronat 2015 përmban dispozita vlefshmëria e të cilave përfundon sipas ligjit në lidhje me operimin e Agjencisë (*shih paragrafët 44 dhe 50 më poshtë*).

iii. Shqyrtimi i pretendimeve për pronën të reja dhe të mbetura pezull

44. Në përputhje me fushën e veprimit të zbatimit të ligjit për pronat 2015, ATP-ja duhej të shqyrtonte pretendimet për pronën, të cilat ishin paraqitur tek dhe nuk ishin shqyrtuar nga (ish-) Agjencia, si edhe të pranonte dhe të vendoste për pretendimet e reja mbi pronën të paraqitura përpara saj për një periudhë deri në nëntëdhjetë ditë nga data e hyrjes në fuqi. Sipas nenit 27, afati nëntëdhjetëditor nuk mund të shtyhej në asnjë rrethanë me anë të një vendimi gjyqësor ose administrativ. Procesi për shqyrtimin e pretendimeve mbi pronën të mbetura pezull duhej të përfundohej brenda tri vitesh nga data e hyrjes në fuqi, që është rreth datës 23 shkurt 2019. Nëse ATP-ja nuk do t’i shqyrtonte pretendimet e paraqitura rregullisht për njohjen e të drejtave të pronës, brenda afatit trevjeçar, një ish-pronar do të kishte të drejtën të ndërmerre një veprim civil në gjykatën e shkallës së parë (të juridiksionit të përgjithshëm), sipas nenit 34.

45. ATP-ja mund të njihete të drejtat e një ish-pronari ndaj pronës dhe të drejtën për kompensim në përputhje me nenin 20. Sipas nenit 29, një vendim i ATP-së nëpërmjet të cilit njihet (ose jo) të drejtat e pronës dhe të drejtën për kompensim mund të apelohej brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi i tij, në gjykatën kompetente të apelit. Nëse vendimi i ATP-së bëhet i formës së prerë, ai do të regjistrohej në Zyrën e Regjistrimit të Pronës së Paluajtshme (ZRPP), në përputhje me nenin 30.

46. Ish-pronarëve iu kërkua që të paguanin tarifën e përpunimit për të mbuluar kostot administrative të pretendimeve të tyre, sipas nenit 28§5.

iv. Përcaktimi i vlerësimit financiar

47. Të gjitha vendimet e formës së prerë, të cilët njihnin të drejtat e pronës dhe të drejtën për kompensim, duke përfshirë vendimet në lidhje me kërkesat, të cilat ishin pezull për shqyrtim në gjykatat e brendshme dhe përpara kësaj Gjykate, do t’i nënshtroheshin një vlerësimi financiar, i cili do të kryhej nga ATP-ja, sipas neneve 6 dhe 7, të ligjit për pronat, i cili parashikon si më poshtë (në versionin origjinal):

“Neni 6

Metodologjia e vlerësimit

1. Për efekt të ekzekutimit, të gjitha vendimet përfundimtare për kthimin dhe kompensimin e pronës do t’i nënshtrohen vlerësimit financiar nga ATP-ja, si më poshtë:

a) prona e njohur për kompensim vlerësohet në bazë të zërit kadastral që ka pasur në kohën e shpronësimit;

b) prona e kthyer vlerësohet duke e përcaktuar atë nga diferenca, që do të rezultojë midis vlerës së saj, sipas zërit kadastral aktual dhe vlerës së kësaj prone, sipas zërit kadastral në kohën e shpronësimit.

2. Vendimet përfundimtare, që kanë të njohur vetëm të drejtën e kompensimit, vlerësohen financiarisht, sipas zërit kadastral që ka pasur prona në kohën e shpronësimit, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Në rastet kur subjektet e shpronësuar kanë përfituar me vendim kthimi dhe kompensimi, diferenca e llogaritur, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, zbritet nga vlerësimi i pronës së njohur për kompensim, e llogaritur sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij neni.

4. Vlerësimi për vendimin përfundimtar që ka njohur të drejtën e kompensimit bëhet duke marrë si referim zërin kadastral, sipas origjinës së pronës, që ndodhet më afër pronës që do të kompensohet, duke u bazuar në hartën e vlerës në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Në rast se pranë pronës që do të kompensohet gjenden disa zëra kadastralë të njëjtë me atë të origjinës së pronës, me distancë të njëjtë dhe me vlera të ndryshme, atëherë për referim në përllogaritje merret zona që ka çmimin më të lartë.

5. Në rast se ATP-ja merr vendim për njohje dhe kompensim fizik në pronën e subjektit, prona vlerësohet sipas pikës 1 të këtij neni. Kur nga ky vlerësim rezulton se subjekti përfiton një pronë që ka vlerë më të lartë se sa prona që ka pasur në momentin e shpronësimit, atëherë subjektit i kompensohet fizikisht sipërfaqja që i korrespondon vlerësimit dhe pjesa tjetër e pronës kalon në fondin e tokës me vendim të ATP-së.

6. Vlera e aksioneve, obligacioneve, kompensimit financiar apo çdo lloj kompensimi tjetër, duke përfshirë vlerën e pronës së përfituar nga dispozitat ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, që subjekti apo trashëgimtarët e tij kanë përfituar më parë, zbritet nga shuma e përllogaritur për kompensim.

7. Për vendimet e kompensimit, të përcaktuara me vlerë dhe ende të paekzekutuara, nga periudha e njohjes së të drejtës për kompensim deri në marrjen e shpërblimit, subjektet e shpronësuara do të përfitojnë indeksimin, sipas vlerës zyrtare të inflacionit dhe interesin bankar, sipas mesatares vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 7

1. Të gjitha vendimet përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit dhe ato që do të merren deri në përfundim të procesit, sipas këtij ligji, do të zbatohen sipas parashikimeve të këtij ligji.

2. Vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare për kompensim do të bëhet duke vlerësuar financiarisht pronën e njohur për kompensim, sipas nenit 6, të këtij ligji, në përputhje me procedurën e mëposhtme:

a) nëse vlerësimi i pronës së kthyer me vendim përfundimtar rezulton se është më i madh sesa vlerësimi i tokës së njohur për kompensim, atëherë subjekti i shpronësuar konsiderohet i kompensuar;

b) nëse vlerësimi i pronës që është njohur për kompensim është më i madh se sa vlerësimi i tokës së kthyer, atëherë subjektit i kompensohet diferenca, sipas përcaktimeve të këtij ligji;

c) në rast se vendimi përfundimtar nuk ka vendosur kthim prone, atëherë llogaritet vlerësimi financiar i pronës së njohur për kompensim, bazuar në zërin kadastral që ka pasur prona në momentin e shpronësimit, sipas pikës 3, të nenit 6, të këtij ligji;

ç) në rast se vendimi përfundimtar nuk ka vendosur kompensim prone, atëherë vendimi dhe dokumentacioni përkatës arkivohen sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për arkivat.”

48. Vlerësimi financiar i vendimeve do të kryhej në rend kronologjik, duke filluar me vendimet më të hershme. Brenda 5 muajsh nga data e hyrjes në fuqi, ATP-ja duhej të publikonte një regjistër me të gjitha vendimet që njihnin të drejtën për kompensim, sipas parashikimit në nenin 16. Regjistri do të publikohej në faqen e internetit të ATP-së, Buletini i Njoftimeve Zyrtare dhe në media. Dokumentet që mungonin do të plotësoheshin brenda gjashtë muajsh nga data e publikimit të regjistrit.

49. Nëse dokumentet që mungonin nuk do të siguroheshin brenda afatit gjashtëmuor dhe nëse do të ishte objektivisht e pamundur për ATP-në të vlerësonte pronën mbështetur në dokumentacionin nën pronësinë e saj, vendimet e formës së prerë që njihnin të drejtën për kompensim do të ishin objekt i vlerësimit financiar mbështetur në çmimin më të ulët parashikuar në hartën e vlerësimit të pronës për të njëjtën kategori pronash dhe për të njëjtën njësi administrative.

50. Brenda tri vitesh nga data e hyrjes në fuqi, që është data 23 shkurt 2019, ATP-ja do të kryente vlerësimin financiar për të gjitha vendimet e formës së prerë që njihnin të drejtën për kompensim, sipas nenit 15§1. Me kalimin e afatit trevjeçar, ish-pronarët do të kishin të drejtën për të ndërmarrë një veprim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë ku të kërkonte vlerësimin financiar të vendimeve të formës së prerë që njihnin të drejtat e pronës dhe të drejtën për kompensim, sipas nenit 15§2, në rast se ATP-ja nuk do të kishte mundur ta bënte një gjë të tillë.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

51. Sipas nenit 19, vendimi i ATP-së, në lidhje me vlerësimin financiar do të mund të apelohej pranë Gjykatës Administrative të Apelit, brenda tridhjetë ditësh nga njoftimi i tij.

52. Personat, prona e të cilëve ishte e zënë nga ndërtimet e ndërtesave të paautorizuara, të cilat janë objekt i procesit të legjitimizimit, sipas ligjit për legalizimin, do të kishin të drejtën të kërkonin kompensim, sipas këtij ligji në përputhje me nenin 21 në këtë ligj.

53. Nëse vendimet e brendshme njihnin të drejtën për parablerje për objektet nën pronësinë e shtetit, të cilat do t'i nënshtroheshin privatizimit, një ish-pronar ishte i lirë të hiqte dorë nga ushtrimi i një të drejte të tillë, në shkëmbim të kompensimit (shumë e cila do të vlerësohej nga ATP), brenda një viti nga publikimi i regjistrit të vendimeve që njihnin të drejtën për kompensim. Ky afat nuk mund të shtyhej.

v. Format dhe pagesat e kompensimit

54. Format kryesore të kompensimit, sipas ligjit për pronat 2015 janë kompensim në natyrë dhe kompensim financiar, sipas parashikimit në nenin 8, i cili parashikon si më poshtë:

“Neni 8

Format e kompensimit dhe vlerësimi

1. Subjektet e shpronësuara u nënshtrohen procedurave të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim:

a) financiar;

b) me pronë tjetër të paluajtshme të çdo lloji, me vlerë të barabartë, në pronësi të shtetit;

c) me aksione në shoqëri me kapital shtetëror ose ku shteti është bashkëpronar, që kanë vlerë të barabartë me pronën e paluajtshme;

ç) me vlerën e objekteve, të cilat janë objekt i privatizimit.

2. Procesit të vlerësimit të pronës që do të kompensohet, sipas këtij neni, u nënshtrohen:

a) toka;

b) objektet ndërtimore.

...

4. Vlera e pronës që kompensohet nxirret sipas përcaktimeve të këtij ligji, duke u bazuar:

a) për tokën, në hartën e vlerës;

b) për objektet, në vendimin e Këshillit të Ministrave për metodologjinë e vlerësimit të pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.”

55. Procesi i kompensimit do të fillonte kur vendimi i ATP-së për vlerësimin financiar të bëhej i formës së prerë, sipas parashikimeve të nenit 16§5 të ligjit për pronat 2015. Procesi i kompensimit për të gjitha vendimet e formës së prerë, të cilat njohin të drejtën për kompensim, duhet të realizohet brenda dhjetë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi. Shuma e kompensimit nuk do të jetë objekt tatimi.

56. Seksioni i 25-të parashikon se nuk do të akordohet asnjë kompensim në natyrë jashtë zonës së pazënë të tokës së ish-pronarit, nëse toka, midis të tjerash, i shërben një interesi publik në përputhje me kufizimit e parashikuara nga ligji ose nëse është zënë në përputhje me një sërë statutesh bashkëlidhur ligjit për tokën 2015.

57. Ligji për tokën 2015 parashikon krijimin e një fondi kompensimi, i cili është i paprekshëm dhe do të përbëhet nga fondi për tokën dhe fondi për kompensimin financiar.

a) Fondi i tokës

58. Sipas nenit 2, fondi i tokës i cili do të përdoret për të ofruar kompensimin në natyrë, përbëhet nga: a) prona fizike të pozicionuara në secilin rreth dhe të disponueshme me anë të vendimeve qeveritare; b) tokë e pazënë e pozicionuar në zona të zëna nga ndërtime të paligjshme; dhe c) tokë tjetër e cila bëhet e disponueshme, në përputhje me ligjin e brendshëm ose me anë të zbatimit të vendimeve. Fondi i tokës i nënshtrohet vlerësimit financiar, në përputhje me hartat e vlerësimit të pronës. Informacioni për fondin e tokës dhe vlerësimin e tij publikohet në ambientet dhe në faqen e internetit të ATP-së.

b) Fondi për kompensimin financiar

59. Burimet e fondi për kompensimin financiar, i cili administrohet nga ATP-ja, janë si më poshtë: a) derdhje të përvitshme në fond nga buxheti i shtetit; b) produktet e përfituara nga shitjet në ankand të pronave shtetërore, të cilat janë pjesë e fondit të tokës; c) produkte të gjeneruara gjatë procesit të legalizimit të ndërtimeve të paligjshme, sipas ligjit për legalizimin (*shih paragrafët 110–112 më poshtë*); d) produktet të cilat transferohen në fondin e kompensimit financiar, sipas statuteve të posaçme ose me zbatimin e vendimeve; dhe e) kontributet e bëra nga donatorët.

60. Në lidhje me alokimet nga buxheti i shtetit, shuma në total do të jetë jo më pak se 50 milionë lekë shqiptarë (ALL) (rreth 405,503,000 euro) të cilat do të kontribuohen përgjatë dhjetë vjetësh. ATP-ja mund të organizojë edhe shitje në ankand të pronave, të cilat përbëjnë fondin e kompensimit financiar. Të gjithë ish-pronarët në pronësi të një vendimi i cili njih të drejtën për kompensim, i cili ka qen objekt i vlerësimit financiar nga ATP-ja ka të drejtë të marrë pjesë në të. Nëse ankandi është i pasuksesshëm, prona do të jepet si kompensim në natyrë për ish-pronarët, të cilët zotërojnë një vendim të formës së prerë, i cili njih të drejtën e tyre për kompensim.

61. Sipas nenit 17, jo më shumë se një e treta e secilës derdhje buxhetore vjetore nga buxheti i shtetit do të përdoret për të paguar kompensimin e përshpejtuar me kërkesë të ish-pronarit; si më poshtë: a) nëse një ish-pronar kërkon pagesën e të gjithë kompensimit financiar brenda një viti, do të paguhet vetëm 20% e shumës së kompensimit në total dhe do të hiqet dorë prej pjesës tjetër; b) nëse një ish-pronar kërkon pagesën e kompensimit financiar brenda tri jetësh, do të paguhet vetëm 30% e shumës në total të kompensimit dhe nga pjesa tjetër do të hiqet dorë; dhe a) nëse një ish-pronar kërkon pagesën e kompensimit financiar brenda pesë vitesh, do të paguhet vetëm 40% e shumës në total të kompensimit dhe hiqet dorë nga pjesa tjetër.

62. Sipas nenit 18, nëse dy ose më shumë vendime të veçantë njohin të drejtën për kompensim për persona të ndryshëm për pjesë të së njëjtës sipërfaqe toke, ATP-ja do të: a) procedojë me vlerësimin financiar të pronës, në përputhje me parashikimet e ligjit për pronat të vitit 2015; b) paguajë kompensimin për pjesët e tokës të cilat nuk mbivendosen; dhe c) depozitojë shumën e kompensimit për pjesët e tokës të cilat mbivendosen, në një llogari bankare të posaçme, shumë e cila paguhet pas zgjidhjes së çështjes me anë të një zgjidhje miqësore midis palëve ose me anë të përfundimit të procedimeve gjyqësore.

2. Praktika gjyqësore e gjykatave të brendshme, në lidhje me ligjin për pronat 2015

a) Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese

63. Në vitin 2016, një kërkesë për shqyrtim kushtetues për ligjin për pronat 2015 u paraqit në Gjykatën Kushtetuese. Ankuesit, më konkretisht Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, një sërë deputetësh dhe shoqatat e ish-pronarëve, pretenduan se ligji për pronat 2015 shkelte parimin e sigurisë ligjore, sepse ai: 1. paraqiste një skemë të re kompensimi, e cila do të rezultonte në shuma shumë më të ulëta kompensimi për shumë ish-pronarë; 2. ndryshonte skemën e kompensimit të pronës për ish-pronarët, prona e të cilëve ishte shpronësuar nga regjimi komunist; dhe 3. rezultonte në një shqyrtim të vendimeve të formës së prerë të paekzekutuara të cilat akordonin kompensim ose rikthim. Në vijim, ata argumentonin se ligji për pronat 2015 rezultonte në diskriminimin midis ish-pronarëve, të cilët prisnin të merrnin kompensim dhe atyre të cilët tashmë kishin përfutur kompensim në mbështetje të legjislationit të mëparshëm, i cili parashikonte kompensim në vlerën e tregut.

i. Përmbledhja e këshilltarit (amicus curiae) të Komisionit të Venecias

64. Më 7 korrik 2016, kryetari i Gjykatës Kushtetuese ftoi Komisionin Evropian për Demokraci me Anët të Ligjit (Komisioni i Venecias) për të ofruar një përmbledhje të *amicus curiae* (e këshilltarit) për respektimin e nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës në ligjin për pronat 2015.

65. Më 17 tetor 2016, Komisioni i Venecias lëshoi një përmbledhje të *amicus curiae* (këshilltarit) (opinion nr. 861/2016–CDL–AD (2016)023). Në lidhje me ekzistencën e një ndërhyrje, përmbledhja e *amicus curiae* nënvizonte për sa ka të bëjë me çështjen, si më poshtë (referencat janë hequr):

“28. Sipas [nenit] 3 (*shih më sipër*) të një relacioni për [ligjin për pronat 2015], ky [akt] duhet të zbatohet për të gjitha kërkesat e shqyrtuara nga [Agjencia për Trajtimin e] Pronës, ditën e hyrjes së tij në fuqi, si edhe për të gjitha ato kërkesa të cilat do të dorëzohen, sipas kushteve të këtij ligji për

njohjen e së drejtës ndaj pronës, dhe do të shtrijë e efektin e tij edhe për vlerësimin dhe ekzekutimin e të gjitha vendimeve për njohjen e së drejtës për kompensim, marrë nga organet administrative ose autoritetet gjyqësore, duke përfshirë ato të cilat shqyrtohen nga gjykatat, Gjykata e Lartë e Shqipërisë, si edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

29. Sipas ligjit, vendimet administrative të formës së prerë ose ato gjyqësore të cilat përmbajnë një shumë specifike kompensimi për t'u ofruar, por nuk janë ekzekutuar ende, nuk do të rivlerësohen. Në përputhje me rrethanat, edhe pse në këto çështje ekziston një "pritshmëri legjitime" e padiskutueshme, nuk ekziston asnjë ndërhyrje, sipas kuptimit të nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për aq kohë sa këto vendime ekzekutohen rregullisht. Në këtë kontekst, duhet të ritheksohet se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka deklaruar se një mungesë fondesh ose burimesh të tjera nuk mund të jetë një arsye për vendin të mos respektojë detyrimin e tij, sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për të siguruar respektimin e vendimit të formës së prerë brenda një afati të arsyeshëm.

30. Në lidhje me vendimet, të cilat përcaktojnë rikthimin ose kompensimin vetëm për sipërfaqen dhe jo për vlerën financiare, nuk është e qartë se sa larg shkon pritshmëria legjitime. Relacioni për ligjin për pronat 2015 argumenton se nuk është ndërtuar kurrë një skemë kompensimi e formës së prerë. Për sa u përket personave ose subjekteve të cilëve nuk iu është dhënë ende një vendim i formës së prerë nga organi administrativ ose gjykata ku të njihet e drejta për rikthim ose kompensim, Qeveria shqiptare i referohet vendimit të Gjykatës Evropiane në çështjen *Bici kundër Shqipërisë* për të justifikuar se këta persona ose subjekte nuk zotërojnë një pronë dhe nuk kanë krijuar pritshmëri legjitime përdërisa e drejta e tyre nuk njihet në nivel lokal.

31. Megjithatë, skema e re e kompensimit e zbatuar nga ligji për pronat 2015 ka ndryshuar metodën e vlerësimit. Elementi kryesor i vlerësimit të kompensimit financiar është vlera e pronës, sipas kategorisë kadastrave që ajo kishte në kohën e shpronësimit. Kjo qasje ndryshon nga legjislacioni i mëparshëm dhe mund të çojë në një kompensim më të ulët. Ligjet e mëparshme: ligji për pronat i vitit 1993, ai i vitit 2004 dhe ai i vitit 2006, parashikonin një skemë më të larët kompensimi se sa ligji për pronat 2015. Për këtë arsye, mund të argumentohet se ish-ligjet krijuan pritshmëri për të marrë kompensim të barasvlershëm me vlerën e tregut të pronës në kohën e vendimit për kompensim. Edhe nëse kompensimi më i ulët nuk mund të kualifikohet si shpronësim formal, mund të kualifikohet si një "ndërhyrje tjetër", e cila është një dispozitë gjithëpërfshirëse e parashikuar në nenin 1, protokollit nr. 1."

66. Përmbledhja e *amicus curiae*, në vijim nënvizonte se ndërhyrja e autoriteteve kishte një bazë të qartë ligjore në ligjin për pronat 2015 dhe se ndërhyrja ndiqte një interes publik legjitim, sipas parashikimit në nenin 2 të tij. Në lidhje me proporcionalitetin e ndërhyrjes, përmbledhja e *amicus curiae* pohon, për sa ka të bëjë me çështjen, si më poshtë:

"40. Siç mund të vihet re në vendimin *Manushaqe [Puto dhe të tjerët]*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është bërë me dije për situatën e veçantë në Shqipëri dhe është e gatshme ta marrë atë në konsideratë, teksa vlerëson situatën ligjore të Shqipërisë në një grup të ri procedimesh pasi Gjykata Kushtetuese ka vendosur për çështjen. Në lidhje me këtë, analiza e detajuar në relacionin për ligjin për pronat 2015 do të marrë në konsideratë proporcionalitetin e ndërhyrjes në të drejtat e pronarëve. Gjithashtu, numri i lartë i çështjeve të mbetura pezull (rreth 40,000) është një faktor i përcaktuar dhe i padiskutueshëm. Ky është një element tjetër i cili do t'i japë legjislaturës së brendshme një margjinë të caktuar vlerësimi, për aq kohë sa Çështja zgjidhet në mënyrë jodiskriminuese dhe përfundimtare.

41. Në kontekstin shqiptar, Qeveria gjykoi se nëse kompensimi do të bëhej sipas ligjit të mëparshëm, ai do të kushtonte 814 miliardë lekë shqiptarë (pothuajse 6 miliardë euro) dhe procesi i kompensimit do të merrte 2,713 vite kohë (me një buxhet prej 300 milionë lekësh në vit). Sipas skemës së re të kompensimit, Çështja e kompensimit mund të zgjidhet në shumën prej 50 miliardë lekësh, brenda një periudhe prej dhjetë vjetësh. Gjithashtu, ligjet e mëparshme (aktet e pronës së vitit 1993, 2004, 2006) nuk ia kanë dalë të adresojnë problemin e rikthimit ose kompensimit të pronave në

mënyrë efikase, kryesisht për shkak të problemeve financiare, por edhe për shkak të zgjidhjeve të paligjshme për tokën ose për shkak të mungesës së eficiencës nga ana e institucioneve. Kjo do të rezultonte në një numër të madh çështjesh të prapambetura të cilat arrijnë, siç përmendet me sipër, rreth 40,000 çështje në nivele kombëtar.

42. Në nenin 11 të ligjit për pronat 2015 parashikohet një fond financiar prej 50 miliardë lekësh brenda 10 vjetësh. Megjithatë, nuk ofrohet asnjë shpjegim për mënyrën se si kjo shumë u përcaktua, duke marrë në konsideratë buxhetin e shtetit si një të tërë dhe PBB-në në Shqipëri. Gjithashtu, ligji për pronat 2015, nuk parashikon një vlerësim për të ardhurat nga ankandet për pronat (neni 13 i ligjit për pronat 2015). Duhet të merren në konsideratë kostot, të cilat mbulohen nga shteti për burimet njerëzore, materialet, koordinimin midis institucioneve dhe mekanizmit të apelimeve, së bashku me zhvillimin ekonomik në të ardhmen dhe të ardhurat e taksave në lidhje me to.

43. Në vendimin *Manushaqe [Puto dhe të tjerët]*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nënvizon rëndësinë e vendosjes së një kuadri statutor realist dhe afateve detyruese për çdo hap të procesit. Në këtë situatë, ligji për pronat 2015 parashikon afate të qarta për zbatimin e legjislacionit dytësor (*shih më sipër për tri aktet nënligjore*) dhe aktivitetet e Agjencisë për Trajtimin e Pronës. Ky është një hap shumë pozitiv, edhe pse nuk është dhënë asnjë shpjegim për mënyrën se si do të përlogariten këto afate dhe përse vlerësohen si realiste.

44. Në përfundim, duke marrë në konsideratë situatën specifike të Shqipërisë, mund të argumentohet se një kuadër i ri dhe efikas ligjor, i cili mund të çojë në një shumë më të ulët kompensimi për ish-pronarët, i përmbush kërkesat e proporcionalitetit parashikuar në nenin 1 protokollit nr. 1 i KEDNJ-së. Veçanërisht, duket me vend që ligji për pronat 2015 t'i referohet kategorizimit kadastral të pronës në kohën e shpronësimit pa u konsideruar si shpërpjesëtim ekstrem midis vlerës zyrtare kadastrale të tokës dhe kompensimit të paguar për ish-pronarët.”

ii. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese

67. Në vendimin e saj nr. 1, të datës 16 janar 2017 (vendimi nr. 1/2017), banka me tetë anëtarë e Gjykatës Kushtetuese kundërshtoi kërkesën për rrëzim të zbatimit të ligjit për pronat 2015 si i pabazuar. Shumica pranoi se nenet 6§1 dhe 6§2 të ligjit për pronat 2015 ishin kushtetuese. Në gjykimin e Gjykatës Kushtetuese, këto parime “mbartin parimet kryesore në lidhje me skemën e kompensimit”, e cila ishte ndryshe nga skema e parashikuar në legjislacionin e mëparshëm. Skema e re e kompensimit do të rezultonte në dhënien e shumave më të vogla të kompensimit në disa çështje në krahasim me legjislacionin e mëparshëm për pronën. Mund të argumentohet se ligjet e mëparshme mund të kenë krijuar disa pritshmëri legjitime për pjesën e ish-pronarëve, në mënyrë që këta të fundit të merrnin kompensimin me vlerën e tregut. Megjithatë, skema e re e kompensimit nuk mund të ngrinte çështje për një shkëlqje të pretenduar të pritshmërive legjitime të ish-pronarëve, duke qenë se një skemë përfundimtare kompensimi për të drejtën ndaj një shume të përgjithshme kompensimi, nuk ishte përcaktuar kurrë. Për më tepër, një reduktim në shumën e kompensimit nuk mund të konsiderohej shpronësim formal, por si “një ndërhyrje tjetër”, sipas interpretimit të nenit 1, të protokollit nr. 1. Një ndërhyrje e tillë parashikohej me një ligj të miratuar nga Parlamenti.

68. Për sa i përket ekzistencës së një interesi publik, Gjykata Kushtetuese vendosi se parimi i sigurisë ligjore nuk ishte absolut dhe mund të kufizohej për një interes legjitim ose publik. Ajo konstatoi se interesi publik me një ndërhyrje të tillë ishte “zgjidhja e problemeve të pronës brenda një harku kohor të arsyeshëm, më konkretisht 10 vjet, me kosto financiare me vend, si edhe krijimi i paqes sociale midis shtresave të ndryshme të shoqërisë nën ndikimin e çështjeve të pronës, të cilat vijonin të ishin të pazgjidhura për 25 vjet. Për sa i përket proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar përmbledhjes së *amicus curiae* (këshilltarit) të Komisionit të Venecias pohonte se “Shteti gëzon një margjinë të gjerë vlerësimi në përcaktimin se çfarë është në interesin publik, veçanërisht sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 dhe, veçanërisht, kur zbatohen politika sociale dhe ekonomike”. Në vijim, referohej paragrafi 44 i përmbledhjes së *amicus curiae* të Komisionit të Venecias. Ai arrinte në përfundimin se skema e re e kompensimit synonte të vendoste balancën e duhur midis interesave të ndryshëm konkurrues.

69. Në lidhje me vendimet e brendshme, të cilat jepnin një shumë specifike kompensimi, Gjykata Kushtetuese nënvizonte se këto vendime nuk do t'i nënshtroheshin rivlerësimit financiar. Duke u mbështetur në këtë vendim të Gjykatës në çështjen *Bici kundër Shqipërisë* (nr. 5250/07, 3 dhjetor 2015), Gjykata Kushtetuese theksonte se nuk mund të kishte një shkelje të pritshmërive legjitime për ish-pronarët të cilëve nuk iu njiheshin ende të drejtat mbi pronën.

70. Megjithatë, Gjykata Kushtetuese gjykonte se “pjesa tjetër e nenit 6 rregullon situata specifike, të cilat – [duke qenë] pjesë e metodologjisë së kompensimit – gjejnë zgjidhje në dispozita të tjera të ligjit për pronat 2015.” Në këtë këndvështrim, me një shumicë, ajo rrëzoi nenet 6§3 dhe 6§5 të ligjit për pronat 2015. Në këtë këndvështrim, të dyja dispozitat “u perceptuan si shpronësimi i ri, duke qenë se ato përcaktonin një rivlerësim të pronave të cilat i ishin rikthyer tashmë ish-pronarëve ose për të cilat ata tashmë kishin marrë kompensim”. Për këtë arsye, ata ngritën çështje në lidhje me shkeljen e parimit të sigurisë ligjore, veçanërisht në lidhje me mungesën e qartësisë dhe parashikueshmërisë. Gjykata Kushtetuese pohonte se “ligjvënësi duhej të merrte në konsideratë masën në të cilën kompensimi në natyrë i parashikuar në nenet [e shfuqizuar] 6§§3 dhe 5 plotësohej nga dispozita të tjera për të shmangur ndonjë mbivendosje ose kontradiktë midis parashikimeve ligjore”.

71. Gjykata Kushtetuese theksonte, se, për aq sa ligji për pronat 2015 parashikonte për të drejtën e një ish-pronari për të apeluar ndaj një vendimi të ATP-së, i cili (nuk) njihte të drejtat e pronës, në gjykatën e apelit, ankesa në lidhje me mungesën e mundësisë për të nisur procedimet përpara gjykatës së shkallës së parë ishte dukshëm e pabazuar.

72. Votimi në Gjykatës Kushtetuese ishte në barazim në lidhje me ankesën për skemën e kompensimit parashikuar në seksionin e 7-të, të ligjit për pronat 2015, ankesë e cila u rrëzua.

73. Në lidhje me këtë, më 7 dhjetor 2017, një kërkesë e re për rishikim kushtetues të nenit 6§1(b) dhe të nenit 7§2(a) dhe (b), të ligjit për pronat 2015 u dorëzua në Gjykatën Kushtetuese, përpara së cilës procedimit janë ende pezull aktualisht. Shoqata ankuese, në mbështetje të të njëjtit arsyetim mbi të cilin Gjykata Kushtetuese, kishte shfuqizuar nenin 6§§3 dhe 5, i kishte kërkuar Gjykatës Kushtetuese t'i shfuqizonte ato nene si nene që ishin në shkelje të parimit për siguri ligjore.

b) Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë

74. Në një vendim njësoj të datës 7 shkurt 2018 (vendimi nr. 611/2018), banka civile me tre anëtarë e Gjykatës së Lartë gjykonte se gjykata e apelit, në juridiksionin e së cilës pozicionohej prona e paluajtshme e diskutuar, do të shqyrtonte një ankesë e cila ishte paraqitur nga ish-pronarët kundër vendimeve të Komisionit ose të Agjencisë, pas hyrjes në fuqi të ligjit të pronat 2015. Gjykata e apelit do të kishte juridiksion të plotë mbi faktet dhe ligjin. Një ankesë kundër vendimit të gjykatës së apelit mund të paraqitej në Gjykatën e Lartë, e cila do të kishte juridiksion ekskluzivisht mbi aspekte të ligjit. Kjo do të zbatohet edhe për apelimet e paraqitura kundër vendimeve të ATP-së që njihnin ose refuzonin të njihnin të drejtat mbi pronën ose të drejtën për kompensim, sipas nenit 29, të ligjit për pronat 2015. Megjithatë, të gjitha apelimet kundër shumës së kompensimit të përcaktuar nga ATP-ja do të shqyrtoheshin nga Gjykata Administrative e Apelit, në përputhje me nenin 19, të ligjit për pronat 2015.

75. Në vijim, Gjykata e Lartë vendosi se gjykata e shkallës së parë, në juridiksionin e së cilës përfshihej prona e paluajtshme në gjykim, do të shqyrtonte të gjitha veprimet civile të palëve të treta, në lidhje me të drejtat e pretenduara për pronat, për të cilat Komisioni ose Agjencia kishte dhënë një vendim në favor të ish-pronarit.

76. Në lidhje me zbatimin retroaktiv të ligjit për pronat 2015, Gjykata e Lartë shpjegoi se ligji për pronat 2015, në mënyrë retroaktive gjente zbatim mbi të gjitha procedimet, të cilat kishin filluar përpara hyrjes së tij në fuqi, për aq sa ato kishin të bënin me vlerësimin financiar të pronës. Nëse procedimet lidheshin me çështje të tjera, ato do të shqyrtoheshin mbi bazën e ligjit në fuqi në kohën kur do të fillonin procedimet. Për këtë arsye, Gjykata e Lartë doli në përfundimin se të gjitha veprimet civile të cilat ishin paraqitur kundër vendimeve të Komisionit ose të Agjencisë, përpara hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2015, do të shqyrtoheshin nga gjykatat e shkallës së parë në juridiksionin e së cilave përfshihej prona e paluajtshme në gjykim.

3. *Vendime në zbatim të ligjit për pronat 2015*

77. Në zbatim të ligjit për pronat 2015, u miratuan instrumentet e mëposhtme:

a) Vendimi për organizmin dhe funksionimin e ATP-së

78. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 221, i datës 23 mars 2016, parashikonte kërkesat e ligjshmërisë për, përgjegjësitë dhe llogaridhënien e anëtarëve të stafit të ATP-së dhe të drejtorit të tij të përgjithshëm, strukturën organizative dhe detyrimet raportuese (*shih edhe paragrafin 43 më sipër*). Në qershor 2018, ATP-ja punësoi një fuqi punëtore duke krijuar një staf me 169 anëtarë (*shih paragrafin 127 më poshtë*).

b) Vendimi për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e së drejtës për kompensim

79. Këshilli i Ministrave miratoi vendimin nr. 222, të datës 23 mars 2016, për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e të drejtave ndaj pronës dhe të drejtën për kompensim (VKM-ja nr. 222/2016). Vendimi trajtonte procedurat për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e dokumentacionit që ish-pronari duhej të dorëzonte për njohjen e të drejtave ndaj pronës dhe të drejtën për kompensim. Ish-pronarëve, të cilët dëshironin të paraqisnin një kërkesë për njohjen e të drejtave ndaj pronës dhe të drejtën për kompensim, iu kërkua që të paraqisnin një format aplikimi tip, bashkëlidhur në vendim, së bashku me dokumentet mbështetëse ligjore dhe kartografike, sipas vendimit. Nëse ATP-ja do të konstatonte se mungonin dokumente, ish-pronarët do të ftoheshin të plotësonin dosjen, brenda tridhjetë ditëve nga data e njoftimit.

80. ATP-ja do të bënte kërkime me institucione të ndryshme shtetërore dhe do të kryente verifikime në terren për vendndodhjen gjeografike dhe situatën fizike të pronës së pretenduar. ATP-ja do të jepte një vendim mbi vendimin për kërkesën në lidhje me ligjin për pronat 2015. ATP-ja do të korrigjonte gabime materiale në çdo kohë, me marrjen e kërkesës nga ish-pronari.

81. Më 7 dhjetor 2017, si pjesë e një kërkesë të re për rishikim kushtetues të disa dispozitave të ligjit për pronat 2015 (*shih paragrafin 73 më sipër*), shoqëria e ankuesit, duke u mbështetur në po të njëjtat arsyetime, kërkoi edhe rishikimin kushtetues të VKM-së nr. 222/2016.

Ndryshim në VKM-në nr. 222/2016

82. Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1/2017, VKM-ja nr. 222/2016 u ndryshua me anë të VKM-së nr. 765, të datës 20 dhjetor 2017, për shqyrtimin e kërkesave për njohjen e së drejtës për kompensimin e pronës (VKM nr. 765/2017). VKM-ja nr. 765/2017 sqaronte se vendimmarrja e ATP-së kishte të bënte me njohjen e së drejtës për kompensim. Sipas VKM-së nr. 765/2017, ATP-ja mund të kërkonte dokumente mbështetëse shtesë gjatë shqyrtimit administrativ të kërkesës së ish-pronarëve. Nëse, pas përfundimit të afatit që një ish-pronar të paraqiste dokumente shtesë, kërkesa nuk do të respektonte kërkesat formale të parashikuara në vendim, ATP-ja do të shqyrtonte themelin mbi bazë të dokumenteve dhe informacioneve të disponueshme. Nga institucionet shtetërore, të cilat do të konsultoheshin për gjendjen ekzistuese të pronës së kërkuar, ATP-ja ishte e detyruar të kërkonte informacione nga Agjencia Shqiptare për Zhvillim dhe Investim dhe Agjencia për Trajtimin e Koncesioneve. Nëse ATP-ja do të pranonte kërkesën, si pjesë e të njëjtit vendim, ajo do të duhej të përcaktonte shumën dhe metodën e kompensimit. Kërkesat të cilat ishin paraqitur përpara datës së hyrjes në fuqi, për të cilat ishin njohur të drejtat e pronës, do të ishin objekt i një vlerësimi financiar në rend kronologjik.

c) Vendimi për përcaktimin e vlerësimit financiar dhe për ekzekutimin e kompensimit

83. Sipas neneve 2 deri në 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 223, të datës 23 mars 2016 (VKM nr. 223/2016), ATP-ja, duke iu referuar hartave për vlerësimin e pronës (të cilat do të miratoheshin me ekzekutimin e ligjit për pronat) do të kryente vlerësimin financiar të të gjitha vendimeve të formës së prerë, të cilat njihnin të drejtën për kompensim, në rend kronologjik, duke nisur nga vendimi më i hershëm, në përputhje me metodologjinë për kompensim: a) prona për të cilën njihet e drejta për kompensim, do të ishte objekt i vlerësimit financiar mbi bazën e kategorisë kadastrale në kohën e shpronësimit; b) prona e cila tashmë ishte rikthyer, do t'i nënshtrohej vlerësimit financiar, duke siguruar diferencën midis vlerës së saj në bazë të kategorisë aktuale kadastrale dhe vlerës së saj në bazë të kategorisë kadastrale në kohën e shpronësimit; c) kategoria kadastrale fillestare

e pronës do të përcaktohej në bazë të dokumenteve në dosjen e çështjes, dhe në mungesë të saj do të përcaktohej mbi bazë të hartës së pronës në kohën e shpronësimit ose në mungesë të një harte të tillë të pronës, mbi një hartë e cila i ngjante shumë hartës në kohën e shpronësimit. Nëse do të ishte objektivisht e pamundur që ATP-ja të përcaktonte kategorinë kadastrave, vendimi për kompensimin do të përcaktohej duke iu referuar çmimit më të ulët për pronën e pozicionuar në të njëjtën njësi administrative dhe e cila i përkiste të njëjtës kategori; d) vlera e aksioneve, bonove, kompensimit financiar ose çdo forme tjetër kompensimi, duke përfshirë vlerën e çdo prone, të përcaktuar mbi bazën e hartës së pronës dhe të siguruar në zbatim të parashikimeve ligjore për ndarjen e tokës bujqësore, të cilën e kishte marrë një ish-pronar ose trashëgimtarët e tij/saj, do të nxirrej nga vlera e siguruar si rezultat i vlerësimit financiar.

84. Sipas nenit 5, nëse shuma e kompensimit do të përcaktohej specifikisht në një vendim paraprak administrativ ose gjyqësor, shuma e kompensimit do të indekssohej në përputhje me normën zyrtare të inflacionit dhe interesit bankar mbi bazë të normës mesatare vjetore të nxjerrë nga Banka e Shqipërisë deri më 24 shkurt 2016.

85. ATP-ja do të krijonte një regjistër për vendimet e formës së prerë, i cili njihet të drejtën për kompensim, sipas nenit 7. Sipas buletineve të njoftimeve zyrtare dhe/ose medias, ish-pronarëve iu kërkohej të paraqisnin dokumentet në mungesë brenda gjashtë muajsh nga publikimi i ti, për t'i dhënë mundësinë ATP-së të kryente një vlerësim financiar të pronës, sipas së cilit duhej të njihet e drejta për kompensim. Sipas nenit 14, një ish-pronar, brenda një viti nga publikimi i vendimit të formës së prerë, mund të hiqte dorë nga ushtrimi i së drejtës për parablerje në shkëmbim të kompensimit.

86. Ish-pronarët, në zotërim të një vendimi të formës së prerë, sipas së cilit ishte kryer një vlerësim financiar, kishin të drejtën të aplikonin për kompensim, i cili do të ofrohej në rend kronologjik, si më poshtë: i. ish-pronarët në zotërim të vendimeve të formës së prerë, të cilat kishin qenë objekt i një vlerësimi financiar, duke iu referuar kategorisë kadastrave të tokës bujqësore, pyjeve, kullotave dhe lëndinave do të kompensoheshin në natyrë nga fondi i tokës, sipas nenit 18; ii. ish-pronarët, të cilët zotëronin vendime të formës së prerë, të cilët i ishin nënshtruar vlerësimit financiar, duke iu referuar kategorisë kadastrave të truallit do të kompensoheshin financiarisht në natyrë, sipas nenit 19.

87. Neni 23 parashikonte pagesën e përshpejtuar të kompensimit financiar, sipas kërkesës së një ish-pronari. ATP-ja, pavarësisht rendit kronologjik, do të orientonte pagesën e kompensimit financiar për një ish-pronar, si më poshtë: a) nëse ish-pronari do të kërkonte të paguhej për kompensimin financiar brenda një viti, ai do të merret 20% të shumës në total të kompensimit dhe do të hiqte dorë nga e drejta për pjesën e mbetur të shumës së kompensimit; b) nëse ish-pronari kërkonte pagesën e kompensimit financiar brenda tre vjetësh, ai do të merrte 30% të shumës së kompensimit, në tri këste të barabarta, gjatë tre vjetëve të njëpasnjëshëm dhe do të hiqte dorë nga e drejta për shumën e mbetur të kompensimit; c) nëse ish-pronari do të kërkonte të paguhej për kompensim financiar brenda pesë tre vjetësh, ai do të merrte 40% të shumës së kompensimit, në pesë këste të barabartë gjatë pesë vjetëve të njëpasnjëshëm dhe do të hiqte dorë nga e drejta për shumën e mbetur të kompensimit.

88. Sipas neneve 27 deri në 36, ish-pronarët të cilët kishin marrë një vendim të formës së prerë, i cili njihet të drejtën e tyre për kompensim dhe kishin siguruar vlerësimin financiar të pronës së tyre do të mund të aplikonin për të marrë pjesë në ankande të mbyllura për pronat shtetërore. Këto prona mund të përfshinin tokën, e cila i ishte nënshtruar një procesi të pasuksesshëm privatizimi. Nëse vendimi nuk do të ishte objekt i një vlerësimi financiar, ATP-ja, pa paragjykim ndaj respektimit të rregullës për rendin kronologjik, do të përcaktonte vlerën e tij financiare. ATP-ja do t'ia akordonte pronën e nxjerrë në ankand ofertuesit më të lartë. Nëse prona nuk do të mund të shitej me anë të procedurës së ankandit të mbyllur, ATP-ja do të organizonte një procedurë me ankand të hapur dhe do të ftohte të gjitha palët e interesuara që të bënin një ofertë.

89. Më 7 dhjetor 2017, si pjesë e kërkesës së re për shqyrtim kushtetues të disa dispozitave të ligjit për pronën 2015 (*shih paragrafin 73 më sipër*), shoqëria ankuuese, duke u mbështetur në të njëjtat arsye, kërkoi edhe shqyrtim kushtetues të VKM-së nr. 223/2016.

i. Ndryshimet në VKM-në nr. 223/2016

90. Format e aplikimit bashkëlidhur në VKM-në nr. 223/2016, u ndryshuan me anë të VKM-së nr. 685, të datës 28 shtator 2016. Ndryshimi kryesor kishte të bënte me një kërkesë për ish-pronarët për të paraqitur një vetëdeklarim të noterizuar, me anë të të cilit ata do të deklarorin nëse vendimi administrativ, i cili njihete të drejtat e tyre për pronën ishte bërë i formës së prerë ose ishte apeluar dhe nëse ata kishin përfituar nga dispozitat ligjore në lidhje me shpërndarjen e tokës.

91. Në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1/17, ministri i Drejtësisë urdhëroi ngritjen e një grupi pune për të kryer një analizë të detajuar të vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe ndikimin e saj në legjislacionin ekzistues, si edhe të bënte rekomandime ose të propozonte zgjidhje me qëllimin për të sjellë aktet nënligjore në linjë me ligjin për pronat 2015, sipas nevojës.

92. Siç iu parashtrua, Komitetit të Ministrave, në detyrën e tij për të mbikëqyrur zbatimin e vendimit pilot *Manushaqe Puto (shih paragrafët 126 dhe 127 më poshtë)*, Qeveria arriti në përfundimin se nuk kishte nevojë të ndryshohej ligji për pronat 2015, duke qenë se sipas këndvështrimit të saj, dispozitat e shfuqizuara nuk kishin sjellë ndryshime materiale në ligjin për pronat 2015 ose në formulën e kompensimit. Për të siguruar respektimin e parimit të sigurisë ligjore dhe për të ofruar qartësi të mëtejshme për procedurat për vlerësimin financiar dhe kompensimin e ish-pronarëve, sipas udhëzimit të Gjykatës Kushtetuese, Qeveria vendosi të ndryshonte VKM-në nr. 223/2016.

93. Për pasojë, VKM-ja nr. 223/2016 u ndryshua me anë të VKM-së nr. 766, të datës 20 dhjetor 2017 (VKM nr. 766/2017). VKM-ja nr. 766/2017, në vijim parashikonte se kompensimi në natyrë i përfituar nga një ish-pronar do të ishte po ashtu objekt i një vlerësimi financiar, duke përfutur diferencën midis vlerës së tij në bazë të kategorisë aktuale së kadastrave dhe vlerës së tij në bazë të kategorisë së kadastrave në kohën e shpronësimit.

94. Sipas nenit të ri 4/1, nëse vlerësimi financiar i pronës objekt kompensimi, të përlllogaritur në bazë të kategorisë së kadastrave në kohën e shpronësimit do të ishte më i lartë se sa vlerësimi financiar i pronës, e rikthyer në natyrë, një ish-pronar do të kompensohej për diferencën midis të dyjave. Megjithatë, nëse vlerësimi financiar i pronës objekt kompensimi, sipas përlllogaritjes në bazë të kategorisë kadastrale në kohën e shpronësimit, do të ishte më pak se sa vlerësimi financiar i pronës së rikthyer në natyrë, do të gjykohej se ish-pronari ishte kompensuar plotësisht.

95. Sipas nenit të ri 16/2, kompensimi do të ofrohej në rendin e mëposhtëm të prioritetit: a) kompensimi në natyrë nga hapësira e lirë e pronës së shpronësuar të ish-pronarit; b) kompensimi në natyrë nga fondi i tokës, dhe c) kompensimi financiar. Prioritet do t'i jepej kompensimit në natyrë të zonës së lirë të pronës së shpronësuar të ish-pronarëve, sipas nenit 26/1. Kompensimi në natyrë i një zone të lirë, i pronës së ish-pronarit, nuk do të finalizohet, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila do të finalizohet me 100 hektarë, sipas nenit të ri 26/3. Sipas nenit të ri 26/4, vlera e kompensimit në natyrë do të mbështetej në hartat e vlerësimit të pronës (të cilat do të miratoheshin në zbatim të ligjit për pronat 2015).

96. Sipas nenit të ri 17/1, ATP-ja nuk do të akordonte kompensim në natyrë nga prona e shpronësuar e ish-pronarit (për të cilat ishin njohur të drejtat për pronën), nëse toka do të gjykohej se ishte zënë, sipas interpretimit të ligjit për pronën 2015 (*shih paragrafin 56 më sipër*). Sipas nenit të ri 17/2, ATP-ja do t'u adresojë autoriteteve të ndryshme qendrore dhe lokale për të kërkuar informacion nëse një leje për ndërtim ose një leje tjetër ishte dhënë ose ishte në procesin e dhënies, sipas ligjit, përpara se të vendosej se prona e shpronësuar e një ish-pronari (për të cilën ishin njohur të drejtat për pronën) mund të përdorej si kompensim në natyrë.

97. Sipas nenit të ndryshuar 37, ATP-ja do të akordonte kompensim në natyrë nga fondi i tokës, nëse ishin përfunduar procedurat për kompensimin në natyrë të një zone të lirë nga prona e shpronësuar e ish-pronarit, nëse ish-pronari nuk kishte aplikuar për kompensim me anë të ankandit dhe nëse ish-pronari kishte paraqitur një formular aplikimi standard për të marrë kompensim në natyrë nga fondi i tokës. ATP-ja do të përzgjidhte tokën, e cila do të ishte gjeografikisht pranë pronës për të cilën ishte njohur e drejta për kompensim.

98. Sipas nenit 18 të ndryshuar, kompensimi financiar do të akordohet në të gjitha rastet e pamundësisë nga ana e autoriteteve për të akorduar kompensim në natyrë, sipas përshkrimit në

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

paragrafët paraprijës 95 dhe 97. Kompensimi financiar do të finalizohet me më pak se 20% nga shumën në total, përfshirë si rezultat i vlerësimit financiar dhe 10 milionë ALL (rreth 81,100 euro). Sipas nenit të ri 9/1, kompensimi financiar do të akordohet vetëm nëse kompensimi në natyrë nuk mund të ofrohet. Kompensimi financiar do të paguhet në këste të barabarta gjatë periudhës dhjetëvjeçare sipas nenit të ri 40/2.

ii. Praktika gjyqësore e gjykatave të brendshme, në lidhje me kushtetutshmërinë e VKM-së nr. 766/2017

99. Një sërë ankuesish, pronat e të cilëve ishin objekt i vlerësimeve financiare nga ATP-ja, përpara muajit dhjetor 2017, shumën e të cilave ata e kishin pranuar, kundërshtuan kushtetutshmërinë e VKM-së nr. 766/2017, përpara Gjykatës Kushtetuese, duke argumentuar se duke finalizuar shumën e kompensimit financiar në 10 milionë ALL, që do të paguheshin në 10 vite dhe duke parashtruar një hierarki për format e kompensimit, parashikimet e VKM-së ishin në disproporcion dhe përtej parashikimeve statutores në ligjin për pronat 2015. Sipas tyre, ndryshimet e shkaktuara nga VKM-ja që kundërshtohet, kishin efekt retroaktiv, nuk ishin bërë objekt konsultimesh (publike) dhe nuk i shërbenin një interesi legjitim.

100. Me anë të vendimeve nr. 82, 85 dhe 86, të datës 20 qershor 2018 dhe nr. 94, të datës 2 korrik 2018, Gjykata Kushtetuese rrëzonte ankesat kushtetuese të ankuesve me argumentin për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme, për shkak të mosdorëzimit të një ankese në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila konsiderohej të ishte një mjet efikas për të kundërshtuar ligjshmërinë e VKM-së nr. 766/2017.

101. Nga faqja e internetit të Gjykatës Administrative të Apelit rezultoi se, më 26 prill 2019, Gjykata Administrative e Apelit kishte rrëzuar apelimin e ankuesit për shfuqizimin e VKM-së nr. 766/2017 (Çështja nr. 31156-003367-86-2018 paraqitur më 7 shtator 2018). Në Gjykatën Administrative të Apelit do të rezultonin gjashtë apeline shtesë të mbetura pezull për shqyrtim.

iii. Praktika gjyqësore e gjykatave vendëse në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e VKM-së nr. 766/2017

102. Më 16 tetor 2019, Qeveria parashtroi vendimet e mëposhtme të gjykatave të brendshme:

i. Me anë të vendimit nr. 61, të datës 19 mars 2019, një bankë e Gjykatës Administrative të Apelit konstatoi se apelimi i kërkuesve ishte paraqitur brenda afatit 30-ditor nga publikimi i vendimit të ATP-së, mbi vlerësimin financiar, në përputhje me nenin 19, të ligjit për pronën 2015. Në vijim ajo shtoi se në mungesë të një neni në vendimin e ATP-së për vlerësimin financiar ku të parashikohej e drejta e ankuesit për apelim, afati kohor për të ushtruar një të drejtë të tillë do të ishte një vit nga data e publikimit të tij, në përputhje me nenin 18§2 të ligjit për gjykatat administrative (*shih paragrafin 116 më poshtë*). Gjykata e rrëzoi apelimin e ankuesit në themel dhe la në fuqi vendimin e ATP-së për vlerësimin financiar.

ii. Më 26 mars, 28 maj dhe 25 prill 2019, një bankë tjetër e Gjykatës Administrative të Apelit prishi vendimet e ATP-së, për vlerësimin financiar të pronave të ankuesve, sipas së cilave, me qëllim realizimin e vlerësimit financiar, pronat konsideroheshin si toka bujqësore në kohën e shpronësimit. Gjykata, duke iu referuar dokumenteve në dosjet e çështjes dhe të raporteve të ekspertëve, theksoi se pronat e ankuesve kishin qenë truall në kohën e shpronësimit. Mbështetur në hartat e vlerësimit të pronës dhe në kërkesat e ankuesve, gjykata përcaktoi shumën e kompensimit, të cilat ATP-ja do të duhej t'u paguante ankuesve.

Me anë të të njëjtave vendime, Gjykata Administrative e Apelit, në vijim deklaroi se në mungesë të një neni në vendimet e ATP-së për vlerësimin financiar, ku të përcaktohej e drejta e ankuesve për apelim, afati për të ushtruar një të drejtë të tillë ishte një vit nga data e publikimit të tij, sipas nenit 18§2 të nenit për gjykatat administrative.

iii. Me anë të vendimit nr. 142, të datës 10 qershor 2019, një bankë tjetër e Gjykatës Administrative të Apelit konstatoi se apelimi i ankuesve ishte dorëzuar brenda afatit tridhjetëditor nga publikimi i vendimit të ATP-së për vlerësimin financiar, sipas nenit 19 të ligjit për pronat 2015. Gjykata rrëzoi apelimin e ankuesve në themel dhe la në fuqi vendimin e ATP-së për vlerësimin financiar.

d) Vendimi për hartat e vlerësimit të pronave

103. Më 3 shkurt 2016, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin e tij nr. 89 për hartat e vlerësimit të pronës (VKM-ja nr. 89/2016). Hartat për vlerësimin e pronave përbëhen nga tabela të cilat përmbajnë emrat e njësive administrative, zonat kadastrale, kategorinë kadastrale dhe çmimin respektiv për metër katror.

104. Më 22 dhjetor 2017, në Gjykatën Kushtetuese u paraqit një kërkesë për shqyrtimin kushtetues të VKM-së nr. 89/2016, Gjykatë në të cilën procedimet aktualisht janë pezull. Shoqëria ankuese, duke cituar vendimet e kësaj Gjykate në çështjet *Vrioni dhe të tjerët*, cituar më sipër, *Karagozi dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, dhe *Sharra dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, i ka kërkuar Gjykatës Kushtetuese të shfuqizojë VKM-në nr. 89/2016, duke argumentuar se hartat e vlerësimit të vitit 2016 nuk reflektonin vlerën aktuale të tregut.

i. Metodologjia në lidhje me përgatitjen e hartave të vlerësimit të pronës

105. Hartat e vlerësimit të pronës u përcaktuan në mbështetje të metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të miratuar me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 658, të datës 26 shtator 2012, ndryshuar me vendimin nr. 1034, të datës 16 dhjetor 2015. Sipas nenit 3 të aneksit 1 bashkëlidhur vendimit, “përlllogaritja e vlerësimit të pronës do të mbështetet në standardet ndërkombëtare për vlerësimin e pronave të paluajtshme ..., përmes të cilit vlera e tokës barazohet me çmimin e kontratës së shitjes. Çmimi i shitjes nënkupton çmimin e tregut sipas llojit dhe qëllimit të përdorimit të pronës. Çmimi i tregut do të merret nga regjistri zyrtar i kontratave të shitjes të regjistruara në ZRPP”.

106. Metodologjia është përshkruar në vendimin e Gjykatës në çështjen *Sharra dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §§35–42. Sipas nenit 5, ZRPP-ja i vë në dispozicion ATP-së të dhëna të përvitshme për çmimet e shitjeve, të cilat janë regjistruar në ZRPP, për çdo zonë kadastrale, sipas transaksioneve të regjistruara në, dhe të raportuara nga ZRPP-ja, sipas parashikimit në nenin 6. Nevojiten të paktën tri transaksione për të përcaktuar çmimin e pronës për një zonë ose kategori të caktuar kadastrale. Në mungesë të këtyre transaksioneve, “vlerësimi i pronës do të përcaktohej mbështetur në metodën jo të drejtpërdrejtë, duke i grupuar kontratat e shitjes në një nivel me të ngushtë, sipas këtij rendi: fshat, qytet, bashki, qark për llojin e grupit të pronës”.

ii. Praktika gjyqësore e gjykatave të brendshme, në lidhje me hartat për vlerësimin e pronës

107. Më 16 tetor 2019, Qeveria parashtrroi se me anë të vendimit nr. 162, të datës 20 qershor 2019, Gjykata Administrative e Apelit kishte pushuar veprimin e një ankuesi ndaj paligjshmërisë së pretenduar të VKM-së nr. 89/2016.

Gjykata Administrative e Apelit konstatoi se VKM-ja nr. 89/2016 ishte miratuar në zbatim të ligjit për pronat 2015, i cili, nga ana tjetër, ishte prezantuar si reagim ndaj vendimeve të Gjykatës dhënë për Shqipërinë. Më tej, ajo konstatoi se veprimi i ankuesve, kryesisht kishte të bënte me pakushtetueshmërinë e pretenduar të dispozitave të ligjit për pronën 2015, të cilat ishin shqyrtuar me anë të vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1/2017.

108. Më 15 gusht 2019, ankuesit paraqitën një apelim ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit në Gjykatën e Lartë, përpara së cilës procedimet kanë ende pezull.

e) Urdhri i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Financave

109. Në përputhje me ligjin për pronën 2015 (*shih paragrafin 46 më sipër*), më 9 janar 2017, ministri i Drejtësisë dhe ministri i Financave lëshuan një urdhër të përbashkët (nr. 6445/3), në lidhje me tarifën e zbatueshme për pretendimet të cilat do të dorëzoheshin nga ish-pronarët. Tarifën varionin nga 2000 ALL deri në 3000 ALL (afërsisht midis 16 dhe 24 euro).

C. Ligje të tjera të brendshme relevante

1. Ligji për legalizimin

110. I përballur me lëvizjet e brendshme demografike të popullsisë, të shpejta dhe të shtrira gjerësisht në vitet 1990 dhe 2000, Parlamenti miratoi ligjin për legalizimin (ligji nr. 9482, i datës 3 mars 2006 për legalizimin, planifikimin urban dhe integrimin e ndërtimeve pa leje) për të: i. rregulluar ndërtimet pa leje dhe shtesat bërë në sipërfaqet e tokës shtetërore ose private, ii. transferuar pronësinë e sipërfaqes së tokës në të cilën ishin ndërtuar ndërtesa pa leje; iii. urbanizuar zonat, blloqet e

ndërtesave dhe godinat, si edhe për të integruar ato zona në zhvillimin territorial dhe infrastrukturor të vendit, duke përmirësuar kushtet e tyre të jetesës; dhe iv. përcaktuar procedurat për rregullimin e këtyre godinave pa leje.

111. Nëse sipërfaqja e truallit në të cilin ishte ndërtuar objekti pa leje do të ishte i regjistruar në ZRPP, nën emrin e (ish-) pronarit të tokës (i cili nuk zotëronte godinën e ndërtuar pa leje), (ish-) pronarit të tokës do t'i jepej kompensim për sipërfaqen e tokës së ndërtimit, e cila prekej nga ndërtimi i paautorizuar, shuma e të cilit do të miratohej me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave (neni 15/1). Për të përlogaritur shumën e kompensimit, sipërfaqja e tokës do të klasifikohet si truall dhe çmimi i pronës do të përcaktohej sipas një vendimi të Këshillit të Ministrave.

112. Ligji për legalizimin krijoi Agjencinë për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve/Zonave Informale, e cila është zëvendësuar nga Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, sipas ligjit për kadastrën (ligji nr. 111/2018), i cili hyri në fuqi më 21 mars 2019.

2. Ligji për Gjykatën Kushtetuese

113. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577, i datës 10 shkurt 2000, për organizimin dhe funksionin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë) u ndryshua me anë të ligjit nr. 99/2016, i cili u publikua në Fletoren Zyrtare, më 8 nëntor 2016. Dispozitat e parashikuara më poshtë hynë në fuqi më 23 nëntor 2016.

114. Gjykata Kushtetuese përbëhet nga nëntë gjyqtarë. Sipas nenit 32, të ndryshuar, Gjykata Kushtetuese, kuorumi i së cilës nuk mund të jetë më pak se dy të tretat e të gjithë gjyqtarëve, shqyrton ankesat në një seancë plenare të ndjekur nga të gjithë gjyqtarët.

115. Sipas nenit të ri 73§4, nëse Gjykata Kushtetuese nuk mund të arrijë një shumicë prej pesë votash, ankesa kushtetuese konsiderohet e rrëzuar.

3. Ligji për gjykatat kushtetuese (ligji nr. 49, i datës 16 maj 2012, i ndryshuar, për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative)

116. Neni 18§2, i ligjit për gjykatat administrative, parashikon se afati për paraqitjen e një veprimi në gjykatën administrative ndaj një vendimi administrativ, në rast se vendimi administrativ nuk e parashikon qartë një afat të tillë kohor, është një vit nga data e njoftimit ose publikimit të tij.

4. Kodi i Procedurës Civile

117. Më 30 mars 2017, Kuvendi miratoi një sërë ndryshimesh në Kodin e Procedurës Civile (ligji nr. 38/2017), të cilat hynë në fuqi më 5 nëntor 2017 (gjashtë muaj pas publikimit të tyre në Fletoren Zyrtare, më 5 maj 2019). Nenet përkatëse, të cilat kanë të bëjnë me ekzekutimin e procedimeve parashikojnë si më poshtë:

“KREU X

GJYKIMI I KËRKESAVE PËR KONSTATIMIN E SHKELJES SË AFATIT TË ARSYESHËM, PËRSHPEJTIMIT E PROCEDURAVE DHE SHPËRBLIMIN E DËMIT

Neni 399/1

Objekti

1. Në kompetencë të gjykatave, sipas shkallëve të gjykimit të përcaktuar në këtë krye, hynë edhe shqyrtimi i kërkesave për shpërblimin e drejtë të personit që ka pësuar një dëm pasuror ose jopasuror, për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes, sipas përkufizimit të nenit 6/1 të Konventës Europiane, “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.

2. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë vlerësimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procesit, si edhe shpërblimin e drejtë, kur konstatohet kohëzgjatje e paarsyeshme në procedurat e hetimit, gjykimit të çështjeve, si edhe në procedurat e ekzekutimit të vendimeve.

Neni 399/2

Afati i arsyeshëm

Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

...

c) në procedurën e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, me përjashtim të detyrimeve

periodike ose të përcaktuara në kohë, afati njëvjeçar fillon nga dita e paraqitjes së kërkesës për vënie në ekzekutim;

...

Neni 399/3

Shpërblimi i drejtë

1. Shpërblimi i drejtë për shkeljen e afatit të arsyeshëm do të konsiderohet njohja e shkeljes, çdo masë e marrë për të përshpejtuar procedurat e hetimit, gjykimin të çështjes dhe të ekzekutimit të vendimit dhe/ose shpërblimin e dëmit, sipas përcaktimeve të këtij kreu.

Neni 399/6

Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës ose të kërkesëpadsisë

Kërkesa për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave i drejtohet gjykatës kompetente, sipas llojit të mosmarrëveshjes penale, civile ose administrative si më poshtë:

...

ç) në rastet kur çështja, në të cilën pretendohet të ketë shkelje, është në procedurë ekzekutimi, kërkesa gjykohet nga gjykata e shkallës së parë, kompetente për ekzekutimin, sipas rregullave në fuqi.

Neni 399/10

Përmbajtja e vendimit për shpërblimin e dëmit

1. Pas shqyrtimit të kërkesëpadsisë gjykata vendos shpërblimin e dëmit nga 50 000 lekë [400 euro] deri në 100 000 lekë [800 euro], për çdo vit ose muaj, në raport me vitin, përtej afatit të arsyeshëm [parashikuar në nenin 399/2].

2. Shpërblimi i dëmit bëhet duke mbajtur parasysh:

a) vështirësinë e procesit, në të cilin është verifikuar shkelja;

b) sjelljen e trupit gjykues ose të përmbartës dhe të palëve;

c) natyrën e interesave në çështje;

ç) vlerën dhe rëndësinë e çështjes në lidhje me objektin e mosmarrëveshjes ose ekzekutimit, e vlerësuar edhe në raport me kushtet personale të palëve.

...”

III. MATERIALET RESPEKTIVE TË KËSHILLIT TË EVROPËS

A. Materiale nga Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve

118. Më 2 qershor 2015, Departamenti për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut përgatiti një raport për një projektligj për pronën 2015, të cilin autoritetet e paraqitën për komente më 1 prill dhe 18 maj 2015 (H/Exec(2015)16). Duke qenë se projektligji mbështetej në miratimin e legjislacionit dytësor për zbatimin e tij, raporti theksonte se ai nuk duhej të dëmtonte parimin e sigurisë ligjore. Projektligji parashikonte mundësinë e ish-pronarëve për të paraqitur kërkesa të reja për pronën, të cilat mund të ndikojnë në faturën përfundimtare financiare dhe autoritetet ftoheshin të shpjegojnë arsyet pas një propozimi të tillë. Raporti parashikonte miratimin e vendimeve të mbivendosura ose konfliktuale, të cilat në fund mund të përfundonin në procedime gjyqësore, ndikimi i të cilave nuk ishte vlerësuar. Ai rekomandonte se procedurat e pajtueshmërisë nuk duhej të ishin konsumuese në kohë dhe kërkesat për dokumentacion nuk duhej ta vështirësonin procedurën në mënyrë të panevojshme. Duke qenë se autoritetet ishin të mendimit se duhej të ndërtohej një organ i ri, ishte i nevojshëm një arsyetim bindës për zgjedhjen e tyre. Autoritetet u ftuan të bënin një identifikim shumë më të qartë të arsytimit, të justifikimeve për formulën e propozuar të kompensimit, si edhe për afatet e propozuara në projektligj. Raporti ngrinte shqetësime në lidhje me fizibilitetin e respektimit të afateve të parashikuara në projektligj, në rast se nuk do të garantohej një përmirësim i ndjeshëm në burimet e personelit për organin e ri dhe për gjykatat, të cilat mund të priten të trajtojnë një rritje në ngarkesën e tyre të punës me marrjen e apelimeve. Metoda e shpërndarjes së informacioneve relevante dhe vendimeve për paditësit dhe publikun nuk shpjegoheshin me detaje të mjaftueshme. Raporti nënvizonte se në tetor 2014, ishin organizuar dy raunde konsultimesh paraprake me subjektet dhe grupet e interesit për rezultatin e analizës së legjislacionit dhe propozimeve për ndryshime. Ai i inkurajonte autoritetet të vijonin me

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

zhvillimin e konsultimeve publike për të fituar mbështetjen e publikut dhe të paditësve për çdo qasje që në fund do të miratohej.

119. Me miratimin e ligjit për pronën të vitit 2015, Komiteti i Ministrave, në takimin e tij të 1243-të, më 8 dhe 9 dhjetor 2015, miratoi një vendim (CM/Del/Dec (2015)1243/H46-1), në të cilin ai njihnte miratimin e ligjit të pronësisë vitit 2015, dhe ftonte autoritetet të ofronin informacion për zbatimin e vendimeve, të cilat ato planifikonin t'i prezantonin, hartat e vlerësimit të cilat do të përdorreshin si bazë për përllogaritjen e kompensimit dhe një plan veprimi të përditësuar.

120. Më 23 shkurt 2016, agjenti i Qeverisë informoi Komitetin e Ministrave për hyrjen në fuqi të ligjit për pronën 2015 dhe zbatimin e vendimeve që Qeveria synonte të miratonte, me qëllimin për të zbatuar ligjin e pronës 2015 (DH-DD(2016)196). Qeveria pohoi, midis të tjerash, se: i. 23,000 hektarë tokë bujqësore dhe 71,699 hektarë pyje dhe kullota ishin transferuar në fondin e tokës; ii. ATP-ja do të kryente vlerësimin financiar për 26,000 vendime të formës së prerë dhe do të shqyrtonte pretendimet për pronën për 10,131 kërkesa të mbetura pezull; dhe iii. kapaciteti i ATP-së do të përforcohej me 59 punonjës të tjerë, gjë e cila do ta çonte kapacitetin, në një total prej 150 punonjësish. Në një shënim informativ, në lidhje me miratimin e hartës për vlerësimin e tokës, i cili i ishte bashkëlidhur komunikimit, Qeveria nënvizonte, se: “harta e vlerësimit të tokës dhe metodologjia për miratimin e saj nuk ka të bëjë vetëm me procesin e kompensimit të ish-pronarëve, por është miratuar për t'u përdorur në çdo transaksion që institucionet qeveritare do të kryejnë në lidhje me pronën, për shembull: shpronësimi, blerja, shitja, procesi i legalizimit etj., me pronat shtetërore”.

121. Më 15 prill 2016, agjenti i Qeverisë i vuri në dispozicion Komitetit të Ministrave një kopje të vendimeve të zbatueshme, të cilat Qeveria i kishte miratuar në zbatim të ligjit për pronën 2015.

122. Më 9 maj 2016, agjenti i Qeverisë, në përgjigje të komunikimit dërguar nga një shoqatë e ish-pronarëve, informoi Komitetin e Ministrave, midis të tjerash, se ata kishin organizuar evente të konsultimit publik, të cilat ishin ndjekur nga përfaqësues të shoqatave të ish-pronarëve (DH-DD(2016)592).

123. Në mbledhjen e saj të 1259-të, më 7 dhe 8 qershor 2016, Komiteti i Ministrave miratoi një vendim (CM/Del/Dec(2016)1259/H46-1), me anë të së cilit ai mirëpriste miratimin e vendimeve të zbatueshme dhe ftonte autoritetet të vinin në dispozicion informacione për zbatimin e ligjit për pronën 2015 dhe vendimet zbatuese.

124. Më 12 korrik 2017, Qeveria i vuri në dispozicion Komitetit të Ministrave, midis së tjerash, informacionet e mëposhtme statistikore (DH-DD(2017)807):

- i. Fuqia punëtore në total e ATP-së do të rritje me 169 punonjës;
- ii. 2 miliardë lekë (në vend të 3 miliardë lekëve, sipas parashikimit në ligjin për pronën 2015 – të barasvlershme me 16 milionë euro) i ishin alokuar fondit financiar në vitin 2016;
- iii. 1.8 miliardë lekë (në vend të 3.33 miliardë lekëve, sipas parashikimit në ligjin për pronën 2015 – të barasvlershme me 14.4 milionë euro) i ishin alokuar fondit financiar në vitin 2017;
- iv. 23,368.8 hektarë tokë bujqësore, në vlerën prej 37 miliardë lekësh (296 milionë euro) ishin identifikuar dhe transferuar në fondin e tokës;
- v. 50,989.76 hektarë tokë pyjore dhe kullotash, të vlerësuara në shumën prej 60 miliardë lekësh (480.1 milionë euro) ishin identifikuar dhe transferuar në Fondin e Tokës;
- vi. 160 objekte shtetërore, në vlerën 2.155 miliardë lekë (17.2 euro) ishin identifikuar dhe transferuar në fondin e tokës;
- vii. 5,700 pretendime të reja për pronat ishin dorëzuar në ATP për shqyrtim;
- viii. 10,763 vendime, të cilat ishin dhënë në periudhën 1993–1995, i ishin nënshtruar vlerësimit financiar, vlerësuar në shumën në total prej 34.2 miliardë lekësh (274.3 milionë euro); 24 vendime ishin apeluar në Gjykatën Administrative të Apelit;
- ix. 312.8 hektarë tokë bujqësore, me vlerën prej 640.1 milionë lekësh (5.1 milionë euro) ishin akorduar si kompensim në natyrë;

Vëllimi III, 2020-2021

x. 343 vendime ishin ekzekutuar plotësisht, duke arritur një shumë në total prej 3.4 miliardë lekësh (27.4 milionë euro), përveç 493 vendimeve përfituesit e të cilave vlerësoheshin të ishin kompensuar si rezultat i rikthimit të mëparshëm dhe të pjesshëm të pronës në natyrë;

xi. 4 kërkesa kishin përfituar nga procedura e kompensimit të përshpejtuar; dhe

xii. 2,230 paditës ishin kompensuar në shumën në total prej 1.9 miliardë lekësh (15.3 milionë euro) për pronat e zëna nga godinat e ndërtuara pa leje.

125. Në mbledhjen e tij të 1294-t, më 19 dhe 21 shtator 2017, Komiteti i Ministrave miratoi një vendim (CM/Del/Dec(2017)1294/H46-1), me anë të të cilit ai iu referua vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe angazhimit të autoriteteve për të vlerësuar situatën dhe për të marrë masat e duhura për të parandaluar çfarëdo ndikimi negativ, dhe ftoi autoritetet të vinin në dispozicion burimet për të përfunduar procesin e kompensimit, brenda kuadrit kohor të përcaktuar, si edhe për të ofruar informacione të përditësuara.

126. Më 27 dhjetor 2017, agjenti i Qeverisë informoi Komitetin e Ministrave se në vijim të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, ministri i Drejtësisë kishte ngritur një grup pune, i cili ishte ngarkuar me detyrën për të bërë propozime për çdo ndryshim legjislativ (DH-DD(2018)64). Qeveria kishte arritur në përfundimin se nuk kishte nevojë të ndryshonte ligjin për pronat 2015, duke qenë se shfuqizimi i dy dispozitave nga Gjykata Kushtetuese nuk kishte ndikuar materialisht formulën e kompensimit. Në vend të kësaj, Qeveria kishte vendosur të bënte ndryshime në vendimet zbatuese për të sqaruar procedurën për vlerësimin financiar dhe për të unifikuar procedurën e vendimmarrjes, në lidhje me pretendimet në shqyrtim. Qeveria vuri në dispozicion informacionet e mëposhtme statistikore:

i. fuqia punëtore e ATP-së ishte rritur në 118 punëtorë;

ii. 380 vendime ishin ekzekutuar plotësisht, duke arritur në një shumë në total prej 3.76 miliardë lekësh (30.1 milionë euro);

iii. 16 kërkesa kishin përfituar nga procedura e kompensimit të përshpejtuar, duke arritur një shumë në total prej 70,733,017 lekësh (566,012 euro);

iv. 10,909 vendime, të dhëna në periudhën 1993–1995, i ishin nënshtruar vlerësimit financiar;

v. 2,529 vendime ishin dhënë për pretendimet e reja për pronën; dhe

vi. dokumente shtesë ishin kërkuar për 9,000 kërkesa të pashqyrtuara.

127. Në komunikimet e saj me Komitetin e Ministrave (*shih dokumentin DH-DD(2018)592, të datës 11 qershor 2018, ndryshuar me dokumentin DH-DD(2018)793, të datës 24 gusht 2018*), Qeveria, teksa përsëriste arsyet për procedimin me ndryshimet për vendimet zbatuese, vuri në dispozicion informacionet e mëposhtme statistikore:

i. Fuqia punëtore e ATP-së ishte rritur me 169 punonjës;

ii. Fondi financiar ishte plotësuar për çdo vit siç tregohet më poshtë:

Fondi financiar	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018
Buxheti i shtetit	2.00	1.80	2.50
Produkte të përfutuara nga transferimi i pronësisë së parcelave për ndërtim, sipas ligjit nr. 9482, i datës 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve të paligjshme", të ndryshuar	1.60	2.00	1.50
Totali, miliardë/lekë	3.60	3.80	4.00

iii. 18,029 vendime, të dhëna në periudhën midis viteve 1993 dhe 1998, i ishin nënshtruar vlerësimit financiar, duke arritur një total prej 75.5 miliardë lekësh (604.6 milionë euro); 235 vendime ishin apeluar ndaj Gjykatës Administrative të Apelit;

iv. 424 vendime ishin ekzekutuar plotësisht, duke arritur në një total prej 4 miliardë lekësh (32.6 milionë euro);

v. 323,4 hektarë nga fondi i tokës, me një vlerë në 663.2 milionë lekë (5.3 milionë euro) ishin akorduar si kompensim në natyrë;

vi. 16,462 pretendime të reja për pronat ishin paraqitur në ATP për shqyrtim;

vii. 5,174 vendime ishin dhënë për pretendimet e reja ndaj pronave, dhe 163 vendime ishin apeluar në gjykatën e apeli; dhe

viii. 11,288 pretendime ishin pezull për shqyrtim.

128. Në mbledhjen e tij të 1324-t mbajtur më 18 deri më 20 shtator 2018, Komiteti i Ministrave miratoi një rezolutë (CM/RESDH(2018)349) në të cilën vendosi të mbyllte shqyrtimin e vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, pasi ishte siguruar se ishin miratuar të gjitha masat e kërkuara nga neni 46§1 i Konventës.

B. Raporti i vlerësimit nga Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të parave dhe Financimit të Terrorizmit (MONEYVAL)

129. Në raportin e tij të vlerësimit të raundit të pestë për Shqipërinë, i cili u publikua në korrik 2018, pas një vizite në vend nga data 1 deri më 14 tetor 2017, MONEYVAL, për sa kishte të bënte me transaksionet e pronave të paluajtshme, vërejtë si më poshtë: “5. (...) Profesionit të noterit historikisht konsiderohej si shumë vulnerabil, për shkak të përfshirjes në transaksionet e pasurive të paluajtshme, por ndërgjegjësimi ndaj rrezikut dhe zbutja e tij janë përmirësuar ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Në vijim të kontroleve të shtuara në transaksionet e pronave të paluajtshme, në ditë e sotme rreziqet më të larta konsiderohen të jenë të pranishme në transaksionet ku noterët dhe agjentët e pronave të paluajtshme nuk përfshihen (transaksionet informale).

...

12. (...) Përdorimi i parave në dorë është kufizuar kur bëhet tregti me mallra dhe është i ndaluar për transaksionet e pronave të paluajtshme. [Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave], Ministria e Drejtësisë (MD) dhe Dhoma Kombëtare e Noterëve (DHKN) kanë koordinuar përpjekjet për të rritur sensibilizimin ndaj rreziqeve midis noterëve, të cilët kanë një rol kyç në transaksionet e pasurive të paluajtshme.

...

25. Noterët e kanë pranuar rolin e tyre të rëndësishmi prej kontrollori në transaksionet e pronave të paluajtshme dhe kanë treguar ndërgjegjësim për rrezikun [e pastrimit të parave - PP]. Zbatimi nga ana e tyre i detyrimeve [kundër pastrimit të parave/lufta ndaj financimit të terrorizmit – KPP/LFT], duke përfshirë identifikimin e [pronarit përfitues], identifikimi dhe paraqitja e [raporteve për transaksionet dyshues] janë përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit.

...

60. Noterët luajnë një rol kyç në regjimin parandalues të KPP/LFT për sektorin e pasurisë së paluajtshme. Legjislacioni detyron që çdo transaksion i pronës së paluajtshme duhet të kalojë nëpërmjet noterit. Noterët janë të licencuar dhe mbikëqyren nga MD-ja dhe funksionojnë nën DHKN-në.

401. Ndërgjegjësimi i noterëve për kërcënimet e PP-së ndaj rolit të tyre kontrollues në sistemin ekonomik është i duhuri. Mbikëqyrësit kanë realizuar trajnime të rëndësishme sensibilizimi në vitet e fundit ..., të cilat kanë çuar në një mirëkuptim midis noterëve të tipologjive të PP-së në sektorin e pronave të paluajtshme, si edhe në nevojën për të ushtruar kontrole. Legjislacioni detyron çdo transaksion të pronave të paluajtshme të kalojë nëpërmjet noterit. Që prej vitit 2014, ndalohet të përdoren para në dorë për transaksionet e pronave të paluajtshme dhe noterët janë ushtuar nga autoritetet të sigurohen që të përdoren gjithmonë llogaritë bankare. Noterët ofruan shembuj për mënyrën se si ata krahasojnë vlerën e kontratës me çmimin e referencës së tregut për të gjitha transaksionet e pronave të paluajtshme për t'u përpjekur të parandalojnë shkëmbimin e parave në dorë jashtë llogarisë nën kujdestarinë noteriale në bankë.

420. Noterët demonstrojnë dije të mira, në lidhje me kërkesat, detyrimet në përgjithësi [për kujdesin e duhur ndaj klientit]. (...) Noterët kërkojnë burime fondesh për transaksionet, edhe pse ata në përgjithësi konstatuan se bankat shkojnë edhe më tej në të tilla kontrole krahasuar me ta. Bankat marrin udhëzime për procedurat që duhen ndjekur për transaksionet në llogaritë nën kujdestarinë noteriale dhe do të kërkojnë dokumentacionin ligjor si mbështetje përpara se të transmetohen fondet.

Në transaksionet e pronave të paluajtshme, ky dokumentacion do të ishte kontrata e shitblerjes dhe certifikata e pronësisë. Depozitimet në para në dorë në llogaritë noteriale ndalohen dhe bankat konfirmuan se ato pyesin për burimin e fondeve të transferuara në llogarinë nën kujdesin noterial.”

ANKESAT

130. Kërkuesit, duke iu referuar nenit 6§1 dhe nenit 13 të Konventës, si edhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, u ankuan për mosakordimin nga Qeveria e kompensimit për ta, sipas vendimeve të brendshme të formës së prerë.

LIGJI

I. BASHKIMI I KËRKESAVE

131. Sipas rregullit 42§1 të Rregullores së Gjykatës dhe duke marrë në konsideratë faktin se kërkesat aktuale vinin prej së njëjtës shkelje sistematike të Konventës, sipas konstatimit në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, Gjykata e gjykon me vend t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

II. ANKESAT SIPAS NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 DHE NENIT 13 TË KONVENTËS

132. Kërkuesit u ankuan se ishte shkelur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak të mosakordimit nga autoritetet të kompensimit të tyre dhe një shkelje e nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e mjetit efikas për të drejtën e tyre për të marrë kompensim.

133. Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

A. Parashtrimet e palëve

1. Në lidhje me prezantimin dhe efikasitetin e mjetit të ri

a) Qeveria

134. Qeveria parashitroi se në zbatim të vendimit pilot, Parlamenti kishte miratuar ligjin për pronat 2015, i cili parashikonte një mjet të përshtatshëm dhe të aksesueshëm të brendshëm për t’u shteruar nga kërkuesit. Sipas këtij mjeti të ri, Qeveria i kërkoi Gjykatës të përjashtonte të gjitha kërkesat nga lista e çështjeve. Ligji për pronat 2015 ishte miratuar pas konsultimeve publike të organizuara në vitin 2014 dhe 2015, me partnerët dhe grupet e interesit. Ai parashikonte afatet detyruese dhe realiste, pasi ishte bërë një testim pilot në Tiranë. Fuqia punëtore e ATP-së ishte zgjeruar dhe u ishte nënshtruar trajnimeve për të ngritur kapacitete në trajtimin e pretendimeve për pronat dhe kompensimet.

135. Përpara miratimit të ligjit për pronat 2015, autoritetet kishin realizuar një vlerësim të detajuar të kuadrit ligjor që rregullonte rikthimin dhe kompensimin e pronave dhe arritën në përfundimin se legjislacioni i brendshëm në fuqi në atë kohë nuk kishte parashikuar një skenë të formës së prerë për përcaktimin e shumës së kompensimit, e cila duhej të akordohej sipas vendimeve të formës së prerë që njihnin të drejtën për kompensim. Këto autoritete kishin identifikuar një total prej 26,357 vendimesh të formës së prerë të paekzekutuara (shumica pa kuant), të cilat njihnin të drejtën për kompensim. Si rezultat i këtyre gjetjeve, ato kishin prezantuar një metodologji kompensimi, e cila do të zgjidhte përgjithmonë përcaktimin dhe pagesën e kompensimit.

136. Kompensimi do të akordohej sipas hartave të vlerësimit të pronës, të cilat ishin përgatitur në përputhje me standardet ndërkombëtare për vlerësimin e pronave. Ato ishin përditësuar me anë të një reference në vlerën kadastrale në ZRPP. Hartat e vlerësimit të pronave referoheshin për qëllime të

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

tjera, të tilla si përlogaritja e kompensimit në rastin e shpronësimit, si edhe procesi i akordimit të kompensimit në rastin e rregullimit të ndërtesave pa leje.

137. Qeveria parashtrroi se kërkuessit, duke mos marrë pjesë në procedimet kushtetuese, nuk mund të pretendonin të ishin “viktima”, sipas interpretimit të nenit 7 të ligjit për pronat 2015. Në çdo rast, vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte qenë në koherencë me nenin 74§4, të ligjit për Gjykatën Kushtetuese.

138. Pasi Gjykata Kushtetuese shfuqizoi nenet 6§§3 dhe 5 të ligjit për pronat 2015, Qeveria nuk e kishte konsideruar si të nevojshme ose të përshtatshme të bënte ndryshime statutore. Në vend të kësaj, ajo kishte vendosur të ndryshonte vendimet zbatuese të miratuara me ekzekutimin e ligjit për pronat 2015, duke shpjeguar procedurën për vlerësimin dhe kompensimin e pronave dhe unifikimin e procedurës vendimmarrëse, në lidhje me kërkesat e mbetura pezull.

139. Në vijim, Qeveria parashtrroi se burime të rëndësishme nga buxheti i shtetit i ishin alokuar për çdo vit fondit financiar; në vitin 2016, 3.6 miliardë lekë (28,823,000 euro); në vitin 2017, 3.8 miliardë lekë (30,424,300 euro); dhe në vitin 2018, 4 miliardë lekë (32,025,600 euro). Fondi i Tokës përbëhej nga tri kategori kryesore: 23,368.8 hektarë tokë bujqësor, e vlerësuar të kishte vlerën 37 miliardë lekë (296,237,000 euro); 160 godina shtetërore, me një vlerë prej 2 miliardë lekësh (16,012,800 euro); dhe 50,989.76 hektarë tokë pyjore dhe kullota, me një vlerë prej 60 miliardë lekësh (480,384,000 euro).

140. ATP-ja kishte proceduar me vlerësimin financiar të vendimeve që njihnin të drejtën për kompensim në një rend kronologjik, duke filluar nga vendimet më të hershme dhënë në vitin 1993, rezultati i të cilave ishte publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

141. Më 4 mars 2019, Qeveria ofroi informacionin e mëposhtëm statistikor si rezultat i funksionimit të ligjit për pronat 2015.

i. ATP-ja kishte kryer vlerësimin financiar për 25,314 vendime, si rezultat i të cilave: ishte vendosur se shumica në total e kompensimit për t'u akorduar ishte 96,495,445,182 lekë (afërsisht 772,580,000 lekë) për 22,428 vendime ishte konstatuar, se për rikthimin paraprak dhe të pjesshëm të pronës në natyrë, ish-pronarët gjykoreshin të ishin kompensuar për 2,368 vendime; dhe ishte njohur e drejta e ish-pronarëve për parablerje për 518 vendime.

ii. Nga data e hyrjes në fuqi deri më 20 dhjetor 2017, kompensimi financiar në total 3,890,078,214 lekë (31,145,500 euro) dhe kompensimi në natyrë në një total prej 323.3 hektarësh ishin dhënë për 396 vendime, të cilat konsideroreshin të ishin zbatuar plotësisht.

iii. Pas ndryshimeve në VKM-në 223/2016, më 20 dhjetor 2017, kompensimi financiar në një total prej 1,536,663,923 lekësh (12,303,153 euro) dhe kompensimi në natyrë në një total prej 57 hektarësh ishin dhënë për 104 vendime, të cilat konsideroreshin të ishin ekzekutuar plotësisht.

iv. Në vitin 2018, 355 padi ishin paraqitur në gjykatat vendëse ndaj vendimeve të ATP-së, në lidhje me përcaktimin e vlerësimit financiar, nga të cilat 124 ishin rrëzuar, kthyer ose ndërprerë, 26 ishin pranuar, 47 ishin deklaruar të papajtueshme dhe 158 ishin pezull përpara gjykatave vendëse.

v. Nga një total prej 16,462 kërkesave të reja për njohjen e të drejtave të pronës, ATP-ja kishte shqyrtuar 9,512 kërkesa deri më 23 shkurt 2019 (*shih paragrafin 44 më sipër*). Pjesa e mbetur e 6,950 kërkesave do të shqyrtohej, sipas kërkesës së një ish-pronari, nga gjykata e shkallës së parë, në përputhje me nenin 34, të ligjit për pronat 2015 (*shih paragrafin 44 më sipër*). Më 23 shkurt 2019, Agjencia nxori një njoftim publik ku informonte ish-pronarët se ata mund të merrnin të gjitha dokumentet e dorëzuar në Agjenci, nëse dëshironin të paraqisnin një padi civile në gjykatën e shkallës së parë.

b) Kërkuessit

142. Fillimisht kërkuessit argumentuan se nuk duhej të pritej që ata të shteronin një mjet të cilin autoritetet e kishin paraqitur shumë vite pasi ata kishin paraqitur kërkesat e tyre në gjykatë.

143. Ata parashtruan se zbatimi retroaktiv i ligjit për pronat 2015 kishte shkaktuar një shkelje të parimit të sigurisë ligjore në tri aspekte. Së pari, ligji për pronat 2015 i njihte të drejtën për kompensim vetëm ish-pronarëve, një formë prej së cilës kishte të bënte me rikthimin në natyrë; legjislacioni i mëparshëm njihte të drejtën për rikthim të pronës së shpronësuar ose konfiskuar të ish-pronarëve dhe

të drejtën për kompensim, në vend të tyre. Së dyti, Gjykata Kushtetuese e kishte deklaruar nenin 6§3, të ligjit për pronën 2015 si jokushtetues. Megjithatë, Qeveria kishte rivendosur një dispozitë të ngjashme në VKM-në nr. 766/2017 (*shih paragrafin 94 më sipër*). Së treti, dhe çfarë është më e rëndësishmja, ligji për pronën 2015 i jepte të drejtën ATP-së së rishqyrtonte vendimet e formës së prerë për pronën, të cilat ishin bërë *res judicata*, duke përcaktuar shumën financiare që do të jepej si kompensim. Sipas ligjit për pronat 2015, kërkuessit do të merrnin kompensim të barasvlershëm me vlerën e tregut për pronat, ndërsa shuma e kompensimit sipas ligjit për pronat 2015 do të përllogaritej, duke iu referuar kategorisë kadastrale të pronës në kohën e shpronësimit.

144. Kërkuessit nënvizuan se zbatimi i skemës së kompensimit, të parashikuar në ligjin për pronën 2015, do të rezultonte në shuma kompensimi jashtëzakonisht të ulëta, të cilat mund të ishin njëqind herë më pak sesa shumat që do të kishin marrë në zbatim të ligjit për pronat 2004, ose disa kërkuess do të vlerësoheshin se ishin kompensuar plotësisht në mbështetje të faktit se vlera e tokës, e cila ishte rikthyer më herët në natyrë, do të tejkalonte shumën në total të kompensimit për të cilën atyre do t'u njihet e drejta. Kërkuessit ritheksuan se kjo Gjykatë tashmë kishte vendosur se kompensimi i drejtë duhej të jepej në bazë të kategorisë kadastrale në kohën e miratimit të vendimit të brendshëm, në vend të kategorisë kadastrale në kohën e shpronësimit.

145. Kërkuessit argumentuan se zbatimi i skemës së kompensimit do të shkaktonte diskriminim në krahasim me ata kërkuess të cilët tashmë ishin kompensuar me anë të vendimeve të mëparshme të kësaj Gjykate për të njëjtën pronë. Sipas këndvështrimit të tyre, Gjykata duhej të vijonte të zbatonte metodologjinë e përllogaritjes, të parashikuar në vendimin *Vrioni dhe të tjerët*. Në vijim, ata theksuan se vendimi i autoriteteve, për të ulur dhe për të përmbyllur tavanin e kompensimit financiar nga 50 milionë lekë (403,673 euro) në 10 milionë lekë (81,100 euro), kishte shkaktuar trajtim të pabarabartë për ish-pronarët.

146. Sipas kërkuessve, ligji për pronat 2015 parashikonte një hierarki formash kompensimi, kompensim financiar, i cili mbizotëronte ndaj formave të tjera të kompensimit. Me këtë në konsideratë, fondi për kompensimin financiar, i cili nuk merrte në konsideratë pretendimet ndaj pronës të mbetura pezull dhe rezultatin prej tyre, nuk ishte përcaktuar mbi bazën e të dhënave të plota dhe të sakta, dhe burimet që i alokoheshin atij ishin të pamjaftueshme. Kërkuessit parashtruan se ata nuk mund të kundërshtonin kompensimin financiar i cili jepej nga autoritetet. Kërkuessit, të cilët dëshironin të merrnin kompensim të përsheptuar, duhej të nënshkruanin një formular duke hequr dorë nga të gjitha ankesat që kishin paraqitur në të shkuarën ose mund të paraqisnin në të ardhmen. Në vijim, ata argumentuan se kompensimi në natyrë nuk ishte efikas, duke qenë se autoritetet nuk kishin një rekurs për të. Ata parashtruan se Qeveria kishte transferuar më shumë se 18,000 hektarë tokë për Ministrinë e Bujqësisë, në vend që t'i përdorte ato si kompensim në natyrë. Gjithashtu, në disa raste, autoritetet kishin dhënë me qira tokë dhe asete të tjera për palë të treta, për një çmim simbolik prej 1 eurosh për metër katror, në vend që t'i përdornin si kompensim në natyrë.

147. Kërkuessit parashtruan se hartat e vlerësimit të pronës 2016, të cilat autoritetet i përdornin me qëllimin për të përcaktuar vlerësimin financiar, nuk reflektonin vlerën e tregut të tokës, veçanërisht në qytetet ku çmimet ishin të larta, të tilla si kryeqyteti, Tirana. Duke iu referuar vendimit të Qeverisë (nr. 655, i datës 22 korrik 2015), ata theksuan se Qeveria përdori harta të ndryshme për vlerësimin e pronës, kur akordoi kompensim për shpronësimet e reja.

148. Në vijim, kërkuessit parashtruan se VKM-ja nr. 685/2016 kishte vendosur mbi ta barrën për të dorëzuar deklarata të noterizuara për dokumente të cilat ekzistonin fizikisht në arkivat e institucioneve shtetërore. Një kërkesë e tillë, së bashku me kostot që passillte lëshimi i një akti të noterizuar, përbënin një pengesë kundrejt tyre për të realizuar thelbin e së drejtës së tyre.

149. Kërkuessit argumentuan se për sa i përket *backlog*-ut të çështjeve të mbetura pezull përpara Gjykatës Administrative të Apelit, çdo apel ndaj shumës së kompensimit do të merrte një kohë paarsyeshmërisht të gjatë për t'u shqyrtuar. Ligji për pronat 2015 i privonte ata nga e drejta për të apeluar ndaj vendimeve të tilla gjyqësore në një gjykatë më të lartë.

150. Në lidhje me konsultimin publik me grupet e interesit, ata pretendojnë se shoqatat e ish-

pronarëve nuk ishin lejuar të shprehnin opinionin e tyre gjatë konsultimeve publike të organizuara nga Qeveria.

2. Në lidhje me kërkesat individuale

a) Qeveria

151. Më 4 mars 2019, Qeveria parashtrroi informacione të përditësuara për secilën kërkesë.

152. Në lidhje me kërkesën 29026/06, Qeveria parashtrroi se ATP-ja nuk mund të kryente vlerësimin financiar të vendimit të parë të Komisionit për shkak të mungesës së dokumenteve, të cilët kërkuarit nuk i kishin paraqitur brenda afatit statutor pas publikimit të vendimit të ATP-së dhe të cilët kërkuarshin për të përcaktuar vendndodhjen e pronës, për të cilën kërkuarshin do të kompensoheshin. Në të tilla rrethana, kërkuarshin mundësinë e hapur të dorëzonin një padi, sipas nenit 15§2 të ligjit për pronat 2015, në Gjykatën Administrative të Apelit të Shkallës së Parë, ku kërkohej vlerësimi financiar i atij vendimi. Në lidhje me vendimin e dytë të Komisionit, ATP-ja kishte vendosur vlerësimin financiar dhe kërkuarshin nuk kishin bërë kërkesë për pagesën e kompensimit.

153. Në lidhje me kërkesën nr. 3165/08, Qeveria parashtrroi se kërkuarshin konsideroheshin se ishin kompensuar, sepse vlera e vlerësuar e sipërfaqes së tokës të rikthyer më herët ishte më e lartë sesa vlerësimi financiar i sipërfaqes së tokës, për të cilën do të kompensoheshin kërkuarshin. Vendimi i ATP-së, i cili ishte publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, më 12 mars 2018, ishte bërë i formës së prerë më 12 prill 2018, në përputhje me nenin 16§5 të ligjit për pronat 2015, dhe ndaj tij nuk ishte dorëzuar asnjë apelim.

154. Në lidhje me kërkesën nr. 56956/10, Qeveria parashtrroi se ATP-ja kishte kryer vlerësimin financiar të pronës së kërkuarshinve, edhe pse kërkuarshin nuk kishin paraqitur dokumente plotësuese.

155. Në lidhje me kërkesën nr. 29127/11, Qeveria parashtrroi se ajo kishte publikuar një vendim në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, më 8 maj 2017. Duke qenë se kërkuarshin nuk kishin hequr dorë nga e drejta e tyre për parablerje për dy godinat, ATP-ja nuk mund të përcaktonte vlerësimin financiar për godinat (*shih paragrafin 85 më sipër*).

156. Në lidhje me kërkesën nr. 8904/12, Qeveria parashtrroi se ATP-ja kishte vendosur se vlerësimi financiar i të drejtave të kërkuarshinve për kompensim përlllogaritëshin në 13,110,832 lekë (913,170 euro). Vendimi i saj ishte publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, më 8 gusht 2018. Kërkuarshin kishin apeluar ndaj vendimit të ATP-së në Gjykatën Administrative të Apelit, përpara së cilës procedimet ishin ende pezull.

157. Në lidhje me kërkesën nr. 6311/12, Qeveria parashtrroi se në vijim të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, të datës 18 qershor 2018, e cila e kishte kundërshtuar apelimin e kërkuarshinve ndaj vendimit të ATP-së për vlerësimin financiar, apelimi i kasacionit të kërkuarshinve ishte pezull përpara Gjykatës së Lartë, që prej datës 3 gusht 2018.

158. Në lidhje me kërkesën nr. 5915/14, Qeveria parashtrroi se sipërfaqja për të cilën do të kompensoheshin ankuesit mbivendosej me një pronë për të cilën ishte njohur e drejta për kompensim, gjithashtu, për palë të tjera me anë të një vendimi tjetër. Në rrethana të tilla, ATP-ja kishte depozituar para në një llogari bankare, para të cilat do të paguheshin pas zgjidhjes përfundimtare të çështjes në lidhje me mbivendosjen e sipërfaqes së tokës në përputhje me nenin 18, të ligjit për pronën 2015 (*shih paragrafin 62 më sipër*).

159. Në lidhje me kërkesën nr. 53846/14, Qeveria parashtrroi se kërkuarshin, të cilët nuk kishin dorëzuar dokumente plotësuese, do të konsideroheshin se ishin kompensuar.

160. Në lidhje me kërkesën nr. 57152/14, Qeveria parashtrroi se, në vijim të vendimit të ATP-së për vlerësimin financiar dhe kërkesës së kërkuarshinve për t'u kompensuar, vendimi ishte ekzekutuar plotësisht: kërkuarshin kishin marrë 50 milionë lekë nga fondi i kompensimit financiar dhe 12,162 metra katrorë tokë bujqësore, si kompensim në natyrë nga fondi i tokës.

161. Në lidhje me kërkesën nr. 67059/14, Qeveria parashtrroi se vendimi i ATP-së për vlerësimin financiar ishte publikuar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, më 18 dhjetor 2017.

162. Në lidhje me kërkesën nr. 72755/14, më 16 tetor 2019, Qeveria konfirmoi zhvillimet e parashtruara nga kërkuarshin në paragrafin 169 më poshtë.

163. Në lidhje me kërkesën nr. 537/15, Qeveria parashtrroi se ATP-ja nuk kishte përcaktuar ende vlerësimin financiar të së drejtës së kërkuarve për kompensim.

b) Kërkuarve

164. Në lidhje me kërkesat nr. 3165/08, 56956/10, 29127/11, kërkuarve nuk paraqitën parashtrime të përditësuar.

165. Në lidhje me kërkesën nr. 5915/14, kërkuarve e kundërshtuan kërkesën për formulën e re të kompensimit dhe i kërkuarve Gjykatës të mbështetej në raportin e ekspertit që ata e kishin dorëzuar në vitin 2015.

166. Në lidhje me kërkesën nr. 53846/14, kërkuarve parashtruan se në mbështetje të hartave për vlerësimin e pronës 2016, çmimi i referencës për metër katror do të ishte 105 herë më pak sesa çmimi i referencës së deklaruar në hartat e vlerësimit 2014, nga 23,955 lekë (192 euro) për metër katrorë në 230 lekë (2 euro) për metër katrorë.

167. Në lidhje me kërkesën nr. 57152/14, kërkuarve konfirmuan se në rrethanat e nevojës ekstreme, ata kishin marrë kompensim, i cili ishte më i ulët sesa vlera reale e tregut të pronës.

168. Në lidhje me kërkesën nr. 67059/14, kërkuarve parashtrroi se ai kishte dorëzuar një apelim ndaj vendimit të ATP-së për vlerësimin financiar në Gjykatën Administrative të Apelit, përpara së cilës procedimet ishin ende pezull.

169. Në lidhje me kërkesën nr. 72755/14, kërkuarve parashtruan se ata kishin apeluar ndaj vendimit të ATP-së për vlerësim financiar në Gjykatën Administrative të Apelit. ATP-ja kishte vendosur se sipërfaqja e tokës për të cilën kërkuarve do të merrnin kompensim, në kohën e shpronësimit kishte qenë tokë bujqësore. Më 5 prill 2019, Gjykata Administrative e Apelit vendosi se sipas ligjit për pronat 2015, ATP-së i kërkohej të publikonte vlerësimin financiar në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe një ankues kishte të drejtën të apelonte ndaj vendimit të ATP-së brenda tridhjetë ditësh nga një publikim i tillë, ku ATP-ja nuk kishte asnjë detyrim të merrte ndonjë vendim tjetër individual, i cili do të ishte veprues.

Duke marrë një vendim për apelin e ankuesve, gjykata, në vijim të një vlerësimi për provat përpara saj, vendosi se sipërfaqja e tokës prej 103,000 metra katrorësh ishte truell në kohën e shpronësimit. Sipas konstatimeve të saj, Gjykata urdhëroi ATP-në të kryente një vlerësim të ri financiar për sipërfaqen e tokës prej 103,000 metra katrorësh, duke iu referuar si truell. Nuk ka asnjë informacion nëse është paraqitur një apelim pranë seksionit administrativ të Gjykatës së Lartë. Në çdo rast, kërkuarve argumentuan se një apelim para Gjykatës së Lartë do të kërkonte një kohë të gjatë të shqyrtohej meqë ka një vonesë me mbi 30,000 çështje të mbetura pezull për shkak të mosfunksionimit të saj si rezultat i procesit në vijim për rivlerësimin e përkohshëm të gjyqtarëve.

B. Vlerësimi i Gjykatës

1. Fusha e veprimt e çështjes përpara Gjykatës

170. Kërkesat në fjalë, të cilat u dorëzuan nga viti 2006 deri më 2014, kanë të bëjnë me të njëjtat çështje si ato të identifikuar në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, më konkretisht mosekzekutimi nga ana e autoriteteve e vendimeve të formës së prerë që njohin të drejtën e ankuesve për kompensim. Gjykata risjell në vëmendje se vendimi pilot kishte ardhur si përgjigje ndaj rritjes në ngarkesën me çështje të Gjykatës, të shkaktuar nga një sërë çështjesh që vijnë nga i njëjti mosfunksionim strukturor ose sistematik dhe për të siguruar zgjidhje afatgjata për problemet që gjenden në nivel kombëtar.

171. Në lidhje me këtë, qëllimi i vendimit pilot është reduktimi i kërcënimit për funksionimin efikas të sistemit të Konventës dhe për lehtësimin e zgjidhjes më të shpejtë dhe më efektive të një mosfunksionimi, që ndikon në mbrojtjen e të drejtave të Konventës, në një rend ligjor kombëtar, duke sjellë krijimin e një mjeti të brendshëm, i cili do të mund të trajtojë çështje të ngjashme (*shih, për shembull, Rezmiveq dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 61467/12 dhe 3 të tjerë, §§102-5, 25 prill 2017*). Kjo është arsyeja se përse në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, Gjykata e orientoi Qeverinë e paditur të “merrte masa të përgjithshme, me urgjencë, për të siguruar në një mënyrë efektive të drejtën për kompensim”.

172. Në përgjigje të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, autoritetet kanë adaptuar një mjet të ri, sipas parashikimit në ligjin për pronat 2015. Kërkesat në fjalë, të cilat Gjykata nuk i ka deklaruar ende të pranueshme, fillimisht do të shqyrtohen sipas udhëzimit të mjetit të ri. Gjykata është e mendimit se vlerësimi i ankesave në kërkesat aktuale shkon përtej interesave të vetëm të kërkuesve individualë dhe kërkon shqyrtimin e çështjes nga perspektiva e vlerësimit të mjetit të ri, të cilin e kanë paraqitur autoritetet në zbatim të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët (shih për shembull, Hutten-Czapyska kundër Polonisë [DHM], nr. 35014/97, §238, GJEDNJ 2006-VIII)*.

173. Në shqyrtimin e saj të çështjes konkrete, Gjykata, duke marrë në konsideratë të plotë informacionin në zotërim të saj, parashtrimet e palëve dhe parimet e parashtruara në praktikën e saj gjyqësore, sipas interpretimit të Konventës, e cila është përgatitur për të garantuar të drejtat që janë praktike dhe efikase, joteorike ose iluzionare (*shih, më e fundit, N.D. dhe N.T. kundër Spanjës [DHM], nr. 8675/15 dhe 8697/15, §171, 13 shkurt 2020, dhe Ilgar Mammadov kundër Azerbajxhanit (procedime për shkeljen) [DHM], nr. 15172/13, §215, 29 maj 2019*), do të përcaktojë nëse, brenda kontekstit të pajtueshmërisë së ankuesve me rregullin për shterimin e mjeteve të brendshme, ligji për pronat 2015 përmbush kriteret e parashikuara në praktikën gjyqësore për t'u konsideruar një mjet efikas.

2. Shterimi i mjeteve të brendshme

174. Neni 35§1 i Konventës parashikon si më poshtë:

“1. Gjykata mund të trajtojë çështjen vetëm pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet e brendshme ligjore sipas rregullave përgjithësisht të pranuarra të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një periudhe prej gjashtë muajsh nga data në të cilën është marrë vendimi i formës së prerë.”

a) Parime të përgjithshme të shterimit

175. Qëllimi i rregullit të shterimit është t'u ofrojë shteteve kontraktuese mundësinë e parandalimit ose të korigjimit të shkeljeve të pretenduara ndaj tyre përpara se këto pretendime të paraqiten në Gjykatë (*shih, midis autoriteteve të tjera, Selmouni kundër Francës [DHM], nr. 25803/94, §74, GJEDNJ 1999-V*). Rregulli në nenin 35§1 mbështetur në prezumimin të reflektuar në nenin 13 (me të cilin ka një afërsi të ngushtë), gjë e cila është një mjet efikas i brendshëm i disponueshëm në respekt të shkeljes së pretenduar të të drejtave të një individi sipas Konventës (*shih, për shembull, Kulla kundër Polonisë, [DHM], nr. 30210/96, §152, GJEDNJ 2000-XI*). Në këtë mënyrë, ky është një aspekt i rëndësishëm i parimit që makineria e mbrojtjes së parashikuar nga Konventa është mbështetëse për sistemet e brendshme të cilat mbrojnë të drejtat e njeriut (*shih, midis të tjerave, Sejdovic kundër Italisë, [DHM], nr. 56581/00, §43, GJEDNJ 2006-II*).

176. Ekzistenca e mjetit duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dështimi i së cilës vjen nga mungesa e aksesit dhe efikasitetit të kërkuar (*shih, për shembull, Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë (kundërshtim paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, §71, 25 mars 2014*). Për të qenë efikas, një mjet duhet të ketë mundësinë të kuroj gjendjen e vënë në pikëpyetje të çështjeve dhe duhet të ofrojë perspektiva të arsyeshme të suksesit (*shih, më e fundit G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë, [DHM], nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, §182, 28 qershor 2018*). Megjithatë, ekzistenca e dyshimeve të thjeshta për aspektet e suksesit të një mjeti specifik, i cili nuk është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për mosshterimin e asaj mënyre korigjimi (*shih, për shembull, Gberghina kundër Rumanisë [DHM], nr. 42219/07, §86, 9 korrik 2015*). Efikasiteti i një mjeti sipas parashikimit të nenit 13 nuk varet nga siguria e një rezultati të favorshëm për kërkuesin (*shih Ališić dhe të tjerët kundër Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, Serbisë, Sllovenisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë [DHM], nr. 60642/08, §131, GJEDNJ 2014*).

177. Vlerësimi nëse mjetet e brendshme janë shteruar normalisht kryhet me referencë në datën në të cilën kërkesa u paraqit në Gjykatë. Megjithatë, Gjykata ka vendosur në shumë raste se ky rregull ka përjashtime, të cilat mund të justifikohen nga rrethanat specifike të secilës çështje (*shih, Demopoulos dhe të tjerët kundër Turqisë (vendim) [GJM] nr. 46113/99 dhe 7 të tjerë, §84, GJEDNJ 2010*). Midis këtyre përjashtimesh janë situata ku, sipas vendimit pilot në të cilin Gjykata konstatoi një shkelje sistematike të Konventës, shteti i paditur ka prezantuar një legjislacion të ri ose ndryshues, i cili mund t'i sigurojë viktimave ekzistuese dhe të mundshme të dhunës sistematike një lehtësim të mjaftueshëm dhe të

mjaftueshëm në nivelin e brendshëm, të tillë si ai që shqyrtimi i mëtejshëm i Gjykatës i kërkesave të ngjashme, nuk justifikohet më (*shih për shembull, Balan kundër Republikës së Moldavisë (vendim), nr. 44746/08, 14 janar 2012, dhe Nagovitsyn dhe Nalgijev kundër Rusisë (vendim) nr. 27451/09 dhe 60650/09, 23 shtator 2010, në lidhje me mosekzekutimin e vendimeve; Stella dhe 10 të tjerë kundër Italisë (vendim) nr. 49169/09, 16 shtator 2014 dhe Łatak kundër Polonisë (vendim) nr. 52070/08, 12 tetor 2010, në lidhje me mbipopullimin e burgut; Techniki Olympiaki A.E. kundër Greqisë (vendim), nr. 40547/10, 1 tetor 2013; Balakchiev dhe të tjerët kundër Bullgarisë, (vendim), nr. 65187/10, 18 qershor 2013, në lidhje me kobëzgjatjen e procedimeve; dhe Hodžić kundër Sllovenisë (vendim) nr. 3461/08, 4 prill 2017, në lidhje me kursimet “e vjetra” në monedhën e buaj).*

b) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

i. Në lidhje me efikasitetin e ligjit për pronat 2015

178. Gjykata vëren se kërkesit kishin ngritur një sërë argumentesh në lidhje me efikasitetin e mjetit i cili ishte vënë në dispozicion me anë të ligjit për pronat 2015. Siç përshkruhet më sipër, termi “efikas” do të thotë që një mjet duhet të jetë i përshtatshëm dhe i aksesueshëm (*McFarlane kundër Irlandës [GHM], nr. 31333/06, §108, 10 shtator 2010*). Gjykata duke iu përgjigjur argumenteve të kërkesve do të shqyrtojë më poshtë përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e ligjit për pronat 2015.

a) Përshtatshmëria e formës së korigjimit

179. Kërkesit kanë bërë një sërë ankesash, duke kundërshtuar kufizimet ligjore për rikthimin e pronës së tyre të shpronësuar (në krahasim me kompensimin financiar ose forma të tjera të kompensimit në natyrë), dhe rendin prioritar të formave të kompensimit që duhet të jepen nga autoritetet. Duke qenë se kritika bëhet për një qasje kufizuese për rikthimin e pronës fillestare pas njohjes së të drejtave për pronën, neni 1 i protokollit nr. 1 nuk mund të interpretohet si vendosës i ndonjë kufizimi ndaj lirisë së shteteve kontraktuese për të përcaktuar qëllimin e rikthimit të pronës (*shih Janter kundër Sllovakisë, nr. 39050/97, §34, 4 mars 2003*). Shtetet kontraktuese shijojnë një marginë të madhe vlerësimi në këtë aspekt, dhe do të ishte e pamenduar për Gjykatën që të përpiquej të ushtronte një detyrim mbi shtetin për të vënë në fuqi rikthimin e të gjitha pronave, të cilat janë shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar gjatë regjimit komunist në të gjitha shkallët (*shih Sirc kundër Sllovenisë (vendim), nr. 44580/98, §275, 22 qershor 2006*). Për më tepër, disa kërkes në kërkesat në fjalë kanë përfutuar rikthimin e pronave të cilat ishin të pazëna.

180. Ligji për pronat 2015 parashikon një sërë formash kompensimi. Nuk i takon kësaj Gjykate të përcaktojë hierarkinë e formave të kompensimit për t’iu dhënë autoriteteve të brendshme. Gjykata është e kënaqur se Qeveria, sipas vendimit pilot në *Manusbaqe Puto dhe të tjerët*, ka parashikuar përdorimin e “formave alternative të kompensimi”. Thënë kjo, Gjykata është e mendimit se nga perspektiva e sigurisë ligjore, neni 25 i ligjit 2015 – i cili përjashton rikthimin e pronës së shpronësuar “e cila i shërben interesit publik në përputhje me kufizimet e parashikuara në ligj” – si edhe formulimin e vendimit të saj zbatues (*shih veçanërisht paragrafin 96 më sipër*) është disi e hapur. Kjo është kryesisht një çështje që u përket gjykatave të brendshme të vendosin, megjithatë Gjykata thekson se kuadri i zbatueshëm ligjor, më konkretisht statutet dhe vendimet zbatuese duhet të përshkruajnë dhe të përkufizojnë me qartësi të mjaftueshme ushtrimin e diskrecionit nga ATP-ja – ose autoritete të tjera zbatuese – në vendimmarrje në lidhje me dhënien e kompensimit në natyrë për pronën e shpronësuar (për të cilën janë njohur të drejtat e ish-pronarit ndaj pronës).

181. Gjithashtu, Gjykata merr në konsideratë realitetin në Shqipëri, ku janë ndërtuar një sërë ndërtime pa leje në të gjithë vendin, duke përfshirë tokat e ish-pronarëve. Kjo situatë ka bërë që autoritetet të ndërhyjnë vazhdimisht duke paraqitur legjislationin për rregullimin e ndërtimeve të paligjshme për të ruajtur paqen sociale. Ligji për pronat 2015 ka marrë në konsideratë këtë situatë dhe parashikon në lidhje me njohjen e së drejtës së ish-pronarëve për kompensim, sa herë që rikthimi është i pamundur materialisht ose ligjërish. Nëse kompensimi i duhur paguhet në përputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës, në përgjithësi nuk ka një balancë të padrejtë midis interesave të palëve.

182. Për sa i përket korrigjimit ligjor, ligji për pronat 2015 parashikon të drejtën e një paditësi për të apeluar ndaj vendimeve të ATP-së, të cilat njohin të drejtat e pronës dhe të drejtën për kompensim në gjykatën kompetente të apelit. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë në vijim sqaron se një apelim kundër vendimit dhënë nga gjykata e apelit mund të paraqitet në Gjykatën e Lartë (*shih paragrafët 74-76 më sipër*).

183. Për më tepër, në rastet që kanë të bëjnë me mosmarrjen e një vendimi nga ana e ATP-së për paditë për pronat të mbetura pezull brenda afatit trevjeçar, ligji për pronat 2015 parashikon të drejtën e paditësit për të paraqitur një padi civile në gjykatën e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm. Në lidhje me këtë, rezulton se është disi e qartë se mbi çfarë bazash do të vendosin gjykatat e brendshme për paditë e mbetura pezull për pronat, do të kryejnë vlerësimin financiar dhe do të realizojnë funksione të tjera, të cilat më herët kryheshin nga ATP-ja. Në çdo rast, Gjykata duhet të theksojë se për sa i përket kërkesës për afat të arsyeshëm, praktika gjyqësore përkatëse dhe proceset e shpejta kërkohen për të trajtuar pothuajse 7,000 padi për pronat të mbetura pezull, sipas parashtrimeve të Qeverisë në paragrafin 141 (v) më sipër.

184. Për më tepër, ligji për pronat 2015 garanton të drejtën e ish-pronarëve për të apeluar kundër vendimeve të ATP-së për vlerësimet financiare të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata është e kënaqur që vendime të tilla administrative janë të predispozura për t'u apeluar përpara një gjykate. Në vijim, Gjykata vëren se në rastet që kanë të bëjnë me mospërcaktimin e vlerësimit financiar nga ATP-ja brenda afatit trevjeçar, ligji për pronat 2015 parashikon të drejtën e ish-pronarit për të paraqitur një padi civile në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

185. Gjithashtu, Gjykata mirëpret faktin se ligji për pronat 2015 parashikon situatat e padive të mbivendosura, duke i nxitur palët ta zgjidhin çështjen në mënyrë miqësore, dhe në rast se kjo nuk funksionon, palët kanë të drejtën të ndërmarrin procedime gjyqësore, të cilat kërkojnë përcaktimin përfundimtar të së drejtës për kompensim (*krabaso Preda dhe të tjerët kundër Rumanisë, nr. 9584/02 dhe 7 të tjerë, §§124 dhe 130, 29 prill 2014*). Ndërkohë, shuma e kompensimit në lidhje me pjesën e diskutuar të pronës do të depozitohet në një llogari bankare specifike për t'u paguar me zgjidhjen e çështjes.

186. Ligji për pronat 2015, nuk përmban një dispozitë të qartë e cila i jep të drejtën ATP-së të ngrejë pyetje për përfundimin e vendimeve pa kuant. Ligji për pronat 2015 parashikon se këto vendime do t'i nënshtrohen vlerësimit financiar për të përcaktuar shumën e kompensimit dhe për pasojë dhënien e kompensimit nga fondi i kompensimit. Gjithashtu, neni 6§7 i ligjit për pronat 2015 lë në fuqi përfundimin e vendimeve, të cilat përcaktojnë shumën e kompensimit që duhet të jepet për ish-pronarët, objekt të indeksimit. Duke qenë se e drejta e kompensimit mbetet e pakundërshtueshme dhe e padiskutueshme, për të cilën kërkuesit nuk paraqitën ndonjë praktikë në zhvillim për të provuar të kundërtën, Gjykata nuk është dakord me argumentin e kërkuesve që ligji për pronat 2015 shkel parimin e sigurisë ligjore për sa ka të bëjë me të drejtën për kompensim.

187. Së fundmi, Gjykata vëren se kërkuesit kanë ngritur padi ndaj qasjes së ndjekur nga Qeveria pas dhënies së vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 1/2017, duke miratuar ndryshimet ndaj vendimeve zbatuese në vend të prezantimit të ndryshimeve statutores në ligjin për pronat 2015 (*shih paragrafin 126 më sipër*), edhe pse këto arsye nuk kishin qenë objekt i kontrollit nga Kuvendi, sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese (*shih paragrafin 70 më sipër*). Për më tepër, rezulton se ndryshimet në vendimet zbatuese, së pari, nuk rregullojnë me qartësi të mjaftueshme situatën e rregulluar nga neni 6§5 i shfuqizuar i ligjit për pronën 2015, më konkretisht përllëvizjet në lidhje me pjesën e tokës për të cilën i jepet e drejta një ish-pronari, kur Agjencia merr në konsideratë një rikthim të ri të pronës së tij të njohur. Sidoqoftë, nuk është roli i kësaj Gjykate të përcaktojë rendin të cilin duhet të ndjekin autoritetet për të korrigjuar një situatë të brendshme pas shfuqizimit të dispozitave statutores. Një çështje e tillë mbetet në vlerësimin dhe sekrecionin e autoriteteve, duke i dhënë rëndësi kërkesave ligjore të brendshme. Më tej, Gjykata vëren se procedimet në lidhje me kushtetutshmërinë e VKM-së nr. 222/2016 dhe 223/2016 janë pezull për shqyrtim përpara Gjykatës Kushtetuese (*shih paragrafët 81 dhe 89 më sipër*), dhe procedimet në lidhje me kushtetutshmërinë e VKM-së nr. 766/2017 janë pezull për shqyrtim përpara Gjykatës Administrative të Apelit edhe pse apelimi i ankuesit tashmë është

rrëzuar (*shih paragrafin 101 më sipër*). Në këtë kontekst, Gjykata ka për qëllim të varet nga sistemet e brendshme të cilat ruajnë të drejtat e njeriut dhe është me vend që gjykatat e brendshme fillimisht të kenë mundësinë për të përcaktuar çështjet në lidhje me pajtueshmërinë e ligjit të brendshëm me Konventën, dhe nëse kërkesa sidoqoftë paraqitet në Strasburg, Gjykata duhet të përfitojë nga këndvështrimet e gjykatave të brendshme, si kontakti i drejtpërdrejtë dhe i vazhdueshëm me forcat e vendeve të tyre (*shih Burden kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], nr. 13378/05, §42, GJEDNJ 2008*).

188. Si përfundim, Gjykata nënvizon se autoritetet e brendshme të cilat janë në pozicionin më të mirë për të vlerësuar prakticitetet, prioritetet dhe interesat konfliktuale në një nivel të brendshëm, shijojnë një marginë të gjerë vlerësimi për sa i përket zgjedhjes së formave të korrigjimit për shkeljet e të drejtave ndaj pronës. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se nuk ngrihen çështje në lidhje me korrektësinë e formës së korrigjimit, të parashikuar nga ligji për pronat 2015, i cili do të vinte në dyshim efikasitetin e mjetit në këtë aspekt.

b) Përshtatshmëria e kompensimit

189. Në çështjen *Vistinš dhe Perepjolkins kundër Letonisë* ([DHM], nr. 71243/01, 25 tetor 2012), Gjykata përmbloodhi parimet e zbatueshme për kushtet e kompensimit, duke përfshirë në kontekst tranzicionet e mëdha politike, duke pohuar, midis të tjerash, si më poshtë:

“112. (...) Neni 1 i protokollit nr. 1 nuk garanton të drejtën për kompensim të plotë në të gjitha rrethanat (*shih Bronionowski kundër Polonisë [DHM], nr. 31443/96, §182, [GJEDNJ 2004-V]. Një mungesë në total e kompensimit mund të konsiderohet e justifikueshme vetëm në rrethana përjashtuese (shih ish-Mbreti i Greqisë dhe të tjerët [DHM] (themeli), [nr. 25701/94], §89 [GJEDNJ 2000-XII]). Objektivat legjitimë të “interesit publik” të ndjekura në masat e reformës ekonomike ose masat e hartuara për të arritur drejtësi më të madhe sociale mund të kërkojnë më pak sesa rimbursimi i vlerës së plotë të tregut (shih James dhe të tjerët [kundër Mbretërisë së Bashkuar, 21 shkurt 1986], §54 [seritë A nr. 98]); në të tilla raste kompensimi nuk duhet të reflektojë domosdoshmërisht vlerën e plotë të pronës në fjalë.*

113. Ky parim zbatohet me më shumë forcë kur ligjet ekzekutohen në kontekstin e ndryshimit të regjimit politik dhe ekonomik, veçanërisht gjatë periudhës fillestare tranzitore, i cili domosdoshmërisht shënohet nga trazira dhe pasiguri; në të tilla raste shteti ka një marginë të gjerë vlerësimi (*shih, midis autoriteteve të tjera, Kopecký kundër Sllovakisë [DHM], nr. 44912/98, §35, GJEDNJ 2004-IX; Jabn dhe të tjerët [kundër Gjermanisë ([DHM], nr. 46720/99, 72203/01 dhe 72552/01), §116 (a) [GJEDNJ 2005-VI]; dhe Suljagić kundër Bosnjë-Hercegovinës, nr. 27912/02, §42, 3 nëntor 2009*). Kështu, për shembull, Gjykata ka vendosur se më pak sesa kompensimi i plotë mund të jetë i nevojshëm *a fortiori*, në rastin kur prona merret me qëllimin për “ndryshime të tilla themelore të sistemit kushtetues të një vendi si tranzicion nga monarkia në republikë” (*shih ish-Mbreti kundër Greqisë dhe të tjerët (themeli), cituar më sipër, §87*). Gjykata rikonfirmoi se parimi në *Bronionowski* (cituar më sipër, §182), në kontekstin e rikthimit të pronës dhe politikës së kompensimit, dukë specifikuar një skemë për të rregulluar pronën, duke qenë “e gjerë por kontroversale... me një ndikim të madh ekonomik për vendin në tërësi”, mund të përfshinte vendimet që kufizonin kompensimin për marrjen ose rikthimin e pronës në një nivel nën vlerën e saj të tregut. Gjithashtu, Gjykata thekson se këto parime në lidhje me zbatimin e ligjeve në “kontekstin përjashtues të ribashkimit të Gjermanisë” (*shih Maltzan dhe të tjerët kundër Gjermanisë (vendim) [DHM], nr. 71916/01, 71917/01 dhe 10260/02, §§77 dhe 111-112, GJEDNJ 2005-V, dhe Jabn dhe të tjerët, cituar më sipër*”).

190. Gjykata është e mendimit se Çështja në fjalë nuk ka të bëjë me shpronësimin e paligjshëm fillestar të pronave të kërkuarve, rast në të cilin do të kërkohej në parim kompensimi i plotë i vlerës aktuale të tregut (*shih, për shembull, Papamichalopoulos dhe të tjerët kundër Greqisë (neni 50), 31 tetor 1995, §§34-40, seritë A nr. 330-B*); më shumë sesa mund të ishte për organizimet të cilat ofronin kompensim për privim të padrejtë nga prona, kryer nga ish-regjimi komunist.

191. Gjykata vëren se, në zbatim të ligjit për pronat 2015, vendimet të cilat përcaktonin shumën e kompensimit për t’iu dhënë ish-pronarëve duhet të zbatohen sipas indeksimit. Gjykata është e kënaqur për faktin se ligji për pronat 2015 nuk ngre pyetje për shumën e kompensimit të dhënë me anë të atyre vendimeve (*shih edhe paragrafin 186 më sipër*) dhe se autoritetet kanë ndërmarrë të

respektojnë detyrimet që dalin prej tij.

192. Megjithatë, për sa ka të bëjë me vendimet pa kuant, Gjykata vëren se, ndryshe nga pritshmëritë e kërkuesve për t'u kompensuar në vlerën aktuale të tregut dhënë sipas legjislacionit të mëparshëm, shumat për t'u dhënë si kompensim sipas ligjit për pronat 2015, në disa raste, mund të reduktohen ndjeshëm për shkak të ndryshimeve në klasifikimin kadastral të pronës së shpronësuar gjatë kohës. Në raste të tjera, kërkuesit mund të konsiderohen se janë kompensuar plotësisht. Në këto rrethana, ligji për pronën 2015 do të përbëjë një ndërhyrje të mundshme të rëndësishme dhe Gjykata duhet të caktojë nëse përcaktimi i kompensimit është i justifikuar në përputhje me ligjin për pronat 2015.

193. Gjykata vëren se Gjykata Kushtetuese konstatoi se prezantimi i një skeme të re kompensimi ndoqi interesin publik të zgjidhjes të “problemeve të pronës brenda një afati, më konkretisht brenda 10 viteve, sipas kostove praktike financiare, si edhe krijimin e paqes sociale midis shtresave të ndryshme sociale të ndikuara nga çështjet e pronës, të cilat vijonin të mbeshnin të pazgjidhura për 25 vite”. Për shkak të njohurive të tyre të drejtpërdrejta për shoqërinë dhe nevojat e saj, autoritetet e brendshme në parim janë më mirë të pozicionuara sesa gjyqtari ndërkombëtar për të vlerësuar se çfarë është në interesin publik dhe kështu gëzojnë një margjinë më të gjerë vlerësimi në këtë fushë (*shih Jabn dhe të tjerët [DHM], cituar më sipër, §91*). Gjykata vëren konstatimet e Gjykatës Kushtetuese dhe i vë rëndësi faktit se ligji për pronat 2015 u miratua si reagim ndaj vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, për të zgjidhur një problem strukturor dhe sistematik, i cili vijonte që prej vitit 1993 dhe ndikonte të paktën 26,000 padë për kompensim.

194. Për më tepër, Gjykata është e mendimit se shteti ka trajtuar një çështje jashtëzakonisht të vështirë dhe komplekse, e cila përfshinte një zgjedhje sipas së cilës duheshin përmeshur detyrimet monetare dhe morale ndaj personave, të cilët kishin vuajtur padrejtësi në të shkuarën. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se Qeveria kishte përlogaritur faturën financiare për shumën mbi 6.5 miliardë euro, e cila në normën mesatare të alokimeve buxhetore të shtetit gjatë dy dekadave të fundit do të merrte një kohë shumë të gjatë për t'iu paguar paditësve mbi bazën e skemës së kompensimit sipas ligjit për pronat 2004 (*shih paragrafin 38 më sipër*). Duke marrë në konsideratë magnitudën e problemit dhe rëndësinë e gjetjes së një zgjidhje afatgjatë për kompensimin e pronës, autoritetet e iu është dashur të marrin në konsideratë aspekte të ndryshme sociale, ligjore dhe ekonomike. Qasja e autoriteteve nuk duket e paarsyeshme dhe disproporcionale, duke marrë në konsideratë faktin se ata kanë detyrën për të korigjuar joefikasitetin e legjislacionit të mëparshëm për rikthimin dhe kompensimin e pronës, dhe duke marrë në konsideratë margjinën e gjerë të vlerësimit që iu është akorduar në situatat ku përfshihej një skemë e gjithëpërfshirëse, por kontraversale legjislative me një ndikim të rëndësishëm ekonomik për vendin në tërësi.

195. Për faktin nëse kërkuesit duhet të përballen me një barrë disproporcionale dhe të madhe, Gjykata rithekson se në çështjen *Wolkenberg dhe të tjerët kundër Polonisë* (vendim) (nr. 50003/99, §64, 4 dhjetor 2007), ajo pranonte argumentin e Qeverisë së paditur në lidhje me nevojën për një kompromis midis pritshmërive të të paditurve dhe kufizimeve buxhetore të shtetit në një situatë jashtëzakonisht të vështirë, e cila çon në një reduktim të shumës së kompensimit në 20% të vlerës aktuale të pronës fillestare në lidhje me përshtatshmërinë e kompensimit për të “hequrit”, Gjykata pranon si të arsyeshme dhe proporcionale “shumat e kompensimit financiar të zgjedhura nga autoritetet, të cilat variojnë nga 20% dhe 60% e akordimit individual të Dhomës së Madhe në çështjen pilot [*Kurić dhe të tjerët kundër Sllovenisë* (kompensim i drejtë) [DHM], nr. 26828/06, GJEDNJ 2014-I]” (*shih Anastasov dhe të tjerët kundër Sllovenisë* (vendim), nr. 65020/13, §18 tetor 2016).

196. Duke u rikthyer në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata është e mendimit se referenca në kategorinë origjinale kadastrale të pronës së shpronësuar, si bazë për realizimin e vlerësimit financiar, nuk është *per se* arbitrare. Megjithatë, disa kërkues mund të përftojnë vetëm një shumë të vogël kompensimi si rezultat i përdorimit të këtij kriteri reference, pavarësisht vlerës së rritur të pronës së tyre të shpronësuar gjatë viteve. Në këto rrethana, për të parandaluar një ngarkesë ekstreme mbi ish-pronarët në përgjithësi dhe kërkuesve në veçanti, mjeti mund të konsiderohet efikas në masën që

shuma në total e kompensimit – pavarësisht formës së kompensimit – shkon në të paktën 10% të vlerës për të cilën i është dhënë e drejta kërkuesit nëse vlerësimi financiar të kryhej duke iu referuar kategorisë aktuale kadastrale të pronës së shpronësuar. Sipas Gjykatës, pragu minimal prej 10% për shumën e kompensimit mund të konsiderohet i arsyeshëm në një kontekst specifik të procesit për rikthimin dhe kompensimin e pronave në Shqipëri, sipas nivelit të përgjithshëm të sakrificës sipas skemës së re të kompensimit për ish-pronarët, duke përfshirë kërkuesit, krahasuar me pritshmërinë e tyre për të marrë kompensimin e vlerës aktuale të tregut, e cila rridhte nga legjislacioni i mëparshëm (*shih edhe paragrafin 194 më sipër*).

197. Në lidhje me kundërshtimin e kërkuesve për të përdorur hartat e vlerësimit të pronave të vitit 2016, Gjykata vëren se hartat për vlerësimin e pronave 2016 ishin hartuar sipas vlerave të transaksioneve për pronat e paluajtshme të regjistruara në ZRPP. Gjykata i referohet raportit të fundit të vlerësimit të MONEYVAL-it, i cili thekson përmirësimet e konsiderueshme të ndërmarra nga autoritetet për transaksionet e pronave të paluajtshme të kryera që prej vitit 2014, kryesisht me anë të ndalimit të përdorimit të transfertave ose depozitave në para në dorë, përdorimit të detyrueshëm të llogarive bankare nën kujdesin noterial dhe detyrimit të noterit të përcaktojë çmimin real të shitjeve për pronat e paluajtshme (*shih paragrafin 129 më sipër*). Sipas përpjekjeve të vazhduara të autoriteteve për të frenuar dhe luftuar ekonominë informale, Gjykata pranon se situata nuk ka mbetur e pandryshuar që prej miratimit të vendimit në çështjen *Sharra dhe të tjerët* [Komiteti], cituar në paragrafin 12(iii) më sipër. Fakti nëse hartat për vlerësimin e pronave 2016 reflektojnë vlerat e duhura të pronës është një çështje që duhet të përcaktohet nga autoritetet e brendshme.

198. Në lidhje me këtë, dhe për sa i përket kërkesës nr. 53846/14, Gjykata e konsideron të pasaktë parashtrimin e ankuesit për një rënie drastike të çmimit të referencës. Pasi ka shqyrtuar hartat për vlerësimin e pronës 2016, Gjykata vëren se çmimi i referencës për të njëjtën kategori kadastrale (e cila është truall) është rritur me 29,106 lekë (233 euro) në vitin 2016 (krahasuar me 192 euro pretenduar në vitin 2014).

199. Në lidhje me argumentet e kërkuesve për një ndryshim në trajtimin e ish-pronarëve, duke përfshirë ish-kërkues të suksesshëm në këtë Gjykatë, Gjykata vëren se ish-kërkuesit e suksesshëm u kompensuan (në vlerën e tregut), duke qenë në përputhje me legjislacionin në fuqi në kohën në fjalë. Megjithatë si rezultat i vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët* dhe masave të përgjithshme të treguara nga Qeveria e paditur, autoritete kanë rishikuar legjislacionin për rikthimin dhe kompensimin e pronave dhe kanë zbatuar ligin për pronat 2015, i cili prezantonte një skemë tjetër kompensimi. Gjykata kujton se vetëm ndryshimet në trajtimin e mbështetur në karakteristikat e identifikueshme, ose në “status” mund të sjellin diskriminim. Fjalëve “status tjetër” iu është dhënë një kuptim i gjerë në praktikën gjyqësore të gjykatës dhe interpretimi i tyre nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që janë të lindura ose të qenësishme (*shih, për shembull, Molla Sali kundër Greqisë [DHM], nr. 20452/14, §134, 19 dhjetor 2018*). Ndryshimi në trajtimin, të cilin kërkuesit e kërkojnë ka të bëjë më masën e kompensimit që duhet të përlllogaritet duke iu referuar kategorisë kadastrale të pronës në kohën e shpronësimit në vend që t’i referohet çmimit aktual të tregut të pronës. Edhe duke siguruar se kjo diferencë mbështetet në karakteristika personale të identifikueshme të tyre, dhe sipas nenit 14 të Konventës i përkiste kategorisë “status tjetër”, kjo ndodhte ekskluzivisht për shkak të një ndryshimi ndërhyrës në legjislacion dhe nuk mund të konsiderohej si diskriminuese (*shih, për shembull, Yordanova dhe Toshev kundër Bullgarisë, nr. 5126/05, §62, 2 tetor 2012, dhe referencat cituar në të*).

200. Në të njëjtën linjë, fakti se disa ish-pronarë mund të mendohen si të kompensuar plotësisht sipas ligjit për pronat 2015, sipas rikthimit të mëparshëm (të pjesshëm) të pronës që kanë përfutur, nuk mund të konsiderohet si një ndryshim në trajtim dhe nuk ndikon ose ndryshon formën e kompensimit që ata kanë përfutur. Mungesa e dhënies së një kompensimi të mëtejshëm do të ishte me të vërtetë rezultati logjik i zbatimit të një skeme të re kompensimi. Ndryshe, ata do të kishin një avantazh të padrejtë ndaj pronarëve, të cilët nuk kanë mundur ende të marrin ndonjë formë kompensimi në të shkuarën, duke theksuar se qëllimi i ligjit për pronat 2015 është zgjidhja e çështjes së pronës në mënyrën më të barabartë të mundur (*shih edhe paragrafin 193 më sipër*).

201. Së fundmi, Gjykata nuk është bërë me dije se pas ndryshimeve në VKM-në nr. 223/2016, reduktimi i shumës së kompensimit financiar nga 50 milionë lekë (403,763 euro) në 10 milionë lekë (81,100 euro) ka rezultuar në një situatë pasigurie të madhe ligjore ose një ndryshim të përgjithshëm në trajtim. Në lidhje me këtë, nuk rezulton që mbi informacionet statistikore të ofruara nga Qeveria më 2019-n (*shih paragrafin 141(ii) dhe (iii) më sipër*), akordimi mesatar i kompensimit financiar reduktohej ndjeshëm (ose plotësisht) sipas ndryshimeve në VKM-në nr. 223/2016. Qeveria mund t'i ketë dhënë prioritet kompensimit në natyrë dhe të reduktojë kompensimin e përgjithshëm financiar (*shih paragrafin 95 më sipër*), sidoqoftë Gjykata duhet të theksojë faktin se ndryshimet e shpeshta në legjislacion, duke përfshirë vendimet zbatuese, mund të kontribuojnë në një mungesë të përgjithshme të sigurisë ligjore dhe ky është një faktor që duhet të merret në konsideratë në vlerësimin e reagimit të shtetit në të ardhmen (*shih Manushaqe Puto dhe të tjerët, cituar më sipër, §110*).

202. Më tej, Gjykata vëren se përshtatshmëria e kompensimit ka mundësi të zvogëlohet nëse do të paguhej pa pasur si referencë në rrethanat e ndryshme përgjegjëse për të reduktuar vlerën e tij, si për shembull, kalimi i një kohe të konsiderueshme (*shih Rafineritë greke Stran dhe Stratis Andreadis kundër Greqisë, 9 dhjetor 1994, §82, seritë A nr. 301-B, dhe Wolkenberg dhe të tjerët (vendim), cituar më sipër, §65*), shuma do të konvertohet në vlerën aktuale për të nxitur efektet e inflacionit. Për këtë qëllim, Gjykata vëren se duke marrë në konsideratë skemën e kompensimit të ndryshuar ndjeshëm, shuma e kompensimit duhet të indeksohet me inflacionin deri në pagesën përfundimtare, në mënyrë që mjeti të vijojë të mbetet efikas (*shih edhe Guiso-Gallisay kundër Italisë (kompensim i drejtë) [DHM], nr. 58858/00, §105, 22 dhjetor 2009*). Sidoqoftë, Gjykata mirëpret faktin se sipas nenit 6§7 të ligjit për pronat 2015, vendimet e formës së prerë të cilat kishin përcaktuar shumën e kompensimit që do t'i jepej ish-pronarëve do të ishte objekt indeksimi (*shih paragrafin 186 më sipër*).

203. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se në përputhje me prapësinë minimal prej 10% për shumën e kompensimit, nuk ngrihen problematike në lidhje me përshtatshmërinë e kompensimit parashikuar në ligjin për pronat 2015, që do të vinte në dyshim efikasitetin e mjetit në këtë aspekt.

c) Aksesueshmëria dhe efikasiteti i mjetit

204. Në lidhje me funksionimin e ligjit për pronat 2015 në praktikë, Gjykata do t'i referohej statistikave më të fundit të ofruara nga Qeveria (*shih paragrafin 141 më sipër*). Që prej datës së hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2015, Qeveria parashikoi se autoritetet kishin zbatuar plotësisht 500 vendime; dhe kishin shqyrtuar mbi 9500 padi të reja për pronat. Këto shifra tregojnë një ecuri në punën e kryer nga autoritetet në krahasim me statistikën që Qeveria kishte paraqitur në Komitetin e Ministrave në qershor 2018 (*shih paragrafin 127 më sipër*).

205. Ndryshe nga situata e mëparshme, Qeveria kishte zbatuar detyrimet statutoare që rridhnin nga ligji për pronën 2015, duke alokuar burime të rëndësishme buxhetore të përvitshme për pagesën e kompensimit financiar. Gjithashtu, ajo e kishte zgjeruar pjesën e tokës të caktuar nga shteti për kompensim në natyrë. Në fakt, shteti ka siguruar kompensim financiar dhe kompensim në natyrë për paditësit, të cilët kanë hartuar këto procedura të brendshme (*shih paragrafët 127 dhe 141 më sipër*).

206. Gjykata i konsideron këto zhvillime si të kënaqshme. Gjithsesi, ajo nënvizon se edhe pse përqindja e fondit të tokës, e përdorur për të dhënë kompensim në natyrë ka qenë e ulët deri më sot, përdorimi më i madh i kompensimit në natyrë në parim do të reduktohte faturën e përgjithshme financiare të kompensimit dhe mund t'i lejojë ish-pronarët të përfitojnë nga një rritje në të ardhmen në vlerën e kompensimit në natyrë. Në vijim, Gjykata thekson se alokimi i mjaftueshëm i burimeve, i infrastrukturës dhe i lehtësirave është i nevojshëm për të siguruar se procedimi me paditë e pashqyrtuara të pronave dhe skema e kompensimit mbesin në çdo kohë “efikase dhe të shpejta” (*shih Bronionski [DHM], cituar më sipër, §194*), pikërisht sepse pothuajse 7,000 padi pronash, të cilat ishin shqyrtuar nga ATP-ja brenda afatit 3-vjeçar, do të duhej të shqyrtoheshin nga gjykata e shkallës së parë sipas kërkesës së një ish-pronari.

207. Gjykata vëren se ligji për pronat 2015, i hartuar sipas përpilimit të një baze të shinash elektronike të vendimeve administrative dhënë në vitin 1993, parashikonte afate të qarta dhe detyruese për autoritetet në mënyrë që ato të vepronin. Ai parashikonte se ATP-ja ishte përgjegjëse

për shqyrtimin e padive të pronave dhe njohjen e së drejtës ndaj pronës, duke përfshirë të drejtën për kompensim. ATP-ja do të përcaktonte edhe vlerësimin financiar në lidhje me vendimet e mbetura pezull përpara autoriteteve të brendshme dhe kësaj Gjykate. Duke iu referuar informacionit të ofruar nga Qeveria, Gjykata vëren se ATP-ja kishte përcaktuar vlerësimin financiar për pothuajse çdo kërkesë e cila është pjesë e çështjes konkrete (*shih paragrafët 152–163 më sipër*).

208. Në lidhje me këtë, Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin se ATP-ja ishte vetëm një gjymtyrë e sistemit të mjeteve të parashikuara nga autoritetet, dhe se do të kishte një procedurë të dytë plotësisht gjyqësore, e cila mund të rezultojë në një vendim të ligjshëm detyrues gjyqësor. Gjykata është e kënaqur se një sistem i tillë tashmë është përdorur, duke qenë se kërkuessit dhe ish-pronarët kanë apeluar ndaj vendimeve të ATP-së (*shih paragrafët 102 dhe 169 më sipër*). Në lidhje me argumentin e kërkuessve dhe procedimet do të ishin paarsyeshmërisht të gjata përpara gjykatave të brendshme, do të ishte spekuluese nga ana e Gjykatës të arrinte në përfundimin se gjykatat e brendshme që trajtimin këto çështje nuk do të vepronin me kujdesin e duhur, kjo e fundit duke qenë një çështje e administrimit gjyqësor dhe menaxhimit të çështjeve. Është e vërtetë se efikasiteti i mjetit varej nga aftësia e gjykatave për t'i trajtuar këto çështje me kujdes të veçantë në aspektin e kohës së nevojshme për përcaktimin e tyre. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata e Lartë aktualisht nuk funksionon për shkak të ligjit për rivlerësimin tranzitor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe për shkak të vonesave në caktimin e gjyqtarëve. Kohëzgjatja e tepruar e procedimeve gjyqësore, duke përfshirë ato pezull përpara Gjykatës së lartë për kërkesat individuale mund të jetë objekt i shqyrtimit të kësaj Gjykate në të ardhmen dhe mund të ketë ndikim në vlerësimin e përgjithshëm të efikasitetit të mjetit.

209. Në lidhje me ata kërkuess të cilët kishin paraqitur një kërkesë në Gjykatë në datën e dhënies së këtij vendimi, dhe zgjodhën një apelim ndaj vendimit të ATP-së, i cili përcaktonte vlerësimin financiar ose të mos dorëzonin asnjë nga dokumentet që mundonin brenda afateve statutore, Gjykata vëren se sipas publikimit zyrtar të ligjit për pronën 2015, kërkuessit janë bërë me dijeni për datën e hyrjes së tij në fuqi (*shih, mutatis mutandis, Brica dhe Texier-Micault kundër Francës, nr. 27928/2, dhe 31694/02, §20, 21 tetor 2003*). Kërkuessit kishin alternativën e hapur, ku që prej datës së hyrjes në fuqi ata do të respektonin kërkesat statutore të parashikuara në ligjin për pronat 2015 në vend të dyshonin *a priori* efikasitetin e mjetit të ri të prezantuar në sistemin ligjor të shtetit të paditur si përgjigje ndaj vendimit pilot *Manusbaqe Puto dhe të tjerët*. Në vijim, Gjykata nënvizon se duke marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës Kushtetuese, i cili rrëzonte një kërkesë për pezullimin e zbatimit të ligjit për pronat 2015, si të pabazuar dhe e deklaroi ligjin për pronat 2015 si të sigurt nga aspekti kushtetues për nenet e tij 6§§3 dhe 5, do të ishte e drejtë dhe e arsyeshme që kërkuessit të moslejoreshin të merrnin rekursin e tij. E thënë ndryshe, kjo mund të sillte një diferencim të padrejtë në trajtimin për ata ish-pronarë të cilët kishin respektuar kërkesat e mjetit të ri të brendshëm. Pavarësisht kësaj, për respektimin e pragut prej 10% për shumën e kompensimit (*shih paragrafin 196 më sipër*), kërkuessit duhet të kenë mundësinë e hapur të kërkojnë rregullimin e kompensimit sipas rregullave të zbatueshme që do të miratoheshin për këtë qëllim.

210. Në ligjin për pronat 2015, të zbatuar nga urdhri i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Financave, parashikohet pagesa e një tarife (*shih paragrafin 109 më sipër*), megjithatë Gjykata është e mendimit se kërkesa, që kërkuessit të paraqesin një vetëdeklarim të noterizuar nuk përbën një pengesë të madhe për realizimin e thelbit të së drejtës së tyre. Ata nuk provonin se kostot për përgatitjen e vetëdeklarimit të noterizuar ishin frenuese. Gjykata po ashtu nuk bindet se detyrimi për të dorëzuar prova dokumentuese mbështetëse përbën një pengesë të madhe për realizimin e të drejtave të tyre.

211. Në lidhje me afatin 10-vjeçar për pagesën e plotë të kompensimit, Gjykata është e mendimit se edhe pse kërkuessit mund të duhet të presin për një sërë vitesh të marrin shumat e kompensimit plotësisht, sistemi i ndryshimit të kompensimit mund të pranohet në rrethana përjashtuese të kësaj çështje dhe në vetvete do të vinte në dyshim efikasitetin e mjetit ose do të ishte në kundërshtim me kërkesën për kohë të arsyeshme, të garantuar nga neni 6 i Konventës (*shih, Knežević dhe të tjerët kundër Bosnjë-Herzegovinës (vendim), nr. 15663/12, §15, 14 mars 2017 dhe Preda dhe të tjerët, cituar më sipër, §131; në*

kontrast me Đurić dhe të tjerët kundër Bosnjë-Hercegovinës, nr. 79867/12 dhe 5 të tjerë, §30, 20 janar 2015).

212. Për sa ka të bëjë me vonesat në të shkuarën, Gjykata vëren se mjeti i paraqitur në vitin 2017 (*shih paragrafin 117 më sipër*) është përgatitur për të adresuar, midis të tjerash, çështjen e moszbatimit ose vonesës në zbatim të vendimeve të formës së prerë në një mënyrë efikase dhe të kuptimtë, duke marrë në konsideratë kërkesat e Konventës sipas nenit 6§1. Në këtë aspekt, Gjykata ka vendosur se vendimet administrative për pronën janë “të formës së prerë” sipas nenit 6§1 të Konventës, për aq kohë sa mbesin të pakundërshtuar dhe “gjenerojnë të drejta të cilat janë të formës së prerë dhe të zbatueshme” (*shih, për shembull, Ramadhi dhe të tjerët, cituar më sipër, §36; Hamzaraj (nr. 1), cituar më sipër, §26; Nuri, cituar më sipër, §28*). Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se pa paragjykim ndaj shqyrtimit të efikasitetit të këtij mjeti në të ardhmen, në parim kërkuessit do ta kishin të hapur mundësinë të kërkonin lehtësim për stresin dhe tensionin e shkaktuar nga mosekzekutimi i tejzgjatur i autoriteteve i vendimeve të formës së prerë në çështjet e tyre respektive. Në këtë mënyrë, për të parandaluar vonesa të tjera në këtë kontekst, Gjykata është e mendimit se kjo çështje mund të adresohet në mënyrën e duhur duke prezantuar një skemë të thjeshtësuar për dhënien e kompensimit jomonetar për ish-pronarët, duke përfshirë kërkuessit në çështjen në fjalë, duke iu kushtuar vëmendje praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate (*shih, për shembull, Cocchiarella kundër Italisë [DHM], nr. 64886/1, §GJEDNJ 2006-V; Scordino kundër Italisë, (nr. 1) [DHM], nr. 36813/97; §204-06, GJEDNJ 2006-V; Bizjak kundër Sllovenisë (vendim), nr. 25516/12, 39–4 3, 8 korrik 2014; dhe Knežević dhe të tjerët (vendim), cituar më sipër, §11 dhe 15–16*).

213. Së fundmi, nga raporti i Komisionit Parlamentar rezulton se grupet e interesuar, përveç grupeve të tjera të interesit, janë ftuar të paraqesin komente për projektligjin e ri. Qeveria parashtrroi se ajo kishte organizuar tavolina të rrumbullakëta, duke ftuar përfaqësues të shoqatave të ish-pronarëve. Edhe duke hamendësuar se e drejta për konsultim nuk ishte ushtruar me efikasitet, Gjykata është e kënaqur se shoqatat e ish-pronarëve ishin midis ankuesve, të cilët ushtronin me efikasitet të drejtën për ankesë në Gjykatën Kushtetuese. Në lidhje me këtë, Gjykata është e mendimit se vota jo me shumicë e Gjykatës Kushtetuese, në lidhje me ankesën e ankuesve për nenin 7 të ligjit për pronat 2015, nuk shkelte të drejtën e kërkuessve për cilado procedime të brendshme, të lidhura me shkelje të pretenduara të të drejtave individuale të garantuara nga Konventa. Procedimet kushtetuese u ndërmorën nga shoqatat e ish-pronarëve dhe lidheshin *in abstrakto* me një shqyrtim kushtetues të dispozitave të ligjit për pronat 2015 (krahaso *Marini kundër Shqipërisë*, nr. 3738/02, §§118-23, 18 dhjetor 2007, në të cilin kërkuessi ndikohej personalisht dhe drejtpërdrejt si rezultat i votës jo me shumicë i Gjykatës Kushtetuese në procedime për likuidimin e kompanisë në të cilën ai ishte aksionar). Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese rezulton të ketë zbatuar nenin e ri 7§4 të ligjit për Gjykatën Kushtetuese, kur rrëzonte ankesën për nenin 7 të ligjit për pronën 2015 (*shih paragrafin 115 më sipër*).

214. Për këtë arsye, Gjykata konstaton se sipas arsyeve të përshkruar më sipër, nuk dalin problematika në lidhje me aksesueshmërinë dhe efikasitetin e mjetit të parashikuar në ligjin për pronat 2015.

d) Përfundim

215. Gjykata, duke marrë në konsideratë parashtrimet e mësipërme dhe miratimin e rezolutës së Komitetit të Ministrave në përmblyllje të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët (shih paragrafin 128 më sipër)*, konstaton se mjeti i paraqitur me anë të ligjit për pronat 2015, është efikas sipas nenit 35§1 dhe nenit 13 të Konventës.

ii. Në lidhje me detyrimin e kërkuessve për të shteruar mjetin e brendshëm

216. Gjykata kujton parimin e saj të përgjithshëm, të nënvizuar në paragrafin 177 më sipër. Në të tilla raste, Gjykata i deklaronte çështjet pasuese të papranueshme për mosshkrim të mjeteve të brendshme dhe “i rikthente në origjinë” këto çështje te Qeveria e paditur përkatëse.

217. Duke i dhënë rëndësi karakterit ndihmues të rolit të saj, Gjykata është e mendimit se këtu zbatohet përjashtimi për arsyet e mëposhtme. Fillimisht, Gjykata e konsideron me rëndësi që autoritetet e miratuan ligjin për pronat 2015, i cili ishte përgatitur për të adresuar çështjen e zbatimit të

së drejtës së ish-pronarëve për kompensim në një mënyrë efektive dhe të kuptimtë, duke marrë në konsideratë kërkesat e Konventës, si përgjigje ndaj vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*. Do të ishte në një linjë me shpirtin dhe logjikën e vendimit pilot që kërkuarit të ankoreshin për moszbatim të së drejtës së tyre për kompensim, në rast se padia do të mund të korrigjonte ankesat e tyre me anë të ligjit për pronat 2015. Së dyti, Gjykata i jep rëndësi të veçantë faktit se ligji për pronat 2015 zbatohet për të gjithë individët të cilët kishin paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Strasburgut përpara hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2015. Së fundmi, Gjykata thekson se detyra e saj, e parashikuar në nenin 19 të Konventës, nuk do të përmbushej më së miri duke i çuar këto çështje për gjykim tek autoritetet e brendshme, jo më t'i shqyrtonte ato paralelisht me procedimet e brendshme.

218. Duke marrë në konsideratë nënvizimet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuarve në kërkesat nr. 29026/06, 3165/08, 56956/10, 29127/11, 5915/14, 53846/14, dhe 537/15 iu kërkohej ose i kërkohej të shfrytëzojnë mjetet e brendshme të parashikuara në ligjin për pronat 2015, në përputhje me rregullat e brendshme përkatëse. Për më tepër, ajo nuk konstaton rrethana përjashtuese që i përjashton ata nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme. Në këtë mënyrë, kërkesa e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 duhet të kundërshtohet sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

219. Në lidhje me kërkuarit në kërkesat nr. 8904/12, 6311/12, 67059/14 dhe 72755/14, Gjykata konstaton se në lidhje me faktin që procedimet e brendshme janë pezull përpara gjykatave të brendshme, do të ishte e parakohshme për Gjykatën të merrej me ankesën e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1, i cili duhet të kundërshtohet sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës.

220. Në lidhje me kërkuarit, në kërkesën nr. 57152/14, Gjykata konstaton se për sa i përket pagesës së plotë të kompensimit, ata nuk mund të pretendojnë të jenë “viktimë” e shkeljeve të të drejtave të Konventës. Ankesa e tyre sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 është e papajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës sipas interpretimit të nenit 35§3 (a) të Konventës dhe për këtë arsye duhet të kundërshtohet sipas nenit 35§4.

221. Sipas konstatimeve të saj, në paragrafët 215 më sipër, Gjykata nënvizon se ankesa e kërkuarve sipas nenit 13 të Konventës është dukshëm e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

222. Pozicioni i Gjykatës mund t'i nënshtrohet rishikimit në të ardhmen, veçanërisht, në varësi të mundësisë së autoriteteve për të demonstruar se mjetet e parashikuara në ligjin për pronat 2015, duke përfshirë mundësinë e tyre, për të: i. trajtuar pothuajse 7,000 padi pronash të mbetura pezull në një mënyrë efektive (*shih paragrafin 183 më sipër*), ii. ofruar kompensim jo më pak se 10% të vlerës për të cilën kërkuarit do të kishin pasur të drejtë, nëse do të kryhej vlerësimi financiar sipas kategorisë kadastrale aktuale të pronës së shpronësuar (*shih paragrafët 196 më sipër*); dhe iii. parashikojë indeksimin e shumës së kompensimit deri në pagesën përfundimtare (*shih paragrafin 202 më sipër*), të vijojnë të respektojnë kërkesat e Konventës në praktikë.

III. ANKESË SIPAS NENIT 6§1

223. Ankuesit u ankuan se ishte shkelur neni 6§1 i Konventës, për shkak të: i. moszbatimit nga autoritetet e vendimeve të formës së prerë, të cilat njihnin të drejtën e tyre për kompensim, dhe ii. zbatimi retroaktiv i ligjit për pronat 2015 për të zbatuar vendimet administrative të formës së prerë, të cilat kishin marrë fuqinë e *res judicata* (çështjes së gjykuar). Neni 6§1 i Konventës, në pjesët relevante, parashikon si më poshtë:

“1. Çdo person ka të drejtë që Çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga një gjykatë ... në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”

224. Duke iu referuar konstatimeve të saj në paragrafët e mëparshëm, se ligji për pronat 2015 parashikon se kërkuarit kanë ose kishin akses në Gjykatë ose morën kompensim të plotë, Gjykata është e mendimit se ankesa e kërkuarve në lidhje me pretendimin për mosekzekutim nga autoritetet të vendimeve të formës së prerë, ku njihet e drejta e kërkuarve për kompensim është qartazi e pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

225. Në lidhje me ankesën e kërkuësve për ndërhyrje të pretenduar legjislativë, me zbatimin e vendimeve të formës së prerë, Gjykata vazhdimisht ka gjykuar se teksa në parim legjislativa nuk përjashtohet në çështjet civile nga miratimi i dispozitave të reja retrospektive për të rregulluar të drejtat që dalin sipas ligjit ekzistues, parimi i shtetit të së drejtës dhe nocioni i gjykimit të drejtë, parashikuar në nenin 6, përcakton çdo ndërhyrje nga legjislativa – me përjashtim të arsyeve detyruese të interesit të përgjithshëm – me administrimin e drejtësisë të programuar për të ndikuar në përcaktimin gjyqësor të një mosmarrëveshjeje (*shih midis të tjerësh, Rafineritë greke Stran dhe Stratis Andreadis, cituar më sipër, §49; Zielinski dhe Pradal dhe Gonzales dhe të tjerët kundër Francës [DHM], nr. 24846/94, dhe 9 të tjerë, §57, GJEDNJ 1999-VII dhe Scordino (nr. 1), cituar më sipër, §29*). Vetë trajtimet financiare nuk mund të justifikojnë legjislativën të vetzëvendësimit me gjykatat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (*shih Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 48357/07 dhe 3 të tjerë, §76, 24 qershor 2014*).

226. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, Gjykata rithekson se ligji për pronat 2015 nuk ndikon në negativisht në vendimet e formës së prerë të cilat kishin përcaktuar shumën e kompensimit që do t'i jepej ish-pronarëve ose që kishin urdhëruar rikthimin në natyrë për ish-pronarët. Në lidhje me vendimet pa kuant, Gjykata është e kënaqur që ligji për pronat 2015 lë në fuqi të drejtën e ankuesve për kompensim (*shih paragrafin 186 më sipër*). Gjykata nuk është e bindur se vendimet pa kuant, të cilat parashikojnë se ish-pronarët duhej të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, jepnin efekte *res judicata* ose për sa i përket formës precize të kompensimit të shumës së kompensimit që do të jepej në çështje individuale, duke i kushtuar rëndësi faktit se realizimi i kompensimit do të varej nga zbatimi i vendimeve rregullatore dhe vendimmarrja administrative diskrecionale (*shih, në lidhje me këtë, Manushaqe Puto dhe të tjerët, cituar më sipër §§35–40*).

227. Gjithashtu, Gjykata është e mendimit se teksa ligji për pronat 2015 paraqiste një mjet të ri sipas të cilit vendimet pa kuant do të ishin objekt i vlerësimit financiar, duke iu referuar kategorisë kadastrale të pronës në kohën e shpronësimit, zbatimi i tij retroaktiv nuk synojë specifikisht për ndonjë kërkesë individuale – jo më pastaj kërkesat individuale të çështjes në fjalë, procedimet e së cilës ishin përfunduar përpara ekzekutimit dhe datës së hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2015 – por përbënte përgjigjen globale të autoriteteve ndaj vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, duke i bërë thirrje shtetit të “siguronte një mënyrë efikase të drejtën për kompensim” për të paktën 26,000 vendime të cilat autoritetet i kishin identifikuar në vijim (*shih paragrafin 38 më sipër*). Gjykata vëren se mund të thuhet se në rrethanat e çështjes në fjalë, kërkuësit mund të kishin parashikuar një reagim nga legjislativi i brendshëm (*shih, për shembull, National and provincial Building Society, Leeds Permanent Building Society and Yorkshire Building Society kundër Mbretërisë së Bashkuar, 23 tetor 1997, §112, raportet e gjykimeve dhe vendimeve 1997-VII dhe OGIS–Institut Stainlas, OGEIC Saint-Pie X dhe Blanche de Castille dhe të tjerët kundër Francës, nr. 42219/98, dhe 54563/00, §72, 27 maj 2004*).

228. Në vijim, Gjykata është e kënaqur, sepse sipas përfundimeve të saj në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1, miratimi i ligjit për pronat 2015 nuk ishte i motivuar vetëm nga konsiderata financiare, por nga nevoja për të ofruar një zgjidhje afatgjatë për mosgarantimin për një kohë të gjatë nga ana e shtetit për të siguruar zbatimin e shumicës dërrmuese të vendimeve për kompensimin e pronës, duke i kushtuar vëmendje konsideratave komplekse sociale, ligjore dhe ekonomike (*shih paragrafët 193 dhe 194 më sipër*). Për këtë arsye, Gjykata është e mendimit se miratimi i një ligji të ri për pronat me efekte retroaktive i përgjigjej justifikimit të interesit të dukshëm dhe detyrues publik (*shih, për shembull, Forrer-Niedenthal kundër Gjermanisë, nr. 47316/99, §§63-64, 20 shkurt 2003; kerabaso Zielinski dhe Pradal dhe Gonzales dhe të tjerët, cituar më sipër, §§58-60, Scordino (nr. 1), cituar më sipër, §§126-33, GJEDNJ 2006-V; De Rosa dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 52888/08 dhe 13 të tjerë, §§47-55, 11 dhjetor 2012; Azienda Agricola Silverfunghi S.a.s dhe të tjerët, cituar më sipër, §88; dhe më e fundit, Cicero dhe të tjerët kundër Italisë, nr. 29483/11 dhe 4 të tjerë, §§29-34, 30 janar 2020, nuk është ende i formës së prerë*).

229. Sipas rastit, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë është dukshëm e pabazuar dhe duhet të kundërshtohet sipas nenit 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

Vëllimi III, 2020-2021

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos të bashkojë kërkesat;
- I deklaron kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 7 maj 2020.

Stanley Naismith
Sekretar

Robert Spano
Kryetar

Shtojcë

LISTA E KËRKESAVE

Nr.	Kërkesa nr.	Emri i çështjes	Dorëzuar më	Kërkuesi	Kombësia	Përfaqësuar nga
1	29026/06	Beshiri kundër Shqipërisë	14.7.2006	Agim Beshiri ⁵ Makbule Beshiri ⁶ Suleiman Beshiri Ylber Beshiri Lumnije Beshiri ⁷	shqiptar shqiptare shqiptar shqiptar shqiptare	Sokol Puto
2	3165/08	Cale kundër Shqipërisë	7.1.2008	Theodhoraq Cale Gjergji Cale Spiro Cale Stefanaq Cale	shqiptar shqiptar shqiptar shqiptar	Gjergji Cale
3	56956/10	Foundos dhe Kallinikos kundër Shqipërisë	27.9.2010	Albert Foundos Louis Foundos Viola Kallinikos	amerikan amerikan amerikan	Artan Hajdari
4	29127/11	Maci dhe të tjerët kundër Shqipërisë	26. 3.2011	Gezim Maci Maksim Lesko Hatlije Llagami ⁸ Ardian Maci Skender Bylyku Mahmudije Golia ⁹	shqiptar shqiptar shqiptare shqiptar shqiptar shqiptare	Elton Gongo
5	6311/12	Perja kundër Shqipërisë	10.1.2012	Silva Perja	shqiptare	Artan Hajdari
6	8904/12	Karapici dhe të tjerët kundër Shqipërisë	19.1.2012	Gani Karapici Sabri Jella ¹⁰ Bukurie Sopot Drita Bozgo Fatmira Elmazi Pranvera Zgjani Shkendi Zgjani Andi Zeqiraj Merjeme Turdiu ¹¹ Zana Jella Ema Jella Hasan Jella ¹² Eleen Jella Bernice Jella Hysni Jella (Karapici) Mary Jela (Yella) Shpresa Haxhiu Lumturi Sorra Saemira Taushani Aldona Brahimmuco Admir Sorra Arjana Strati Luella Gunbardhi Diana Sorra	shqiptar shqiptar shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptar shqiptar shqiptar shqiptare shqiptare shqiptar shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare shqiptar shqiptare shqiptare shqiptare shqiptare	Sokol Puto

⁵ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Dritan Beshiri, Hafize Beshiri dhe Shpresa Papadhima Beshiri.

⁶ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Bardhyl Reso dhe Flutura Petrela.

⁷ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Arjan Dervishi, Erna Bonati Dervishi dhe Linda Kumbaro Dervishi.

⁸ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Shpetim Llagami, Ismail Llagami, Eshref Llagami, Blend Llagami, Apostolia Llagami, Marcio Llagami dhe Ana Llagami.

⁹ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Hajten Meta, Fatmir Golia, Edmons Golia dhe Alben Golia.

¹⁰ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

¹¹ Zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Neraida Turdiu dhe Gazmend Turdiu.

¹² Ndarë nga jeta.

SEKSIONI I KATËRT

“ÇËSHËTJA SHARRA DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË”¹³

(ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12)

**VENDIM
STRASBURG
10 nëntor 2015**

Ky vendim është i formës së prerë por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Nona Tsotsoria, *kryetare,*

Ledi Bianku,

Paul Mahoney, *gjyqtarë,*

dhe Fatoş Aracı, *zëvendësregjistrar i Seksionit,*

pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, më 22 tetor 2015,

pasi ka vërejtur se çështja ligjore në fjalë në ankimet e mëposhtme, tashmë është objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §31 korrik 2012),

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar me 12 ankime (25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë nga 61 shtetas shqiptarë, bazuar në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Detajet e ankuesve dhe të përfaqësuesve janë të përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkangjitur vendimit.

2. Më 27 mars 2013, trashëgimtari i znj. Gurie Dvorani, i cili ishte njëri prej ankuesve të parë në ankimin nr. 4036/10, znj. Lejla Ago, me mbiemrin e vajzërisë Belli, shprehu dëshirën të ndiqte procedimet në emrin e saj. Më 30 shtator 2014, trashëgimtarët e znj. Tefta Agolli, e cila ishte njëra prej ankuesve të parë në ankimin nr. 20240/10, z. Ilir Shijaku dhe znj. Dëshira Keta, me mbiemrin e vajzërisë Shijaku, shprehën dëshirën të ndiqnin procedimet në emrin e saj. Më 13 mars 2015, trashëgimtarët e znj. Naide (Nahide) Shkodra, me mbiemrin e vajzërisë Frashëri, e cila ishte njëra prej ankuesve të parë në ankimin nr. 64399/09, znj. Rozafa Çabej, me mbiemrin e vajzërisë Shkodra dhe znj. Valbona Mardodaj, me mbiemrin e vajzërisë Shkodra, të caktuara me anë të një testamenti, shprehën dëshirën e tyre për të ndjekur procedimet në emrin e saj. Për arsye praktike, ankueset znj. Gurie Dvorani, znj. Tefta Agolli dhe znj. Naide (Nahide) Shkodra, me mbiemrin e vajzërisë Frashëri, do të vijojnë të referohen në këtë vendim si ankuese, edhe pse tashmë si të tillë do të konsiderohen trashëgimtarët e tyre (shih *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, §1, GJEDNJ 1999-VI dhe *Janoëic dhe të tjerët kundër Rusisë* [DHM], nr. 55508/07 dhe 29520/09, §§97-101, GJEDNJ 2013).

3. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga Agjentja e saj, znj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

4. Më 25 janar 2010 dhe 20 dhjetor 2–13, ankimet iu komunikuan Qeverisë.

5. Për sa u përket ankimeve nr. 64376/09, 64399/09, 12889/10 dhe 29442/10, Qeveria nuk dorëzoi vërejtje me shkrim brenda afatit kohor të lejuar.

6. Për sa u përket ankimeve nr. 347/10 dhe 33154/11, ankuesit nuk paraqitën kërkesa për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar.

¹³ Qendra e Botimeve Zyrtare nr. 105, Tiranë 2020, f. 6049.

FAKTE

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Ankimi nr. 25038/08: Sharra

7. Më 28 dhjetor 1994, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Vlorë (Komisioni) u njohu ankuesve dhe trashëgimtarëve të tjerë të drejtën mbi një sërë tokash të trashëguara me sipërfaqe prej 46, 750 metra katrorësh, nga e cila atyre u rikthyen 900 metra katrorë. Duke qenë se pjesa e mbetur e tokës ishte e zënë, Komisioni vendosi që ankuesja dhe trashëgimtarët e tjerë do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, për pjesën prej 45,850 metra katrorësh. Komisioni nuk mund të përcaktonte kufijtë e sipërfaqes së tokës prej 13,750 metra katrorësh, kështu nuk mori një vendim në lidhje me njohjen e të drejtave të ankueses mbi pronën e trashëguar.

8. Më 8 mars 2011, Gjykata shpalli vendimin për çështjen *Eltari kundër Shqipërisë*, nr. 16530/06, për mospagimin e kompensimit nga ana e autoriteteve për sipërfaqen e tokës prej 10,500 metra katrorësh, e cila ishte pjesë e vendimit të Komisionit.

9. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

B. Ankimi nr. 64376/09: Xibinaku dhe të tjerët

10. Më 21 mars 1996, Komisioni i Lushnjës i njohu ankuesit të drejtat mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 576 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një prej mënyrave të parashikuara me ligj. Ankuesit parashtruan se ata ishin trashëgimtarët që kishin mbetur për tokën e përmendur më sipër, për të cilën tashmë Gjykata kishte nxjerrë një vendim në çështjen *Hamzaraj kundër Shqipërisë (nr. 1)* (nr. 45264/04, 3 shkurt 2009).

11. Deri më sot, ankuesve nuk u është paguar asnjë kompensim.

C. Ankimi nr. 64399/09: Frashëri

12. Më 18 maj 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me sipërfaqe toke prej 1,000 metra katrorësh. Komisioni urdhëronte që toka i duhej kthyer plotësisht ankuesve. Më 11 shkurt dhe 14 dhjetor 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë ndryshoi vendimin e Komisionit dhe urdhëroi se ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, ku 200 metra katrorë u ishte kthyer. Duke qenë se pjesa e mbetur e tokës prej 800 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

13. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

D. Ankimi nr. 347/10: Maçi

14. Më 13 shtator 1996, Komisioni i Tiranës njohu, midis të tjerave, edhe të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, për një sipërfaqe toke me përmasën 16,500 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

15. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

E. Ankimi nr. 1376/10: Çoka

16. Më 25 tetor 1995, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, Tiranë, (Komisioni) njohu, midis të tjerave, të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar për një sipërfaqe toke prej 150,000 metra katrorësh, nga e cila atyre u kthye 120,300 metra katrorë. Duke qenë se sipërfaqja e mbetur prej 120,300 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

17. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

F. Ankimi nr. 4036/10: Dvorani dhe Dume

18. Më 10 dhjetor 1999, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 11,000 metra katrorësh, nga të cilët 10,100 metra katrorë do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

19. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

G. Ankimi nr. 12889/10: Asllani

20. Më 23 tetor 1996 dhe 24 prill 1998, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 9,950 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

21. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

H. Ankimi nr. 20240/10: Agolli

22. Më 7 korrik 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 800 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

23. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

I. Ankimi nr. 29442/10: Talipi (Peshkëpia)

24. Më 28 shkurt 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 335 metra katrorësh, nga e cila ankuesit iu rikthyen 162 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 173 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

25. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

J. Ankimi nr. 29617/10: Kati

26. Më 28 shkurt 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 910 metra katrorësh, nga e cila ankuesve u rikthyen 630 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 280 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

27. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

K. Ankimi nr. 33154/11: Vrioni

28. Më 21 dhjetor 1995 dhe 22 prill 1996, Komisioni i Beratit njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 3,435 metra katrorësh, nga e cila ankuesit iu rikthye 130 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 3,305 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

29. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

L. Ankimi nr. 2032/12: Lelo

30. Më 10 gusht 2007, Agjencia për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia), e cila kishte zëvendësuar Komisionin, i njohu ankuesit të drejtat mbi pronën e trashëguar me një sipërfaqe toke prej 14,400 metra katrorësh në Vlorë. Duke qenë se pjesa e tokës ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

31. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

II. L LIGJI PËRKATËS VENDËS

32. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse përshkruhen në detaje, *inter alia*, në vendimin *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§23-53, 31 korrik 2012) dhe *Ramadhi kundër Shqipërisë* (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007). Legjislacioni shtesë përkatës vendës përfshin, si më poshtë vijon:

A. Kushtetuta e Shqipërisë

33. Pjesa përkatëse e Kushtetutës parashikon si më poshtë vijon:

“Neni 41

“... ”

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.”

B. Akti i pronës 2004

34. Sipas nenit 13, ndryshuar me aktin nr. 55/2012, të datës 10 maj 2012, kompensimi duhet të përcaktohet bazuar në çmimin e tregut, me llojin e pronës dhe me përdorimin e saj të synuar.

C. Vendimet e Këshillit të Ministrave

1. *Mbi metodologjinë për vlerësimin e pronës së paluajtshme (VKM-ja nr. 658, e datës 26 shtator 2012)*

35. Vendimi përcakton metodologjinë dhe rregullat që duhet të përdoren për vlerësimin e pronës së paluajtshme. Në vendim pohohet se metodologjia e propozuar bazohet në standarde ndërkombëtare për vlerësimin e pronës së paluajtshme, sipas së cilave vlera e pronës është e barabartë me çmimin e kontratës së shitjeve.

36. Sipas vendimit, çmimi i kontratës së shitjeve tregon vlerën e tregut, në lidhje me llojin e pronës dhe përdorimin e saj të synuar. Zyra për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme (ZRPP) është përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së tregut bazuar në të dhënat zyrtare të cilat gjenden në kontratat e shitjeve të regjistruara gjatë një viti kalendarik. Gjatë çerekut të fundit të një viti kalendarik, ZRPP-ja grupon të dhënat sipas llojit të pronës, sipas çdo zone kadastrale dhe qarkut. ZRPP-ja ia përcjell informacionin Agjencisë rreth mesit të muajit nëntor.

37. Nga fundi i dhjetorit, Agjencia përpunon të gjitha të dhënat dhe ia dorëzon vlerësimet ministrit të Drejtësisë, i cili më pas kërkon miratimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave. Të dhënat përpunohen si më poshtë vijon: a) nxjerrja e çmimeve minimale dhe maksimale të kontratave të shitjeve për secilën tip prone dhe zone kadastrale; b) përlllogaritja e çmimit mesatar të kontratave të shitjeve për secilin tip të pronës dhe zone kadastrale; c) heqja e vlerave më të ulëta dhe më të larta (duke filluar nga një diferencë prej 5%) të kontratave të shitjeve; d) përlllogaritja e vlerës gjerësisht të tregtueshme (*moda*) – ajo vlerë e cila referohet më shpesh në kontratat e shitjeve – për secilën lloj prone dhe zone kadastrale, e nxjerrë nga numri total i kontratave të shitjeve; e) përlllogaritja e çmimit mesatar nxjerrë nga numri total i kontratave të shitjes. Ky proces çon në përlllogaritjen përfundimtare të vlerës së pronës së paluajtshme.

38. Numri minimal i kontratave të shitjeve për një zonë kadastrale është tre. Në një rast të tillë, vlera e pronës do të jetë çmimi mesatar, i cili është rezultat i tri kontratave. Në rast se nuk ka transaksione për një lloj të caktuar prone, në një zonë kadastrale, do të zbatohet një metodë përlllogaritjeje jo e drejtpërdrejtë, duke grupuar kontratat e shitjeve të regjistruara për atë lloj toke, në nivelin administrativ më të afërt, sipas këtij rendi nga më i ulëti te më i larti: komunë, bashki dhe rreth.

2. *Pasqyrë e metodologjisë nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore (administratën publike dhe të drejtat e njeriut)*

39. Më 29 prill 2015, Qeveria paraqiti regjistrimet e një takimi parlamentar të datës 7 maj 2012 të Komisionit për Çështjet Ligjore, ku, brenda kuadrit të një debati për projektligjin e ri për rikthimin dhe kompensimin e pronës, u diskutua, midis të tjerave, metodologjia për vlerësimin e pronës së paluajtshme, e cila duhej të miratohej.

40. Ministri i Drejtësisë konfirmoi qëllimin e Qeverisë për të ofruar kompensim në vlerën e tregut, përlllogaritja e të cilit do të bazohej në standardet ndërkombëtare vlerësimin e pronës së paluajtshme. Tri elementet, të cilat do të përdoreheshin për vlerësimin e pronës së paluajtshme ishin: çmimi i negociuar, lloji i pronës dhe përdorimi i saj i synuar. Vlerësimi i pronës do të përditësohej për çdo vit, në mënyrë që të reflektojë luhatjet e tregut.

41. Hartat e vlerësimit të pronës do të miratoheshin me anë të një vendimi të Qeverisë. Ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë pohuan se ndryshe nga metodologjia ekzistuese, në të cilën vlerat e pronës përlllogaritëshin bazuar në 20 dhe 30 faktorë dhe ku gjendeshin një sërë pasaktësish, metodologjia e propozuar do t'i shkëpuste të dhënat nga transaksionet kontraktuale të dakordësuara midis palëve private të regjistruara në ZRPP. Duke iu referuar numrit të duhur të të dhënave të mbledhura, një gjë e tillë do të garantonte një mundësi të ulët për gabime në vlerësimin e pronës dhe do të përjashtonte ndërhyrjen nga ana e Qeverisë në përcaktimin e vlerave të pronës.

42. U shprehën shqetësime për faktin nëse metodologjia duhej miratuar me anë të një vendimi të Qeverisë ose nëse duhej miratuar nga vetë Parlamenti. Lindi skepticizmi në lidhje me ekzistencën e një numri të mjaftueshëm transaksionesh, të cilat do të bënin të mundur vlerësimin e saktë të pronës. U shprehën edhe rezervat nëse transaksionet përfaqësonin vlerën reale të tregut, duke pasur parasysh se palët, në përgjithësi nuk deklarorin çmimin real të blerjeve/shitjeve për të shmangur taksat e larta.

Metodologjia e propozuar mund të ishte në dëm të pronarëve të mëparshëm, për sa i përket së drejtës së tyre për kompensim.

3. Në lidhje me hartat e vlerësimit të pronës në vitet 2013 dhe 2014

43. Sipas vendimeve për metodologjinë për vlerësimin e pronës së paluajtshme, të datave 6 mars 2013 dhe 30 korrik 2014, Qeveria miratoi dhe nxori harta të reja për vlerësimin e pronës, të cilat përfshinin çmimin e referencës për metër katror në të gjithë vendin (vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 187, i datës 6 mars 2013 dhe 514, i datës 30 korrik 2014).

III. MATERIALET E KËSHILLIT TË EVROPËS

44. Materialet që kanë lidhje me këtë çështje u referuan në vendimet e kësaj Gjykate, duke përfshirë *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08, §§15–17, 16 korrik 2015); *Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 37295/05 dhe 42228/05, §§12–13, 10 mars 2015); dhe *Karagozji dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§36-38, 8 prill 2014).

LIGJI

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

45. Duke qenë se të gjitha ankimet ngrenë të njëjtën çështje, Gjykata vendos se ato duhet të bashkohen në përputhje me rregullën 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENEVE 6§1 DHE 13 TË KONVENTËS, SI EDHE TË NENIT 1, TË PROTOKOLLIT NR. 1, TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME MOSZBATIMIN E VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË

46. Ankuesit pretendonin se ishin shkelur nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe neni 1 i protokollit nr. 1, të Konventës, për sa i përket moszbatimit të vendimeve vendëse të formës së prerë, të cilat u jepnin të drejtën për kompensim në vend të kthimit të pronave të tyre.

Për sa ka lidhje me çështjen konkrete, neni 6§1 i Konventës përcakton, si më poshtë vijon:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve ... çdo njeri ka të drejtën për një seancë ... dëgjimore ... nga [një] ... tribunal ...”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve, ose të gjobave të tjera.”

A. Pranueshmëria

47. Qeveria nuk e kontestoi pranueshmërinë e këtyre ankesave.

48. Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë të pabazuara në fakte, sipas interpretimit të nenit 35§3 (a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Cilësitë

49. Qeveria nuk debatoi në lidhje me cilësitë e ankesave dhe pranoi se ankimet ishin objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar bazuar në vendimin për çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër.

50. Sipas konstatimeve të saj, në çështjet e mëparshme kundër Shqipërisë, për të cilat Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë argument që do të përlligite shmangien e tyre (shiko midis të tjerave *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§93–97 dhe referencat cituar në vijim), Gjykata konstaton se

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

moszbatimi nga ana e Qeverisë e vendimeve vendëse të formës së prerë dhe veçanërisht mosrealizimi i pagesës për kompensimin e dhënë, shkelte të drejtat e ankuesve sipas nenit 6§1 dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

51. Gjithashtu, Gjykata vendos se nuk ka pasur asnjë kompensim vendës efikas, i cili do të mundësonte kompensimin e duhur dhe të mjaftueshëm për moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve vendëse të formës së prerë, të cilat përcaktonin një kompensim. Për këtë arsye, është shkelur neni 13 i Konventës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §72–84 dhe referencat cituar në vijim).

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME KOHËZGJATJEN E PROCEDIMEVE

52. Ankuesit, në ankimet nr. 64376/09, 64399/09, 1376/10, 4036/10, 29617/10 dhe 20240/10, në bazë të nenit 6§1, shprehën pakënaqësinë në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, për shkak të moszbatimit të vendimeve të Komisionit.

53. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte, sipas parashikimit të nenit 35§3(a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ankesa nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër dhe për këtë arsye e deklaroi atë të pranueshme.

54. Gjykata vendos se, sipas konstatimeve në paragrafët 49–51 më sipër, çështja e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të konsiderohet se është e përfshirë në çështjen e moszbatimit (shiko, për shembull, *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, §34, GJEDNJ 2002-II dhe *Popova kundër Rusisë*, nr. 23697/02, §44, 21 dhjetor 2006). Për këtë arsye, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme që çështja e kohëzgjatjes së procedimeve të shqyrtohet në mënyrë të ndarë.

IV. SHKELJE TË TJERA TË PRETEN-DUARA TË KONVENTËS

55. Në ankimin nr. 25038/08, ankuesja shprehu pakënaqësinë për një shkelje të të drejtave të saj mbi pronën, në lidhje me sipërfaqen e tokës prej 13,750 metra katrorësh. Gjykata vëren se në mungesë të njohjes së pronës së saj nga Komisioni, ankuesja nuk mund të argumentojë se ka një “kërkesë”, sipas parashikimit të nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës. Gjykata e deklaroi këtë ankesë të papajtueshme *ratione materiae* dhe e kundërshtoi atë në përputhje me nenin 35§3(a) dhe 4 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

56. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

1. Parashtrimet e palëve

a) Ankuesit

i. Vërejtje të përgjithshme

57. Ankuesit i kërkuan Gjykatës të zbatonte hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2008 për përlogaritjen e dëmit monetar. Ata parashtruan se hartat për vlerësimin e pronës të nxjerra në vitet 2013 dhe 2014 parashikonin një rritje të ndjeshme të çmimit të referencës. Për shembull, në sipërfaqet e tokës të pozicionuara në qendër të Tiranës kishte një rënie të ndjeshme të çmimit me 50%, ndërsa çmimi i referencës në një nga periferitë e Tiranës, Paskuqan, ishte rritur dhe ishte më i lartë se çmimi i një sipërfaqeje toke në qendër të qytetit. Sipas këndvështrimit të tyre, hartat e vlerësimit të vitit 2014 nuk i referoheshin vlerësimit të bazuar në treg dhe ishin miratuar me qëllimin e vetëm për të ulur çmimin e referencës. Të gjithë procesit i mungonte transparenca, sepse Qeveria nuk kishte ofruar të dhëna faktike, për mënyrën se si ishin realizuar përlogaritjet për përcaktimin e çmimit të referencës. Ata pretendonin, se në mungesë të shifrave mbi të cilat do të bëheshin komentet, Qeveria mund të kishte zgjedhur tri transaksionet me vlerën më të ulët, të cilat do të justifikonin një rënie drastike në çmimin e referencës. Në vijim, ankuesit argumentuan se harta e vlerësimit e vitit 2014 nuk duhet të përdoret në mënyrë retroaktive për ankimet e paraqitura përpara se kjo hartë të hynte në fuqi.

58. Ankuesit parashtruan se Qeveria nuk kishte marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, të cilat lindnin nga vendimi pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër. Ata argumentuan se Qeveria vepronte kundër interesave të pronarëve të mëparshëm, duke ulur çmimet e referencës. Duke u mbështetur në vendimin e kësaj Gjykate për çështjen *Karagjozi dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §64, ata nënvizuan faktin se Qeveria nuk kishte treguar se çmimet e referencës “reflektonin vlerën reale të tregut, së bashku me “indeksin për interesin dhe inflacionin”. Në vijim, ata parashtruan se në rast se çmimet nuk kishin rënie, sipas hartave të viteve 2013 dhe 2014, do të zbatohesh çmimi më i favorshëm i referencës. Gjithashtu, ata paraqitën raportet e ekspertëve, duke argumentuar se hartat e vlerësimit nuk reflektonin vlerën reale të tregut të pronës. Për përcaktimin e çmimit të referencës, ekspertët morën në konsideratë çmimin për metër katror të apartamenteve afër zonës, qiratë në zonën përreth, faktin se prona, deri në këto momente, pozicionohej në një zonë banimi dhe tregtare, supozimin se nuk kishte asnjë detyrim për t'u paguar për pronën dhe se ajo nuk prekej nga ndikimet e zhvillimit.

59. Disa ankues parashtruan se duke u bazuar në ankimin e tyre të paanshëm, hartat e vlerësimit të vitit 2014 barazonin në mënyrë të padrejtë statusin e pronarëve të mëparshëm të ligjshëm me statusin e pronarëve të cilët kanë bërë ndërtime të paligjshme. Sipas këndvështrimit të tyre, tregu, i cili nuk duhet të ndikohet nga ndërhyrjet e Qeverisë, duhet të përcaktojë vlerat e pronës. Në vijim, ata argumentuan se hartat e vlerësimit të pronave, të vitit 2014, nuk merrnin në konsideratë cilësitë e pronës, nuk ofronin interes shtesë për pagesat e vonuara, për dëmet jomonetare ose për kostot e procedurave ligjore dhe për shpenzimet e bëra nga ankuesit.

ii. Kërkesa specifike për çdo ankim

60. Ankuesit bënë kërkesa për dëmin monetar dhe jomonetar, të paraqitura në shtojcën nr. 2.

61. Në lidhje me ankimin nr. 25038/08, ankuesja parashtrroi se pjesa e saj ishte një e gjashtëmbëdhjeta e sipërfaqes së tokës prej 35,850 metra katrorësh. Ajo paraqiti raportin e një eksperti mbi dëmin monetar, sipas së cilit çmimi i referencës varioonte nga 161 EUR/metër katror deri në 200 EUR/metër katror.

62. Ankuesit në ankimin nr. 64376/09 parashtruan se ishin pjesa tjetër e trashëgimtarëve të së njëjtës sipërfaqe toke, për të cilën gjykata kishte akorduar kompensim në çështjen Hamzaraj, cituar më sipër (shih, gjithashtu, paragrafin 10 më sipër). Duke u bazuar në këtë vendim, ankuesit kërkuan një shumë prej 87,000 eurosh për dëmin monetar dhe jomonetar, si edhe për kostot dhe shpenzimet, pa dorëzuar një pasqyrë të detajuar për këto kërkesa. Ata parashtruan se zotëronin 576 metra katrorë të të gjithë pronës.

63. Në lidhje me ankimin nr. 64399/09, ankuesit pretendonin se çmimi i referencës ishte 120,000 lekë/metër katror. Ata argumentonin se zotëronin të gjithë pronën.

64. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, ankuesit parashtruan kërkesat e tyre për kompensim, pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar për atë qëllim (shiko edhe paragrafin 6 më sipër). Duke u bazuar në raportin e ekspertit, ata parashtruan se çmimi i referencës ishte 30,059 lekë/metër katror për ankimin nr. 347/10 dhe 25,000 lekë/metër katror për ankimin nr. 33154/11.

65. Ankuesit, në ankimet nr. 4036/10 dhe 29617/10 paraqitën edhe raportet e ekspertëve. Në lidhje me ankimin nr. 4036/10, ankuesit parashtruan se të dyja hartat e vlerësimit të vitit 2008 dhe të vitit 2013 parashikonin të njëjtin çmim reference, i cili ishte 10,000 lekë/metër katror. Megjithatë, duke u bazuar në raportin e ekspertit, ata pretendonin se çmimi i referencës ishte 13,246.8 lekë/metër katror. Për sa i përket ankimit nr. 2961/10, ankuesit pretendonin se çmimi i referencës ishte 1,466 euro/metër katror.

66. Në lidhje me ankimin nr. 1376/10, ankuesit kërkuan që Gjykata të aplikonte çmimin e referencës prej 20,473 lekësh/metër katror, paraqitur në hartat e vlerësimit të vitit 2008, në vend të çmimit të referencës prej 9,274 lekësh/metër katror në hartat e vlerësimit të vitit 2013. Ata zotëronin dy të pesëmbëdhjetat e sipërfaqes së tokës.

67. Gjithashtu, në lidhje me ankimin nr. 12889/10, ankuesi pretendonte se çmimi i referencës ishte 14,500 lekë/metër katror, për pjesën e tij prej një të dhjetave, për ankimin nr. 29442/10 çmimi ishte 12,000 lekë/metër katror dhe për ankimin nr. 20240/10 çmimi ishte 857 euro/metër katror.

68. Për sa i përket ankimit nr. 2032/12, ankuesi kërkoi që Gjykata të aplikonte çmimin e referencës prej 11,523 lekësh/metër katror sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2013, në vend të çmimit të referencës prej 10,000 lekësh/metër katror, sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2008.

b) Qeveria

i. Vërejtje të përgjithshme

69. Qeveria i kërkoi Gjykatës të aplikonte hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014, për përlllogaritjen e dëmit monetar. Qeveria parashtroi se hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2014 ishin realizuar bazuar në vendimin e Qeverisë për metodologjinë e vlerësimit të pronës së paluajtshëm (VKM-ja nr. 658, e datës 26 shtator 2012). Në përputhje me atë vendim, përditësimi i përvitshëm i hartave bazohej në të dhënat e paraqitura nga ZRPP-ja bazuar në transaksionet financiare, që janë kontratat e shitjeve, të regjistruara për çdo zonë kadastrale. U përdorën tri kritere për përlllogaritjen e vlerës së pronës së një zone kadastrale, të cilat konkretisht janë: çmimi i tregut, tipi i pronës dhe përdorimi i saj i synuar. Vlera e pronës reflektonte çmimin mesatar të kontratave të shitjes në një zonë kadastrale.

70. Qeveria pranoi se hartat e vlerësimit të pronave, të vitit 2014, paraqisnin çmime më të ulëta reference se sa ato të vitit 2008. Një rënie e tillë mendohej se shkaktohej nga kriza ekonomike në Evropë, e cila kishte ndikuar edhe në tregun e pronës në Shqipëri dhe në metodologjinë e përmirësuar, e cila po zbatohet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Më tej, Qeveria parashtroi se hartat e vlerësimit të pronës i ishin referuar dhe përdorshin sipas shpronësimit të pronarëve të ligjshëm dhe legjislacionit për ndërtesat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Sipas opinionit të Qeverisë, hartat e vlerësimit 2008 nuk reflektonin realitetin.

71. Sipas opinionit të Qeverisë, dëmi monetar duhet të përlllogaritet duke marrë në konsideratë llojin e tokës në momentin e konfiskimit dhe/ose kalimit të saj në pronësi të shtetit. Vlerësimi i saj nuk duhet të bazohet në natyrën e ndryshuar të tokës, ashtu siç ishte për momentin.

ii. Komente specifike për çdo ankim

72. Për sa i përket ankimit nr. 25038/08, Qeveria parashtroi se ankuesi duhet të kompensohet për një të njëzetën e të gjithë pronës, sipas hartave të vlerësimit për vitin 2008. Më tej, Qeveria shtoi se një sipërfaqe toke prej 442 metra katrorësh, e cila i ishte rikthyer ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë, bazuar në vendimin e datës 5 maj 2009, duhej zbritur.

73. Për sa u përket ankimeve nr. 64376/09, 64399/09, 12889/10 dhe 29442/10, Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment për pretendimet e ankuesve për kompensim brenda afatit kohor të përcaktuar për atë qëllim (shiko paragrafin 5 më sipër).

74. Për sa u përket ankimeve 347/10 dhe 33154/11, Qeveria i kërkoi Gjykatës të mos akordonte asgjë, përderisa ankuesit nuk paraqitën pretendimet e tyre për kompensim brenda afatit kohor të përcaktuar nga Gjykata. Por si një alternativë për këtë situatë, Qeveria parashtroi se në rast se Gjykata i pranonte parashtrimet e vonuara të ankuesve, ata do të duhej të kompensoheshin bazuar në çmimet e referencës në hartat e vlerësimit të vitit 2014, në shumën prej 3,667 lekësh/metër katror, për ankimin nr. 33154/11. Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment në lidhje me pretendimin e ankuesve për kompensim, lidhur me ankimin 347/10.

75. Në lidhje me ankimin nr. 1376/10, Qeveria deklaroi se, për momentin, sipërfaqja e tokës së ankuesve ndodhej në zonën kadastrale, e cila përbëhej vetëm prej një toke trualli, çmimi i referencës të së cilës ishte 38,359 lekë/m². Zona kadastrale nuk tregonte ndonjë çmim reference për tokën bujqësore. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në kohën e konfiskimit trualli ishte tokë bujqësore, Qeveria propozoi që të zbatohet çmimi i referencës për tokën bujqësore krahasuar me një zonë tjetër kadastrale më afër, çmim i cili është 551 lekë/m².

76. Qeveria paraqiti të njëjtat parashtrime në lidhje me ankimet nr. 4036/10 dhe 2032/12. Qeveria deklaroi se, për momentin, tokat e ankuesve pozicionoheshin në një zonë kadastrale, e cila përbëhej

vetëm nga tokë trualli, çmimet e referencës të së cilës, sipas hartave të vlerësimit për vitin 2014, ishin 8,413 lekë/m², për ankimin nr. 4036/10 dhe 8,300 lekë/m² për ankimin nr. 2032/12. Zonat kadastrale nuk kishin ndonjë çmim reference për tokën bujqësore. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në kohën e konfiskimit tokat kishin qenë bujqësore, ata propozonin që të duhej të zbatohesh çmimi i referencës për tokën bujqësore për nivelin më të afërt administrativ, i cili është 102 lekë/m², në lidhje me ankimin nr. 4036/10 dhe 281 lekë/m², në lidhje me ankimin nr. 2032/12.

77. Për sa u përket ankimeve nr. 20240/10 dhe 29617/10, Qeveria parashtroi se ankuesit duhej të kompensoheshin sipas hartës së vlerësimit të vitit 2014. Për të dyja ankimet, çmimi i referencës ishte 57,126 lekë/m², sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2014.

2. Vlerësimi i Gjykatës

78. Sipas natyrës joefikase të sistemit aktual të kompensimit dhe duke marrë në konsideratë, veçanërisht, faktin se ka kaluar një periudhë kohore prej 8 deri 21 vjetësh, që prej momentit kur ankuesve iu dha kompensim për herë të parë, pa paragjykuar zhvillimet e mundshme në të ardhmen për një mekanizëm efikas për kompensim, Gjykata është e mendimit se është me vend që ankuesve t'u jepet një shumë e cila do të ishte një zgjidhje përfundimtare dhe shteruese e çështjeve.

79. Gjykata përsërit parimin e saj se dëmi monetar i akorduar në rastet e shpronësimit të paligjshëm duhet të korrespondojë me vlerën aktuale të pronës, nëse nuk është e mundur *restitutio in integrum* (shiko *Brumărescu kundër Rumanisë* (kompensim i drejtë) [DHM], nr. 28342/95, §§19–24, GJEDNJ 2001-I, dhe *Scordino kundër Italisë* (nr. 3) (kompensim i drejtë)).

80. Gjykata shqyrtoi një problematikë të ngjashme në çështjen *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§33–39, 7 dhjetor 2010, në të cilën ajo arsyetoi dhe arriti në përfundimin se, në rastin e shpronësimeve të paligjshme, si në rastin e ankimeve konkrete, për të cilat autoritet akorduan kompensim në vend të rikthimit të plotë të pronës, shuma e kompensimit do të korrespondonte me vlerën aktuale të pronës.

81. Në çështjen *Vrioni dhe të tjerët* (kompensim i drejtë), cituar më sipër, Gjykata akordoi kompensim, bazuar në hartat e vlerësimit të pronës, miratuar në vitin 2008. Kjo mënyrë e përllogaritjes së dëmit monetar është zbatuar vazhdimisht në të gjitha gjykimet në vijim, miratuar nga Gjykata (shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §125; *Delvina kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 49106/06, §17, 21 maj 2013; *Karagozji dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §§63 dhe 65; *Siliqi dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §27; dhe *Metalla dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §37).

82. Në rastin konkret, Gjykata duhet të përcaktojë nëse duhet t'u referohet hartave për vlerësimin e pronës së viti 2008 ose atyre të vitit 2014 për përllogaritjen e dëmit monetar. Pasi ka shqyrtuar argumentet e palëve, Gjykata bën vërejtjet e mëposhtme.

83. Vendimi pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, në lidhje me mospagimin e kompensimit nga autoritetet në vend të rikthimit të pronës, u dha nga Gjykata më 31 korrik 2012. Ky vendim u bë i formës së prerë më 17 dhjetor 2012. Në paragrafin e tij 121 dhe në parashikimin në fuqi nr. 7, Gjykata vendosi të mos i pezullonte procedimet e çështjeve dorëzuar përpara daljes së atij vendimi, por të vazhdohej me shqyrtimin e tyre, pasi vendimi të bëhej i formës së prerë. Në lidhje me këtë situatë, ankimet aktuale u paraqitën në Gjykatë nga 15 maj 2008 deri më 19 dhjetor 2011. Vini re se ankimet iu dhanë Qeverisë më 25 janar 2010 dhe 20 dhjetor 2013 (shiko paragrafin 4 më sipër).

84. Gjykata u kushton vëmendje argumenteve të Qeverisë në favor të ankimit për hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 për përllogaritjen e dëmit monetar. Ajo mbështet faktin se vlerësimet e pronës janë (pretendohen të jenë) përditësuar çdo vit, në bazë të një metodologjie, e cila u miratua me vendim të Qeverisë në vitin 2012. Megjithatë, Gjykata nuk u bind nga propozimet e Qeverisë.

85. Pikë së pari, hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 u miratuan pas paraqitjes së ankimeve aktuale, të cilat po shqyrtohen në përputhje me udhëzimet e dhëna në vendimin pilot. Sipas Gjykatës, referenca të harta e vlerësimit të vitit 2014, do të linte vend për pabarazi gjatë trajtimit të ankuesve për sa i përket çmimit të referencës.

86. Së dyti, Gjykata do t'u referohej argumenteve të shprehura gjatë takimit parlamentar të datës 7 maj 2012, për shkakun se shitblerjet e regjistruara në ZRPP, nuk e reflektonin në përgjithësi dhe

domosdoshmërisht vlerën reale të tregut si rezultat i evazionit të taksave mbuluar nga palët sipas kontratës së shitjeve. Për pasojë, Gjykata mendon se referimi i plotë në çmimet e shitjeve të shitblerjeve të regjistruara nuk do të ishte aspak në zbatim të parimit se kompensimi, në rastet e shpronësimit të paligjshëm, duhet të jetë në përputhje me vlerën e tregut, për këtë arsye Gjykata ka ndërmarrë edhe masa për të parandaluar dhe luftuar evazionin e taksave.

87. Së treti dhe e lidhur ngushtë me arsyen e dytë, Gjykata është e shqetësuar, se çmimet e pronës në disa qytete, veçanërisht në zonat të cilat po njohin një zhvillim relativisht në rritje, si për shembull qendra e Tiranës, kryeqytetit, kanë shënuar një rënie të ndjeshme. Gjykata nuk është në pozicionin të spekulojë arsyet për një rënie të tillë, por nuk është e bindur se ato reflektojnë në mënyrë objektive vlerën aktuale të tregut dhe se ishin “të indeksuar me interesin dhe inflacionin”, për të kompensuar dëmin të shkaktuar nga pamundësia për kompensim gjatë gjithë këtyre viteve (krahaso *Vrioni dhe të tjerët* (kompensim i drejtë), cituar më sipër, §37).

88. Gjykata nuk mund të pranojë as raportet e ekspertëve paraqitur nga ankuesit. Vlerësimi i tyre ishte i bazuar kryesisht në çmimet e shitjeve të blloqeve, me apartamente të ndërtuara në hapësirat e afërta dhe jo në vlerat e krahasueshme të tokave rreth e rrotull. Kështu, raportet e ekspertëve nuk provonin çmimet e referencës së cilave u referoheshin, me anë të dokumenteve mbështetëse.

89. Në lidhje me ankimin nr. 25038/08, palët debatuan për pjesën e tokës së ankueses. Duke iu referuar pjesës nën pronësinë e saj, Gjykata vendos se ankueses i duhet dhënë një e gjashtëmbëdhjeta e sipërfaqes së tokës, me përmasë 35,350 metra katrorë, 10,500 prej së cilës kanë qenë objekt i vendimit të saj në çështjen *Eltari* cituar më sipër. Në vijim, Gjykata thekson se sipërfaqja e tokës prej 442 metra katrorësh, e cila iu rikthye asaj dhe trashëgimtarëve të tjerë, me anë të vendimit të datës 5 maj 2009, nuk ishte pjesë e tokës me sipërfaqe prej 35,300 metra katrorësh e cila duhej kthyer si kompensim.

90. Duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se duhet ta përcaktojë dëmin monetar në bazë të hartave për vlerësimin e pronës së vitit 2008. Duke iu referuar materialit që zotëron, Gjykata e gjykon të arsyeshme të japë kompensimet për dëmin monetar dhe jomonetar, siç paraqitet në shtojcën nr. 3.

91. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, përfaqësuesit e ankuesve nuk i dorëzuan kërkesat e tyre brenda afatit kohor të lejuar (shih paragrafët 6 dhe 65 më sipër). Në vijim, Gjykata është e mendimit se nuk ka arsye për t'i akorduar ndonjë shumë ankuesve (shiko, së fundmi, *Apostu kundër Rumanisë*, nr. 22765/12, §136, 3 shkurt 2015). Megjithatë, Gjykata mendon se për aq kohë sa vendimet e Komisionit mbeten në fuqi, detyrimet e shtetit të paditur për t'i zbatuar ato nuk diskutohet. Gjykata përsërit se forma më e drejtë e kompensimit në lidhje me shkeljen ndaj nenit 6, është garantimi se ankuesi është sa më shumë të jetë e mundur në pozitë që do të kishte qenë nëse kërkesat e nenit 6 nuk do të ishin anashkaluar (shih midis të tjerave, *S.C. Procomexim SRL kundër Rumanisë* (nr. 2), nr. 31760/06, §52, 6 korrik 2010). Në lidhje me shkeljen e konstatuar, Gjykata vendos se ky parim zbatohet edhe në çështjen konkrete. Për këtë arsye, ajo vendos se Qeveria duhet të garantojë me anë të mjeteve të duhura zbatimin e vendimeve të Komisionit, në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11.

B. Kostot dhe shpenzimet

92. Ankuesit paraqitën kërkesa në lidhje me kostot dhe shpenzimet, sipas pasqyrës në shtojcën nr. 2.

93. Në lidhje me ankimet nr. 1376/10, 4036/10, 20240/10, 29617/10 dhe 2032/12, duke cituar *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §72, 29 Shtator 2009), sipas së cilave “një ankues ka të drejtën për rimbursimin e kostove dhe të shpenzimeve, për aq sa provohet se këto të fundit janë paguar dhe ishin të nevojshme për t'u bërë dhe janë brenda një kufiri të arsyeshëm”, Qeveria e ka çështjen në duart e Gjykatës të vendosë shumën që duhet të akordohet për këtë aspekt.

94. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, “një ankues ka të drejtën për rimbursimin e kostove dhe të shpenzimeve, për aq sa provohet se këto të fundit janë paguar dhe ishin të nevojshme për t'u bërë dhe janë brenda një kufiri të arsyeshëm” (shih *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009).

Në këtë pikë, rregulla 60§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës parashikon se ankuesit duhet të dorëzojnë së bashku me kërkesat e tyre për kompensim të drejtë “çdo dokument mbështetës”, sepse në rast se ato nuk dorëzohen Gjykata “mund t’i kundërshtojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht”.

95. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, Gjykata nuk do të japë kompensim për kostot dhe shpenzimet, sepse kërkesat u dorëzuan përtej afatit kohor (shih, së fundmi *Apostu*, cituar më sipër, §136).

96. Në lidhje me ankimet nr. 12889/10 dhe 29442/10, Gjykata nuk do të japë kompensim për kostot dhe shpenzimet, sepse nuk janë dorëzuar dokumente mbështetës.

97. Në lidhje me konstatimet në paragrafët 55–64, me natyrën përsëritëse të ankesave të ngritura në ankimet e mësipërme, pasi të njëjtat parashtrime u bënë edhe në Gjykatë, me përfaqësimin e ankuesve nga i njëjti avokat dhe me këndvështrimin e Gjykatës se shumica e kostove dhe e shpenzimeve të kërkuara nuk ishin të arsyeshme, bën që Gjykata ta mendojë të arsyeshme të japë shpërblim për kostot dhe shpenzimet e paraqitura në shtojcën nr. 3.

C. Interesi i vonuar

98. Gjykata e mendon të arsyeshme, që norma e interesit të vonuar duhet të bazohet në normën e huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës do t’i shtohen pikë tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. *Vendos* t’i bashkojë të gjithë ankimet;
 2. *I deklaron* ankesat në lidhje me nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe nenin 1 të protokollit nr. 1, mbi moszbatimin e vendimeve vendëse dhe kohëzgjatjen e procedimeve të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimeve të papranueshme;
 3. *Vendos* se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13 si edhe të nenit nr. 1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendëse;
 4. *Vendos* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa në lidhje me nenin 6§1 të Konventës, mbi kohëzgjatjen e procedimeve;
 5. *Vendos*:
 - a) Se shteti paditës duhet të garantojë, me anë të mjeteve të duhura, zbatimin e vendimeve vendëse në favor të ankuesve në ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, brenda tre muajve;
 - b) Se shteti paditës duhet t’i paguajë ankuesve së bashku, në ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10 dhe 2032/12, brenda tre muajve, shumat e referuara në paragrafët 90 dhe 97 të vendimit dhe në shtojcën 3, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, duke i konvertuar në monedhën vendëse në normën e zbatuar në datën e kompensimit;
 - c) Se nga momenti i përfundimit të periudhës tremujore të përmendur më sipër deri në kompensim, interesi i thjeshtë duhet të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë tre për qind;
 - d) *Rrëzon* pjesën tjetër të kërkesës së ankuesve për kompensim të drejtë.
- Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 10 nëntor 2015, sipas rregullave 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Fatoş Araci
Zëvendësregjistrar
Nona Tsotsoria
Kryetare

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

**SHTOJCA 1
LISTA E ANKUESVE**

Nr.	Emri i çështjes dhe numri	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes së çështjes
1.	<i>Sharra</i> , nr. 25038/08	Zamira Sharra (1956)	Shqipëri	A. Brovina, avokat	15 maj 2008
2.	<i>Xibinaku dhe të Tjerët</i> , nr. 64376/09	Miriam Xibinaku (1948) Sanie Kaceli (1948) Miron Nuri (1952) Qeriman Nuri (1935) Malfor Nuri (1964) Erina Llapaj (1952) Liliana Llapaj (1956) Nermin Harxhi (1957) Edmond Harxhi (1959) Shpresa Tartari (1940) Mirgjin Tartari (1941) Behare Tartari (1953) Enjana Tartari (1980) Stela Tartari (1983) Ledi Tartari (1991) Mirjane Tartari (1955) Arlind Tartari (1982) Ariona Tartari (1986)	Shqipëri Kanada Shqipëri Itali Shtetet e Bashkuara të Amerikës Shqipëri Itali Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
3.	<i>Frashëri</i> nr. 64399/09	Tarik Shkreli (1950) Fiqirete Frashëri (1930) Hajri Frashëri (1951) Hysref Frashëri (1956) Ilona Ziso (1962) Naide (Nahide) Shkodra (1929) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Rozafa Çabej, mbiemri i vajzërisë, Shkodra dhe Valbona Mardodaj, mbiemri i vajzërisë Shkodra	Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
4.	<i>Maçi</i> nr. 347/10	Musa Maçi (1934) Kujtim Maçi (1943) (që përfaqëson, gjithashtu, Giorgia dall'Olmo (Maçi) (1925), Roberto Maçi (1948), Alessandro Maçi (1955) dhe Tomor Maçi (1937))	Shqipëri Shqipëri Itali	A. Tartari, avokat	13 dhjetor 2009
5.	<i>Çoka</i> nr. 1376/10	Sotir Çoka (1932) Tefta Çoka (1938) Teodor Çoka (1964) Arben Çoka (1960)	Shqipëri	S. Puto and A. Memi, mbiemri i vajzërisë Prifti, avokatë	22 dhjetor 2009
6.	<i>Dvorani and Dume</i> nr. 4036/10	Shtetim Dvorani (1938) Valter Dvorani (1952) Pranvera Dvorani, mbiemri i vajzërisë Bejleri (1954) Diana Dvorani, mbiemri	Shqipëri	S. Puto, avokat	23 dhjetor 2009

Vëllimi III, 2020-2021

Nr.	Emri i çështjes dhe numri	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes së çështjes
		i vajzërisë Qyteti (1958) Gurie Dvorani, mbiemri i vajzërisë Starova (1925) zëvendësuar nga trashëgimtarja e saj Lejla Ago, mbiemri i vajzërisë Belli (1944) Svjetllana Dume (1949) Besa Dume (1952) Fatbardha Dume (1954)			
7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	Albert Asllani (1939)	Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 shkurt 2010
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	Tefta Agolli (1931) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Ilir Shijaku (1950) dhe Deshira Keta v Shijaku (1954) Arben Agolli (1957) Sokol Agolli (1951) Kreshnik Agolli (1956) Ganimet Agolli (1931) Afërdita Agolli (1954) Elira Agolli (1963) Semiha Agolli (1935) Artur Agolli (1958) Valbona Permeti, mbiemri i vajzërisë Agolli (1963) Flutura Agolli (1946) Parid Agolli (1979)	Shqipëri	A. Hajdari and A. Brovina, avokatë	6 prill 2010
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> , nr. 29442/10	Bardhyl Talipi (Peshkëpia) (1946)	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	S. Dodbiba, avokat	10 prill 2010
10.	<i>Kati</i> , nr. 29617/10	Fabian Kati (1963) Anila Kati (1956)	Shqipëri	A. Hajdari dhe A. Brovina, avokatë	20 maj 2010
11.	<i>Vrioni</i> , nr. 33154/11	Turhan Vrioni (1944)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	11 maj 2011
12.	<i>Lelo</i> , nr. 2032/12	Ervin Lelo (1974)	Shqipëri	S. Puto, avokat	19 dhjetor 2011

SHTOJCA 2
KËRKESAT E ANKUESVE PËR KOMPENSIM TË DREJTË,
SI EDHE PËR KOSTOT DHE SHPENZIMET

Nr.	Emri i ankuesit dhe nr.	Dëmi monetar	Dëmi jomonetar	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Sharra</i> nr. 25038/08	EUR 550,000 për vlerën e pronës së pjesës së saj, sipas raportit të ekspertit	EUR 150,000	EUR 6,122 (faturat janë dorëzuar)
2.	<i>Xibinaku dhe të Tjerët</i> nr. 64376/09	EUR 87,000 për dëmin monetar dhe jomonetar, si edhe për kostot dhe shpenzimet, për sa u përket pjesëve të ankuesve		

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

3.	<i>Frashëri,</i> nr. 64399/09	EUR 640,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 800 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 30,000	EUR 1,365 (faturat janë dorëzuar)
4.	<i>Maçi</i> nr. 347/10	ALL 500,000,000, e barasvlefshme me EUR 3,515,860, për vlerën e pronës: tokë, me sipërfaqe 16,500 metra katrorë, sipas raportit të ekspertit	Asnjë	Asnjë
5.	<i>Çoka</i> nr. 1376/10	EUR 2,345,620 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 16,040 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 60,000	EUR 1,000 (faturat janë dorëzuar)
6.	<i>Dvorani DHE Dume</i> nr. 4036/10	EUR 959,500 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 10,100 metra katrorë, sipas raportit të ekspertit	EUR 120,000	EUR 2,740 (faturat janë dorëzuar) (1,000 shpenzime ligjore dhe 1,740 për raportin e ekspertit, për të cilin nuk është dorëzuar një faturë e veçantë)
7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	EUR 1,100,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 9,950 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 50,000	EUR 1,000 (nuk është dorëzuar asnjë faturë)
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	EUR 685,600 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 800 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 175,500	EUR 2,530 (faturat janë dorëzuar)
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> nr. 29442/10	EUR 15,600 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 173 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 50,000	EUR 3,000 (nuk është dorëzuar asnjë faturë)
10.	<i>Kati</i> nr. 29617/10	EUR 205,240 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 280 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008	EUR 30,000	EUR 10,030 faturat janë dorëzuar (EUR 4,030 për shpenzimet ligjore dhe 6,000 për raportin e ekspertit)
11.	<i>Vrioni</i> nr. 33154/11	ALL 82,625,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 3,305 metra katrorë për pjesën e ankuesit, sipas raportit të ekspertit	Asnjë	Asnjë
12.	<i>Lelo</i> nr. 2032/12	EUR 296,305 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 14,400 metra katrorë, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2013	EUR 15,000	EUR 550 (faturat janë dorëzuar)

**SHTOJCA 3
VENDIMET E GJYKATËS**

Nr.	Emri i aplikimit dhe nr.	Dëmi monetar dhe jomonetar	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Sbarra</i> nr. 25038/08	EUR 191,400 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerët,</i> nr. 64376/0	EUR 87,000 (tetëdhjetë e shtatë mijë)	
3.	<i>Frashëri, nr. 64399/09</i>	EUR 670,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
4.	<i>Maçi, nr. 347/10</i>	Asnjë (kërkesat u dorëzuan jashtë afatit)	Asnjë (tetëqind e pesëdhjetë)
5.	<i>Çoka, nr. 1376/10</i>	EUR 2,331,400 (dy milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
6.	<i>Dvorani dhe Dume,</i> nr. 4036/10	EUR 748,900 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)

Vëllimi III, 2020-2021

7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	EUR 106,300 (njëqind e gjashtë mijë e treqind)	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë)
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	EUR 732,450 (shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> nr. 29442/10	EUR 19,300 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind)	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë)
10.	<i>Kati</i> nr. 29617/10	EUR 235,200 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind)	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
11.	<i>Vrioni</i> nr. 33154/11	Asnjë (kërkesat u dorëzuan jashtë afatit)	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë)
12.	<i>Lelo</i> nr. 2032/12	EUR 258,200 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind)	EUR 550 (pesëqind e pesëdhjetë)

GJYKATA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

T: +33(0)3 88 41 20 18
F: + 33(0) 3 88 41 27 30
www.echr.coe.int

Znj. Alma Hicka
Përfaqësuese e Qeverisë Shqiptare
Avokat i Përgjithshëm i Shtetit
Ministria e Drejtësisë
Avokatura e Përgjithshme e Shtetit
Blvd. Zogu I
Tiranë, Shqipëri

SEKSIONI I KATËRT

Datë 8.4.2016
ECHR-LE25.4bG
YP/ewz

Aplikimi nr. 29617/10 **“KATI KUNDËR SHQIPËRISË”,¹⁴**

i bashkuar me aplikimin nr. 25038/08 – Sharra kundër Shqipërisë” (korrigjim vendimi)

E nderuar Zonjë,

Referuar çështjes së mësipërme, Ju informoj se më 22 mars 2016 Komiteti, me iniciativë të tij, bazuar në rregullin 81 të Rregullores së Gjykatës ka vendosur korrigjimin e vendimit të dhënë më 10 nëntor 2015, duke përgjysmuar shumën e vlerës së dhënë për kërkuuesit, nga 235,200 euro në 117,600 euro, me qëllim reflektimin e pjesës së tyre të pasurisë. Vlera e shumës së ndryshuar është reflektuar në shtojcën 3 të vendimit.

Një kopje e vendimit të korrigjuar gjendet bashkëlidhur.

Me respekt,

F. Araci

Zv.regjistruer i Seksionit
Bashkëlidhur: Vendimi.

¹⁴ Qendra e Botimeve Zyrtare nr. 105, Tiranë 2020, f. 6063.

SEKSIONI I KATËRT
“ÇËSHTJA SHARRA DHE TË TJERËT KUNDËR SHQIPËRISË”

(ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12)

VENDIM

*Ky version u korrigjua më 22 mars 2016,
sipas rregullës 81 të Rregullores së Gjykatës.*

STRASBURG

10 nëntor 2015

Ky vendim është i formës së prerë, por mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Sharra dhe të tjerët kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i katërt), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Nona Tsotsoria, *kryetare*

Ledi Bianku

Paul Mahoney, *gjyqtarë*

dhe Fatoş Aracı, *zëvendësregjistrar i seksionit*

pasi ka diskutuar me dyer të mbyllura, më 22 tetor 2015;

pasi ka vërejtur se çështja ligjore në fjalë në ankimet e mëposhtme, tashmë është objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të Gjykatës (shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §31 korrik 2012),

shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja ka filluar me 12 ankime (25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 dhe 2032/12) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë nga 61 shtetas shqiptarë, bazuar në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa). Detajet e ankuesve dhe të përfaqësuesve janë të përcaktuara në shtojcën nr. 1, bashkangjitur vendimit.

2. Më 27 mars 2013, trashëgimtari i znj. Gurie Dvorani, i cili ishte njëri prej ankuesve të parë në ankimin nr. 4036/10, znj. Lejla Ago, me mbiemrin e vajzërisë Belli, shprehu dëshirën të ndiqte procedimet në emrin e saj. Më 30 shtator 2014, trashëgimtarët e znj. Tefta Agolli, e cila ishte njëra prej ankuesve të parë në ankimin nr. 20240/10, z. Ilir Shijaku dhe znj. Deshira Keta, me mbiemrin e vajzërisë Shijaku, shprehën dëshirën të ndiqnin procedimet në emrin e saj. Më 13 mars 2015, trashëgimtarët e znj. Naide (Nahide) Shkodra, me mbiemrin e vajzërisë Frashëri, e cila ishte njëra prej ankuesve të parë në ankimin nr. 64399/09, znj. Rozafa Çabej, me mbiemrin e vajzërisë Shkodra dhe znj. Valbona Mardodaj, me mbiemrin e vajzërisë Shkodra, të caktuara me anë të një testamenti, shprehën dëshirën e tyre për të ndjekur procedimet në emrin e saj. Për arsye praktike, ankueset znj. Gurie Dvorani, znj. Tefta Agolli dhe znj. Naide (Nahide) Shkodra, me mbiemrin e vajzërisë Frashëri, do të vijojnë të referohen në këtë vendim si ankuese, edhe pse tashmë si të tillë do të konsiderohen trashëgimtarët e tyre (shih *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, §1, GJEDNJ 1999-VI dhe *Janowiec dhe të tjerët kundër Rusisë* [DHM], nr. 55508/07 dhe 29520/09, §§97–101, GJEDNJ 2013).

3. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, znj. A. Hicka nga Avokatura e Shtetit.

4. Më 25 janar 2010 dhe 20 dhjetor 2–13, ankimet iu komunikuan Qeverisë.

5. Për sa u përket ankimeve nr. 64376/09, 64399/09, 12889/10 dhe 29442/10, Qeveria nuk dorëzoi vërejtje me shkrim brenda afatit kohor të lejuar.

6. Për sa u përket ankimeve nr. 347/10 dhe 33154/11, ankuesit nuk paraqitën kërkesa për kompensim të drejtë brenda afatit kohor të lejuar.

FAKTE

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Ankimi nr. 25038/08: Sharra

7. Më 28 dhjetor 1994, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave Vlorë (Komisioni) u njohu ankuesve dhe trashëgimtarëve të tjerë të drejtën mbi një sërë tokash të trashëguara me sipërfaqe prej 46,750 metra katrorë, nga e cila atyre u rikthyen 900 metra katrorë. Duke qenë se pjesa e mbetur e tokës ishte e zënë, Komisioni vendosi që ankuesja dhe trashëgimtarët e tjerë do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, për pjesën prej 45,850 metra katrorësh. Komisioni nuk mund të përcaktonte kufijtë e sipërfaqes së tokës prej 13,750 metra katrorësh, kështu nuk mori një vendim në lidhje me njohjen e të drejtave të ankueses mbi pronën e trashëguar.

8. Më 8 mars 2011, Gjykata shpalli vendimin për çështjen *Eltari kundër Shqipërisë*, nr. 16530/06, për mospagimin e kompensimit nga ana e autoriteteve për sipërfaqen e tokës prej 10,500 metra katrorësh, e cila ishte pjesë e vendimit të Komisionit.

9. Deri më sot, nuk është paguar asnjë kompensim.

B. Ankimi nr. 64376/09: Xibinaku dhe të tjerët

10. Më 21 mars 1996, Komisioni i Lushnjës i njohu ankuesit të drejtat mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 576 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një prej mënyrave të parashikuara me ligj. Ankuesit parashtruan se ata ishin trashëgimtarët që kishin mbetur për tokën e përmendur më sipër, për të cilën tashmë Gjykata kishte nxjerrë një vendim në çështjen *Hamzaraj kundër Shqipërisë* (nr. 1) (nr. 45264/04, 3 shkurt 2009).

11. Deri më sot, ankuesve nuk u është paguar asnjë kompensim.

C. Ankimi nr. 64399/09: Frashëri

12. Më 18 maj 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me sipërfaqe toke prej 1,000 metra katrorësh. Komisioni urdhëronte që toka i duhej kthyer plotësisht ankuesve. Më 11 shkurt dhe 14 dhjetor 2000, Gjykata e Rrethit Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë ndryshoi vendimin e Komisionit dhe urdhëroi se ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj, ku 200 metra katrorë u ishte kthyer. Duke qenë se pjesa e mbetur e tokës prej 800 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

13. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

D. Ankimi nr. 347/10: Maçi

14. Më 13 shtator 1996, Komisioni i Tiranës njohu, midis të tjerave, edhe të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar për një sipërfaqe toke me përmasë 16,500 metra katrorë. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

15. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

E. Ankimi nr. 1376/10: Çoka

16. Më 25 tetor 1995, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, Tiranë, (Komisioni) njohu, midis të tjerave, të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar për një sipërfaqe toke prej 150,000 metra katrorësh, nga e cila atyre iu kthye 120,300 metra katrorë. Duke qenë se sipërfaqja e mbetur prej 120,300 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

17. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

F. Ankimi nr. 4036/10: Dvorani dhe Dume

18. Më 10 dhjetor 1999, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 11,000 metra katrorësh, nga të cilët 10,100 metra katrorë do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

19. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

G. Ankimi nr. 12889/10: Asllani

20. Më 23 tetor 1996 dhe 24 prill 1998, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 9,950 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

21. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

H. Ankimi nr. 20240/10: Agolli

22. Më 7 korrik 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 800 metra katrorësh. Duke qenë se sipërfaqja e tokës ishte e zënë, ankuesit do të kompensoheshin në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

23. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

I. Ankimi nr. 29442/10: Talipi (Peshkëpia)

24. Më 28 shkurt 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 335 metra katrorësh, nga e cila ankuesit iu rikthye 162 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 173 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

25. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

J. Ankimi nr. 29617/10: Kati

26. Më 28 shkurt 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e ankuesve mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 910 metra katrorësh, nga e cila ankuesve iu rikthyen 630 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 280 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

27. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

K. Ankimi nr. 33154/11: Vrioni

28. Më 21 dhjetor 1995 dhe 22 prill 1996, Komisioni i Beratit njohu të drejtat e ankuesit mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 3,435 metra katrorësh, nga e cila ankuesit iu rikthye 130 metra katrorë. Duke qenë se pjesa tjetër e tokës prej 3,305 metra katrorësh ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

29. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

L. Ankimi nr. 2032/12: Lelo

30. Më 10 gusht 2007, Agjencia për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia), e cila kishte zëvendësuar Komisionin, i njohu ankuesit të drejtat mbi pronën e trashëguar, me një sipërfaqe toke prej 14,400 metra katrorësh në Vlorë. Duke qenë se pjesa e tokës ishte e zënë, ankuesi do të kompensohej në një nga mënyrat e parashikuara me ligj.

31. Deri më sot nuk është paguar asnjë kompensim.

II. L LIGJI PËRKATËS VENDËS

32. Ligji dhe praktika përkatëse vendëse përshkruhen në detaje, *inter alia*, në vendimin *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (nr. 604/07, 43628/07, 46684/07 dhe 34770/09, §§23–53, 31 korrik 2012) dhe *Ramadhi kundër Shqipërisë* (nr. 38222/02, 13 nëntor 2007). Legjislacioni shtesë përkatës vendës përfshin si më poshtë vijon:

A. Kushtetuta e Shqipërisë

33. Pjesa përkatëse e Kushtetutës parashikon si më poshtë vijon:

“Neni 41

“... ”

3. Ligji mund të parashikojë shpronësime ose kufizime në ushtrimin e së drejtës së pronës vetëm për interesa publikë.

4. Shpronësimet ose ato kufizime të së drejtës së pronës që barazohen me shpronësimin, lejohen vetëm përkundrejt një shpërblimi të drejtë.”

B. Akti i pronës 2004

34. Sipas nenit 13, ndryshuar me aktin nr. 55/2012, të datës 10 maj 2012, kompensimi duhet të përcaktohet bazuar në çmimin e tregut, me llojin e pronës dhe me përdorimin e saj të synuar.

C. Vendimet e Këshillit të Ministrave

1. Mbi metodologjinë për vlerësimin e pronës së paluajtshme (VKM-ja nr. 658, e datës 26 shtator 2012)

35. Vendimi përcakton metodologjinë dhe rregullat që duhet të përdoren për vlerësimin e pronës së paluajtshme. Në vendim pohohet se metodologjia e propozuar bazohet në standarde ndërkombëtare për vlerësimin e pronës së paluajtshme, sipas së cilave vlera e pronës është e barabartë me çmimin e kontratës së shitjeve.

36. Sipas vendimit, çmimi i kontratës së shitjeve tregon vlerën e tregut, në lidhje me llojin e pronës dhe përdorimin e saj të synuar. Zyra për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme (ZRPP) është përgjegjëse për përcaktimin e vlerës së tregut, bazuar në të dhënat zyrtare, të cilat gjenden në kontratat e shitjeve të regjistruara gjatë një viti kalendarik. Gjatë çerekut të fundit të një viti kalendarik, ZRPP-ja grupon të dhënat sipas llojit të pronës, sipas çdo zone kadastrale dhe qarkut. ZRPP-ja ia përcjell informacionin Agjencisë rreth mesit të muajit nëntor.

37. Nga fundi i dhjetorit, Agjencia përpunon të gjithë të dhënat dhe ia dorëzon vlerësimet ministrit të Drejtësisë, i cili më pas kërkon miratimin përfundimtar të Këshillit të Ministrave. Të dhënat përpunohen, si më poshtë vijon: a) nxjerrja e çmimeve minimale dhe maksimale të kontratave të shitjeve për secilin tip prone dhe zone kadastrale; b) përlllogaritja e çmimit mesatar të kontratave të shitjeve për secilin tip të pronës dhe zone kadastrale; c) heqja e vlerave më të ulëta dhe më të larta (duke filluar nga një diferencë prej 5%) të kontratave të shitjeve; d) përlllogaritja e vlerës gjerësisht të tregtueshme (*moda*) – ajo vlerë e cila referohet më shpesh në kontratat e shitjeve – për secilën lloj prone dhe zone kadastrale, e nxjerrë nga numri total i kontratave të shitjeve; e) përlllogaritja e çmimit mesatar nxjerrë nga numri total i kontratave të shitjes. Ky proces çon në përlllogaritjen përfundimtare të vlerës së pronës së paluajtshme.

38. Numri minimal i kontratave të shitjeve për një zonë kadastrale është tre. Në një rast të tillë, vlera e pronës do të jetë çmimi mesatar, i cili është rezultat i tri kontratave. Në rast se nuk ka transaksione për një lloj të caktuar prone, në një zonë kadastrale do të zbatohet një metodë përlllogaritje jo e drejtpërdrejte, duke grupuar kontratat e shitjeve të regjistruara për atë lloj toke në nivelin administrativ më të afërt sipas këtij rendi nga më i ulëti te më i larti: komunë, bashki dhe rreth.

2. Pasqyrë e metodologjisë nga Komisioni Parlamentar për Çështjet Ligjore (Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut)

39. Më 29 prill 2015, Qeveria paraqiti regjistrimet e një takimi parlamentar të datës 7 maj 2012, të Komisionit për Çështjet Ligjore, ku brenda kuadrit të një debati për projektligjin e ri për rikthimin dhe kompensimin e pronës u diskutua, midis të tjerave, metodologjia për vlerësimin e pronës së paluajtshme, e cila duhej të miratohej.

40. Ministri i Drejtësisë konfirmoi qëllimin e Qeverisë për të ofruar kompensim në vlerën e tregut, përlllogaritja e të cilit do të bazohej në standardet ndërkombëtare vlerësimin e pronës së paluajtshme. Tri elementet të cilat do të përdoreheshin për vlerësimin e pronës së paluajtshme ishin: çmimi i negociuar, lloji i pronës dhe përdorimi i saj i synuar. Vlerësimi i pronës do të përditësohej për çdo vit në mënyrë që të reflektojë luhatjet e tregut.

41. Hartat e vlerësimit të pronës do të miratoheshin me anë të një vendimi të Qeverisë. Ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë pohuan se ndryshe nga metodologjia ekzistuese, në të cilën vlerat e pronës përlllogariteshin bazuar në 20 dhe 30 faktorë dhe ku gjendeshin një sërë pasaktësish, metodologjia e propozuar do t'i shkëpuste të dhënat nga transaksionet kontraktuale të dakordësuara midis palëve private të regjistruara në ZRPP. Duke iu referuar numrit të duhur të të dhënave të mbledhura, një gjë e tillë do të garantonte një mundësi të ulët për gabime në vlerësimin e pronës dhe do të përjashtonte ndërhyrjen nga ana e Qeverisë në përcaktimin e vlerave të pronës.

42. U shprehën shqetësime për faktin nëse metodologjia duhej miratuar me anë të një vendimi të Qeverisë ose nëse duhej miratuar nga vetë Parlamenti. Lindi skepticizmi në lidhje me ekzistencën e një numri të mjaftueshëm transaksionesh të cilat do të bënin të mundur vlerësimin e saktë të pronës.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

U shprehën edhe rezervat nëse transaksionet përfaqësonin vlerën reale të tregut, duke pasur parasysh se palët, në përgjithësi, nuk deklarorin çmimin real të blerjeve/shitjeve për të shmangur taksat e larta. Metodologjia e propozuar mund të ishte në dëm të pronarëve të mëparshëm, për sa i përket të drejtës së tyre për kompensim.

3. Në lidhje me hartat e vlerësimit të pronës në vitet 2013 dhe 2014

43. Sipas vendimit për metodologjinë për vlerësimin e pronës së paluajtshme, të datës 6 mars 2013 dhe 30 korrik 2014, qeveria miratoi dhe nxori harta të reja për vlerësimin e pronës, të cilat përfshinin çmimin e referencës për metër katror në të gjithë vendin (vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 187, i datës 6 mars 2013 dhe 514, i datës 30 korrik 2014).

III. MATERIALET E KËSHILLIT TË EVROPËS

44. Materialet që kanë lidhje me këtë çështje u referuan në vendimet e kësaj Gjykate, duke përfshirë *Metalla dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 30264/08, 42120/08, 54403/08 dhe 54411/08, §§15–17, 16 korrik 2015); *Siliqi dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 37295/05 dhe 42228/05, §§12–13, 10 mars 2015); dhe *Karagozji dhe të tjerët kundër Shqipërisë* [Komiteti] (nr. 25408/06, 37419/06, 49121/06, 1504/07, 19772/07, 46685/07, 49411/07, 27242/08, 61912/08 dhe 15075/09, §§36–38, 8 prill 2014).

LIGJI

I. BASHKIMI I ANKIMEVE

45. Duke qenë se të gjitha ankimet ngrenë të njëjtën çështje, Gjykata vendos se ato duhet të bashkohen në përputhje me rregullën 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

II. SHKELJET E PRETENDUARA TË NENEVE 6§1 DHE 13 TË KONVENTËS, SI EDHE TË NENIT 1, TË PROTOKOLLIT NR. 1, TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME MOSZBATIMIN E VENDIMEVE TË FORMËS SË PRERË

46. Ankuesit pretendonin se ishin shkelur nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe neni 1, i protokollit nr. 1, të Konventës, për sa i përket moszbatimit të vendimeve vendëse të formës së prerë, të cilat u jepnin të drejtën për kompensim në vend të kthimit të pronave të tyre.

Për sa ka lidhje me çështjen konkrete, neni 6§1 i Konventës përcakton si më poshtë vijon:

“Në përcaktimin e të drejtave civile dhe detyrimeve ... çdo njeri ka të drejtën për një seancë ... dëgjimore ... nga [një] ... tribunal ...”

Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës parashikon si më poshtë vijon:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

A. Pranueshmëria

47. Qeveria nuk e kontestoi pranueshmërinë e këtyre ankesave.

48. Gjykata vëren se këto ankesa nuk janë të pabazuara në fakte, sipas interpretimit të nenit 35§3(a) të Konventës. Më tej ajo vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë shkak tjetër. Për këtë arsye, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Cilësitë

49. Qeveria nuk debatoi në lidhje me cilësitë e ankesave dhe pranoi se ankimet ishin objekt i praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar, bazuar në vendimin për çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër.

50. Sipas konstatimeve të saj në çështjet e mëparshme kundër Shqipërisë, për të cilat Qeveria nuk ka paraqitur ndonjë argument që do të përligjte shmangien e tyre (shiko midis të tjerave *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§93–97 dhe referencat cituar në vijim), Gjykata konstaton, se moszbatimi nga ana e Qeverisë e vendimeve vendëse të formës së prerë dhe veçanërisht mosrealizimi i pagesës për kompensimin e dhënë shkelte të drejtat e ankuesve, sipas nenit 6§1 dhe nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës.

51. Gjithashtu, Gjykata vendos se nuk ka pasur asnjë kompensim vendës efikas, i cili do të mundësonte kompensimin e duhur dhe të mjaftueshëm për moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve vendëse të formës së prerë, të cilat përcaktonin një kompensim. Për këtë arsye, është shkelur neni 13 i Konventës (shiko *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §72–84 dhe referencat cituar në vijim).

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6§1 TË KONVENTËS, NË LIDHJE ME KOHËZGJATJEN E PROCEDIMEVE

52. Ankuesit në ankimet nr. 64376/09, 64399/09, 1376/10, 4036/10, 29617/10 dhe 20240/10, në bazë të nenit 6§1, shprehën pakënaqësinë në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve, për shkak të moszbatimit të vendimeve të Komisionit.

53. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është e pabazuar në fakte, sipas parashikimit të nenit 35§3(a) të Konventës. Më tej, ajo vëren se ankesa nuk është e papranueshme për ndonjë shkak tjetër dhe për këtë arsye e deklaron atë të pranueshme.

54. Gjykata vendos se, sipas konstatimeve në paragrafët 49–51 më sipër, çështja e kohëzgjatjes së procedimeve duhet të konsiderohet se është e përfshirë në çështjen e moszbatimit (shiko, për shembull *Kutić kundër Kroacisë*, nr. 48778/99, §34, GJEDNJ 2002-II, dhe *Popova kundër Rusisë*, nr. 23697/02, §44, 21 dhjetor 2006). Për këtë arsye, Gjykata konstaton se nuk është e nevojshme që çështja e kohëzgjatjes së procedimeve të shqyrtohet në mënyrë të ndarë.

IV. SHKELJE TË TJERA TË PRETEN-DUARA TË KONVENTËS

55. Në ankimin nr. 25038/08, ankuesja shprehu pakënaqësinë për një shkelje të të drejtave të saj mbi pronën, në lidhje me sipërfaqen e tokës prej 13,750 metra katrorësh. Gjykata vëren se në mungesë të njohjes së pronës së saj nga Komisioni, ankuesja nuk mund të argumentojë se ka një “kërkesë”, sipas parashikimit të nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës. Gjykata e deklaron këtë ankesë të papajtueshme *ratione materiae* dhe e kundërshton atë, në përputhje me nenin 35§§3(a) dhe 4 të Konventës.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

56. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

1. Parashtrimet e palëve

a) Ankuesit

i. Vërejtje të përgjithshme

57. Ankuesit i kërkuan Gjykatës të zbatonte hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2008 për përlogaritjen e dëmit monetar. Ata parashtruan se hartat për vlerësimin e pronës të nxjerra në vitet 2013 dhe 2014 parashikonin një rritje të ndjeshme të çmimit të referencës. Për shembull, në sipërfaqet e tokës të pozicionuara në qendër të Tiranës kishte një rënie të ndjeshme të çmimit me 50%, ndërsa çmimi i referencës në një nga periferitë e Tiranës, Paskuqan, ishte rritur dhe ishte më i lartë çmimi i një sipërfaqeje toke në qendër të qytetit. Sipas këndvështrimit të tyre, hartat e vlerësimit të vitit 2014, nuk i referoheshin vlerësimit të bazuar në treg dhe ishin miratuar me qëllimin e vetëm për të ulur çmimin e referencës. Të gjithë procesit i mungonte transparenca, sepse Qeveria nuk kishte ofruar të dhëna faktike për mënyrën se si ishin realizuar përlogaritjet për përcaktimin e çmimit të referencës. Ata pretendonin se në mungesë të shifrave mbi të cilat do të bëheshin komentet, Qeveria mund të kishte zgjedhur tri transaksionet me vlerën më të ulët, të cilat do të justifikonin një rënie drastike në

çmimin e referencës. Në vijim, ankuesit argumentuan se harta e vlerësimit e vitit 2014 nuk duhet të përdoret në mënyrë retroaktive për ankimet e paraqitura përpara se kjo hartë të hynte në fuqi.

58. Ankuesit parashtruan se Qeveria nuk kishte marrë masa për përmbushjen e detyrimeve, të cilat lindnin nga vendimi pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër. Ata argumentuan se Qeveria vepronte kundër interesave të pronarëve të mëparshëm, duke ulur çmimet e referencës. Duke u mbështetur në vendimin e kësaj Gjykate për çështjen *Karagozji dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §64, ata nënvizuan faktin se Qeveria nuk kishte treguar se çmimet e referencës reflektonin vlerën reale të tregut, së bashku me “indeksin për interesin dhe inflacionin”. Në vijim, ata parashtruan se, në rast se çmimet nuk kishin rënie sipas hartave të viteve 2013 dhe 2014, do të zbatoheshin çmimi më i favorshëm i referencës. Gjithashtu, ata paraqitën raportet e ekspertëve, duke argumentuar se hartat e vlerësimit nuk reflektonin vlerën reale të tregut të pronës. Për përcaktimin e çmimit të referencës, ekspertët morën në konsideratë çmimin për metër katror të apartamenteve afër zonës, qiratë në zonën përreth, faktin se prona, deri në këto momente, pozicionohej në një zonë banimi dhe tregtare, supozimin se nuk kishte asnjë detyrim për t'u paguar për pronën dhe se ajo nuk prekej nga ndikimet e zhvillimit.

59. Disa ankues parashtruan se duke u bazuar në ankimin e tyre të paanshëm, hartat e vlerësimit të vitit 2014 barazonin në mënyrë të padrejtë statusin e pronarëve të mëparshëm të ligjshëm me statusin e pronarëve, të cilët kanë bërë ndërtime të paligjshme. Sipas këndvështrimit të tyre, tregu, i cili nuk duhet të ndikohet nga ndërhyrjet e qeverisë, duhet të përcaktojë vlerat e pronës. Në vijim, ata argumentuan se hartat e vlerësimit të pronave, të vitit 2014, nuk merrnin në konsideratë cilësitë e pronës, nuk ofronin interes shtesë për pagesat e vonuara, për dëmet jomonetare ose për kostot e procedurave ligjore dhe për shpenzimet e bëra nga ankuesit.

ii. Kërkesa specifike për çdo ankim

60. Ankuesit bënë kërkesa për dëmin monetar dhe jomonetar, të paraqitura në shtojcën nr. 2.

61. Në lidhje me ankimin nr. 25038/08, ankuesja parashtroi se pjesa e saj ishte një e gjashtëmbëdhjeta e sipërfaqes së tokës prej 35,850 metra katrorësh. Ajo paraqiti raportin e një eksperti mbi dëmin monetar, sipas së cilit çmimi i referencës varionte nga 161 EUR/metër katror deri në 200 EUR/metër katror.

62. Ankuesit në ankimin nr. 64376/09 parashtruan se ishin pjesa tjetër e trashëgimtarëve të së njëjtës sipërfaqe toke, për të cilën gjykata kishte akorduar kompensim në çështjen *Hamzuraraj*, cituar më sipër (shih, gjithashtu, paragrafin 10 më sipër). Duke u bazuar në këtë vendim, ankuesit kërkuan një shumë prej 87,000 eurosh për dëmin monetar dhe jomonetar, si edhe për kostot dhe shpenzimet, pa dorëzuar një pasqyrë të detajuar për këto kërkesa. Ata parashtruan se zotëronin 576 metra katrorë të të gjithë pronës.

63. Në lidhje me ankimin nr. 64399/09, ankuesit pretendonin se çmimi i referencës ishte 120,000 lekë/metër katror. Ata argumentonin se zotëronin të gjithë pronën.

64. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, ankuesit parashtruan kërkesat e tyre për kompensim pas përfundimit të afatit kohor të përcaktuar për atë qëllim (shiko edhe paragrafin 6 më sipër). Duke u bazuar në raportin e ekspertit, ata parashtruan se çmimi i referencës ishte 30,059 lekë/metër katror për ankimin nr. 347/10 dhe 25,000 lekë/metër katror për ankimin nr. 33154/11.

65. Ankuesit në ankimet nr. 4036/10 dhe 29617/10 paraqitën edhe raportet e ekspertëve. Në lidhje me ankimin nr. 4036/10, ankuesit parashtruan se të dyja hartat e vlerësimit të vitit 2008 dhe të vitit 2013 parashikonin të njëjtin çmim reference, i cili ishte 10,000 lekë/metër katror. Megjithatë, duke u bazuar në raportin e ekspertit, ata pretendonin se çmimi i referencës ishte 13,246.8 lekë/metër katror. Për sa i përket ankimit nr. 2961/10, ankuesit pretendonin se çmimi i referencës ishte 1,466 euro/metër katror.

66. Në lidhje me ankimin nr. 1376/10, ankuesit kërkuan që Gjykata të aplikonte çmimin e referencës prej 20,473 lekësh/metër katror, paraqitur në hartat e vlerësimit të vitit 2008, në vend të çmimit të referencës prej 9,274 lekësh/metër katrorë në hartat e vlerësimit të vitit 2013. Ata zotëronin dy të pesëmbëdhjetat e sipërfaqes së tokës.

67. Gjithashtu, në lidhje me ankimin nr. 12889/10, ankuesi pretendonte se çmimi i referencës ishte 14,500 lekë/metër katror, për pjesën e tij prej një të dhjetat, për ankimin nr. 29442/10 çmimi ishte 12,000 lekë/metër katrorë dhe për ankimin nr. 20240/10 çmimi ishte 857 euro/metër katrorë.

68. Për sa i përket ankimit nr. 2032/12, ankuesi kërkoi që Gjykata të aplikonte çmimin e referencës prej 11,523 lekësh/metër katror, sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2013, në vend të çmimit të referencës prej 10,000 lekësh/metër katrorë, sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2008.

b) Qeveria

i. Vërejtje të përgjithshme

69. Qeveria i kërkoi Gjykatës të aplikonte hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014, për përllogaritjen e dëmit monetar. Qeveria parashtroi se hartat e vlerësimit të pronës të vitit 2014 ishin realizuar bazuar në vendimin e Qeverisë për metodologjinë e vlerësimit të pronës së paluajtshëm (VKM-ja nr. 658, e datës 26 shtator 2012). Në përputhje me atë vendim, përditësimi i përvitshëm i hartave bazohej në të dhënat e paraqitura nga ZRPP-ja, bazuar në transaksionet financiare, që janë kontratat e shitjeve, të regjistruara për çdo zonë kadastrale. U përdorën tri kritere për përllogaritjen e vlerës së pronës së një zone kadastrale, të cilat konkretisht janë: çmimi i tregut, tipi i pronës dhe përdorimi i saj i synuar. Vlera e pronës reflektonte çmimin mesatar të kontratave të shitjes në një zonë kadastrale.

70. Qeveria pranoi se hartat e vlerësimit të pronave, të vitit 2014, paraqisnin çmime më të ulëta reference se sa ato të vitit 2008. Një rënie e tillë mendohej se shkaktohej nga kriza ekonomike në Evropë, e cila kishte ndikuar edhe në tregun e pronës në Shqipëri dhe në metodologjinë e përmirësuar, e cila po zbatohet në përputhje me standardet ndërkombëtare. Më tej, Qeveria parashtroi se hartat e vlerësimit të pronës i ishin referuar dhe përdorëshin sipas shpronësimit të pronarëve të ligjshëm dhe legjislacionit për ndërtesat e ndërtuara në mënyrë të paligjshme. Sipas opinionit të Qeverisë, hartat e vlerësimit 2008 nuk reflektonin realitetin.

71. Sipas opinionit të Qeverisë, dëmi monetar duhet të përllogaritet duke marrë në konsideratë llojin e tokës në momentin e konfiskimit dhe/ose kalimit të saj në pronësi të shtetit. Vlerësimi i saj nuk duhet të bazohet në natyrën e ndryshuar të tokës, ashtu siç ishte për momentin.

ii. Komente specifike për çdo ankim

72. Për sa i përket ankimit nr. 25038/08, Qeveria parashtroi se ankuesi duhet të kompensohet për një të njëzetën e të gjithë pronës, sipas hartave të vlerësimit për vitin 2008. Më tej, Qeveria shtoi se një sipërfaqe toke prej 442 metra katrorësh, e cila i ishte rikthyer ankuesit dhe trashëgimtarëve të tjerë, bazuar në vendimin e datës 5 maj 2009, duhej zbritur.

73. Për sa u përket ankimeve nr. 64376/09, 64399/09, 12889/10 dhe 29442/10, Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment për pretendimet e ankuesve për kompensim brenda afatit kohor të përcaktuar për atë qëllim (shiko paragrafin 5 më sipër).

74. Për sa u përket ankimeve 347/10 dhe 33154/11, Qeveria i kërkoi Gjykatës të mos akordonte asgjë përderisa ankuesit nuk paraqitën pretendimet e tyre për kompensim brenda afatit kohor të përcaktuar nga Gjykata. Por, si një alternativë për këtë situatë, Qeveria parashtroi se në rast se Gjykata i pranonte parashtrimet e vonuara të ankuesve, ata do të duhej të kompensoheshin bazuar në çmimet e referencës në hartat e vlerësimit të vitit 2014, në shumën prej 3,667 lekësh/metër katror, për ankimin nr. 33154/11. Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment në lidhje me pretendimin e ankuesve për kompensim, lidhur me ankimin 347/10.

75. Në lidhje me ankimin nr. 1376/10, Qeveria deklaroi se për momentin sipërfaqja e tokës së ankuesve ndodhej në zonën kadastrale, e cila përbëhej vetëm prej një toke trualli, çmimi i referencës të së cilës ishte 38,359 lekë/ m². Zona kadastrale nuk tregonte ndonjë çmim reference për tokën bujqësore. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në kohën e konfiskimit trualli ishte tokë bujqësore, Qeveria propozoi që të zbatohet çmimi i referencës për tokën bujqësore krahasuar me një zonë tjetër kadastrale më afër, çmim i cili është 551 lekë/ m².

76. Qeveria paraqiti të njëjtat parashtrime në lidhje me ankimet nr. 4036/10 dhe 2032/12. Qeveria deklaroi se për momentin tokat e ankuesve pozicionoheshin në një zonë kadastrale, e cila përbëhej

vetëm nga tokë trualli, çmimet e referencës të së cilës, sipas hartave të vlerësimit për vitin 2014, ishin 8,413 lekë/m², për ankimin nr. 4036/10 dhe 8,300 lekë/m² për ankimin nr. 2032/12. Zonat kadastrale nuk kishin ndonjë çmim reference për tokën bujqësore. Megjithatë, duke pasur parasysh faktin se në kohën e konfiskimit tokat kishin qenë bujqësore, ata propozonin që të duhej të zbatohesh çmimi i referencës për tokën bujqësore për nivelin më të afërt administrativ, i cili është 102 lekë/m², në lidhje me ankimin nr. 4036/10 dhe 281 lekë/m² në lidhje me ankimin nr. 2032/12.

77. Për sa u përket ankimeve nr. 20240/10 dhe 29617/10, Qeveria parashtroi se ankuesit duhej të kompensoheshin sipas hartës së vlerësimit të vitit 2014. Për të dyja ankimet, çmimi i referencës ishte 57,126 lekë/m², sipas hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2014.

2. Vlerësimi i Gjykatës

78. Sipas natyrës joefikase të sistemit aktual të kompensimit dhe duke marrë në konsideratë, veçanërisht, faktin se ka kaluar një periudhë kohore prej 8 deri 21 vjetësh, që prej momentit kur ankuesve iu dha kompensim për herë të parë, pa paragjykuar zhvillimet e mundshme në të ardhmen për një mekanizëm efikas për kompensim, Gjykata është e mendimit se është me vend që ankuesve t'u jepet një shumë e cila do të ishte një zgjidhje përfundimtare dhe shteruese e çështjeve.

79. Gjykata përsërit parimin e saj se dëmi monetar i akorduar në rastet e shpronësimit të paligjshëm duhet të korrespondojë me vlerën aktuale të pronës nëse nuk është e mundur *restitutio in integrum* (shiko *Brumărescu kundër Rumanisë* (kompensim i drejtë) [DHM], nr. 28342/95, §§19–24, GJEDNJ 2001-I, dhe *Scordino kundër Italisë* (nr. 3) (kompensim i drejtë)).

80. Gjykata shqyrtoi një problematikë të ngjashme në çështjen *Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 35720/04 dhe 42832/06, §§33–39, 7 dhjetor 2010, në të cilën ajo arsyetoi dhe arriti në përfundimin se, në rastin e shpronësimeve të paligjshme, si në rastin e ankimeve konkrete, për të cilat autoritet akorduan kompensim në vend të rikthimit të plotë të pronës, shumata e kompensimit do të korrespondonte me vlerën aktuale të pronës.

81. Në çështjen *Vrioni dhe të tjerët* (kompensim i drejtë), cituar më sipër, Gjykata akordoi kompensim, bazuar në hartat e vlerësimit të pronës, miratuar në vitin 2008. Kjo mënyrë e përllogaritjes së dëmit monetar është zbatuar vazhdimisht në të gjitha gjykimet në vijim, miratuar nga Gjykata (shih *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, §125; *Delvina kundër Shqipërisë* (kompensim i drejtë), nr. 49106/06, §17, 21 maj 2013; *Karagozji dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §§63 dhe 65; *Siliqi dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §27; dhe *Metalla dhe të tjerët* [Komiteti], cituar më sipër, §37).

82. Në rastin konkret, Gjykata duhet të përcaktojë nëse duhet t'u referohet hartave për vlerësimin e pronës së viti 2008 ose atyre të vitit 2014 për përllogaritjen e dëmit monetar. Pasi ka shqyrtuar argumentet e palëve, Gjykata bën vërejtjet e mëposhtme.

83. Vendimi pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, cituar më sipër, në lidhje me mospagimin e kompensimit nga autoritetet në vend të rikthimit të pronës, u dha nga Gjykata më 31 korrik 2012. Ky vendim u bë i formës së prerë më 17 dhjetor 2012. Në paragrafin e tij 121 dhe në parashikimin në fuqi nr. 7, Gjykata vendosi të mos i pezullonte procedimet e çështjeve dorëzuar përpara daljes së atij vendimi, por të vazhdohej me shqyrtimin e tyre, pasi vendimi të bëhej i formës së prerë. Në lidhje me këtë situatë, ankimet aktuale u paraqitën në Gjykatë nga 15 maj 2008 deri më 19 dhjetor 2011. Vini re se ankimet iu dhanë Qeverisë më 25 janar 2010 dhe 20 dhjetor 2013 (shiko paragrafin 4 më sipër).

84. Gjykata u kushton vëmendje argumenteve të Qeverisë në favor të ankimit për hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 për përllogaritjen e dëmit monetar. Ajo mbështet faktin se vlerësimet e pronës janë (pretendohen të jenë) përditësuar çdo vit, në bazë të një metodologjie, e cila u miratua me vendim të Qeverisë në vitin 2012. Megjithatë, Gjykata nuk u bind nga propozimet e Qeverisë.

85. Pikë së pari, hartat e vlerësimit të pronës së vitit 2014 u miratuan pas paraqitjes së ankimeve aktuale, të cilat po shqyrtoheshin në përputhje me udhëzimet e dhëna në vendimin pilot. Sipas Gjykatës, referenca të harta e vlerësimit të vitit 2014, do të linte vend për pabarazi gjatë trajtimit të ankuesve për sa i përket çmimit të referencës.

86. Së dyti, Gjykata do t'u referohej argumenteve të shprehura gjatë takimit parlamentar të datës 7 maj 2012 për shkakun se shitblerjet e regjistruara në ZRPP, nuk e reflektonin në përgjithësi dhe

domosdoshmërisht vlerën reale të tregut si rezultat i evazionit të taksave mbuluar nga palët sipas kontratës së shitjeve. Për pasojë, Gjykata mendon se referimi i plotë në çmimet e shitjeve të shitblerjeve të regjistruara nuk do të ishte aspak në zbatim të parimit se kompensimi, në rastet e shpronësimit të paligjshëm, duhet të jetë në përputhje me vlerën e tregut, për këtë arsye Gjykata ka ndërmarrë edhe masa për të parandaluar dhe luftuar evazionin e taksave.

87. Së treti, dhe e lidhur ngushtë me arsyen e dytë, Gjykata është e shqetësuar, se çmimet e pronës në disa qytete, veçanërisht në zonat të cilat po njohin një zhvillim relativisht në rritje, si për shembull qendra e Tiranës, kryeqytetit, kanë shënuar një rënie të ndjeshme. Gjykata nuk është në pozicionin të spekulojë arsyet për një rënie të tillë, por nuk është e bindur se ato reflektojnë në mënyrë objektive vlerën aktuale të tregut dhe se ishin “të indeksuar me interesin dhe inflacionin” për të kompensuar dëmin e shkaktuar nga pamundësia për kompensim gjatë gjithë këtyre viteve (krahaso *Vrioni dhe të tjerët* (kompensim i drejtë), cituar më sipër, §37).

88. Gjykata nuk mund të pranojë as raportet e ekspertëve paraqitur nga ankuesit. Vlerësimi i tyre ishte i bazuar kryesisht në çmimet e shitjeve të blloqeve me apartamente të ndërtuara në hapësirat e afërta dhe jo në vlerat e krahasueshme të tokave rreth e rrotull. Kështu, raportet e ekspertëve nuk provonin çmimet e referencës së cilave u referoheshin, me anë të dokumenteve mbështetëse.

89. Në lidhje me ankimin nr. 25038/08, palët debatuan për pjesën e tokës së ankueses. Duke u referuar pjesës nën pronësinë e saj, Gjykata vendos se ankueses i duhet dhënë një e gjashtëmbëdhjeta e sipërfaqes së tokës me përmasë 35,350 metër katrorë, 10,500 prej të cilave kanë qenë objekt i vendimit të saj në çështjen *Eltari* cituar më sipër. Në vijim, Gjykata thekson se sipërfaqja e tokës prej 442 metër katrorë, e cila iu rikthye asaj dhe trashëgimtarëve të tjerë, me anë të vendimit të datës 5 maj 2009, nuk ishte pjesë e tokës me sipërfaqe prej 35,300 metër katrorësh, e cila duhej kthyer si kompensim.

90. Duke marrë në konsideratë argumentet e mësipërme, Gjykata arrin në përfundimin se duhet ta përcaktojë dëmin monetar në bazë të hartave për vlerësimin e pronës të vitit 2008. Duke iu referuar materialit që zotëron, Gjykata e gjykon të arsyeshme të japë kompensimet për dëmin monetar dhe jomonetar, siç paraqitet në shtojcën nr. 3.

91. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, përfaqësuesit e ankuesve nuk i dorëzuan kërkesat e tyre brenda afatit kohor të lejuar (shih paragrafët 6 dhe 65 më sipër). Në vijim, Gjykata është e mendimit se nuk ka arsye për t'i akorduar ndonjë shumë ankuesve (shiko, së fundmi, *Apostu kundër Rumanisë*, nr. 22765/12, §136, 3 shkurt 2015). Megjithatë, Gjykata mendon se për aq kohë sa vendimet e Komisionit mbeten në fuqi, detyrimet e shtetit të paditur për t'i zbatuar ato nuk diskutohet. Gjykata përsërit, se forma më e drejtë e kompensimit në lidhje me shkeljen ndaj nenit 6, është garantimi se ankuesi është sa më shumë të jetë e mundur në pozitë që do të kishte qenë nëse kërkesat e nenit 6 nuk do të ishin anashkaluar (shih midis të tjerave, *S.C. Procomexim SRL kundër Rumanisë* (nr. 2), nr. 31760/06, §52, 6 korrik 2010). Në lidhje me shkeljen e konstatuar, Gjykata vendos se ky parim zbatohet edhe në çështjen konkrete. Për këtë arsye, ajo vendos se Qeveria duhet të garantojë me anë të mjeteve të duhura zbatimin e vendimeve të Komisionit në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11.

B. Kostot dhe shpenzimet

92. Ankuesit paraqitën kërkesa në lidhje me kostot dhe shpenzimet, sipas pasqyrës në shtojcën nr. 2.

93. Në lidhje me ankimet nr. 1376/10, 4036/10, 20240/10, 29617/10 dhe 2032/12, duke cituar *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009), sipas të cilave “një ankues ka të drejtën për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve, për aq sa provohet se këto të fundit janë paguar dhe ishin të nevojshme për t'u bërë dhe janë brenda një kufiri të arsyeshëm”, Qeveria e ka çështjen në duart e Gjykatës të vendosë shumën që duhet të akordohet për këtë aspekt.

94. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, “një ankues ka të drejtën për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve, për aq sa provohet se këto të fundit janë paguar dhe ishin të nevojshme për t'u bërë dhe janë brenda një kufiri të arsyeshëm” (shih *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009).

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

Në këtë pikë, Rregulli 60§§2 dhe 3 i Rregullores së Gjykatës parashikon se ankuesit duhet të dorëzojnë së bashku me kërkesat e tyre për kompensim të drejtë “çdo dokument mbështetës”, sepse në rast se ato nuk dorëzohen Gjykata “mund t’i kundërshtojë kërkesat plotësisht ose pjesërisht”.

95. Në lidhje me ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, Gjykata nuk do të japë kompensim për kostot dhe shpenzimet, sepse kërkesat u dorëzuan përtej afatit kohor (shih, së fundmi, *Apostu*, cituar më sipër, §136).

96. Në lidhje me ankimet nr. 12889/10 dhe 29442/10, Gjykata nuk do të japë kompensim për kostot dhe shpenzimet, sepse nuk janë dorëzuar dokumente mbështetëse.

97. Në lidhje me konstatimet në paragrafët 55–64, me natyrën përsëritëse të ankesave, të ngritura në ankimet e mësipërme, pasi të njëjtat parashtrime u bënë edhe në Gjykatë, me përfaqësimin e ankuesve nga i njëjti avokat dhe me këndvështrimin e Gjykatës se shumica e kostove dhe shpenzimeve të kërkuara nuk ishin të arsyeshme, bën që Gjykata ta mendojë të arsyeshme të japë shpërblim për kostot dhe shpenzimet e paraqitura në shtojcën nr. 3.

C. Interesi i vonuar

98. Gjykata e mendon të arsyeshme, që norma e interesit të vonuar duhet të bazohet në normën e huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane, së cilës do t’i shtohen pikë tre për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME,

1. *Vendos* t’i bashkojë të gjithë ankimet;

2. *I deklaron* ankesat në lidhje me nenet 6§1 dhe 13 të Konventës, si edhe nenin 1 të protokollit nr. 1 mbi moszbatimin e vendimeve vendëse dhe kohëzgjatjen e procedimeve të pranueshme dhe pjesën tjetër të ankimeve të papranueshme;

3. *Vendos* se ka pasur një shkelje të neneve 6§1 dhe 13, si edhe të nenit nr. 1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin e vendimeve vendëse;

4. *Vendos* se nuk është e nevojshme të shqyrtohet ankesa në lidhje me nenin 6§1 të Konventës, mbi kohëzgjatjen e procedimeve;

5. *Vendos*:

a) se shteti paditës duhet të garantojë, me anë të mjeteve të duhura, zbatimin e vendimeve vendëse në favor të ankuesve në ankimet nr. 347/10 dhe 33154/11, brenda tre muajve;

b) se shteti paditës duhet t’i paguajë ankuesve së bashku, në ankimet nr. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10 dhe 2032/12 brenda tre muajve, shumat e referuara në paragrafët 90 dhe 97 të vendimit dhe në shtojcën 3, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, duke i konvertuar në monedhën vendëse në normën e zbatuar në datën e kompensimit;

c) se nga momenti i përfundimit të periudhës tre-mujore të përmendur më sipër deri në kompensim, interesi i thjeshtë duhet të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës plus pikë tre për qind;

d) Rrëzon pjesën tjetër të kërkesës së ankuesve për kompensim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 10 nëntor 2015, sipas Rregullit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Fatoş Aracı

Nona Tsotsoria

Zëvendësregjistrar

Kryetare

Vëllimi III, 2020-2021

SHTOJCË 1
LISTA E ANKUESVE

Nr.	Emri i çështjes dhe numri	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes së çështjes
1.	<i>Sharra</i> nr. 25038/08	Zamira Sharra (1956)	Shqipëri	A. Brovina, avokat	15 maj 2008
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerët</i> nr. 64376/09	Miriam Xibinaku (1948) Sanie Kaceli (1948) Miron Nuri (1952) Qeriman Nuri (1935) Malfor Nuri (1964) Erina Llapaj (1952) Liliana Llapaj (1956) Nermin Harxhi (1957) Edmond Harxhi (1959) Shpresa Tartari (1940) Mirgjin Tartari (1941) Behare Tartari (1953) Enjana Tartari (1980) Stela Tartari (1983) Ledi Tartari (1991) Mirjane Tartari (1955) Arlind Tartari (1982) Ariona Tartari (1986)	Shqipëri Kanada Shqipëri Itali Shtetet e Bashkuara të Amerikës Shqipëri Itali Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
3.	<i>Frashëri</i> nr. 64399/09	Tarik Shkreli (1950) Fiqirete Frashëri (1930) Hajri Frashëri (1951) Hysref Frashëri (1956) Ilona Ziso (1962) Naide (Nahide) Shkodra (1929) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Rozafa Çabej mbiemri i vajzërisë Shkodra dhe Valbona Mardodaj mbiemri i vajzërisë Shkodra	Shqipëri	S. Puto, avokat	4 dhjetor 2009
4.	<i>Maçi</i> nr. 347/10	Musa Maçi (1934) Kujtim Maçi (1943) (që përfaqëson gjithashtu Giorgia dall'Olmo (Maçi) (1925), Roberto Maçi (1948), Alessandro Maçi (1955) dhe Tomor Maçi (1937))	Shqipëri Shqipëri Itali	A. Tartari, avokat	13 dhjetor 2009
5.	<i>Çoka</i> nr. 1376/10	Sotir Çoka (1932) Tefta Çoka (1938) Teodor Çoka (1964) Arben Çoka (1960)	Shqipëri	S. Puto and A. Memi mbiemri i vajzërisë Prifti, avokatë	22 dhjetor 2009
6.	<i>Dvorani dhe Dume</i> nr. 4036/10	Shpetim Dvorani (1938) Valter Dvorani (1952) Pranvera Dvorani mbiemri i vajzërisë Bejleri (1954) Diana Dvorani mbiemri i vajzërisë Qyteti (1958) Gurie Dvorani mbiemri i vajzërisë Starova (1925) zëvendësuar nga trashëgimtarja e saj Lejla Ago mbiemri i vajzërisë	Shqipëri	S. Puto, avokat	23 dhjetor 2009

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

Nr.	Emri i çështjes dhe numri	Emri i ankuesit (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga	Data e paraqitjes së çështjes
		Belli (1944) Svjetllana Dume (1949) Besa Dume (1952) Fatbardha Dume (1954)			
7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	Albert Asllani (1939)	Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	5 shkurt 2010
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	Tefta Agolli (1931) zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj Ilir Shijaku (1950) and Deshira Keta v Shijaku (1954) Arben Agolli (1957) Sokol Agolli (1951) Kreshnik Agolli (1956) Ganimet Agolli (1931) Afërdita Agolli (1954) Elira Agolli (1963) Semiha Agolli (1935) Artur Agolli (1958) Valbona Permeti mbiemri i vajzërisë Agolli (1963) Flutura Agolli (1946) Parid Agolli (1979)	Shqipëri	A. Hajdari and A. Brovina, avokatë	6 prill 2010
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> nr. 29442/10	Bardhyl Talipi (Peshkëpia) (1946)	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	S. Dodbiba, avokat	10 prill 2010
10.	<i>Kati</i> nr. 29617/10	Fabian Kati (1963) Anila Kati (1956)	Shqipëri	A. Hajdari dhe A. Brovina, avokatë	20 maj 2010
11.	<i>Vrioni</i> nr. 33154/11	Turhan Vrioni (1944)	Shqipëri	A. Tartari, avokat	11 maj 2011
12.	<i>Lelo</i> nr. 2032/12	Ervin Lelo (1974)	Shqipëri	S. Puto, avokat	19 dhjetor 2011

SHTOJÇË 2

KËRKESAT E ANKUESVE PËR KOMPENSIM TË DREJTË SI EDHE PËR KOSTOT DHE SHPENZIMET

Nr.	Emri i ankuesit dhe nr.	Dëmi monetar	Dëmi jomonetar	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Sharra</i> nr. 25038/08	EUR 550,000 për vlerën e pronës së pjesës së saj sipas raportit të ekspertit.	EUR 150,000	EUR 6,122 (faturat janë dorëzuar).
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerët</i> nr. 64376/09	EUR 87,000 për dëmin monetar dhe jo monetar si edhe për kostot dhe shpenzimet, për sa i përket pjesëve të ankuesve.		
3.	<i>Frashtëri</i> nr. 64399/09	EUR 640,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 800 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 30,000	EUR 1,365 (faturat janë dorëzuar).
4.	<i>Maçi</i> nr. 347/10	ALL 500,000,000, e barazvlefshme me EUR 3,515,860, për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 16,500 metër katror sipas raportit të ekspertit.	Asnjë.	Asnjë.
5.	<i>Çoka</i> nr. 1376/10	EUR 2,345,620 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 16,040 metër katror sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 60,000	EUR 1,000 (faturat janë dorëzuar).
6.	<i>Dvorani dhe Dume</i> nr. 4036/10	EUR 959,500 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 10,100 metër katror sipas raportit të ekspertit.	EUR 120,000	EUR 2,740 (faturat janë dorëzuar) (1,000 shpenzime ligjore dhe 1,740 për raportin e ekspertit, për të cilin nuk është dorëzuar një faturë e veçantë).

Vëllimi III, 2020-2021

7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	EUR 1,100,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 9,950 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 50,000	EUR 1,000 (nuk është dorëzuar asnjë faturë).
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	EUR 685,600 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 800 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 175,500	EUR 2,530 (faturat janë dorëzuar).
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> nr. 29442/10	EUR 15,600 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 173 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 50,000	EUR 3,000 (nuk është dorëzuar asnjë faturë).
10.	<i>Kati</i> nr. 29617/10	EUR 205,240 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 280 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2008.	EUR 30,000	EUR 10,030 faturat janë dorëzuar (EUR 4,030 për shpenzimet ligjore dhe 6,000 për raportin e ekspertit).
11.	<i>Vrioni</i> nr. 33154/11	ALL 82,625,000 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 3,305 metër katror për pjesën e ankuesit, sipas raportit të ekspertit.	Asnjë.	Asnjë.
12.	<i>Lelo</i> nr. 2032/12	EUR 296,305 për vlerën e pronës: tokë me sipërfaqe 14,400 metër katror, sipas hartave të vlerësimit të vitit 2013.	EUR 15,000	EUR 550 (faturat janë dorëzuar).

SHTOJCË 3 VENDIMET E GJYKATËS

Nr.	Emri i aplikimit dhe nr.	Dëmi monetar dhe jomonetar	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Sbarra</i> nr. 25038/08	EUR 191,400 (njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind).	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë).
2.	<i>Xibinaku dhe të tjerët</i> nr. 64376/09	EUR 87,000 (tetëdhjetë e shtatë mijë).	
3.	<i>Frashëri</i> nr. 64399/09	EUR 670,000 (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë).	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë)
4.	<i>Maçi</i> nr. 347/10	Asnjë (kërkesat u dorëzuan jashtë afatit).	Asnjë (tetëqind e pesëdhjetë).
5.	<i>Çoka</i> nr. 1376/10	EUR 2,331,400 (dy milion e treqind e tridhjetë e një mijë e katërqind).	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë).
6.	<i>Dvorani dhe Dume</i> nr. 4036/10	EUR 748,900 (shtatëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind).	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë).
7.	<i>Asllani</i> nr. 12889/10	EUR 106,300 (njëqind e gjashtë mijë e treqind).	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë).
8.	<i>Agolli</i> nr. 20240/10	EUR 732,450 (shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë).	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë).
9.	<i>Talipi (Peshkëpia)</i> nr. 29442/10	EUR 19,300 (nëntëmbëdhjetë mijë e treqind).	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë).
10.	<i>Kati</i> nr. 29617/10	EUR 117,600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) ¹⁵ .	EUR 850 (tetëqind e pesëdhjetë).
11.	<i>Vrioni</i> nr. 33154/11	Asnjë (kërkesat u dorëzuan jashtë afatit).	Asnjë (nuk u paraqit asnjë kërkesë).
12.	<i>Lelo</i> nr. 2032/12	EUR 258,200 (dyqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind).	EUR 550 (pesëqind e pesëdhjetë).

¹⁵ Korriguar më 22 mars 2016: kompensimi u përgjysmua nga EUR 235,200 në EUR 117,600 për të reflektuar pjesën e pronës së ankuesit.

SEKSIONI I DYTË
ÇËSHTJA
“KASMI KUNDËR SHQIPËRISË”¹⁶

(kërkesa nr. 1175/06)

VENDIM
Strasburg
23 qershor 2020

Neni 1, P 1 – Kontroll i përdorimit të pronës – Pamundësia e kërkuarit të rimerrte në zotërim pronën e zënë nga qiramarrësit, për më shumë se 13 vjet, në kuadër të mbrojtjes së strehimit të qiramarrësve të prekur nga kthimi i pronave të shpronësuar ose të shtetëzuara tek ish-pronarët – Janë marrë në konsideratë rrethanat sociale dhe ekonomike në kohën respektive – Skema synohet të ishte për një kohëzgjatje të kufizuar, me përgjegjësinë e Shtetit për të siguruar zgjidhje alternative për strehim për qiramarrësit e prekur – Marrëveshjet e qiramarrjes parashikuar nga ligji – Marrëveshja e pakufizuar në kohë – Mungesa e mekanizmave të dubur në mbrojtje të së drejtës së kërkuarit për të zgjedhur marrëveshjet e qiramarrjes - Vlerë e ulët e qirasë e përcaktuar nga ligji, duke mos lejuar indeksimin e saj ndaj inflacionit – Mungesa e masave konkrete të autoriteteve për të garantuar strehim alternativ për qiramarrësit – Periudhë e gjatë pasigurie – Barra e një situate komplekse nga aspekti social mbi kërkuarin

*Ky vendim do të bëhet i formës së prerë, sipas rrethanave të parashikuara në nenin 44 §2 të Konventës.
Ai mund të bëhet objekt i rishikimit redaktues.*

Në çështjen “Kasmi kundër Shqipërisë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur si një dhomë e përbërë nga:

Robert Spano, kryetar

Paul Lemmens

Valeriu Griçco

Egidijus Kūris

Jon Fridrik Kjølbro

Stéphanie Mourou-Vikström

Darian Pavli, gjyqtarë

dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 10 prill 2018 dhe 26 maj 2020,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë.

PROCEDURA

1. Çështja filloi me një kërkesë (nr. 1175/06) kundër Republikës së Shqipërisë, paraqitur në Gjykatë me datë 19 dhjetor 2005, mbështetur në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga një shtetas shqiptar, z. Gëzim Kasmi (kërkuari).

2. Kërkuari u përfaqësua nga z. S. Dodbiba, një avokat i cili ushtron aktivitetin në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj, në atë kohë, znj. E. Hajro nga Avokatura e Shtetit.

3. Z. Ledi Bianku, pas përfundimit të mandatit të tij si gjyqtari i zgjedhur për Shqipërinë, u tërhoq nga çështja (rregulla 28 e Rregullave të Gjykatës). Z. Darian Pavli, pasi mori detyrën si gjyqtari i zgjedhur për Shqipërinë, zuri vendin e tij (rregulla 26 §1(a)).

4. Sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuari pretendonte se kishte pasur një shkelje të të drejtave të tij të pronës, pasi ai nuk kishte mundur të rimerrte në pronësi shtëpinë e tij.

5. Më 5 shkurt 2009, kërkesa iu komunikua Qeverisë.

¹⁶ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 180*. Tiranë, 2020. f. 12544

FAKTET

6. Kërkuesi lindi në vitin 1942 dhe jeton në Tiranë.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

A. Konteksti përkatës

7. Gjatë periudhës së komunizmit në Shqipëri, familjet, në përgjithësi, jetonin në mjedise nën pronësinë e Shtetit, të lëna si banesa, në përputhje me marrëveshjet e qiradhënieve për banim, të cilat lidheshin midis qiramarrësit dhe Ndërmarrjes Komunale të asaj kohe për Banesa nën pronësinë e Shtetit (Ndërmarrja Komunale për Banesa). Banesat private, të cilat kishin kaluar në pronësinë e Shtetit, me anë të legjislacionit për shtetëzim, i kaluan nga Qeveria e asaj kohe familjeve – anëtarët e të cilave, si rregull, në atë kohë punonin për Shtetin – në mbështetje të marrëveshjeve të qiramarrjes.

8. Në vitin 1992, pas rënies së regjimit komunist, hyri në fuqi ligji i privatizimit, sipas të cilit banesat nën pronësinë e Shtetit, përveç atyre të cilat më herët kishin qenë prona private, do t'i nënshtroheshin privatizimit. Dispozitat përkatëse të aktit të privatizimit parashikohen në paragrafët 21–24 më poshtë.

9. Në vitin 1993, hyri në fuqi ligji për kthimin dhe kompensimin e pronës (ligji i pronës), sipas të cilit ish-pronarëve ose trashëgimtarëve të tyre u jepet drejta të kërkonin kthimin e pronave të shpronësuara ose të shtetëzuara, si edhe kompensimin në vend të kthimit. Megjithatë, apartamentet në ato prona shpesh ishin të zënë nga qiramarrësit, të cilët kishin lidhur një marrëveshje qiramarrje me Shtetin. Dispozitat përkatëse të ligjit të pronës paraqiten në paragrafët 41–46 më poshtë.

B. Rrethanat e çështjes specifike

1. Procedimet administrative në lidhje me kthimin e pronës së kërkuesit

10. Babai i kërkuesit zotëronte dy shtëpi që gjendeshin në Tiranë dhe secila prej tyre përbëhej nga katër dhoma, një dhomë ngrënie dhe oborri përkatës. Në një datë të papërcaktuar, në vitet 1950, të dyja pronat u shtetëzuan nga Shteti dhe më pas u morën me qira nga familje.

11. Pas hyrjes në fuqi të ligjit të pronës në vitin 1993, në një datë të papërcaktuar – me shumë mundësi në vitin 1994 ose 1995 – babai i kërkuesit paraqiti një kërkesë pranë Komisionit për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës, Tiranë (Komisioni) për kthimin e shtëpive.

12. Konstatohet se me anë të një vendimi të datës 27 shtator 1995, për të cilin nuk është dorëzuar asnjë kopje nga palët, Komisioni i njohu babait të kërkuesit të drejtat e pronësisë ndaj shtëpive.

13. Më 15 gusht 1997, pas vdekjes së babait të kërkuesit, e drejta e tij dhe e motrave dhe e vëllezërve të tij ndaj pronës u regjistruan në regjistrin e pronave.

2. Procedimet gjyqësore në lidhje me nxjerrjen e qiramarrësve që kishin zënë pronën e kërkuesit

14. Në një datë të paspecifikuar, duke qenë se kërkuesi nuk mund të rifitonte pronësinë e njëres prej shtëpive, duke qenë se ajo ishte e zënë prej qiramarrësve, ai paraqiti një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit), me të cilën kërkonte nxjerrjen e tyre. Sipas këndvështrimit të tij, qiramarrësit nuk gëzonin ndonjë të drejtë prone ndaj shtëpisë, ata nuk i kishin paguar atij qira dhe ligjërisht nuk ishin të pastrehë. Ai argumentoi se duke qenë se ishte pronari i ligjshëm i shtëpisë, zënia e shtëpisë nga qiramarrësit kishte cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë të drejtat e tij ndaj pronës, mbrojtja e të cilave garantohej nga Kushtetuta dhe Konventa.

15. Më 17 mars 2003, Gjykata e Rrethit Tiranë la në fuqi padinë e kërkuesit. Ajo konstatoi se njëri prej qiramarrësve, më konkretisht J.D., nuk zotëronte një autorizim të ligjshëm mbajtjeje në zotërim, për të vijuar të zinte pronën e kërkuesit. Në lidhje me qiramarrësit e tjerë, gjykata deklaroi se dy prej tyre, konkretisht B.S. dhe M.S., kishin jetuar jashtë vendit për të paktën pesë vjet dhe njëri prej tyre, më konkretisht F.S., kishte marrë strehim nga Shteti. Gjykata i urdhëroi të gjithë qiramarrësit që të lironin shtëpinë.

16. Qiramarrësit apelian në Gjykatën e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit), e cila më 23 prill 2004 prishi pjesërisht vendimin e Gjykatës së Rrethit për sa kishte të bënte me J.D., B.S. dhe M.S. Gjykata e Apelit konstatoi se ata qiramarrës e kishin zënë shtëpinë që prej viteve 1980. Në lidhje me J.D., gjykata konstatoi se ai ishte ligjërisht i pastrehë dhe kishte fituar të drejtën për qiramarrje që prej vitit 1993. Në lidhje me B.S. dhe M.S., gjykata konstatoi se duke qenë se ata kishin jetuar jashtë vendit si emigrantë ekonomikë për dy vitet e fundit dhe nuk kishin vendosur vendbanim të përhershëm atje,

ata nuk e kishin braktisur banesën e tyre në Shqipëri. Gjykata e Apelit, megjithatë, la në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit për sa kishte të bënte me F.S. dhe e urdhëroi atë qiramarrës të lironte një dhomë në katin përdhes.

17. Kërkuesi apeloj në Gjykatën e Lartë duke parashtruar se J.D. nuk kishte pasur një autorizim të ligjshëm për zënien e pronës, sipas të cilit ai të mund të lidhte një marrëveshje qiramarrjeje. Në vijim, ai argumentoi se B.S. dhe M.S. kishin dhjetë vjet që jetonin jashtë vendit.

18. Më 19 korrik 2005, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë njohur të drejtat e padiskutueshme të kërkuesit ndaj shtëpisë. Megjithatë, për sa i përket J.D., Gjykata e Lartë konstatoi se duke qenë se në bazë të ligjit ai ishte i pastrehë, ligjërisht ai kishte zënë njërin prej apartamenteve, sipas një autorizimi shfrytëzimi, që prej vitit 1986. Në vijim, ai mori një vendim gjykate të formës së prerë në vitin 1993, vendim i cili mbeti i pavënë në fuqi, duke i dhënë të drejtën të vijonte qiramarrjen. Gjykata, në vijim gjykoi se edhe pse B.S. dhe M.S. jetonin jashtë vendit, ata po e zinin në mënyrë të ligjshme apartamentin me arsyen se ishin ligjërisht të pastrehë.

19. Gjykata e Lartë, në vijim deklaroi se për sa i përket nenit 14 të ligjit të pronës 1993, i cili parashikonte marrëdhënien midis ish-pronarëve dhe qiramarrësve (*shih paragrafin 42 më poshtë*) palët ndërgjyqjese kishin hapësira ligjore për rregullimin e marrëdhënieve të tyre.

3. Zhvillime të mëtejshme pasi çështja iu komunikua Qeverisë

20. Më 20 maj 2010, kërkuesi informoi Gjykatën se qiramarrësit të cilët jetonin në pronën e tij, pa i specifikuar emrat e tyre, kishin vdekur dhe se ai e kishte marrë shtëpinë në pronësi.

II. KUADRI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

A. Kuadri i brendshëm ligjor, në lidhje me privatizimin e banesave në pronësinë e Shtetit dhe mbështetja e Shtetit për familjet e pastreha

1. Ligji për privatizimin e banesave shtetërore (ligji i privatizimit – ligji nr. 7652, i datës 23 dhjetor 1992, i ndryshuar)

21. Ligji i privatizimit synonte të privatizonte banesat shtetërore dhe të krijonte një treg të lirë për strehimin, duke bërë të mundur në këtë mënyrë që qiramarrësit në këto banesa të bëheshin pronarë. Familjet që jetonin në banesat shtetërore, sipas marrëveshjes së qiramarrjes, mund t'i blinin ato banesa dhe të bëheshin pronarë që do t'i nënshtroheshin një pakete veprimesh, të tilla si pagesa e çmimit të plotë të privatizimit dhe regjistrimi i pronës në zyrën përkatëse për regjistrimin e tokës.

22. Neni 16 parashikon se të pastrehët kishin të drejtën të merrnin hua nga institucionet financiare për të zgjidhur nevojat e tyre të strehimit. Pagesat e interesit do të barteshin nga Shteti me anë të Entit Kombëtar të Banësive (EKB).

23. Neni 21 parashikon se banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private nuk do t'i nënshtroheshin privatizimit sipas ligjit për privatizimin. Duke qenë se qiramarrësit do të vijonin të paguanin qira, neni 19 parashikonte se qiratë për banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, do të lroheshin prej muajit dhjetor 1995. Neni 21/1, i variantit të vitit 1994, parashikonte se banesat shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, për të cilat nuk ishte paraqitur asnjë kërkesë për kthim, sipas ligjit të pronës 1993, do të vijonin të administroheshin dhe të mirëmbaheshin nga EKB-ja.

24. Sipas nenit 25, Shteti do t'i siguronte jetesën qiramarrësve në banesat që u përkisnin ish-pronarëve, dhe që do t'i lironin banesat sepse ato do t'i ktheheshin ish-pronarëve, në strehët me qira që do të ndërtoheshin në të ardhmen.

25. Ligji i privatizimit, veprimi i të cilit zgjerohej shpesh, të paktën deri më 31 dhjetor 1995, u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale, i ndryshuar në vitin 2007 (*shih paragrafin 37 më poshtë*).

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/1993

26. Pas kërkesës për shqyrtim kushtetues të ligjit për pronat, me argumentin se diskriminonte qiramarrësit të cilët kishin zënë pronat që do t'i ktheheshin ish-pronarëve, kërkesë që u paraqit në Gjykatën Kushtetuese nga 265 qiramarrës, të cilët kishin zënë ish-pronat private, më 27 gusht 1993, Gjykata Kushtetuese e kundërshtoi kërkesën si të pabazuar në fakte.

“Gjykata [Kushtetuese] konstaton se [ligji i privatizimit] dhe [ligji për pronën] rregullojnë problemet e privatizimit të banesave shtetërore dhe kthimin e pronave ish-pronarëve ose kompensimin e tyre.

Sipas të dyja ligjeve, qiramarrësit e banesave shtetërore kanë të drejtën t’i zotërojnë ato privatisht, sipas kushteve të parashikuara në ligj. Për të zgjidhur nevojat e tyre të strehimit, qiramarrësve të banesave të cilat u janë kthyer ish-pronarëve, u është dhënë e drejta të marrin hua nga institucionet financiare, pagesa e interesit të të cilave do të mbulohet nga Shteti, siç parashikohet shprehimisht në nenin 16 të ligjit ose, në një variant tjetër, ata do të strehohen si qiramarrës në njësitë e strehimit të cilat do të ndërtohen nga Shteti në përputhje me nenin 25 të këtij ligji.

Zgjidhjet e ndryshme për problemet e strehimit, të cilat u përkasin këtyre kategorive qiramarrësish nuk lindin prej ndonjë lloji diskriminimi midis tyre, por janë rezultat i statusit të ndryshëm që ata gëzojnë: të parët janë qiramarrësit e banesave shtetërore, të dytët janë qiramarrësit e banesave që u janë kthyer ish-pronarëve.

Kërkesa e ankuesve se janë diskriminuar [në mbështetje të faktit se i përkasin kategorisë së qiramarrësve, të cilët kanë zënë ish-pronat private], sipas ligjit të privatizimit dhe ligjit të pronës është e pabazuar në fakte.”

2. Kontributi i shtetit në ligjin për familjet e pastreha (“Kontributi në ligjin për familjet e pastreha” – ligji nr. 8030 i datës 15 nëntor 1995, i ndryshuar me ligjin nr. 8647 të datës 24 korrik 2000)

27. Sipas nenit 1, ligji synonte të përcaktonte detyrimet e Shtetit për familjet e pastreha (që janë familjet të cilat mbetën të pastreha si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit për privatizimin), duke u dhënë një kuotë për strehim dhe hua. Gjithashtu, ai synonte t’u jepte mundësinë të përfitonin nga tregu i lirë i pronës.

28. Sipas nenit 2, familjeve të pastreha u jepej e drejta të merrnin një kuotë për strehim nga Shteti. Sipas nenit 6, kuota mund të përdorej për të blerë godina nga Shteti ose persona privatë, për të blerë një sipërfaqe trualli për ndërtimin e një banese nga Shteti ose personat privatë dhe për të [paguar qiranë kontraktuale për përdorimin e një banese shtetërore ose private. Me shterimin e kuotës, statusi i familjes së pastrehë do të revokohej. Për më tepër, familjeve të pastreha u ishte dhënë e drejta për një hua nga Banka e Kursimeve e asaj kohe, për ndërtimin ose blerjen e një banese, sipas parashikimit në nenet 7 dhe 8.

29. Neni 2 i ndryshuar, në vijim parashikonte se familjet e pastreha, të cilat jetonin në banesa që u përkisnin ish-pronarëve do të trajtoheshin si një kategori me prioritet. Shteti do t’u siguronte strehim me anë të EKB-së. Privatizimi i këtyre njësisve strehuese do të kryhej në përputhje me ligjin e privatizimit, duke i shtuar tarifës së shitjes indeksin e korrigjimit të çmimeve.

30. Seksioni 11 parashikonte nocionin e liberalizimit të qirave, të cilat do të duhej të paguheshin nga qiramarrësit e pastrehë, që jetonin në banesa të cilat u përkisnin ish-pronarëve. Ai përcaktonte raportin e qirasë së pagueshme nga qiramarrësi dhe nga Shteti. Qiramarrësit do të duhej të paguanin një qira të ngjashme me atë të paguar për banesat shtetërore, e përllëgaritur në përputhje me përmasën e pronës që zinin. Shteti ishte i detyruar të paguante vlerën e mbetur të qirasë, të përllëgaritur në përputhje me qiratë e paguara për banesat shtetërore dhe përmasën e pronës. Në vijim, ky nen u shfuqizua nga Gjykata Kushtetuese në vitin 1997 (*shih paragrafin 35 më poshtë*).

31. Pas shfuqizimit të nenit 11 nga Gjykata Kushtetuese, neni 10 i ligjit, i ndryshuar në vitin 2000, parashikonte se deri në zgjidhjen e problemit të strehimit, qytetarët e pastrehë, të cilët jetonin në banesat që u përkisnin ish-pronarëve, do të paguanin qiranë, sipas normave që paguanin në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit të pronës 1993.

32. Kontributi në Ligjin për Familjet e Pastreha u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale në vitin 2004 (*shih paragrafin 37 më poshtë*).

a) Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 250, i datës 16 prill 1996, për procedurat dhe prioritetet në lidhje me zbatimin e kontributit në ligjin për familjet e pastreha, i ndryshuar (VKM-ja nr. 250/1996)

33. Familjet që jetonin në banesat private, të cilat u përkisnin ish-pronarëve ishin kategoria e parë e familjeve të pastreha, të cilat do të përfitonin nga dieta e strehimit e parashikuar në ligjin për familjet e pastreha, problemi i strehimit i të cilave do të trajtohej me prioritet, sipas përcaktimit në nenin 6. Neni 2.1 i vendimit parashikonte se si rezultat i zbatimit të ligjit për pronën 1993, marrëveshjet e mëparshme të qiradhënies të lidhura midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve dhe shtetit në atë moment gjykoheshin si të lidhura midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve në mbështetje të dokumentacionit që do të parashitrohej nga këta të fundit. Autoritetet e qeverisë lokale do të hartonin një listë me këto familje.

34. Neni 14 parashikonte se marrëveshjet ekzistuese të qiramarrjes midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve do të rinovoheshin me anë të ndihmës së autoriteteve të qeverisë lokale. Këto marrëveshje do të kishin një afat kohor, i cili zgjaste derisa qiramarrësi do të kishte përdorur plotësisht subvencionin e dhënë prej Shtetit. Sipas nenit 15, qiramarrësit që jetonin në banesat, të cilat u përkisnin ish-pronarëve, të cilat ishin brenda normave të strehimit do të duhej të paguanin tre të pestat e qirasë, ndërsa Shteti do të paguante pjesën e mbetur.

b) Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997

35. Sipas një kërkesë për shqyrtim kushtetues të ligjit për familjet e pastreha, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat ishin ish-pronë private, më 27 shkurt 1997, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizonte nenin 11 të këtij ligji. Pasi shqyrtoi kërkesën e parashikuar në VKM nr. 250/1996, qiramarrësit do të duhej t'u paguanin ish-pronarëve tre të pestat e vlerës së qirasë, Gjykata Kushtetuese konstatoi se raporti i qirasë së pagueshme nga qiramarrësit do të ishte pothuajse ekuivalenti i një pensioni pleqërie. Për sa i përket faktit se shumica e qiramarrësve të cilët jetonin në banesa që u përkisnin ish-pronarëve kishin dalë në pension dhe përfitonin nga pensioni i vjetërsisë ose merrnin ndihmë financiare, gjykata kishte parashikuar se ata do të ishin të detyruar të përdornin të gjithë pensionin ose ndihmën financiare kundrejt pagesës së qirasë, duke e klasifikuar dhënien e saj pa asnjë qëllim dhe strehimin e tyre të pambrojtur. Rrjedhimisht, do të ishte jopraktike të zbatohej ligji në fjalë, i cili do të kishte ndikim negativ mbi interesat e qiramarrësve dhe ish-pronarëve.

36. Gjykata Kushtetuese udhëzoi miratimin e një dispozite të re, e cila do të rregullonte detyrimin e qiramarrësve, të cilët zinin ish-banesat private në mënyrë që ata t'i paguanin qiranë ish-pronarëve brenda kapacitetit të tyre financiar, deri në zgjidhjen e problemit të strehimit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese rekomandonte se një parashikim i ri do të parashikonte indeksimin e kuotës së strehimit ndaj ndryshimit të çmimeve.

3. Programet sociale për strehimin e banorëve të ligjit për zonat urbane (ligji për programet sociale – ligji nr. 9232, i datës 13 maj 2004, i ndryshuar)

37. Ligji për programet sociale, i cili në vitin 2004 shfuqizoi ligjin për familjet e pastreha dhe në vitin 2007, ligjin e privatizimit synonte të parashikonte mundësitë për strehim të përballueshëm dhe të përshtatshëm, duke pasur në vëmendje kapacitetin financiar të familjeve, të cilat kishin nevojë për strehim. Ligji në fjalë parashikonte tre tipa programesh strehimi social: i. programet për garantimin e strehimit social me qira; ii. programet për parashikimin e strehimit me kosto të ulët; iii. programet për pajisjen e truallit me infrastrukturë (neni 3). Familjet të cilat nuk kishin përfituar nga zbatimi i ligjit të privatizimit, në rastin kur përmbushnin kërkesat e parashikuara në ligjin e programeve sociale, do të trajtoheshin me prioritet në përputhje me nenin 5.

38. Ligji për programet sociale u shfuqizua me hyrjen në fuqi të ligjit për strehimin social, në nëntor 2018.

B. Kuadri ligjor i brendshëm në lidhje me kthimin dhe kompensimin e pronës

1. Kushtetuta

39. Neni 41 i Kushtetutës, e cila hyri në fuqi në vitin 1998, parashikon se e drejta ndaj pronës private mbrohet me ligj. Ligji mund të parashikojë shpronësimin ose kufizimet në ushtrimin e një të drejtë ndaj pronës vetëm në interesin publik.

40. Neni 131 (f) i Kushtetutës parashikonte në periudhën në fjalë se Gjykata Kushtetuese do të dëgjonte ankesat përfundimtare nga individët që pretendonin një shkelle të së drejtës së tyre kushtetuese për një seancë të drejtë dëgjimore, pasi të jenë shfrytëzuar të gjitha mjetet ligjore për mbrojtjen e asaj të drejte.

2. Ligji për pronën

a) Ligji për pronën 1993 (ligji nr. 7698, i datës 15 prill 1993, i ndryshuar)

41. Sipas ligjit për pronën 1993, ish-pronarët ose trashëgimtarët e tyre të ligjshëm kishin të drejtën të pretendonin pronësinë e tyre ndaj pronës fillestare të paluajtshme, e cila ishte shpronësuar, shtetëzuar ose konfiskuar nga regjimi komunist. Sipas përcaktimit për pronësinë, ata kishin të drejtën ose t'iu rikthehej prona e tyre fillestare e paluajtshme ose t'u jepej kompensim në vend të njëres prej formave të parashikuara në ligj. Megjithatë, sipas ligjit për pronën, vendimi i autoriteteve për t'i kthyer pronën ish-pronarëve nuk ndikonte marrëveshjet paraprake ekzistuese të qiramarrjes, të cilat u jepnin të drejtë qiramarrësve të vijonin t'i mbanin të zëna ato prona.

42. Parashikimi përkatës i ligjit për pronën 1993, siç u referua në vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 9 korrik 2005, në paragrafin 19 më sipër, parashikon si më poshtë:

Neni 14

“Marrëdhëniet midis qiramarrësve dhe ish-pronarëve që bëhen pronarë sipas këtij ligji rregullohen me [ligjin për privatizimin].

Në qoftë se ... ish-pronari i siguron qiramarrësit banesë tjetër brenda së njëjtës qendër [të pushtetit lokal] të banuar, me sipërfaqe banimi aq sa u takon sipas normave të strehimit në momentin e daljes së këtij ligji, por jo më tepër se sa ka, atëherë qiramarrësi është i detyruar të lirojë banesën.

Shteti detyrohet të zgjidhë, në përputhje me normat aktuale të strehimit, strehimin e qiramarrësve të sotëm, duke u dhënë përparësi familjeve me të ardhura të pakta financiare.

Me dëshirën e ish-pronarëve, ata mund të kompensohen sipas mënyrave të përcaktuara në këtë [ligj].”

b) Ligji për pronën 2004 (ligji nr. 9235, i datës 29 korrik 2004, i ndryshuar)

43. Për sa ka të bëjë me çështjen, ligji për pronën 2004, që shfuqizon ligjin për pronën 1993, dhe që ka hyrë në fuqi më 15 shtator 2004, parashikonte:

Neni 9

“Pronat të cilat janë pronë e ish-pronarëve do të lirohen nga qiramarrësi/t brenda tre vjetësh. Qiramarrësit do të vijojnë të paguajnë qiranë e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave për dy vite pas hyrjes në fuqi të këtij ligji. Këshilli i Ministrave është përgjegjës për strehimin e qiramarrësve të pastrehë, duke u garantuar një banesë me qira të ulët, ose duke garantuar një banesë qiraja e së cilës mbulohet nga Shteti.”

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005

44. Sipas një kërkesë për shqyrtim kushtetues të nenit 9 (1) të ligjit në fjalë, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat më herët kishin qenë prona private, më 2 nëntor 2005, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi atë dispozitë si jokushtetues. Gjykata i vuri rëndësi faktit se dispozita kishte përkeqësuar statusin e qiramarrësve krahasuar me parashikimet që kishin ekzistuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit për pronat 2004. Ajo konstatoi se ndryshimi në legjislacion nuk respektonte parimin e sigurisë ligjore. Ajo arriti në përfundimin se një kufizim mbi të drejtën e qiramarrësve ndaj strehimit nuk mund të justifikohet nga interesi publik, duke përkrahur të drejtat ndaj pronës së ish-pronarëve. Vendimi, për sa ka lidhje me çështjen, parashikon si më poshtë:

“Deri në hyrjen në fuqi të parashikimit të mësipërm, qiramarrësve të banesave shtetërore, të cilat ishin ish-prona private, u jepeshin disa të drejta... veçanërisht: një qira fikse në nivelet e vitit 1993, derisa të gjendej një zgjidhje për problemi e strehimit; një dispozitë për strehim nga Shteti me anë të Agjencisë Shtetërore Kombëtare të Strehimit, në përputhje me kriteret e parashikuara në [Ligjin e Privatizimit 1992]. Në mbështetje të këtyre parashikimeve, Shteti, fillimisht, ndërmori të garantonte strehim me anë të privatizimit, në përputhje me kriteret të cilat përdorshin për privatizimin e strehimit në vitin 1992, dhe së dyti, garantonte se qiratë do të mbeteshin të pandryshuara deri në

zgjidhjen e problemit të [strehimit].

Neni 9(1) [i ligjit për pronën 2004] bën ndryshime të rëndësishme në të drejtat e qiramarrësve. Sipas parashikimeve të mëparshme, Shteti ndërmori të zgjidhte problemin e strehimit duke u bërë të mundur qiramarrësve të bëheshin pronarë në bazë të kriterëve, të cilat zbatoheshin për pjesën tjetër të popullsisë, megjithatë dispozita e kundërshtuar nuk e vendos atë detyrim shprehimisht ndaj Shtetit. Neni parashikon garantimin e strehimit me anë të banesave me qira të ulët, huat me interes të ulët ose [pagesën e] qirave... nga Shteti.

Për më tepër, në kontrast me dispozitën e mëparshme, e cila “ngrinte” qiratë deri sa të gjendej zgjidhja e problemit të strehimit, parashikimi i kundërshtuar parashikon shprehimisht pagesën e këtyre qirave “të ngrira” për dy vitet e parë pas hyrjes në fuqi të ligjit, duke lënë të kuptohet se qiratë do të ishin të liberalizuara në përfundimin e atij afati kohor.

Ligji i ri përmban parashikime të tjera, të cilat përkeqësojnë seriozisht statusin e qiramarrësve. Ligji i mëparshëm parashikonte se banesat do të liroheshin kur qiramarrësve të tyre do t’iu garantohej strehim i përhershëm, megjithatë dispozita e kundërshtuar në mënyrë arbitrare dhe pa dhënë ndonjë siguri të shprehur, parashikon se qiramarrësit duhet të lirojnë banesat brenda tre vjetëve.

Është e qartë se neni 9 (1) [i ligjit për pronën 2004] cenon ndjeshëm disa të drejta që qiramarrësit kishin kërkuar sipas legjislacionit të mëparshëm ...

Gjykata Kushtetuese vëren, gjithashtu, se neni 9 (1) shkel ... parimin e sigurisë ligjore ...

Siguria ligjore prezumon *inter alia*, se qytetarët duhet të kenë besim te Shteti dhe në pandryshueshmërinë e ligjit. Ai besim lidhet me faktin se qytetarët nuk duhet të shqetësohen vazhdimisht për natyrën vazhdimisht të ndryshueshme dhe pasojat e normave ligjore, të cilat cenojnë dhe përkeqësojnë statusin e përcaktuar më herët.

... Ky parim [i sigurisë ligjore] nuk mund të mbizotërojë në çdo shkallë. Kështu, nëse ndodh që rregullimi i ligjshëm i marrëdhënies ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga interesi publik, është ky i fundit që mbizotëron mbi parimin e sigurisë ligjore.

Në çështjen në fjalë, ndryshimi në ligjin në favor të një pjesë të caktuar të popullsisë nuk mund të justifikohet nga një interes publik thelbësor. Është e vërtetë se dispozita e ndryshuar favorizon pronarët e pronave; megjithatë, nga ana tjetër, ai diskriminon një grup tjetër (edhe pse i vogël në numër), duke cenuar të drejtën bazë për të jetuar të qiramarrësve dhe dispozitën për strehimin. Duke iu mohuar qiramarrësve të drejtat e tyre për t’u bërë pronarë dhe duke i dhënë fund qiramarrjes së tyre pa u garantuar një banesë tjetër nuk mund të justifikohet për asnjë arsye të interesit publik.”

c) Ligji për pronën 2006

45. Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005, i vitit 2006, neni 9 i ligjit të vitit 2004, u ndryshua me përmbajtjen si më poshtë:

Neni 9

“1. Pronat të cilat janë pronë e ish-pronarëve dhe të cilat iu dhanë me qira qiramarrësve nga Shteti, përpara hyrjes në fuqi të [ligjit për privatizimet 1992], të cilat u përdorën për nevoja strehimi, do t’u transferohen në pronësi ish-pronarit/ëve, kur përmbushet një prej kushteve si më poshtë:

a) nevojat për strehim të qiramarrësve janë përmbushur në çdo mënyrë tjetër të ligjshme;

b) ish-pronari i garanton qiramarrësit një banesë e cila ka një sipërfaqe jo më të vogël se sa banesa në të cilën ata tashmë zënë, dhe e cila është afërsisht në kushte të ngjashme dhe brenda së njëjtës qeverisje lokale, deri sa të vijë momenti që nevojat për strehim të qiramarrësve të përmbushen në një nga mënyrat e tjera të parashikuara në këtë seksion;

c) qiramarrësit përmbyllin një marrëveshje huaje me një institucion financiar, në përputhje me... [ligjin për programet sociale 2004];

d) qiramarrësit përfitojnë strehim ose një sipërfaqe toke sipas parashikimit në ... [ligjin për programet sociale 2004]”

...

4. Të pastrehët të cilët janë qiramarrës në banesa që janë pronë e ish-pronarëve dhe të cilët nuk kanë lidhur një marrëveshje huaje sipas nënparagrafit “c” të paragrafit të parë të këtij seksioni, ose nuk

iu është ofruar ende strehim, sipas nënparagrafëve “a”, “c” dhe “d” të paragrafit të parë të këtij neni, humbasin të drejtën e tyre për të zënë ligjërisht banesën deri më 31 dhjetor 2008. Atyre do t’iu ofrohen programe të posaçme strehimi, në përputhje me nenin 4 të ligjit për programet sociale. Ish-pronari do të ketë të drejtën të marrë në zotërim banesën nën pronësinë e tij.

5. Qiraja për banesat e zëna nga të pastrehët, sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij seksioni do të indeksohet ... në çmimin vjetor dhe në rritjet e pagave, dhe qëllimi i saj është mbulimi i shpenzimeve të pronarit për mirëmbajtjen dhe miradministrimin e banesës ...”

Vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 11/2007

46. Në vijim të një kërkesë për shqyrtim kushtetues të nenit të ndryshuar 9, me arsyen se ai shkelte parimin e të drejtave të fituara dhe gjetjet e Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 26/2005, paraqitur në Gjykatën Kushtetuese nga Shoqata e Qiramarrësve të Banesave Shtetërore, të cilat më herët ishin prona private, më 4 prill 2007, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi nenin e ndryshuar për të njëjtat arsye të parashikuara në vendimin e saj nr. 26/2005. Ajo urdhëronte miratimin e dispozitave të reja për të mbushur vakumin ligjor.

d) Akti normativ 2012

47. Më 1 gusht 2012, Qeveria paraqiti një akt normativ për lirimin e pronave të ish-pronarëve, të cilat vijonin të ishin të zëna nga qiramarrësit. Në vijim, akti normativ u miratua nga parlamenti, më 13 shtator 2012.

48. Afati për të liruuar vullnetarisht pronat e ish-pronarëve u vendos data 1 nëntor 2012. Në rastin e një pamundësie për të liruuar një pronë vullnetarisht brenda afatit të parashikuar kohor, AKS-ja me anë të një njoftimi me shkrim të ish-pronarit, do të lëshonte një urdhër dëbimi, i cili do të konsiderohej një vendim i ekzekutueshëm sipas kuptimit të Kodit të Procedurës Civile. Më pas, AKS-ja do t’i kërkonte Gjykatës së Rrethit të lëshonte një urdhër ekzekutimi të përmbarimit për lirimin e apartamentit. Neni 3 pengon ndalimin e ekzekutimit të urdhrat të përmbarimit.

49. Detajet e aktit normativ, duke përfshirë procedurat e pasuksesshme për shqyrtim kushtetues, paraqitur përpara Gjykatës Kushtetuese kundër tij, përshkruhen në vendimin e Gjykatës në çështjen *Baku dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vendim) nr. 43928/13 dhe 16 kërkesa të tjera, 10 prill 2018.

C. Praktikë tjetër gjyqësore e brendshme relevante

50. Në vendimet nr. 36/2002 dhe nr. 531/2002, Gjykata e Lartë pushoi paditë civile të pronarëve në lidhje me pagesën e qirave të tregut të lirë (të liberalizuara) nga qiramarrësit, duke zënë banesa, të cilat u ishin kthyer pronarëve, në cilësinë e tyre si ish-pronarë dhe i ridërgoi çështjet për shqyrtim përpara Gjykatës së Apelit. Gjykata e Lartë arsyetonte se neni 11 i ligjit për familjet e pastreha ishte shfuqizuar nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997. Në vijim, ajo pohoi se neni 10, ndryshuar në vitin 2000, parashikonte se qiramarrësit duhej të paguanin një qira në bazë të normave në të cilat kishin paguar në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit për pronën 1993 (*shih edhe paragrafin 31 më sipër*).

51. Në vendimin nr. 44, të datës 24 shkurt 2009, Gjykata e Lartë, në mbështetje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 26/2005 dhe nr. 11/2007, rrëzoi pretendimin e pronarit për lirimin e pronës së zënë nga qiramarrësit, për aq sa problemi i qiramarrësve për strehim nuk ishte zgjidhur nga autoritetet. Për pasojë, Gjykata e Lartë e kundërshtoi pretendimin për pagesë të një qiraje të tregut të lirë nga qiramarrësit.

LIGJI

I. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS

52. Kërkuesi u ankua se ishte shkelur neni 1, i protokollit nr. 1 të Konventës, në lidhje me pamundësinë e tij të rifitonte pronësinë e shtëpisë së tij dhe të merrte të ardhura prej saj.

Neni 1 i protokollit nr. 1 parashikon si më poshtë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive, në përputhje me interesin e

përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

53. Qeveria parashtroi se kërkuesi nuk kishte shfrytëzuar mjetet e brendshme, më konkretisht një ankesë në Gjykatën Kushtetuese, sipas nenit 131 të Kushtetutës së Shqipërisë për një shkelje të pretenduar të të drejtave të tij. Gjithashtu, Qeveria parashtroi se ankuesi nuk kishte paraqitur një padi administrative ose nuk kishte dorëzuar një padi civile ndaj aktit administrativ, i cili i kishte dhënë statusin e të pastrehuarit qiramarrësve që jetonin në pronën e tij.

54. Kërkuesi, në mbështetje të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997, 26/2005 dhe 11/2007, parashtroi se një ankesë kushtetuese do të kishte qenë joefikase, përderisa ajo gjykatë nuk kishte mbrojtur të drejtat e ish-pronarëve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

55. Gjykata kujton se të vetmet mjete të cilat kërkohen të shterohen nga neni 35 §1 i Konventës janë ato që lidhen me shkeljen e pretenduar dhe mund të kompensojnë shkeljen e pretenduar. Ekzistenca e këtyre mjeteve duhet të jetë mjaftueshëm e sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, mosrealizimi i të cilave do të pengojë aksesueshmërinë e nevojshme dhe efikasitetin: i takon Shtetit përgjegjës të përcaktojë nëse këto kushte janë përmbushur (*shih, së fundmi, Magyar Kétfarkú Kutya Párt kundër Hungarisë [DHM] nr. 201/17, §52, 20 janar 2020*).

56. Gjykata vëren se sipas nenit 131 (f) të Kushtetutës në periudhën në fjalë, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente për shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara të së drejtës për një seancë të drejtë dëgjimore, garantuar nga neni 6 i Konventës, për të drejtat kushtetuese të kërkuarit. Ky mjet ishte i jashtëzakonshëm, duke qenë se Gjykata Kushtetuese do të duhej të shqyrtonte procedimet në tërësi, që nga procedimet përpara gjykatës së shkallës së parë, te procedimet përpara Gjykatës së Lartë, për aq sa ato lidheshin me një shkelje të pretenduar të së drejtës për një seancë të drejtë dëgjimore, të drejtë të mbrojtur nga neni 6 i Konventës (*shih Jakupi kundër Shqipërisë (vendim) nr. 11186/03, 1 dhjetor 2009, dhe Balliu kundër Shqipërisë (vendim) nr. 74727/01, 30 shtator 2004*).

57. Duke u kthyer te Çështja konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi nuk pohoi në asnjë pikë të procedimeve përpara kësaj Gjykatë se i ishin shkelur të drejtat sipas nenit 6 të Konventës. Në fakt, e vetmja ankesë e tij, në bazë të së cilës u njoftua Qeveria e paditur për çështjen, kishte të bënte me një shkelje të gëzimit të qetë të pronës së tij, garantuar nga neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës. Në këto rrethana, Gjykatë vlerëson se për qëllime të nenit 35 §1 të Konventës, apelimi kushtetues në periudhën konkrete nuk do të ishte një mjet, i cili do të mund të kishte qenë efikas në praktikë për ankesën aktuale. Për këtë arsye, kërkuarit nuk iu kërkua që ta shfrytëzonte atë mjet dhe për pasojë Gjykata vendos të rrëzojë këtë kundërshtim.

58. Gjithashtu, Gjykata vëren se ankuesi ndërmoi procedime ligjore përpara gjykatave vendëse, në mënyrë që qiramarrësit të lironin pronën e tij. Në vendimin e saj përfundimtar, Gjykata vlerëson, se ndryshe nga kundërshtimi i Qeverisë, do të kishte qenë e pavlerë që kërkuesi në ndërmerre procedime të veçanta për të kundërshtuar statusin e të pastrehut të qiramarrësve. Për këtë arsye, Gjykata e rrëzon këtë kundërshtim.

59. Gjykata konstaton se kërkesa nuk është qartazi e pabazuar në fakte, sipas kuptimit të nenit 35 §3 (a) të Konventës. Duke mos qenë e papranueshme në secilin argument tjetër, atëherë ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Kërkuesi

60. Kërkuesi parashtroi se ai ishte privuar nga zotërimi i pronës së tij dhe nga përdorimi i të ardhurave në treg. Shteti nuk i kishte garantuar mirëmbajtjen e pronës, gjë e cila do të kërkonte kosto shtesë, për ta kthyer atë në gjendje të mirë. Kërkuesi argumentoi se paragrafi i parë i nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës aplikohet në çështjen në fjalë.

61. Kërkuesi parashtroi se asnjë autoritet ose gjykatë e brendshme nuk e kishte përshkruar ndonjëherë ndërhyrjen e bërë në interesin publik. Një interes i tillë nuk kishte ekzistuar as kur numri i qiramarrësve ishte shumë më i vogël sesa numri i ish-pronarëve. Për shembull, në Tiranë gjendeshin më pak se 960 familje që jetonin në banesat e ish-pronarëve. Në vijim, ai parashtroi se ndërhyrja kishte vijuar për 19 vjet (nga viti 1990 deri në vitin 2009) dhe në këtë mënyrë situata nuk mund të konsiderohej më tej e jashtëzakonshme.

62. Për sa i përket testit të proporcionalitetit, kërkuesi parashtroi se ish-pronarët nuk kishin gëzuar ende plotësisht të drejtat e tyre për pronën, gjatë gjithë asaj kohe. Nuk ishte vendosur asnjë balancë midis interesave konkurrues; Shteti kishte favorizuar qiramarrësit në dëm të të drejtave të ish-pronarëve. Megjithatë, në situatën e tij, dëbimi i qiramarrësve nuk do të kishte rezultuar në ndonjë pasojë të rëndë ose prishje të rendit publik, duke qenë se B.S. dhe M.S. jetonin jashtë vendit, dhe J.D. jetonte vetëm.

63. Kërkuesi parashtroi se ish-pronarëve u ishte paguar një qira e ulët mujore, e barasvlershme me qiranë që kishte ekzistuar përpara vitit 1990, më konkretisht dy euro në muaj, ndërsa qiraja mujore e tregut të lirë faktikisht ishte shumë më e lartë. Së bashku me motrat dhe vëllezërit e tij, ai do të kishte fituar 2,160 euro në muaj duke e dhënë shtëpinë me qira.

64. Autoritetet nuk kishin marrë masa për të garantuar strehimin e qiramarrësve në përputhje me ligjin për familjet e pastreha dhe legjislacionin dytësor, i cili i klasifikonte ata si kategori prioritare (*shih paragrafin 33 më sipër*). Në të kundërt, gjatë viteve, autoritetet i kishin garantuar strehim kategorive të tjera të familjeve të pastreha. Me hyrjen në fuqi të ligjit për programet sociale, qiramarrësit që jetonin në banesat e ish-pronarëve nuk pozicionoheshin më në një kategori prioritare, ndërsa kategoria e familjeve që kualifikoheshin në programet për strehim social ishte rritur. Gjithashtu, ai parashtroi se Gjykata Kushtetuese, me anë të vendimeve të saj nr. 26/05 dhe 11/07, kishte rrëzuar parashikimet e Ligjit për Pronën, i cili parashikonte një zgjidhje për problemin. Që prej asaj kohe, dhe deri në datën kur kërkuesi parashtroi vërejtjet e tij, më 4 shtator 2009, autoritetet nuk kishin ofruar ndonjë mjet tjetër. Gjithashtu, ai parashtroi se ish-pronarët kishin pasur një barrë të shpërpjesëtuar për një periudhë të gjatë, pa shpresë për zgjidhje. Nuk ekzistonte asnjë akt ligjor apo garanci procedurale që zgjidhte problemin me të cilin përballeshin ata.

b) Qeveria

65. Qeveria parashtroi se për këtë çështje do të parashtrohej paragrafi i dytë i nenit 1 i protokollit nr. 1 i Konventës. Ata pranonin se kishte pasur një ndërhyrje me të drejtën e kërkuesit për pronë. Megjithatë, ndërhyrja ishte parashikuar nga ligji dhe kishte ndjekur edhe një qëllim legjitim, më konkretisht, mbrojtjen e të drejtave të qiramarrësve për strehim. Në vijim, Qeveria parashtroi se ndërhyrja kishte filluar nën regjimin komunist dhe kishte lidhje me procesin e tranzicionit në vend.

66. Për sa i përket testit të proporcionalitetit, Qeveria parashtroi se ndërhyrja ishte bërë në kontekstin e politikave që synonin drejtësi sociale për individët dhe familjet, të cilët kishin nevojë për mbrojtjen e së drejtës së tyre për jetë familjare dhe së drejtës së tyre për një shtëpi. Situata mund të klasifikohej si e jashtëzakonshme. Më konkretisht, procedimet për dëbimin e qiramarrësve do të shoqëroheshin me pasoja të rënda për rendin publik, duke ndikuar në këtë mënyrë qindra familje. Ekzekutimi i menjëhershëm i vendimeve administrative që njihnin të drejtat ndaj tokës së ish-pronarëve do të kishte prekur nivelet minimale të jetesës së gëzuar nga qiramarrësit, ndërsa ish-pronarët nga ana tjetër, përfitonin disa të ardhura nga pagesa e qirasë. Shteti kishte autoritetin të ndërhynte në problemin e strehimit, i cili nuk mund t'i lihej plotësisht logjikës së tregut. Në vlerësimin e interesave konkurrues midis të drejtave të ish-pronarëve dhe nevojave për strehim të qiramarrësve, Palëve Shtetërore u lihej një marginë vlerësimi për përzgjedhjen e mjeteve të nevojshme për të arritur atë qëllim. Në vijim ato parashtronin se Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj kishte vendosur në favor të qiramarrësve, duke pasur në konsideratë parimin e sigurisë ligjore.

67. Në vijim, Qeveria parashtronte se Shteti shqiptar ishte përpjekur disa herë të gjente një zgjidhje për problemin, por kompleksiteti i situatës dhe fakti se disa masa ishin rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese nënkuptonte se ata nuk e kishin gjetur një të tillë. Megjithatë, autoritetet e brendshme kishin marrë dhe ende po merrnin masa procedurale dhe institucionale për të zgjidhur problemet e strehimit të qiramarrësve. Për shembull, autoritetet lokale ishin përgjegjëse për ndërtimin e strehimit për t'iu siguruar atyre streha. Procesi i ndërtimit kërkonte një kohë të caktuar për shkak të numrit të madh të familjeve të përfshira, konkretisht 5,000. Megjithatë, ato po merrnin masa për të zgjidhur problemin sa më shpejt të ishte e mundur.

68. Duke u kthyer në çështjen në fjalë, Qeveria parashtronte se kërkuesi nuk kishte nevojë për strehim. Prona e tij ishte dhënë me qira personave, të cilët kishin statusin e të pastrehut. Ata kishin paguar qiranë, e cila ishte kontrolluar nga Shteti dhe e cila nuk ishte hequr ende. Për këtë arsye, nuk mund të thuhet se ndërhyrja përbënte një barrë serioze për kërkuenin dhe ish-pronarët e tjerë, sepse ishte e një natyre të përkohshme.

2. Vlerësimi i Gjykatës

69. Gjykata vëren se, e drejta e babait të kërkuetit për kthimin e pronës së tij u njoh më 27 shtator 1995, megjithatë periudha e shqyrtimit nga Gjykata filloi më 2 tetor 1996 – datë në të cilën Konventa hyri në fuqi për Shqipërinë – dhe përfundoi kur kërkuesi rifitoi zotërimin e pronës në vitin 2010 (*shih paragrafin 20 më sipër*).

a) Nëse kishte një ndërhyrje në gëzimin e qetë të kërkuetit të “zotërimeve” të tij

70. Gjykata e konsideron se është e nevojshme të përcaktohet ndërhyrja e pretenduar në çështjen konkrete, ekzistenca e së cilës nuk është kundërshtuar nga palët. Në lidhje me këtë, neni 1 i protokollit nr. 1 përmban tre rregulla të qartë: rregulla e parë i parashtruar në fjalinë e parë të paragrafit të parë është i një natyre të përgjithshme dhe parashtron parimin e gëzimit të qetë të pronës; rregullia e dytë e cila gjendet në fjalinë e dytë të paragrafit të parë mbulon privimin e zotërimeve dhe e bën atë objekt të një sërë kushtesh; rregulla e tretë e parashtruar në paragrafin e dytë njeh të drejtën e Shteteve Kontraktuese *inter alia* të kontrollojnë përdorimin e pronës, në lidhje me interesin e përgjithshëm. Të tria rregullat kanë të bëjnë me shkallë të caktuara të ndërhyrjes me të drejtën për gëzim të paqetë të pronës dhe për këtë arsye duhet të interpretohen në dritën e parimit të përgjithshëm të përcaktuar në rregullën e parë (*shih, midis autoriteteve të tjerë, G.I.E.M. S.R.L. dhe të tjerët kundër Italisë [DHM] nr. 1828/06 dhe 2 të tjerë, §289, 28 qershor 2018*).

71. Duke u rikthyer në çështjen konkrete, argumenti kryesor i kërkuetit është se ai nuk kishte mundësi të merrte zotërimin e pronës së tij, për faktin se ajo ishte e zënë nga qiramarrësit. Në procedimet e brendshme në lidhje me dëbimin e qiramarrësve, gjykatat e brendshme konstatuan se situata kishte qenë rezultat i veprimit të legjislacionit të brendshëm. Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar nxjerrjen e një konkluzioni tjetër. Ajo vëren se zbatimi kumulativ i statuteve të brendshme, më konkretisht ligji për privatizimin, kontributi në ligjin për familjet e pastreha dhe ligji për pronën, parashikonin të drejtën e qiramarrësit për të vijuar të mbante të zëna banesat private të cilat u ishin kthyer ish-pronarëve, si kërkuetit në çështjen konkrete.

72. Në vijim, Gjykata konstaton se ndërhyrja nuk përbënte as shpronësimin formal dhe as atë *de facto*. Pronësia e kërkuetit ndaj pronës ishte regjistruar në regjistrin e pronës (*shih paragrafin 13 më sipër*) dhe ai nuk e humbi kurrë atë pronësi apo të drejtën e tij për ta shitur pronën e tij. As autoritetet nuk ushtruan masa që rezultonin në transferimin e kësaj pronësie. Ndërhyrja, në këtë mënyrë, synonte bërjen objekt të pronës së tij ndaj një qiramarrje të vazhduar dhe jo ta merrnin atë prej tij në mënyrë të përhershme. Sipas rastit, Gjykata mendon se ndërhyrja në fjalë përbënte një masë e cila parashikonte kontrollin e përdorimit të pronës, sipas kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

b) Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar

i. Nëse ndërhyrja “parashikohet në ligj”

73. Kërkesa e parë dhe më e rëndësishme e nenit 1 të protokollit nr. 1 është se çdo ndërhyrje për gëzimin e paqhtë të zotërimeve duhet të jetë e ligjshme. Veçanërisht, paragrafi i dytë i nenit 1 parashikon se Shtetet kanë të drejtën të kontrollojnë përdorimin e pronës, ndërsa subjektet të drejtën e tyre me kushtin që ky kontroll të ushtrohet duke venë në zbatim “ligjet”. Për më tepër, parimi i ligjshmërisë presupozon se parashikimet e zbatueshme të ligjit të brendshëm janë mjaftueshëm të aksesueshme, precize dhe të parashikueshme në zbatimin e tyre (*shih, për shembull, Ghigo kundër Maltës nr. 31122/05, §51, 26 shtator 2006*). Me qëllim shqyrtimin e ligjshmërisë, Gjykata përsërit se kryesisht u takon autoriteteve të brendshme, veçanërisht gjykatave, që të interpretojnë dhe të zbatojnë ligjin e brendshëm dhe të vendosin për çështjet e kushtetutshmërisë (*shih, për shembull, RçL, s.r.o. dhe të tjerët kundër Republikës së Çekisë nr. 37926/05 dhe 4 të tjerë, §115, 3 korrik 2014*).

74. Fakti se ndërhyrja ishte e ligjshme ishte një çështje e padiskutuar nga palët. Siç shprehet në paragrafin 71 më sipër, Gjykata konsideron se baza ligjore për ndërhyrjen shtrihet në statutet e brendshme, të cilët ishin në fuqi në periudhën konkrete. Nuk ka asnjë tregues se parashikimet përkatëse të atyre statuteve, të interpretuar sipas gjykatave të brendshme, nuk përmbushnin kërkesat për aksesueshmëri të mjaftueshme, precizion dhe parashikueshmëri, pavarësisht ndryshimeve të vazhdueshme të legjislationit. Për këtë arsye, ndërhyrja parashikohet nga ligji, sipas parashikimit të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës.

ii. Nëse ndërhyrja ndoqi një qëllim legjitim

75. Çdo ndërhyrje me qëllim kontrollin e përdorimit të pronës mund të justifikohet vetëm nëse vërtetohet të jetë *inter alia*, “në përputhje me interesin e përgjithshëm”. Për shkak të dijenisë së tyre të përgjithshme të shoqërisë së tyre dhe të nevojave të saj, autoritetet e brendshme në parim janë më mirë të pozicionuara se sa gjyqtari ndërkombëtar në vlerësimin se çfarë është në interesin “e përgjithshëm” të “publikut”. Nocioni i interesit “i përgjithshëm” i “publikut” domosdoshmërisht është i gjerë. Veçanërisht, sfera të tilla si strehimi i popullsisë, të cilat shoqëritë moderne e konsiderojnë si nevojën kryesore sociale dhe i cili luan një rol qendror në mirëqenien dhe politikën ekonomike të Shteteve Kontraktuese, shpesh mund të kërkojë një lloj rregullimi nga Shteti. Në atë sferë, vendimet nëse dhe nëse po, ku, duhet t’i lihen plotësisht lojës së forcave të tregut të lirë ose duhet të jetë subjekt i kontrollit të Shtetit, ashtu si edhe zgjedhja e masave për të siguruar nevojat për strehim të komunitetit dhe të kohës për zbatimin e tyre, në mënyrë të domosdoshme përfshin shqyrtimin e çështjeve komplekse sociale, ekonomike dhe politike. Duke e konsideruar si të natyrshme që margjina e vlerësimit të disponueshëm për legjislaturën në zbatimin e politikave sociale dhe ekonomike duhet të jetë e gjerë, në shumë raste, Gjykata ka deklaruar se do të respektojë vendimin e legjislaturës për atë se çfarë është në interesin “e përgjithshëm” të “publikut”, vetëm në rast se ai vendim nuk është qartazi i pa themel të arsyeshëm (*shih midis autoriteteve të tjerë Hutten-Czapka kundër Polonisë [DHM] nr. 35014/97, §§165–66, GJEDNJ, 2006-VIII, dhe Amato Gauci kundër Maltës nr. 47045/06, §54, 15 shtator 2009*).

76. Gjykata pranon se legjislacioni i brendshëm, sipas interpretimit nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 5/1997 dhe 26/2005 (*shih paragrafët 35 dhe 44 më sipër*) synonte të parashikonte strehim për pjesën vulnerabël të shoqërisë, si për shembull, pensionistët, në një vend ku mundësia për të siguruar banesa nuk mund të përmbushte kërkesën. Gjithashtu, ai synonte ofrimin e akomodimit për çmime të arsyeshme dhe të përballueshme për ata anëtarë të popullatës me më pak të ardhura, të cilët nuk kishin mjetet financiare të paguanin akomodim alternativ. Gjykata është e përgatitur të pranojë se në rrethanat sociale dhe ekonomike të Shqipërisë, në periudhën konkrete, kontrolli i përdorimit të pronës së ankuesit kishte një qëllim legjitim për interesin e përgjithshëm, sipas parashikimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të protokollit nr. 1.

iii. Nëse ndërhyrja ishte e proporcionale

77. Çdo ndërhyrje në pronë duhet të kënaqë edhe kërkesën e proporcionalitetit. Ashtu si Gjykata ka deklaruar në mënyrë të përsëritur, duhet të gjendet një balancë e drejtë midis kërkesave të interesit të përgjithshëm të komunitetit dhe kërkesave të mbrojtjes së të drejtave themelore të individit, përpjekja për ta gjetur këtë balancë të drejtë e cila është e qenësishme në të gjithë Konventën. Balanca e nevojshme nuk vendoset në rastin kur personi konkret mban një barrë individuale (*shih, midis autoriteteve të tjerë Brumărescu kundër Rumanisë [DHM] nr. 28342/95, §78, GJEDNJ, 1999-V*). Shqetësimi për ta arritur këtë balancë reflektohet në strukturën e nenit 1 të protokollit nr. 1 si i tërë. Në çdo rast, me përfshirjen e një shkeljeje të pretenduar të atij neni, Gjykata për këtë arsye duhet të sigurojë, se nëse, për shkak të ndërhyrjes së Shtetit, personit në fjalë iu desh të përballonte një barrë të shpërpjestimuar dhe të madhe (*shih Bittó dhe të tjerët kundër Republikës së Sllovakisë nr. 30255/09, §97, 28 janar 2014*).

78. Në vlerësimin e respektimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, Gjykata duhet të bëjë një kontroll të përgjithshëm të një sërë interesash në konsideratë, duke mbajtur në mendje se Konventa synon të ruajë të drejtat, të cilat janë “praktike dhe efikase”. Duhet të shikojë çfarë fshihet pas anës sipërfaqësore dhe të hetojë realitetet e situatës për të cilën është bërë ankesë. Në rastet që kanë të bëjnë me veprimin e legjislativitetit të gjerë për strehimin, ai vlerësim mund të përfshijë jo vetëm kushtet e dhënies me qira marrë nga pronarët individualë dhe nivelin e ndërhyrjes së Shtetit në lirinë e kontratës dhe marrëdhëniet kontraktuale në tregun e qiradhënies, por edhe praninë e masave mbrojtëse të tjera, të cilat sigurojnë se funksionimi i sistemit dhe ndikimi i tij mbi të drejtat e një pronari nuk janë as arbitrare as të paparashikueshme. Pasiguria – qoftë legjislative, administrative ose e lindur prej praktikave të zbatueshme nga autoritetet – është një faktor për t’u marrë në konsideratë në vlerësimin e reagimit të Shtetit. Në të vërtetë, në rastin kur një çështje e interesit të përgjithshëm është në rrezik, është detyra e autoriteteve publike të veprojnë në kohën e duhur dhe në mënyrën e duhur dhe konsistente (*shih Immobiliare Saffi kundër Italisë [DHM] nr. 22774/93, §54, GJEDNJ 1999-V*).

79. Gjykata është e mendimit se shtytja kryesore e ankesës së kërkuarit përpara Gjykatës ka të bëjë me pamundësinë e tij për të rifituar zotërimin e pronës së tij, e cila ishte e zënë nga qiramarrësit sipas marrëveshjeve të qiramarrjes. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kuadri përkatës ligjor synonte të ofronte mbrojtjen e strehimit për një kategori të kufizuar qiramarrësish, të cilët do të ndikoheshin nga kthimi i pronave tek ish-pronarët në një kontekst tranzitor; si i tillë, ajo nuk mori në konsideratë një sistem të përgjithshëm kontrolli qiraje në përfitim të familjeve me të ardhura të pakta (*kerbaso Riedel dhe të tjerët kundër Sllovakisë nr. 44218/07 dhe 3 të tjerë; §§7 dhe 28 33, 10 janar 2017; Hutten-Czapka, cituar më sipër, §§154–225; dhe Mellacher dhe të tjerët kundër Austrisë, 19 dhjetor 1989, §§42–47, seritë A, nr. 169*). Gjithashtu, dhe më e rëndësishmja, skema, që prej fillimit, synohej të ishte për një afat të kufizuar kohe me Shtetin, i cili qartazi ushtronte përgjegjësinë për të siguruar zgjidhje alternative për strehim për qiramarrësit e prekur gjatë kësaj periudhe tranzitore (*shih paragrafët 23, 24 dhe 42 më sipër*). Në vijim, Gjykata vëren se si një rregull e përgjithshme, një marrëveshje qiramarrjeje normalisht do të lidhej në mënyrë vullnetare midis palëve me qiranë, e cila reflekton nivelin e tregut në kohën kur ishte lidhur marrëveshja. Megjithatë, në rastin konkret, siç edhe parashikohet në paragrafin 33 më sipër, marrëveshjet e qiramarrjes u krijuan *ex lege* nga transferimi i marrëveshjeve të mëparshme ekzistuese të lidhura midis qiramarrësit dhe Shtetit. Kërkuari nuk kishte ndikim në zgjedhjen e qiramarrësve ose në elementet thelbësore të marrëveshjeve të qiramarrjes. Por as nuk mund të argumentohet se kërkuari, në mënyrë implicite, kishte hequr dorë nga e drejta e tij për të zgjedhur qiramarrësit, duke qenë se ai nuk e pati kurrë mundësinë për ta ushtruar atë të drejtë (*shih R & L, s.r.r., dhe të tjerët, kundër Republikës Çeke cituar më sipër, §106*).

80. Për më tepër, duke iu referuar marrëveshjes së qirasë së lidhur midis njërit prej qiramarrësve dhe Shtetit, një kopje të së cilës e dha kërkuari, Gjykata vëren se marrëveshja nuk ishte e kufizuar në kohë. Megjithatë, kërkuari ndërmori procedimet për dëbim ndaj qiramarrësve. Gjykata vlerëson se detyra e gjykatave të brendshme ishte e vështirë në një çështje sensitive në nivel social. Ajo vëren se Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk u lejuan që të vendosnin një balancë të drejtë midis interesave në rrezik, për shkak të kufizimeve të ushtruara nga legjislativi i brendshëm.

81. Për më tepër, Gjykata nuk është e bindur se interesat e dy qiramarrësve, konkretisht B.S. dhe M.S., të cilët kishin jetuar jashtë vendit që përpara fillimit të procedimeve gjyqësore, duhet të kishin mbizotëruar, në mbështetje të nenit 1 të protokollit nr. 1, mbi interesat e kërkuesit ndaj pronës. Më i rëndësishëm është fakti se kërkuesi nuk kishte mundësi të përfntonte qira të arsyeshme, duke qenë se niveli i qirasë ishte i ngrirë në nivelin që kishte qenë në vitin 1993 (*shih paragrafët 35, 31 dhe 50 në atë rend*) dhe gjatë gjithë pjesës tjetër të periudhës nën vëmendjen e Gjykatës (*shih paragrafin 69 më sipër*). Për më tepër, legjislacioni nuk parashikonte ndonjë përshtatje të qirasë për të marrë në konsideratë ndryshimet në inflacion.

82. Pas rezultatit të pasuksesshëm të procedimeve për dëbim, kërkuesi nuk kishte ndonjë mjet tjetër për të zgjidhur marrëveshjet. Kjo e bënte të pamundur që ai rifitonte zotërimin e pronës së tij, duke e lënë në dorë të qiramarrësve të zgjidhnin marrëveshjet e qiramarrjes. Një rrugë e tillë ishte një mundësi disi e largët në rrethanat e rastit konkret, pikërisht për shkak të pagesës së një qiraje fikse, ekzistencës së një marrëveshjeje qiramarrjeje me kohëzgjatje të papërcaktuar dhe mungesës së akomodimit të përballeshëm dhe të përshtatshëm. Fakti se e drejta e pronarit për të zgjidhur marrëveshjen e qiramarrjes ishte seriozisht e kufizuar përsëritet në vijimësi në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 51 më sipër*).

83. Kjo situatë e la kërkuesin në mënyrë të pashmangshme në një gjendje pasigurie “të vazhdueshme” për faktin nëse do të mund të ishte në gjendje ndonjëherë të rifitonte pronën e tij, pikërisht për shkakun se dispozitat statutorë të prezantuara në vitin 2004 dhe 2006 u shfuqizuan më pas në vitin 2005 dhe 2007 si të padrejta për qiramarrësit. Për më tepër, nuk u mor asnjë masa për të plotësuar vakumin pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese 11/2007 pavarësisht drejimit të marrë për këtë aspekt në atë vendim (*shih paragrafin 46 më sipër*). Qeveria e miratoi aktin normativ 2012 për lirimin e pronave të ish-pronarëve, të cilat vijonin të ishin të zëna nga qiramarrësit (*shih paragrafin 47 më sipër*). Gjithashtu, nuk është provuar se autoritetet kombëtare morën masa konkrete për të ofruar strehim alternativ për qiramarrësit, të cilët kishin zënë shtëpinë e kërkuesit, gjatë gjithë periudhës në shqyrtim nga Gjykata (*shih paragrafin 69 më sipër*). Kuadri kombëtar ligjor, sipas interpretimit nga gjykatat vendase dhe i zbatuar nga agjencitë respektive zbatuese, efektivisht e vendosi të gjithë barrën e një situatë komplekse në rend social mbi kërkuesin.

84. Së fundmi, kërkuesi nuk mund të qortohet për këtë situatë, duke qenë se ishte përtej kontrollit të tij, për arsyet e dhëna në paragrafët e mësipërm. Gjykata vëren se ai ishte i detyruar të priste për një kohë jashtëzakonisht të gjatë – më shumë se 13 vjet – përpara se të ishte në gjendje të rimerrte zotërimin e pronës së tij, gjë e cila përfundimisht nuk ishte për shkak të ndërhyrjes së autoriteteve.

85. Në mbështetje të këtyre konsideratave dhe, më specifikisht, duke marrë në konsideratë marrëveshjet e qiramarrjes të ushtruara nga ligji, mungesën e mekanizmave të përshtatshëm që ruajnë të drejtën e kërkuesit për të zgjidhur marrëveshjet e qiramarrjes, duke përfshirë mungesën e harkut kohor specifik të parashikuar nga ligji për këtë qëllim, vlerën e vogël të qirasë së përcaktuar nga ligji, e cila nuk lejonte këtë indeksim në inflacion (listën e çmimeve), periudhën e gjatë të pasigurisë në të cilën u gjend kërkuesi, Gjykata konstaton se kërkuesi është detyruar të përballojë një barrë të shpërpjestimuar dhe të madhe. Në vijim, Shteti nuk vendosi balancën e nevojshme të drejtë midis interesave të përgjithshëm të komunitetit dhe mbrojtjes të së drejtës së kërkuesit ndaj pronës.

86. Është shkëlur neni 1 i protokollit nr. 1 të Konventës.

II. ZBATIMI NENIT 41 TË KONVENTËS

87. Neni 41 i Konventës parashikon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

88. Kërkuesi paraqiti një raport vlerësimi, sipas së cilit ndërtesa me tri kate u vlerësua në vlerën rreth 351,300 euro dhe humbjen e përfitimit prej dhënies me qira të godinës për pesëmbëdhjetë vite (nga viti 1994, kur prona u rikthye nga autoritetet, deri në 2009, kur kërkuesi parashitroi kërkesën e tij

për shpërblim të drejtë) u përlogarit në vlerën 338,800 euro. Raporti i vlerësimit deklaronte se qiraja për metër katror në zonën përkatëse ishte 5–10 euro dhe se ai po kërkonte vlerën më të ulët, më konkretisht 5 euro për m². Përlllogaritja u bë në bazë të një qiraje fikse (5 euro) gjatë gjithë periudhës. Kërkuesi, gjithashtu, pretendonte se kishte shpenzimet për riparimet dhe dëmtimet, e shkaktuara gjatë viteve, pa e saktësuar shumën.

89. Qeveria i kërkoi Gjykatës që të vendoste se çdo konstatim shkelje do të përbënte në vetvete dëmshpërblim të mjaftueshëm për dëmin e vuajtur nga kërkuesi. Në një alternativë tjetër, Qeveria parashtrroi se pretendimi i kërkuesit ishte i paarsyeshëm dhe i pabazuar. Raporti i ekspertit nuk ishte i detajuar dhe godina kishte dy kate faktikisht.

90. Gjykata vëren se, në lidhje me shkeljen e konstatuar në çështjen konkrete, kërkuesit i jepet e drejta për dëmshpërblim. Megjithatë, Gjykata është e mendimit, se duke pasur parasysh interesin e përgjithshëm, për shkak të ndërhyrjes në të drejtat e kërkuesit ndaj pronës (*shih paragrafin 76 më sipër*), dëmshpërblimi për dëmin monetar të vuajtur nga kërkuesi duhet të kufizohet në kompensimin e duhur (*shih Statileo kundër Kroacisë nr. 12027/10, §156, 10 korrik 2014, dhe Bittó dhe të tjerët kundër Sllovakisë (dëmshpërblim i drejtë) nr. 30255/09, §22, 7 korrik 2015*).

91. Gjatë vlerësimit të dëmit monetar të mbuluar nga kërkuesi, Gjykata nuk mund të pranojë shumat që ka paraqitur ai. Gjykata përsërit se kërkuesi nuk u zhvesh kurrë nga të drejtat e tij ndaj pronës (*shih paragrafin 72 më sipër*). Përpjekja e tij për të vlerësuar humbjen e përfuturit nga qiraja, në vlerën 2,160 euro në muaj (*shih paragrafin 63 më sipër*) është spekulative. Së fundi, në mungesë të ndonjë parashtrimi specifik dhe dokumenti mbështetës, pretendimi i kërkuesit për shpenzime për sa u përket riparimeve dhe dëmtimeve nuk mund të pranohet. Nuk i takon Gjykatës t'i vendosë vlerën këtij pretendimi.

92. Gjykata e vlerëson të nevojshme që të kompensojë kërkuesin për dëmin monetar për pjesën e tij të pronës, duke risjellë në vëmendje se ai është një nga bashkëpronarët. Gjykata e konsideron të arsyeshme që t'i japë kërkuesit 30,000 euro për dëmin monetar.

93. Gjykata, duke vërejtur se kërkuesi nuk parashtrroi ndonjë pretendim për dëmin jomonetar, gjykon se nuk ka rrethana përjashtuese, që do të kërkonin dhënien në një shpërblimi në atë aspekt (*shih Nagmetov kundër Rusisë [DHM] nr. 35589/08, §§74-92, 30 mars 2017*).

B. Kostot dhe shpenzimet

94. Kërkuesi kërkoi edhe 2,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara gjykatave të brendshme dhe 2,000 euro për ato shpenzime të bëra përpara Gjykatës.

95. Qeveria kundërshtoi pretendimin e kërkuesit.

96. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtën për t'u rimbursuar për kostot dhe shpenzimet vetëm për sa është treguar se këto faktikisht dhe domosdoshmërisht janë bërë dhe janë të arsyeshme sipas shumës (*shih për shembull Gjyli kundër Shqipërisë nr. 32907/07, §72, 20 shtator 2009*). Në këtë pikë, rregulla 60 §§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës parashikon se kërkuesit mund të bashkëngjisin me pretendimet e tyre për dëmshpërblim të drejtë “çdo dokument relevant mbështetës”, dhe kur kjo nuk ndodh Gjykata “mund të kundërshtojë pretendimet plotësisht ose pjesërisht”.

97. Gjykata vëren se kërkuesi nuk parashtrroi ndonjë dokument mbështetës për pretendimet e tij për kostot dhe shpenzimet. Në këtë rast, Gjykata kundërshton pretendimin e tij.

C. Interes i papaguar

98. Gjykata vlerëson me vend që norma e interesit të papaguar duhet të mbështetet në normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, shumë së cilës i shtohen 3 për qind pikë.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. E deklaron kërkesën të pranueshme.
2. Vendos se është shkelur neni 1, i protokollit nr. 1, të Konventës.
3. Vendos:
 - i. Se Shteti i paditur duhet t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve nga data në të cilin vendimi bëhet i formës së prerë, në përputhje me nenin 44 §2 të Konventës, 30,000 euro (tridhjetë mijë euro) plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme, për dëmin monetar, i cili do të mbulohet në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e zgjidhjes.
 - a) Se nga përfundimi i tre muajve të përmendur më sipër deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm për shumat më sipër në një normë të barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së vonesës, plus tre pikë përqindjeje.
 4. Pushon pjesën tjetër të pretendimit të kërkuarit për kompensim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 23 qershor 2020, sipas rregullës 77 §§2 dhe 3 të Rregullave të Gjykatës.

Stanley Naismith
Sekretar

Robert Spano
Kryetar

SEKSIONI I DYTË
“ROBERT VEVECKA KUNDËR SHQIPËRISË”¹⁷

(nr. i kërkesës 40554/04)

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), më datë 26 maj 2020, mbledhi dhomën e përbërë nga:

Jon Fridrik Kjølbros, kryetar

Marko Bošnjak

Valeriu Grițco

Egidijus Kūris

Ivana Jelić

Darian Pavli

Peeter Roosma, gjyqtarë

dhe Stanely Naismith, sekretare e seksionit,

Duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të depozituar më 9 nëntor 2004;

Duke pasur parasysh vërejtjet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe vërejtjet në përgjigje të paraqitura nga kërkuesi;

pas diskutimeve, vendosi si vijon:

FAKTET

A. Historiku i çështjes

1. Në vitet ‘90 dhe 2000, për shkak të migrimit të madh të brendshëm të popullsisë, u ndërtuan në vend një numër i madh ndërtesash të paautorizuara, duke krijuar vendbanime informale. Nuk ishte e pazakontë që banorët e blloqeve ekzistuese të ndërtesave ngritën shtesa ose zgjerime të paautorizuara në ndërtesa, për qëllime banimi, bënë ndryshime strukturore në banesa ose kryen çfarëdo lloj punimi pa marrë lejen e kërkuar.

2. Për shkak të përballjes me numrin e lartë të vendbanimeve të tilla informale, si dhe të shtesave e zgjerimeve të paautorizuara në ndërtesat ekzistuese, dy akte legalizimi u miratuan në vitin 2004, me qëllim rregullimin e ndërtimeve të paautorizuara (*shih paragrafët 32 dhe 33 më poshtë*).

B. Rrethanat e çështjes

3. Kërkuesi, z. Robert Vevecka, është një shtetas shqiptar dhe austriak, i cili ka lindur në vitin 1950 dhe jeton në Vjenë. Pas komunikimit të kërkesës të Qeveria e paditur, kërkuesi informoi Gjykatën se ai kishte fituar shtetësinë austriake.

4. Më 5 dhjetor 1996, kërkuesi bleu një apartament me një dhomë gjumi në katin e katërt të një pallati pesëkatësh në Tiranë.

5. Duket se, ndërkohë që kërkuesi jetonte në Vjenë, në një datë të paspecifikuar banorët e pallatit të kërkuetit filluan të ndërtonin një shtesë anësore, e cila bashkohej me murin verior të ndërtesës.

6. Në janar 1999, gjatë një vizite në Tiranë, kërkuesi vuri re se po kryhej ndërtimi i shtesës dhe raportoi ndërhyrjen në pronën e tij te Policia e Ndërtimit (*Policia ndërtimore*).

7. Më 20 janar 1999, Policia e ndërtimit, duke vërejtur ekzistencën e një ndërtimi të dyshuar të paligjshëm, urdhëroi pezullimin e punimeve të ndërtimit në pritje të shqyrtimit të kundërvajtjes administrative (*shih paragrafin 31 më poshtë*). Procesverbali përcaktonte se “në momentin e ushtrimit të kontrollit, objekti i kundërligjshëm është në fazën e muraturës së katit IV dhe vendosjes së armaturës së kolonës së ndërtimit”.

8. Më 27 janar 1999, kërkuesi, duke qenë se punimet e ndërtimit kishin vazhduar me gjithë urdhrin e pezullimit, depozitoi një padi civile në Gjykatën e Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit) kundër

¹⁷ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 180*. Tiranë, 2020. f. 12558

kompanisë së ndërtimit dhe K.G., i cili ishte pronari i pretenduar i apartamentit të katit të katërt të shtesës. Në padinë e tij civile, kërkuesi kryesisht u mbështet në nenet 302 dhe 303 të Kodit Civil (KC) (*shih paragrafët 22 dhe 23 më poshtë*) dhe kërkoi: i. ndërprerjen e ndërhyrjes në të drejtat e tij të pronësisë; ii. pezullimin e punimeve të paautorizuara të ndërtimit; iii. prishjen e shtesës së paautorizuar; dhe iv. që ai të njihet si pronari i ligjshëm i apartamentit në katin e katërt të shtesës që mbështetej në apartamentin e tij. Kërkuesi pretendonte se shtesa kishte shkelur të drejtat e tij të pronësisë, pasi ajo kishte zvogëluar vlerën e apartamentit të tij duke penguar dritën, pamjen dhe ajrosjen dhe duke zënë pjesën e tij të parcelës që ndodhej nën ndërtesën kryesore. Gjithashtu u kishte mundësuar hajdutëve të hynin në apartament.

9. Më 18 shkurt 2000, Gjykata e Rrethit urdhëroi një raport ekspertit për të marrë informacion, ndër të tjera, mbi ligjshmërinë e shtesës, gjendjen e punimeve të ndërtimit dhe çdo dëm të shkaktuar në apartamentin e kërkuesit.

10. Më datë 9 mars 2000, siç u plotësua më datë 30 mars 2000, raporti i ekspertit përcaktonte se ishin ngritur dy zgjerime të paautorizuara, njëri bashkohej me anën veriore dhe tjetri bashkohej me anën lindore të ndërtesës që përfshinte apartamentin e kërkuesit. Në lidhje me shtesën anësore në konflikt, raporti përcaktonte se ajo ishte ndërtuar nga banorët e pallatit në të cilin ndodhej apartamenti i kërkuesit, pa marrë asnjë leje paraprake. Shtesa anësore kishte hyrje dhe shkallë më vete dhe nuk kishte hapje strukturore me asnjë nga apartamentet që ndodheshin në pallatin e kërkuesit.

Raporti më tej pohonte se kishte pasur ndërhyrje në shfrytëzimin e murit verior të apartamentit të kërkuesit, i cili ishte një mur mbajtës kallkan dhe shërbente si mur veshës për apartamentin që supozohej t'i përkiste K.G. dhe në shfrytëzimin e ngastrës së tokës që shtrihej nën banesë. Punimet e ndërtimit, të cilat konsistonin në mure të suvatuara dhe në vendosjen e dyshemesë, dritareve dhe dyerve, kishin përfunduar në apartamentin e katit të katërt me dy dhoma gjumi. Asnjë dëm nuk ishte vërejtur në murin verior të banesës së kërkuesit si rezultat i punimeve të ndërtimit.

11. Më 12 maj 2000, Gjykata e Qarkut, duke vërejtur se kërkuesi jetonte në Austri që prej vitit 1994, bëri gjetje në favor të tij. Duke pasur parasysh dëshirën e kërkuesit për të tërhequr dy padi: atë kundër kompanisë së ndërtimit dhe pretendimin për t'u njohur si pronar i ligjshëm i apartamentit me dy dhoma gjumi në katin e katërt të shtesës, gjykata vendosi të ndërpresë ato pjesë të procedimeve. Duke u mbështetur në raportin e ekspertit, gjykata gjeti se K.G., i cili kishte pranuar ndërtimin e paautorizuar të shtesës, kishte blerë apartamentin me dy dhoma gjumi në keqbesim nga pronarët e paligjshëm, të cilët kurrë nuk kishin pasur një titull pronësie mbi të dhe nuk kishin qenë kurrë banorë të pallatit të kërkuesit. Më tej, ajo vendosi se shtesa ishte ngritur në mungesë të lejes së vlefshme dhe dokumentacionit tjetër teknik. Gjykata, më në fund urdhëroi K.G. që të prishte apartamentin me dy dhoma në katin e katërt të shtesës së paautorizuar, e cila kishte shkelur të drejtat e pronësisë së kërkuesit, duke shfrytëzuar murin verior të apartamentit të tij.

12. Më 19 dhjetor 2000, pas apelimit të K.G. kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit, Gjykata e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit) e prishi atë dhe ia ktheu çështjen Gjykatës së Rrethit për një shqyrtim të ri nga një panel tjetër. Ajo vendosi që Gjykata e Rrethit nuk kishte vlerësuar aspekte të ndryshme të çështjes, të tilla si data në të cilën kishin filluar punimet e ndërtimit, veçanërisht nëse punimet e ndërtimit kishin filluar para ose pas marrjes së pronësisë nga kërkuesi, dhe nëse ish-pronarët e apartamentit të kërkuesit kishin dhënë pëlqimin për ndërtimin e shtesës. Me urdhërimin e K.G. për të prishur apartamentin e katit të katërt të shtesës, Gjykata e Rrethit, gjithashtu, nuk kishte arritur të jepte arsye në lidhje me pasojat që një prishje e tillë do të kishte për pronarët e pretenduar të apartamentit që do të ndërtohej në katin e pestë të shtesës. K.G. nuk mund të mbahej si përgjegjësi i vetëm për ndërtimin e paautorizuar të shtesës pesëkatëshe. Edhe pse raporti i ekspertit kishte deklaruar që apartamenti i kërkuesit nuk ishte dëmtuar si rezultat i punimeve të ndërtimit, ai nuk kishte demonstruar qartë ekzistencën e ndërhyrjes në të drejtat e pronësisë së kërkuesit.

13. Pas apelimit të kasacionit të kërkuarit kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, më 7 nëntor 2001, Gjykata e Lartë e refuzoi atë *de plano*, duke gjetur se arsyet e tij ishin jashtë objektit të arsyeve të kufizuara të apelit brenda kuptimit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) (*shih paragrafët 28 dhe 29 më poshtë*).

Procedurat e rishqyrtimit (seancave të reja dëgjimore)

14. Pas rikthimit të çështjes, Gjykata e Rrethit urdhëroi një raport të ri ekspertit, i cili u krye më 15 shtator 2002. Raporti i ekspertit përcaktoi se një shtesë anësore gjysmë e shkëputur, pesëkatëshe ishte ngritur dhe përfunduar në vitin 2002, bashkuar me murin mbajtës kallkan në anë veriore të ndërtesës së kërkuarit. Secili kat i shtesës kishte një apartament me dy dhoma gjumi, të cilat ishin të gjitha të zëna. Raporti nuk mund të përcaktonte natyrën e saktë të punimeve të ndërtimit të kryera nga kompania e ndërtimit, e cila kishte hedhur themelet. Ai vuri në dukje, megjithatë, se në mars 1995, kompania e ndërtimit u kishte dhënë mandate arkëtimi banorëve të ndërtesës së kërkuarit dhe se, në bazë të një kontrate (shitjeje) të datës 4 shtator 1996, S.S. i kishte shitur apartamentin e katit të katërt të shtesës D.D., i cili më pas ia kishte shitur atë K.G. Raporti nuk cilësoi ndonjë dëm të jashtëm, siç është lagështia, në muret e apartamentit të kërkuarit ose pengimi i dritës; ai vuri në dukje se suvaja kishte rënë nga muret e ballkonit të kërkuarit. Eksperti nuk kishte inspektuar ambientin e brendshëm të apartamentit të kërkuarit, i cili ishte i mbyllur me çelës.

15. Më 10 nëntor 2002, Gjykata e Rrethit rrëzoi padinë e kërkuarit. Duke bërë një vlerësim të provave në dosjen e çështjes, gjykata gjeti se kryerja e punimeve të ndërtimit kishte qenë pa leje, siç provohet nga urdhri i pezullimit i Policisë së Ndërtimit. Duke iu referuar faturave të kompanisë së ndërtimit, ajo zbuloi se punimet e ndërtimit kishin filluar para marsit 1995 dhe karabinaja e shtesës ishte ngritur në shtator 1996, kohë e cila ishte para blerjes së apartamentit nga kërkuari më 2 dhjetor 1996. Sipas pikëpamjes së gjykatës, kërkuari u ndalua të kërkonte pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe prishjen e shtesës përderisa ato pretendime u depozituan më 27 janar 1999, e cila ishte përtej afatit ligjor njëvjeçar të parashikuar në nenin 303 të Kodit Civil. Kërkuari nuk e kishte vërtetuar faktin se ai kishte jetuar jashtë shtetit që nga koha kur u bë pronar i apartamentit deri në vitin 1999, kur ai ngriti padinë e tij civile. As nuk kishte bërë një kërkesë për të ngritur padinë civile jashtë afatit. Gjykata e Rrethit, gjithashtu, vendosi që, në kohën që kërkuari kishte paraqitur padinë civile në vitin 1999, pjesa më e madhe e punimeve të ndërtesës kishin përfunduar, dhe K.G. kishte zënë apartamentin e katit të katërt të shtesës.

16. Gjykata e Rrethit konsideroi se kërkesa e kërkuarit për ndërprerjen e ndërhyrjes në të drejtat e tij të pronësisë, sipas nenit 302 të Kodit Civil ishte e pabazuar. Për arritjen e këtij konkluzioni, gjykata iu referua raportit të ekspertit (*shih paragrafin 14 më lart*), i cili kishte gjetur se shtesa anësore bashkohej me murin mbajtës kallkan të ndërtesës së kërkuarit dhe se ajo nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuarit. Gjithashtu, raporti i ekspertit kishte cilësuar se asnjë shenjë lagështie nuk ishte e dukshme në murin veshës dhe se asnjë dëm nuk mund të ndodhte në apartamentin e kërkuarit si rezultat i ndërtimit të shtesës. Në fund, Gjykata e Rrethit hodhi poshtë pretendimin e kërkuarit për t'u njohur si pronar i apartamentit në katin e katërt të shtesës si pa prova dhe pa bazë ligjore.

17. Kërkuari apeloj, duke argumentuar se Gjykata e Rrethit kishte legjitimuar një ndërtim të paligjshëm, i cili ishte ngritur në mungesë të lejes së ligjshme dhe në shkelje të rregulloreve të planifikimit urban. Ai pohoi se Gjykata e Qarkut kishte bërë një vlerësim të gabuar të provave. Për shembull, ai kishte qenë qiramarrës para se të bëhej pronar i apartamentit në vitin 1996 dhe shtesa kishte ndërhyrë në të drejtën e tij për mbrojtjen e pronës. Kryerja e punimeve të ndërtimit kishte filluar në vitin 1999, siç u provua nga urdhri i pezullimit i Policisë së Ndërtimit dhe ai ishte brenda afatit ligjor të parashikuar nga neni 303 i Kodit Civil për të ngritur padinë civile. Sidoqoftë, gjykata e kishte injoruar urdhrin e pezullimit, i cili përcaktonte se muratura për katin e katërt po vazhdonte. Në parashitjet e tij të mëtejshme, kërkuari, pa dhënë hollësi të mëtejshme, deklaroi se Gjykata e Apelit duhej t'i ishte referuar vendimit nr. 901 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 korrik 2000 (*shih paragrafin 27 më poshtë*).

18. Më 15 maj 2003, Gjykata e Apelit miratoi gjetjet e Gjykatës së Rrethit, la në fuqi vendimin e saj dhe rrëzoi ankesën e kërkuarit. Gjykata, pasi vlerësoi provat në dosjen e çështjes, rikonfirmoi, se: kërkuari kishte përvetësuar apartamentin e tij më 5 dhjetor 1996, punimet e ndërtimit për shtesën kishin filluar para 15 marsit 1995, punimet e ndërtimit kishin përfunduar dhe apartamentet e shtesës ishin të gjitha të zëna. Ajo hodhi poshtë pretendimin e kërkuarit sipas nenit 302 të Kodit Civil si të pabazuar, pasi kërkuari nuk kishte arritur të demonstroi se shtesa cenonte të drejtat e tij të pronësisë. Raporti i ekspertit kishte cilësuar se banesa e kërkuarit nuk kishte pësuar ndonjë dëm ose nuk ishte prekur në ndonjë mënyrë si rezultat i ndërtimit të shtesës. Gjykata më tej hodhi poshtë pretendimin e kërkuarit, sipas nenit 303 të Kodit Civil, si të paraqitur përtej afatit prej një viti të parashikuar nga ajo dispozitë.

19. Më 18 qershor 2004, pas apelit të kasacionit të kërkuarit, i cili përmbante të njëjtat arsye që ai kishte ngritur para gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën *de plano*, duke gjetur se arsyet e saj ishin jashtë objektit të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile.

20. Më 18 shkurt 2005, pas ankesës kushtetuese të kërkuarit, Gjykata Kushtetuese, me një panel prej tre gjyqtarësh, e deklaroi të papranueshme *de plano* ankesën e kërkuarit, duke përcaktuar se ankesa nuk ngriti çështje në lidhje me të drejtën e kërkuarit për një seancë të drejtë dëgjimore.

C. Ligji dhe praktika përkatëse në vend

1. Kushtetuta

21. Pjesët përkatëse të Kushtetutës, në kohën materiale, përcaktojnë sa më poshtë:

Neni 42 §2

“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Neni 131

“Gjykata Kushtetuese vendos për: ... f) gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.”

2. Kodi Civil (KC)

22. Neni 302 i Kodit Civil përcakton, se: “pronari [i një prone] ka të drejtë të kërkojë nga cilido që e cenon në pronësinë e tij, por pa u zhveshur nga posedimi, të pushojë cenimin, të mos përsërisë këtë në të ardhmen dhe, kur është rasti, të shpërblejë dëmet që mund t'i ketë shkaktuar”.

23. Neni 303 i Kodit Civil përcakton, se: “pronari [i një prone], i cili ka arsye të shqetësohet se nga një punim i ri i filluar nga një palë e tretë në pronën e tij ose të saj ose në pronën e të tjerëve, ka të drejtë të fillojë procedurat civile me kusht që punimet të mos kenë përfunduar ose të mos ketë kaluar një vit nga fillimi i punimeve të reja”. Gjykata, sipas rastit, vendos ndalimin e ndërtimit, shembjen e tij dhe urdhëron shpërblim ose rrëzon padinë civile.

24. Nenet 608 dhe 609 të Kodit Civil parashikojnë një padi nga ana e një pronari për shkeljen e një të drejte, i cili kërkon kompensim për dëmin në pronën e tij.

a) Praktika e Gjykatës së Lartë për interpretimin e nenit 303

25. Në vendimin e saj nr. 41 të datës 25 janar 2000, Gjykata e Lartë vendosi që katër kushtet e mëposhtme kumulative duhet të plotësohen për të shqyrtuar një padi civile sipas nenit 303 të Kodit Civil: i. paditësi duhet të jetë pronari ose poseduesi i një prone; ii. ekzistenca e punimeve të reja duhet të jetë e pranishme; iii. punimet e reja nuk duhet të kenë mbaruar dhe nuk duhet të ketë kaluar një vit nga fillimi i tyre; iv. ekzistenca e shkaqeve të arsyeshme se punimet e reja do të dëmtonin pronën e paditësit (*shih, gjithashtu, vendimin pasues nr. 341 të datës 27 mars 2007, i cili ndjek të njëjtin arsyetim*).

26. Në vendimet e saj nr. 1102, të datës 25 tetor 2001 dhe nr. 647, datë 9 prill 2003, Gjykata e Lartë hodhi poshtë ankesën e paditësve, sipas, ndër të tjera, nenit 303 të Kodit Civil, meqenëse ishte i parashikuar. Padia civile e paditësit ishte depozituar përtej afatit prej një viti (*shih, gjithashtu vendimet pasuese nr. 126, të datës 14 shkurt 2006 dhe nr. 769, të datës 5 qershor 2007, që ndjekin të njëjtën qasje*).

b) Praktika gjyqësore të tjera të përshtatshme të Gjykatës së Lartë

27. Vendimi nr. 901 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i datës 14 korrik 2000, siç referohet nga kërkuesi në apelin e tij (*shih paragrafin 17 më lart*), përcaktoi se gjykata që shqyrton një padi civile duhet të marrë një qëndrim në lidhje me të gjitha pretendimet. Vetëm paditësi mund të përcaktojë të paditurin/t dhe, si rregull, gjykata nuk mund të përcaktojë palët në procedurë. I padituri mund të vendosë të paraqesë një prapësim ose një kundërpadi në përgjigje të padisë civile.

3. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

28. Neni 472 i KPC-së, në kohën materiale, parashikonte, se: “Gjykata e Apelit dhe vendimet e Gjykatës së Rrethit mund të apelohej në Gjykatën e Lartë, nëse: a) ligji nuk është respektuar ose nuk është zbatuar në mënyrë korrekte; b) ka pasur shkelje serioze të rregullave procedurale; c) provat vendimtare të kërkuara nga palët gjatë gjykimit nuk janë pranuar; ç) arsyetimi i vendimit është qartësisht i palogjikshëm; ose d) janë shkelur dispozitat mbi juridiksionin dhe autoritetin.”

29. Neni 480 i KPC-së, në kohën materiale, parashikonte, se: “Gjykata e Lartë do të hedhë poshtë një ankesë nëse nuk përputhet me kërkesat e parashikuara në nenin 472 të KPC-së. Gjykata e Lartë vendos pa praninë e palëve për pranueshmërinë e ankesave.”

4. Ligji për planifikimin urban i vitit 1998 (ligji nr. 8405, i datës 17 shtator 1998, i ndryshuar)

30. Ligji për planifikimin urban i vitit 1998 përcaktoi rregullat e përgjithshme që rregullojnë planifikimin urban dhe arkitekturën e ndërtimeve në Shqipëri. Ligji krijoi një procedurë në dy nivele për marrjen e lejes së kërkuar. Fillimisht do të dorëzohet një kërkesë për leje planifikimi (kërkesa për shesh ndërtimi) për shqyrtim dhe miratim nga autoriteti kompetent bashkiak dhe ishte e nevojshme të merrej një leje ndërtimi përpara fillimit dhe kryerjes së çdo punimi ndërtimi.

5. Ligji për policinë e ndërtimit i vitit 1998 (ligji nr. 8408 i datës 25 shtator 1998)

31. Sipas ligjit për policinë e ndërtimit të vitit 1998, policia e ndërtimit ishte përgjegjëse për mbikëqyrjen e respektimit të legjislacionit për planifikimin urban, vendosjen e gjobave në rast të shkeljes së legjislacionit për planifikimin urban dhe vendosjen për pezullimin e punimeve të ndërtimit dhe urdhërimin e prishjes së ndërtimeve të paligjshme.

6. Ligjet për legalizimet të vitit 2004

32. Ligji për legalizimin e shtesave të ndërtesave (ligji nr. , i datës 23 mars 2004) hyri në fuqi në datë 25 maj 2004 dhe ligji për legalizimin e vendbanimeve të paligjshme (ligji nr. 9304, i datës 28 tetor 2004) hyri në fuqi në datë 24 dhjetor 2004 (të dyja “ligjet e legalizimit të vitit 2004”).

33. Sipas ligjeve për legalizimin të vitit 2004, kërkuessit duhet të paraqisnin një kërkesë për rregullimin e ndërtesave të tyre të paautorizuara brenda afateve të përcaktuara me ligj. Pas shqyrtimit të kërkesës, autoritetet kompetente do të lëshonin një leje legalizimi kundër pagesës së një tarife, duke njohur të drejtat e pronësisë së kërkuessve mbi ndërtesën e paautorizuar dhe token përkatëse.

34. Të dyja ligjet e legalizimit të vitit 2004 u shfuqizuan më pas nga ligji për legalizimet i vitit 2006 (ligji nr. 9482, i datës 3 mars 2006, i ndryshuar).

ANKESAT

35. Kërkuessi u ankua sipas nenit 6 §1 të Konventës për padrejtësi dhe zgjatje të paarsyeshme të procedurave. Ai, më tej, u ankua sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 për shkeljen e të drejtave të tij të pronësisë, për shkak të ndërtimit të paligjshëm të shtesës anësore.

LIGJI

A. Shkelja e pretenduar e nenit 6 §1 të Konventës

36. Kërkuessi u ankua sipas nenit 6 §1 të Konventës se procedurat ishin tepër të gjata dhe të padrejta.

37. Neni 6 §1 i Konventës, në pjesët përkatëse të tij përcakton:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ... të gjithë kanë të drejtë për një proces të drejtë ... brenda një kohe të arsyeshme ... nga [një] ... gjykatë ...”

1. Për sa i përket ankesës në lidhje me kohëzgjatjen e pretenduar të procedurave

38. Kërkuessi u ankua për kohëzgjatjen e procedurave në vend, sipas nenit 6 §1 të Konventës.

39. Gjykata përsërit se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet në kuadrin e

rrethanave të çështjes dhe duke iu referuar kritereve të mëposhtme: kompleksitetit të çështjes, qëndrimit të kërkuarit dhe autoriteteve përkatëse dhe çfarë ishte në rrezik për kërkuarin në konflikt (*shih, ndër të tjera Gazsó kundër Hungarisë nr. 48322/12, §15, 16 korrik 2015*).

40. Duke pasur parasysh kriteret e mësipërme, Gjykata vëren se ka pasur një grup procedurash, të cilat filluan më 27 janar 1999 dhe përfunduan më 18 shkurt 2005. Procedurat zgjatën gjashtë vjet në katër shkallë, tre prej të cilave e shqyrtuan çështjen dy herë.

41. Gjykata vlerëson se autoritetet vendëse kanë vepruar me shpejtësi nga 27 janari 1999 deri më 7 nëntor 2001. Ndërsa kthimi i çështjes për rishqyrtim, domosdoshmërisht i zgjati procedurat, zhvillimi i tyre i përgjithshëm nga 7 nëntori 2001 deri më 18 shkurt 2005, në katër shkallë, nuk zbulon ndonjë vonesë ose periudhë pasiviteti që do të shkelte nenin 6 §1 të Konventës. Gjithashtu, Gjykata konsideron se kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave nuk ka shkelur kërkesën për arsyeshmëri të kësaj dispozite.

42. Gjykata arrin në përfundimin se ankesa e kërkuarit në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35 §§3 dhe 4 të Konventës.

2. *Për sa i përket ankesës në lidhje me padrejtësinë e pretenduar të procedurave*

43. Kërkuari u ankua në bazë të nenit 6 §1 të Konventës se procedurat civile kishin qenë të padrejta, në atë që gjykatat vendëse kishin hedhur poshtë padrejtësisht padinë e tij, si rezultat i së cilës ata nuk kishin arritur të shqyrtonin argumentet e tij në mënyrë të plotë. Ai, gjithashtu, u ankua se vendimet e gjykatave më të larta nuk ishin të arsyetuara siç duhet.

44. Qeveria parashtroi se vendimet në vend ishin arsyetuar në mënyrën e duhur, se kërkuari kishte përfituar nga procedurat konfliktuale, të cilat, në tërësi, kishin qenë të drejta.

45. Gjykata përsërit se nuk është funksioni i saj të merret me gabimet e pretenduara të ligjit ose fakteve të kryera nga gjykatat kombëtare, përveçse nëse dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura nga Konventa (*shih, për shembull, Garcia Ruiz kundër Spanjës [GC] nr. 30544/96, §28, GJEDNJ 1999-1, dhe Perez kundër Francës [GC] nr. 47287/99, §82, GJEDNJ 2004-1*), për shembull, atje ku mund të thuhet se arrin në “padrejtësi” në shkelje të nenit 6 të Konventës. Ndërsa neni 6 garanton të drejtën për një proces të drejtë, ai nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën se si duhet të vlerësohen provat, këto janë kryesisht çështje për rregullim nga ligji kombëtar dhe gjykatat kombëtare. Në parim, çështje të tilla, si: pësia e dhënë nga gjykatat kombëtare për çështje të veçanta të provave ose për gjetjet ose vlerësimet që ju janë paraqitur atyre për shqyrtim nuk janë për t'u shqyrtuar nga Gjykata. Gjykata nuk duhet të veprojë si një organ i shkallës së katërt dhe për këtë arsye nuk do të vërë në pikëpyetje sipas nenit 6 §1 vlerësimin e gjykatave kombëtare, përveçse nëse gjetjet e tyre mund të konsiderohen arbitrare ose dukshëm të paarsyeshme (*shih, për shembull, De Tommaso kundër Italisë [GC] nr. 43395/09, §170, 23 shkurt 2017, dhe referencat e cituara në të*).

46. Efekti i nenit 6 §1 është që t'i vendosë gjykatat vendëse në detyrë që të kryejnë një shqyrtim të duhur të parashtresave, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa cenuar vlerësimin e tij, nëse ato janë relevante për vendimin e saj (*shih Carmel Saliba kundër Maltës nr. 24221/13, §64, 29 nëntor 2016*). Detyra e vetme e Gjykatës në lidhje me nenin 6 të Konventës është të shqyrtojë kërkesat që pretendojnë se gjykatat vendëse nuk kanë respektuar masa specifike mbrojtëse procedurale të parashikuara në atë nen ose që zhvillimi i procedurave në tërësi nuk i garantoit kërkuarit një proces të drejtë (*shih, për shembull, Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë [GC] nr. 38433/09, §197, GJEDNJ 2012, dhe Donadze kundër Gjeorgjisë nr. 74644/01, §§30–31, 7 mars 2006*).

47. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuari, duke u mbështetur në nenet 302 dhe 303 të Kodit Civil, filloi procedurat për ndërhyrje në të drejtat e tij të pronësisë, për shkak të ndërtimit të paautorizuar të shtesës anësore.

48. Gjykata vëren se kërkuari vazhdimisht ankohej për ndërtimin e paautorizuar të shtesës anësore, e cila ishte në qendër të kërkesës së tij sipas nenit 302 të Kodit Civil. Si përgjigje, Gjykata e Rrethit, në procedurat e rishqyrtimit, u dha një peshë të konsiderueshme argumenteve të kërkuarit dhe pranoi

paligjshmërinë e ndërtimit të shtesës anësore. Sidoqoftë, duke urdhëruar një raport të ri ekspertit, i cili arriti në përfundimin se apartamenti i kërkuarit nuk kishte pësuar ndonjë dëm të jashtëm, përfshirë lagështirën dhe se shtesa nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuarit, Gjykata e Rrethit, në procedurat e rishqyrtimit, hodhi poshtë pretendimin e tij (*shih paragrafin 16 më lart*). Në veçanti, Gjykata e Rrethit gjeti se neni 302 i Kodit Civil, i cili rregullon ndërhyrjen e vazhdueshme në gëzimin e pasurisë së dikujt, nuk ishte i zbatueshëm për rrethanat e çështjes së kërkuarit. Gjykata konstaton se Gjykata e Qarkut dha arsye, të cilat nuk mund të konsiderohen qartazi të paarsyeshme ose arbitrare.

49. Gjykata më tej vëren se kërkuari mund të përfitonte nga mundësia për të apeluar kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit (*shih paragrafin 17 më lart*). Ai nuk u ankua se nuk kishte përfitimin e procedurave konfliktuale. Në fazat e ndryshme të këtyre procedurave, qoftë personalisht ose përmes avokatit të tij, kërkuari mund të paraqiste argumentet që i konsideronte të përshtatshme për çështjen e tij. Në apel, Gjykata e Apelit, duke iu referuar gjetjeve të raporteve të ekspertit, la në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët, duke shpjeguar se kërkuari nuk kishte vërtetuar se kishte pasur një ndërhyrje në gëzimin paqësor të apartamentit të tij (*shih paragrafin 18 më lart*). Prandaj, Gjykata nuk konsideron që, për sa i përket pretendimit të kërkuarit, sipas nenit 302 të Kodit Civil, gjetjet e gjykatave vendëse ishin arbitrare ose haptazi të paarsyeshme.

50. Në lidhje me pretendimin e kërkuarit sipas nenit 303 të Kodit Civil, gjykatat vendëse gjetën se punimet e ndërtimit kishin filluar në një datë të paspecifikuar para marsit 1995 dhe kërkuari e bleu apartamentin e tij në 5 dhjetor 1996 (*shih paragrafët 15 dhe 18 më lart*), datë në të cilën ai së paku duhet të ketë qenë në dijeni të ndërtimit. Nuk ka asgjë në dosjen e çështjes që të tregojë se kërkuari nuk mund të parashikonte rrjedhën e punimeve të ndërtimit. As nuk mund të konkludohet se ai ishte penguar të vizitonte apartamentin dhe vendin e ndërtimit, si rezultat i së cilës ai nuk mund të kishte vërejtur punimet e ndërtimit.

51. Megjithatë, kërkuari depozitoi padinë e tij civile në Gjykatën e Rrethit, më 27 janar 1999, përtej afatit ligjor prej një viti të parashikuar në nenin 303 të Kodit Civil. Gjykata, se, pavarësisht nga data e zhvendosjes së aplikantit në Austri ose data e blerjes së apartamentit, gjykatat vendëse nuk duket se gabuan në llogaritjen e tyre të afatit prej një viti. Për më tepër, vlerësimi i provave nga gjykatat e vendit dhe interpretimi i ligjit vendës nuk ishte në mospërputhje me praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë për këtë çështje (*shih paragrafët 25 dhe 26 më lart*). Si pasojë, vendimi i gjykatave vendëse që përcakton pretendimin e kërkuarit sipas nenit 303 të Kodit Civil, si të parashkruar nuk ishte as arbitrar dhe as haptazi i paarsyeshëm.

52. Në fund, Gjykata vëren se ankesa e kasacionit të kërkuarit në Gjykatën e Lartë ishte në thelb e njëjtë me apelin e tij në Gjykatën e Apelit, e cila e kishte shqyrtuar dhe adresuar atë. Gjykata vlerëson se arsyet e kufizuara të dhëna nga Gjykata e Lartë në formulën e saj të papranueshmërisë tregojnë në mënyrë të nënkuptuar që kërkuari nuk kishte ngritur një nga pikat e ligjit të parashikuar nga neni 472 i KPC-së. Gjykata vëren se kur një Gjykatë e Lartë refuzon të pranojë një çështje në bazë të asaj që nuk ka ngritur baza ligjore për apel, arsyetimi shumë i kufizuar mund të përmbushë kërkesat e nenit 6 të Konventës (*shih Marini kundër Shqipërisë nr. 3738/02, §106, GJEDNJ 2007 (ekstrakte)*). Ishte për të njëjtat arsye që Gjykata Kushtetuese hodhi poshtë ankesën kushtetuese të kërkuarit në lidhje me shkeljen e së drejtës për proces të drejtë.

53. Në kuadrin e konsideratave të mësipërme, Gjykata konsideron se ankesa e kërkuarit se procedurat ishin të padrejta është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë në përputhje me nenin 35 §§3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Shkelja e pretenduar e nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës

54. Sipas nenit 1, të protokollit nr. 1 të Konventës, kërkuari u ankua se të drejtat e tij të pronësisë ishin shkelur si rezultat i ndërtimit të një ndërtese të paligjshme.

55. Neni 1, i protokollit nr. 1, të Konventës thotë:

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji

dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

56. Kërkuesi parashtroi se shtesa e ndërtuar në mënyrë të paligjshme ngjitur me apartamentin e tij kishte penguar ndjeshëm ndriçimin dhe ajrosjen e saj. Ai nuk kishte mundur as ta shiste apo ta jepte me qira apartamentin.

57. Qeveria argumentoi se gjykatat vendëse kishin vendosur se shtesa nuk cenonte posedimin paqësor të pronës së tij nga kërkuesi. Ato u mbështetën në një raport tjetër ekspertit që kishin porositur, i cili përcaktonte se shtesa nuk ndërhynte në ndriçim dhe ajrosje ose për hyrjen në apartamentin e kërkuesit. Ato më tej deklaruan se shtesa ishte ndërtuar në një ngastër toke publike, e cila i përkiste Shtetit, pas pëlqimit kolektiv të të gjithë banorëve të tjerë. Si i tillë, legalizimi i shtesës ishte një çështje që duhej zgjidhur midis shtetit dhe banorëve të saj.

58. Qeveria pretendoi se paaftësia e kërkuesit për të shitur ose dhënë me qira banesën ishte për shkak se ai nuk e kishte mirëmbajtur atë ose ngaqë nuk kishte vendosur dritare dhe xhama.

59. Gjykata vëren se asnjë nga palët nuk e kontestuan zbatueshmërinë e nenit 1, të protokollit nr. 1. Ajo nuk sheh asnjë arsye për të vendosur ndryshe.

60. Gjykata ka përsëritur vazhdimisht se neni 1 i protokollit nr. 1 përcakton, gjithashtu, disa detyrime pozitive. Në rastet që përfshijnë çështje gjyqësore midis palëve private, Shteti ka një detyrim pozitiv që t'u lejojë palëve në mosmarrëveshje procedurat gjyqësore të cilat ofrojnë garancitë e nevojshme procedurale dhe për këtë arsye u mundëson gjykatat vendore që të gjykojnë në mënyrë efikase dhe të drejtë çdo mosmarrëveshje midis palëve private (*shih, për shembull, Kotov kundër Rusisë [GC] nr. 54522/00, §114, 3 prill 2012; Blumberga kundër Letonisë nr. 70930/01, §67, 14 tetor 2008; dhe Sovtransavto Holding kundër Ukrainës nr. 48553/99, §96, GJEDNJ 2002-VII*).

61. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se kërkuesi ankohet kryesisht për mënyrën se si gjykatat vendëse interpretojnë dhe zbatojnë ligjin vendës në procedurat, para së gjithash, midis palëve private.

62. Siç ka gjetur Gjykata në shqyrtimin e ankesës së kërkuesit në lidhje me padrejtësinë e pretenduar të procedurave në vend sipas nenit 6 §1 të Konventës më lart, gjykatat vendëse bënë një shqyrtim të përgjithshëm faktik dhe ligjor të interesave të ndryshëm në fjalë dhe hodhën poshtë pretendimet e kërkuesit duke dhënë arsye që nuk mund të konsiderohen haptazi të paarsyeshme ose arbitrare. Vlen të përmendet se gjykatat vendëse pranuan ndërtimin e paligjshëm të shtesës. Për më tepër, ata zbuluan se shtesa nuk kishte penguar ndriçimin dhe ajrosjen ose hyrjen në apartamentin e kërkuesit, i cili nuk kishte pësuar ndonjë dëm të jashtëm si rezultat i ndërtimit të paligjshëm.

63. Gjykata nuk mund të gjejë ndonjë bazë mbi të cilën të konkludojë se gjetjet e gjykatave vendëse ishin prekur nga ndonjë element ose arbitraritet ose se ato përndryshe ishin qartazi të paarsyeshme.

64. Për sa i përket mbrojtjes procedurale të interesave të kërkuesit, Gjykata vëren se kërkuesit, i cili ishte përfaqësuar siç duhet gjatë procedurave në vend, iu dha mundësia e mjaftueshme për të çuar përpara të gjitha argumentet që ai i konsideronte si të rëndësishme për rezultatin e çështjes dhe përfitoi nga procedurat konfliktuale.

65. Nga kjo rrjedh se ankesa e kërkuesit, sipas nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës, është qartazi e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë, në përputhje me nenin 35 §§3 (a) dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- E deklaron kërkesën të papranueshme.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 25 qershor 2020.

Stanley Naismith Registrar
Sekretare

Jon Fridrik Kjølbro
Kryetar

SEKSIONI I DYTË
“GJERGO DHE BABICENKO KUNDËR SHQIPËRISË
DHE 76 KËRKESA TË TJERA”¹⁸

(Nr. i kërkesës 13618/10)

VENDIM

(shikoni listën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), e mbledhur në komision më datë 8 shtator 2020, e përbërë nga:

Egidijus Kūris, kryetar

Ivana Jelić

Darian Pavli, gjyqtarë

dhe Hasan Bakırcı, zëvendëssekretar i seksionit,

Duke pasur parasysh kërkesat e mësipërme të depozituara në datat e ndryshme të dhëna në tabelën bashkëlidhur,

Duke pasur parasysh vendimin pilot të dhënë për çështjen e *Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 604/07 dhe 3 të tjera, 31 korrik 2012,

Duke pasur parasysh observacionet e paraqitura nga Qeveria e paditur dhe observacionet në përgjigjet e paraqitura nga kërkuessit,

Duke pasur parasysh informacionet e paraqitura nga Qeveria më 4 mars 2019 për zhvillimet e përditësuara në lidhje me shumicën dërrmuese të kërkuessve, pas diskutimeve, shpall vendimin e mëposhtëm:

FAKTET

1. Një listë e detajuar kërkuessish, duke përfshirë përfaqësuesit e tyre dhe datën e paraqitjes së çdo kërkesë, është parashtruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi (shtojca).

2. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj në atë kohë, znj. A. Hicka dhe, më pas, nga agjenti i saj z. Metani i Avokaturës së Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

3. Këto kërkesa u depozituan në Gjykatë ndërmjet viteve 2010 dhe 2015 dhe lidhen me moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve të formës së prerë, të cilat kanë njohur të drejtën e kërkuessve për kompensim në njërin nga mënyrat e parashtruara nga ligji në vend të kthimit të pronave të tyre, që janë konfiskuar ose janë shtetëzuar nga regjimi komunist i mëparshëm. Ato ngrenë çështje të ngjashme me ato të shqyrtuara nga Gjykata në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, të cituar më sipër.

4. Detajet e vendimeve të formës së prerë dhe të zbatimit të tyre, të cilat janë përditësuar në lidhje me informacionin e dhënë nga qeveria më 4 mars 2019, janë parashtruar në mënyrë të përmbledhur në shtojcë.

B. Ligji dhe praktika përkatëse në vend

5. Në vijim të zbatimit të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, më 5 dhjetor 2015, parlamenti shqiptar miratoi ligjin për “Trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” (ligji për pronat i vitit 2015), i cili, në vijim të botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më 24 shkurt 2016. Një përshkrim i detajuar i ligjit për pronat të vitit 2015, duke përfshirë praktikën gjyqësore vendëse dhe legjislacionin dytësor që zbatohet është dhënë në vendimin e Gjykatës në çështjen *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vendimi nr. 2906/06 dhe 11 kërkesa të tjera, §§30–109, 17 mars 2020).

¹⁸ Qendra e Botimeve Zyrtare. Fletore Zyrtare nr. 197. Tiranë, 2020. f. 13893

6. Karakteristika dalluese e ligjit për pronat të vitit 2015 është që, për qëllime zbatimi, të gjitha vendimet e formës së prerë, të cilat kishin njohur të drejtën e kompensimit pa përcaktuar shumën e kompensimit, do t'i nënshtroheshin një vlerësimi financiar, i cili do të kryhej nga Agjencia e Trajtit të Pronave (ATP), duke iu referuar kategorisë kadastrale të pronës në kohën e shpronësimit. Sidoqoftë, vendimet që kishin përcaktuar shumën e kompensimit do të zbatoheshin në mënyrë të plotë, në varësi të indeksimit.

7. Në vijim të dhënies së vendimit të Gjykatës, në çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, vendim i cituar më sipër, nga data 15 maj në datën 8 qershor 2020, paneli administrativ i Gjykatës së Lartë ka dhënë një sërë vendimesh në lidhje me kërkesat për ndalimin e zbatimit të vendimeve të gjykatave vendëse të dhëna në çështjet që lidhen me vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja, konkretisht: vendimet nr. 210, të datës 15 maj 2020; nr. 122/462, të datës 1 qershor 2020; nr. 45/327 dhe 56/348 të datës 8 qershor 2020. Paneli administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur që një kërkesë për ndalimin e zbatimit të vendimeve të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit do të miratohet me kusht që, ndër të tjera, vendimet e kundërshtuara të ishin të formës së prerë. Në ato raste, për aq sa Gjykata Administrative e Apelit kishte shqyrtuar veprimet kundër vendimeve të ATP-së për vlerësimin financiar si gjykatë e shkallës së parë dhe duke pasur parasysh që një ankim kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit ishte depozituar në Gjykatën e Lartë dhe kishte mbetur pezull para saj, kërkesa për ndalimin e zbatimit u rrëzua me arsyetimin se vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishin të formës së prerë. Vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit kishin anuluar vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja dhe kishin urdhëruar ATP-në që ose të përcaktonte një vlerësim të ri financiar ose të jepte pagesën e një shume specifike parash si kompensim financiar.

ANKIMET

8. Kërkuesit u ankuan se ka pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, të marra veçmas dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës, për shkak të moszbatimit të vendimeve të formës së prerë nga autoritetet që kishin njohur të drejtën e tyre për të marrë kompensim në vend të kthimit të pronave.

9. Disa kërkues, gjithashtu, u ankuan se kishte pasur një shkelje të nenit 6§1 të Konventës, për shkak të zbatimit retroaktiv të ligjit për pronat të vitit 2015.

10. Kërkuesi në kërkesën nr. 11321/11 (*shih rreshtin nr. 10 të shtojcës*), më tej u ankua se kishte pasur shkelje të së drejtës së tij për të hyrë në gjykatë, siç garantohet nga neni 6§1 i Konventës, për shkak të mosshqyrtimit nga ana e autoriteteve të padisë së tij për njohjen e të drejtave të pronësisë, sipas pretendimit të tij.

11. Së fundmi, kërkuesit, në kërkesat nr. 47807/12 dhe 48401/12 (*shih rreshtat nr. 34 dhe 37 të shtojcës*), u ankuan se kishte pasur një shkelje të nenit 14 të Konventës, pasi nuk u ishte rikthyer toka për të cilën ishte njohur e drejta e parablerjes së ndërtesave.

LIGJI

12. Gjykata vëren se kërkuesit u ankuan në bazë të nenit 6§1 të Konventës dhe të nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, të marra veçmas dhe në lidhje me nenin 13 të Konventës, të cilët, për aq sa është relevante, përcaktojnë sa më poshtë:

Neni 6

E drejta për një proces të drejtë gjyqësor

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe i detyrimeve të tij civile ... çdokush ka të drejtën e një procesi të drejtë ... nga [një] gjykatë ...”

Neni 13

E drejta për zgjidhje efektive

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1

Mbrojtja e pronës

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pronave të tij. Askush nuk privohet nga pronat e tij përveç në rastet e interesit publik dhe në bazë të kushteve të parashikuara me ligj dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Megjithatë, dispozitat pararendëse nuk cenojnë në ndonjë mënyrë të drejtën e një Shteti për të zbatuar ato ligje që i çmon të nevojshme për të kontrolluar përdorimin e pronës, në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose gjobave të tjera.”

A. Çështja paraprake

13. Më 27 korrik 2020, kërkesit e përfaqësuar nga z. Sokol Puto, përveç kërkesve në kërkesën nr. 67286/14, bënë një kërkesë për shtyrjen e shqyrtimit të kërkesave të tyre, në pritje të zbatimit të vendimit *Beshiri dhe të tjerët* nga ana e autoriteteve.

14. Pasi shqyrtoi arsyet e paraqitura nga kërkesit, Gjykata vendosi të rrëzojë kërkesën për shtyrje, në funksion të gjetjeve të bëra në vendimin e çështjes *Beshiri dhe të tjerët* (vendimi). Do të ishte e papërshtatshme të miratohej një qasje tjetër në këto raste nga ajo që Gjykata ka miratuar tashmë në vendimin *Beshiri dhe të tjerët*.

B. Bashkimi i kërkesave

15. Gjykata, duke pasur parasysh lëndën e ngjashme të kërkesave, e gjen të përshtatshme që t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm, në përputhje me rregullën 42§1 të Rregullores së Gjykatës.

C. Ankesa sipas nenit 13 të Konventës, si dhe ankesat sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës

1. Për sa i takon vendimit nr. 251, të datës 21 gusht 2008, në kërkesën nr. 78958/11

16. Për sa i përket vendimit nr. 251, datë 21 gusht 2008, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 78958/11 (*shih rreshtin nr. 18 të shtojcës*), Gjykata mban shënim dëshirën e kërkesve për të tërhequr ankimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesit nuk kanë ndërmend të ndjekin ankimet e tyre në lidhje me atë vendim, brenda kuptimit të nenit 37§1 (a) të Konventës dhe nuk gjen asnjë arsye me interes të përgjithshëm, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, brenda kuptimit të fjalisë së fundit të nenit 37§1, i cili do të kërkonte vazhdimin e shqyrtimit të atyre ankimeve. Nga kjo rrjedh se, për aq sa u takon ankimeve në lidhje me vendimin nr. 251, të datës 21 gushtit 2008, ajo pjesë e kërkesës duhet të hiqet nga lista e çështjeve të Gjykatës.

2. Për sa i takon pjesës së mbetur të kërkesave

17. Në fillim, Gjykata vlerëson se nuk është e nevojshme të shqyrtohen argumentet e palëve, në lidhje me statusin ligjor të disa kërkesve ose trashëgimtarëve të tyre, përqindjet e pronave të trashëguara të kërkesve ose të drejtën e tyre për kompensim ose çdo mospërputhje faktike, në lidhje me vendimet në vend, pasi kërkesat në çdo rast janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

18. Gjykata vëren se në vitin 2012 ajo ka miratuar një vendim pilot, në lidhje me këto çështje (*shih Manushaqe Puto dhe të tjerët, cituar më lart*), në të cilin konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të Konventës, si dhe të nenit 1, të protokollit nr. 1, për shkak të moszbatimit të tejzgjatur të vendimeve të formës së prerë për dhënien e kompensimit dhe shkeljes së nenit 13 të Konventës, për shkak të mungesës së një zgjidhjeje efektive në këtë drejtim brenda vendit.

19. Më tej, në zbatim të këtij vendimi pilot, u miratua ligji për pronat i vitit 2015, i cili prezantoi një mjet të ri kompensimi (*shih paragrafët 5 dhe 6 më lart*).

20. Gjykata ka konstatuar kohët e fundit se mjeti juridik i prezantuar nga ligji për pronat i vitit 2015 është efektiv, brenda kuptimit të nenit 35§1 dhe nenit 13 të Konventës (*shih Beshiri dhe të tjerët (vendimi)*), cituar më lart, §215). Gjykata nuk sheh asnjë arsye për t'u larguar nga ky konstatim në kontekstin e çështjes në fjalë dhe konsideron se ankimi i kërkesve, sipas nenit 13 të Konventës (*shih paragrafin 8 më lart*) është qartazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës (*shih Beshiri dhe të tjerët (deklarata), cituar më sipër, §221*).

21. Duke pasur parasysh gjetjet e saj në vendimin *Beshiri dhe të tjerët*, cituar më lart, §§224–29, i njëjti konkluzion është i vlefshëm në lidhje me ankimet e kërkesve se kishte pasur shkelje të nenit 6§1 të

Konventës, për shkak të zbatimit retroaktiv të ligjit për pronat të vitit 2015 (*shih paragrafin 7 më lart*). Gjykata konsideron se ky ankim është, gjithashtu, qartazi i pabazuar dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§§3 dhe 4 të Konventës.

22. Për sa u përket ankimeve të mbetura të kërkuësve, sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 (*shih paragrafin 8 më lart*), Gjykata vëren se, në varësi të fazës aktuale të procedurave, në lidhje me secilën kërkesë, mund të veçohen situatat e mëposhtme.

23. Në radhë të parë, Gjykata konstaton, se, pavarësisht nga data e paraqitjes së kërkesave, kërkuësve në kërkesat që gjenden në rreshtat 1–29 dhe 31–73 të shtojcës, përveç vendimeve specifike individuale të dhëna në lidhje me një numër të kufizuar kërkesash, të cilat janë shqyrtuar veçmas në paragrafin 24 më poshtë, u është kërkuar ose u kërkohet në bazë të nenit 35§1 të Konventës për të përfituar nga mjetet e reja juridike në vend, të paraqitura në bazë të ligjit për pronat të vitit 2015, në përputhje me rregullat përkatëse në vend. Doli në pah nga informacioni i dhënë nga Qeveria më 4 mars 2019 se ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar kryesisht (*ex officio*), në lidhje me pothuajse çdo vendim brenda vendit, siç përshkruhet në kolonën që u përket detajeve të zbatimit. Kërkuësit ose nuk kanë arritur të shterojnë mjetet juridike vendëse ose nuk kanë informuar Gjykatën për ndonjë veprim që mund të kenë ndërmarrë në lidhje me këtë. Kjo vlen njësoj si për ato raste në të cilat ATP-ja nuk ka kryer një vlerësim financiar, për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar ose për shkak të arsyeve të tjera, në lidhje me të cilat kërkuësve u kërkohet në mënyrë të ngjashme të ndiqnin procedurat përkatëse në vend. Gjykata nuk gjen asnjë rrethanë të jashtëzakonshme që mund të përjashtojë kërkuësit nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme juridike (*shih Beshiri dhe të tjerët (vendimi) cituar më sipër*, §§216–18). Nga kjo rrjedh se këto ankime duhet të rrëzohen sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës për mosshkrimin e mjeteve juridike vendëse. Pavarësisht nga konkluzioni i mësipërm, Gjykata rikujton përcaktimet e bëra në paragrafin 222 të vendimit në çështjen *Beshiri dhe të tjerët (vendimi)*, cituar më lart, në lidhje me kushtet që autoritetet duhet të plotësojnë në mënyrë që mjeti të vazhdojë të mbetet efektiv.

24. Së dyti, në lidhje me vendimin nr. 2406, datë 8 nëntor 2013, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 68195/14 (*shih rreshtin nr. 57 të shtojcës*); vendimin nr. 70, të datës 14 prill 2006, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 74968/14 (*shih rreshtin nr. 62 të shtojcës*); dhe kërkesat nr. 70211/13, 70730/014 dhe 9152/15 (*shih rreshtat nr. 74-76 të shtojcës*), Gjykata vëren se procedurat e brendshme, në lidhje me përcaktimin e shumës së kompensimit kanë mbetur pezull në gjykatat kombëtare. Prandaj, ajo konsideron se do të ishte e parakohshme që ajo të trajtonte këto ankime, të cilat duhet të rrëzohen sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës (*shih Beshiri dhe të tjerët (vendimi) cituar më lart*, §219). Praktika gjyqësore vijuese e Gjykatës së Lartë rikonfirmon më tej se, kur një ankim është depozituar në gjykatën më të lartë, vendimet e gjykatave më të ulëta do të marrin formë të prerë dhe do të bëhen të zbatueshme me dorëzimin e një vendimi nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 7 më lart*).

25. Së treti, Gjykata, duke pasur parasysh pagesën e plotë të shumës së kompensimit sipas kërkesës së kërkuësve, siç përcaktohet në parashtresën e Qeverisë, të datës 4 mars 2019, konsideron se kërkuësit në kërkesën nr. 67286/14 (*shih rreshtin nr. 77 të shtojcës*) nuk mund të pretendojnë më të jenë “viktimë” e shkeljeve të të drejtave të tyre, sipas nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1, të protokollit nr. 1, brenda kuptimit të nenit 34 të Konventës (*shih Beshiri dhe të tjerët (vendimi) cituar më lart*, §220). Nga kjo rrjedh se kjo kërkesë është e papajtueshme *ratione personae* me dispozitat e Konventës për qëllimet e nenit 35§1 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4.

26. Së fundmi, Gjykata vëren, se procedurat në vend në lidhje me njohjen fillestare të të drejtave për pronat e trashëguara të kërkuësve në kërkesën nr. 30942/12, janë akoma pezull (*shih rreshtin nr. 30 të shtojcës*). Nuk është marrë asnjë vendim i formës së prerë, nuk mund të thuhet se kërkuësit kanë “posedime ekzistuese” brenda kuptimit të nenit 1, të protokollit nr. 1. Besimi se, në të ardhmen, autoritetet mund të nxjerrin një vendim që njeh të drejtat për pronat e trashëguara të kërkuësve nuk mund të konsiderohet si një formë e “pritshmërisë legjitime” për qëllimet e nenit 1, të protokollit nr. 1. Gjykata rikujton se ekziston një ndryshim midis një shprese të thjeshtë për rikthim, sado e kuptueshme që mund të jetë shpresa, dhe një pritshmërie legjitime, e cila duhet të jetë e një natyre më

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

konkrete se sa një shpresë e thjeshtë dhe të bazohet në një dispozitë ligjore ose në një akt juridik, të tillë si vendimi gjyqësor (*shih Kopecký kundër Sllovakisë [GC], nr. 44912/98, §49, GJEDNJ 2004-IX; dhe Gratzinger dhe Gretzingerova kundër Republikës Çeke (vendimi), nr. 39794/98, §73, GJEDNJ 2002-VII*). Prandaj, Gjykata arrin në përfundim se, për momentin, kërkuesit nuk kanë treguar se ata kanë pasur një kërkesë, e cila ishte vërtetuar mjaftueshëm për t'u zbatuar dhe për këtë arsye ata nuk mund të argumentojnë se kanë pasur një "posedim" brenda kuptimit të nenit 1, të protokollit nr. 1. Nga kjo rrjedh se ky ankim është i papajtueshëm *ratione materiae* me dispozitat e Konventës brenda kuptimit të nenit 35§3 dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35§4 të Konventës.

D. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

27. Duke pasur parasysh të gjithë materialin në zotërim të saj dhe për aq sa ankimet i përkasin kompetencës së saj, Gjykata konstaton se ankimet sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me një shkelje të pretenduar të së drejtës së kërkuesit për të pasur akses në gjykatë dhe, sipas nenit 14 të Konventës (*shih paragrafët 10 dhe 11 më lart*), nuk paraqesin asnjë shfaqje të shkeljes së të drejtave dhe lirive të përcaktuara në Konventë ose në protokollet e saj. Nga kjo rrjedh se kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet si e pabazuar, në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

- Vendos të bashkojë kërkesat;
- Vendos të heqë pjesën e kërkesës nr. 78958/11 lidhur me vendimin nr. 251, datë 21 gusht 2008 nga lista e çështjeve të saj;
- Deklaron pjesën e mbetur të kërkesave të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 1 tetor 2020.

Hasan Bakırcı
Zëvendëssekretar

Egidijus Kūris
Kryetar

SHTOJCË

Nr.	Nr. i kërkesës dhe data e regjistrimit	Emri i plotë i kërkuesit	Data e komunikimit/nenet	Përshkrimi i vendimeve të formës së prerë të marra në vend	Detajet e zbatimit	Emri i përfaqësuesit
1	13618/10 Depozituar më 8.3.2010	Mihallaq Gjergo Athina Gjergo Jorgjie Gjirkopulli née Gjergo Elvira Babicenko née Gjergo	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimet nr. 34 dhe 35, të datës 10 korrik 2007, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Vlorës (Komisioni) njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 25,200 metra katrorësh, për të cilat do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	Agjencia e Trajtitimit të Pronave (ATP) ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Artan Hajdari
2	36482/10 Depozituar më 20.5.2010	Donard Strazimiri Indrit Strazimiri Bedrie Florini née Fortuzi Bledar Florini Alma Hyka née Fortuzi Fisnik Preza Dhurata	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 419, të datës 9 nëntor 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 41,618 metra katrorësh, nga të cilat 6,055 metra katrorë iu kthyen dhe pjesa e mbetur prej 35,563 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ajo, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuesve për parablerjen e disa ndërtesave në rast privatizimi.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim. ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të sipërfaqes së zënë nga ndërtesat, pasi kërkuesit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e	Artan Hajdari

Vëllimi III, 2020-2021

	Karajani née Fortuzi Fatbardha Agushi née Fortuzi Aferdita Husha née Fortuzi Fatri Llagami ¹⁹ Bujar Llagami ²⁰ Vera Panariti ²¹ Miranda Nosi Dashuri Llagami Denis Llagami Helidon Llagami Mysin Pilku Lira Kasharaj Nimet Pilku Niada Shima Floran Pilku Hamijet Zogolli Gojar Dishnica Rebeka Verdha née Dishnica Bardhyl Zogolli Nazime Zogolli Adrian Zogolli Hasan Zogolli Mybara Zogolli Erjon Zogolli Helga Zogolli Luan Fortuzi Arben Fortuzi Avni Fortuzi Miranda Fortuzi Eva Shehaj née Fortuzi Zana Fortuzi Fisnik Fortuzi Astrit Fortuzi			parablerjes.	
--	--	--	--	--------------	--

¹⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Bedar Llagami dhe Etleva Llagami.

²⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Fatbardha Llagami, Diana Dhamo dhe Aferdita Shehu.

²¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Qamil Panariti, Suzana Haveri.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

		Liri Fortuzi Enri Laku Ilir Laku Ariana Laku Artan Fortuzi Sokol Fortuzi Ballkez Fortuzi22 Sokol Fortuzi				
3	37381/10 Depozituar më 21.10.2010	Gezim Shehi Makbule Cene Lirie Meca Shpresa Hysaj Bardha Shehi Myhyrije Shehi Adrian Shehi Haki Shehi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1055, të datës 24 qershor 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 34,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
4	41859/10 Depozituar më 23.10.2010	Eqerem Risilia	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 116, të datës 19 nëntor 1996, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 11,400 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 14, të datës 14 mars 2000, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 20,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	Palët nuk kanë dhënë ndonjë informacion në lidhje me kryerjen e vlerësimit financiar të vendimit. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
5	48830/10 Depozituar më 19.7.2010	Agim Toro Ervehe Ceribashi Lindita Kapaj-Toro	26/05/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 321, të datës 16 maj, Komisioni i Gjirokastrës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 17,062 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 7.062 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Qeveria parashtrroi se vendimi nr. 937 i Gjykatës së Rrethit Gjyrokastër, datë 29 maj 2008, kishte vendosur të anulonte të drejtat pronësore të kërkuessit për 1,260 metra katrorësh, pasi ato mbivendoseshin me të drejtat pronësore të një pale të tretë.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të vendimit, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar. Qeveria më tej parashtrroi se, krahas një ankimi të depozituar nga kërkuessit kundër vendimit të ATP-së, vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit nr. 187, i datës 14 nëntor 2018, kishte vendosur që t'ua kthente ankimin kërkuessve për korrigjim. Deri më sot, kërkuessit nuk	Spiro Dodbiba

²² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtari i saj: Sokol Fortuzi.

Vëllimi III, 2020-2021

					kanë dhënë ndonjë informacion përkatës të përditësuar në përgjigje të këtij vendimi.	
			Neni 6§1 (aksesi në gjykatë)	<p>Me vendimin nr. 174, të datës 5 maj 2009, Gjykata e Lartë shpalli veprimin civil të kërkesve kundër një vendimi të Komisionit, i cili kishte njohur të drejtat pronësore të një pale të tretë, jashtë juridiksionit të gjykatave të zakonshme, për shkak të mosparaqitjes nga ana e kërkesit të një anekse administrative në atë kohë në Agjencinë Qendrore për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave²³ (Agjencia Qendrore), drejtori i së cilës kishte kompetencën për të rishikuar vendimin e Komisionit.</p> <p>Më 6 shtator 2009, pas ankesës së mëvonshme të kërkesve më 16 korrik 2009, drejtori i Agjencisë Qendrore i informoi ata se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit pas mbarimit të afatit ligjor për të bërë një ankesë.</p> <p>Më 13 korrik 2010, pas ankesës së re të kërkesit më 11 shkurt 2010, drejtori i Agjencisë Qendrore i informoi ata se, në funksion të vendimit nr. 27 të Gjykatës Kushtetuese më 26 maj 2010, i cili kishte deklaruar jokushtetuese kompetencat e tij për të rishikuar vendimin e Komisionit, ankesa e tyre nuk mund t'i nënshtrohej shqyrtimit administrativ.</p>	Nuk ka informacione të disponueshme që, pas letrës së drejtorit të datës 13 korrik 2010, kërkesit e ndoqën çështjen përpara gjykatave vendëse.	
6	56958/10 Depozituar më 27.9.2010	Klerenti Dume Bedri Fesko Zana Dume Ilirdume Agim Dume Vladimir Dume Ermira Dume Nuri Dume Vjollca Dume Svjetllana Dume Besa Dume Fatbardha Dume Teuta Matua Gramoz Mborja Donika Mborja née	20.12.2013 Neni 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 169, të datës 1 shkurt 1996, Komisioni i Ersekës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 3,561 metra katrorësh, nga të cilat 1,529 metra katrorë u kthyen dhe 1,057 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkesve për parablerjen e një ndërtese.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dy vendimeve, vendosi që kërkesit të konsiderohen të kompensuar.	Artan Hajdari

²³ Agjencia për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia) zëvendësoi Komisionin në vitin 2006.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

7	60264/10 Depozituar më 27.9.2010	Dajlani Agron Skenderi Bashkim Kaca	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 67 të datës 21 tetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 7,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,164 metra katrorë u kthyen dhe 5,281 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Asnjë kompensim nuk është bërë në lidhje me 555 metra katrorë, të cilët ishin zënë nga godina të ndërtuara në mënyrë të paligjshme; ata që i kishin zënë u udhëzuan që t'u paguanin qira kërkuarve. Komisioni, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuarve për parablerjen e një ndërtese që zinte 2.736 metra katrorë.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarve të konsiderohen të kompensoar.	Gentiana Tirana
8	4899/11 Depozituar më 24.12.2010	Fadil Omari Liri Maci	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 394, të datës 23 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 162 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari
9	4901/11 Depozituar më 24.12.2010	Elvana Samarxhija née Cepunja	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 255, të datës 3 tetor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 416.5 metra katrorësh, nga të cilat 30 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 386.5 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari
10	11321/11 Depozituar më 15.11.2010	Refat Puto ²⁴	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 195 të datës 8 janar 1996, Komisioni i Pronave Sarandë pranoi që babai i kërkuarve kishte pasur në pronësi një pjesë, përkatësisht një të tetën, të një kullote me përmasa 1,000,000 metra katrorë, me vendndodhje në Lëkurës (kullota e parë) dhe të një kullote tjetër me përmasa 3,500,000 metra katrorë me vendndodhje në Berdenesh (kullota e dytë). Meqenëse kullota e parë dhe vetëm 225,000 metra katrorë nga kullota e dytë rezultuan <i>infra mums</i> , Komisioni njohu pjesën e trashëguar të kërkuarve në të dyja kullotat me një total prej 152,000 metra katrorësh nga të cilat 4,642 metra katrorë u kthyen. 1.098 metra katrorë që janë kthyer tashmë me anë të dy vendimeve të mëparshme të dhëna në vitin 1994 dhe në vitin 1995 dhe pjesa e mbetur prej 146,260 metra katrorësh do të kompensoheshin në natyrë dhe me anë të obligacioneve. Gjithashtu, u	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarve të konsiderohen të kompensoar.	Sokol Puto

²⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Ermira Allabashi Arapi, Roza Allabashi, Ledia Hobdari dhe Bersant Hobdari.

Vëllimi III, 2020-2021

				njoh e drejta e kërkesit për parablerjen e një ndërtese që zë 960 metra katrorë (shih, gjithashtu, kërkesën nr. 13258/11 më poshtë)		
			Neni 6§1 (aksesi në gjykatë)	Duke u bazuar në materialet në dosjen e çështjes, del se në mars 1997, kërkuesi paraqiti një kërkesë pranë Komisionit të atëhershëm për t'i kthyer atij pjesën e mbetur të kullotës së dytë. Si rezultat, me vendimin nr. 257, datë 10 korrik 2008, Agjencia e Pronave të Vlorës njohu titullin e trashëguar të kërkesit për një shtesë prej 121.200 metra katrorësh, që i përkisnin kullotës së dytë, nga të cilat 119,350 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1.850 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Kërkuesi apeloj tek Agjencia Qendrore në Tiranë. Në të njëjtën kohë, më 25 shkurt 2010, Agjencia Qendrore e informoi aplikantin se, pas shpërbërjes së zyrave vendore, kërkesa që ai kishte paraqitur në vitin 1997 do të shqyrtohej nga Agjencia Qendrore. Në vitin 2013 Agjencia Qendrore deklaroi ankimin e kërkesit kundër vendimit nr. 257/2008 jashtë juridiksionit në funksion të një vendimi të Gjykatës Kushtetuese, që kishte shfuqizuar kompetencat e drejtorit të saj për të rishikuar vendimet e dhëna nga zyrat vendore të Agjencisë.	Pas hyrjes në fuqi të ligjit për pronat të vitit 2015, nuk duket se aplikanti ka depozituar padi të re pranë ATP-së ose në gjykatat vendëse për njohjen e të drejtave të trashëguara për tokën e mbetur të kullotës së dytë.	
11	11489/11 Depozituar më 16.2.2011	Gurije Dvorani Née Starova ²⁵ Shpetim Dvorani Svjettllana Dume Besa Dume Fatbardha Dume Valter Mborja Pranvera Bejleri née Mborja Diana Qyteti née Mborja	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1024, të datës 30 qershor 2009, Agjencia e Korçës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 11.000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari
12	13258/11 Depozituar më 29.12.2010	Zamir Myftiu Adile Kondi née Puto Arben Puto Bleriana Myftiu Beatty	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 196 të datës 8 janar 1996 Komisioni i Sarandës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 152,000 metra katrorësh, nga të cilat 7,942 metra katrorë u kthyen, 1,098 metra katrorë ishin kthyer tashmë me anë të dy vendimeve të mëparshme të dhëna në vitin 1994 dhe në vitin 1995 dhe pjesa e	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Sokol Puto

²⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Lejla (AGO) Belli.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

				mbetur prej 142,960 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Gjithashtu, u njoh e drejta e kërkuesit për parablerjen e një ndërtese që zë 960 metra katrorë.		
13	28124/11 Depozituar më 5.2.2011	Naim Frasheri Feride Komnino Lejda Frasheri Enrik Bregasi Brunilda Castelluchio Manuel Komnino	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 75, të datës 27 qershor 2002, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari Mirko Walbach
14	28137/11 Depozituar më 5.2.2011	Shefqet Tìgani Feim Tìgani Drita Boshnjaku (Tìgani) Muhamed Tìgani Sylejman Tìgani Fatlum Domniku Burim Domniku Laura Dranqolli née Domniku Lendita Radoni née Domniku Bekim Domniku Ardita Dobroshi née Domniku Gjemajllje Mulhaxha née Domniku Besnik Domniku Besim Tìgani Hajrije Tìgani Gentiana Tìgani Aulona Tìgani Granit Tìgani Lorik Tìgani Ibrahim Tìgani Atifete Tìgani Arjeta	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 80, të datës 30 maj 1995, Komisioni i Vlorës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 40,000 metra katrorësh, nga të cilat 2,664 metra katrorë u kthyen dhe 20,000 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Artan Hajdari

Vëllimi III, 2020-2021

		(Tigani) Hoti Armend Tigani Antigona Kabashi née Tigani Agron Tigani Servete Tigani Nurco Muratoviq Ahmet Muratoviq Fikreta Muratoviq Mersija Muratoviq Femi Tigani Demir Tigani Magdalena Tigani ²⁶ Millka Tigani Bujar Tigani Suzana Tigani Merita Tigani Sabahat Gorani Nasire Gorani Nevzat Gorani ²⁷ Arbnor Gorani Alush Tigani Jakute Tigani ²⁸				
15	29139/11 Depozituar më 1.4.2011	Ardian Maci Maksim Lesko Hatlije Llagami ²⁹ Skender Bylyku Gezim Maci ³⁰ Mahmudije Golia ³¹	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1018, të datës 24 mars 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuësve për pronën e trashëguar prej 46,000 metra katrorësh dhe për 130 pemë ulliri, vlera totale e të cilave u përcaktua në 675,200 lekë (5,367 euro). Kërkuësit do të kompensoheshin me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Elton Gongo
16	33144/11	Preng Tosku ³²	20.12.2013	Me vendimin nr. 111, të datës 27 dhjetor 1998, Komisioni i Matit	ATP-ja ka kryer vlerësimin	Xhevdet Sheta

²⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Femi Tigani dhe Demir Tigani.

²⁷ Nevzat Gorani ndërroi jetë pas depozitimit të kërkesës në gjykatë, por kërkuësit nuk mund të paraqisnin një certifikatë trashëgimie në kohë për kërkesat JS, por rezervojnë të drejtën për të dorëzuar certifikatën dhe për ta dërguar menjëherë në gjykatë.

²⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Valbona Baqaj, Vjollca Rexhepi dhe Flutura Sokoli.

²⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Shpetim Llagami, Eshref Llagami, Blend Llagami, Ismail Llagami, Apostolia Llagami, Marcio Llagami dhe Ana Llagami.

³⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Adem Maci dhe Ondina Karabeci.

³¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Hajten Meta, Fatmir Golia. Edmond Golia dhe Alben Golia.

³² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Viktor Tosku, Bardhe Tosku, Kol Tosku dhe Rexhina Tosku, më 28

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

	Depozituar më 10.5.2011		Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	njohu të drejtat e kërkesit për pronën e trashëguar prej 96.823 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	financiar për këtë vendim.	
17	46474/11 Depozituar më 18.7.2011	Ljulzim Jajaga Sadulla Kerliku	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 412, të datës 7 nëntor 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 11,816 metra katrorësh, nga të cilat 10,118 metra katrorë u kthyen ose kompensuan dhe 635 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyjs vendimeve, vendosi që kërkesit të konsiderohen të kompensoar.	Elton Gongo
18	78958/11 Depozituar më 12.12.2011	Mirvet Petrela Albi Petrela Genci Petrela Miranda Petrela nëc Bakiri	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 205, të datës 5 gusht 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 1,278.4 metra katrorësh, nga të cilat 1,036 metra katrorë u kthyen dhe 232 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ai njohu të drejtën e kërkesit për parablerjen e një ndërtese që zë 144 metra katrorë, e cila ndodhet në sipërfaqen që do të kompensohet.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, në lidhje me 88 metra katrorë. Sidoqoftë, nuk ka përcaktuar vlerësimin financiar për pjesën e mbetur prej 144 metra katrorësh, meqenëse kërkesit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Aida Prifti
				Me vendimin nr. 78, të datës 14 prill 2008, Agjencia e Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 21.2 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
				Me vendimin nr. 251, të datës 21 gusht 2008, Agjencia e Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 28,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Del se ky vendim më pas është prishur ndërsa procedurat po vazhdonin	Më 28 shtator 2016, kërkesit shprehën dëshirën e tyre për të tërhequr ankimet e tyre në lidhje me këtë vendim.	
19	6312/12 Depozituar më 26.1.2012	Sabri Jella ³³ Zana Jella Ema Jella Hasan Jella ³⁴ Eleen Jella (Yella) Bernice Jella (Yella) Mary (Jella) Mc Dermott	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 249, të datës 1 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 99 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
20	9217/12	Sabri Jella ³⁵	20.12.2013	Me vendimin nr. 200, të datës 6	ATP-ja ka kryer	Sokol Puto

gusht 2014, z. Zef Tosku, z. Edmir Merlika, znj. Eva Tosku, z. Vili Tosku, znj. Angela Saal, znj. Kristina Tosku dhe znj. Gjele Tosku shprehën dëshirën e tyre për t'u bashkuar në kërkesë, për shkak se ata janë trashëgimtarë të së njëjtës sipërfaqe toke.

³³ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

³⁴ Ka ndërruar jetë.

³⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

Vëllimi III, 2020-2021

	Depozituar më 26.1.2012	Zana Jella Enia Jella Hasan Jella ³⁶ Hysni Jella Eleen Jella Bernice Jella Mary (Yella) Medermott	Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	qershor 1997, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 15,500 metra katrorësh, nga të cilat 3,160 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 12,340 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	vlerësimin financiar për këtë vendim.	
21	9218/12 Depozituar më 26.1.2012	Sabri Jella ³⁷ Zana Jella Ema Jella	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 82, të datës 1 dhjetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 303 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
22	11629/12 Depozituar më 26.1.2012	Zana Jella Sabri Jella ³⁸ Ema Jella Hasan Jella ³⁹ Eleen Jella Bernice Jella Hysni Jella (Karapici) Mary (Yella) Mc Dermott	22/09/2014 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 516, të datës 9 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtën e kërkuessve për kompensim në lidhje me dy sipërfaqe toke, përkatësisht 177 5 metra katrorë dhe 238.6 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
23	21447/12 Depozituar më 28.3.2012	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ⁴⁰ Gabriel Eqimijatru Petri Eqimijatru	22.9.2014 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 633, të datës 22 prill 2002, Gjykata e Rrethit Durrës, pasi kishte ndryshuar vendimin nr. 1424 të Komisionit, datë 1 qershor 1996, njohu të drejtën e kërkuessve për kompensim në lidhje me 5.000 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Petrika Demiri
24	21527/12 Depozituar më 12.3.2012	Julian Benusi Valeria Benusi Anton Benusi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 140, të datës 20 korrik 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,217.35 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Më tej, ajo njohu të drejtën e kërkuessve për parablerjen e godinave të ndërtuara aty.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa pasi kërkuessit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Sokol Puto
25	21529/12 Depozituar më 12.3.2012	Valeria Vrioni Gherardo La Franceska Oliver Vrioni Dario La Franceska	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Kjo kërkesë, e cila është një vazhdim i vendimit të kësaj Gjykate në çështjen <i>Vrioni dhe të tjerët kundër Shqipërisë</i> ((vetëm plotësim), nr. 35720/04 dhe 42832/06, 7 dhjetor 2010) në të cilin Gjykata dha kompensim në lidhje me një sipërfaqe toke që zë 1,456 metra katrorë, lidhet me mospagimin nga ana e autoriteteve të kompensimit të kërkuessve në lidhje me 181 metra katrorë të mbetur. Autoritetet më tej njohën të drejtën e kërkuessve për parablerjen e disa godinave të ndërtuara aty.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuessit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Sokol Puto

³⁶ Ka ndërruar jetë.

³⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët et ij: Halit Jella, Gazmend Jella, Adela Jella dhe Hans Jella.

³⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Halit Jella, Gazmend Jella. Adela Jella dhe Hans Jella.

³⁹ Ka ndërruar jetë.

⁴⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

26	21532/12 Depozituar më 12.3.2012	Oliver Vrioni	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 230, të datës 31 mars 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 837 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
27	21599/12 Depozituar më 12.3.2012	Oliver Vrioni Valeria Vrioni Gherardo La Francesca Dario La Francesca Nevin Godo Vrioni Age Vrioni Alan Vrioni	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 448, të datës 10 maj 1996, Komisioni i Beratit njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 12,915 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Sokol Puto
28	21675/12 Depozituar më 18.12.2012	Orhan POJANI	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 960, të datës 1 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2006 kërkuari mori kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
				Me vendimin nr. 323, të datës 30 qershor 2006, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 409.04 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
29	30941/12 Depozituar më 28.12.2012	Lavdiqe Kalasa (Pojani)	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 265, të datës 5 maj 1994, Komisioni i Korçës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 1.587 metra katrorësh, e cila do të kompensohej me anë të obligacioneve. Në vitin 2009 kërkuari mori kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
30	30942/12 Depozituar më 26.4.2012	Mit'hat Gega Jari Demishaga Ibrahim Demishaga Qazim Demishaga Pellumb Demishaga Ermila Demishaga Bedri Elezaj ⁴¹ Fatbardha Dervishi Pranvera Rexho Vjosa Luto Edmond Gega	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 992, të datës 2 qershor 2009, Agjencia e Korçës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 333.3 hektarësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	Nga vëzhgimet e palëve del se vendimi u anulua më pas. Procedura ka mbetur pezull përpara Gjykatës së Lartë.	Mit'hat Gega

⁴¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Flutura Elezaj, Dorian Elezaj dhe Ina Elezaj.

Vëllimi III, 2020-2021

31	33619/12 Depozituar më 15.5.2012	Andon Melo Reno Melo	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 357, të datës 19 shtator 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 800 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2006 kërkuessit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
32	45721/12 Depozituar më 13.6.2012	Grigor Rexho	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 927, të datës 3 maj 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 5,271 metra katrorësh, nga të cilat 3,509 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Komisioni udhëzoi kërkuessin të fillojë procedurat gjyqësore në lidhje me 1,514 metra katrorë, të cilat i ishin kthyer padrejtësisht një pale të tretë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Kosta Gazeli
33	47797/12 Depozituar më 29.7.2012	Kostaq Sahatci ⁴² Alberto Laca Laura Laca Antigoni Hoxha Dhoksi Sahatci Klajdi Sahatci Aurora Sahatci	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 645, të datës 17 janar 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Në vitin 2007 kërkuessit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Doris Andoni
34	47807/12 Depozituar më 27.7/2012	Emilia Sahatci née Kondi Luiza Dhamo née Kondi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 54, të datës 29 maj 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,100 metra katrorësh, nga të cilat 235 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 865 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e kërkuessve për parablerjen e një ndërtese që ndodhet në zonën që do të kompensohet.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuessit nuk kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.	Doris Andoni
35	47825/12 Depozituar më 26.7.2012	Liri née Myrteza Rexhep Myrteza Enver Dibra Ylli Dibra Adrian Voilla Edlena Ahmetaj née Voilla Xhoana Myslim (Dibra) Enton Dibra Fatime Dibra	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1, të datës 29 tetor 2001, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 61,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Artan Hajdari

⁴² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Etleva Sahatci, Emilia Sahatci dhe Doris Andoni née Sahatci.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

		Kozma Voilla ⁴³				
36	48173/12 Depozituar më 12.7.2012	Klaudio Ligori ⁴⁴	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 601, të datës 1 dhjetor 1998, Komisioni i Gjyroskastrës njohu të drejtat e kërkuarit për pronën e trashëguar prej 3,836 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin, me kusht që kërkuari të mos ketë ushtruar të drejtën e parablerjes për objektin e ndërtuar aty (e cila ju kompensohet ... në rast mosprivatizimi, gjë e cila mbështetet ... për të drejtën e parablerjes).	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të tokës së zënë nga ndërtesa, pasi kërkuari nuk ka hequr dorë nga drejta e tij e parablerjes.	
37	48401/12 Depozituar më 26.7.2012	Hyrije Derhemi née Duka Arsed Bodinaku Liljana Liku Née Mezini Nazmi Derhemi Ardjan Derhemi Lirie Derhemi Besnike Ndoni Semiha Lluqi née Derhemi Qamile Llaci ⁴⁵ née Derhemi Bedrije Lici Iglimona Kalaja (Derhemi) Ridian Derhemi	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 90, të datës 17 korrik 1997, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarëve për pronën e trashëguar prej 4.500 metra katrorësh, nga të cilat 839 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 3,661 metra katrorësh do të kompensohej. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara në zonën që do të kompensohet. Me vendimin nr. 241, të datës 13 korrik 2000, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarëve për pronën e trashëguar prej 3,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,865 metra katrorë u kthyen dhe 955 metra katrorë do të kompensoheshin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara në zonën që do të kompensohet.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarët të konsiderohen të kompensuar.	Suela Meneri
38	50791/12 Depozituar më 25.7.2012	Jorgji Stavri Maksim Sinemati Gezim Sinemati	20.12.2013 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1602, të datës 25 shtator 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarëve për pronën e trashëguar prej 73,000 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë u kompensuan në natyrë (me vendim nr. 72, datë 29 janar 1997) dhe 6,300 metra katrorë (10% e pjesës së mbetur prej 63.000 metra katrorësh) do të kompensoheshin me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Artan Hajdari
39	53998/12 Depozituar më 16.8.2012	Ajet Shembitraku	22.4.2016 Nenet 6§1 dhe neni 1 i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1920, të datës 22 tetor 2003, Gjykata e Rrethit të Korçës, pasi ndryshoi vendimin nr. 49, të datës 10 dhjetor 1993 (vendimi i parë), dhe vendimin nr. 163, të datës 22 prill 1994 (vendimi i dytë), të Komisionit, njohu të drejtat e kërkuarëve për pronën e	Qeveria parashtroi se ATP-ja kishte kryer vlerësimin financiar të vendimit të parë. Sidoqoftë, zona për të cilën ishte njohur e drejta e	Anesti Shembitraku

⁴³ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Adria Voilla dhe Edlena Ajmetaj (Voilla).

⁴⁴ Më 15 gusht 2014, kërkuari kërkoj që vëllai i tij të bashkohej me procedurat e mbetura pezull në Gjykatë.

⁴⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ilir Llaci, Kosta Llaci, Nexhmi Llaci dhe Ruzhdi Llaci.

Vëllimi III, 2020-2021

				trashëguar prej 2,126 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ajo, gjithashtu, njohu të drejtën e parablerjes së objekteve të ndërtuara aty.	parablerjes nuk iu nënshtrua një vlerësimi financiar, pasi kërkuesi nuk hoqi dorë nga kjo e drejtë. Për sa i përket vendimit të dytë, ATP-ja ka vendosur që kërkuesit të konsiderohen të kompensuar.	
40	54729/12 Depozituar më 8.5.2012	Petraç Nishe Iriqi Shkurti née Nishe Ilija Çili Margarita Tola née Çili Sotir Çili	22.9.2014 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 2772, të datës 19 nëntor 1997, Gjykata e Apelit e Tiranës, pasi ndryshoi vendimin nr. 851, datë 18 shtator 1996, të Gjykatës së Rrethit të Devollit, njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 510 metra katrorësh, nga të cilat 50 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 460 metra katrorësh do të kompensohej në natyrë dhe me anë të obligacioneve.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Spiro Dodbiba
41	65797/12 Depozituar më 21.9.2012	Sherjar Vaçari Gazmend Baku Ida Peni ⁴⁶	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 83, të datës 5 qershor, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 70,000 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 60,000 metra katrorësh do të kompensohej me anë të obligacioneve. Me vendimin nr. 1014, të datës 24 mars 2003, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 193,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej me anë të obligacioneve në vlerën prej 3,067.200 lekësh (24,432 euro).	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes. ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
42	74866/12 Depozituar më 31.10.2012	Fatmir Majuni	12/03/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me një vendim të datës 29 gusht 1995, Gjykata e Rrethit Durrës, duke ndryshuar vendimin nr. 683 të Komisionit datë 17 Nëntor 1994 njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 500 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Redi Petushi
43	74867/12 Depozituar më 1.10.2012	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ⁴⁷ Gabriel Eqimijatru Petri Eqimijatru	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 148, të datës 27 korrik 2006 (vendimi i dytë), Komisioni i Korçës njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 7,292 metra katrorësh, nga të cilat 6,750 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Kërkuesve iu kthyen 11,728 metra katrorë nga Gjykata e Apelit e Korçës me	Qeveria, duke konsideruar që zona për t'u kompensuar me anë të vendimit të dytë ishte pjesë e pronës së njohur me anë të vendimit të parë, parashtrroi se	Petrika Demiri

⁴⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Fation Peni dhe Musa Peni.

⁴⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

				vendimin nr. 141, të datës 21 maj 1999, i cili ndryshoi vendimin nr. 1292 të Komisionit të datës 22 dhjetor 1995 (vendimi i parë).	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar.	
44	4692/13 Depozituar më 17.9.2012	Zamira Marku née Daja	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 113, të datës 12 qershor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 441 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, në lidhje me të cilin ka mbetur pezull kërkesa për zbatim e kërkuarve.	Xhevdet Sheta
45	64182/13 Depozituar më 3.10.2013	Dashamir Luga ⁴⁸ Sanije Hyskaj Hysen Tepelena Gezim Luga Hajrie Nallbani Hysen Luga Jusuf Fani Prandvera Kalaci ⁴⁹ née Luga Dilaver Tepelena	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1083, të datës 31 tetor 1995 Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 43,000 metra katrorësh, nga të cilat 10,000 u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 33,000 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Ledio Milkani
46	26412/14 Depozituar më 6.8.2014	Ymer Gega	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 128/1, të datës 25 korrik 1996, Komisioni i Gjyroskastrës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 39,000 metra katrorësh, nga të cilat 20,000 metra katrorë u kthyen dhe 510 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Gjithashtu, ai njohu të drejtën e kërkuarve për parablerjen e godinave që zënë 5,590 metra katrorë, nga të cilat 3,025 metra katrorë u transferuan në pronësi të kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike në vijim të privatizimit të kompanisë kombëtare për furnizimin me energji elektrike.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Avni Shehu
47	30096/14 Depozituar më 9.6.2014	Kujtim Spahiu Lumnan Spahiu Sanije Bilalaj née Spahiu Manushaqe Mena née Spahiu Bukurije Gjoka née Spahiu Sose Kastrati née Spahiu Nuhi Spahiu Kahit Spahiu	31.1./2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 38, të datës 20 shkurt 1998, Komisioni i Kukësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 92,649 metra katrorësh, nga të cilat 76,000 metra katrorë do të kompensoheshin me anë të obligacioneve në vlerën prej 2,239.542.3 lekësh (17.845 euro).	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Ardian Spahiu

⁴⁸ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Mehriban Luga, Edlira Luga dhe Gentian Luga.

⁴⁹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj: Mirvana Kadriu, Arben Kalaci, Lauresha Kapidani dhe Amela Lila.

Vëllimi III, 2020-2021

		Fllanza Cengu née Spahiu				
48	39836/14 Depozituar më 8.8.2014	Ylvije Pinari	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 211. të datës 7 korrik 1995. Komisioni i Tiranës njohe të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 1,658 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim, në lidhje me të cilin kërkesa për zbatim e kërkuessit ka mbetur pezull, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Xhevdet Sheta
49	44461/14 Depozituar më 26.7.2014	Liri Kaba	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 66, të datës 28 dhjetor 1994, Komisioni i Vlorës njohe të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 7,200 metra katrorësh, nga të cilat 5,000 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit brenda afatit trevjeçar të përcaktuar nga ligji për pronat e vitit 2015.	Agim Toro
50	48714/14 Depozituar më 24.6.2014	Abdulla Kasmi	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1, të datës 20 prill 2007, Agjencia e Durrësit njohe të drejtat e kërkuessit për pronën e trashëguar prej 160,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Adi Brovina
51	55175/14 Depozituar më 18.7.2014	Ali Arbana ⁵⁰	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 81, të 24 qershorit 2002, Komisioni i Tiranës, në plotësim të vendimit nr. 367, të datës 25 prill 1994, dhe të vendimit nr. 526, të datës 22 prill 1996, të Komisionit, njohe të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 8.207 metra katrorësh, nga të cilat 7,999 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Në vitin 2013 kërkuessi mori kompensim financiar për 500 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Xhevdet Sheta
52	57161/14 Depozituar më 31.10.2014	Ferit Llagami Nusret Llagami Razije Manehasa Nezahet Hoxha Bukurije Gjonaj Emine Themeli Liliana Llagami Altin Llagami Letfije Llagami Indrin Llagami Andri Llagami	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 120, të datës 27 gusht 2002, Komisioni i Tiranës, duke ndryshuar vendimet e tij nr. 586, të datës 29 korrik 1994, dhe nr. 317, të datës 16 shtator 2000, njohe të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 48,753 metra katrorësh, nga të cilat 29,768.5 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar.	Xhevdet Sheta

⁵⁰ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Lirije Arbana, Evis Bajo dhe Valbona Dajzmaili.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

53	57229/14 Depozituar më 24.7.2014	Egon Gjadri ⁵¹ Lejla Muça	28.1/2015	Me vendimin nr. 18, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 80,000 metra katrorësh, nga të cilat 3.786 u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 76,214 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Viktor Gumi
				Me vendimin nr. 19, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 75,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
				Me vendimin nr. 20, të datës 27 dhjetor 2005, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 60,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.		
54	58130/14 Depozituar më 18.8.2014	Ismet Vorpsi Seit Vorpsi Myzejen Erfbara	28.1.2015	Me vendimin nr. 1701, të datës 23 nëntor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 17,000 metra katrorësh nga të cilat 632.5 ishin kthyer me anë të vendimit nr. 1501 të Komisionit, datë 11 korrik 1996, dhe 10,067.5 metra katrorë do të kompensoheshin në natyrë ose me anë të obligacioneve.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Viktor Gumi
55	63020/14 Depozituar më 24.7.2014	Egon Gjadri ⁵²	28.1.2015	Me vendimin nr. 21, të datës 17 janar 2006, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 203,924 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Viktor Gumi
56	66622/14 Depozituar më 4.12.2014	Ismete Shehi Ermira Shehi Endrit Shehi Eliana Shehi Arkan Shehi	28.1.2015	Kjo kërkesë është depozituar pas komunikimit të kërkesës nr. 37381/10, detajet e së cilës janë dhënë në rreshtin 3 më lart, nga trashëgimtarë shtesë.	Ju lutemi shikoni detajet e dhëna në lidhje me kërkesën nr. 37381/10.	Spiro Dodbiba
57	68195/14 Depozituar më 10.10.2014	Engjellushe Gega née Luli Haxhire Luli Selim Luli Petrit Luli Vjollca Sauku née Luli Flora Foci née Luli Arben Luli	28.1.2015	Me vendimin nr. 2406, të datës 8 nëntor 2013, Gjykata e Apelit Tiranë, ndërkohë që la në fuqi vendimin nr. 916, të Komisionit, datë 26 prill 1996, njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 8,087 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar, në lidhje me Xhevdet Shetën për çdo vendim, kundër të cilit një ankim i depozituar nga njëri prej kërkesve ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	Xhevdet Sheta

⁵¹ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.

⁵² Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ikbale Gjadri dhe Ervin Gjadri.

Vëllimi III, 2020-2021

				Me vendimin nr. 918, të datës 26 prill 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 6,512 5 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar.	
				Me vendimin nr. 90, të datës 15 dhjetor 1999, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 4.061 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
58	72752/14 Depozituar më 17.11.2014	Shazivar Karaosmani Anita Alicka Shegushe Kosova	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 47, të datës 21 janar 2008, Komisioni i Fierit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 617,400 metra katrorësh, nga të cilat 360,150 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për Sokol Puton në këtë vendim.	Sokol Puto
59	72770/14 Depozituar më 17.11.2014	Bulcent Tela Anita Alicka Shegushe Kosova Edmond Tela Agron Tela Nesfije Selenica Lavdije Kalasa Teuta Fora Nebi Sefa Hajali Ypi Xhaneta Prodani Suhela Libohova Gjerak Karaikaj Felatun Karaikaj Shazivar Kalraosmani	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 2997, të datës 30 qershor 2004, Gjykata e Rrethit Tiranë, duke ndryshuar vendimin nr. 359 të Komisionit, datë 19 shtator 1995, njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar me një sipërfaqe toke 1.110 metra katrorë. Në vitin 2009 kërkuessit morën kompensim financiar për 200 metra katrorë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit. Sidoqoftë, ajo konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuessve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që, ATP-ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18, të ligjit për pronat të vitit 2015, në lidhje me tokën e mbivendosur.	Sokol Puto
				Me vendimin nr. 207, të datës 1 qershor 2009, Agjencia e Elbasanit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 154,488 metra katrorësh, nga të cilat 19,479 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 135,009 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensuar.	
60	72779/14 Depozituar më 17.11.2014	Ali Kosova Astrit Permeti Arjan Permeti Aida Podgorica Sokol Kosova Shqipe Kosova Ermira Hydi	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 347, të datës 10 mars 1994, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 5,000 metra katrorësh, nga të cilat 1,000 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 4,000 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
				Me vendimin nr. 1652/1, të datës 29 tetor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar		

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

				<p>prej 3,458 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.</p> <p>Me vendimin nr. 1652/3, të datës 29 tetor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 2.476 metra katrorësh, nga të cilat 223 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 2,253 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.</p> <p>Me vendimin nr. 170, të datës 23 qershor 2009, Agjencia e Durrësit, në plotësim të vendimit nr. 1696/1 të Komisionit, datë 23 nëntor 1996, njohu titullin e pronësisë së trashëguar të kërkuarve për një sipërfaqe toke 5,000 mera katrorësh, nga të cilat 3,177.2 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1,822.8 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.</p> <p>Me vendimin nr. 596, të datës 7 dhjetor 2000, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 1,600 metra katrorësh, nga të cilat 72 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 1,528 do të kompensohej në përputhje me ligjin.</p> <p>Me vendimin nr. 734, të datës 5 qershor 2003, Komisioni i Pronave në Durrës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 352 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.</p>		
61	74962/14 Depozituar më 18.11.2014	Sara Myshketa Agron Myshketa Suzana Myshketa Hasan Myshketa Kujtim Myshketa Aishe Shehu Teuta Gjezi (Myshketa) Lejla Kodra (Myshketa) Verusha Kurani (Myshketa) Ermine Petrela (Myshketa)	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	<p>Me vendimin nr. 849, të datës 27 prill 1995, Komisioni i Durrësit njohu të drejtën e kërkuarve për kompensim për 4.999.5 metra katrorë.</p> <p>Me vendimin nr. 1539, të datës 6 gusht 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtën e kërkuarve për kompensim për 1,684.5 metra katrorë.</p>	Palët nuk kanë paraqitur ndonjë informacion në lidhje me kryerjen e vlerësimit financiar të secilit prej vendimeve.	Sokol Puto
62	74968/14 Depozituar	Sara Myshketa Agron	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe	Me vendimin nr. 70, të datës 14 prill, Komisioni i Durrësit, në plotësim të vendimit të tij nr. 933,	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit	Sokol Puto

Vëllimi III, 2020-2021

	më 18.11.2014	Myshketa Suzana Myshketa Hasan Myshketa Kujtim Myshketa	13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	datë 4 korrik 1995, njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 2,825 metra katrorësh, nga të cilat 142 metra katrorë u kthyen dhe 2,593 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai, gjithashtu, njohu të drejtën e tyre të parablerjes së një ndërtese që zë 90 metra katrorë.	financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuarët të konsiderohen të kompenzuar. Kërkuarët kanë apeluar kundër vendimit të ATP-së dhe procedurat duket se kanë mbetur pezull në Gjykatën e Lartë.	
				Me vendimin nr. 441, të datës 9 mars 1999, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 4,250 78 metra katrorësh, nga të cilat 661 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 3,589.78 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
63	510/15 Depozituar më 16.12.2014	Ilirian Cani Enrieta Vozga née Cani Nadire Bacelli née Cani Emin Shijaku Myzejen Murthi ⁵³ née Cani Haxhi Cani Arben Cani Albana Thodhori née Cani Merita Toska	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1218, të datës 27 nëntor 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 130,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Xhevdet Sheta
64	551/15 Depozituar më 6.1.2015	Petro Axha Jolanda Axha Vlash Heba Aurel Heba	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 471, të datës 12 prill 1996, Komisioni i Pronave në Kavajë njohu të drejtën e kërkuarve për kompensim për 1,148 metra katrorë.	ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar të vendimit brenda afatit trevjeçar të përcaktuar nga ligji për pronat e vitit 2015.	Sokol Puto
65	3082/15 Depozituar më 30.1.2013	Dhimitraq Eqimijatru Kleri Cika ⁵⁴ Gabriel Eqimi Jatru Petri Eqimi Jatru	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 691/1, të datës 9 tetor 2002, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 58,000 metra katrorësh, nga të cilat 15,800 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka vendosur që të mos përcaktojë vlerësimin financiar të vendimit, për shkak të mungesës së dokumenteve në dosjen e çështjes.	Petrika Demir1
66	6543/15 Depozituar më	Aferdita Koxhaj Genc Koxhaj	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i	Me vendimin nr. 1410, të datës 28 maj 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 379 metra	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Dorant Ekmekçiu

⁵³ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Ismail Murthi dhe Fatlinda Struga.

⁵⁴ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Nikolla Cika, Leonard Cika dhe Robert Cika.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

	28.1.2015	Andrea Koxhaj	protokollit nr. 1	katrorësh, e cila do të kompensohej në natyrë. Me vendimin nr. 1712, të datës 28 nëntor 1996, Komisioni i Durrësit njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 51 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në natyrë.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit. Sidoqoftë, ajo konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuarve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që ATP-ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18 të ligjit për pronat të vitit 2015 në lidhje me tokën e mbivendosur.	
67	6613/15 Depozituar më 28.1.2015	Aferdita Koxhaj	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 861, të datës 18 nëntor 1994, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 762.56 metra katrorësh nga të cilat 448.3 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu të drejtën e saj për parablerjen e disa godinave. Me vendimin nr. 283, të datës 10 tetor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 1,239 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 449, të datës 19 shkurt 1996, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 396.5 metra katrorësh, nga të cilat 18 metra katrorë iu kthyen dhe pjesa e mbetur prej 378.5 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Me vendimin nr. 188, të datës 31 korrik 1996, Komisioni i Kavajës njohu, ndër të tjera, të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 5,000 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për çdo vendim.	Dorant Ekmekçiu
68	10728/15 Depozituar më 23.2.2015	Elton Lelo Gigi (Haxhire) Lelo Helda Rock (Lelo)	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 49, të datës 10 gusht 2007, Agjencia e Vlorës njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar prej 14,400 metra katrorësh, e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit dhe konstatoi se disa pjesë të tokës së kërkuarve mbivendoseshin me ato të njohura në favor të një pale të tretë. Kështu që, ATP-	Sokol Puto

Vëllimi III, 2020-2021

					ja ka proceduar në përputhje me seksionin 18, të ligjit për pronat të vitit 2015, në lidhje me tokën e mbivendosur.	
69	11214/15 Depozituar më 20.2.2015	Ndricim Dibra Vjollca Mesi Amir Dibra	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 807, të datës 13 shkurt 1995, Komisioni i Shkodrës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 10,210 metra katrorësh, nga të cilat 5,805 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 4.405 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja, pas kryerjes së vlerësimit financiar të të dyja vendimeve, vendosi që kërkuessit të konsiderohen të kompensoar.	Avni Shehu
70	12394/15 Depozituar më 6.3.2015	Asllan Picari Xhumaje Hajdari née Picari Ahemal Picari Fatime Aliu née Picari	25.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 153, të datës 28 maj 2009, <i>the Tirana Agency, supplementing the Commission decision no. 35 of 30 mars 1994</i> , njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 41,000 metra katrorë <i>which would be compensated in accordance with the law.</i>	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Besim Peka
71	21648/15 Depozituar më 28.4.2015	Shpresa Kercani Nuri Kercani Luljeta Kercani	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 1255, të datës 20 mars 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 631.5 metra katrorësh nga të cilat 234 sq. m were restored and the remaining 397.5 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Sokol Puto
				Me vendimin nr. 493, të datës 20 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 59,500 metra katrorësh, nga të cilat 30,000 metra katrorë were restored and the remaining 29,500 sq. m do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.		
				Me vendimin nr. 494, të datës 20 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 64,500 metra katrorësh, nga të cilat 10.000 metra katrorë u kthyen dhe 29,500 metra katrorë do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e objekteve që zënë 25,000 metra katrorë .		
72	21704/15 Depozituar më 27.4.2015	Hamid Meneri Tahir Meneri ⁵⁵ Pranvera Reci Aferdita Saraci	25.4.2016 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Sipas kërkuessve, me vendimin nr. 158, të datës 23 qershor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkuessve për pronën e trashëguar prej 713.5 metra katrorësh, nga të cilat 266.1 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 447.4 metra katrorësh	Vendimi i është nënshtruar vlerësimit financiar, përveç zonës në të cilën ishte njohur e drejta e parablerjes, pasi	Suela Meneri

⁵⁵ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Anila Agaraj Meneri dhe Eneida Janku Meneri.

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

		Luljana Llagam ⁵⁶ Reshat Meneri Luan Meneri Suzana Tafaj Dhurata Reci Ili Meneri Betina Xhepa		do të kompensoheshin në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e disa godinave që ndodhen në zonën që do të kompensohet.	kërkuesit nuk kanë hequr dorë nga ajo në përputhje me ligjin për pronat.	
				Me vendimin nr. 761, të datës 28 shkurt 1996, Komisioni i Tiranës njohu titullin e trashëguar të kërkuesve për 59 metra katrorë, të cilat do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
				Me vendimin nr. 643, të datës 30 korrik 1996, Komisioni i Tiranës njohu titullin e trashëguar të kërkuesve për 400 metra katrorë, nga të cilat 60 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 340 metra katrorësh do të kompensohej në përputhje me ligjin. Ai njohu më tej të drejtën e tyre për parablerjen e disa godinave që ndodhen në zonën që do të kompensohet.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	
73	8789/15 Depozituar më 10.2.2015	Mas-Har Kapidani Isuf Kapidani Meleqe Daja née Kapidani	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me tri vendime të ndryshme nr. 2, 3 dhe 4, të datës 20 prill 2007, Agjencia e Durrësit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 239,000 metra katrorësh do të kompensoheshin në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar për këtë vendim.	Xhevdet Sheta
74	70211/13 Depozituar më 1.11.2013	Xhemil Gjergji Minerva Kotherja Ferzilet Sakrja Zedlir Bylykbashi Armand Bvlykbashi Myzejen Caku Ermira Garunja	31.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 373/2, të datës 27 korrik 1994, Komisioni i Elbasanit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 2.490 metra katrorësh e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit. Një ankim kundër vendimit të ATP-së, depozituar nga njëri prej kërkuesve ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	Endri Kotherja
75	71730/14 Depozituar më 5.11.2014	Hysni Kotherja Artan Kurti Silvana Dracini Mirela Dracini Minerva Kotherja Hyqmet Kotherja ⁵⁷ Burbuqe Kotherja	28.1.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 523/2, të datës 23 shtator 1996, Komisioni i Elbasanit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 330 metra katrorësh e cila do të kompensohej në përputhje me ligjin.	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit. Një ankim kundër vendimit të ATP-së, depozituar nga njëri prej kërkuesve ka mbetur pezull në Gjykatën e Lartë.	Endri Kotherja
76	9152/15 Depozituar më 12.2.2015	Halil Kadria	12.3.2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 15, të datës 24 dhjetor 1996, Komisioni i Kukësit njohu të drejtat e kërkuesve për pronën e trashëguar prej 7,211 metra katrorësh e cila do të	ATP-ja ka realizuar vlerësimin financiar të vendimit dhe	Xhevdet Sheta

⁵⁶ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Bledar Llagami dhe Etleva Beliu.

⁵⁷ Siç është zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij: Elida Kotherja, Dored Kotherja dhe Elvis Kotherja.

Vëllimi III, 2020-2021

				kompensohej në përputhje me ligjin.	ankimi i kërkesit kundër vendimit të ATP-së duket se ka mbetur pezull në Gjykatën Administrative të Apelit.	
77	67286/14 Depozituar më 7.10.2014	Ikbal Hyka Fatbardha Zhegu (Hyka) Lindita Tola (Hyka) Amir Hyka Genti Hyka	28/01/2015 Nenet 6§1 dhe 13, dhe neni 1, i protokollit nr. 1	Me vendimin nr. 259, të datës 23 nëntor 1995, Komisioni i Tiranës njohu të drejtat e kërkesve për pronën e trashëguar prej 2,009 metra katrorësh, nga të cilat 1.439 metra katrorë u kthyen dhe pjesa e mbetur prej 570 metra katrorë do të kompensohej në përputhje me ligjin.	Si rezultat i vlerësimit financiar të vendimit, Qeveria ka parashtruar se kërkesit kanë marrë kompensim financiar dhe në natyrë, si rezultat i të cilit vendimi është zbatuar plotësisht. Kërkesit nuk kanë paraqitur ndonjë informacion të azhurnuar në përgjigje të kësaj.	Sokol Puto

SEKSIONI I DYTE
ÇËSHTJA
“TËRSHANA KUNDËR SHQIPËRISË”⁵⁸
(ankimi nr. 48756/14)

VENDIM

Strasbourg
4 gusht 2020

Neni 2 (material) - Detyrimet pozitive - Sulm me acid ndaj një gruaje në rrugë - Ekzistenca e një kuadri të ligjit penal efektiv - Rreziku për jetën e ankueses nga ish-bashkëshorti i dyshuar nuk është sjellë në vëmendje të autoriteteve para sulmit - Autoritetet shtetërore nuk janë përgjegjëse, neni 2 (procedural) - Hetim efektiv - Gjykata ka parasysh situatën e përgjithshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri - Qasje joefektive ndaj dhunës ndaj grave nga zyrtarët e zbatimit të ligjit - Detyrimi nga ana e autoriteteve hetimore për të reaguar me kujdes të veçantë në kryerjen e një hetimi të plotë - Moskryerje me shpejtësinë dhe vendosmërinë e dubur të masave hetimore të një rëndësie thelbësore - Pamundësi e ankueses për të apeluar vendimin për pezullimin e hetimit, për të kundërshtuar (mungesën e) hapave hetimorë ose paraqitjen e kërkesës për dëmshtëpërlim.

*Ky vendim do të marrë formë të prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44§2 të Konventës.
Ai mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktues.*

Në çështjen “Tërshana kundër Shqipërisë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i dytë), me trup gjykues të përbërë nga:

Robert Spano, president

Paul Lemmens

Ledi Bianku

Valeriu Griçco

Jon Fridrik Kjolbro

Stéphanie Mourou-Vikström

Arnfinn Bårdsen, gjyqtarë

dhe Stanley Naismith, sekretar i seksionit

Pas shqyrtimit me dyer të mbyllura më 3 korrik 2018 dhe 23 qershor 2020,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka zanafillën në ankimin (nr. 48756/14) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar pranë Gjykatës, sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetase shqiptare, znj. Dhurata Tërshana (ankuesja), më 30 qershor 2014.

2. Ankuesja u përfaqësua nga z. N. Marku, avokat që ushtron aktivitetin e tij në Tiranë. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentja e saj, në atë kohë, znj. Alma Hicka nga Avokatura e Shtetit.

3. Ankuesja pretendonte se autoritetet kanë dështuar në mbrojtjen e jetës së saj dhe të së drejtës së saj për jetë private, sipas neneve 2, 3, 8, 13 dhe 14 të Konventës. Ajo, gjithashtu, u ankua për dështimin e autoriteteve për të kryer një investigim të shpejtë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen dhe dënimin e autorit të sulmit.

4. Më 6 tetor 2014 ankimi iu komunikua Qeverisë.

⁵⁸ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 205*. Tiranë 2020, f. 14509

FAKTET

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

5. Ankuesja ka lindur në vitin 1984 dhe banon në Tiranë.

A. Historiku i çështjes

6. Më 29 korrik 2009, rreth orës 4 pasdite, ndërsa ecte në një nga rrugicat e Tiranës, ankuesja pësoi dëmtime të rënda në një sulm me acid nga një autor i paidentifikuar. Ajo u dërgua menjëherë në spitalin “Nënë Tereza” për të marrë trajtim urgjent mjekësor. Raporti i spitalit tregonte se njëzet e pesë për qind e trupit të ankueses, kryesisht fytyra dhe pjesa e sipërme e trupit ishte djegur (*combustio corporis, facies et extremitas superior*), për shkak të sulmit me acid dhe se ishte në gjendje kritike. Më 1 gusht 2009 ajo u dërgua në Itali për një trajtim mjekësor më të specializuar. Raporti i spitalit i datës 2 tetor 2009 tregonte se ankuesja kishte djegie të shkallës së mesme deri në thellësi të fytyrës, qafës dhe trupit (*ustioni intermedio-profonde di volto, collo, tronco, arti superiori ed inferiori*) të shkaktuara nga acidi sulfurik. Sipas raportit të trajtimit të saj spitalor në Itali, ankuesja iu nënshtrua të paktën katërmbëdhjetë operacioneve në periudhën midis viteve 2009 dhe 2012. Shpenzimet e këtyre operacioneve u përballuan nga Krahinat e Pulias dhe Marche, Itali si dhe nga ankuesja. Ajo vuante nga ankthi dhe probleme psikologjike dhe kishte frikë të kthehej në Shqipëri. Ajo përfitoi raport mjekësor për të paktën shtatë muaj nga autoritetet shqiptare, por duket se nuk ishte në gjendje të punonte për disa vjet.

B. Hetimi i çështjes së sulmit të 29 korrikut 2009

7. Më 29 korrik 2009 prokurori hapi një hetim për sulmin me acid, sipas nenit 88 të Kodit Penal (*shih paragrafin 64 më poshtë*). Ankuesja bëri një deklaratë në të cilën u shpreh se nuk e kishte njohur autorin e sulmit ndaj saj. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd, por dyshonte se sulmi ishte organizuar nga ish-bashkëshorti i saj (E.A.) si një akt hakmarrjeje dhe vazhdimësisë së dhunës që kishte pësuar në të kaluarën. Ai e kishte kërcënuar në të kaluarën se do ta vriste. Ajo dhe E.A. ishin ndarë përfundimisht, pasi ai kishte refuzuar ta lejonte atë që të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali. Përveç kësaj, ajo deklaroi se në kohën e sulmit, autori mbante një kapelë ngjyrë kafe/bezhë, syze dielli të zeza dhe këmbë të zezë. Autori i sulmit kishte hedhur një substancë mbi fytyrën dhe trupin e saj dhe më pas ishte larguar. Ajo kishte ndjerë që fytyra dhe gjoksi i saj po digjeshin dhe rrobat e saj po shkriheshin. Substanca ishte hedhur edhe mbi kolegen e saj. Ajo më tej deklaroi se E.A. kishte qenë i burgosur në Itali dhe se kishte miq me rekorde kriminale.

8. Po atë ditë, prokurori mori një deklaratë nga kolegia e ankueses, e cila kishte qenë me të gjatë sulmit me acid dhe kishte pësuar, gjithashtu, dëmtime të rënda. Edhe kolegia e ankueses deklaroi se nuk e kishte njohur autorin e sulmit. Autori kishte veshur pantallona të errëta dhe këmbë të zezë dhe mbante një enë që kishte brenda një substancë të kuqe. Ndërkohë që ecte drejt saj dhe ankueses, ai kishte hapur enën dhe kishte hedhur përmbajtjen e saj mbi trupat e tyre. Ajo deklaroi se nuk kishte mosmarrëveshje me askënd dhe se kishte dëgjuar nga pjesëtarët e familjes së ankueses se dyshonin për ish-bashkëshortin e ankueses. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kishte parë njerëz të tjerë në vendngjarjen e sulmit dhe një burrë në rrugën kryesore.

9. Më 29 korrik dhe 6 gusht 2009 E.D., një nga kolegët e ankueses dha një deklaratë ku shprehej se nuk kishte qenë në gjendje të dallonte fytyrën e autorit të krimit, sepse kishte qenë me shpinë ndaj tij. Sipas përshkrimit të tij, autori kishte veshur këmbë të kuqe, xhins me vija të bardha dhe syze dielli. Ai, më tej, përshkroi se si e kishte ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër, dhe se, së bashku me një kolege tjetër, E.S., i kishin dërguar të dyja në spital. Ai, gjithashtu, deklaroi se në vendngjarje kishin ardhur njerëz të tjerë dhe ishin përpjekur të ndihmonin viktimat. Kolegia e lartpërmendur E.S. deklaroi se kishte ndihmuar për t'i dërguar viktimat në spital. Ajo nuk e kishte parë fare autorin e krimit.

10. Më 29 korrik 2009 B.D., motra e ankueses, deklaroi se e motra i kishte treguar më parë që E.A. ishte xheloz dhe ushtronte dhunë ndaj saj. Ajo kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali, por E.A. nuk e kishte lejuar. Ai e kishte kërcënuar se do ta vriste nëse do të divorcoheshin. Ajo, gjithashtu, deklaroi se kushëriri i saj, R.T., ishte takuar me E.A. për t'i kthyer disa sende në emër

të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do t'i shkaktonte ankueses asnjë problem dhe se ajo mund të vazhdonte jetën e saj normale. B.D. deklaroi, gjithashtu, se në maj 2009 ajo ishte takuar me E.A. dhe nënën e tij në prani të motrës së saj për të diskutuar mbi vazhdimësinë e marrëdhënies së tyre. Sipas B.D., ishte e qartë nga diskutimet që patën se E.A. kishte ushtruar dhunë ndaj motrës së saj. Më 21 dhjetor 2009 B.D. dha një deklaratë tjetër në të cilën konfirmonte deklaratat e saj të datës 29 korrik 2009 dhe u shpreh se ende kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.

11. Më 29 korrik 2009 R.T., kushëriri i ankueses, deklaroi se ishte në dijeni që E.A. kishte përdorur dhunë ndaj ankueses dhe ishte xheloz. Ai kishte takuar E.A. dy muaj më parë dhe i kishte dhënë disa sende në emër të ankueses. E.A. i kishte thënë R.T. se nuk do të kontaktonte me ankuesen dhe nuk do t'i shkaktonte asaj asnjë problem.

12. Më 29 korrik 2009 L.D., kunati i ankueses deklaroi se kishte mësuar nga gruaja e tij B.D., se kunata e tij i ishte nënshtruar dhunës dhe fyerjeve nga bashkëshorti i saj.

13. Më 29 korrik 2009 V.T., nëna e ankueses deklaroi se E.A. ishte përfshirë në vepra penale, të tilla si vjedhja e kasafortave dhe vrasja. Ai kishte përdorur dhunë ndaj ankueses. Një herë, ai e kishte mbyllur atë në banesën e tij për tri ditë, duke e penguar të shkonte në punë, në shenjë hakmarrjeje për kërcënimin se do ta denonconte atë në polici. Pas divorcit ata kishin pasur disa herë grindje në lidhje me sende të caktuara që duhej t'i kthenin njëri-tjetrit.

14. Më 29 korrik 2009, një tjetër dëshmitar, G.D., i cili kishte qenë duke pirë kafe në një kafene aty pranë në kohën e sulmit, deklaroi se kishte shkuar për të ndihmuar ankuesen dhe viktimën tjetër pasi dëgjoji britma. Ai nuk e kishte parë kush e kishte kryer sulmin. Ai kishte parë një enë në rrugë dhe e kishte shkëluar. Sipas tij, substanca e cila u derdh nëpër rrugë kishte qenë acid.

15. Në një deklaratë të dhënë po atë ditë, E.A. deklaroi se më 29 korrik 2009 ai kishte qenë në Durrës deri në orën 6 pasdite. Më tej ai deklaroi se me ankuesen ishin divorcuar në maj 2009, sepse kishin probleme; ai nuk kishte qenë dakord me ankuesen kur ajo kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs profesional të specializuar. Ai, gjithashtu, deklaroi se procesi i divorcit kishte shkuar normalisht dhe që nga ajo kohë nuk kishte pasur asnjë kontakt me ankuesen. Ai nuk kishte asnjë informacion se kush mund të ketë qenë autori i krimit. Ai, gjithashtu, dha informacion për njerëzit që njihje, konkretisht familjarët, miqtë dhe të afërmit.

16. Më 29 korrik 2009 F.P., nëna e E.A., deklaroi se djali i saj dhe ankuesja kishin pasur marrëdhënie të mira, por ishin divorcuar në vitin 2009, sepse ankuesja kishte dashur të ndiqte një kurs trajnimi të specializuar në Itali dhe E.A. nuk ishte pajtuar me idenë. Ajo më tej deklaroi se ditën që ata u divorcuan ajo kishte takuar djalin e saj, ankuesen dhe motrën e ankueses për të gjetur një zgjidhje. Megjithatë, djali i saj dhe ankuesja kishin vendosur t'i jepnin fund marrëdhënies së tyre. Që nga ajo kohë, me sa ishte në dijeni, ata nuk kishin pasur asnjë kontakt. Ajo konfirmoi se djali i saj kishte qenë në Durrës gjatë gjithë ditës. Kushëriri i E.A., L.A., deklaroi, gjithashtu, se me sa ishte në dijeni, kushëriri i tij nuk kishte asnjë mosmarrëveshje me ankuesen.

17. Më 29 korrik 2009, një oficer i policisë gjyqësore kreu një ekzaminim në vendngjarje dhe siguroi disa prova, përfshirë rrobat e ankueses dhe koleges së saj dhe një enë qelqi që përmbante një sasi të vogël të një substance të lëngshme të kuqe.

18. Më 29 korrik dhe 1 tetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që duhej të përpiloheshin disa raporte, përkatësisht një raport mjekoligjor, një raport ekspertimi i gjurmëve të gishtave mbi enën prej qelqi të përdorur për hedhjen e acidit, një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi enën prej qelqi për të identifikuar substancën e lëngshme dhe metodën me të cilën ishte prodhuar lëngu, si dhe një raport ekspertimi kimik dhe toksikologjik mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër për të identifikuar substancën e lëngshme dhe për të përcaktuar nëse dëmtimi i rrobave kishte ndodhur si rezultat i përdorimit të asaj lënde.

19. Më 29 korrik 2009 prokurori urdhëroi përgjimin e bisedave telefonike të E.A. për periudhën 29 korrik deri më 12 gusht 2009, që më pas u aprovua nga gjykata e rrethit më 30 korrik 2009. Më 13 gusht 2009 prokurori i përgjithshëm i dërgoi rezultatet e përgjimit prokurorit të rrethit.

20. Më 30 korrik 2009 oficeri i policisë gjyqësore referoi pranë prokurorisë së rrethit, veprën penale të shkaktimit të plagosjes së rëndë me dashje që i atribuohet E.A. Ai u shpreh se më 29 korrik 2009 në një rrugicë pranë Ministrisë së Drejtësisë, një person i paidentifikuar kishte hedhur acid mbi ankuesen dhe viktimën tjetër, duke i lënë të dyja në gjendje kritike. Ai vlerësonte se në bazë të dëshmimeve në dosje, si dhe deklaratave të dhëna nga ankuesja, viktima tjetër dhe familjarët e tjerë, ishte e qartë se kishte dyshime që E.A. mund të ketë kryer sulmin.

21. Më 31 korrik 2009 ankuesja dha një deklaratë tjetër, duke thënë se ende kishte dyshime që E.A. kishte dashur të hakmerret për shkak të divorcit. Ajo, gjithashtu, shtoi se në të kaluarën ai kishte kryer vepra penale – përkatësisht vjedhje nga kasaforta dhe shtëpi – dhe se posedonte një armë.

22. Më 3 gusht 2009, prokurori i rrethit urdhëroi që të ndërmerren një sërë veprimesh procedurale, të tilla si ekzaminimi i raport ekspertimit të gjurmëve të gishtave mbi enën e përdorur për hedhjen e acidit dhe që rezultatet të krahasohen me gjurmët e gishtave të personave të tjerë të dyshuar, si dhe çdo personi tjetër të përfshirë në listën e personave të dyshuar në Laboratorin Qendror të Kriminologjisë; ekzaminimi i raportit mjekoligjor dhe i raporteve të tjera të ekspertimit; pyetja e çdo personi që ka dijeni për ngjarjen; ekzaminimi i përgjimeve telefonike; marrja e tabulateve telefonike të viktimave dhe E.A., si dhe të çdo personi tjetër që mund të ketë lidhje me hetimin; gjetja dhe verifikimi i numrave telefonikë të përdorur nga E.A. në internet; konfiskimi i pamjeve filmike të disa kamerave aty pranë, pasi ndonjëra prej tyre mund të ketë kapur dhe regjistruar autorin e krimit; përcaktimi i aparateve të gjetura në banesën e E.A. (*shih paragrafin 44 më poshtë*); si dhe çdo veprim tjetër që gjykohej me vend.

23. Më 3 gusht 2009, një raport ekspertimi i përgatitur nga Instituti i Policisë Shkencore (ISP) konkludonte se nuk mund të identifikohet asnjë gjurmë gishtash në enën prej qelqi.

24. Më 6 gusht 2009 një raport mjekoligjor i përgatitur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (FMI) konkludonte se njëzet e pesë për qind e fytyrës, e barkut dhe e gjymtyrëve të sipërme të ankuseses ishin djegur, ku dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë gërryese. Raporti më tej konkludonte se ishte e pamundur që duke u bazuar vetëm në raportin mjekoligjor të jepej një konkluzion i saktë në lidhje me kategorinë e dëmtimeve të ankuseses. Prandaj ishte e nevojshme që ankuesja të ekzaminohej tre muaj pas datës në të cilën ishte dëmtuar.

25. Më 11 gusht 2009 oficeri i policisë gjyqësore kreu kërkime në internet për të gjetur numrat e telefonit të renditur në emër të E.A. Po atë ditë, prokurori kërkoi që një kompani e telefonisë celulare t'i siguronte historikun e regjistrimit të thirrjeve, në lidhje me disa nga numra telefonikë të E.A. për periudhën 25 deri më 30 korrik 2009, si dhe vendndodhjen dhe zonën e mbulimit më 29 korrik 2009. Më 18 gusht kompania e telefonisë celulare paraqiti informacionin e kërkuar nga prokurori.

26. Më 15 gusht dhe 15 dhjetor 2009 u kërkuan informacione të tjera në lidhje me disa numra telefonikë për të identifikuar personat që u përkisnin dhe që mund të kenë bërë thirrje telefonike gjatë orëve kur ka ndodhur sulmi. Më 21 dhjetor 2009 kompania e telefonisë celulare dorëzoi informacionin e kërkuar nga prokurori. Në janar 2011 dy individët e pyetur nga oficeri i policisë gjyqësore deklaruan se nuk kishin asnjë informacion për incidentin e datës 29 korrik 2009. Megjithëse ishin miq me E.A., ata pohuan se ai nuk e kishte diskutuar ngjarjen me ta. Një person tjetër i pyetur deklaroi se nuk e njihte fare E.A.

27. Më 11 gusht 2009 prokurori i rrethit kërkoi që t'i siguroheshin pamjet filmike nga tri banka aty pranë, pasi kamerat e tyre të sigurisë mendohej të kenë regjistruar imazhet e ngjarjeve të datës 29 korrik 2009. Më 13 dhe 18 gusht 2009 dy banka dorëzuan pamjet filmike në CD-ROM. Raporti i shkruar nga oficeri i policisë gjyqësore më 24 shtator 2009 mbi shqyrtimin e provave shprehte se ishin ekzaminuar CD-ROM-ët, me qëllim identifikimin e ndonjë personi që kishte të njëjtat karakteristika me personin e përshkruar në deklaratat e dhëna nga dëshmitarët. Ato u ekzaminuan edhe nga ankuesja dhe kolegja e saj. Sidoqoftë, askush nuk mund të identifikohet si autori i dyshuar.

28. Më 9 shtator 2009 një dëshmitare tjetër, G.V., kolege e ankuseses, u pyet dhe përshkroi se si ishte veshur një burrë të cilin ajo e kishte parë pranë vendit të ngjarjes. Sipas saj, autori i sulmit mbante një kapele të errët, syze dielli dhe rroba të errëta. Po atë ditë, një tjetër dëshmitare, Y.K.,

deklaroi se kishte parë dy të rinj që mbanin një enë qelqi, njëri prej të cilëve kishte veshur një këmishë të kuqe dhe tjetri një këmishë të zezë.

29. Më 16 dhjetor 2009, E.K. – motra e E.A. – dha një deklaratë përpara oficerit të policisë gjyqësore, në të cilën konfirmonte se më 29 korrik 2009, E.A. kishte qenë në Durrës me të. Ajo deklaroi se ankuesja dhe E.A. kishin pasur një marrëdhënie të mirë. Ata ishin divorcuar sepse ankuesja kishte dashur të shkonte në Itali për të ndjekur një kurs trajnimi të specializuar dhe E.A. nuk kishte rënë dakord me idenë për arsyet e tij personale.

30. Më 30 shtator 2009, Fakulteti i Shkencave të Natyrës (FNS) informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk ishte në gjendje të përpilonte raportin e ekspertimit kimik të kërkuar (ka të ngjarë duke iu referuar raportit të ekspertimit që do të hartohej në lidhje me substancën e kuqe – shih paragrafin 18), pasi i mungonin pajisjet e nevojshme të specializuara.

31. Më 23 tetor 2009 ISP informoi oficerin e policisë gjyqësore se nuk mund të përpilonte një raport ekspertimi mbi rrobat e ankueses dhe viktimës tjetër, pasi nuk binte në sferën e tij të kompetencës.

32. Më 7 dhjetor 2009 oficeri i policisë gjyqësore vendosi që FMI-ja duhej të përpilonte një raport tjetër mjekoligjor në funksion të konkluzioneve të nxjerra në raportin e datës 6 gusht 2009 (*shih paragrafin 24 më lart*). Më 15 dhjetor 2009 mjeku u përgjigj se raporti mund të përgatitej sapo t'i vihej në dispozicion një kopje e raporteve mjekësore të ankueses përgatitur nga spitali italian.

33. Më 15 dhjetor 2009 një grup ekspertësh i FMI-së përgatiti një raport tjetër mjekoligjor. Ata vunë në dukje se nuk mund të ekzaminonin ankuesen, pasi ajo ishte në Itali duke marrë trajtim special dhe nuk kishin qenë në gjendje të shqyrtonin raportet mjekësore të ardhura nga spitali italian. Ata përsëritën konkluzionin e shprehur në raportin mjekoligjor të datës 6 gusht 2009. Ata konkluduan, se, në bazë të dokumenteve që dispononin, në kohën kur u shkaktuan dëmtimet, ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses, nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore.

34. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, vendosi të pezullojë hetimin në lidhje me veprën penale të shkakimit të plagosjes së rëndë me dashje, në përputhje me nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale, për veprime të mëtejshme për identifikimin e autorit. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklaratat e dhëna nga ankuesja dhe personat e tjerë. Vendimi shprehte, për aq sa është e arsyeshme, si më poshtë:

“... raportet mjekoligjore konkluduan se njëzet e pesë për qind e fytyrës, të barkut dhe të gjymtyrëve të sipërme të ankueses ishin djegur. Dëmtimet ishin shkaktuar nga një substancë gërryese. Dëmtimet ishin aq të rënda sa do të përbënin rrezik për jetën e ankueses nëse nuk do t'i ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore ... raporti i ekspertimit të gjurmëve të gishtave konkludonte se asnjë gjurmë gishtash nuk mund të identifikohet ...

FNS-ja u përgjigj se i mungonin pajisjet e specializuara të nevojshme për të hartuar raportet përkatëse të ekspertimit ...

ISP-ja u përgjigj se nuk ishte detyra e këtij institucioni që të kryente raportin e ekspertimit të kërkuar, në lidhje me ekzaminimin e rrobave që kishte veshur ankuesja në kohën e sulmit ...

Pas ekzaminimit të pamjeve filmike nga dy kamera aty pranë, askush nuk mund të identifikohet si i dyshuar për kryerjen e krimit, duke marrë parasysh tiparet e përmendura nga dëshmitarët në deklaratat e tyre; marrja e një kopje të CD-ROM-it nga banka tjetër ishte e pamundur, për shkak të vështirësive teknike të hasura me zbardhjen e saj ...

Përgjimet e komunikimeve telefonike nuk zbuluan asnjë bisedë me rëndësi për hetimin ...

U morën në pyetje tre individë të tjerë të cilët kishin kryer komunikime telefonike gjatë periudhës kur ndodhi sulmi, por pa rezultat ...

Është e qartë se prokurori i rrethit ndërmori veprime të shumta hetimore, të tilla si shqyrtimi i shumë provave, si dhe pyetja e ankueses. Për arsyet e mësipërme, janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, por nuk ka qenë e mundur të identifikohet autori/ët e veprës penale ...”

35. Ankuesja, duke mos marrë asnjë komunikim tjetër zyrtar pas fillimit të hetimit, më 10 mars 2012 autorizoi Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (Qendra) për të ndjekur

çështjen e saj.

36. Më 2 prill 2012 Qendra kërkoi informacion nga prokurori në lidhje me ecurinë e hetimit.

37. Më 17 prill 2012 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar dhe dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme, me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Qendra u informua se duhej të kërkonte kopje të dokumenteve që kërkonte nga autoriteti përkatës policor.

38. Më 19 prill 2012 Qendra kërkoi nga Drejtoria e Policisë Tiranë (DPT) që t'i dërgonte informacion në lidhje me ecurinë e hetimit.

39. Më 23 maj 2012, DPT-ja informoi Qendrën se hetimi vijonte dhe i vuri në dispozicion një kopje të raporteve mjekësore. Një kopje e vendimit të prokurorit ku pezullonte hetimin nuk mund të sigurohej pa autorizimin paraprak të prokurorit.

40. Më 5 dhjetor 2013 Qendra kërkoi nga prokurori që t'i siguronte një kopje të dosjes hetimore. Qendra, gjithashtu, nxiti prokurorin për gjetjen dhe dënimin e autorit.

41. Më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, pasi autori i sulmit nuk mund të identifikohet. Dosja e çështjes i kishte kaluar tërësisht autoritetit policor, nga ku Qendra mund të merrte një kopje.

42. Dosja penale që u paraqit nga Qeveria si pjesë e vëzhgimeve të tyre tregonte se ishte hapur një hetim mbi veprat penale të shkakimit të plagosjes së rëndë me dashje dhe prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve parashikuar respektivisht në nenet 88 dhe 279 të Kodit Penal. Në dy raste, më 30 tetor dhe 31 dhjetor 2009, prokurori ka zgjatur hetimin me argumentin se hetimi ishte kompleks dhe se ishte e nevojshme pyetja e shumë individëve dhe ekzaminimi i disa akteve të tjera.

43. Duket se deri në fund të vitit 2015, kur palët dorëzuan parashtrimet e tyre me shkrim përpara Gjykatës, Çështja ishte ende në pritje përpara autoriteteve policore, dhe palët nuk kanë dhënë ndonjë informacion të azhurnuar.

C. Procedimet gjyqësore në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve

44. Më 29 korrik 2009, në banesën e E.A. u ushtrua kontroll dhe u gjetën dy thika, katër televizorë, dy kompjuterë laptopë dhe një aparat telefonik. Këto mjete u konfiskuan më pas.

45. Më 30 korrik 2009 prokurori i rrethit i atribuoi E.A. veprën penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve, sipas nenit 279 të Kodit Penal, me argumentin se ishin gjetur dy thika në banesën e E.A. (*shih paragrafin 64 më poshtë*).

46. Më 30 korrik 2009 E.A. u arrestua për kryerjen e veprës penale të prodhimit dhe të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta. Më pas, prokurori caktoi ndaj tij masën e detyrimit për t'u paraqitur përpara policisë gjyqësore (masë shtrënguese), e cila u miratua nga gjykata e rrethit më 1 gusht 2009.

47. Më 6 gusht 2009 Komisariati i Policisë Tiranë deklaroi se sendet e sekuestruara në banesën e E.A., më 29 korrik 2009, nuk përputheshin me përshtetimin e asnjë objekti që ishte vjedhur në territorin e mbuluar nga ai Komisariat.

48. Më 11 janar 2010 Ministria e Kulturës informoi prokurorin e rrethit se të dy thikat ishin për përdorim thjesht dekorativ.

49. Më 2 shkurt 2010 prokurori i rrethit, në një vendim të arsyetuar, pushoi hetimin në lidhje me veprën penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, në përputhje me të drejtën e procedurës penale (*shih paragrafin 61 më poshtë*). Gjithashtu urdhëroi heqjen e masës shtrënguese ndaj E.A. Vendimi përshkruante të gjitha provat e marra dhe deklaratimet e dhëna nga ankuesja dhe të tjerët. Vendimi arsyetonte se meqenëse thikat ishin gjetur në banesën e E.A. dhe jo në një vend publik dhe se shkresa e Ministrisë së Kulturës e datës 11 janar 2010 deklaronte se ato ishin vetëm për përdorim dekorativ, ishte e qartë se nuk ishte kryer asnjë vepër penale.

D. Procedimet gjyqësore në lidhje me kërkesën e ankueses për dëmshpërblim

50. Më 2 maj 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme (Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave), depozitoi një kërkesë pranë Ministrisë së Drejtësisë ku kërkonte kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid (*shih paragrafin 89 më poshtë*).

51. Më 3 shtator 2012 ankuesja, duke u mbështetur në Konventën Evropiane për Kompensimin e Viktimave, nenet 625, 640 dhe 641 të Kodit Civil, si dhe në vendimin nr. 12/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 73 më poshtë*), depozitoi një kërkesë për dëmshpërblim pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë kundër Ministrisë së Drejtësisë, duke kërkuar kompensim nga Shteti si rezultat i sulmit me acid. Ajo, gjithashtu, kërkoi që të përjashtohet nga pagesa e tarifave gjyqësore, për shkak të mungesës së mjeteve financiare, dhe t'i përcaktohet masa e kompensimit nga ekspertë.

52. Ankuesja parashitroi se e kishte tërhequr çështjen pasi e kishte të pamundur të paguante tarifën gjyqësore.

53. Më 30 maj 2013 Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi pushimin e gjykimit kur ankuesja dhe avokati i saj nuk u paraqitën në seancë.

II. E DREJTA DHE PRAKTIKA E BRENDSHME PËRKATËSE

A. Kushtetuta

54. Dispozitat përkatëse të Kushtetutës parashikojnë si më poshtë:

Neni 21

“Jeta e personit mbrohet me ligj.”

Neni 25

“Askush nuk mund t’u nënshtrohet torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”

Neni 44

“Kushdo ka të drejtë të rehabilitohet dhe/ose të zhdëmtohet në përputhje me ligjin, në rast se është dëmtuar, për shkak të një akti, veprimi ose mosveprimi të paligjshëm të organeve shtetërore.”

B. Kodi i Procedurës Penale (KPP)

55. Dispozitat e KPP-së që ishin në fuqi në kohën materiale kishin përmbajtjen e mëposhtme.

56. Neni 24§4 parashikonte se urdhrat dhe direktivat e një prokurori të një niveli më të lartë ishin të detyrueshme për një prokuror të një niveli më të ulët. Neni 24§5 parashikonte se një prokuror i një niveli më të lartë, qoftë *proprio motu* ose pas një apelimi, kishte të drejtë të ndryshonte ose shfuqizonte vendimet e një prokurori të një niveli më të ulët.

57. Sipas nenit 61, personi që ka pësuar dëm pasuror si rezultat i kryerjes së një vepre penale mund të ngrejë padi civile gjatë procesit penal për të kërkuar dëmshpërblim. Sipas nenit 62§1, kërkesa duhej të depozitohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Në përputhjen me nenin 62§3, gjykata mund të vendosë veçimin e padisë civile nga procesi penal nëse gjykimi i saj vështirëson ose zvarrit procesin penal.

58. Neni 105 i KPP-së parashikonte të drejtën e çdo pale të interesuar të kërkojë, me shpenzimet e veta, kopje dhe ekstrakte të akteve të veçanta.

59. Neni 326 i KPP-së, që parashikonte të drejtën e prokurorit për pezullimin e hetimeve, citon si më poshtë:

“1. Kur nuk njihet autori i veprës penale (...), prokurori mund të vendosë pezullimin e hetimeve.

2. Pezullimi i hetimeve vendoset pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme.

3. Hetimi i pezulluar mund të rifillojë me vendim të prokurorit.”

60. Në kohën materiale, KPP-ja nuk përmbante asnjë dispozitë specifike mbi të drejtën e ankimit kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes/hetimit.

61. Neni 328 i KPP parashikon të drejtën e prokurorit për pushimin e çështjes/hetimit. Kundër vendimit të prokurorit që ka pushuar çështjen/hetimin mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me nenin 329 të KPP-së.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me pezullimin e hetimit

62. Në një rast, një ankues, H.S., paraqiti një ankesë pranë prokurorisë lidhur me vdekjen e motrës së tij. Prokurori e kishte pezulluar hetimin në bazë të nenit 326§1 të KPP-së me arsyetimin se nuk mund të gjendej asnjë autor i krimit. Ankuesi nisi procedurën ligjore kundër pezullimit të çështjes. Ai u ankua se nuk ishte informuar mbi përmbajtjen e dosjes hetimore dhe as mbi pezullimin e çështjes, se prokurori nuk kishte pyetur të gjithë dëshmitarët, dhe se ai nuk kishte mjet juridik efektiv për t’u

ankuar, në lidhje me vendimin e pezullimit të çështjes. Gjykatat e brendshme e rrëzuan padinë e tij. Gjykata e Apelit Tiranë u shpreh, se, meqenëse hetimi vazhdonte dhe meqenëse prokuroria kishte diskrecionin për të vendosur kryerjen e veprimeve hetimore, ankuesi nuk kishte kompetence ligjore. Ajo ripohoi se nuk ekzistonte e drejta e apelit kundër vendimit për pezullimin e procedimit penal, sipas legjislacionit procedural penal. Ankuesi paraqiti një ankesë kushtetuese pranë Gjykatës Kushtetuese, e cila u refuzua me vendimin nr. 4, datë 18 janar 2013. Gjykata Kushtetuese u shpreh, ndër të tjera, se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas ligjit të brendshëm kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e çështjes. Sidoqoftë, fakti që ankuesi kishte pasur akses në gjykatat e brendshme, tregonte se ai kishte të drejtën efektive për t'u ankuar në gjykatë.

C. Kodi Penal (KP)

63. KP-ja përbëhet nga kapituj të ndarë në seksione. Kapitulli II i pjesës specifike të KP-së u është kushtuar veprave penale kundër njeriut. Seksioni I i kapitullit mbulon krimet me dashje kundër jetës dhe, në kohën përkatëse, përmbante më shumë se dhjetë dispozita të ndryshme për vrasje. Seksioni III i kapitullit II trajton krimet me dashje kundër shëndetit. Veprat e sulmit, të cilat më tej karakterizohen sipas nivelit të ashpërsisë së dëmit të shkaktuar, bien në seksionin III, të tilla si tortura (neni 86), shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje (neni 88), plagosja e lehtë me dashje (neni 89), dhe dëmtime të tjera me dashje (neni 90). Nga këto vepra, vetëm vepra penale e shkaktimit të plagosjes së lehtë me dashje (neni 89) bie në kategorinë e çështjeve të ndjekjes private, të cilat duhet të dërgohen nga personi i interesuar drejtpërdrejt në gjykatën kompetente, dhe mund të tërhiqen në çdo fazë të procedurës (neni 284 i KKP-së).

64. Neni 88 i KP-së parashikon se shkaktimi i plagosjes së rëndë me dashje që ka sjellë si pasojë, gjymtimin, shpërfytyrimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet. neni 279 i KP-së parashikon, ndër të tjera, se prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve të ftohta dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet.

65. Pas ndryshimeve të bëra në KP në vitin 2012, neni 130/a përcaktoi dhunën në familje si vepër penale. Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, plagosja e kryer me dashje ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psikosocial dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

66. Në vitin 2013 u bënë ndryshime në nenin 50 të KP-së, i cili konsideron si rrethanë rënduese kryerjen e një vepre penale gjatë ose pas dhënies së urdhrit gjyqësor të mbrojtjes të dhënë në lidhje me dhunën në familje.

D. Kodi Civil

67. Neni 608 i Kodit Civil parashikon se kushdo që në mënyrë të paligjshme dhe gabimisht i shkakton dëm një personi tjetër ose pasurisë së tij, është i detyruar të paguajë kompensim për dëmin. Personi që ka shkaktuar dëmin nuk përgjigjet kur provon se nuk ka faj.

68. Neni 609 parashikon se dëmi duhet të jetë rrjedhim i veprimit a mosveprimit të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm.

69. Neni 625 parashikon se personi që pëson një dëm, të ndryshëm nga ai pasuror, ka të drejtë të kërkojë kompensim kur ka pësuar dëmtim të shëndetit apo integritetit fizik ose mendor të tij ose nëse ose është cenuar në nderin, personalitetin ose reputacionin e tij, ose nëse është cenuar e drejta e tij e respektimit të jetës private.

70. Sipas nenit 640, dëmi pasuror përfshin humbjen e pësuar dhe fitimin e munguar. Shpenzimet e arsyeshme dhe ato të nevojshme mund të jenë gjithashtu subjekt kompensimi.

71. Sipas nenit 641, personi që i ka shkaktuar tjetrit një dëm në shëndetin e tij, duhet ta kompensojë dëmin, duke pasur parasysh humbjen ose pakësimin e aftësisë për punë të të dëmtuarit, shpenzimet që janë bërë për mjekimin e tij, si dhe shpenzime të tjera që kanë lidhje me dëmin e shkaktuar.

Praktika ligjore e brendshme përkatëse në lidhje me shyerjen e dëmeve

72. Qeveria paraqiti disa praktika ligjore në lidhje me shlyerjen e dëmeve si pjesë e vëzhgimeve të saj.

73. Në vendimin unifikues nr. 12, datë 14 shtator 2007, pas kërkesës civile për dëmshpërblim dhe shpenzimet kundër Institucionit Shqiptar të Sigurimeve (subjekt shtetëror) për vdekjen e tre personave në një aksident automobilistik, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vendosën, për sa është e rëndësishme, si më poshtë:

“... gjykatat e brendshme kanë pranuar që tre persona humbën jetën në një aksident automobilistik ... në thelb, sipas nenit 608 të Kodit Civil ... legjislacioni parashikon mbrojtjen e të drejtës së jetës, shëndetit, personalitetit, dinjitetit, jetës private e kështu me radhë nga aktet e paligjshme të një pale të tretë. Nëse ka shkelje të ndonjë prej këtyre të drejtave, si rrjedhojë e aktit të paligjshëm, pala e dëmtuar ka të drejtën e kompensimit ekstrakontraktual ... Në zbatim të nenit 609 të Kodit Civil, duhet të provohet lidhja materiale shkakësore ndërmjet sjelljes së paligjshme (veprimi a mosveprimi) si dhe fajit dhe dëmit. Në përcaktimin e dëmit real të shkaktuar nga fakti i paligjshëm dhe kompensimit përkatës, duhet të provohet, gjithashtu, lidhja juridike shkakësore midis tyre. Lidhja materiale shkakësore shërben për të identifikuar personin përgjegjës dhe lidhjet shkakësore midis tri elementeve të aktit të paligjshëm: sjellja e paligjshme, faji dhe pasoja që rrjedh prej tyre, që do të thotë dëmi i një personi tjetër ose pronës së tij ... Lidhja juridike shkakësore shërben për të demonstruar lidhjet shkakësore midis aktit të paligjshëm, të marrë në tërësinë e tij, dhe shkeljes specifike të të drejtave dhe interesave të ligjshëm [të një personi tjetër]

...
Humbja e përfitimit [parashikuar në nenin 640 të Kodit Civil] ka të bëjë me pamundësinë për të marrë kompensim pasuror në të ardhmen, që është një aset që nuk i përkiste personit të dëmtuar në kohën kur është shkaktuar dëmi.

...
Kompensimi jopasuror për dëmtimin e shëndetit të personit, sipas nenit 625 të Kodit Civil, mund të kërkohej pavarësisht kërkesës për kompensim pasuror si rezultat i humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë parashikuar në nenin 641 të Kodit Civil. Personi i dëmtuar që kërkon kompensim në zbatim të nenit 641 të Kodit Civil, ka barrën e provës së shumës së të ardhurave, që nuk mund t'i fitojë më për shkak të humbjes ose pakësimit të aftësisë për punë, pas përmbushjes së detyrimit për të demonstruar dëmtimin e shëndetit të tij, natyrën e përhershme ose të përkohshme të tij, si dhe shkallën e dëmit.”

74. Në një rast tjetër, një ankues kishte kërkuar kompensim nga subjekti shtetëror sipas nenit 640 të Kodit Civil, për dëmin e shkaktuar në shëndetin e tij nga një plagosje me armë zjarri shkaktuar nga oficerët e policisë së Shtetit. Me vendimin nr. 275, datë 24 shtator 2009, Gjykata e Lartë ia kaloi çështjen për rishqyrtim gjykatës përkatëse të apelit. Ajo arsyetonte se, për shkak të plagosjes së ankuesit nga oficerët e policisë së Shtetit, ishte provuar dëmi i shkaktuar në shëndetin e tij.

75. Në një vendim të datës 25 nëntor 2011, Gjykata e Rrethit Tiranë pranoi nga ankuesit një kërkesë civile për kompensim solidar kundër autoriteteve shtetërore dhe dy kompanive private të depozituar, *inter alia*, sipas nenit 625 dhe 640 të Kodit Civil, për shkak të vdekjes së familjarit të tyre nga një shpërthim masiv në një fabrikë të çmontimit të armëve. Gjykata arsyetoi se përgjegjësia penale ishte e pavarur nga detyrimi civil për të paguar kompensim, që lidhej vetëm me kompensimin për dëmin e shkaktuar nga aktiviteti i rrezikshëm i çmontimit.

E. Ligji për Dhunën në Familje (ligji nr. 9669 për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare, datë 18 janar 2006, i ndryshuar me ligjet nr. 9914, datë 12 maj 2008, nr. 10329, datë 30 shtator 2010 dhe nr. 47/2018 datë 23 korrik 2018)

76. Ligji për Dhunën në Familje, i cili hyri në fuqi më 1 qershor 2007, përcaktoi mekanizmin për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje përmes një urdhri mbrojtjeje (UM), i cili mund të lëshohet nga gjykata civile me kërkesën e viktimës. Gjykata mund të japë përkohësisht urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje (UMM), nëse autori ka kërcënuar se do të kryejë akte të dhunës në familje ose nëse autori paraqet një kërcënim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm për sigurinë, shëndetin apo mirëqenien e

viktimitës ose pjesëtarëve të tjerë të familjes (neni 19). UMM-ja është i vlefshëm deri në lëshimin e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykate. Ligji parashikon një mbrojtje më të mirë, jo vetëm për personat që janë aktualisht në marrëdhënie familjare, por edhe për personat që nuk janë më në një marrëdhënie të tillë, siç janë ish-bashkëshortët dhe ish-partnerët (neni 3).

77. Miratimi i një urdhri mbrojtjeje apo i një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje nuk e pengon viktimitën që të nisë procedimin penal sipas Kodit Penal (neni 24). Policia, prokurori ose një organizatë joqeveritare mund të kërkojnë, gjithashtu, miratimin e një urdhri mbrojtjeje apo të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje (neni 13). Kur kërkesa është bërë nga policia ose prokurori, tërheqja nga ana e viktimitës nuk sjell pushimin e çështjes (neni 16).

78. Neni 10 rendit masat mbrojtëse me vendim gjykate. Pra, një urdhër mbrojtjeje mund të përfshijë, midis masave të tjera, largimin e autorit nga banesa e viktimitës (pavarësisht të drejtave pronësore të autorit), ndalimin e autorit që t'i afrohet përtej një distance të caktuar viktimitës apo pjesëtarëve të familjes së viktimitës, ndalimin e autorit që të hyjë apo qëndrojë në banesën e përkohshme apo të përhershme të viktimitës ose në ndonjë pjesë të saj, vendosjen e grave dhe fëmijëve të tyre në strehime të përkohshme apo një urdhër për pjesëmarrjen e autorit në programe rehabilitimi.

79. Ligji për dhunën në familje, gjithashtu, parashikon krijimin e një strehe për viktimat e dhunës në familje (neni 6 i ndryshuar) dhe një sistem të koordinuar për referimin pranë autoriteteve të çështjeve të dhunës në familje.

80. Shkelja e urdhrit të mbrojtjes përbën vepër penale sipas nenit 321 të KP-së dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në dy vjet.

III. E DREJTA DHE MATERIALET NDËRKOMBËTARE PËRKATËSE, NË LIDHJE ME DHUNËN ME BAZË GJINORE

A. Konventa e Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave

81. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (Konventa CEDAW) u miratua në vitin 1979 nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara dhe Shqipëria e ratifikoi më 9 nëntor 1993. Zbatimi i Konventës CEDAW monitorohet nga Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW), i cili bën rekomandime për shtetet palë mbi çështjet specifike që lidhen me eliminimin e diskriminimit ndaj grave.

82. Në sesionin e njëmbëdhjetë në vitin 1992, Komiteti CEDAW miratoi rekomandimin e përgjithshëm nr. 19 për dhunën ndaj grave (A/47/38). Rekomandimi përcaktonte dhunën me bazë gjinore, si: “dhunë që drejtohet ndaj një gruaje, sepse është grua ose që prek gratë në mënyrë disproporcionale”. Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 shprehte, se: “Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjëse për aktet private, nëse dështojnë që të veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe dënuar aktet e dhunës dhe për të siguruar kompensim”. Lidhur me komentet për nenet specifike të Konventës CEDAW, Rekomandimi i përgjithshëm nr. 19 thekson më tej, se: “qëndrimet tradicionale nga të cilat gratë vlerësohen si të varura nga burrat ose me role stereotipike, mbajnë gjallë praktika të përhapura që përfshijnë dhunën ose shtrëngimin, të tilla si: dhuna në familje dhe abuzimi, martesat e detyruara, vdekjet me motiv prikën, sulmet me acid dhe gjymtimi gjeneral femëror. Paragjykimet dhe praktikat e tilla mund të justifikojnë dhunën me bazë gjinore si një formë e mbrojtjes ose kontrollit të grave. Efekti i një dhune të tillë në integritetin fizik dhe mendor të grave është privimi i tyre nga barazia në gëzimin, ushtrimin dhe njohjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ndërsa ky koment adreson kryesisht dhunën aktuale ose kërcënuese, pasojat themelore të këtyre formave të dhunës me bazë gjinore ndihmojnë në mbajtjen e grave në role vartëse dhe kontribuojnë në nivelin e tyre të ulët të pjesëmarrjes politike, si dhe në nivelin e tyre më të ulët të arsimit, aftësive dhe mundësive për punë”.

83. Më 26 korrik 2017 Komiteti CEDAW azhurnoi rekomandimin e përgjithshëm të tij nr. 19, duke miratuar rekomandimin e përgjithshëm nr. 35, mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (CEDAW/C/GC/35). Sipas rekomandimit të përgjithshëm nr. 35, dhuna me bazë gjinore ndaj grave: “është një nga mjetet themelore shoqërore, politike dhe ekonomike, me të cilat vazhdon pozita

vartëse e grave në lidhje me burrat dhe rolet e tyre stereotipike”. Gjatë gjithë punës së tij, Komiteti [CEDAW] e ka bërë të qartë se kjo dhunë është një pengesë kritike për arritjen e barazisë thelbësore midis grave dhe burrave, si dhe për gëzimin nga gratë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë. Kjo dhunë merr forma të shumëllojshme, duke përfshirë veprime ose mosveprime, që synojnë ose mund të shkaktojnë, apo rezultojnë në vdekje ose dëmtime, apo vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike të grave, kërcënime për veprime të tilla, ngacmime, shtrëngime dhe privime arbitrare të lirisë. (...) Dhuna me bazë gjinore ndaj grave mund të arrijë në torturë ose trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtëruar në rrethana të caktuara, përfshirë rastet e përdhunimit, dhunës në familje ose praktikave të dëmshme. (...) Kur aktet e dhunës me bazë gjinore ndaj grave arrijnë në tortura ose trajtim mizor, çnjerëzor ose degradues, kërkohet një qasje me bazë ndjeshmërie gjinore për të kuptuar nivelin e dhimbjes dhe vuajtjeve të përjetuara nga gratë, dhe për të kuptuar se kërkesat e qëllimit për klasifikimin e akteve të tilla si torturë plotësohen, kur veprimet ose mosveprimet janë specifike gjinore ose kryhen ndaj një personi në bazë të gjinisë.

84. Komiteti CEDAW rekomandoi që masat të merren në fushën e parandalimit, mbrojtjes, ndjekjes penale dhe dënimit, kompensimit, mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit, si dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për të përshpejtuar eliminimin e dhunës me bazë gjinore ndaj grave.

85. Sa i përket mbrojtjes, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera, “të miratojnë dhe të zbatojnë masa efektive për të mbrojtur dhe ndihmuar gratë ankuese dhe dëshmitare të dhunës me bazë gjinore përpara, gjatë dhe pas procedurave ligjore dhe për të siguruar që të gjitha procedurat ligjore, masat mbrojtëse dhe mbështetëse, si dhe shërbimet në lidhje me viktimat/të mbijetuarat respektojnë dhe forcojnë autonominë e tyre”.

86. Sa i përket ndjekjes penale dhe dënimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: “a) të sigurojnë qasje efektive për viktimat në gjykata dhe që autoritetet t’u përgjigjen në mënyrën e duhur të gjitha rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përmes zbatimit të së drejtës penale dhe, sipas rastit, ndjekjes penale kryesisht për të dërguar autorët e dyshuar në gjyq në një mënyrë të drejtë, të paanshme, në kohë dhe të shpejtë dhe përmes dhënies së dënimeve të përshtatshme; tarifat gjyqësore nuk duhet të vihen për viktimat/të mbijetuarat; dhe b) të adresojnë faktorët që rrisin rrezikun e ekspozimit për gratë ndaj formave të rënda të dhunës me bazë gjinore, siç janë aksesueshmëria e gatshme dhe disponueshmëria e armëve të zjarrit, përfshirë këtu eksportin e tyre, një shkallë të lartë krimi dhe pandëshkueshmërie të përhapur, që mund të rriten në situata të konfliktit të armatosur apo pasigurisë së shtuar. Duhet bërë përpjekje për të kontrolluar disponueshmërinë dhe aksesueshmërinë e acidit dhe të substancave të tjera të përdorura për të sulmuar gratë”.

87. Sa i përket kompensimit, Komiteti CEDAW rekomandoi që Shtetet palë, ndër të tjera: “a) të sigurojnë kompensime efektive për viktimat/të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Kompensimet duhet të përfshijnë masa të ndryshme, të tilla si kompensimi monetar, sigurimi i shërbimeve ligjore, sociale dhe shëndetësore, përfshirë shërbimet seksuale, riprodhuese dhe të shëndetit mendor për një rikuperim të plotë, si dhe shpërblimin dhe garancitë e mospërsëritjes. Kompensime të tilla duhet të jenë të përshtatshme, të atribuara menjëherë, holistike dhe proporcionale me seriozitetin e dëmit të pësuar; dhe b) të krijojnë fonde specifike për kompensime ose të përfshijnë alokime në buxhetet e fondeve ekzistuese, përfshirë përdorimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale për kompensimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave”.

B. Materialet e Këshillit të Evropës

1. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)

88. Konventa e Stambollit u miratua nga Komiteti i Ministrave më 7 prill 2011. Konventa u hap për nënshkrim më 11 maj 2011 dhe hyri në fuqi më 1 gusht 2014. Shqipëria e ratifikoi Konventën e Stambollit më 4 shkurt 2013. Konventa e Stambollit zbatohet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe siguron një kuadër gjithëpërfshirës për parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe mbrojtjen e viktimave.

2. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave të Krimeve të Dhunshme

89. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave u ratifikua nga Shqipëria më 26 nëntor 2004 dhe hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 mars 2005. Ministria e Drejtësisë është Autoriteti Qendror për qëllime të Konventës Evropiane për Kompensimin e Viktimave. Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave i kërkon Palëve Kontraktuese, në mungesë të kompensimit nga burime të tjera, të kontribuojnë në kompensimin e viktimave të veprave të qëllimshme dhe të dhunshme, të cilat janë kryer në territorin e tyre dhe kanë rezultuar në lëndime trupore ose vdekje. Kompensimi duhet të akordohet edhe nëse shkelësi i ligjit/fajtori nuk është ndjekur penalisht ose dënuar.

90. Raporti Shpjegues i Konventës shpreh se Konventa Evropiane për Kompensimin e Viktimave nuk është drejtpërdrejt e zbatueshme dhe se u takon “Shteteve kontraktuese të përcaktojnë bazën ligjore, kuadrin administrativ dhe metodat e funksionimit të skemave të kompensimit”.

3. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave (2002)5 për mbrojtjen e grave kundër dhunës

91. Në Rekomandimin (2002)5 të datës 30 prill 2002 për mbrojtjen e grave kundër dhunës, Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës rekomandoi, ndër të tjera, që Shtetet anëtare duhet “të kenë detyrimin për të treguar kujdesin e duhur për parandalimin, hetimin dhe dënimin e akteve të dhunës, qoftë këto të kryera nga shteti apo persona privatë, dhe të sigurojnë mbrojtje për viktimat”.

92. Komiteti i Ministrave rekomandoi, në veçanti, që Shtetet anëtare duhet të penalizojnë dhunën serioze ndaj grave, të tillë si dhuna seksuale dhe përdhunimi, abuzimi me cenueshmërinë e viktimave shtatzëna, të pambrojtura, të sëmura, me aftësi të kufizuara ose të varura, si dhe penalizimin e abuzimit me pozitën nga autori. Rekomandimi, gjithashtu, shprehte se shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të gjitha viktimat e dhunës janë në gjendje të nisnin procedurat, të marrin masa për të siguruar që procedimet penale mund të fillojnë nga prokurori publik, të inkurajojnë prokurorët që ta konsiderojnë dhunën ndaj grave si një faktor rëndues ose vendimtar në marrjen e vendimit, nëse do të ndiqet penalisht apo jo për interes publik, të sigurojnë kur është e nevojshme marrjen e masave për të mbrojtur viktimat në mënyrë efektive nga kërcënimet dhe aktet e mundshme të hakmarrjes, si dhe të marrin masa specifike për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve gjatë procedimeve.

C. Raportet për dhunën me acid

1. Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave

93. Në një raport për dhunën ndaj grave të datës 20 gusht 2004 (A/59/281), Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara paraqiti informacion në lidhje me legjislativin, politikën dhe masat e tjera të ndërmarra nga vende të ndryshme dhe institucione të tjera ndërkombëtare, për të luftuar të gjitha format e dhunës ndaj grave, si dhe krimet ndaj grave të kryera në emër të nderit. Me rëndësi të veçantë për rastin në fjalë ishte fakti që Bangladeshi kishte miratuar, ndër të tjera, Aktin e Kontrollit të Acidit në vitin 2002 dhe që një gjykatë speciale ishte krijuar në të gjithë vendin për të trajtuar rastet që kishin të bënin me dhunën ndaj grave.

2. Raporti i Raportueses Speciale të Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave, shkaqet dhe pasojat për misionin e saj në Bangladesh

94. Në vitin 2013 Raportuesja Speciale e Kombeve të Bashkuara për dhunën ndaj grave kreu një vizitë zyrtare në Bangladesh për të shqyrtuar situatën e dhunës ndaj grave në këtë vend. Në raportin e saj për Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (A/HRC/26/38/Add.2), Raportuesja Speciale u shpreh, *inter alia*, si më poshtë:

“11. Përhapja e sulmeve me acid mbetet një çështje problematike në vend, dhe këto sulme ndodhin në familje dhe në komunitet. Organizatat e shoqërisë civile raportuan 31 raste të dhunës me acid në Bangladesh për periudhën nga janari deri në gusht 2013. Nga këto raste, 22 sulme janë kryer kundër ndaj grave dhe 4 ndaj vajzave. Po kështu, në vitin 2012 gratë dhe vajzat ishin viktimat kryesore të sulmit me acid, ku nga një total prej 105 rastesh, 58 gra dhe 20 vajza ishin shënjestra e një sulmi të tillë. Acidi, përgjithësisht, hidhet në fytyrë ose organet seksuale të viktimave femra kur refuzojnë kërkesat për marrëdhënie seksuale apo propozimet për martesë. Qëllimi përfundimtar është dëmtimi i paraqitjes së viktimës për t'i shkatërruar perspektivën e saj për martesë.

55. Për sa u përket sulmeve me acid, Akti i Kontrollit të Krimeve me Acid i vitit 2002 përcakton se dënimi për vrasjen e një personi me acid ose plagosja e personit me pasojë humbjen e shikimit, dëgjimit, apo dëmtimin ose shpërfytyrimin e fytyrës, gjoksit ose organeve seksuale, mund të rezultojë në dënimin kapital ose burgim të përjetshëm dhe një gjobë që nuk tejkalon një *lakh taka* (afërsisht 1190 USD). Gjithashtu, dëmtimi ose shpërfytyrimi i ndonjë pjese të trupit do të rezultojë në një dënim me 14 vjet burg ose të paktën 7 vjet 'burgim i rreptë'."

3. *Opinionit i Komisionit për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian për dhunën ndaj grave*

95. Më 14 janar 2014 Komisioni për Liritë Civile, Drejtësinë dhe Çështjet e Brendshme i Parlamentit Evropian i dhanë një opinion Komisionit të Parlamentit Evropian për luftimin e Dhunës ndaj Grave në një mocion për një rezolutë të Parlamentit Evropian, në lidhje me dhunën ndaj grave. Opinioni deklaronte se dhuna ndaj grave mund të përfshijë, pa kufizim, "dhunën në marrëdhënie të afërta, përdhunimin, përfshirë dhunimin martesor, dhunën me motiv prikën, gjymtimin gjenital femëror, hedhjen e acidit, martesën e detyruar, abuzimin seksual, prostitucionin e detyruar dhe pornografinë, trafikimin e grave dhe vetëvrasjen e detyruar".

4. *Materiale të tjera përkatëse*

a) Luftimi i dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia

96. Në vitin 2011, Qendra Avon Global për Gratë dhe Drejtësi në *Cornell Law School*, Komiteti për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut të Dhomës së Avokatisë së *New York*-ut, Klinika për të Drejtat Ndërkombëtare të Njeriut e *Cornell Law School* dhe *Virtue Foundation*, duke pasur parasysh incidencën e lartë të regjistruar të dhunës me acid në Bangladesh, Indi dhe Kamboxhia, nxorën një raport për luftimin e dhunës me acid në këto vende. Raporti theksonte se shpesh sulmet me acid kryhen ndaj grave, sepse ato shkelin normat gjinore që i kalojnë ato në pozita vartëse. Për më tepër, detyra për të parandaluar shkeljen e të drejtave të njeriut përfshin detyrimin për të miratuar legjislacionin e hartuar për frenimin e dhunës me acid. Përveç legjislacionit, qeveritë duhet: 1. të kryejnë hetime të duhura për sulmet me acid; 2. të mbrojnë viktimat nga kërcënimet që mund të minojnë këto hetime; dhe 3. të ndjekin penalisht dhe të ndëshkojnë autorët e sulmeve me acid.

b) Drejtësi? Çfarë drejtësie? Trajtimi i dhunës me acid dhe sigurimi i drejtësisë për të mbijetuarit

97. Në vitin 2015, Fondacioni *Thompson Reuters, Acid Trust international* dhe *J. Sagar Associates* nxorën një studim krahasues mbi legjislacionin ekzistues dhe zbatimin e tij për luftimin e dhunës me acid në katër vende: Kamboxhia, Kolumbi, Indi dhe Mbretërinë e Bashkuar. Për sa i takon ekzistencës së kuadrit ligjor, raporti deklaronte se në Kolumbi ekzistonte një ligj i veçantë për acidin, sipas të cilit dhuna me acid ishte një veprë penale e veçantë dhe specifike. Në Indi dhe në Mbretërinë e Bashkuar nuk ekzistonte ndonjë legjislacion i veçantë për trajtimin e dhunës me acid. Në vend të kësaj, ekzistonin dispozita në ligje të tjera penale të cilat e trajtonin plagosjen përmes përdorimit të substancës gërryese si veprë penale dhe parashikonin dënime të rënda për plagosje të tilla.

98. Për sa i përket ndjekjes penale të veprave penale, raporti thekson, se: "qëllimi për të kryer veprën penale *mens rea* dhe akti real që përben veprën *actus reus* janë të dy elemente thelbësore. Sidoqoftë, ka raste të caktuara kur përgjegjësia është absolute, d.m.th., thjesht ndodhja e incidentit është e mjaftueshme për të formuar një veprë penale pavarësisht ekzistencës apo mungesës së qëllimit. Raporti thekson se neni 20 i ligjit të veprave penale kundër personit (OAPA) i Mbretërisë së Bashkuar, që nuk zbatohet për Skocinë, e bën atë një veprë që i shkakton dëme të rënda trupore një personi pa ndonjë kërkesë për të synuar kryerjen e një dëmi të tillë. Sipas kësaj dispozite mund të ngrihen akuza për rastet kur kalimtarët janë lënduar rastësisht si rezultat i një sulmi. Nga ana tjetër, sipas nenit 29 të OAPA-së, një veprë thuhet se është kryer pavarësisht nëse në të vërtetë është shkaktuar dëmtimi nga kryerja e veprës, me kusht që shkelësi i ligjit të ketë qëllimin e nevojshëm".

99. Sa u përket ndëshkimeve, raporti shtonte, se: "ligjet zakonisht parashikojnë një spektër dënimesh dhe gjykatësit vendosin për dënimin brenda këtij spektri, bazuar në një sërë faktorësh duke përdorur diskrecionin e tyre. Në Indi, konsideratat për rritjen ose uljen e dënimeve janë shumë të paqëndrueshme dhe nuk ka udhëzime të qarta për dënimin. Për krahasim, manuali i dënimit i

Shërbimit të Prokurorisë së Kurorës në Angli dhe Uells vë në dukje përdorimin e acidit si një faktor që tregon për fajësinë më të lartë të shkelësit të ligjit, duke ndikuar kështu në ashpërsinë e dënimit. Në Kolumbi, dënimi varet edhe nga pjesa e trupit që preket dhe deformimi i fytyrës konsiderohet më i rëndë”.

IV. MATERIALI PËRKATËS KOMBËTAR DHE NDËRKOMBËTAR, NË LIDHJE ME SITUATËN E GRAVE NË SHQIPËRI

A. Raportet kombëtare

1. Vrojtimet kombëtare me bazë popullatën nga Instituti i Statistikave

100. Në mars 2009, Instituti i Statistikave (INSTAT) nxori një raport kërkimor mbi “Dhunën në familje në Shqipëri: Një vërtetim kombëtar me bazë popullatën” mbi bazën e të dhënave të mbledhura në vitin 2007. Qëllimi i sondazhit kombëtar të vitit 2007 ishte të gjeneronte të dhëna dhe gjetje të besueshme mbi natyrën dhe përhapjen e dhunës në familje në vend, që do të përdreshin për të bërë të ditur hartimin e masave dhe politikave efektive parandaluese, mbrojtëse dhe ato ligjore. INSTAT-i kreu sondazhe të reja në vitin 2013 dhe 2018, ku gratë u pyetën për përvojat e tyre “ndonjëherë” dhe “aktualisht” për secilën nga format e ndryshme të dhunës në familje.

101. Të dyja vërtimet kombëtare, me bazë popullatën, konfirmuan se dhuna në familje ndaj grave ishte një problem i përhapur në familjet dhe komunitetet në të gjithë Shqipërinë. Gjetjet zbuluan se raporti i grave që kishin përjetuar “ndonjëherë” një formë të dhunës në familje ishte rritur nga 56.09% në vitin 2007, në 59.4% në vitin 2013. Vërtimet dokumentonin qartë se gratë vazhdonin të përjetonin lloje të shumta të dhunës në familje njëkohësisht në familjet e tyre dhe në marrëdhëniet intime, përfshirë format e shumta të dhunës psikologjike, fizike dhe seksuale.

102. Në vitet 2007 dhe 2013 gratë e dhunuara zbuluan se shpesh kanë përjetuar pak a shumë të njëjtat lëndime që lidhen me dhunën në familje me shkaletë të ndryshme ashpërsie. Në vitin 2007, 48.3% e grave që përjetonin dhunë në familje raportuan se ishin plagosur me prerje, ënjtje ose dhimbje, ndërsa në vitin 2013 vetëm 18.8% e grave të abuzuara fizikisht “ndonjëherë” raportuan se kanë përjetuar lëndime që lidhen me dhunën në familje.

103. Vërtimi kombëtar, me bazë popullatën, i vitit 2018, i cili u botua në mars 2019, ishte përpjekja e tretë në Shqipëri për të mbledhur të dhëna mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave, duke përfshirë jo vetëm dhunën në familje, por edhe dhunën në një lidhje, dhunën nga një jopartner, abuzimin seksual të fëmijëve, ngacmimin seksual dhe përndjekjen. Të dhënat në sondazhin e vitit 2019 siguruan prova se dhuna ndaj grave dhe vajzave ishte e përhapur dhe se prekte shumicën e grave. Sondazhi i vitit 2018 zbuloi se 52.9% e grave të moshës 18–74 përjetonin “ndonjëherë” një ose më shumë nga pesë llojet e ndryshme të dhunës (dhunë nga një partner intim, dhunë në një lidhje, dhunë nga një jopartner, ngacmim seksual dhe/ose përndjekje) gjatë jetës së tyre dhe 36.6% e grave përjetonin dhunë “aktualisht”. 75.4% e grave raportuan se dhuna në familje ndaj grave është një problem i madh në Shqipëri. 70.8% e grave raportuan se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, 69.9% raportuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është një problem i madh në Shqipëri, dhe 68.4% raportuan se përndjekja e grave dhe e vajzave është një problem i madh në Shqipëri. Duke pasur parasysh këto gjetje, nuk është për t'u habitur që shumica e grave pohonin se është shumë e rëndësishme që në Shqipëri të ketë ligje që mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna në martesën/familjet e tyre (83.0%) dhe nga ngacmimi seksual dhe përdhunimi (81.9%).

104. Sondazhi i vitit 2018 matë, gjithashtu, normat sociale në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave, perceptimin e grave për seriozitetin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe rëndësinë e ekzistencës së legjislacionit, në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave. Sa u takon normave sociale për dhunën në familje, sondazhi i vitit 2018 konstatoi se 52.2% e grave të moshës 18–74 mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se dhuna midis burrit dhe gruas është një çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë, dhe 46.5% mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se gruaja duhet të tolerojë njëfarë dhune për të mbajtur familjen të bashkuar. Gjithashtu, 27.5% e grave mendonin se të gjithë apo shumica e njerëzve në komunitet besojnë se kur një grua rrihet nga burri i saj, faji apo gabimi është pjesërisht i saj dhe se një grua duhet

të ketë turp apo të ndihet keq të flasë me dikë jashtë familjes së saj për abuzimin apo dhunën në familjen e saj. Këto norma sociale mund të kontribuojnë në përhapjen e dhunës në familje nga një partner intim ndaj grave dhe të mbajnë gratë e dhunuara të mbërthyer në marrëdhënie abuzive dhe të dhunshme.

2. Raporti i Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

105. Në nëntor 2010, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare botoi raportin për zbatimin e ligjit për dhunën në familje. Raporti monitoroi urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Tiranë, për periudhën 1 janar 2009 deri më 1 janar 2010. Sipas raportit, ka pasur një rritje të madhe të numrit të grave që raportojnë incidente në polici, gjë që ka ndodhur, për shkak të ndërgjegjësimit në rritje të grave mbi rëndësinë e raportimit të dhunës në familje, si dhe të përgatitjes më të mirë dhe kualifikimeve nga ana e organeve përkatëse që i pranuan dhe i ndihmuan viktimat e dhunës në familje.

3. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

106. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (Komisioneri kundër Diskriminimit) u krijua përmes aktit antidiskriminim (ligji nr. 10221, 4 shkurt 2010), dhe është organi kombëtar përgjegjës për sigurimin e barazisë dhe mbrojtjes efektive nga diskriminimi.

107. Në raportin vjetor të vitit 2011, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se “gratë vuajnë nga dhuna në familje”. Në raportin vjetor të vitit 2012, Komisioneri kundër Diskriminimit deklaroi, se: “janë raportuar disa raste të dhunës ndaj grave, të cilat ndonjëherë kanë rezultuar në humbjen e jetës së grave të dhunuara. Sipas statistikave të siguruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë janë identifikuar 2,526 raste të dhunës në familje, gjë që shënoi një rritje me 345 raste krahasuar me një vit më parë. Një rritje e tillë është reflektuar edhe në rritjen e numrit të kërkesave për urdhër mbrojtjeje, të cilat kishin arritur në 1,562 në vitin 2012, pra 217 kërkesa më shumë se një vit më parë”.

B. Raportet ndërkombëtare

1. Materialet e Këshillit të Evropës

a) Raporti i Grupit të Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)

108. Monitorimi i Konventës së Stambollit sigurohet nga dy organe të dallueshme: Grupi i Ekspertëve kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), një organ i pavarur ekspertësh dhe Komiteti i Palëve, një organ politik i përbërë nga përfaqësues të Shteteve palë të Konventës.

109. Raporti i vlerësimit i GREVIO-s për Shqipërinë i vitit 2017 (GREVIO/Inf(2017)13) deklaroi, se: “statistikat zyrtare për rastet e dhunës në familje portretizojnë një tablo të përzier, ku shifrat e larta janë ana tjetër e përpjekjeve që synojnë inkurajimin e raportimit. Nga viti 2010 deri më 2014-ën, rastet e raportuara të dhunës në familje u rritën ndjeshëm me afërsisht tri herë më shumë viktimat gra se sa burra. Dhuna në familje tejkalon shumë të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të madh të viktimitave dhe në vitin 2015, vetëm vdekjet që lidhen me dhunën në familje përfaqësonin 37% të të gjitha vdekjeve të nxitura nga krimi”.

110. Në raportin e vlerësimit të GREVIO-s thuhet më tej, se: “të dhënat për dhunën në familje lejojnë krijimin e një tabloje të besueshme të realitetit të dhunës në familje në Shqipëri. Sidoqoftë, të dhënat për format e tjera të dhunës ndaj grave, të tilla si dhuna seksuale, mezi lënë të kuptohet për ekzistencën e një fenomeni i cili nga shumë dëshmi mbetet një territor kryesisht i panjohur, i rrethuar nga tabu dhe nga mosraportimi i theksuar”. Raporti i nxiste autoritetet “të bënin dhunën në familje ndaj grave dhe natyrën gjinore të formave të tjera të dhunës ndaj grave më të dukshme në statistikat e krimit të paraqitura në publik, duke identifikuar qartë numrin e viktimitave gra, sipas llojit të veprës. Kjo do të përfshinte zbulimin qartazi para publikut të informacionit mbi numrin e vrasjeve të grave nga burrat (vrasjet e grave me lidhje gjinore); dhe hartimin e kategorive të të dhënave mbi llojin e marrëdhënies midis autorit dhe viktimës për të gjitha format e dhunës ndaj grave gjë që do të çonte në dokumentimin më specifik të natyrës së marrëdhënies së tyre”.

111. Për sa i përket së drejtës së viktimës për të kërkuar kompensim, raporti i vlerësimit të GREVIO-s citon si më poshtë:

“115. Në zbatim të neneve 61 deri 68 të [Kodit të Procedurës Penale] (KPP), viktimat e dhunës kanë të drejtë të aplikojnë, në kuadër të procedimeve penale për kompensim në lidhje me dëmet e pësuarat për veprën penale. Pretendimet për kompensim të zgjidhura në procedimet penale kufizohen në dëmshpërblimin ekonomik dhe shlyerja e tyre varet nga rezultati i gjykimit penal. Në mënyrë alternative, viktimat mund të paraqesin një kërkesë për kompensim që shtrihet në të gjitha format e dëmit, përfshirë dëmin jopasuror, sipas nenit 625 të Kodit Civil. Nuk disponohet informacion që dëshmon se ndonjë viktimë e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, ka filluar ndonjëherë apo ka përfituar nga procedime të tilla. Raportet e paraqitura pranë GREVIO-s theksojnë tarifat e larta gjyqësore si një nga faktorët që pengojnë aksesin e viktimave në kompensim, pavarësisht parimit të përcaktuar me ligj se viktimat e dhunës në familje përjashtohen nga tarifat gjyqësore. Për më tepër, nuk ka asnjë skemë kompensimi shtetëror në dispozicion për viktimat e dhunës ndaj grave në Shqipëri. Asnjë rezervim nuk u përfshi nga Shqipëria, duke e përjashtuar atë nga zbatimi i nenit 30, paragrafi 2, i Konventës mbi kompensimin shtetëror ndihmës për lëndime të rënda trupore ose dëmtimin e shëndetit”.

112. Në dritën e masave të identifikuar në raportin e vlerësimit të GREVIO-s, Komiteti i Palëve rekomandoi që Qeveria të ndërmarrë hapa për të siguruar, ndër të tjera, aksesin e viktimave në mjetet juridike civile kundër autoriteteve shtetërore, në veçanti, përmes informimit të viktimave për të drejtat e tyre dhe ndërgjegjësimin të zyrtarëve publikë në lidhje me to, si dhe të krijojë dhe financojë në mënyrën e duhur një sistem efektiv të ndihmës ligjore për viktimat e të gjitha formave të dhunës ndaj grave që mbulohet nga Konventa dhe të nxisë ushtrimin e së drejtës së viktimave për akses në ndihmë juridike.

b) Raportet e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut

113. Pas vizitës zyrtare në Shqipëri nga 27 tetori deri më 2 nëntor 2007, si pjesë e misioneve të rregullta në vend, Komisioneri botoi raportin e tij më 18 qershor 2008 (CommDH(2008)8), i cili thekson, për aq sa është e rëndësishme, se dhuna ndaj grave, veçanërisht dhuna në familje, ishte një shkelje e përhapur e të drejtave të njeriut që karakterizohej nga mosraportimi, moshetimi, mosndjekja penale dhe mosdënimi në Shqipëri. Ekzistonte një numër i pacaktuar i shkelësve të ligjit që gëzonin pandëshkueshmëri, pasi krimi ende shihej si një çështje private dhe për këtë arsye raportohej rrallë.

114. Pas një vizite zyrtare në Shqipëri, në intervalin 23 deri më 27 shtator 2013, Komisioneri nxori raportin e tij më 13 janar 2014 (CommDH(2014)1), i cili vinte në dukje se në maj 2013 ishin miratuar ndryshimet e bëra në ligjin për ndihmën juridike, të cilat e ngarkonin Komisionin Shtetëror me dhënien e përjashtimeve nga pagesa e tarifave gjyqësore në kushte të caktuara. Ato përcaktuan se përfituesit e ndihmës juridike, kur paraqesin ankesa civile ose administrative në gjykatë, mund të përjashtohen nga tarifat gjyqësore (dhe shpenzimet gjyqësore), nëse provojnë se janë, ndër të tjera, viktimat e dhunës në familje. Kërkesa do të shqyrtohej nga Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike, brenda dhjetë ditësh nga paraqitja e kërkesës. Nëse Komisioni nuk vendoste mbi kërkesën, brenda dhjetë ditësh ose e refuzonte atë, gjykata mund të vendoste mbi kërkesën për përjashtimin e tarifës në seancën paraprake.

2. Vëzhgimet përfundimtare të Komitetit CEDAW, në lidhje me Shqipërinë

115. Shqipëria ka paraqitur tri raporte periodike pranë Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave mbi zbatimin e vëzhgimeve të CEDAW-s.

116. Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2003 mbi raportet e kombinuara periodike fillestare dhe të dyta të paraqitura nga Shqipëria (A/58//38), Komiteti CEDAW shprehu: “shqetësimin për incidencën e lartë të dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje dhe mungesën e mbledhjes sistematike të të dhënave për dhunën ndaj grave, e posaçërisht për dhunën në familje”. Komiteti i kërkoi Shqipërisë: “të miratojë legjislacionin për dhunën në familje dhe të sigurojë se dhuna ndaj grave ndiqet penalisht dhe ndëshkohet me seriozitetin dhe shpejtësinë e kërkuar dhe të krijojë një strukturë për mbledhjen sistematike të të dhënave mbi dhunën ndaj grave, përfshirë këtu dhunën në familje”.

117. Në vëzhgimet përfundimtare të 16 shtatorit 2010 mbi raportin e tretë periodik të paraqitur nga Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/3), Komiteti CEDAW mbetej: “i shqetësuar për përhapjen e lartë e të vazhdueshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri”. Komiteti ishte veçanërisht i shqetësuar, se: “dhuna në familje nuk është sanksionuar dhe kriminalizuar siç duhet” dhe për: “shkallën e lartë të vetëvrasjeve të femrat viktime të dhunës në familje, për mangësitë në [ligjin për dhunën në familje] dhe zbatimin e tij si dhe mungesën e të dhënave statistikore”. Komiteti CEDAW rekomandonte, ndër të tjera, që “[autoritetet] të forcojnë përpjekjet [e tyre] për të siguruar se femrat viktime të dhunës kanë mbrojtje të menjëhershme” dhe “zyrtarët publikë, veçanërisht zyrtarët e zbatimit të ligjit, anëtarët e pushtetit gjyqësor, ofruesit e kujdesit shëndetësor dhe punonjësit socialë, janë plotësisht të sensibilizuar për të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe të krijohen struktura për të ndihmuar femrat viktime të dhunës për të rindërtuar jetën e tyre”.

118. Në vëzhgimet përfundimtare të 25 korrikut 2016 mbi raportin e katërt periodik të paraqitur nga Shqipëria (CEDAW/C/ALB/CO/4), Komiteti CEDAW ishte i shqetësuar: “për mungesën e zbatimit të legjislacionit mbi barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin, si dhe mungesën e monitorimit të zbatimit të ligjeve dhe politikave të tilla, [dhe që] gratë, veçanërisht ato që u përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara, mbeten të pavetëdijshme për të drejtën e tyre për ndihmë juridike dhe vazhdojnë të përballen me pengesa të konsiderueshme ligjore dhe praktike për të fituar akses në drejtësi, gjë që reflektohet në numrin e ulët të ankesave të depozituara. Komiteti është, gjithashtu, i shqetësuar për problemin e përhapur të mosekzekutimit të urdhrave të gjykatës, përfshirë këtu urdhrat për pagesën e detyrimit financiar”. Komiteti [CEDAW] është i shqetësuar se dhuna me bazë gjinore ndaj grave mbetej mbizotëruese, gjë që reflektohej nga: “a) shkalla e ulët e raportimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, për shkak të aksesit të kufizuar të grave në shërbimet e ndihmës juridike, veçanërisht në zonat rurale dhe të thella, si dhe mungesa e shërbimeve të linjës telefonike për gratë që janë viktime të një dhune të tillë; b) zbatimi i pamjaftueshëm i mekanizmit kombëtar të referimit që synon parandalimin dhe sigurimin e mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore, në veçanti në nivel lokal, për shkak të mungesës së koordinimit ndërmjet subjekteve përgjegjëse dhe mungesës së aftësive dhe kapaciteteve të nevojshme në radhët e stafit përgjegjës; c) numri i pamjaftueshëm i strehëzave për gratë që janë viktime të dhunës me bazë gjinore dhe kriteret kufizuese për pranimin në strehëza, si dhe mungesa e shërbimeve rehabilituese mjekësore dhe psikologjike për gratë; dhe d) dështimi i vazhdueshëm për të zbatuar urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes”.

3. Progresraportet e Komisionit Evropian

119. Komisioni Evropian nxjerr progresraporte vjetore për vendet që dëshirojnë të aderojnë në Bashkimin Evropian. Progresraportet analizojnë, ndër të tjera, kapacitetet e këtyre vendeve për të zbatuar standardet evropiane.

120. Në progresraportin për Shqipërinë 2008 (SEC(2008) 2692) thuhej, ndër të tjera, se: “strategjia për parandalimin e dhunës në familje nuk është zbatuar, për shkak të mungesës së mekanizmave zbatues. Përqindja e grave që kanë vuajtur nga dhuna në familje është e konsiderueshme dhe në rritje. Ajo që nevojitet tani është alokimi i burimeve të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për të siguruar zbatimin e plotë të legjislacionit”.

121. Në progresraportin e vitit 2009 (SEC(2009)1337) thuhej, ndër të tjera, se: “dhuna në familje mbetet e përhapur”. Shumë incidente nuk janë raportuar. Të dhëna të sakta mungojnë. Kërkohen masa të mëtejshme për të forcuar nivelin e mbrojtjes për gratë viktime të dhunës në familje, përfshirë fushatat ndërgjegjësuese të medieve dhe trajnimet e specializuara për gjyqtarët”.

122. Në raportin analitik të vitit 2010 (SEC(2010) 1335) thuhej: “Dhuna në familje është një fenomen i vazhdueshëm, që prek shumë familje në Shqipëri dhe është një çështje serioze shqetësuese (...) [Rastet] vazhdojnë të mos raportohen në shkallë të madhe, si dhe të hetohen dhe të ndiqen penalisht në mënyrë të pamjaftueshme, veçanërisht në zonat rurale. Një numër relativisht i vogël ankesash çojnë në ndjekje penale, pasi zakonisht është detyrë e viktimës për të nisur këtë procedurë. Detyra e prokurorit për të filluar një ndjekje penale ndodh vetëm në rastet që rezultojnë me vdekje,

plagosje të rëndë ose kërcënim për jetën. Mbrojtja e grave dhe e viktimave të tjera ndaj të gjitha formave të dhunës duhet të forcohet në mënyrë të konsiderueshme”.

4. Raporti i *Amnesty International*

123. Në mars 2006, *Amnesty International*, bazuar në kërkimet e bëra përfshirë monitorimin e dokumentacionit për procedimet penale dhe raportet në medien shqiptare, për një periudhë trevjeçare, si dhe në kërkimet e OJQ-ve, profesionistëve dhe akademikëve, nxori një raport për Shqipërinë me titull: “Dhuna ndaj grave në familje: Nuk është turp për të”. Raporti, ndër të tjera, citonte si më poshtë:

“Të paktën një e treta e grave në Shqipëri vlerësohet se kanë përjetuar dhunë fizike në familjet e tyre. Ato janë goditur, rrahur, dhunuar dhe në disa raste edhe vrarë. Shumë të tjera kanë duruar dhunë psikologjike, kontroll fizik dhe ekonomik (...). Bashkëshortët, ish-bashkëshortët dhe partnerët janë përgjegjës për shumicën e abuzimeve të tilla, por edhe pjesëtarët e tjerë të familjes mund të bëhen pjesë apo mbështesin akte dhune, të cilat shpesh mund të pranohen nga komuniteti i gjerë në të cilin jeton gruaja.

Qëndrimet sociale dhe vlerat kulturore – jo vetëm nga publiku i gjerë, agjentët [shtetërorë], të tillë si policia, por edhe vetë gratë – i nxisin gratë të pranojnë dhunën. Një gjë e tillë nuk është e paevitueshme dhe as nuk nënkupton, se [Shteti] mund të heqë dorë nga përgjegjësia. Shqipëria është përgjegjëse për dështimin e saj në adresimin e qëndrimeve të tilla që mbështesin abuzimin e vazhdueshëm të grave. Për shkak të ndjenjës së fortë të turp-it dhe të mungesës së besimit te policia, gratë rrallë i drejtohen policisë, por edhe kur në raste të veçanta e bëjnë një gjë të tillë, policia nuk arrin të njohë dhunën në familje si çështje penale dhe shpesh dështon të hetojë pretendimet/akuzat e dhunës në familje. Për më tepër, prokurorët, në përgjithësi, ngrenë akuza vetëm në rastet e vdekjes ose të plagosjes serioze ose të kanosjeve me armë zjarri ose me armë të tjera. Gratë, zakonisht, nuk inkurajohen të paraqesin ankesa ndaj sulmuesve të tyre, dhe nuk marrin mbrojtje efektive nga sulmet ose kërcënimet, përfshirë ato me armë zjarri, nga burrat dhe të afërmit e tyre. Personat përgjegjës – me përjashtim të rasteve të vdekjes apo të plagosjes shumë të rëndë – shpesh nuk vihen para drejtësisë. Ekziston mungesë qëndrueshmërie në qasjen nga ana e gjyqësorit dhe të paktën në një rast të njohur nga *Amnesty International*, gjykatat kanë treguar butësi ndaj autorëve që vrasin gra për shkak të ‘nderit’”.

124. Raporti kërkonte: “përgjigje të koordinuar kundër dhunës ndaj grave në familje, qasje të integruar të multiagjencive që përfshin jo vetëm autoritetet ligjzbatuese dhe ligjore, por edhe profesionistët e kujdesit shëndetësor dhe të arsimit (...) Kur masat parandaluese dështojnë, zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe prokurorët duhet të regjistrujnë dhe të monitorojnë incidentet e raportuara, të veprojnë për mbrojtjen e viktimave të dhunës, si dhe t’u përgjigjen me shpejtësi dhe efektivitet pretendimeve apo kanosjeve të dhunës ndaj grave. Prokurorët dhe gjyqësori duhet të sigurojnë vënien para drejtësisë të autorëve të krimit. Gratë duhet të kenë aksesin e duhur në mekanizmat ligjorë, që ofrojnë mbrojtjen e tyre, si dhe në kujdesin shëndetësor dhe strehëzat që sigurojnë mbrojtje fizike, ndihmë mjekësore dhe mbështetje psikologjike”.

E DREJTA

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

125. Ankuesja u ankua, sipas neneve 2, 3 dhe 8 të Konventës, se autoritetet kishin dështuar të mbronin jetën e saj. Ajo më tej u ankua për dështimin e autoriteteve në kryerjen e një hetimi të plotë dhe efektiv që do të çonte në identifikimin, ndjekjen penale dhe dënimin e autorit të sulmit.

126. Duke qenë master i karakterizimit që u duhet dhënë fakteve të çështjes me ligj, Gjykata nuk është e detyruar nga karakterizimi i dhënë nga ankuesja ose një qeveri (*shih Radomilja dhe të Tjerë kundër Kroacisë [GC], nr. 37685/10 dhe 22768112, §126, 20 mars 2018*). Gjykata konsideron që ankimet e ankuesit të ngritura në bazë të neneve 3 dhe 8 duhet të shqyrtohen nga këndvështrimi i nenit 2, nën aspektet e saj thelbësore dhe procedurale, për aq sa ato lidhen me të drejtën e ankuesve për jetën. Dispozita, për sa është e rëndësishme, parashikon si më poshtë:

Neni 2

“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj.”

A. Pranueshmëria

1. Parashtrimet e palëve

127. Qeveria parashtrroi se ankuesja nuk ka paraqitur asnjë ankim para gjykatave të brendshme. Ajo, gjithashtu, nuk ka arritur të paraqesë kërkesë civile për dëmshpërblim, sipas neneve 608, 625 dhe 640 të Kodit Civil, si dhe vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2007, ose një kërkesë civile gjatë procedimeve penale, sipas nenit 61 të KPP-së. Kërkesa e ankueses për dëmshpërblim para gjykatës së rrethit është tërhequr, për shkak të mosparaqitjes në seancë. Për më tepër, ankuesja, ka abuzuar me të drejtën e saj të ankimit, pasi nuk ka apeluar kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e hetimit dhe nuk ka përdorur mjete të tjera juridike. Asnjë vendim i formës së prerë nuk është dhënë ende nga autoritetet.

128. Qeveria, gjithashtu, parashtrroi se kërkesa është paraqitur përtej afatit gjashtëmuor, duke sjellë pezullimin e procedimeve më 26 shkurt 2010 dhe vendimin e formës së prerë më 30 maj 2013. Ankuesja është njoftuar sipas rregullave për vazhdimin e hetimit.

129. Ankuesja parashtrroi se nuk kishte asnjë mjet juridik efektiv që mund të përdorte. Ajo nuk i është drejtuar Gjykatës me një kërkesë të drejtpërdrejtë për kompensim; në vend të kësaj, ankimi i saj është përqendruar në paaftësinë e Qeverisë për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e saj. Kërkesa civile për dëmshpërblim nuk do të çonte në identifikimin dhe dënimin e personave përgjegjës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Në çdo rast, përdorimi i mjetit juridik, sipas Kodit Civil, mund të ishte efektiv vetëm pasi të ishte identifikuar autori i veprës. Mjeti juridik, sipas nenit 61 të KPP-së mund të përdorej vetëm në rast se Çështja do të ishte dërguar për gjykim para një gjykate të brendshme. Për më tepër, Qeveria ka dështuar të paraqesë praktikën e brendshme në lidhje me përdorimin e dhunës ndaj grave. Asnjë kompensim nuk i është akorduar ndonjëherë grave që kanë pësuar dhunë. Praktika ligjore e brendshme e paraqitur nga Qeveria nuk ishte e zbatueshme në rastin e ankueses, pasi të gjitha çështjet ishin të ndryshme nga Çështja e saj.

130. Ankuesja, më tej, parashtrroi se autoritetet nuk kishin qenë të kujdesshme dhe nuk i ishin përgjigjur kërkesës së saj për informacion për herë të parë më 17 prill 2012. Për më tepër, prokurori nuk e ka njoftuar ankuesen për veprimet e tij hetimore dhe gjithashtu nuk i ka vënë në dispozicion një kopje të këtyre veprimeve, duke bërë kështu të pamundur për ankuesen kundërshtimin e tyre. Në çdo rast, ligji nuk parashikonte asnjë apelim kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e vendimit. Autoritetet nuk ishin në gjendje të identifikonin apo dënonin autorin e veprës për shkeljen e nenit 2 të Konventës. Pra, situata e ankueses vijonte të ishte e njëjtë.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Zbatueshmëria e nenit 2

131. Në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 2 të çështjes në fjalë, Gjykata konstaton se ankuesja pretendon se lëndimet e saj ishin shkaktuar nga një individ dhe jo nga një agjent i Shtetit. Sidoqoftë, Gjykata kujton se mungesa e një përgjegjësie të drejtpërdrejtë të Shtetit për vdekjen e një personi nuk përjashton zbatimin e nenit 2 të Konventës (*shih, për shembull, Yotova kundër Bullgarisë, nr. 43606/04, §68, 23 tetor 2012*).

132. Gjykata më tej kujton se mbrojtja e kësaj dispozite të Konventës mund të bëhet jo vetëm në rastin e vdekjes së viktimës nga aktet e dhunshme. Neni 2 bëhet, gjithashtu, efektiv në situatat ku personi në fjalë ishte viktimë e një aktiviteti a sjelljeje, qoftë publike apo private, e cila nga natyra e vet e vuri jetën e tij/saj në një rrezik real dhe të pashmangshëm dhe ai/ajo ka pësuar dëmtime që duken me rrezik për jetën, edhe pse ai/ajo përfundimisht ka mbijetuar (*shih, ndër të tjera, Nicolae Virgiliu Tănase kundër Rumanisë [GC], nr. 41720/13, §140, 25 qershor 2019; Makaratzis kundër Greqisë [GC], nr. 50385/99, §55, ECHR 2004-XI, dhe Soare dhe të Tjerë kundër Rumanisë, nr. 24329/02, §108, 22 shkurt 2011*). Në çështjen në fjalë Gjykata vëren se ankuesja iu nënshtrua një sulmi të dhunshëm, i cili rezultoi në dëmtime të rënda, dhimbje dhe shpërfytyrimin e njëzet e pesë për qind të trupit të saj. Ajo u dërgua në spital në gjendje kritike (*shih paragrafin 6 më lart*) dhe sipas raportit të datës 18 dhjetor 2009,

jeta e saj do të ishte në rrezik nëse nuk do të ishte dhënë ndihmë e specializuar mjekësore (*shih paragrafin 33 më lart*). Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se metoda e përdorur nga sulmuesi ishte e një natyre dhe intensiteti që mund të rrezikonte jetën e ankueses. Rrjedhimisht, neni 2 i Konventës është i zbatueshëm në këtë rast.

b) Mosrespektimi i rregullit gjashtëmujor sipas nenit 35§1 të Konventës

133. Gjykata përsërit se qëllimi i rregullit gjashtë-mujor sipas nenit 35§1 të Konventës është të promovojë sigurinë ligjore dhe të sigurojë që çështjet e ngritura sipas Konventës të trajtohen brenda një kohe të arsyeshme (*shih, për shembull, Lopes de Sousa Fernandes kundër Portugalisë [GC], nr. 56080/13, §129, 19 dhjetor 2017, dhe Opuz kundër Turqisë, nr. 33401/02, §110, ECHR 2009*). Sipas praktikës së saj ligjore të mirëpërcaktuar, kur nuk ka mjet juridik të brendshëm në dispozicion, periudha gjashtëmujore fillon nga data e paraqitjes së ankimit për aktin.

134. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se ankuesja është sulmuar nga një person i panjohur më 29 korrik 2009. Një hetim është hapur nga prokurori, i cili më 2 shkurt 2010 e pezulloi hetimin. Ankuesja nuk u njoftua asnjëherë mbi rezultatin e hetimit. Më specifikisht, vetëm më 17 prill 2012, pas kërkesës së Qendrës për informacion, prokurori e informoi atë se hetimi ishte pezulluar. Megjithatë, prokurori e informoi Qendrën se dosja e çështjes i kishte kaluar policisë për veprime të mëtejshme me qëllim identifikimin e autorit të sulmit. Më 23 maj 2012 policia informoi Qendrën se hetimi vazhdonte. Vetëm më 8 janar 2014 prokurori informoi Qendrën se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit (*shih paragrafin 41 më lart*).

135. Gjykata vëren, se meqenëse autoritetet informuan Qendrën më 8 janar 2014 se hetimi ishte pezulluar, për shkak të mosidentifikimit të autorit të sulmit, ky rast mund të konsiderohet si data në të cilën ankuesja u vu në dijeni mbi paefektshmërinë e mjeteve juridike në të drejtën e brendshme. Gjykata, gjithashtu, vëren se para kësaj, ankuesja kishte kontaktuar autoritetet disa herë për t'u informuar mbi ecurinë e hetimit. Duke pasur parasysh që këto rrethana tregojnë se ankuesja veprroi me kujdesin e duhur në paraqitjen e ankimit të saj pasi u bë e qartë se nuk do të kishte ndreqje për ankesat e saj, Gjykata vlerëson se data përkatëse për qëllimet e afatit gjashtëmujor nuk duhet të konsiderohet të jetë më herët se 8 janari 2014 (*shih, për shembull, Mocanu dhe të Tjerë kundër Rumanisë [GC], nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, §§258-269, ECHR 2014 (ekstraktet)*).

136. Në kontekstin specifik të kësaj çështjeje, rezultoi se ankimet e ankueses janë paraqitur brenda afatit gjashtëmujor të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin paraprak të Qeverisë në këtë drejtim.

c) Mosshterimi i mjeteve juridike të brendshme

137. Gjykata vëren, se Qeveria ka ngritur dy kundërshtime bazuar në kërkesën për shterimin e mjeteve juridike të brendshme. Së pari, Qeveria pretendonte se ankuesja nuk ka paraqitur kërkesë për dëmshpërblim dhe, së dyti, argumentoi se ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, ku për pasojë nuk ishte dhënë asnjë vendim i formës së prerë.

138. Në lidhje me kundërshtimin e parë të Qeverisë, Gjykata vëren se ishte hapur një hetim nga prokurori. Ankuesja kishte pritur se do të njoftohej për rezultatin e hetimit dhe se do t'i tregohej që autori ishte identifikuar dhe dënuar sipas së drejtës penale. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, duke pasur parasysh përshkrimin e praktikës së brendshme të paraqitur nga Qeveria, do të ishte shumë e vështirë për ankuesen që të provonte çështjen e saj, nëse do t'i drejtohej procedimit civil sipas Kodit Civil, duke kërkuar dëmshpërblim për dëmtimet e pësuar pa identifikuar autorin. Sa i përket paraqitjes së një kërkesë civile gjatë procedimit penal, sipas nenit 61 të KPP-së, Gjykata vëren se një kërkesë e tillë mund të paraqitet vetëm nëse Çështja ishte dërguar për gjykim para gjykatave të brendshme. Në rrethana të tilla si në këtë rast, kur Çështja nuk është dërguar asnjëherë për gjykim, Gjykata nuk e sheh se si mund të ketë qenë efektiv ky mjet juridik (*shih, gjithashtu, paragrafin 111 më lart*).

139. Në çdo rast, Gjykata vlerëson se kërkohej dispozita efektive të së drejtës penale për të siguruar parandalimin efektiv kundër kërcënimeve ndaj së drejtës për jetën. Mjetet juridike civile ku bazohej Qeveria nuk mund të konsiderohen si të mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të një shteti kontraktues, sipas nenit 2 të Konventës në raste të tilla si ky në fjalë, sepse qëllimi i tyre është përfundim

i dëmshpërblimit dhe jo parandalimi, pengimi dhe dënimi i shkeljeve, sipas dispozitave të tilla (*shih Akeliene kundër Lituanisë, nr. 54917/13, §69, 16 tetor 2018*). Rrjedhimisht, Gjykata rrëzon kundërshtimin e parë të Qeverisë bazuar në mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme në këtë drejtim.

140. Në lidhje me kundërshtimin e dytë të Qeverisë, Gjykata vëren se ankueses i është ndaluar të kundërshtonte vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit, pasi KPP nuk parashikonte ndonjë të drejtë të tillë. Në vendimin e saj të datës 18 janar 2013 Gjykata Kushtetuese theksoi se nuk ekzistonte asnjë mjet juridik, sipas së drejtës së brendshme kundër vendimit të prokurorit për pezullimin e një hetimi (*shih paragrafin 62 më lart*). Ishte në diskrecionin e prokurorit për të rihapur ose jo një hetim, siç parashikohet në nenin 326 të KPP-së (*shih paragrafin 59 më lart, si dhe Piboni kundër Shqipërisë, nr. 74389/13, §95, 13 shkurt 2018*). Në këto rrethana, Gjykata rrëzon kundërshtimin e dytë të Qeverisë.

d) Përfundim

141. Gjykata vëren se këto ankime nuk janë haptazi të pabazuara në kuptim të nenit 35§3 (a) të Kushtetutës. Gjykata, më tej, vëren se ato nuk janë të papranueshme për ndonjë arsye tjetër. Rrjedhimisht, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Themeli

1. Parashtrimet e palëve

a) Parashtrimet e ankueses

142. Sipas nenit 2 të Konventës, ankuesja parashtrroi se sulmi me acid kundër saj ka qenë i rëndë dhe ka kërcënuar të drejtën e saj të jetës. Ajo parashtrroi se kuadri legjislativ në vend nuk ofronte mbrojtje të mjaftueshme për gratë kundër dhunës, pasi autoritetet kishin dështuar të përmbushnin detyrimet e tyre sipas Konventës së Stambollit. Neni 88 i Kodit Penal, për shembull, nuk ishte në përputhje me Nenin 49 të Konventës së Stambollit. Për më tepër, Konventa nuk zbatohet nga autoritetet në nivel vendor në rastet e dhunës ndaj grave. Në dritën e të dhënave statistikore mbi frekuencën e dhunës ndaj grave, autoritetet duhet të kishin dijeni dhe të merrnin masat parandaluese të nevojshme për të mbrojtur ankuesen. Ajo, gjithashtu, parashtrroi se hetimi nuk kishte qenë efektiv, i plotë dhe i shpejtë. Autoritetet kishin dështuar të merrnin masat e nevojshme, në faktin që ato nuk ishin në gjendje të ekzaminonin llojin e substancës së gjetur në enë ose të ekzaminonin enën që mbante autori, apo të identifikonin gjurmët e gishtave në enë, ose të ekzaminonin rrobat e ankueses. Për më tepër, nuk ishte marrë asnjë masë për të përcaktuar se si ishte blerë substanca gërryese ose si ishte përftuar nga autori. Ankuesja nuk ishte njoftuar për zgjatjen e hetimit apo për vendimin e prokurorit për pushimin e hetimit ndaj E.A. Autoritetet nuk kishin arritur të ngrinin dyshime, në lidhje me ndonjë person tjetër dhe asnjë veprim i mëtejshëm nuk ishte ndërmarrë prej tyre që nga pezullimi i hetimit. Ankuesja nuk ishte përfshirë në hetim dhe asnjëherë nuk i ishte ofruar dokumentacion që detajonte veprimet hetimore të ndërmarra.

b) Parashtrimet e Qeverisë

143. Qeveria parashtrroi se ankuesja nuk i është nënshtruar dhunës në familje apo dhunës, sipas nenit 2 të Konventës. Kuadri legjislativ në fuqi në atë kohë parashikonte mbrojtjen e duhur për viktimat e dhunës në familje në formën e Kushtetutës, disa konventa për të drejtat e grave që ishin ratifikuar nga Shqipëria, dhe një ligj specifik mbi dhunën në familje që ishte në fuqi. Për më tepër, në vitin 2012, Kodi Penal ishte ndryshuar për të parashikuar një vepër specifike të dhunës në familje dhe abuzimit, dhe ishte hartuar një plan kombëtar veprimi.

144. Sa i përket situatës së përgjithshme, në lidhje me dhunën në familje në Shqipëri, Qeveria parashtrroi disa të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për periudhën nga janari deri në dhjetor 2014. Sipas këtyre të dhënave policia kishte identifikuar 4,121 vepra penale të dhunës në familje dhe vepra të tjera penale që kishin ndodhur në ambientin familjar, në lidhje me 2,422 nga të cilat policia kishte krijuar procedurat e veta ligjore për nxjerrjen e një urdhri mbrojtjeje apo një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje. Policia kishte nisur procedimet penale dhe i kishte dërguar dosjet prokurorit për 1,797 rastet e mbetura. Numri i përgjithshëm i viktimave kishte qenë 3,090 nga të cilat 1,789 kishin qenë bashkëshortja e autorit të krimit. 551 autorë ishin arrestuar gjatë kryerjes së veprës; 48 ishin ndaluar dhe 147 të tjerë ishin ende në kërkim nga policia. Gjatë vitit 2014, janë identifikuar 17

raste vrasjesh me pasojë vdekjen e 22 personave. Ishin 10 viktime femra të vrasjeve në familje, nga të cilat 6 kishin qenë bashkëshortja e autorit përkatës.

145. Qeveria, më tej, parashtrroi se, me qëllim mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, policia kishte ndërmarrë hapat në vijim: një plan veprimi i datës 14 prill 2014, “Për zbatimin e plan veprimit kombëtar, 2011–2015”; përgatitja e kërkesave civile për nxjerrjen e urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes; ndjekja e zbatimit të vendimeve të gjykatave të brendshme; fillimi i procedimeve penale ndaj kujtdo që shkelte urdhrat e mbrojtjes; bashkëpunimi me institucione të tjera dhe organizata të shoqërisë civile; fushata të ndryshme në qytete të ndryshme të vendit; trajnimi i oficerëve të policisë etj.

146. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Qeveria parashtrroi se hetimi ka qenë efektiv dhe i plotë, ku ankuesja ka qenë në gjendje të përdorë të gjitha mjetet juridike për realizimin e të drejtave të saj. Prokurori kishte nisur hetimin menjëherë dhe kishte ndërmarrë disa veprime hetimore. Prokurori, gjithashtu, kishte arrestuar ish-bashkëshortin e ankuseses. Ankuesja nuk e kishte kundërshtuar vendimin e prokurorit për pezullimin e hetimit. Hetimi është pezulluar për arsye që nuk vareshin nga sjellja e palëve. Autoritetet nuk i kanë mohuar ankueses të drejtën e saj për t’u informuar dhe për të bashkëpunuar gjatë hetimit. Ishte vetë ankuesja që nuk i kishte dhënë ndihmën e duhur autoriteteve.

2. Vlerësimi i Gjykatës

a) Aspekti material

147. Gjykata përsërit, se fjalja e parë e nenit 2§1, jo vetëm ndalon Shtetin të kryejë marrjen e qëllimshme dhe të paligjshme të jetës, por edhe i kërkon të marrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e personave në juridiksionin e tij (*shih L.C.B. kundër Mbretërisë së Bashkuar, 9 qershor 1998, §36, Raportet e Gjyqimeve dhe Vendimeve 1998-III*). Kjo përfshin detyrën kryesore për Shtetin që të sigurojë të drejtën e jetës, duke vënë në zbatim dispozita të ligjit penal efektiv për parandalimin e kryerjes së veprave ndaj një personi të mbështetur nga mekanizmat ligjzbatues, me qëllim parandalimin, pengimin dhe dënimin e shkeljeve të dispozitave të tilla (*Mastromatteo kundër Italisë [GC], nr. 37703/97, §67, ECHR 2002-VIII*). Kjo pjesë, gjithashtu, shtrihet në rrethana të përshtatshme për një detyrim pozitiv mbi autoritetet për të marrë masa operacionale dhe parandaluese për mbrojtjen e individit, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të një individi tjetër (*shih Osman kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 tetor 1998, §115, Raportet e gjyqimeve dhe vendimeve 1998-VIII; Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë [GC], nr. 23458/02, §244, ECHR 2011 (ekstrakte); dhe Fernandes de Oliveira kundër Portugalisë [GC], nr. 78103/14, §108, 31 janar 2019*).

148. Duke pasur parasysh vështirësitë e qenësishme në policimin e shoqërive moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operacionale që duhen bërë në drejtim të prioriteteve dhe burimeve, objekti i detyrimit pozitiv për të marrë masa operacionale dhe parandaluese duhet të interpretohet në një mënyrë që nuk vendos barrë të pamundur dhe disproporcionale mbi autoritetet. Pra, jo çdo rrezik i pretenduar për jetën, mund të bëjë të nevojshme për autoritetet një kërkesë të Konventës për të marrë masa operacionale për të parandaluar materializimin e këtij rreziku. Që të lindë një detyrim pozitiv, duhet të përcaktohet se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni në kohë, mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën e një individi të identifikuar, që rezulton nga aktet kriminale të një pale të tretë. Kur Gjykata konstaton se autoritetet kishin dijeni ose duhet të kishin dijeni për këtë rrezik, ajo duhet të vlerësojë nëse këto autoritete morën masat brenda objektit të kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej që të shmangnin këtë rrezik (*shih, mes shumë të tjerësh, Osman, cituar më lart, §116; Fernandes de Oliveira [GC], cituar më lart, §110; dhe Nicolae Virgilu Tanase [GC], cituar më lart, §136*).

149. Për sa më lart, Gjykata duhet të përcaktojë nëse ka ekzistuar një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në atë kohë dhe nëse autoritetet kishin dijeni, ose duhet të kishin dijeni mbi ekzistencën e një rreziku real dhe të menjëhershëm për jetën ose integritetin fizik të ankuseses.

150. Gjykata vëren në fillim se faktet e çështjes kanë të bëjnë me një sulm të rëndë me acid mbi ankuesen të kryer nga një individ i paidentifikuar. Gjykata vëren se në Shqipëri një vepër penale është subjekt i ndjekjes penale publike, përveç nëse bie në kategorinë e krimeve që janë subjekt i ndjekjes

private. Në kohën përkatëse, Kodi Penal parashikonte një numër veprash të kryera kundër jetës ose shëndetit të një personi. Këto vepra, përfshirë atë të parashikuar në nenin 88 të KP-së, sipas të cilit prokurori hapi hetimin penal për sulmin me acid, janë subjekt i hetimit nga prokurori me zgjedhjen e tij (*shih paragrafin 63 më lart*). Gjykata është e kënaqur që, në mungesë të ndonjë argumenti nga ankuesja se dispozitat e ligjit penal ishin joefektive, ekzistonte një kuadër legjislativ efektiv në Shqipëri në kohën përkatëse, në lidhje me krimet kundër jetës dhe shëndetit.

Gjykata, më tej, vëren, megjithëse jo në lidhje me çështjen në fjalë, se, pas ndryshimeve legjislative të bëra në vitet 2012 dhe 2013, Kodi Penal përmban dispozita specifike që ndalojnë dhunën në familje dhe rrahjen, si dhe kriminalizimin si rrethanë rënduese të kryerjes së një vepre tjetër gjatë ose pas një urdhri mbrojtjeje të gjykatës dhënë në lidhje me ndodhjen e dhunës në familje (*shih paragrafët 65 dhe 66 më lart*).

151. Gjykata, më tej, vëren se ankuesja dyshonte që ish-bashkëshorti i saj kishte qenë sulmuesi/agresori, pas sulmit me acid, duke pasur parasysh edhe dhunën në familje së cilës ajo pretendon se i ishte nënshtruar në të kaluarën. Ankuesja u ankua për dhunën e ish-bashkëshortit ndaj saj për herë të parë, kur dha deklaratën para prokurorit të rrethit pas sulmit me acid më 29 korrik 2009. Deklarata e ankueses është konfirmuar nga pjesëtarët e familjes së ankueses. Sidoqoftë, nuk duket që ankuesja, ndonjëherë para sulmit, të ketë sjellë në vëmendjen e autoriteteve ndonjë rrezik që i është paraqitur në jetën e saj nga ish-bashkëshorti i saj, gjë që do të kishte nxitur detyrimin pozitiv të autoriteteve për të marrë masa parandaluese ose hapa të tjerë të arsyeshëm në mbrojtje të jetës së ankueses (*krabasoni dhe kontrastoni Osman, cituar më lart, dhe Civek kundër Turqisë, nr. 55354/11, 23 shkurt 2016*). Në këndvështrimin e Gjykatës, në rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata nuk mund të shohë se si autoritetet shtetërore mund të mbahen përgjegjëse për mosparandalimin e sulmit ndaj ankueses.

152. Rezulton se nuk ka pasur shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin pozitiv të autoriteteve për të mbrojtur jetën dhe integritetin fizik të ankueses.

b) Aspekti procedural

153. Gjykata kujton se detyrimi pozitiv i Shtetit në mbrojtje të jetës së personave brenda juridiksionit të tij kërkon në mënyrë të nënkuptuar se duhet të ekzistojë një formë e hetimit zyrtar efektiv ku ka arsye për të besuar se një individ ka pësuar dëmtime kërcënuese për jetën në rrethana të dyshimta. Hetimi duhet të jetë në gjendje të përcaktojë shkakun e dëmtimit dhe, sipas rastit, identifikimin e personave përgjegjës, me qëllim ndëshkimin e tyre (*shih Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë [GC], nr. 24014/05, §172, 14 prill 2015*). Kurdoherë që ekzistojnë dyshime në lidhje me shfaqjen e dhunës në familje ose dhunës ndaj grave, kërkohet kujdes i veçantë nga autoritetet për t'u marrë me natyrën specifike të dhunës gjatë procedimeve të brendshme (*shih Volodina kundër Rusisë, nr. 41261/17, §92, 9 korrik 2019*).

154. Kërkesa për shpejtësi të arsyeshme është e nënkuptuar në kontekstin e një hetimi efektiv në kuptim të nenit 2 të Konventës (*shih, midis shumë të tjerëve, Talpis kundër Italisë, nr. 41237/14, §106, 2 mars 2017*). Duhet pranuar që mund të ketë pengesa ose vështirësi të cilat pengojnë progresin në një hetim në një situatë të veçantë. Sidoqoftë, një përgjigje e shpejtë nga autoritetet në hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse mund të konsiderohet përgjithësisht si thelbësore për të ruajtur besimin e publikut në respektimin e shtetit të së drejtës dhe në parandalimin e çdo shfaqjeje të tolerancës ndaj akteve të paligjshme (*Armani Da Silva kundër Mbretëria e Bashkuar [GC], nr. 5878/08, §237, 30 mars 2016*). Gjithashtu, hetimi duhet të jetë i aksesueshëm për familjen e viktimës në masën e nevojshme për të mbrojtur interesat e veta legjitime (*Giuliani dhe Gaggio [GC], cituar më lart, §3303*).

155. Gjykata do të shqyrtojë tashmë nëse hetimi i kryer nga autoritetet shtetërore ka plotësuar kërkesat e pjesës procedurale të nenit 2 të Konventës. Kjo do të bëhet duke marrë parasysh situatën e përgjithshme të grave në Shqipëri në të cilën ndodhi sulmi me acid dhe përgjegjësinë e autoriteteve për hetimin e incidentit.

156. Gjykata vëren se raportet ndërkombëtare në lidhje me Shqipërinë kanë theksuar në mënyrë të përsëritur një prevalencë të lartë të dhunës ndaj grave të paktën që prej vitit 2003 (shih paragrafët 108–124 më lart). Për më tepër, raportet kombëtare mbështesin pikëpamjen se midis viteve 2007–

2013 dhuna ndaj grave ishte një problem i përhapur (*shih paragrafët 100–107*). Midis viteve 2006 dhe 2012 raportet ndërkombëtare vinin në dukje mosraportimin, moshetimin, mosndjekjen penale dhe mosdënimin e dhunës ndaj grave. Ato sugjeronin se policia dhe autoritetet e ndjekjes penale manifestonin një qasje joefektive kundër dhunës ndaj grave me argumentin e “qëndrimit social dhe vlerave kulturore” dhe se mbizotëronte një klimë butësie ose pandëshkueshmërie ndaj autorëve të dhunës ndaj grave (*shih paragrafët 113, 117 dhe 120–122 më lart*). Në vëzhgimet përfundimtare të vitit 2010, Komiteti CEDAW rekomandoi, ndër të tjera, që: “zyrtarët publikë, në veçanti zyrtarët e zbatimit të ligjit dhe anëtarët e gjyqësorit të ndërgjegjësohen plotësisht për të gjitha format e dhunës ndaj grave”. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se, në kohën e sulmit, ekzistonte *prima facie* një klimë e përgjithshme në Shqipëri që ishte e favorshme për dhunën ndaj grave. Për më tepër, raporti i vlerësimit 2017 të GREVIO-s vuri në dukje se dhuna në familje tejkalonte: “të gjitha krimet e tjera si vepra penale me numrin më të lartë të viktimave” (*shih paragrafin 109 më lart*).

157. Kur një sulm ndodh në një klimë të përgjithshme, siç përshkruhet më lart, hetimi merr një rëndësi edhe më të madhe dhe autoritetet hetimore duhet të jenë më të kujdesshme në kryerjen e një hetimi të plotë, në mënyrë që të sigurojnë zbatimin efektiv të ligjeve të brendshme që mbrojnë të drejtën e jetës. Një kujdes i tillë për të hetuar, ndër të tjera, një sulm me acid – i cili, sipas Komitetit CEDAW dhe raporteve të tjera referuar në paragrafët 93–99 më lart, mund të jetë praktikë e “dhunës me bazë gjinore” ndaj grave – është përsëritur në rekomandimin e përgjithshëm nr. 19, sipas të cilit “Shtetet mund të jenë, gjithashtu, përgjegjës për aktet private nëse nuk veprojnë me kujdesin e duhur për të parandaluar shkeljet e të drejtave ose për të hetuar dhe ndëshkuar akte dhune dhe për sigurimin e kompensimit”, dhe është ripërcaktuar fort në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 35 (*shih paragrafët 82 dhe 86 si dhe paragrafin 89 më lart*).

158. Duke iu kthyer efektivitetit të hetimit të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se është hapur një hetim për sulmin me acid nga prokurori dhe janë kryer disa veprime hetimore në lidhje me E.A., për të cilin u caktua një urdhër shtrëngimi. Në banesën e tij i ushtrua kontroll dhe disa sende në pronësi të tij u seksuestruan. U ndërmorën hapa të tjerë hetimore që përfshinin masat në vijim: u krye një ekzaminim në vendngjarje, u pyetën disa persona, u morën dhe u ekzaminuan pamjet filmike nga videokamera të dy bankave aty pranë, u morën raportet mjekoligjore, dhe u urdhëruan raporte të tjera ekspertimi. Megjithatë, në asnjë moment autoritetet nuk ishin në gjendje të përcaktonin natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankueses. Nuk u mor asnjë raport ekspertimi teknik ose toksikologjik, pasi FNS dhe ISP ose nuk kishin pajisjet e nevojshme të specializuara ose nuk ishte në kompetencën e tyre hartimi i raporteve të tilla (*shih paragrafët 30–31 më lart*).

159. Në këtë drejtim, është e vështirë për Gjykatën të pranojë që një masë hetimore me rëndësi thelbësore për çështjen, përkatësisht një raport ekspertimi për të mundësuar identifikimin e substancës së përdorur për të sulmuar ankuesen, nuk është kryer me shpejtësinë dhe vendosmërinë e duhur. U takon autoriteteve vendore të zgjidhin çështjet e kompetencës ose të ngrenë institucione të specializuara për kryerjen e hapave të tillë proceduralë që janë vendimtarë për mbarëvajtjen e hetimit dhe përmbushjen e detyrimeve procedurale, sipas nenit 2 të Konventës.

160. Gjykata vlerëson se rrethanat e sulmit ndaj ankueses – i cili ka shenjat dalluese të një forme të dhunës me bazë gjinore – duhet të kishte nxitur autoritetet të reagonin me kujdes të veçantë në kryerjen e masave hetimore. Kurdo që ekziston dyshimi se një sulm mund të jetë i motivuar nga gjinia, është veçanërisht e rëndësishme që hetimi të kryhet me vull.

161. Gjykata përfundimisht vëren se vendimi i formës së prerë në çështjen – vendim i datës 2 shkurt 2010, për pezullimin e hetimit, i cili nuk ishte i përshtatshëm për apelim (*shih paragrafin 140 më lart*) – nuk ofron ndonjë përgjigje të saktë për natyrën e substancës së gjetur në enë dhe në rrobat e ankueses. Për më tepër, me gjithë pyetjet e përsëritura të ankueses në lidhje me ecurinë e hetimit, asaj nuk iu dha asnjë informacion ose dokument në përgjigje. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të kundërshtonte (mosveprimin e) hapave hetimore ose t’u kërkonte autoriteteve të merrnin masa të tjera (*shih Piboni, cituar më lart, §95*). Po kështu, ajo nuk mund të paraqiste kërkesë për dëmshpërblim në mungesë të një autori të identifikuar (*shih paragrafin 138 më lart*).

162. Rrjedhimisht, hetimi i krimit në fjalë, i cili është pezulluar që prej vitit 2010 nga prokurori, nuk mund të përshkruhet si një përgjigje efektive nga autoritetet ndaj sulmit me acid. Ka pasur pra shkelje të nenit 2 të Konventës, në lidhje me detyrimin procedural të Shtetit.

II. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

163. Ankuesja u ankua për mossigurimin nga ana e autoriteteve të një trajtimi psikoterapie ose rehabilitimi, dhe për mungesën e kompensimit financiar. Ajo u bazua në nenin 8 të Konventës, i cili, për sa është i rëndësishëm, citon si më poshtë:

Neni 8

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private ...”

164. Qeveria nuk paraqiti ndonjë vëzhgim të veçantë.

165. Gjykata vlerëson, në bazë të materialit të parashtruar, se nuk paraqitet asnjë shkelje në këtë drejtim, dhe për këtë arsye e rrëzon këtë ankim si haptazi të pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

166. Ankuesi u ankua për shkelje të nenit 13 të Konventës në lidhje me nenin 2 të Konventës në funksion të faktit se nuk mund të kundërshtonte veprimet e prokurorit dhe se nuk mund të kërkonte kompensim për sulmin aktual.

167. Neni 13 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

168. Sa i përket pamundësisë së ankueses për të kundërshtuar veprimet e prokurorit, Gjykata vlerëson se ky ankim lidhet me atë të shqyrtuar në nenin 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (*shih paragrafët 161 dhe 140*), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

169. Për sa i përket mundësisë së ankueses për të marrë kompensim nga autori i veprës, Gjykata, gjithashtu, vlerëson se ky ankim është i lidhur me atë të shqyrtuar, sipas nenit 2 më lart dhe për këtë arsye duhet të deklarohet, gjithashtu, i pranueshëm. Sidoqoftë, duke pasur parasysh gjetjet e Gjykatës, sipas nenit 2 të Konventës më lart (*shih paragrafët 161 dhe 138*), nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i këtij ankimi.

170. Sa i përket mundësisë së ankueses për të marrë kompensim nga Shteti, Gjykata vëren se procedimet, në lidhje me kërkesën e ankueses për dëmshpërblim u pushuan nga Gjykata e Rrethit Tiranë më 30 maj 2013, për shkak se ankuesja dhe avokati i saj nuk kishin arritur të paraqiteshin (*shih paragrafin 53 më lart*). Gjykata vëren se ankuesja nuk dha asnjë shpjegim ose ndonjë provë se arsyeja e mosparaqitjes në seancat gjyqësore kishte të bënte me pamundësinë e saj për të paguar taksat gjyqësore. Po kështu, ajo nuk parashtroi që Gjykata e Rrethit kishte refuzuar kërkesën e saj për përjashtim nga kërkesa për të paguar tarifat gjyqësore para se të vendoste pushimin e procedimeve. Në çdo rast, kërkesa e ankueses për dëmshpërblim nuk ishte përcaktuar në terma sasiorë, ku në këtë rast tarifat gjyqësore do të përcaktoheshin si përqindje e kërkesës. Prandaj, në mungesë të ndonjë provueshmërie, kjo pjesë e ankimit duhet të rrëzohet si haptazi e pabazuar në përputhje me nenin 35§§3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 14 TË KONVENTËS

171. Së fundmi, ankuesja u ankua në bazë të nenit 14 të Konventës se autoritetet kishin mbajtur qëndrim pasiv edhe pse ajo kishte shprehur dyshime në lidhje me ish-burrin e saj. Veprimet e autoriteteve kishin treguar se ishin diskriminues ndaj saj për shkak të gjinisë së saj.

172. Duke pasur parasysh faktin që Gjykata tashmë ka shqyrtuar rrethanat e kësaj çështjeje, sipas nenit 2 të Konventës më lart (*shih, në veçanti, paragrafët 156 dhe 157*), nuk e gjen të nevojshme të shqyrtojë pranueshmërinë ose themelin e këtij ankimi.

V. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

173. Neni 41 i Konventës parashikon se:

“Nëse Gjykata konstaton, se ka pasur shkelje të Konventës dhe të Protokolleve të saj, dhe nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesëshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim së drejtë palës së dëmtuar.”

A. Dëmi

174. Ankuesja pretendoi 3,730.20 euro, në lidhje me dëmin pasuror – që përbëhet nga shpenzimet që ankuesja ka bërë për trajtimin e saj në Itali – dhe 4,938,469 lekë (afërsisht 36,452 euro), në lidhje me humbjen e fitimeve, shumë kjo që përfaqëson pagën e saj për një periudhë prej një viti. Ankuesja, gjithashtu, pretendoi shumë prej 9,890,004 lekësh (afërsisht 73,000 euro), në lidhje me dëmin jopasuror që përbëhet nga: 4,945,002, në lidhje me integritetin fizik dhe psikologjik të saj; 2,472,501 lekë, në lidhje me dhimbjet dhe vuajtjet që kishte duruar; dhe 2,472,501 lekë, në lidhje me cilësinë e jetës së saj. Ankuesja paraqiti një raport ekspertimi, sipas të cilit llogaritja është bazuar në vendimin unifikues të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë të datës 14 shtator 2007 (*shih paragrafin 88 më lart*).

175. Qeveria argumentoi që ankuesja nuk kishte paraqitur një kërkesë civile për dëmshpërblim. Raportekspertimi ishte bazuar në ligjin shqiptar të sigurimeve. Për rrjedhojë, Qeveria i kërkoi Gjykatës të rrëzonte pretendimet e saj si të pabazuara.

176. Gjykata vëren se rregulli që duhet të shterohen mjetet juridike të brendshme, nuk zbatohet për pretendimet për shpërblim të drejtë parashtruar Gjykatës, sipas nenit 41 të Konventës (*shih De Wilde, Ooms and Versyp kundër Belgjikës (neni 50), 10 mars 1972, §§15–16, seria A nr. 14, dhe Salab kundër Hollandës, nr. 8196/02, §§67, ECHR 2006-IX (ekstrakte)*).

177. Gjykata nuk dallon ndonjë lidhje shkakësore midis shkeljes së konstatuar dhe dëmit pasuror të pretenduar; Ajo, rrjedhimisht, e rrëzon këtë pretendim. Nga ana tjetër, Gjykata i akordon ankueses, mbi baza të barabarta, 12,000 euro, në lidhje me dëmin jopasuror, si rezultat i shkeljes së konstatuar, për shkak të paefektshmërisë së hetimit.

B. Kosto dhe shpenzime

178. Ankuesja pretendoi, gjithashtu, 1,500 euro për përfaqësimin e saj para Gjykatës, si dhe 1,220 euro dhe 70,150 lekë (518 euro), për lidhje me shpenzimet e përkthimit, ato administrative si dhe kostot dhe shpenzimet para gjykatave të brendshme dhe Gjykatës.

179. Qeveria nuk paraqiti ndonjë koment të veçantë.

180. Sipas praktikës ligjore të Gjykatës, një ankues ka të drejtën e rimbursimit të kostove dhe shpenzimeve vetëm për aq sa është treguar se ato janë bërë realisht dhe domosdoshmërisht dhe janë të arsyeshme për sa i përket sasisë (*shih Gjyli kundër Shqipërisë, nr. 32907/07, §72, 29 shtator 2009*). Në çështjen në fjalë, duke pasur parasysh dokumentet në zotërim dhe kriteret e mësipërme, Gjykata çmon të arsyeshme të akordojë shumë prej 2,720 eurosh që mbulon të gjitha kostot sipas çdo kreu.

C. Interesi i munguar

181. Gjykata e çmon të arsyeshme që norma e interesit të munguar duhet të bazohet në normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, mbi të cilën duhet të shtohen 3 për qind.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

1. Deklaron ankimin sipas nenit 2 të Konventës dhe ankimet sipas nenit 13 të Konventës në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të kundërshtuar veprimet e prokurorit dhe për të kërkuar kompensim nga autori i veprës, të pranueshme, si dhe ankimin, sipas nenit 8 të Konventës dhe ankimin sipas nenit 13 të Konventës, në lidhje me mungesën e një mjeti juridik për të marrë kompensim nga Shteti të papranueshme.

2. Vendos se nuk është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja materiale e saj.

3. Vendos se është shkelur neni 2 i Konventës nga pikëpamja procedurale e saj.

4. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet themeli i ankimeve, sipas nenit 13 të

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

Konventës.

5. Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pranueshmëria ose themeli i ankimit, sipas nenit 14 të Konventës.

6. Vendos:

a) se Shteti i paditur duhet t'i paguajë ankueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi ka marrë formë të prerë, në përputhje me nenin 44§2 të Konventës, shumat e mëposhtme, të cilat duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e shlyerjes;

i. 12,000 euro (dymbëdhjetë mijë euro), plus çdo taksë që mund të vendoset, në lidhje me dëmin jopasuror;

ii. 2,720 euro (dy mijë e shtatëqind e njëzet euro), plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet ankueses, në lidhje me kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës prej tre muajsh të përmendur më lart deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të jetë i pagueshëm mbi shumat e mësipërme me një normë të barabartë me normën marxhinale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit të detyrimeve financiare, plus tre për qind;

7. Rrëzon, në mënyrë unanime, pjesën tjetër të pretendimit të ankueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 4 gusht 2020, sipas nenit 77§§2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Stanley Naismith
Sekretar

Robert Spano
Kryetar

SEKSIONI I TRETË
“FATBARDH BUDO KUNDËR SHQIPËRISË”⁵⁹
(kërkesa nr. 7576317)

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur në datën 12 janar 2021, si komitet i përbërë nga:

Dmitry Dedov, president

Darian Pavli

Peter Roosma, gjykatës

dhe Olga Chernishova, zëvendës regjistruese e seksionit.

Duke pasur parasysh kërkesën e mësipërme të depozituar në datën 18 tetor 2017, duke pasur parasysh deklaratat zyrtare që pranojnë një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes, pas shqyrtimit të çështjes, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkuesi, z. Fatbardh Budo, është një shtetas shqiptar i cili ka lindur në vitin 1975 dhe jeton në Gjirokastrë. Ai u përfaqësua para Gjykatës nga z. F. Caka, një avokat që ushtron profesionin në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga Agjenti i tyre i atëhershëm, z. A. Metani dhe më pas nga znj. E. Muçaj nga zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Kërkuesi, i cili ishte një i burgosur i dënuar, u ankua për shkelje të nenit 3, të Konventës në lidhje me përdorimin e prangave në një mjedis spitalor dhe të nenit 13, për mungesën e një mjeti efektiv juridik për ankesën e tij sipas nenit 3.

4. Çështja iu komunikua Qeverisë më 18 dhjetor 2019.

6. Më 3 dhjetor 2020, Gjykata mori një deklaratë nga Qeveria në lidhje me një zgjidhje të çështjes me mirëkuptim, e cila përmban tekstin e mëposhtëm:

“Me anë të kësaj deklaroj se Qeveria e Shqipërisë ofron të paguajë *ex gratia*, me qëllim që të sigurojë një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes së lartpërmendur, të mbetur pezull para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, 10.000 euro (dhjetë mijë euro) për kërkuesin ... për të mbuluar çdo dhe të gjithë dëmin material dhe jomaterial, si edhe 700 euro (shtatëqind euro) në lidhje me kostot dhe shpenzimet, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuesit.

2. Shumat e mësipërme do të paguhen brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të dhënë nga Gjykata, në përputhje me nenin 39 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Nga mbarimi i periudhës së lartpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën marzhinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje. Kjo pagesë do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

3. Qeveria shpreh sinqerisht keqardhje që kërkuesi u mbajt i prangosur në një shtrat spitali dhe pranon se rrethanat e çështjes në fjalë tregonin një problem sistematik dhe strukturor, specifikisht përdorimi i prangave për të lidhur një të burgosur në një shtrat spitali, i cili ishte parashikuar në rregullat e hollësishme në lidhje me sjelljen e oficerëve të policisë në burg (2010).

4. Kjo praktikë, përkatësisht përdorimi standard i prangave në një mjedis spitalor, është ndërprerë që nga data 31 korrik 2018. Gjithashtu, dy akte ligjore të kohëve të fundit, përkatësisht ligji për të drejtat dhe trajtimin e të burgosurve (ligji nr. 81/2020) dhe ligji për policinë e burgjeve (ligji nr. 81/2020) u miratuan në vitin 2020 dhe vunë theksin në kryerjen e një vlerësimi të rrezikut, duke

⁵⁹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 34*. Tiranë 2021, f. 4426

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

përfshirë vlerësimin e nivelit të rrezikshmërisë së çdo të burgosuri, përpara zbatimit të ndonjë mase kufizuese.

5. Qeveria më tej merr përsipër të:

- ndryshojë legjislacionin dytësor zbatues ekzistues dhe të miratojë legjislacionin e ri dytësor, në zbatim të ligjeve të mësipërme, duke përfshirë miratimin e rregullave të reja në lidhje me sjelljen e oficerëve të policisë në burg, brenda një viti nga data e vendimit të Gjykatës;

- marrë masa për krijimin e njërive të specializuara brenda institucioneve të përshtatshme shëndetësore me elemente të përmirësuara sigurie, që do të plotësojnë nevojat e sigurisë dhe do të garantojnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të burgosurve;

- zhvillojë seminare trajnimi dhe ndërgjegjësimi me oficerë të policisë së burgjeve dhe autoritete të tjera përkatëse mbi legjislacionin e miratuar së fundi, me qëllim që të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.”

7. Më 8 dhjetor 2020, Gjykata mori një deklaratë të nënshkruar nga kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij në lidhje me një zgjidhje me mirëkuptim të çështjes, pjesa më e rëndësishme e të cilës përmbante tekstin e mëposhtëm:

“2 pranon propozimin e bërë nga Qeveria dhe heq dorë nga çdo pretendim i mëtejshëm kundër Shqipërisë” në lidhje me faktet e kësaj kërkesë. Unë deklaroj se pagesa e shumës së mësipërme përbën zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje.”

LIGJI

8. Gjykata konstaton zgjidhjen me mirëkuptim të arritur ndërmjet palëve. Ajo është e bindur se zgjidhja bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe Protokollet e saj dhe nuk vëren asnjë arsye për të justifikuar vijimin e shqyrtimit të kërkesës (neni 37§1 *in fine* i Konventës). Sa më sipër, është e nevojshme që Çështja të fshihet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

- Vendos të fshijë kërkesën nga lista e çështjeve të saj në përputhje me nenin 39 të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim në datën 4 shkurt 2021.

Olga Chernishova
Zëvendës regjistruer

Dmitry Dedov
president

SEKSIONI I TRETË
Çështja
“XHOXHAI KUNDËR SHQIPËRISË”⁶⁰
(aplikimi nr. 15227/19)

VENDIM
Strasbourg
9 shkurt 2021

Neni 6/1 (aspekti civil) - Organe të ngritura për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për të luftuar korrupsionin, që përbëjnë gjykata të pavarura dhe të paanshme të ngritura me ligj. - Masa mbrojtëse të mjaftueshme. - Mospërfaqësimi i gjyqtarëve në detyrë në përputhje me natyrën dhe frymën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit, shoqëruar me kërkesa ligjore strikte përzgjedhëse. - Rishikim i plotë i juridiksionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

Neni 6/1 (aspekti civil) - Proces i rregullt. - Mungesë të kufizimeve me ligj sa i takon vlerësimin të pasurisë, duke mos shkelur mbi parimin e sigurisë ligjore, duke pasur në konsideratë natyrën dhe kontekstin e saj sui generis.

Neni 6/1 (aspekti civil) - Proces i rregullt. - Informacioni i dubur, koha e mjaftueshme dhe lehtësira në përgatitjen e mbrojtjes në bazë të vlerësimit dhe arsyetimit të mjaftueshëm për vendimin e dhënë nga trupa gjykuese të rivlerësimit. - Natyra e procesit nuk kërkon shqyrtimin në seancë publike të ankimit.

Neni 8 - Jeta private. - Shkarkim i justifikuar i gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese, bazuar në gjetjet nga vlerësimi i pasurisë. - Përfjashtëmi proporcional nga rihyrja në sistemin e drejtësisë për shkelje të rënda etike.

Vendimi do të marrë formë të prerë sipas dispozitës së nenit 44/2 të Konventës.

Ai mund t'u nënshtrohet redaktimeve gjuhësore.

Në çështjen “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), si një kolegji i përbërë nga:

Paul Lemmens, kryetar

Georgios A. Serghides

Dmitry Dedov

Georges Ravarani

Maria Elósegui

Darian Pavli

Peeter Roosma, gjyqtarë

dhe Milan Blaško, sekretar

Duke pasur parasysh:

- aplikimin me nr. 15227/19 kundër Republikës së Shqipërisë, u depozitua në Gjykatë bazuar në nenin 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) nga një shtetase shqiptare, znj. Altina Xhoxhaj (kërkuesja), më datë 8 mars, 2019;

- vendimin për njoftimin e aplikimit qeverisë shqiptare (Qeveria);

- parashtrimet me shkrim mbi pranueshmërinë dhe themelin, të paraqitura nga qeveria dhe kërkuesja;

- komentet e palëve të treta të marra nga Komisioni Evropian dhe Respublica, të cilave u ishte dhënë leje nga kryetari për të bërë ndërhyrje me shkrim (neni 36/2 i Konventës dhe rregulli 44/3);

Pas diskutimeve me dyer të mbyllura, më 15 dhjetor 2020 dhe më 19 janar 2021,

Jep vendimin e mëposhtëm, i miratuar në datën e përmendur më të fundit.

⁶⁰ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 97*. Tiranë 2021, f. 9555

HYRJE

1. Kjo çështje ka të bëjë me përfundimin e procesit të rivlerësimit (referuar ndryshe si “veting”) kundër kërkuases, që çoi në shkarkimin e saj nga posti i gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese. Ajo është pjesë e një sërë aplikimesh të depozituara pranë Gjykatës që kanë ngritur çështje të ngjashme faktike dhe ligjore sipas neneve 6, 8 dhe 13 të Konventës.

FAKTET

2. Kërkuësja ka lindur në vitin 1970 dhe adresa e saj në formularin e aplikimit jepet sikur është në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kërkuësja u përfaqësua nga z. A. Saccucci dhe znj. G. Borgna, avokatë me seli në Romë.

3. Qeveria u përfaqësua nga agjenti i saj, z. A. Metani, dhe më pas nga znj. E. Muçaj nga Avokatura e Shtetit.

I. KONTEKSTI I ÇËSHTJES

4. Në vitin 2014 u krijua një komision parlamentar *ad hoc*, i cili do të ishte përgjegjës për reformën në sektorin e drejtësisë. Më pas, ai miratoi një raport mbi vlerësimin e sistemit të drejtësisë në Shqipëri (Raporti i Vlerësimit). Raporti i vlerësimit iu referua një numri sondazhesh të opinionit publik dhe anketave të kryera për gjykatat për vitet 2009 dhe 2015, sipas të cilave kishte një perceptim të gjerë publik se sistemi i drejtësisë ishte i mbytur nga korrupsioni, ndikime të jashtme të parregullta, mungesa të praktikave transparente ligjore, procedura tepër të gjata dhe mosekzekutim i vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Sipas opinionit publik, disa gjyqtarë dhe prokurorë duhej të paguanin rryshfet për t’u emëruar ose transferuar në pozicione të lira në kryeqytet ose në qytete të tjera të mëdha. Të dhënat jozyrtare treguan se cikli i pagimit të rryshfeteve – kryesisht me përfshirjen e një “ndërmjetësi”, të tillë si një anëtar i familjes, një mik apo avokat ishte i përhapur mes aktorëve kryesorë, siç janë oficerët e policisë gjyqësore, prokurorët dhe gjyqtarët. Si pasojë, kjo kishte penguar dhënien e drejtësisë: oficerët e korruptuar të policisë gjyqësore merrnin rryshfet në mënyrë që të shkatërronin provat në skenën e krimit, prokurorët e korruptuar pranonin pagesa për të shmangur fillimin e procedimeve penale ose ngritjen e akuzave, dhe gjyqtarë të korruptuar vononin mbajtjen e seancave ose kushtëzonin dhënien e vendimeve me marrjen e rryshfeteve. Niveli i ulët i profesionalizmit i demonstruar nga palët kryesore të sistemit të drejtësisë ishte i dukshëm, ashtu si edhe dështimi i sistemit arsimor në fushën ligjore për të formuar qytetarët, për t’i njohur ata me të drejtat dhe detyrimet e tyre ligjore dhe për rëndësinë e njohjes dhe respektimit të ligjit. Raporti i vlerësimit iu referua, gjithashtu, një numri raportesh monitorimi të kryera nga institucione të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kishin vënë theksin te probleme të ndryshme që prekin sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

5. Raporti i vlerësimit shërbeu si gur themeli për përgatitjen dhe miratimin e një strategjie për reformën e sistemit të drejtësisë (Strategjia e Reformës) që kishte si qëllim, midis të tjerave: i. përmirësimin e sistemit për zbulimin dhe verifikimin e pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe konfliktin e interesit për të identifikuar rastet e përvetësimit të pasurive të paligjshme; ii. futjen e dispozitave ligjore që e bëjnë të detyrueshëm verifikimin e hollësishëm të pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe konfliktin e interesit përpara marrjes së tyre në detyrë; iii. rritjen e transparencës për zbulimin e pasurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke mundësuar përfshirjen e aktorëve të tjerë (të tillë si publiku dhe shoqëria civile) në sigurimin e informacionit, fakteve dhe të dhënave të tjera që do të lehtësonin verifikimin e tyre; dhe iv. kërkesa me ligj e inicimit të procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve për fshehje apo deklarim jo të plotë të pasurive, si dhe konflikt interesi gjatë ushtrimit të detyrave të tyre.

6. Si rezultat i strategjisë së propozuar të reformës, në vitin 2016 u ndryshua Kushtetuta dhe u miratuan një sërë ligjesh thelbësore, një prej të cilëve ishte ligji i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, i referuar ndryshe si ligji nr. 84/2016. Për qëllimet e këtij vendimi, termat “ligji i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve” dhe “ligji nr. 84/2016” kanë kuptim të njëjtë. Po kështu, termat “proces/procedura të vetingut” dhe “procesi/procedurat e rivlerësimit” përdoren në mënyrë të njëjtë.

7. Procesi i rivlerësimit të cilit do t'i nënshtroheshin të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë do të kryhej nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit në shkallën e parë dhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në apel, që do të rivlerësonte tri kritere, përkatësisht: vlerësimin e pasurive, kontrollin e integritetit të figurës për të zbuluar lidhje me krimin e organizuar dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Të gjithë personat që do të verifikoheshin, u kërkohej nga ligji të paraqisnin tri deklaratat të veçanta, të bashkëngjitura ligjit nr. 84/2016, në lidhje me secilin kriter rivlerësimi.

II. RRETHANAT E ÇËSHTJES

8. Faktet e çështjes, siç janë parashtruar nga palët, mund të përmbliidhen si më poshtë.

9. Karriera gjyqësore e kërkuases filloi në muajin mars 1995, kur ajo u emërua në pozicionin e gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Tiranë. Në vitin 2006, ndërsa vazhdonte të punonte si gjyqtare, ajo u zgjodh anëtare e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, organi përgjegjës për emërimin, transferimin dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të gjykatave të rrethit dhe apelit, si dhe përfundimin e shërbimit të tyre, ku ajo shërbeu për katër vjet. Më datë 25 maj 2010, ajo u emërua si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, për një mandat nëntëvjeçar të parinovueshëm.

10. Në përputhje me ligjin për deklarimin e pasurive, kërkuësja paraqiti deklaratat vjetore të pasurisë mes viteve 2003 dhe 2016, ashtu si dhe bashkëjetuesi i saj, i cili ishte një nëpunës civil.

A. Procesi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

11. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, kërkuësja paraqiti deklaratën e pasurisë. Ajo dhe bashkëjetuesi i saj deklaruan se kishin në pronësi tri prona: i. një apartament me sipërfaqe 101 m² të përfituar nëpërmjet një kontrate sipërmarrjeje të nënshkruar më datë 8 mars 2005 dhe të regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në muajin dhjetor 2011 pas nënshkrimit të kontratës së shitjes; ii. një apartament me sipërfaqe 59 m² i blerë më datë 5 tetor 2010 (kontratë sipërmarrjeje datë 5.10.2010); dhe iii. një truall me sipërfaqe 221,9 m². Të dy bënë përshkrime të detajuara të burimit të të ardhurave, si dhe të kursimeve të tyre. Kërkuësja deklaroi, gjithashtu, se kishte llogari bankare në Shtetet e Bashkuara, të cilat ishin hapur në vitet 2015 dhe 2016. Ajo ka dorëzuar, gjithashtu, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin e vetëvlerësimit profesional (*shih paragrafët 133 dhe 134 më poshtë*).

1. Hetimi administrativ

12. Më datë 14 nëntor 2017, duke qenë se kërkuësja ishte në listën e personave me prioritet për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit, pasi ajo ishte gjyqtare në Gjykatën Kushtetuese, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) vendosi të kryejë një hetim të thelluar administrativ për të tria deklaratat e plotësuara nga ana e saj.

13. Më datë 30 nëntor 2017 u hodh shorti në KPK-në për përbërjen e trupës gjyqësore prej tre anëtarësh dhe ndërkohë u njoftua edhe kërkuësja.

14. Ndërmjet datave 15 dhjetor 2017 dhe 5 mars 2018, KPK-ja i kërkoj kërkuases t'i përgjigjej një numri të detajuar pyetjesh. Ajo u përgjigj ndërmjet datave 26 dhjetor 2017 dhe 6 mars 2018.

15. Më datë 19 mars 2018, KPK-ja, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, informoi kërkuësen për përfundimin e hetimit administrativ dhe i paraqiti asaj gjetjet përkatëse paraprake, përfshirë dokumentet që kishin shërbyer si bazë për ato gjetje. Në veçanti, në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², gjetjet theksuan: i. se kishte mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave që ishin përdorur për të blerë apartamentin, kur krahasohej deklaratat e pasurisë e vitit 2005 dhe deklaratat e rivlerësimit, dhe në lidhje me mjetet me të cilat ajo ishte krijuar, në veçanti, ekzistencën e një kontrate sipërmarrjeje të lidhur në vitin 2003; dhe ii. që kishte mungesë të dokumenteve mbështetëse në lidhje me burimin e fondeve që ishin përdorur për të blerë apartamentin. Sa i përket situatës financiare të kërkuases (likuiditetet), gjetjet theksuan se ajo nuk kishte pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në vitet 2007, 2009 dhe 2015 për të justifikuar sasinë e tepërt të likuiditeteve. Për sa i përket truallit me sipërfaqe 666 m², të cilin ajo e kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë të vitit 2003, por nuk e kishte përfshirë në deklaratën për rivlerësim, gjetjet theksuan se kishte mospërputhje në lidhje me pjesën e saj takuese në atë truall. Për më shumë, asaj iu kërkua të jepte shpjegime në lidhje me një ankesë të bërë nga një individ në lidhje me dështimin e saj për të hequr

dorë nga shqyrtimi i një ankese kushtetuese.

16. Sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, KPK-ja i kaloi barrën e provës kërkueses, e cila kishte njëzet ditë kohë për të paraqitur argumente në mbështetje të mbrojtjes së saj. Ajo, gjithashtu, u njoftua për të drejtat e saj sipas neneve 35–40 dhe 45–47 të Kodit të Procedurës Administrative, përfshirë të drejtën për t'u njohur me dosjen e çështjes, për paraqitjen e provave shtesë dhe thirrjen e dëshmitarëve.

17. Më datë 21 mars 2018, kërkuesja bëri një kërkesë për t'u njohur me dosjen e saj, duke kërkuar informacion në lidhje me metodologjinë e përdorur për të përlogaritur shpenzimet e bëra gjatë udhëtimeve të saj jashtë vendit. KPK-ja u përgjigj përkatësisht në datat 23, 27 dhe 30 mars 2018. Më tej, që nga data 6 janar deri më 5 dhjetor 2017, organet ndihmëse të cilat ishin autorizuar nga ligji nr. 84/2016 për të ndihmuar organet e rivlerësimit, përkatësisht Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (IKLD), ishin shprehur në favor të deklarimeve të kërkueses.

18. Më datë 7 prill 2018, kërkuesja parashtroi argumente të shumta, si dhe prova në mbështetje të mbrojtjes së saj.

19. Më datë 16 prill 2018, pas parashtrimeve të kërkueses, KPK-ja i kërkoi asaj të paraqesë informacion shtesë, në mënyrë që të përcaktoheshin rrethana të caktuara faktike.

20. Më datë 17 prill 2018, KPK-ja informoi kërkuesen se në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 do të mbahej një seancë publike. Ajo, gjithashtu, u informua për të drejtat e saj sipas neneve 35–40 të Kodit të Procedurës Administrative. Seanca publike u zhvillua më datë 23 prill 2018. Kërkuesja, e cila u përfaqësua nga mbrojtësi i saj, bëri parashtrime të mëtejshme me shkrim dhe verbalisht.

21. Më datë 25 prill 2018, KPK-ja shtyu seancën pa marrë një vendim për çështjen e kërkueses, në mënyrë që të kishte më shumë kohë për të shqyrtuar provat shtesë që ajo kishte paraqitur me *e-mail* më datë 18 prill 2018 dhe i kishte vënë në dispozicion në seancë.

2. Vendimi i KPK-së

22. Më datë 4 qershor 2018, KPK-ja, duke pasur parasysh raportet e paraqitura nga organet ndihmëse, provat e tjera me shkrim që kishte marrë gjatë hetimit administrativ, parashtrësas e bëra në përgjigje nga kërkuesja dhe dy ankesat e bëra nga publiku, dha vendimin e tij të arsyetuar në çështjen e kërkueses. Dispozitivi i tij ishte bërë publik më datë 3 maj 2018.

a) Gjetjet sa i takon vlerësimit të pasurisë

i. Sa i takon apartamentit me sipërfaqe 101 m²

23. KPK-ja, pasi shqyrtoi provat në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m² që i përkiste kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj, konstatoi që “*në lidhje me ligjshmërinë e burimit të deklaruar të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor, deklaram të rremë dhe fshehtë të të ardhurave*”.

24. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, KPK-ja konstatoi se ekzistonte një mospërputhje midis deklaratës së rivlerësimit të pasurisë së kërkueses dhe deklaratës së pasurisë së bashkëjetuesit të saj të depozituar në vitet 2003 dhe 2005 në lidhje me burimin e të ardhurave që ishte përdorur për blerjen e pasurisë. Në deklaratën “veting”, kërkuesja deklaroi se burimi i të ardhurave, i përdorur për blerjen e apartamentit, kishin qenë të ardhurat e bashkëjetuesit të saj nga punësimi fitimprurës në Itali dhe paratë e bursave të përfituara nga ai. Ndërsa në deklaratat e pasurisë së bashkëjetuesit të saj, të depozituar në vitin 2005, ai kishte deklaruar për herë të parë se apartamenti ishte blerë me të ardhurat e shitjes së një banese tjetër me sipërfaqe 93 m², si dhe nga kursimet vjetore. Në deklaratën e tij të pasurisë, të depozituar në vitin 2003, ai deklaronte se apartamenti me sipërfaqe 93 m² ishte blerë me të ardhurat e përfituara nga shitja e një banese tjetër dhe kursimet nga punësimi i tij në Itali. Si pasojë, sipas KPK-së, banesa me sipërfaqe 101 m² ishte blerë me të ardhurat e siguruara nga shitja e mëparshme e një apartamenti me sipërfaqe 93 m².

25. KPK-ja iu referua më tej një kontrate sipërmarrjeje të lidhur para noterit më datë 7 mars 2005,

sipas së cilës kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj kishin rënë dakord për të transferuar pronësinë e banesës me sipërfaqe 93 m² te një palë e tretë, e cila kishte paguar plotësisht çmimin e shitjes. Në kontratë thuhej se si kërkuesja, ashtu edhe bashkëjetuesi i saj kishin marrë çmimin e shitjes. Aty thuhej: “më datë 31 mars 2003, kompania e ndërtimit lidhi një kontratë sipërmarrjeje [me kërkuesen dhe bashkëjetuesin e saj] në lidhje me një apartament... me sipërfaqe 93 m²”. Duke u mbështetur në këtë kontratë, KPK-ja arriti në përfundimin se si kërkuesja, ashtu edhe bashkëjetuesi i saj, kishin përfituar apartamentin me sipërfaqe 93 m². Edhe pse kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin jetuar së bashku në atë kohë, KPK-ja u shpreh se kërkuesja nuk mund të përjashtohet nga detyrimi për të deklaruar në deklaratën e pasurisë së vitit 2003 pasurinë në kontratën e sipërmarrjes në të cilën ajo kishte qenë palë dhe në bazë të së cilës ajo kishte fituar të drejtat e pronësisë dhe kishte bërë një pagesë në lidhje me apartamentin. Ndërkohë, transaksioni ishte kryer me anë të një kontrate sipërmarrjeje, qëllimi i një transaksioni të tillë ishte shitblerja e pronës së paluajtshme. Prandaj, burimi i vërtetë i fondeve për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 101 m² kishin qenë të ardhurat nga shitja e një apartamenti të mëparshëm me sipërfaqe 93 m², të cilin të dy, edhe kërkuesja edhe bashkëjetuesi i saj, e kishin blerë në vitin 2003 përmes një kontrate sipërmarrjeje. KPK-ja konstatoi se ajo kishte qenë bashkëpronare e banesës dhe se ajo nuk e kishte deklaruar apartamentin me sipërfaqe 101 m² në ndonjë prej deklaratave periodike të pasurive ndërmjet viteve 2005 dhe 2011 (*shih paragrafin 11 më lart*). Sipas KPK-së, “*fshehja e veprimeve noteriale nga ana e subjektit të rivlerësimit pasqyron mosdeklarim me vërtetësi të burimit të krijimit të pasurisë-veting*”.

26. Sa i përket pretendimit të kërkueses se ajo kishte kontribuar në blerjen e apartamentit, KPK-ja, duke bërë një vlerësim të provave në dosjen e çështjes, konstatoi se kërkuesja nuk kishte poseduar mjete të mjaftueshme likuide: në vitin 2003, pasuritë e saj likuide arrinin në 783,964 lekë (6,251 euro), me kursin aktual të këmbimit) dhe më 2004 në 25,000 lekë (200 euro). Për më tepër, ajo kishte hua të marra në vitet 2003 dhe 2004.

27. Më tej, KPK-ja hodhi poshtë pretendimin e kërkueses se apartamenti ishte blerë me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj, ndërsa ai kishte qenë duke studiuar, punuar dhe jetuar në Itali nga viti 1992 në vitin 2001. Duke bërë një vlerësim të provave të dosjes së çështjes, KPK-ja, duke pasur parasysh faktin që vetëm të ardhurat që i nënshtrohen tatimit mund të konsiderohen të ligjshme, vlerësoi se situata financiare e bashkëjetuesit të saj kishte qenë negative. Pavarësisht kësaj, KPK-ja kreu një vlerësim tjetër në bazë të të ardhurave të tij të deklaruara dhe arriti në përfundimin se të ardhurat e tij neto (206,399 lekë – 1,646 euro) ishin të pamjaftueshme për të blerë apartamentin. KPK-ja mori parasysh fitimet e marra nga punësimi i bashkëjetuesit të saj si kamerier. Në mungesë të ndonjë dokumenti mbështetës, KPK-ja nuk mori parasysh fitimin që do të llogaritej si komision në bazë të një kontrate që ai kishte lidhur me një kompani italiane. Gjatë përcaktimit të shpenzimeve të jetesës, KPK-ja i bazoi vlerësimet e saj në informacionin e publikuar nga Instituti Italian i Statistikave për periudhën 2002–2004.

28. KPK-ja deklaroi se kërkuesja nuk kishte paraqitur ndonjë dokument mbështetës për të justifikuar pamundësinë e bashkëjetuesit të saj për të siguruar dokumente që datojnë nga vitet 1990, në përputhje me nenin 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Ajo nuk e kishte informuar KPK-në se, në funksion të marrëdhënies që bashkëjetuesi i saj kishte pasur me bankën në të cilën ai kishte një llogari në Itali, kompania italiane që ishte ende funksionale apo Instituti Kombëtar Italian i Sigurimeve Shoqërore, dokumentet mbështetëse mungonin, ishin humbur ose nuk mund të riprodhoheshin në ndonjë mënyrë tjetër. Së fundmi, KPK-ja konstatoi se nuk kishte asnjë dokument në dosjen e çështjes për të demonstruar se paratë e bursës, të cilat Ministria Italiane e Punëve të Jashtme ia kishte dhënë bashkëjetuesit të saj, të ishin transferuar në llogarinë e tij. KPK-ja konsideroi se paratë nga bursa e përfituar, dhënë për një qëllim të veçantë, nuk mund të ishin shkak për kursime të konsiderueshme që mund të përdorëshin për të blerë një apartament. Më tej, konsideroi që të ardhurat që bashkëjetuesi i saj pretendonte të kishte fituar duke punuar në tregun e zi, nuk ishin “burime të bindshme për justifikimin e kësaj pasurie”.

ii. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 58.75 m²

29. KPK-ja konstatoi se kërkuësja nuk kishte të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në vitin 2010, për të blerë apartamentin me sip. 58.75 m² përfituar me anë të kontratës së sipërmarrjes.

iii. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 221.9 m²

30. KPK-ja u shpreh se kërkuësja kishte përfituar një sasi trualli (221.9 m²) më shumë se sa i takonte ligjërisht (që ishte 128.89 m²) si rezultat i transferimit të pronësisë në vitin 2013.

iv. Në lidhje me situatën financiare të kërkuësës dhe të bashkëjetuesit të saj

31. KPK-ja, pasi përcaktoi burimet e pasurive dhe detyrimet e kërkuësës dhe bashkëjetuesit të saj, konstatoi se ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për të justifikuar likuiditetet e saj⁶¹ në vitet 2007, 2009 dhe 2015 në një shumë totale prej 1,972,969 lekësh (15,750 eurosh). Gjatë përcaktimit të situatës financiare, KPK-ja kishte parasysh bilancin e gjendjes së likuiditeteve të kërkuësës dhe bashkëjetuesit të saj në fillim të çdo viti dhe të ardhurat e tyre të dokumentuara. Detyrimet përfshinin shpenzimet e jetesës të përcaktuara nga ILDKPKI-ja, shpenzimet e udhëtimit, të përllogaritura duke iu referuar shumës 180 euro për biletë avioni me kosto të ulët, 300 euro për një biletë vajtje-ardhje dhe 50 euro për shpenzime ditore, ripagimin e hipotekës, të cilat ishin llogaritur në bazë të dokumenteve të paraqitura nga bankat dhe barra të tjera.

32. Në përcaktimin e likuiditeteve, KPK-ja, duke u bazuar në dokumentet mbështetëse që kishte paraqitur kërkuësja, pranoi arsyetimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të caktuara, për shembull të ardhurat e përfituara nga bashkëjetuesi i saj, disa shpenzime udhëtimi të paguara nga punëdhënësi i saj dhe shpenzimet arsimore për fëmijën e saj. Komisioni rrëzoi disa pretendime të tjera të bëra nga kërkuësja për shkak të mungesës së dokumenteve mbështetëse.

33. KPK-ja konstatoi më tej faktin se bashkëjetuesi i saj kishte mbajtur 15,000 euro *cash* në shtëpi, çka është në kundërshtim me dispozitat ligjore për deklarimin e pasurisë, që parashikon që ai duhet t'i depozitonte paratë *cash* të mbajtura në shtëpi në një llogari bankare para se të paraqiste deklaratën vjetore të pasurisë (*shih paragrafin 202 më poshtë*).

v. Sa i takon hipotekës në shumën 40,000 (USD)

34. KPK-ja u shpreh se kërkuësja ka fshehur natyrën e vërtetë të kredisë hipotekare në shumën 40,000 USD, të cilën e kishte marrë në vitin 2003, dhe se marrja e kësaj kredie është fiktive.

vi. Sa i takon tokës bujqësore me sipërfaqe 666 m²

35. KPK-ja konstatoi se, në bazë të dokumentacionit të çështjes, kërkuësja kishte bërë një deklaram të pasaktë në vitin 2003 në lidhje me pjesën e saj të tokës me sipërfaqe 666 m², e cila, në përputhje me kontratën e shitjes dhe certifikatën e pronësisë, ishte regjistruar vetëm në emër të nënës së saj.

vii. Sa i takon apartamentit me sipërfaqe 89.16 m²

36. KPK-ja është shprehur se kërkuësja ka bërë deklaram të rremë sa u takon të ardhurave që kishte përfituar si bashkëpronare nga shitja e apartamentit në vitin 2003.

b) Gjetje sa u takon kriterëve të tjera të rivlerësimit

37. KPK-ja mbështeti gjetjet pozitive të Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë sa u takon aftësive profesionale dhe etikës.

38. KPK-ja konstatoi më tej se, pas një denoncimi të paraqitur nga publiku sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 (*shih paragrafin 148 më poshtë*), kërkuësja nuk kishte deklaruar një konflikt interesi dhe heqjen dorë nga shqyrtimi i një ankese kushtetuese në lidhje me një sërë procedimesh civile para gjykatave më të ulëta, në përputhje me nenin 36 (1) (c) të ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile (*shih paragrafët 199 dhe 197 më poshtë*). Sipas KPK-së, konflikti i interesit qëndronte në faktin se babai i saj kishte qenë relator i një çështjeje në një gjykatë apeli, e cila

⁶¹ Për qëllimet e këtij aktgjykimi, "likuiditete" do të thotë: (A) gjendja e kursimeve *cash* në fund të një viti të caktuar kalendarik, siç përcaktohet nga organet e rivlerësimit, i cili duhet të jetë i barabartë me (B) bilancin e parave të mbartura të kërkuësës dhe bashkëjetuesit të saj nga viti i kaluar kalendarik, plus (C) të ardhurat vjetore të kërkuësës dhe bashkëjetuesit të saj të krijuara gjatë vitit kalendarik raportues, të mbështetura me dokumente ligjore/zyrtare, minus (D) çdo shpenzim (përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet e jetesës, shpenzime udhëtimi, këste hipotekimi). Çdo mospërputhje kur (A) është më e lartë se (B + C - D) do të krijonte likuiditete të pajustificueshme që nuk mbështeten nga rrjedha e parave të përcaktuara nga dokumentet në dosjen e çështjes.

kishte shqyrtuar çështjen e kufizimeve ligjore në një set të veçantë procesesh penale kundër palëve të treta, një ankesë e cila është paraqitur nga i njëjti person që kishte depozituar ankimin pranë Gjykatës Kushtetuese. Në atë grup procesesh penale, gjykata e apelit kishte vendosur që Çështja ishte parashkruar. Palët e treta kishin qenë, gjithashtu, palë e interesuar në procesin kushtetues.

39. Sa i përket sjelljes së kërkueses, KPK-ja u shpreh se ajo kishte bashkëpunuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe kishte dhënë shpjegime, siç kërkohej. Sidoqoftë, KPK-ja doli në përfundimin se dokumentet që ajo kishte siguruar ishin të një natyre deklarative.

c) Konkluzion i përgjithshëm

40. KPK-ja, duke pasur parasysh konstatimet në lidhje me vlerësimin e pasurive të kërkueses dhe mosdeklarimin nga ana e saj të një konflikti interesi, vendosi me shumicë votash shkarkimin e saj nga detyra sipas nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016 (*shih paragrafin 151 më poshtë*).

d) Mendimi i pakicës

41. Një nga anëtarët e KPK-së (G.T.) paraqiti një opinion kundër, duke u shprehur se mospërputhjet për deklarimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 101 m² (*shih paragrafin 24 lart*) nuk përbënin prova të mjaftueshme për shkarkimin nga detyra të kërkueses; dhe as pasaktësitë në deklarimin e pasurisë nuk mund të konsiderohen si mosdeklarim pasurie. Sipas mendimit kundër të G.T., ishte e provuar që apartamenti me sipërfaqe 101 m² ishte blerë me të ardhurat e fituara nga shitja e një apartamenti tjetër, i cili, nga ana tjetër, ishte blerë në vitin 2003 me të ardhurat nga punësimi i bashkëjetuesit të kërkueses në Itali dhe paratë e tij të bursës. Si pasojë, të ardhurat kishin origjinën nga fondet e bashkëjetuesit të saj dhe nuk mund të përbënin shkak për mospërputhje në deklaratat e paraqitura në vite të ndryshme.

42. Meqenëse bashkëjetuesi i saj i kishte fituar të ardhurat mbi njëzet vjet më parë, kishte qenë objektivisht e pamundur që kërkuësja të merrte dhe të paraqiste dokumente për të verifikuar burimin e tyre. Vlerësimi financiar, i bërë në lidhje me bashkëjetuesin e saj, nuk kishte marrë parasysh të ardhurat që ai kishte akumuluar në vitet 1996, 1998 dhe 1999, ndërsa punonte në tregun e zi në Itali. Dihet botërisht se studentëve shqiptarë në Itali, ose diku tjetër jashtë vendit, u duhej të punonin në tregun e zi për të fituar të ardhura të tjera, pavarësisht çdo burse që u jepej. Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 favorizonte të ardhurat e ligjshme që u nënshtroheshin taksave. Ligji *favorizon subjektet duke legjitimuar deri në dyfishin e pasurisë së ligjshme*. Pasuritë totale të kërkueses nuk kishin tejkaluar dyfishin e pasurive të ligjshme. Mendimi i pakicës nuk bashkohet me mendimin e shumicës në lidhje me paratë nga bursa; si dhe nuk mbështeti gjetjet e shumicës në lidhje me aktin noterial të nënshkruar në vitin 2003, për aq kohë sa KPK-ja nuk kishte marrë ndonjë provë për të treguar që kërkuësja kishte kontribuar në blerjen ose përfutimin nga shitja e asaj banese.

43. Sa u përket likuiditeteve të kërkueses në vitet 2007, 2009 dhe 2010, anëtari kundër konsideroi se pasaktësitë në plotësimin e deklarimit të pasurisë nuk mund të konsiderohen si deklarim i rremë ose mungesë e të ardhurave të ligjshme. Për më shumë, sipas mendimit të saj, kredia hipotekare prej 40,000 USD ishte paguar drejtpërdrejt në llogarinë bankare të kompanisë së ndërtimit. Ky fakt mjaftonte për të treguar se kredia ishte marrë për blerjen e apartamentit dhe kërkuësja nuk mund të fajësohej për gabime materiale në aktin noterial. Në tërësi, mendimi kundër përfundon se duke iu referuar parimit të proporcionalitetit, kërkuësja kishte pasuri të besueshme.

44. Së fundmi, kërkuësja nuk ishte përballur me një konflikt interesi në lidhje me ankimin e bërë nga anëtari i publikut në lidhje me pjesëmarrjen e babait të saj në një çështje penale, si anëtar i një gjykate apeli.

B. Procesi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

1. Ankimi i kërkueses

45. Më datë 19 qershor 2018, kërkuësja paraqiti një ankim prej 42 faqesh kundër vendimit të KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (KPA), duke ngritur dy linja argumentesh: e para lidhur me pretendimet në lidhje me shkelje procedurale ose thelbësore të ligjit dhe, e dyta, kundërshtimin e gjetjeve të KPK-së. Kërkuësja përsëriti të njëjtat argumente në parashtrimet e saj të mëtejshme me shkrim të datave 21 shtator dhe 15 tetor 2018.

a) Pretendimet në lidhje me shkeljet procedurale dhe materiale të ligjit

46. Kërkesja pretendoi që asaj nuk i ishte dhënë mundësia të mbrohej në lidhje me gjetjet përfundimtare të KPK-së se ajo kishte pasur fshehje dhe deklarim të rremë ose të pasaktë të pasurive të saj, dhe se asnjë gjetje e tillë nuk ishte bërë në përfundim të hetimit administrativ.

47. KPK-ja kishte luajtur një rol aktiv në mbledhjen e fakteve, provave dhe informacionit, duke tejkaluar rolin standard të një gjykate, e cila zakonisht do të jepte një vendim pasi të dëgjonte të gjitha argumentet e palëve. Më pas, ajo nuk kishte arritur të siguronte garancitë procedurale në procesin ndaj saj, të tilla si barazia e armëve. Komisioni kishte qenë selektiv në provat që kishte përdorur dhe mbështetur kundër saj dhe nuk kishte marrë parasysh analizën, provat dhe argumentet që ajo kishte paraqitur në përgjigje të gjetjeve të hetimit administrativ.

48. KPK-ja nuk ka kompetenca për të interpretuar deklaratat e mëparshme të pasurisë që ajo kishte depozituar në përputhje me ligjin për deklarimin e pasurive, të cilat ishin vlerësuar pozitivisht nga ILDKPKI-ja. Për këtë arsye, ajo argumentoi që KPK-ja kishte zbatuar në mënyrë retroaktive nenin 31 të ligjit nr. 84/2016 për deklaratën e pasurisë të vitit 2003.

49. KPK-ja kishte kaluar në mënyrë të paarsyeshme barrën e provës mbi të për fakte në lidhje me të cilat ajo nuk ishte e detyruar të paraqiste ndonjë dokument mbështetës. Për më tepër, nuk kishte marrë në konsideratë pamundësinë objektive që kërkesja të merrte të gjitha dokumentet mbështetëse të nevojshme për të vërtetuar burimin e të ardhurave të bashkëjetuesit të saj.

50. Së fundmi, KPK-ja nuk ishte shprehur se ajo posedonte më shumë se dyfishin e shumës së pasurive të saj të ligjshme, gjë që do të garantonte shkarkimin e saj nga detyra, në përputhje me nenin D, pika 4 e aneksit të Kushtetutës. Në fakt, pasuritë e saj kishin qenë sa gjysma e shumës së të ardhurave të saj të ligjshme.

b) Pretendimet në lidhje me gjetjet e gabuara në lidhje me kriteret e rivlerësimit

51. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², kërkesja parashtroi tri argumente. Së pari, ajo argumentoi që KPK-ja kishte keqinterpretuar ligjin duke barazuar nënshkrimin e një transaksioni ligjor (veprimi juridik) – duke iu referuar kontratave të sipërmarrjes të viteve 2003 dhe 2005 – me përfitimin e një “pasurie”. Ajo nuk kishte pasur asnjë detyrim për të deklaruar transaksionet ligjore, përfshirë kontratat e sipërmarrjes, të cilat nuk kishin kontribuar në përfitimin e një pasurie sipas ligjit për deklarimin e pasurive dhe ligjit nr. 84/2016.

52. Së dyti, ishte bashkëjetuesi i kërkeses që kishte kryer të gjitha transaksionet ligjore në vitet 2003 dhe 2005, dhe se kërkesja nuk kishte qenë palë në to. Ai kishte bërë deklarimin e pronave që kishte përfituar, përfshirë origjinën e të ardhurave të përdorura, në deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2005, pa asnjë fshehje të tyre. Ajo kishte deklaruar bashkëpronësinë e tyre në deklaratën e pasurive të vitit 2011, pasi bashkëjetuesi i saj kishte vendosur atë si pronare të përbashkët me pjesë takuese 50% të apartamentit në regjistrimin e asaj prone pranë autoriteteve. Në lidhje me këtë, ajo i bashkëlidhi ankimit të saj një vërtetim të lëshuar nga kompania shqiptare me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur një kontratë sipërmarrjeje në vitin 2003 dhe një vërtetim të lëshuar nga ish-punëdhënësi italian i bashkëjetuesit të saj, që vërtetonte se ai kishte punuar për të nga viti 1995 deri në vitin 2001.

53. Së treti, për sa i përket llogaritjes së shpenzimeve të jetesës së bashkëjetuesit të saj në Itali nga viti 1992 deri në qershor 1995, KPK-ja ishte mbështetur në shifra që korrespondojnë me periudhën 2002 deri më 2004, kur kostoja e jetesës ishte rritur si rezultat i inflacionit të shkaktuar nga zëvendësimi i liritës italiane me euron. Për më tepër, bashkëjetuesi i saj ishte punësuar në mënyrë të ligjshme nga korriku 1995 deri në korrik 2000, siç dëshmohet nga kopjet e kontratës së tij të punësimit dhe disa mandatpagesa. Sipas një vlerësimi empirik të të ardhurave dhe shpenzimeve të bashkëjetuesit të saj, ai kishte kursyer 3,444,871.32 lekë (27,586 euro), gjë që justifikon blerjen e banesës në vitin 2003.

54. Sa u përket likuiditeteve, KPK-ja nuk e kishte marrë parasysh faktin se shpenzimet e disa udhëtimeve për qëllime pune ishin përballuar nga punëdhënësi i saj ose institucionet pritëse ose që shpenzimet e disa udhëtimeve personale ishin përballuar nga familjet pritëse. Ai ia kishte atribuuar asaj

padrejtësisht të gjitha ato shpenzime. Duke bërë vlerësimin e saj për vitet 2007, 2009 dhe 2015, ajo argumentoi se ajo kishte pasur të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha shpenzimet e nevojshme.

55. Në lidhje me denoncimin e bërë nga një individ, kërkesja parashtrroi që personi përkatës kishte bërë një denoncim penal në prokurori kundër dy individëve privatë, duke pretenduar falsifikimin e dokumenteve zyrtare. Pas procedimit penal nga Prokuroria, në të cilin ky individ nuk kishte qenë palë, në vitin 2011 një trupë e Gjykatës së Apelit, anëtar i së cilës ishte dhe babai i saj, kishte vendosur që ndjekja penale e këtyre personave ishte parashkruar dhe nuk kishte shqyrtuar çështjen në themel.

56. Procesi kushtetues, i shqyrtuar nga një trupë e Gjykatës Kushtetuese, anëtare e së cilës kishte qenë dhe kërkesja, kishte të bënte me një kërkesë të paraqitur nga i njëjti individ në lidhje me rezultatet e një sërë procesesh civile në lidhje me pavlefshmërinë e një kontrate shitblerjeje të lidhur midis atij personi dhe një personi juridik në vitin 1999. Meqenëse procesi kushtetues nuk kishte asnjë lidhje me procesin penal, ajo nuk ishte në konflikt interesi dhe në këtë mënyrë nuk mund të jetë subjekti i konstatimit se ajo kishte minuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, siç përcaktohet në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

57. Në kontekstin e argumenteve të mësipërme, kërkesja u shpreh që shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë joproporcional dhe se procesi para KPK-së ishte kryer në shkelje të parimeve të ligjshmërisë, drejtësisë, paanësisë, barazisë para ligjit dhe proporcionalitetit.

2. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

58. Më datë 16 korrik 2018, u hodh shorti për përbërjen e trupës prej pesë anëtarësh të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, për këtë, u njoftua përkatësisht kërkesja. Më pas, ajo u informua se ankimi i saj do të shqyrtohej në dhomë këshillimi më datë 24 tetor 2018.

59. Më 24 tetor 2018, Kolegji dha vendimin e tij, duke shqyrtuar procedurën e zbatueshme, si dhe shkaqet e ankimit të kërkeses. Ajo u njoftua për vendimin më datë 23 nëntor 2018.

a) Gjetjet paraprake

60. Sipas një vlerësimi të përgjithshëm, Kolegji konfirmoi se procedimi para saj u bazua në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenet 47, 49 dhe 51 të ligjit për gjykatat administrative (*shih paragrafët 153 dhe 194–196 më poshtë*). Në përputhje me nenet 47 dhe 49, pika 2 e ligjit për gjykatat administrative, Kolegji nuk pranoi marrjen e provave të reja të paraqitura nga kërkesja. Kolegji arsyetoi se ajo nuk kishte paraqitur ndonjë shkak për pamundësinë e saj për të paraqitur provat e reja pranë KPK-së. Gjithashtu, Kolegji nuk pranoi të merrte prova të tjera të paraqitura më 15 tetor 2018, në përputhje me nenin 49, pika 6/a e ligjit nr. 84/2016 (*shih paragrafin 146 më poshtë*). Kolegji vendosi të mos pranojë denoncime shtesë të bëra nga anëtarë të tjerë të publikut pas vendimit të KPK-së, pasi nuk kishte shkaqe për hetim.

61. Edhe pse kërkesja nuk kishte kërkuar në ankim mbajtjen e një seance publike, Kolegji konsideroi se nuk ishte e nevojshme të mbahej një e tillë, pasi: i. KPK-ja kishte bërë një vlerësim të saktë dhe gjithëpërfshirës të fakteve; ii. nuk kishte asnjë nevojë për të pranuar prova të reja ose për të vlerësuar fakte të reja; iii. KPK-ja nuk kishte bërë ndonjë shkelje serioze procedurale ose deklarim të gabuar ose jo të plotë të fakteve; dhe iv. nuk kishte nevojë për të rishqyrtuar provat që ishin pranuar nga KPK-ja.

62. Kolegji sqaroi se, bazuar në nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në nenin Ç, pika 4 dhe nenin D të aneksit të Kushtetutës, organet e vlerësimit kishin kompetenca për të vlerësuar deklaratat e pasurive të një individi të bëra që nga viti 2003, me qëllim verifikimin nëse personi që i nënshtrohet procesit të rivlerësimit zotëron më shumë pasuri sesa ai ose ajo mund të posedonte ligjërisht ose nëse personi kishte bërë deklarim të saktë dhe të plotë të pasurive të tij dhe të personave të tjerë të lidhur me të. Meqenëse dispozitat ligjore u kishin dhënë një vlerë provuese deklaratave periodike të pasurive, ato mund të konsiderohen se kanë të njëjtën rëndësi si deklaratat e pasurisë së rivlerësimit. KPK-ja dhe Kolegji do t'i konsiderojnë këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, në tërësi, në mënyrë që të përcaktojnë rrethanat e çështjes dhe të marrin një vendim të drejtë. KPK-ja, gjithashtu, do të shqyrtojë raportin e hartuar nga ILDKPKI-ja për të përcaktuar provueshmërinë dhe

vërtetësinë e tij.

63. Kolegji sqaroi më tej se, pas mbylljes së hetimit administrativ, KPK-ja kishte informuar kërkuesen për gjetjet paraprake në lidhje me secilën pasuri dhe ia kishte kaluar asaj barrën e provës. Konstatimet përfundimtare në lidhje me fshehjen ose deklarimin e pasaktë të pasurive duhej të bëheshin pasi subjekti i rivlerësimit të kishte paraqitur argumente dhe prova në mbrojtjen e tij ose të saj. Në lidhje me këtë, subjektit të rivlerësimit i kërkohet të demonstronte bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të tij ose të saj dhe të mos fshehtë ose të deklaronte në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedimin ose në përdorim të tij apo saj. Procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese (dhe asnjëherë një proces penal), që ka për qëllim të japë të gjitha garancitë për një proces të rregullt ligjor.

64. Në rastin e kërkueses, Kolegji i Posaçëm i Apelit vuri në dukje se përfundimi i hetimit administrativ kishte të bënte vetëm me gjetjet paraprake të bëra nga KPK-ja, në mungesë të ndonjë argumenti të parashtruar nga kërkuesja. KPK-ja e kishte informuar atë për gjetjet e saj dhe e kishte ftuar të paraqiste argumente dhe prova për të kundërtën, në vijim të të cilave kishte vazhduar hetimin. KPK-ja kishte shtyrë seancën publike të datës 25 prill 2018, në mënyrë që të shqyrtonte plotësisht parashtrirat shtesë me shkrim që ajo kishte paraqitur në të njëjtën datë, si dhe provat e tjera mbështetëse që ajo i kishte vënë në dispozicion më datë 18 prill 2018. Këto veprime garantuan të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt. KPK-ja nuk mund të merrte një vendim në lidhje me fshehjen ose deklarimin të rremë të pasurive gjatë hetimit administrativ, për aq kohë sa procesi ishte ende në vijim, ishte caktuar një seancë publike dhe kërkuesja kishte të drejtën të paraqiste prova dhe parashtrime. Sikur ta kishte bërë këtë, KPK-ja do të kishte paragjykuar rezultatin e çështjes pas kalimit të barrës së provës të kërkuesja, e cila ishte ftuar të paraqiste prova për të kundërtën.

65. Kolegji konsideroi se KPK-ja e kishte shkarkuar nga detyra kërkuesen për deklarim të pamjaftueshëm të pasurive dhe për faktin se ajo, pas shqyrtimit të përgjithshëm të procedurave, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Ajo nuk e ka shkarkuar subjektin e rivlerësimit për efekt të kalimit të dyfishtë të pasurisë së ligjshme. Për më shumë, fakti që ajo kishte marrë një vlerësim pozitiv për figurën nuk e vuri në pikëpyetje papërshtatshmërinë e deklarimit të rremë, të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurive që ajo kishte bërë. Neni 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 nuk kërkonte që të dyja këto kritere të vlerësoheshin negativisht, pasi secili prej tyre përbënte një shkak të veçantë për shkarkimin nga detyra.

66. Së fundmi, ai konstatoi se KPK-ja i kishte siguruar kërkueses të drejtën për t'u njohur me dokumentet e mbledhura gjatë hetimit administrativ; Çështja e saj ishte dëgjuar publikisht brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. KPK-ja kishte marrë vendimin pasi kishte marrë argumentet, dokumentet dhe provat e kërkueses. Për këtë arsye, ishte respektuar e drejta e saj për një proces të rregullt ligjor.

b) Gjetjet në lidhje me vlerësimin e pasurisë

i. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m²

67. Kolegji përcaktoi që me anë të kontratave të sipërmarrjes, kërkuesja kishte përfutur të drejta *in rem* (të drejta reale) në apartamentin objekt të kontratës. Legjislacioni i brendshëm parashikon që lidhja e një kontrate ligjore është një mënyrë për të fituar një pronë ose të drejta *in rem*. KPK-ja kishte arritur në përfundim të saktë, pas një shqyrtimi të dokumenteve në dosjen e çështjes, se kontratat e sipërmarrjes të viteve 2003 dhe 2005 kishin të bënin me transferimin e të drejtave *in rem* në një apartament që do të ndërtohej në të ardhmen kundërt pagimit të një çmimi. Kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj, të cilët kishin nënshkruar të dyja kontratat e sipërmarrjes të vitit 2003 dhe 2005 që kishin specifikuar objektin dhe çmimin të paguar më pas, me nënshkrimin e saj kishin fituar të drejta *in rem*. Prandaj, kërkuesja duhet të kishte deklaruar përfitim të kësaj pasurie të veçantë në kohën e duhur, domethënë, në deklaratën e pasurisë të vitit 2005, në vend që të priste ta deklaronte atë në deklaratën e pasurisë 2011, pasi bashkëjetuesi i saj e kishte regjistruar edhe atë si pronar të përbashkët me 50% të pjesës takuese të apartamentit.

68. Pas një vlerësimi të dokumentacionit të dosjes së çështjes, të tilla si fatura bankare, vërtetime pagash dhe pagesa në lidhje me bursën në Itali, Kolegji konstatoi se bashkëjetuesi i saj nuk ka provuar bindshëm ligjshmërinë e të ardhurave për periudhën 1992 deri 2000 për blerjen e banesës në vitin 2003. KPK-ja nuk kishte gabuar në përllogaritjen e shpenzimeve të bashkëjetuesit të saj gjatë kohës që ishte student në Itali.

69. Në lidhje me të ardhurat e bashkëjetuesit të kërkueses nga punësimi i tij në Itali gjatë periudhës 1995–2000, kërkuesja nuk kishte paraqitur dokumente të mjaftueshme mbështetëse ose prova të tjera për të justifikuar që të ardhurat ishin të ligjshme, domethënë, i ishin nënshtruar pagimit të taksave, pasi bashkëjetuesi i saj kishte punuar në tregun e zi. Nuk kishte asnjë informacion se si të ardhurat ishin transferuar në Shqipëri dhe kërkuesja nuk ndodhej në kushtet e pamundësisë objektive, e cila mund të justifikonte dëmtimin ose humbjen e dokumenteve mbështetëse që provojnë ekzistencën e të ardhurave të ligjshme. Deklarimet e kërkueses, sa i takon burimit të të ardhurave, *mbeten në nivel deklarativ dhe nuk justifikohet ligjshmëria e tyre.*

70. Së fundmi, duke marrë parasysh deklaratat e bëra nga bashkëjetuesi i kërkueses dhe duke marrë parasysh të gjitha të ardhurat që ai mund të kishte fituar gjatë qëndrimit të tij në Itali, kursimet e tij nuk mund të ishin të mjaftueshme për të blerë apartamentin. As kërkuesja nuk kishte mjete të mjaftueshme financiare në vitin 2003 për blerjen e apartamentit. Ajo nuk kishte parashtruar ndonjë argument që kundërshtonte vërtetësinë e kontratës së sipërmarrjes të vitit 2003 ose pagesën e shumës së treguar në të.

71. Kolegji arriti në përfundimin se kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin pasur fonde të mjaftueshme për të blerë apartamentin me sipërfaqe 101 m² me të ardhura të ligjshme, siç deklarohet prej tyre. Prandaj, kërkuesja kishte bërë një deklaram të rremë dhe kishte fshehur pasurinë.

ii. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 58.75 m²

72. Kolegji konstatoi se, duke pasur parasysh situatën financiare të kërkueses, siç është evidentuar në deklaratën e pasurisë të vitit 2009, ajo kishte të ardhura të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie. Kolegji konstatoi se konstatimi i KPK-së sa i takon kësaj pasurie nuk është i saktë.

iii. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 221.9 m²

73. Kolegji konstatoi se kërkuesja nuk mund të fajësohej për përfitimin nga rregullimi i një trualli më të madh ku çmimi dhe madhësia e tij ishin të përcaktuar nga autoritetet publike në vitin 2013, kur në fakt ajo kishte kërkuar që e drejta e saj mbi pronën të rregullohej në kuadër të një trualli më të vogël. Kjo gjetje e KPK-së është e pabazuar.

iv. Në lidhje me situatën financiare

74. Kolegji theksoi se kërkuesja nuk kishte ankimuar në KPK metodologjinë e aplikuar prej tij për përcaktimin e situatës financiare. Ajo nuk kishte parashtruar ndonjë argument ku kundërshton përllogaritjen e shpenzimeve të jetesës.

75. Kolegji mbështeti vendimin e KPK-së për mospranimin e deklaratës noteriale të hartuar jashtë vendit, pasi kjo deklaratë nuk përmban elementet për t'u konsideruar e vlefshme sipas legjislacionit të brendshëm dhe e përdorur gjatë procesit. Sa u takon disa prej shpenzimeve për udhëtime, Kolegji konstatoi se kërkuesja nuk ka paraqitur dokumente mbështetëse bindëse për të provuar ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të përdorura për të mbuluar këto shpenzime. Sa u takon shpenzimeve të tjera të udhëtimit, Kolegji u shpreh se KPK-ja nuk i ka marrë ato në konsideratë në llogaritjen e shpenzimeve të bëra nga kërkuesja. Sa i takon shumës në *cash* (15,000 euro), të cilën bashkëjetuesi i saj nuk e kishte deklaruar ndër vite, Kolegji konstatoi se ai kishte vepruar në kundërshtim të detyrimeve ligjore.

76. Kolegji kreu një rivlerësim të pasurive të kërkueses dhe të bashkëjetuesit të saj dhe të detyrimeve për vitet 2007, 2009, 2015 dhe 2016, ku rezultati ishte i ndryshëm si me atë të KPK-së, ashtu edhe me atë në parashtrimet e kërkueses. Përsëri u konstatua se kërkuesja nuk kishte të ardhura të ligjshme për të justifikuar likuiditetet e saj në shumën totale prej 1,288,258.27 lekësh (afërsisht 10,277 euro krahasuar, gjithashtu, me konstatimin e KPK-së në paragrafin 31 më lart).

77. Kolegji iu referua ekzistencës së dy llogarive bankare që posedonte kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj gjatë viteve 2015 dhe 2016 (*shih paragrafin 11 lart*), duke deklaruar se nuk ishte e qartë se si paratë ishin depozituar ose transferuar, pasi ajo nuk i kishte deklaruar llogaritë në deklaratat vjetore të pasurive. Kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj nuk kishin deklaruar se si i kishin hapur ato llogari dhe se si i kishin kryer transaksionet financiare.

78. Kolegji doli në përfundimin, se: “kërkuesja nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të këtyre shumave monetare, përpiqet të fshehtë dhe të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në likuiditete, si dhe ajo vetë dhe personi i lidhur me të nuk kanë justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave për këto shuma monetare”.

iv. Në lidhje me kredinë hipotekare prej 40,000 US dollarë

79. Kolegji konstatoi se kredia ishte paguar për qëllimin që ishte marrë dhe se gjetja e KPK-së në këtë drejtim nuk ishte e bazuar.

v. Në lidhje me truallin me sipërfaqe 666 m²

80. Kolegji mbajti të njëjtin qëndrim, si dhe KPK-ja se kërkuesja kishte bërë deklaram të pasaktë në deklaratën e vitit 2003 sa i takon pjesës së saj takuese në truallin me sipërfaqe 666 m², e cila i përkiste vetëm nënës së saj.

vi. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 89.16 m²

81. Kolegji u shpreh se sa i takon apartamentit me sipërfaqe 89.16 m², kemi të bëjmë me një deklaram të pasaktë në deklaratën e dorëzuar nga kërkuesja në vend të një deklarimi të rremë, siç u shpreh KPK-ja në gjetjen e saj.

c) Gjetjet në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale

82. Kolegji mbajti të njëjtin qëndrim me KPK-në se, sipas një denoncimi nga një anëtar i publikut, kërkuesja nuk hoqi dorë nga procesi në Gjykatën Kushtetuese. Sipas vendimit të KPA-së, kërkuesja, në cilësinë e anëtares së trupës së Gjykatës Kushtetuese kishte shqyrtuar një ankim të paraqitur nga një individ në kundërshtim me ligjin e proceseve civile në lidhje me vlefshmërinë e një kontrate shitblerjeje të lidhur ndërmjet një personi publik me një subjekt ligjor. Anëtari i publikut kishte vënë në dispozicion të Gjykatës Kushtetuese një vendim të dhënë në vitin 2011 nga një trup gjykues i Gjykatës së Apelit Tiranë, në të cilin babai i kërkueses kishte qenë relator, i cili kishte vendosur që procedimi penal ndaj dy individëve, të cilët ishin dënuar nga gjykata e shkallës së parë për falsifikim të një vendimi administrativ pronësie, ishte parashkruar.

83. Ndërsa në shikim të parë kishte dy grupe të veçanta procesesh, njëri penal dhe tjetri civil, palët ishin pothuajse të njëjta, por në pozicione të ndryshme procedurale. Lënda e të dy grupeve të proceseve duket të jetë e ndryshme; megjithatë, shkaku kryesor i saj ishte privatizimi i një ndërtese dhe vlefshmëria e titullit të pronësisë së një trualli, në lidhje me të cilën ishte ngritur procesi penal kundër disa individëve dhe më pas ai u deklarua i parashkruar. Kërkuesja nuk kishte hequr dorë nga shqyrtimi i ankesës kushtetuese, edhe pse një kopje e vendimit të dhënë nga Gjykata e Apelit, në përbërjen e të cilit babai i kërkueses kishte qenë relator, ishte përfshirë në dosjen e çështjes së Gjykatës Kushtetuese. Dështimi i kërkueses për të hequr dorë nga procesi nuk kishte respektuar parimin e paanësisë dhe kishte ngritur dyshime në lidhje me testin objektiv, si rezultat i të cilit besimi i publikut në sistemin e drejtësisë ishte cenuar. Sipas këndvështrimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, përjashtimi i kërkueses nuk do të kishte penguar shqyrtimin e ankesës kushtetuese nga një kuorum i Gjykatës Kushtetuese, siç kërkohet nga ligji.

d) Përfundim

84. Kolegji la në fuqi vendimin e KPK-së për shkarkimin nga detyra të kërkueses.

e) Mendimi i veçantë

85. Një gjyqtare e KPA-së (I.R.) doli me një mendim të veçantë (*mendim paralel*), i cili nuk ndikoi me votën e saj në favor të shkarkimit të kërkueses nga detyra. Ajo iu referua kryesisht gjetjeve në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m². Sipas këndvështrimit të saj, kontratat e sipërmarrjes, të cilat nuk ishin kontestuar nga kërkuesja, përbënin prova të forta se ajo pasuri nuk ishte fituar vetëm

me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj. Si rezultat, kërkuësja ishte përpjekur të bënte deklaram të pasaktë të pasurive dhe deklarim të rremë të burimit të përdorur për krijimin e tyre.

86. Për sa i përket situatës financiare të kërkuësës, mendimi paralel shprehet se Kolegji nuk kishte marrë në shqyrtim një sërë parashtrimesh të saj në lidhje me disa shpenzime udhëtimesh që ajo kishte bërë gjatë viteve. Ato shpenzime, të cilat nuk ishin përballuar nga kërkuësja dhe për të cilat ajo kishte paraqitur prova, i ishin atribuar gabimisht asaj. Ato shpenzime duheshin zbritur nga shuma totale e përcaktuar nga Kolegji (*shih paragrafin 76 më lart*), dhe shuma që rezultoi do të ishte 478,392 lekë (afërsisht 3,849 euro) ose më pak. Si pasojë, në pikëpamje të vlerës relativisht të ulët dhe të përvojës së gjatë profesionale të kërkuësës, argumenti në lidhje me mungesën e të ardhurave për të justifikuar likuiditetet e saj nuk mund të përbënte një *premisë të qëndrueshme* për ta konsideruar atë si një shkak për shkarkimin nga detyra, sipas kuptimit të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 61, pika 3 dhe 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

87. Opinioni i veçantë pranoi riklasifikimin e Kolegjit si “deklarim i pasaktë” për truallin me sipërfaqe 666 m² dhe apartamentin me sipërfaqe 89,16 m². Sidoqoftë, ajo nuk konsideroi që ato gjetje, të cilat kishin të bënin me deklaratat e pasurisë të viteve 2003 dhe 2004, ishin të mjaftueshme për të krijuar baza për shkarkimin e kërkuësës nga detyra, për aq sa ajo nuk kishte pasur qëllim për të fshehur pasurinë ose për të bërë një deklaram të rremë.

88. Mendimi paralel nuk i pranoi gjetjet e Kolegjit në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuësës. Pas analizimit të nenit 36, pika 1, germa “c” e ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, mendimi paralel argumentoi se, duke pasur parasysh natyrën e veçantë të proceseve para Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte qëllim të shqyrtonte vetëm mungesën e paanësisë në një sërë procedimesh civile dhe jo zbatimin e së drejtës materiale, ligji vendës nuk parashikonte një situatë si ajo në fjalë, në të cilën kërkuësi kishte pasur një konflikt interesi në lidhje me proceset penale në të cilat babai i saj kishte qenë relator i çështjes ku në fund ishte vendosur që procedurat penale ishin parashkruar. Ky individ nuk kishte ngritur ndonjë ankim në lidhje me pjesëmarrjen e kërkuësës në trupën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese. Asnjë interes privat, që i përkiste kërkuësës ose babait të saj, nuk ishte prekur si rezultat i proceseve kushtetuese në të cilat kërkuësja kishte qenë anëtare e trupës së Gjykatës Kushtetuese.

89. Në këndvështrim të arsytimit se nuk kishte pasur konflikt interesi, mendimi paralel konsideroi se përfundimi se besimi i publikut në sistemin e drejtësisë ishte cenuar, ishte i pabazuar. Mendimi paralel vazhdoi më tutje se “fakti që një palë në një sërë procesesh është e pakënaqur, e zhgënjyer ose ka mosbesim nga një vendim i dhënë nga një trupë gjyqësore në të cilën kërkuësja ishte anëtare, nuk përbën domosdoshmërisht një element të mjaftueshëm për ta marrë atë si minimin e besimit të publikut, i cili... duhet të përfshijë një numër të madh individësh të cilët nuk duhet të bien në kategorinë e palëve në atë grup procesesh...”.

C. Ngjarjet pas komunikimit të çështjes

90. Më datë 16 korrik 2020, kërkuësja informoi Gjykatën se kundër L.D. ishte nisur një procedurë penale për falsifikim të dokumenteve për fshehjen e informacionit të rëndësishëm gjatë procesit që çoi në emërimin e tij si anëtar i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. L.D. ishte anëtar i trupës së Kolegjit që kishte shqyrtuar ankimin e kërkuësës.

91. Më datë 24 korrik 2020, pas procedimit penal ndaj L.D., Kolegji urdhëroi pezullimin e tij nga detyra⁶².

92. Ndërkohë, duket se më datë 1 dhjetor 2020⁶³, GJKKO-ja shpalli fajtor L.D. për falsifikim dokumentesh dhe e dënoi atë me 6 muaj burgim, të konvertuar në 12 muaj dënim me kusht. Është raportuar se L.D. ka ankimuar këtë vendim.

⁶² Marrë nga faqja e KPA-së: <http://kpa.al/wp-content/uploads/2020/07/vendim-nr.14.2020.pdf>

⁶³ Siç raportohet dhe publikohet nga media lokale

KUADRI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE LIGJORE

I. MATERIALET E BRENDSHME

A. Kushtetuta

93. Në zbatim të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, qëllimi i parlamentit ishte miratimi i ndryshimeve kushtetuese, të cilat do të mbulonin disa fusha, përfshirë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (“vetingu”).

1. *Opinionit i Komisionit të Venecias*

94. Pas një kërkesë për një mendim mbi përputhshmërinë e draftndryshimeve kushtetuese me standardet ndërkombëtare, nga kryetari i Komisionit Parlamentar *ad hoc*, më datë 14 mars 2016, Komisioni Evropian për Demokraci përmes ligjit (Komisioni i Venecias) miratoi një opinion përfundimtar mbi draftin e ndryshuar të ndryshimeve kushtetuese (opinionit nr. 824/2015 – CDL-AD (2016) 009), pas një opinionit të ndërmjetëm më 21 dhjetor 2015 (CDL-AD (2015) 045).

95. Komisioni i Venecias e konsideroi të përshtatshme strukturën institucionale të propozuar për kryerjen e procesit të rivlerësimit, duke theksuar se u takonte ligjvënësve kombëtarë të hartonin kontrolle dhe ekuilibra, pasi një sistem i prekur nga korrupsioni i përhapur gjerësisht mund të ketë nevojë për më shumë mekanizma të kontrollit të jashtëm sesa një sistem më i shëndetshëm. Komisioni i Venecias konstatoi se projektndryshimet kushtetuese ishin në përgjithësi koherente dhe të pajtueshme me standardet evropiane, pasi ato përmbanin propozime të shëndosha për modelin e ardhshëm institucional të gjyqësorit shqiptar.

96. Në lidhje me masat e jashtëzakonshme për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, Komisioni i Venecias mbeti i mendimit se masa të tilla “[ishin] jo vetëm të justifikuara, por [ishin] të nevojshme që Shqipëria të mbrohej nga përhapja e korrupsionit e cila, nëse nuk adresohet, mund të shkatërronte plotësisht sistemin gjyqësor.” Komisioni i Venecias bëri vërejtje të përgjithshme në lidhje me mandatin e anëtarëve të KPK-së dhe KPA-së. Afati i propozuar prej nëntë vjetësh, pa të drejtë rrimërimi, ishte i gjatë, duke marrë parasysh se rivlerësimi ishte “një masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme” dhe se i gjithë procesi i rivlerësimit “supozohet të zgjaste 11 vjet ose më pak nëse Shqipëria i bashkohej Bashkimit Evropian në një datë më të hershme”. Komisioni i Venecias deklaroi më tej se strukturat e rivlerësimit nuk duhet të zëvendësojnë organet e zakonshme kushtetuese; ndërkohë që ato mund të bashkëtojnë me ta për ca kohë, ato nuk duhet të shndërrohen në mekanizma paralelë pothuajse të përhershëm. Pas përmbylljes së punës së organeve të vetingut, institucionet dhe gjykatat e zakonshme mund të marrin çdo funksion të mbetur për proceset e rivlerësimit që nuk ishin përfunduar ende.

97. Komisioni i Venecias përshëndeti krijimin e një institucioni të veçantë apelimi, përkatësisht Kolegjit, i cili ishte në përputhje me rekomandimin e tij në opinionin e ndërmjetëm. Ai deklaroi si më poshtë:

“Ky organ është padyshim një lloj gjykate e specializuar, e cila nuk është një gjykatë e jashtëzakonshme *ad hoc* – sepse nuk është krijuar në funksion të një çështjeje të veçantë – dhe supozohet të qëndrojë funksional gjatë gjithë kohëzgjatjes së [procesit] të rivlerësimit”.

98. Ndërkohë që Kolegji u bë një institucion qartazi i ndryshëm nga KPK-ja, Komisioni i Venecias rekomandoi, ndër të tjera, që gjyqtarët e Kolegjit të ishin në gjendje të integroheshin automatikisht në gjyqësor në fund të mandatit të tyre.

99. Në opinionin e ndërmjetëm, Komisioni i Venecias ka theksuar:

“në masën që ... rivlerësimi është një masë e përgjithshme, e zbatuar në mënyrë të barabartë për të gjithë gjyqtarët, e vendosur në nivelin kushtetues, dhe e shoqëruar nga disa masa mbrojtëse procedurale dhe që nuk lidhen me ndonjë çështje specifike që një gjyqtar mund të ketë përpara tij, Komisioni i Venecias nuk sheh se si kjo masë mund të interpretohet që ajo ndikon në pavarësinë e gjyqtarit në një masë që nuk përputhet me nenin 6 [të Konventës]. Megjithatë, kjo nuk përjashton mundësinë që procesi i rivlerësimit mund të abuzojë në një rast të veçantë për të favorizuar pozicionin e një gjyqtari në një çështje të caktuar: nëse pretendime të tilla provoheshin, kjo mund të kërkonte rihapjen e asaj çështjeje pasi gjyqtari nuk do të ishte një ‘gjykatë e pavarur’.”

2. Raporti i Komisioni Parlamentar ad hoc mbi projektamendamentet kushtetuese⁶⁴

100. Komisioni parlamentar *ad hoc* theksoi se ndryshimet e propozuara kushtetuese mbi rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve përbënin një nga masat për të arritur profesionalizmin dhe për ta bërë sistemin e drejtësisë imun nga ndikimet e interesave politikë, praktikat korruptive dhe krimi i organizuar.

3. Mbi ndryshimet kushtetuese

101. Më datë 22 korrik 2016, parlamenti miratoi njëzëri një sërë ndryshimesh kushtetuese (ligji nr. 76/2016). Me rëndësi për çështjen aktuale janë neni 179/b i Kushtetutës dhe aneksi i Kushtetutës.

a) Neni 179/b i Kushtetutës

102. Neni 179/b parashikon krijimin e një sistemi rivlerësimi të të gjithë gjyqtarëve, përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, si dhe të të gjithë prokurorëve, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, me synimin për të “garantuar funksionimin e rregullit të ligjit, pavarësinë e sistemit të drejtësisë dhe rivendosjen e besimit të publikut në institucionet [e atij sistemi]”. Këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë duhet t’i nënshtrohen automatikisht rivlerësimit kalimtar. Dështimi për të kaluar procesin e rivlerësimit do të përbëjë një arsye për mbarimin e menjëhershëm të ushtrimit të detyrës, përveç shkaqeve të parashikuara në Kushtetutë. Gjyqtarët dhe prokurorët që kalojnë procesin e rivlerësimit do të qëndrojnë në detyrë ose do të emërohen gjyqtarë ose prokurorë, sipas rastit.

103. Sipas nenit 179/b, rivlerësimi duhet të kryhet nga një Komision i Pavarur i Kualifikimit (KPK) në shkallë të parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit (KPA), i bashkëngjitur si një kolegji i veçantë i Gjykatës Kushtetuese, i cili do të shqyrtojë ankimet ndaj vendimeve të KPK-së. Si KPK-ja, ashtu edhe KPA-ja do të jenë të pavarura dhe të paanshme. Anëtarët e KPK-së dhe komisionerët publikë, të cilët përfaqësojnë interesin publik, do të shërbejnë për një mandat pesëvjeçar, ndërsa mandati i anëtarëve të Kolegji i Apelimit do të jetë nëntë vjet.

b) Aneksi i Kushtetutës

104. Aneksi i Kushtetutës, i cili i kushtohet tërësisht rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, përbëhet nga dhjetë nene të emëruara sipas shkronjave të alfabetit shqiptar. Neni A parashikon që një numër i dispozitave kushtetuese, veçanërisht ato që lidhen me të drejtën për të respektuar jetën private dhe barrën e provës, do të kufizohen pjesërisht. Personat që kalojnë procesin e rivlerësimit do t’i nënshtrohen një sistemi të përhershëm llogaridhënieje, siç parashikohet në Kushtetutë dhe në statutet e tjera.

105. Neni B rregullon krijimin e një Operacioni Ndërkombëtar Monitorimi (ONM), i drejtuar nga Komisioni Evropian, për të mbështetur, monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e rivlerësimit. ONM-ja do të emërojë vëzhgues ndërkombëtarë pasi të ketë njoftuar Qeverinë. Vëzhguesit ndërkombëtarë do të kenë të drejtën të: i. japin rekomandime në parlament për kualifikimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve për pozicionin e anëtarëve të organeve të rivlerësimit ose pozicionin e komisionerit publik; ii. të bëjnë gjetje dhe të japin mendime mbi çështjet që merren në konsideratë nga organet e rivlerësimit; iii. t’i rekomandojnë komisionerit publik për të bërë një ankim kundër vendimit të KPK-së; dhe iv. të kenë qasje e të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për të monitoruar procesin e rivlerësimit në tërësinë e tij. Ata, gjithashtu, mund të kërkojnë nga organet e rivlerësimit që të marrin prova të reja ose mund të paraqesin prova të reja për shqyrtimin e tyre.

106. Neni C parashikon që KPK-ja do të përbëhet nga katër trupa, secila e përbërë nga tre anëtarë. Dy komisionerë publikë, të cilët do të përfaqësojnë interesin publik, mund të ankimojnë vendimin e KPK-së. Puna e KPK-së dhe e KPA-së do të drejtohet nga “parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional, të çliruar nga korrupsioni. Anëtarët e KPK-së dhe komisionerët publikë do të gëzojnë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe anëtarët e KPA-së statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit C, pika 4, anëtarët e

⁶⁴ E marrë nga faqja e Reformës në Drejtësi: <http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/relacion-shtesa-dhe-ndryshime-ne-ligjin-nr.-84172c-date-21.10.1998-kushtetura-e-r.sh-te-ndryshuar.pdf>

organeve të rivlerësimit dhe komisionerët publikë dhe anëtarët e stafit të tyre do të nënshkruajnë një autorizim duke iu nënshtruar një kontrolli vjetor të pasurive të tyre, monitorimit të rregullt të transaksioneve të tyre financiare dhe llogarive bankare dhe kufizimeve të së drejtës së tyre për konfidencialitet të komunikimeve gjatë mandatit të tyre.

107. Sipas nenit Ç, pika 1, rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Neni Ç, pika 2, parashikon që Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm Apelit publikojnë vendimet e tyre, si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm të marrë nga publiku. Këto organe marrin në shqyrtim informacione nga publiku duke respektuar parimin e proporcionalitetit midis privatësisë dhe nevojave të hetimit, si dhe duke garantuar të drejtën për një proces të rregullt. Komisioni ose Kolegji i Posaçëm Apelit, sipas rastit, përmes personelit të tyre, komisionerit publik ose vëzhguesit ndërkombëtar, shqyrton deklaratat e subjektit të rivlerësimit për të shkuarën e tij, interviston personat e përmendur në deklaratë ose persona të tjerë, si dhe bashkëpunon me institucione të tjera shtetërore ose të huaja për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve. Sipas nenit Ç, pika 5, në rrethana të caktuara, barra e provës i kalon subjektit të rivlerësimit vetëm për këtë proces, duke përjashtuar çdo proces tjetër, në veçanti procesin penal.

108. Neni D, i cili udhëheq vlerësimin e pasurive, citohet më poshtë.

Neni D – Vlerësimi i pasurive

“1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaratimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklaratimit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

109. Neni DH, pika 1, kërkon që subjektet e rivlerësimit të dorëzojnë një deklaratë dhe t'i nënshtrohen kontrollit të figurës, me qëllim “identifikimin e atyre që kanë kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar”. Kontrolli i figurës bazohet në deklaratën për figurën dhe prova të tjera, përfshirë vendimet e gjykatave shqiptare ose të huaja. Sipas nenit DH, pika 2, subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaratimit. Deklarata mund të përdoret si provë vetëm në këtë proces dhe në asnjë rast gjatë një procesi penal. Sipas nenit DH, pika 3, nëse subjekti i rivlerësimit rezulton se “ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën”. Neni DH, pika 4, parashikon që nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon në kohë deklaratën për figurën sipas ligjit, ai shkarkohet.

110. Neni E parashikon që subjektet e rivlerësimit t'i nënshtrohen rivlerësimit të aftësive profesionale, me qëllim identifikimin e atyre të cilët nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale që mund të korrigjohen përmes edukimit. Vlerësimi i aftësisë zhvillohet me ndihmën e nëpunësve që ushtrojnë detyrën e vlerësimit etik dhe

profesional të gjyqtarëve ose prokurorëve. Sipas nenit E, pika 3, në rast se rezulton që subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të cekëta, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij, atëherë kjo konsiderohet mangësi profesionale dhe zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të pezullimit, shoqëruar me detyrimin për të ndjekur programin e edukimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën. Sipas nenit E, pika 4, në rast se rezulton se subjekti i rivlerësimit ka njohuri, aftësi, gjykim ose sjellje të papërshtatshme, ose ka një mënyrë pune që nuk pajtohet me pozicionin e tij dhe mangësia e vërejtur nuk mund të korrigjohet përmes programit njëvjeçar të edukimit, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

111. Neni E, pika 1 parashikon që Komisioni ose Kolegji i Posaçëm Apelimt, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, vendos masat disiplinore, pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra për një vit, të shoqëruar me edukim të detyrueshëm, ose shkarkimin e tij nga detyra. Vendimi jepet i arsyetuar. Sipas nenit E, pika 3, shkarkimi i një gjyqtari ose prokurori nuk është shkak për rihapjen e çështjeve të gjykuara ose të hetuara prej tij, përveçse kur ekzistojnë shkaqet, mbi të cilat realizohet kërkesa për rishikim, sipas parashikimeve në ligjet procedurale.

112. Sipas nenit F, Kolegji i Posaçëm Apelimt përbëhet nga shtatë gjyqtarë dhe është organi i vetëm gjyqësor që shqyrton ankimet kundër vendimeve të Komisionit, sipas këtij aneksi dhe ligjit. Kolegji vendos në trupa gjyqese me nga pesë anëtarë. Sipas nenit F, pika 3, Kolegji mund të kërkojë mbledhjen e fakteve ose të provave, si dhe të korrigjojë çdo gabim procedural të kryer nga ana e Komisionit. Kolegji vendos në lidhje me çështjen dhe nuk mund t'ia kthejë atë Komisionit për rishqyrtim. Neni F, pika 7 parashikon që Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrezon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim të arsyetuar me shkrim.

113. Neni G parashikon që subjekti i rivlerësimit mund të dorëhiqet dhe, në këtë rast, procesi i rivlerësimit ndërpritet dhe subjekti “nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror ... për një periudhë 15-vjeçare”.

B. Ligji për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – “ligji i vetingut”)

114. Sipas nenit 179/b të Kushtetutës, më 30 gusht të vitit 2016, parlamenti miratoi ligjin nr. 84/2016, i cili, pas botimit në Fletoren Zyrtare, hyri në fuqi më 8 tetor 2016.

1. Raporti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar⁶⁵

115. Raporti i Komisionit të Posaçëm Parlamentar citonte se projektligji ishte i nevojshëm për rregullimin e detajuar të parashikimeve kushtetuese të nenit 179/b të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës. Projektligji përcaktoi parimet e organizimit të procesit për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, metodologjinë dhe procedurat standarde të rivlerësimit, si dhe rolin e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (“ONM”). Ai u hartua si pjesë e një grupi prej gjashtë ligjesh kyçe në lidhje me zbatimin e ndryshimeve kushtetuese.

116. Qëllimi kryesor i projektligjit ishte të garantonte funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të arrihej duke kryer rivlerësimin kalimtar të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, me synimin për krijimin e një sistemi drejtësie të pavarur, eficient, të besueshëm dhe të ndershëm, i cili do të funksiononte me integritet dhe pa ndikime të jashtme nga krimi i organizuar dhe politika.

2. Relacioni shpjegues⁶⁶

117. Relacioni i projektligjit citon se reforma në drejtësi, siç përshkruhet në raportin e vlerësimit, u nxit kryesisht nga nevoja për të adresuar problemet që kanë lindur nga shkalla e lartë e korrupsionit në sistemin e drejtësisë. Ekzistenca dhe niveli i korrupsionit në drejtësi nuk është më vetëm një çështje e perceptimit nga publiku, por edhe një fakt i pranuar nga vetë gjyqtarët, sipas të cilëve, sistemi i

⁶⁵ Marrë nga faqja zyrtare e Reformës në Drejtësi:

http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/raporti_i_komisionit_te_posacem_parlamentar.pdf

⁶⁶ Marrë nga faqja zyrtare e Reformës në Drejtësi:

<http://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/280616relacion-rivleresimi.pdf>

drejtësisë nuk është i çliruar nga influencat e jashtme. Arsye të tjera lidhen me nivelin e pakënaqshëm të cilësisë së punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe me mosfunksionimin efektiv të mekanizmave ekzistues për kontrollin e tyre, në rastet e shkeljeve të ligjit gjatë ushtrimit të detyrës, për vlerësimin e punës së tyre.

118. Qëllimi i projektligjit ishte përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe subjekteve të tjera që do të rivlerësoheshin sipas nenit 179/b të Kushtetutës. Ky proces do të shërbente për të vlerësuar përgatitjen e tyre profesionale, integritetin moral, si dhe për të zbuluar shkallën e pavarësisë në punën e tyre kundrejt ndikimit të krimit të organizuar, korrupsionit dhe pushtetit politik. Projektligji rregullonte parimet e organizimit dhe procedurat për rivlerësimin. Procesi i rivlerësimit do të kryhej me efektivitet, pa cenuar standardet e procesit të rregullt ligjor, me qëllim që rezultatet e këtij rivlerësimi të shërbenin për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur, që funksionon me eficiencë dhe me besueshmëri, që pasqyron standardet më të larta të ndershmërisë, integritetit, profesionalizmit dhe transparencës.

119. Nga natyra e tij, ai do të ishte një ligj të posaçëm me fuqi të përkohshme deri në përfundimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, të prokurorëve, si dhe të subjekteve të tjera të parashikuara nga Kushtetuta. Projektligji parashikonte ngritjen e një tërësie institucionesh për kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

3. Përmbledhje e ligjit nr. 84/2016

120. Neni 1 parashikon që qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është “përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit, për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi [...]”.

121. Neni 3 përmban disa përkufizime, nga të cilat, më poshtë janë cituar ato më me rëndësi për qëllim të këtij vendimi:

“Pasuri’ janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, ‘Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë – shih paragrafin 202 më poshtë’, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit;

‘Person i lidhur’ është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit;

‘Persona të tjerë të lidhur’ janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.”

a) Institucionet e rivlerësimit

122. Neni 5 detajon institucionet e përfshira në procesin e rivlerësimit, si: Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK-ja), Kolegji i Posaçëm i Apelit (KPA-ja), komisionerët publikë dhe Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit (ONM).

123. Neni 6 përcakton kriteret e zgjedhjes së anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit. Anëtar i institucioneve të rivlerësimit zgjidhet shtetasi shqiptar që plotëson, ndër të tjera kriteret, si: i. ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare (master i shkencave) për drejtësi; ii. të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor i së drejtës, nëpunës i shërbimit civil në nivel drejtues ose në një përvojë të njohur në fushën e së drejtës administrative ose sfera të tjera të së drejtës; iii. nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike ose nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit; iv. ndaj tij të mos ketë nisur një hetim penal, të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi, [apo] për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje [...]; v. ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit në momentin e

aplikimit; vi. nuk ka qenë gjyqtar, prokuror, këshilltar ligjor ose ndihmës ligjor gjatë dy viteve të fundit përpara kandidimit; dhe vii. zotëron shumë mirë gjuhën angleze.

124. Nenet 7 dhe 12 rregullojnë procedurën e aplikimit, përzgjedhjes paraprake, intervistimit dhe zgjedhjes së kandidatëve. Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit zgjidhen nga parlamenti.

125. Neni 4, pika 2, parashikon që Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Sipas nenit 4, pika 5, Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm Apelimit ushtrojnë funksionet e tyre si institucione të pavarura dhe të paanshme, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor. Sipas nenit 4, pika 6, kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin nr. 84/2016 nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. Neni 27 parashikon që anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi. Neni 28 parashikon që komunikimet e tyre elektronike dhe deklarimi i të ardhurave vjetore do të monitorohen sipas nënshkrimit të tyre për heqje dorë nga privatësia.

126. Neni 14 parashikon që Komisioni përbëhet prej dymbëdhjetë anëtarësh, të cilët i gjykojnë çështjet në trupa gjyquese të përbëra nga tre anëtarë secila. Shpërndarja e çështjeve në trupat gjyquese bëhet me short, ku përcaktohet edhe anëtari relator. Neni 15 parashikon që Kolegji i Posaçëm i Apelimit gjykon në trupa gjyquese të përbëra nga 5 gjyqtarë, të cilët caktohen me short për çdo çështje. Për çdo çështje caktohet një relator.

127. Neni 16 detajon shkaqet për përgjegjësi disiplinore për anëtarët e institucioneve të rivlerësimit, ndërsa neni 17 trajton procedurën për shkarkimin e tyre për shkak të një shkeljeje të pretenduar disiplinore. Vendimi në favor të masës disiplinore merret nga një trupë prej tre anëtarësh e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

128. Neni 18 parashikon që institucionet e rivlerësimit kanë diskrecion për vendimmarrje në lidhje me strukturën e tyre organizative dhe punësimin e personelit. Sipas nenit 19, ata propozojnë çdo vit projektbuxhetin e tyre pranë Kuvendit, i cili vendos në lidhje me të si pjesë integrale e buxhetit të shtetit. Neni 22 parashikon se pranë Komisionit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit funksionon Njësia e Shërbimit Ligjor që ushtron veprimtari ndihmëse në procesin vendimmarrës nga anëtarët e këtyre institucioneve.

b) ONM-ja

129. Sipas nenit 45, pika 2, vëzhguesit ndërkombëtarë, pjesë e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM-së), mund të kërkojnë informacion gjatë hetimit administrativ. Neni 50, pika 7 parashikon që ata, gjithashtu, kanë të drejtë të kërkojnë bashkëpunim ndërkombëtar brenda kuadrit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në rrugë diplomatike. Neni 33, pika 3 parashikon që ata kanë të drejtë të aksesojnë të gjithë informacionin në zotërim të ILDKPKI-së. Sipas nenit 50, ata kanë të njëjtat të drejta aksesimi në informacion me institucionet e rivlerësimit.

130. Bazuar në nenin 49, pika 10, vëzhguesi ndërkombëtar mund të depozitojë gjetje në institucionet e rivlerësimit, të cilat i pranojnë si prova. Gjetjet janë të barasvlershme me mendimin e dhënë nga një ekspert dhe mund të refuzohen me anë të një vendimi të arsyetuar. Një mendim me shkrim i dhënë nga vëzhguesit ndërkombëtarë mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes, por nuk ka vlerën e provës.

131. Neni 55 citon se vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore në KPK. Në bisedimet për marrjen e vendimit kërkohet prania e tyre dhe ata mund të shkruajë një mendim ndryshe/paralel që i bashkohet vendimit të KPK-së. Sipas nenit 65, pika 2, një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit mund t'i rekomandojë Komisionerit Publik të paraqesë një ankim kundër vendimit të Komisionit.

132. Neni 17 parashikon se vëzhguesit ndërkombëtarë mund, gjithashtu, të kërkojnë nisjen e hetimit disiplinor ndaj anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, përfshirë komisionerët publikë.

c) Kriteret e rivlerësimit

133. Sipas nenit 4, pika 1, procesi i rivlerësimit kryhet mbi bazën e tri kriterëve: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale. Neni 4, pika 2 parashikon se vendimi merret bazuar në “një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve (ose në vlerësimin tërësor të procedurave)”.

134. Subjekteve të rivlerësimit u kërkohet të depozitojnë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016, deklarin e pasurisë sipas aneksit 2 të këtij ligji, deklaratën e kontrollit të figurës sipas aneksit 3 të ligjit dhe formularin e vetëvlerësimit profesional sipas aneksit 4 të ligjit. Deklarimi i pasurisë përfshin informacione në lidhje me pasuritë e subjektit dhe origjinën e tyre, një përshkrim të të ardhurave dhe detyrimeve të subjektit dhe një listë të personave të tjerë të lidhur. Deklarata e kontrollit të figurës përfshin informacione në lidhje me të dhënat personale të subjektit, historikun e adresave, arsimin dhe kualifikimet e tjera, historikun e punësimit dhe pyetjet rreth lidhjeve me krimin e organizuar. Formulari i vetëvlerësimit profesional përmban informacion rreth historikut të punësimit të subjektit dhe pyetjeve në lidhje me përshkrimin e detyrave të subjektit, statistikave e numrit të çështjeve të shqyrtuara, pjesëmarrjes në trajnime dhe kualifikimeve të marra.

i. Vlerësimi i pasurisë

135. Neni 30 parashikon që objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij. Sipas nenit 31, pika 1, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

136. Në nenin 32, citohet si më poshtë:

“1. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

2. Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t'i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...].

[...]

4. Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

5. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit.”

137. Neni 33 parashikon që ILDKPKI-ja është institucioni përgjegjës për verifikimin e deklarimit të pasurisë. Sipas nenit 33, pika 5, ILDKPKI-ja, në përfundim të kontrollit, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar dhe, sipas rastit, konstaton se: i. deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interes; ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. është kryer fshehje e pasurisë; iv. është kryer deklarim i rremë; v. subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

ii. Kontrolli i figurës

138. Neni 34 parashikon se objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Sipas nenit 35, pika 1, subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 bashkëngjitur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij dhe e dërgon atë pranë Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar.

139. Sipas nenit 36, pika 1, institucionet e rivlerësimit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Neni 36, pika 2 parashikon që Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune për kryerjen e kontrollit të figurës. Neni 36, pika 3 parashikon që DSIK-ja, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar.

140. Neni 38 parashikon se kontrolli i figurës zhvillohet bazuar në prova të sakta, në informacione konfidenciale, si dhe në informacione të tjera të disponueshme.

141. Sipas nenit 39, DSIK-ja i dorëzon një raport KPK-së, duke konstatuar: i. nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, dhe ii. nëse ka informacion në deklaramin e tij ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër.

iii. Vlerësimi i aftësisë profesionale

142. Neni 41, pika 1 kërkon që subjekti i rivlerësimit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, të dorëzojë pranë organit përgjegjës formularin vetëvlerësimit profesional. Neni 41, pika 3 parashikon se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale do të jetë 3 vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Megjithatë, neni 41, pika 4 shpreh se në varësi të disponueshmërisë së informacionit në lidhje me etikën dhe aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale mund të shtrihet nga 1 janari 2006 e në vazhdim.

143. Sipas nenit 43, vlerësimi i aftësive profesionale kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve. Neni 44 parashikon që pranë KPK-së paraqitet një relacion, relatori i të cilit propozon konstatimin e subjektit të rivlerësimit si i aftë, me mangësi, ose i papërshtatshëm.

d) Procedura e rivlerësimit

144. Sipas nenit 45, pika 1, anëtarët e Komisionit, gjyqtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Neni 45, pika 2 parashikon se ata mund të kërkojnë informacion nga çdo subjekt i së drejtës publike. Ata administrojnë dokumentet që vërtetojnë veprime, fakte, cilësi ose një situatë subjektive të nevojshme për realizimin e hetimit administrativ. Sipas nenit 46, ligji nr. 84/2016 i jep përparësi komunikimit me anë të postës elektronike në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

145. Neni 47 shpreh se të drejtat e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit rregullohen sipas përcaktimeve të neneve 35–40 dhe neneve 45–47 të Kodit të Procedurave Administrative. Sipas nenit 48, subjekti i rivlerësimit duhet të bashkëpunojë me institucionet e rivlerësimit, të cilat, në marrjen e vendimit, mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit.

146. Sipas nenit 49, pika 1, institucionet e rivlerësimit marrin dokumente ligjore, mbledhin deklaratat nga subjekti i rivlerësimit, nga dëshmitarët, ekspertët dhe publiku, si dhe dokumente të tjera shkresore për të përcaktuar faktet dhe rrethanat e çdo çështjeje. Neni 49, pika 6/(a) parashikon se institucionet e rivlerësimit mund të refuzojnë marrjen e provave të reja nëse, për shembull, marrja e provës është e panevojshme. Sipas nenit 49, pika 8, institucionet e rivlerësimit duhet të argumentojnë shkaqet e refuzimit të marrjes së provave të reja. Neni 51 parashikon se nëse subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, si dhe kur provat e disponueshme janë të paplota, institucionet e rivlerësimit mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë.

147. Neni 52 kërkon që institucionet e rivlerësimit të udhëhiqen nga parimi i objektivitetit dhe i proporcionalitetit. Nëse ata arrijnë në përfundimin se provat e marra gjatë hetimit administrativ kanë nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 45 të këtij ligji, subjekti i rivlerësimit ka barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

148. Sipas nenit 53, çdo person që vjen në dijeni të fakteve ose rrethanave që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit, ka të drejtë të informojë drejtpërdrejt institucionet e rivlerësimit, të cilat hetojnë mbi pretendimet e ngritura në lidhje me subjektin e rivlerësimit.

149. Neni 55 parashikon se pranë KPK-së mbahet një seancë dëgjimore. Anëtarët e KPK-së dhe vëzhguesi ndërkombëtar mund t'i drejtojnë pyetje subjektit të rivlerësimit.

e) Masat disiplinore

150. Në përfundim të procedurës së rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar, duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, duke e pezulluar atë nga detyra për një periudhë prej një viti me detyrimin për ndjekjen e një programi trajnimi nga Shkolla e Magjistraturës, apo duke e shkarkuar atë nga detyra.

151. Sipas nenit 61, shkarkimi nga detyra për subjektin e rivlerësimit jepet si masë disiplinore në rastet:

“1. Kur rezulton se ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të;

2. Kur rezulton me probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës;

3. Kur rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji;

4. Kur rezulton si i papërshtatshëm nga vlerësimi i aftësive profesionale;

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2, të këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit”.

f) E drejta për të ankimuar

152. Sipas nenit 63, të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit, në përputhje me ligjin për gjykatat administrative.

153. Neni 65, pika 1 shpreh se procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, 49, 51 dhe 55 të ligjit për gjykatat administrative. Neni 65, pika 3 parashikon se në rastin e ankimit nga Komisioneri Publik, Kolegji i Posaçëm i Apelit e gjykon çështjen në seancë publike.

154. Neni 66 parashikon se Kolegji i Posaçëm i Apelit, me anë të një vendimi të arsyetuar, mund të vendosë lënien në fuqi, ndryshimin apo prishjen e vendimit të KPK-së.

4. Procesi pranë Gjykatës Kushtetuese

155. Në muajin tetor të vitit 2016, pranë Gjykatës Kushtetuese u paraqit një kërkesë për shqyrtimin abstrakt të kushtetutshmërisë së ligjit nr. 84/2016. Kërkuesit, konkretisht anëtarët e parlamentit të partisë kryesore opozitare, pretendonin se ligji nr. 84/2016: i. cenonte parimet e ndarjes dhe balancës së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, pasi kishte zhvendosur kontrollin dhe hetimin e procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve, nga organet e pavarura dhe të paanshme të krijuara me anë të ndryshimeve kushtetuese, në drejtim të institucioneve ekzistuese që pretendohet se kontrollohen nga qeveria, si: ILDKPKI-ja, DSIK-ja, Shkolla e Magjistraturës, Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Ministria e Brendshme; ii. cenonte parimin e sigurisë juridike pasi formulimi i parashikimeve ishte i paqartë, konfuz dhe kontradiktor; iii. parashikonte kufizime të pajustificuara të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti në lidhje me mbikëqyrjen e vazhdueshme të jetës private dhe kufizimet mbi të drejtën për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese; dhe iv. nuk parashikonte ndonjë rregull specifik procedural që garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor, të drejtën për ankim dhe respektimin e parimit të barazisë dhe të të drejtave themelore të njeriut, në veçanti pranueshmërinë e provave të marra nga publiku, siç parashikohet në nenet 53 dhe 54 të ligjit nr. 84/2016.

a) Opinioni *amicus curiae* i Komisionit të Venecias

156. Më 25 tetor 2016, Gjykata Kushtetuese, në konsideratë të pasojave të rënda dhe të pariparueshme për liritë dhe të drejtat themelore të personave ndaj të cilëve do të zbatohet ligji nr. 84/2016 dhe funksionimit të shtetit të së drejtës, vendosi të pezullojë zbatimin e tij.

157. Në vijim të një kërkesë të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese drejtuar Komisionit të Venecias për dhënien e një opinioni *amicus curiae* mbi përputhshmërinë e ligjit nr. 84/2016 me standardet ndërkombëtare, përfshirë Konventën, më 12 dhjetor 2016, Komisioni dha një opinion *amicus curiae* (Opinion nr. 868/2016 – CDL-AD (2016)036).

158. Komisioni i Venecias deklaroi se të dyja institucionet e rivlerësimit kishin karakteristika të organeve gjyqësore dhe se do të funksiononin dhe merrnin vendime në mënyrë të pavarur dhe të paanshme. Anëtarët e KPK-së dhe Komisioneri Publik do të kishin statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Posaçëm i Apelit do të funksiononte si pjesë e Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e tij do të gëzojnë statusin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Anëtarët e institucioneve të rivlerësimit do të kenë detyrimin për deklarimin e përvitshëm të pasurisë, e cila do të bëhet publike, llogaritë e tyre financiare do të monitorohen sistematikisht dhe privatësia e komunikimeve të tyre në lidhje me punën do të kufizohet. Ata mbajnë përgjegjësi disiplinore në përputhje me ligjin, i cili ka parashikuar deklarimin e konfliktit të interesit dhe shkarkimin e tyre.

159. Kriteret për emërim në KPK dhe KPA duket se janë të barasvlershme me kriteret e emërimeve në gjyqësor dhe, së paku, duken po aq të rrepta sa ato në fuqi për emërimet në detyrë të përhershme gjyqësore. Përgatitjet për kryerjen e emërimeve duket se ishin projektuar të siguronin, për aq sa mundej, emërimin e kandidatëve me kualifikimin e përshtatshëm, të cilët do të përmbushin kriteret. U garantuan procedurat për mundësimin e emërimeve me anë të shumicës së cilësuar në parlament, me një mekanizëm zhblllokues. Përveç faktit që këto nuk do të ishin institucione të përhershme, duket se qëllimi i parashikimeve kushtetuese dhe ligjore ishte t'u jepte atyre karakteristikat kryesore të gjykatave. Pas përfundimit të mandatit të tyre, çdo çështje në pritje për t'u gjykuar, në vijim, do të shqyrtohet nga institucionet e përhershme gjyqësore dhe të prokurorisë.

160. Sipas Komisionit të Venecias, bazuar në ligjin nr. 84/2016, vlerësimi i çdo informacioni dhe prove të mbledhur nga organet ekzekutive i takon KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të cilët dalin në përfundime në mënyrë të pavarur. Në pikëpamjen e tij, është normale dhe në përputhje me standardet evropiane, që provat e paraqitura përpara gjykatës, fillimisht të merren nga organet ekzekutive si policia apo prokuroria. Kjo nuk do të përbënte ndërhyrje në pushtetin gjyqësor, me kusht që vlerësimi i tyre, d.m.th. vlerësimi i vërtetësisë së tyre dhe peshës që do t'u jepet, të jetë çështje për vlerësim gjyqësor. Për më tepër, KPK-ja dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit do të kishin kompetenca të gjera për t'i hetuar dhe verifikuar vetë çështjet. Fakti që në procesin e rivlerësimit u përfshinë organet ekzekutive, duket se pati funksione ndihmëse dhe instrumentale në dhënien e ndihmës për institucionet e vlerësimit për përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rastet, kompetenca e vendimmarrjes duket se mbetet e KPK-së dhe e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, të krijuara për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet kushtetuese si organe gjyqësore të pavarura dhe të paanshme.

161. Në lidhje me atë nëse ligji nr. 84/2016 garanton të drejtën për proces të rregullt ligjor, Komisioni i Venecias deklaroi se rregullat në lidhje me kualifikimet e kërkuara dhe mënyrat e emërimit të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit janë projektuar për të garantuar pavarësinë dhe paanshmërinë e tyre si gjykata. Për më tepër, institucionet e rivlerësimit do të zbatojnë procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative dhe ligjin për gjykatat administrative për gjykimin e çështjeve individuale. Për më tepër, neni Ç, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, i ka përcaktuar qartë KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelit detyrën për të garantuar të drejtën për proces të rregullt ligjor. Megjithatë në procesin e rivlerësimit, në disa raste zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit, për të cilën subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën, neni Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, parashikon qartë se kjo zbatohet vetëm për procesin e rivlerësimit dhe jo për procese të tjera, në veçanti proceset penale. Të dyja institucionet e rivlerësimit do të funksionojnë me

transparentë; ato do të vërtetojnë faktet dhe rrethanat për çdo çështje, seancat e të cilave janë publike dhe vendimet e tyre do të jenë të arsyetuara dhe me shkrim.

162. Në lidhje me çështjen nëse kontrolli i figurës do të përbente ndërhyrje të pajustificuar në të drejtën për respektimin e jetës private, Komisioni i Venecias shprehu se ekzistenca e kontakteve të papërshtatshme ndërmjet gjyqtarëve dhe krimit të organizuar do të binte ndesh me interesat e sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, me gjasë të inkurajojë sesa parandalojë mungesën e rendit dhe kriminalitetin dhe, ka të ngjarë, më tepër të kërcënojë sesa të mbrojë të drejtat dhe liritë e të tjerëve. Deklarata e kontrollit të figurës do të shërbejë si bazë për kryerjen e kontrollit të figurës. Duhet theksuar se deklarata e kontrollit të figurës nuk do të përdoret në asnjë proces penal. Ndërsa rolin kryesor në kryerjen e kontrollit të figurës e ka një grup pune, përdorimi i vlerësimit do të ishte nën mbikëqyrjen dhe kontrollin e KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Sipas këndvështrimit të Komisionit të Venecias, fakti që një informacion i caktuar nuk bëhet publik, do të ishte i arsyeshëm në rast se është në favor të subjektit të rivlerësimit. Është tepër e rëndësishme që relatori i çështjes të ketë akses në të gjitha dokumentet dhe materialet në zotërim apo në kontrollin e grupit të punës dhe që përfaqësuesi i relatorit të ketë marrë pjesë në takimet e grupit të punës.

b) Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese

163. Me anë të vendimit nr. 2 të datës 18 janar 2017, Gjykata Kushtetuese vendosi që edhe pse gjyqtarët e saj automatikisht do t'i nënshtroheshin procesit të rivlerësimit, të parashikuar në ligjin nr. 84/2016, ajo kishte kompetencë për shqyrtimin e kërkesës së depozituar nga deputetët opozitarë, për atë kohë sa ligji nr. 84/2016 nuk i pengonte gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, të cilët do të vepronin në mirëbesim, të ushtronin detyrat e tyre në interpretimin e parashikimeve ligjore.

i. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve

164. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, Gjykata Kushtetuese thekson se neni 179/b i Kushtetutës, qartazi i ka dhënë kompetenca KPK-së për kryerjen e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në shkallë të parë, me mundësinë e ankimit përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, pjesë e Gjykatës Kushtetuese. Procesi kalimtar i rivlerësimit u krijua si “masë e jashtëzakonshme dhe e përkohshme” për t'u zbatuar nga organet e rivlerësimit të specifikuar në Kushtetutë. Ndërsa Kushtetuta nuk mund të përmbante parashikime shteruese dhe të detajuara në lidhje me organizimin e jetës sociale dhe politike, zbatim i tyre do të kushtëzohej në një ligj tjetër të zbatueshëm. Legjislatura pati diskrecion të gjerë për përcaktimin e çështjeve që do të mbulonte ligji i posaçëm. Gjykata Kushtetuese vijoi me shqyrtimin veçmas të çdo kriteri.

165. Duke iu rikthyer vlerësimit të pasurisë, Gjykata Kushtetuese u shpreh se neni D i aneksit të Kushtetutës i kishte dhënë kompetenca ILDKPKI-së për verifikimin e deklarimit të pasurisë të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, duke mbajtur në konsideratë ekspertizën e ILDKPKI-së, infrastrukturën dhe përgjegjësitë ekzistuese. Detajet në lidhje me ushtrimin e procesit të verifikimit janë parashikuar në ligjin nr. 84/2016, i cili nuk është në kundërshtim me parashikimet kushtetuese. Për më tepër, Gjykata Kushtetuese vlerësoi pavarësinë e ILDKPKI-së për mbledhjen dhe verifikimin e informacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit.

166. Sa i takon vlerësimit të aftësive profesionale, deklarata e vlerësimit profesional (formulari i vetëvlerësimit profesional), pas plotësimit dhe dorëzimit nga subjekti i rivlerësimit, i nënshtrohet rivlerësimit nga organi përgjegjës, në përputhje me nenin E të aneksit të Kushtetutës. Përveç caktimit të Shkollës së Magistraturës si përgjegjëse për testimin e këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë, Kushtetuta nuk ka parashikuar organe të tjera përgjegjëse për vlerësimin e aftësive profesionale. Këto organe, të krijuara nga ligje të tjera, hartojnë një raport të detajuar dhe të arsyetuar dhe e dorëzojnë atë pranë KPK-së, e cila kryen kontrollin e fundit të procesit dhe vendos nëse subjekti i rivlerësimit është i “aftë”, “me mangësi” apo “i papërshtatshëm”.

167. Vlerësimi i aftësive profesionale bazohet në një formular të plotësuar nga subjekti i rivlerësimit dhe prova të tjera, si vendimet nga gjykatat vendëse apo të huaja dhe kryhet në përputhje me nenin DH të aneksit të Kushtetutës. Sipas nenit 36, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit, në bashkëpunim me DISK-në, janë përgjegjëse për vlerësimin e aftësive profesionale.

Gjykata Kushtetuese pranoi se institucionet e përmendura në nenin 36 të ligjit nr. 84/2016 do të luanin një rol aktiv në kryerjen e vlerësimit profesional. Për këtë arsye, iu referua opinionit *amicus curiae* të Komisionit të Venecias, i cili citon si më poshtë:

“[...] nëse procesi i rivlerësimit kryhet apo kontrollohet nga pushteti ekzekutiv, i gjithë procesi i rivlerësimit kalimtar mund të komprometohet. Për këtë arsye, është e rëndësishme që të garantohet se përfshirja e ekzekutivit, në ligj dhe në praktikë, të kufizohet deri në shkallën që është ngushtësisht e domosdoshme për funksionimin efektiv të organeve të rivlerësimit”.

168. Pas shqyrtimit të nenit Ç, pika 4 e aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45, 50 dhe 51 të ligjit nr. 84/2016, Gjykata Kushtetuese arriti përfundimin se organet e rivlerësimit kanë autoritetin për të ruajtur një kontroll të plotë mbi procesin e verifikimit të figurës. Krijimi i një grupi të tillë pune sipas nenit 36 të ligjit nuk shfaq probleme nëse ai përfshin edhe përfaqësues të KPK-së. Kjo mund të garantohet nga prania e këshilltarëve ligjorë, të cilëve relatori i çështjes mund t’u kërkojë të marrin pjesë në takime të tilla.

169. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese arriti përfundimin se organet e tjera të përfshira në procesin e rivlerësimit do të ndihmonin organet e rivlerësimit në përmbushjen e mandatit të tyre. Në të gjitha rrethanat, referuar nenit 4, pika 2 të ligjit të rivlerësimit dhe nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, vendimmarrja i përket KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të cilat krijohen si institucione të pavarura dhe të paanshme. Organet e rivlerësimit kryejnë funksione mbikëqyrje dhe vlerësimi dhe nuk kushtëzohen nga konstatimet e institucioneve ndihmëse. Për aq kohë sa agjencitë ligjzbatuese kanë rol ndihmës dhe aktiviteti i tyre i nënshtrohet mbikëqyrjes dhe kontrollit nga organet e rivlerësimit, ata nuk mund të nisnin aktivitetin e tyre pa u konstituuar më parë organet e rivlerësimit.

170. Falë qëllimit të tyre, funksionimit, ekspertizës dhe detyrave, institucionet ndihmëse ndihmojnë organet e rivlerësimit në ushtrimin e funksioneve të tyre kushtetuese dhe përmbushjes së misionit të tyre në emër të parimit të bashkëpunimit, ndërveprimit dhe koordinimit të të gjithë institucioneve të përfshira në procesin e rivlerësimit. Ata nuk mund t’i kryejnë detyrat e tyre jashtë kontrollit të KPK-së dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Kjo është e rëndësishme për të evituar çdo ndërhyrje të mundshme nga organet në varësi të pushtetit ekzekutiv, veçanërisht në rastin e kontrollit të figurës, shqetësim ky i ngritur edhe në opinionin e Komisionit të Venecias.

171. Sipas Gjykatës Kushtetuese, organet e rivlerësimit janë institucionet e vetme me kompetencë për shkarkimin e një gjyqtari apo prokurori nga detyra. Vetëm ato mund të përcaktojnë nëse deklaratat janë depozituar brenda afateve të parashikuara. Në përfundim të procesit, ata marrin një vendim të arsyetuar, duke përshkruar të gjithë vendimmarrjen.

ii. Në lidhje me pretendimin për cenim të parimit të sigurisë juridike

172. Gjykata Kushtetuese u shpreh se sipas nenit 42 të ligjit nr. 84/2016, të gjithë gjyqtarët në detyrë, përfshirë ata të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese, këshilltarët dhe ndihmësit ligjorë, si dhe prokurorët në detyrë, përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, do t’i nënshtrohen vlerësimit të aftësive profesionale, i cili do të kryhet nga i njëjti institucion. Legjislacioni në lidhje me statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve do të zbatohet në mënyrën e duhur.

173. Pavarësisht institucioneve të përfshira në procesin e rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se parashikimet ligjore nuk përmbajnë paqartësi që mund të çojnë në keqinterpretimin apo keqzbatimin e tyre. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, KPK-ja jep një vendim të arsyetuar, i cili përmban provat që shërbejnë si bazë për përfundimet e tij. Në këndvështrimin e Gjykatës, është e domosdoshme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale.

174. Më tej, Gjykata Kushtetuese qartësoi se, si rregull, periudha kohore në lidhje me vlerësimin profesional do të mbulojë tri vitet e fundit të eksperiencës profesionale. Megjithatë, sipas nenit 41, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit mund të vendosin në raste përjashtimore për shtrirjen e periudhës së rivlerësimit, duke filluar nga 1 janari i vitit 2006. Në raste të tilla, informacioni shqyrtohet nëse relatori apo vëzhguesi ndërkombëtar e çmon si të domosdoshëm për procesin e

vlerësimit.

iii. Në lidhje me kufizimet e pajustificuara mbi të drejtat themelore të njeriut

175. Në lidhje me kufizimet e vendosura nga Kushtetuta mbi anëtarët e organeve të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ata nuk mund të jenë objekt i kontrollit kushtetues. Në lidhje me kufizimet e vendosura nga ligji nr. 84/2016, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ndërhyrja ishte e justifikuar nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve. Gjykata theksoi se është detyrë e organeve të rivlerësimit të kërkojnë respektimin e standardeve dhe të jurisprudencës evropiane.

176. Në përgjigje të pretendimit për cenimin e së drejtës së ankimit, Gjykata Kushtetuese u shpreh se Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 parashikojnë të drejtën për të ankimit vendimin e KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili është një organ i posaçëm i ngritur për garantimin e një game të gjerë të drejtash dhe garancish që u njihen subjekteve të rivlerësimit, siç është theksuar në opinionin *amicus curiae* të Komisionit të Venecias (*shih paragrafin 161 më lart*).

Konsiderohet se, duke pasur parasysh funksionimin e tyre, zgjedhjen e anëtarëve dhe kompetencat e tyre, institucionet e rivlerësimit duket se ofrojnë garancitë e kërkuara nga e drejta për proces të rregullt ligjor. Për më tepër, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendos përfundimisht për themelin e çështjeve dhe nuk mund ta rikthejë çështjen për rishqyrtim në KPK. Si e tillë, mund të thuhet se e drejta e ankimit është garantuar mjaftueshëm.

177. Në lidhje me kufizimin e së drejtës për ankim kushtetues, Gjykata Kushtetuese u shpreh se ky pretendim nuk mund të ishte objekt i kontrollit kushtetues për aq kohë sa parashikohet në ndryshimet kushtetuese. Megjithatë, duke marrë parasysh kompetencat e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i cili rishikon vendimet e marra nga KPK-ja, konsiderohet se ky proces do të jetë objekt mbikëqyrje nga pikëpamja kushtetuese.

iv. Në lidhje me pretendimin për cenim të proces të rregullt ligjor

178. Gjykata Kushtetuese u shpreh se, sipas nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë të paanshme dhe funksionojnë mbi bazën e parimeve të ligjshmërisë dhe proporcionalitetit, si dhe parimet e tjera që garantojnë të drejtën për proces të rregullt ligjor për subjektet e rivlerësimit. Ata zbatojnë edhe parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative dhe ligjit për gjykatat administrative. Për më tepër, ligji nr. 84/2016 ka parashikuar garantimin dhe respektimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit në nenet 35 deri 40, 45 deri 47, 55, 57, 63 dhe 65.

179. Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 nuk ka përcaktuar afate kohore specifike për shqyrtimin e çështjeve individuale, organet e rivlerësimit kanë detyrën ta kryejnë atë brenda një kohe të arsyeshme. Rivlerësimi është një masë e përgjithshme e cila zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, pa shkaktuar pabarazi përpara ligjit.

180. Në përputhje me nenin Ç, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, proporcionaliteti ndërmjet së drejtës për respektim të jetës private dhe detyrës për të hetuar, si dhe së drejtës për proces të rregullt, do të zbatohet kurdo që merret informacion nga publiku, sipas neneve 53 dhe 54 të ligjit nr. 84/2016.

v. Përfundim

181. Gjykata Kushtetuese, duke marrë parasysh procedurën ligjore të ndjekur për miratimin e ligjit nr. 84/2016, si dhe arsyet e përshkruara më lart, vendosi me shumicë votash të rrëzojë shkaqet e ngritura në kërkesën e paraqitur nga kërkuessit.

vi. Mendimi i pakicës

182. Dy gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese (B.I. dhe G.D.) dhanë mendim pakice. Në pikëpamjen e tyre, parashikimet ligjore e kanë transferuar hetimin dhe kontrollin e procesit të rivlerësimit nga organet e rivlerësimit drejt institucioneve ekzistuese të cilat kontrollohen nga pushteti ekzekutiv. Në mbështetje të këtij argumenti, ata theksuan se neni 35 i ligjit nr. 84/2016 kërkon që subjektet e rivlerësimit të depozitojnë pranë DSIK-së deklaratën e tyre të kontrollit, ndërsa neni DH, pika 2 e aneksit të Kushtetutës kërkon që këto subjekte ta depozitojnë atë deklaratë edhe pranë KPK-së. Për më tepër, DSIK-ja dhe organet e tjera, të cilat kontrollohen nga pushteti ekzekutiv, i nisën verifikimet

e deklaratave të kontrollit të figurës në kohën kur organet e rivlerësimit nuk ishin konstituar ende. Kështu, DSIK-ja do të kryente një verifikim *de facto* të deklaratës së kontrollit të figurës, pa mbikëqyrjen apo kontrollin e organeve të rivlerësimit.

183. Për më tepër, gjyqtarët në pakicë nuk u pajtuan me parashikimet ligjore në lidhje me shkarkimin nga detyra të subjektit në rast mosdorëzimi të deklaratës së pasurisë apo deklaratës së kontrollit të figurës brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 84/2016. Për atë kohë sa organet e rivlerësimit nuk ishin formuar ende, mbetej e paqartë se si do të zbatoheshin këto parashikime dhe se si mund të merreshin vendimet. Për këtë arsye, ata argumentuan se shprehja “brenda tridhjetë ditëve nga hyrja në fuqi”, e përdorur në nenet 31, 35 dhe 41 të ligjit nr. 84/2016, duhej të ishte shfuqizuar.

184. Së fundi, gjyqtarët në pakicë vlerësuan se fakti se periudha e vlerësimit të aftësive profesionale mund të shtrihej deri në dhjetë vjet, ose për një periudhë më të gjatë, krijon dyshime serioze në lidhje me respektimin e parimit të sigurisë juridike. Kjo, gjithashtu, mund të çonte në trajtim të pabarabartë të subjekteve të rivlerësimit.

5. Praktika gjyqësore e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

185. Përmbledhja e vendimeve të mëposhtme, të marra nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit përpara dhënies së vendimit në çështjen e kërkuases, është kufizuar në një përshkrim të çështjeve procedurale me qëllim shmangien e paragjykitimit të rezultatit të procesit të brendshëm, në lidhje me të cilat subjektet e rivlerësimit, paraqitën një kërkesë pranë kësaj Gjykate.

i. Vendimi nr. 3 datë 17 korrik 2018 (nr. 3/2018)

186. Në vendimin e tij të parë të themelit (nr. 3/2018), Kolegji i Posaçëm i Apelimit, sipas nenit 47 të ligjit për gjykatat administrative, refuzoi të pranonte të merrte provat e reja të ankuesit si pjesë e dosjes së gjykimit, duke deklaruar se ai nuk kishte arritur të paraqiste shkaqe të arsyeshme për mosdepozitimin e atyre provave pranë KPK-së. I njëjti konstatim u dha edhe në vendimin nr. 7/2008, ku Kolegji i Posaçëm i Apelimit shprehu se, referuar nenit 49, pika 6 të ligjit nr. 84/2016, provat e reja nuk ishin të rëndësishme për procesin e vendimmarrjes. Në vendimin nr. 3/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelimit vendosi të mos zhvillonte një seancë publike

187. Kolegji i Posaçëm i Apelimit u shpreh se edhe pse procesi i rivlerësimit do të zhvillohej mbi bazën e vlerësimit të tri kriterëve të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, vendimi përfundimtar mund të kufizohej në vetëm një prej tyre. Kjo qasje u mundësua nga formulimi i nenit 4, pika 2 i ligjit nr. 84/2016 dhe nuk kishte asnjë parashikim tjetër ligjor i cili pengonte një mënyrë të tillë të vepruari. Në çështjen e kërkuarit, KPK-ja vlerësoi se, bazuar në provat në dosje, rivlerësimi mund të përmbylej sa i takon vlerësimit të pasurisë, duke mos pasur nevojë për të vijuar me vlerësimin e kriterëve të mbetura. Një konstatim i tillë u dha edhe në vendimet nr. 4/2018 dhe nr. 8/2018.

188. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, referuar nenit Ç, pika 4 e aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka shprehur se KPK-ja ka kompetencë të përdorë si prova të gjitha deklaratimet e mëparshme të pasurisë të depozituara nga ankuesi pranë ILDKPKI-së me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit (deklarata e rivlerësimit). Ky konstatim u përsërit edhe në vendimin nr. 8/2008. Çdo hetim i mëparshëm gjithëpërfshirës i kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2011, i cili nuk mund të përbëjë gjë të gjykuar në kuadër të ligjit nr. 84/2016, nuk e pengonte KPK-në të kryente një hetim të thelluar në të tria kriteret e parashikuara në ligjin nr. 84/2016. (*shih, gjithashtu, edhe paragrafin 191 më poshtë*).

189. Sa i takon pretendimit se nuk është përcaktuar metodologji për përcaktimin e të ardhurave, Kolegji i Posaçëm i Apelimit u shpreh se nuk ishte e nevojshme të përcaktohet zbatimi i metodologjisë, meqë, sipas nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, ankuesit i duhej të jepte shpjegime bindëse në lidhje me burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të ardhurave, të cilat ai duhej t'i kishte deklaruar dhe, në lidhje me të cilat, ai duhet të kishte paguar taksat. Meqë ankuesi nuk arriti të demonstronte ekzistencën e këtyre të ardhurave të ligjshme për periudhën nga viti 1994 deri në vitin 2003, nuk u zbatua asnjë metodologji e parashikuar.

ii. Vendimi nr. 4 datë 26 korrik 2018 (nr. 4/2018)

190. Në vendimin nr. 4/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në përputhje me nenin 49 të ligjit për gjykatat administrative, vendosi të mos zhvillojë seancë publike për çështjen e ankuesit, duke deklaruar se: i. faktet janë vërtetuar plotësisht dhe me saktësi; ii. se nuk kishte shkelje serioze procedurale; dhe iii. nuk ishte e nevojshme rihapja e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimi i provave të reja. I njëjti konstatim u bë edhe në vendimin nr. 7/2018.

191. Kolegji i Posaçëm i Apelimit hodhi poshtë argumentin e ankuesit se moskonstatimi i shkeljeve në deklarin e pasurisë në kontrollin e kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2013 përbënte gjë të gjykuar, duke deklaruar se vlerësimi i pasurisë mundësohej *lex specialis*, pikërisht nga ligji nr. 84/2016, i cili ka përcaktuar një metodologji dhe procedurë të ndryshme nga kontrollet e mëparshme. Ky vlerësim do të administrohet vetëm një herë nga një organ tjetër, siç është KPK-ja, e cila ka kompetencën për marrjen e vendimit në çdo çështje individuale.

C. Kodi i Procedurës Administrative (ligji nr. 44/2015)

192. Nenet 35–40 kanë të bëjnë me përfaqësimin e palëve përpara një organi publik. Neni 45 garanton të drejtën e palëve për njohjen me dosjen. Neni 46 parashikon që të drejtat e palëve mund të kufizohen sipas nenit 45, dhe neni 47 garanton të drejtën e palëve për të paraqitur mendime, shpjegime, prova apo të bëjnë propozime rreth fakteve, rrethanave, çështjeve ligjore dhe zgjidhjen e çështjes.

D. Ligji për gjykatat administrative (ligji nr. 49/2012 mbi organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, i ndryshuar)

193. Ligji për gjykatat administrative përcakton rregullat në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatave administrative, si dhe parimet dhe procedurën për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

194. Neni 47 parashikon se në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

195. Neni 49, pika 1 parashikon që shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit. Sipas nenit 49, pika 2, kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Palët kanë të drejtë të paraqesin deri pesë ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.

196. Sipas nenit 51, pika 1, gjykata e apelit, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: i. për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; ii. vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; iii. me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike, duhet të përsëritë marrjen e disa ose të gjitha provave.

E. Kodi i Procedurës Civile (KPC) (ligji nr. 8116 datë 29 mars 1996, i ndryshuar)

197. Sipas nenit 72, pika 6 e KPC-së, gjyqtari mund të heqë dorë nga proceset civile duke i drejtuar një kërkesë kryetarit të gjykatës, në rastet kur: 1. ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim; 2. ai vetë ose bashkëshortja e tij është i afërt deri në shkallë të katërt apo krushqi deri në shkallë të dytë ose është i lidhur me detyrime birësimi apo bashkëjeton në mënyrë të përhershme me njërin nga palët ose nga mbrojtësit; 3. ai vetë ose bashkëshortja e tij janë në konflikt gjyqësor ose në armiqësi apo në marrëdhënie kredie apo huaje me njërin prej palëve, ose njërin prej përfaqësuesve; 4. ka dhënë këshilla ose ka shfaqur mendim për çështjen në gjykim apo ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes në një shkallë tjetër të procesit, është pyetur si dëshmitar, si ekspert ose si përfaqësues i njëres apo tjetrës pale; 5. është kujdestar, punëdhënës i njëres prej palëve, administrator ose ka një detyrë tjetër në një ent, shoqatë, shoqëri ose institucion tjetër që ka interesa për çështjen në

gjykim; 6. “në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

198. Përveç kësaj, neni 74 parashikon se palët në proces mund të kërkojnë përjashtimin e një gjyqtari nga shqyrtimi i çështjes së tyre.

F. Ligji për Gjykatën Kushtetuese (ligji nr. 8577 i datës 10 shkurt të vitit 2000 mbi organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese, ndryshuar me ligjin nr. 99/2016)

199. Neni 36, pika 1 e ligjit për Gjykatën Kushtetuese, ashtu siç ishte në fuqi deri më 22 nëntor 2016, parashikonte që gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese është i detyruar të heqë dorë nga shqyrtimi i një çështjeje konkrete kur: a) ka marrë pjesë në hartimin e aktit objekt shqyrtimi; b) për shkak të lidhjeve fisnore apo lidhjeve të tjera me pjesëmarrësit në gjykim vihet në dyshim objektiviteti i tij; ose c) në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie. Sipas nenit 37, pjesëmarrësit në gjykim kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit kur ekziston një nga rastet e parashikuara në nenin 36 të këtij ligji dhe gjyqtari nuk heq dorë nga shqyrtimi i çështjes.

200. Deri më datë 22 nëntor të vitit 2016, ligji për Gjykatën Kushtetuese nuk përmbante parashikime lidhur me përgjegjësinë disiplinore. Neni 10, pas ndryshimeve të 23 nëntorit të vitit 2016, detajon rastet që mund të çojnë në përgjegjësi disiplinore për një gjyqtar të Gjykatës Kushtetuese. Sipas nenit 10/b, ndaj gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese mund të vendosen këto masa disiplinore: vërejtje me shkrim, vërejtje publike, ulje e përkohshme e pagës deri në 50 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit, pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 6 muaj dhe, shkarkim nga detyra.

G. Ligji për deklarimin e pasurisë (ligji nr. 9049 i datës 10 prill 2003 mbi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publikë, i ndryshuar nga viti 2006 deri 2018)

201. Pas hyrjes në fuqi të ligjit për deklarimin e pasurive në vitin 2003, sipas nenit 6, gjyqtarëve dhe prokurorëve iu kërkua të kryejnë deklarimin fillestar të pasurisë. Neni 9 parashikon që kjo kërkesë të zbatohet edhe për gjyqtarët dhe prokurorët që sapo nisin të ushtrojnë funksionet. Sipas ligjit “Për parandalimin e konflikteve të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, i cili ka hyrë në fuqi më 26 maj të vitit 2005 (“ligji për parandalimin e konflikteve të interesit” – ligji nr. 9367/2005, i ndryshuar), gjyqtarëve dhe prokurorëve u kërkohet të deklarojnë të gjitha rastet e konflikteve të interesit, siç përcaktohet në ligj. Pas ndryshimeve në ligjin për deklarimin e pasurive në vitin 2012, deklaratet vijuese të pasurive dhe konflikteve të interesit duhej vetëm të tregonin ndryshimet me deklaratën fillestare apo deklaratat e mëparshme, sipas rastit. Neni 9/1, i miratuar në vitin 2012 (me ligjin nr. 85/2012), parashikon që çdo deklarim të shoqërohet me një autorizim të veçantë, ku deklaruesi autorizon organet e përcaktuara të verifikojnë brenda dhe jashtë vendit dhe të kontaktojnë çdo person të cilin ata e konsiderojnë të nevojshëm.

202. Deklarata vjetore e pasurisë paraqitet pranë ILDKPKI-së deri më datë 31 mars të çdo viti kalendarik, sa u takon pasurive dhe detyrimeve për periudhën nga data 1 janar deri më 31 dhjetor të vitit pararendës. Neni 4 liston pasuritë të cilat duhen deklaruar, siç janë pasuritë e paluajtshme dhe të luajtshme, sendet me vlerë të veçantë të cilat tejkalojnë një prag të caktuar, vlerën e aksioneve, të letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim, kursimet *cash*, llogaritë bankare, bonot e thesarit dhe huat, të ardhurat personale për vitin, licencat dhe patentat që sjellin të ardhura, dhuratat dhe trajtimet preferenciale që tejkalojnë një vlerë të caktuar, angazhimet në veprimtari private me qëllim fitimi ose çdo lloj veprimtarie që krijon të ardhura dhe, interesat private që bazohen ose burojnë nga marrëdhëniet familjare apo të bashkëjetesës. Përveç kësaj, duhen deklaruar edhe burimet e përdorura për krijimin e tyre, çdo shpenzim që tejkalon një prag të caktuar, detyrimet financiare, përfshirë ato në lidhje me anëtarët e familjes dhe personat e lidhur. Neni 4/1 i ligjit nr. 45/2014, i cili hyri në fuqi më 11 qershor të vitit 2014, u kërkon të gjithë zyrtarëve dhe nëpunësve publikë të cilët mbajnë në shtëpi gjendje *cash* mbi shumën 1.5 milionë lekë (11,990 euro), ta depozitojnë atë në një llogari bankare përpara dorëzimit të deklaratës së interesave private.

203. Neni 22 parashikon që deklaratat e pasurisë i nënshtrohen kontrollit paraprak nga ILDKPKI-ja, e cila verifikon nëse deklaratat (dhe anekset e saj) janë plotësuar siç duhet dhe në mënyrë të saktë.

Ato mund t'i nënshtrohen një kontrolli të plotë, i cili përfshin kontrolle aritmetike dhe logjike. Sipas ndryshimeve të vitit 2012, kontrolli i plotë kryhet çdo dy vjet për gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese dhe, çdo tri vjet për gjyqtarët e gjykatave të apelit. Pas ndryshimeve të vitit 2014 (të miratuara nga ligji nr. 45/2014), gjyqtarët e gjykatave të shkallës së parë i nënshtrohen kontrollit të plotë çdo katër vite (më parë, ata i nënshtroheshin kontrolleve rastësore, të cilat mbulonin të paktën 4% të numrit total të deklaratave të dorëzuara pranë ILDKPKI-së).

204. Sipas nenit 5, refuzimi për deklaram të pasurive dhe konflikteve të interesit çon në shkarkim nga detyra dhe përgjegjësi penale të zbatueshme, pas njoftimit që ILDKPIKI-ja i jep organit përgjegjës punëdhënës. Sipas nenit 38, deklarim i rremë i pasurisë përbën veprë penale sipas legjislacionit të zbatueshëm penal (neni 257/a i Kodit Penal). Fillimisht, ligji parashikonte se mosdeklarimi i pasurisë brenda afatit dhe pa shkaqe të arsyeshme dënohej me gjobë prej 25,000 lekësh (199 euro), e cila dyfishohej në rast shkelje të përsëritur. Në vitin 2012, masa e gjobës u rrit, duke variuar nga 50,000 lekë (399 euro) në 100,000 lekë (798 euro).

205. Sa u takon gjyqtarëve të shkallës së parë dhe apelit, neni 32 (2) (ç) i ligjit të vitit 2008 për gjyqësorin (ligji nr. 9877/2008 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor", i ndryshuar), i cili hyri në fuqi më 15 mars 2008, ndër të tjera, parashikonte se "refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive" përbën shkelje "shumë të rënda" disiplinore, të cilat pasjellin shkarkim nga detyra, në përputhje me nenin 33, pika 3 të tij. Ligji për gjyqësorin i vitit 2008 u shfuqizua si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit për gjyqësorin i vitit 2016 (ligji nr. 98/2016) më datë 22 nëntor 2016.

H. Ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" (ligji nr. 96/2016, i ndryshuar)

206. Ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i cili hyri në fuqi më 22 nëntor 2016, përcakton rregullat për emërimin si gjyqtar. Sipas nenit 28, pika dh, çdo person ka të drejtë të kandidojë për t'u pranuar në formimin fillestar si magjistrat nëse nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi. Ish-gjyqtarët, gjithashtu, mund të riemërohen, me kusht që të përmbushin, ndër të tjera, kërkesën e përcaktuar në nenin 28, pika dh. Neni 150, pika 3, parashikon se masa disiplinore e shkarkimit nga detyra nuk shuhet dhe nuk fshihet nga regjistri i masave disiplinore i autoriteteve përgjegjëse.

207. Neni 166, pika 6 parashikon se "anëtari i Kolegjit të Apelit emërohet si gjyqtar në nivel apeli në përfundim të mandatit, përveç rasteve kur ndaj tij është dhënë masë disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës".

I. LIGJI PËR PROFESIONIN E AVOKATIT (LIGJI NR. 55/2018 "PËR PROFESIONIN E AVOKATIT")

208. Sipas nenit 13, pika 1, e drejta për ushtrimin e profesionit të avokatit fillon nga momenti i fitimit të titullit profesional "Avokat" dhe, në çastin e fitimit të titullit profesional, avokati pajiset nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë me "Certifikatën e avokatit". Neni 13, pika 2, përmban një listë të kërkesave të përgjithshme që duhen përmbushur për të fituar titullin "avokat", ndër të cilat, më me rëndësi për këtë çështje është që "nuk është shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm".

209. Neni 51 i ligjit "Për profesionin e avokatit" parashikon që gjykata kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative të lindura ndaj vendimeve të Komitetit Disiplinor, të parashikuara nga ky ligj, është Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë.

II. MATERIALE NDËRKOMBËTARE ME RËNDËSI

A. Materiale në lidhje me gjyqësorin

210. Dokumente të rëndësishme të Këshillit të Evropës, si ekstraktet nga Rekomandimi (2010) 12 i Komitetit të Ministrave, Magna Carta e Gjyqtarëve (Parimet Themelore) dhe Karta Evropiane mbi Statutin për Gjyqtarët, mund të gjenden në *Baka kundër Hungarisë* ([GC], nr. 20261/12, paragrafët 77, 78 dhe 81, 23 qershor 2016).

211. Dokumente ndërkombëtare me rëndësi, si ekstraktet nga Parimet e Banglores të Sjelljes Gjyqësore mund të gjenden në *Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të Tjerë kundër Gjeorgjisë* (nr. 16812/17, paragrafi 224, 18 korrik 2019), dhe *Harabin kundër Sllovakisë* (nr. 58688/11, paragrafi 107, 20 nëntor 2012).

B. Materiale në lidhje me luftën ndaj korrupsionit

1. Materiale të Kombeve të Bashkuara

212. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit hyri në fuqi për Shqipërinë më 25 maj 2006, pas nënshkrimit më 18 dhjetor 2003. Qëllimi kryesor i saj është përkrahja dhe fuqizimi i masave për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit në mënyrë më të efektshme. Në këtë drejtim, neni 8, i cili i bën thirrje shteteve palë të zbatojnë kode të sjelljes për nëpunësit publikë, ndër të tjera, parashikon se shteti palë duhet “të caktojë masa dhe sisteme që u kërkojnë nëpunësve publikë të bëjnë deklaratat tek autoritetet e duhura, ndër të tjerash, në lidhje me aktivitetet e jashtme, punësimin, investimet, pasuritë dhe dhuratat ose privilegjet e mëdha nga të cilat mund të lindë një konflikt interesash për shkak të funksioneve të tyre si nëpunës publikë” dhe “të marra masa disiplinore apo të tjera ndaj nëpunësve publikë të cilët shkelin kodet apo standardet”.

2. Materiale të Këshillit të Evropës

a) Instrumente ligjore

213. Konventa Penale për Korrupsionin (ETS nr. 173) hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 korrik 2002. Ajo synon kriminalizimin e koordinuar të një sërë praktikash korrupsioni, siç përcaktohet në nenet 2 deri 14 të saj. Zbatimi i saj monitorohet nga Grupi i Shteteve kundër Korrupsionit (“GRECO”), i themeluar në vitin 1999.

214. Konventa Civile për Korrupsionin (ETS nr. 174) hyri në fuqi për Shqipërinë më 1 nëntor 2002. Ajo u kërkon palëve nënshkruese të parashikojnë në legjislacionin e tyre të brendshëm “rregullime efektive për personat që dëmtohen si rezultat i veprimeve korruptive, t’u japë atyre mundësi të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre, duke përfshirë dhe mundësinë për t’u kompensuar për dëmin”. Zbatimi i saj monitorohet nga GRECO-ja.

215. Rekomandimi nr. R (2000)10 i Komitetit të Ministrave mbi kodet e sjelljes për nëpunësit publikë u miratua më datë 11 maj të vitit 2000, duke rekomanduar miratimin e kodeve kombëtare të sjelljes për nëpunësit publikë, bazuar në kodin model të sjelljes në shtojcën e rekomandimit. Sipas nenit 14 të kodit model, nëpunësi publik “në pozicionin e të cilit, interesat e tij/saj personale apo private ka të ngjarë të ndikohen nga detyrat e tij zyrtare, siç kërkohet nga ligji, duhet të deklarojë pas emërimit, dhe, më pas, në intervale të rregullta kohore dhe kurdo që ndodhin ndryshime, natyrën dhe shkallën e këtyre interesave”. Sipas nenit 28, shkelja e parashikimeve të kodit model të sjelljes mund të rezultojë në masa disiplinore.

b) Raporte vlerësimi të GRECO-s

216. Grupi i Shteteve Kundër Korrupsionit (GRECO) monitoron pajtueshmërinë e Shteteve me standardet kundër korrupsionit të Këshillit të Evropës. Ky organ funksionon me cikle/intervale, të njohura ndryshe si periudha vlerësimi, ku çdo periudhë mbulon tematika specifike. Pas vizitës në një shtet të caktuar, ekipi i vlerësimit të GRECO-s (“GET”) harton një raport vlerësimi, i cili mund të përfshijë rekomandime që kërkojnë ndërmarrjen e veprimeve nga shteti në fjalë për të siguruar përputhshmërinë me to.

217. Në raundin e parë të vlerësimit lidhur me pavarësinë, specializimin dhe mjetet e organeve vendëse të angazhuara në parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit, i cili u zhvillua në Shqipëri nga data 8 deri më 12 prill 2002, në seksionin e raportit të tij të vlerësimit “Fenomeni i korrupsionit dhe perceptimi i tij në Shqipëri”, për sa i përket gjyqësorit, GET është shprehur si më poshtë:

“13. Sondazhet (referuar statistikave sipas Qeverisë) e kryera me mbështetjen e komuniteteve ndërkombëtare, tregojnë se sistemi gjyqësor, rrjeti i Doganave, Agjencia e Privatizimit dhe shërbimi shëndetësor janë ndër më të korruptuarit në vend... Autoritetet shprehen se forma më e zakonshme e korrupsionit në Shqipëri është ryshfeti. Nëpunësit civilë ose zyrtarë të tjerë janë të prirur të pranojnë ryshfet për të përshpejtuar ofrimin e shërbimeve, mosdhënien e dënimeve të parashikuara në

ligji/rregullore ose gjyqtarë që mund të jenë të gatshëm të ndryshojnë vendimet e gjykatave etj. Sondazhet, gjithashtu, tregojnë se është më se e zakonshme që ndërmarrjet private t'u ofrojnë ryshfet zyrtarëve publikë për të shmangur taksat dhe rregulloret, apo që vendimet e gjykatës dhe të arbitrazhit po blihen”.

218. Seksioni i analizës së raportit të vlerësimit, në lidhje me gjykatat, lexonte si më poshtë:

“156. ... Pavarësia e sistemit gjyqësor ka një rëndësi të madhe për sa i përket sundimin e ligjit, megjithatë, një pavarësi e tillë nuk është pa kufij dhe duhet të jetë e lidhur me një sistem përgjegjësish. Pavarësia e sistemit gjyqësor është e parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe autoritetet po ndërmarrin hapa për të vendosin një mekanizëm llogaridhënie ndaj gjyqtarëve. GET e pranon që ekzistojnë disa vështirësi të lidhura me këtë, duke marrë parasysh që sistemi gjyqësor në Shqipëri duket se vuan nga një mungesë e përgjithshme e besimit të publikut në të. Për më tepër, kjo është një fushë ku autoritetet shqiptare i konsiderojnë masat kundër korrupsionit si shumë të rëndësishme. Sidoqoftë, vlen të theksohet se sistemi gjyqësor përbëhet nga zyrtarë të përkushtuar që punojnë në kushte të vështira.”

219. Në raundin e dytë të vlerësimit në lidhje me, ndër të tjera, administratën publike dhe korrupsionin, i cili u krye në Shqipëri nga datat 11 deri më 15 tetor 2004, GET në raportin e tij në lidhje me këtë, u shpreh si më poshtë:

“34. Në Shqipëri ka nisur punën një organ i ri auditimi, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe [Kontrollin] e Pasurive. Ky organ është një institucion i pavarur që ka për detyrë të verifikojë deklarin e detyrueshëm të pasurive që u kërkohet individëve, veçanërisht atyre të ekspozuar ndaj korrupsionit. Zyrtarët publikë të nivelit të mesëm, të lartë të zgjedhur, duke përfshirë nivelin lokal, si dhe gjyqtarët, prokurorët etj., kanë detyrimin ligjor të deklarojnë të gjitha llojet e pasurive, detyrimet financiare, të ardhurat etj., te ky organ. Anëtarët e familjes dhe bashkëpunëtorët e tyre të ngushtë, gjithashtu, i nënshtrohen këtij detyrimi. Mosrespektimi i këtij parashikimi mund të çojë në sanksione disiplinore, administrative dhe/ose penale. Kontrolli i gjendjes së tyre financiare kryhet duke kërkuar informacion nga bankat, regjistrat etj. të cilat përmbajnë informacione përkatëse. Këto lloj institucioneesh janë të detyruar të ofrojnë përgjigje dhe informacione të sakta ndaj kërkesave të tilla. Rastet e dyshimta i janë nënshtuar shqyrtimit përkatës tashmë. Në një rast, një person është pushuar nga puna; ky rast u raportua edhe në institucionin e prokurorisë.”

220. Raundi i katërt i vlerësimit të GRECO-s, i cili u krye në Shqipëri nga datat 28 tetor deri më 1 nëntor 2013, u përqendrua në parandalimin e korrupsionit tek anëtarët e parlamentit, deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët. Në lidhje me gjyqtarët, GRECO-ja në këtë raport vlerësimi ka parashtruar si më poshtë:

“13. Sipas Barometrit Global të Korrupsionit 2013, perceptimi i korrupsionit brenda sistemit gjyqësor është më i larti (81% e të anketuarve). Sipas mendimit të Fondacionit Heritage, një kulturë e mosndëshkimit dhe ndërhyrjes politike e ka bërë të vështirë për sistemin gjyqësor që të merret me korrupsionin në nivele të larta dhe të rrenjosur thellë, dhe zbatimi i reformave më të thella institucionale për të rritur pavarësinë e gjyqësorit dhe çrrenjosjen e korrupsionit të vazhdueshëm mbetet kritik. Shkalla tejet e lartë e korrupsionit në sistemin gjyqësor është vënë në dukje edhe në raportet e Komisionit Evropian dhe të Komisionerit për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës

...

53. Diskutimet me përfaqësues të vendit theksuan rëndësinë që i është dhënë deklarinimit të pasurisë nga zyrtarët dhe monitorimin e rregullt dhe të hollësishëm të kryer nga ILDKPI-ja. Pjesë e procedurës së deklarinimit të pasurive janë një numër i konsiderueshëm zyrtarësh (aktualisht rreth 4,670 persona), si dhe pjesëtarët e familjes së tyre, “personat e besuar” dhe “bashkëjetues/bashkëjetuesit”. GET u informua se, për shkak të aftësisë së kufizuar të ILDKPI-së për të përpunuar të gjitha deklaratat dhe për të kontrolluar në kohën e duhur deklarinimet e tyre, [Deklarata e Pasurive] iu nënshtuar ndryshime më 2012, duke prezantuar një trajtim të veçantë për kategori të ndryshme të zyrtarëve.

...

75. ... sistemi i prezantuar së fundmi për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve nuk mund të konsiderohet efektiv dhe efikas për shkak të kohës së konsiderueshme që ka kaluar ndërmjet vlerësimit dhe periudhës së referimit. GRECO-ja nuk është dakord me mendimin e autoriteteve që pohojnë se një vlerësim i tillë nuk mund të menaxhohet në kohë reale pasi kohëzgjatja mesatare e gjykimit përpara tri instancave është deri në tre vjet. Një sistem i mirë-konceptuar i vlerësimeve periodike lejon jo vetëm për monitorimin e performancës së gjyqtarit dhe avancimin e tij me kalimin e kohës, por edhe për konstatimin e hershëm të problematikave, siç është ngarkesa e lartë e çështjeve dhe numri i prapambetur i tyre me të cilin përballen shumë gjyqtarë dhe që mund dhe duhet të adresohet në një fazë të hershme. Në dritën e perceptimit të lartë publik të korrupsionit në sistemin gjyqësor, një tjetër burim shqetësimi që duhet të merret në konsideratë, është mungesa e dukshme e kriterëve të mire-formuluara për vlerësimin periodik të cilësive etike të gjyqtarit (si vazhdim i vlerësimit të integritetit që kryhen përpara emërimit).

Deklarimi i pasurisë, të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

95. Siç edhe është shprehur më sipër, procedura e deklarimit të pasurive konsiderohet gjerësisht si një mjet i rëndësishëm në luftën ndaj korrupsionit dhe arritjen e transparencës më të madhe të interesave private të zyrtarëve, përfshirë anëtarët e sistemit gjyqësor. Megjithatë, problematikat që vijnë nga mungesa e publikimit në kohë të deklaratave të pasurisë së deputetëve, kanë të njëjtin efekt për të gjitha kategoritë e gjyqtarëve dhe çojnë në zvogëlimin e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Thënë kjo, rreziqet e krijuara nga ky publikim me vonesë i këtyre deklaratave, zbuten në njëfarë mase nga kohëzgjatja e shërbimit të gjyqtarit, e cila nuk është e parashkruar. Për këtë arsye, GRECO nuk mund të japë një rekomandim specifik për këtë çështje; prapëseprapë i inkurajon autoritetet të sigurojnë botimin në kohë të deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve në një faqe zyrtare në internet, duke pasur në mendje privatësinë dhe sigurinë e gjyqtarëve dhe anëtarëve të familjes së tyre që i nënshtrohen këtij detyrimi deklarues.

...

Mbikëqyrja e deklarimit të pasurive, të të ardhurave, detyrimeve dhe interesave

97. Mbikëqyrja e deklaratave të pasurisë së gjyqtarëve është, gjithashtu, detyrë e ILDKPI-së. Kjo mbikëqyrje kryhet njësoj si ajo që zbatohet për anëtarët e parlamentit, me përjashtim të faktit se deklaratat e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve anëtarë të KLD-së [Këshillit të Lartë të Drejtësisë] i nënshtrohen kontrollit çdo dy vjet, gjyqtarët e gjykatave të apelit – çdo tre vjet dhe, së fundmi, deklaratat e gjyqtarëve të gjykatave të rrethit i nënshtrohen kontrolleve vjetore sipas rastit. Në rast refuzimi ose mosdeklarimi, fshehje ose deklarimi të rremë të pasurisë, ILDKPI-ja ia referon çështjen Prokurorisë për procedim penal, KLD-së dhe ministrit të Drejtësisë – për [masën] disiplinore të shkarkimit nga detyra.

...

99. Siç u përmend më lart, gjyqtarët mbajnë përgjegjësi disiplinore për shkelje të ligjit dhe kryerje të veprimeve dhe sjellje që diskreditojnë reputacionin dhe integritetin e tyre. Shkeljet “shumë të rënda” (p.sh. mosrespektimi i rregullave të papajtushmërisë; refuzimi për të deklaruar, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë; marrja, drejtpërdrejt ose indirekt, e dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimit preferencial, gjatë ushtrimit të detyrave; mosheqja dorë nga gjykimi; mungesa absolute e arsytimit në një vendim gjyqësor) sanksionohen me masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Shkeljet “e rënda” (p.sh. vonesat e përsëritura dhe të pajustificuara procedurale; ndërhyrjet ose çfarëdo lloj ndikimi tjetër të ushtruar mbi një gjyqtar tjetër; shkelja e normave etike në marrëdhëniet me palët, kolegët, kryetarin e gjykatës dhe stafin, ekspertët, prokurorët dhe avokatët) dënohen me transferim nga një deri në dy vjet në një gjykatë të shkallës më të ulët ose të nivelit të njëjtë jashtë rrethit gjyqësor të emërimit të gjyqtarit. Së fundmi, shkeljet “e vogla” çojnë në vërejtje ose vërejtje me paralajmërim.

100. Procedimet disiplinore kryhen nga KLD-ja. Periudha e parashkrimit është një vit nga data e konstatimit të shkeljes nga ministri i Drejtësisë dhe pesë vjet nga data e kryerjes së saj.”

c) Raporti i Komisionit të Venecias

221. Më datë 9 dhjetor 2020, Komisioni i Venecias publikoi një mendim urgjent mbi situatën kushtetuese të shkaktuar nga një vendim i Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës, e cila kishte deklaruar si antikushtetuese disa parashikime ligjore në sferën e antikorrupsionit, përfshirë një dispozitë të ligjit penal që parashikonte përgjegjësinë penale për dorëzimin e deklaratave të rreme të pasurisë ose mosdorëzimin e deklaratës. Disa nga paragrafët të mendimit të Komisionit të Venecias që lidhen me këtë çështje, janë si më poshtë:

“34. Duke qenë se argumenti kryesor i [Gjykatës Kushtetuese të Ukrainës] është pretendimi për “mungesë proporcionaliteti” të [dispozitës së ‘ligjit penal’], sanksione të vendosura sipas situatës, mund të parashikohen në dispozitën e rishikuar: për shembull, sanksioni i dënimit me burg mund të ruhet vetëm për rastet mbi një prag të caktuar dhe për autorët e krimit që veprojnë me dashje të qëllimshme. Thënë kjo, në këndvështrimin e Komisionit [të Venecias], niveli i gjobave monetare dhe sanksioneve të tjera duhet të jenë mjaft të larta për të vepruar si [një] parandalues dhe për të siguruar një dënim që është proporcional me rëndësinë që ka lufta kundër korrupsionit në Ukrainë. Sanksioni i dënimit me burg duhet të ruhet për shkeljet më të rënda.

C. Praktikë gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE)

1. Vendimet në çështjet “Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës së Lartë, C-619/18) dhe Komisioni kundër Polonisë (Pavarësia e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm)”

222. Në përgjigje të një padie në lidhje me pretendimet për shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian që vijnë nga miratimi i një ligji të ri të brendshëm në Gjykatën e Lartë të Polonisë, të paraqitur nga Komisioni Evropian kundër Polonisë (Çështja e Komisionit kundër Polonisë (Pavarësia e Gjykatës së Lartë), C 619/18), më 24 qershor 2019, Kolegji i Lartë i GJDBE-së u shpreh se Polonia nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas ligjit të Bashkimit Evropian, së pari, duke thënë se masa që konsistonte në uljen e moshës së pensionit në 65 vjeç të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë aplikohet për gjyqtarët në detyrë të cilët ishin emëruar në atë gjykatë përpara datës në të cilën ligji përkatës kishte hyrë në fuqi dhe, së dyti, duke i dhënë Presidentit të Republikës lirinë e veprimit për të zgjatur periudhën e veprimtarisë gjyqësore të gjyqtarëve të asaj gjykate përtej moshës së pensionit të caktuar rishtas. GJDBE-ja u shpreh se zbatimi i masës që ulte moshën e pensionit të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për gjyqtarët në detyrë brenda asaj gjykate nuk ishte i justifikuar nga një qëllim i arsyeshëm dhe minonte parimin e mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili ishte thelbësor për pavarësinë e tyre.

223. Në përgjigje të ndërmarrjes së ndonjë veprimi në lidhje me pretendimet për shkelje të ligjit të Bashkimit Evropian të shkaktuara nga ndryshimet në ligjin polak për gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm, të sjella nga Komisioni Evropian kundër Polonisë (Çështja e Komisionit kundër Polonisë (Pavarësia e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm C 192/18), më datë 5 nëntor 2019, Kolegji i Lartë i GJDBE-së u shpreh se Polonia nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas ligjit të Bashkimit Evropian, së pari, duke caktuar një moshë tjetër pensioni për meshkujt dhe femrat që ishin gjyqtarë ose prokurorë publik në Poloni dhe, së dyti, duke ulur moshën e pensionit të gjyqtarëve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm duke i dhënë ministrit të Drejtësisë kompetencën për të zgjatur periudhën e shërbimit aktiv të atyre gjyqtarëve. Sa i përket pushtetit të dhënë ministrit të Drejtësisë, GJDBE-ja konstatoi se dispozitat ligjore kombëtare që përcaktonin kushtet themelore dhe rregullat e hollësishme procedurale që rregullojnë miratimin e vendimeve nga ministri i Drejtësisë krijuan “dyshime të arsyeshme, ndër të tjera, në mendjet e individëve, për sa i përket mosndikimit të gjyqtarëve nga faktorët e jashtëm dhe për asnjësinë e tyre në lidhje me çdo interes që mund të jetë subjekt i argumenteve para tyre”. GJDBE-ja vlerësoi më tej se pushteti i mbajtur nga ministri i Drejtësisë nuk arriti të përputhet me parimin e mosheqjes nga detyra, e cila ishte e natyrshme në pavarësinë e gjyqësorit.

224. Për aq sa aplikohet për qëllimet e çështjes në fjalë, GJDBE-ja iu referua në të dyja vendimet, ndër të tjera, parimeve të përgjithshme si më poshtë:

“Parimi i mosheqjes nga detyra kërkon, në veçanti, që gjyqtarët të mund të qëndrojnë në detyrë me kusht që ata të mos kenë arritur moshën e pensionit të detyrueshëm ose deri në përfundimin e

mandatit të tyre, nëse ky mandat ka një afat të përcaktuar. Meqenëse kjo nuk është plotësisht absolute, nuk mund të ketë përjashtime nga ky parim vetëm nëse këto përjashtime bazohen në shkaqe të arsyeshme dhe imponuese, në varësi të parimit të proporcionalitetit. Kështu që është pranuar gjerësisht që gjyqtarët mund të shkarkohen nga detyra nëse ata vlerësohen të papërshtatshëm për kryerjen e detyrave të tyre për shkak të paaftësisë ose shkeljes serioze të detyrimeve të tyre, me kusht që të ndiqen procedurat e duhura (mungon referenca).

Bazuar në sa më sipër, është më e qartë, më së shumti nga praktika gjyqësore e [GJDBE-së] se me 'pavarësi' nënkuptohet rregullat që rregullojnë regjimin disiplinor dhe, sipas rastit, çdo shkarkim i atyre që kanë për detyrë të gjykojnë një mosmarrëveshje duhet të sigurojë garancitë e nevojshme në mënyrë që të parandalojnë çdo rrezik që ai regjim disiplinor të përdoret si një sistem i kontrollit politik të përmbajtjes së vendimeve gjyqësore. Kështu, rregullat që përcaktojnë, në veçanti, si sjelljen që përbën shkelje disiplinore ashtu edhe dënimet e zbatueshme, të cilat parashikojnë përfshirjen e një organi të pavarur në përputhje me një procedurë e cila mbron plotësisht të drejtat e parashikuara në ... Kartën [e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian], në veçanti të drejtat e mbrojtjes, dhe të cilat përcaktojnë mundësinë e inicimit të procedurave gjyqësore që kundërshtojnë vendimet e organeve disiplinore përbëjnë një sërë garancish që janë thelbësore për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit.”

2. *Vendimi në çështjen e A.K. kundër të Tjerëve (Pavarësia e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës së Lartë, C-585/18 dhe C-625/18).*

225. Në përgjigje të tri kërkesave për një vendim paraprak në lidhje me pavarësinë e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës Lartë të Polonisë të sapo themeluar, të bëra nga Dhoma e Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë të Polonisë (Çështja AK dhe të tjerët (Pavarësia e Kolegjit për çështjet Disiplinore të Gjykatës së Lartë), C 585/18, C-624/18 dhe C-625/18), më 19 nëntor 2019, Kolegji i Lartë i GJDBE-së u shpreh se gjykata referuese duhej të konstatonte nëse Kolegji i ri Disiplinor i Gjykatës së Lartë ishte i pavarur për të përcaktuar nëse ky kolegji kishte juridiksion për të vendosur mbi çështjet ku gjyqtarët e Gjykatës së Lartë ishin në pension, ose për të përcaktuar nëse çështje të tilla duhej të shqyrtoheshin nga një gjykatë tjetër e cila do të plotësonte kushtin që gjykatat duhet të jenë të pavarura.

226. Duke vepruar kështu, gjykata referuese duhej të vlerësonte rrethanat në të cilat u emëruan gjyqtarët e rinj të Kolegjit për çështjet Disiplinore dhe rolin e Këshillit Kombëtar Polak të Gjyqësorit (“KKPGJ”) në bërjen e propozimeve për emërimin e Presidentit të Republikës të Polonisë. Në mënyrë specifike, gjykata referuese duhej të shqyrtonte faktorët specifik të mëposhtëm, të cilët GJDBE i kishte identifikuar, në mënyrë që të konstatonte nëse Kolegji për Çështjet Disiplinore të Gjykatës Lartë ofronte garanci të mjaftueshme pavarësie: rregullat që rregullojnë emërimin e gjyqtarëve të Kolegjit të ri për çështjet Disiplinore; ii. shkallën e pavarësisë që gëzon KKGJ-ja polak nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv në ushtrimin e përgjegjësive që gëzon sipas ligjit të brendshëm; iii. mënyra në të cilën KKGJ polak ushtroi përgjegjësitë e tij kushtetuese për të siguruar pavarësinë e gjykatave dhe gjyqësorit dhe kompetencat e tij të ndryshme, veçanërisht nëse e bëri atë në një mënyrë që arriti të vinte në dyshim pavarësinë e tij nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv; iv. efektiviteti i rishikimit gjyqësor të një rezolute të KKGJ polak, duke përfshirë vendimet e tij në lidhje me propozimet për emërim në postin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, i cili, së paku, do të ishte në gjendje të shqyrtonte nëse nuk kishte tejkalim kompetencash apo ushtrim gabuar i pushtetit, zbatim i gabuar i ligjit ose gabim i dukshëm në vlerësim.

227. Përveç kësaj, gjykata referuese duhej të shqyrtonte karakteristika të tjera që karakterizuan direkt Kolegjin e Ri Disiplinor, të tilla si: i. juridiksioni i tij ekskluziv për të vendosur mbi një numër specifik çështjesh që më parë binin në juridiksionin e gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm, përbërja e vetëm gjyqtarëve të emëruar rishtas, duke përjashtuar gjyqtarët që tashmë shërbenin në Gjykatën e Lartë; dhe iii. shkallën veçanërisht të lartë të autonomisë krahasuar me kolegjet e tjera të Gjykatës së Lartë.

228. Në mënyrë të përgjithshme, GJDBE theksoi disa herë se, edhe pse secili prej faktorëve të shqyrtuar, më vete, nuk arritën të vinin në dyshim pavarësinë e Kolegjit Disiplinor, kjo mund të

ndodhte nëse ato do të ishin shqyrtuar së bashku.

229. Pas vendimit të GJDBE, Kolegji i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë të Polonisë shpalli tri vendime mbi çështjet që ishin referuar për një vendim paraprak në GJDBE (një më 5 dhjetor 2019 dhe dy më 15 janar 2020). Vendimi i datës 5 dhjetor 2019 përmbante shkaqe gjithëpërfshirëse dhe vuri në zbatim treguesit në lidhje me standardet e zbatueshme të dhëna nga GJDBE-ja. Kolegji i Punës dhe Sigurimeve Shoqërore të Gjykatës së Lartë arriti në përfundimin se KKGJ-ja e Polonisë nuk ishte një organ i paanshëm dhe i pavarur nga pushtetit legjislativ dhe ai ekzekutiv. Për më tepër, ajo arriti në përfundimin se Kolegji Disiplinor i Gjykatës së Lartë i sapo krijuar, nuk ishte një gjykatë sipas kuptimit të ligjit të brendshëm dhe Konventës.

E DREJTA

1. PRETENDIMI PËR SHKELJE TË NENIT 6/1 TË KONVENTËS

230. Kërkesja pretendon se organeve të rivlerësimit u mungonte pavarësia dhe paanësia, siç kërkohet nga neni 6/1 i Konventës, për shkaqet e mëposhtme: i. organet e rivlerësimit përbëhen nga anëtarë jogjyqtarë të cilët nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur; ii. anëtarët e organeve të rivlerësimit u emëruan nga parlamenti pa përfshirë përfaqësues nga gjyqësori; iii. organet e rivlerësimit kryen hetimin paraprak administrativ, përgatitën “akuzën” dhe vendosën mbi themelin e “akuzës”.

231. Po ashtu, bazuar në nenin 6/1 të Konventës, ajo pretendoi se pati parregullsi në procesin gjyqësor në çështjen e saj, për arsye se: i. asaj i ishte refuzuar e drejta për të kundërshtuar arsyen kryesore të shkarkimit të saj dhe për të mbrojtur veten; ii. KPK-ja i kishte kaluar një barrë të paarsyeshme prove në lidhje me rrethanat që kishin lindur dekada më parë; iii. ligji nr. 84/2016 nuk kishte parashikuar ndonjë periudhë kufizimi; iv. vendimet në çështjen e saj nuk kishin arsyetim në lidhje me argumentet e saj; v. organet e rivlerësimit kishin zbatuar standarde të dyfishta krahasuar me çështjet e tjera; vi. Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk e kishte pranuar kërkesën e saj për të paraqitur prova të tjera shfajësuese; vii. ajo nuk kishte pasur kohë dhe lehtësira të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e saj; viii. Kolegji nuk zhvilloi një seancë publike; dhe ix. organet e rivlerësimit kishin shkelur parimin e sigurisë ligjore dhe pritshmërisë së ligjshme duke qenë se kishin shpërfillur vlerësimin e pasurive të saj të kryera nga ILDKPI që kishte rezultuar pozitiv.

232. Në lidhje me këtë, neni 6/1 i Konventës, parashtron si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile ... çdokush ka të drejtën për një seancë të drejtë dhe publike ... nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj.”

A. Pranueshmëria

233. Gjykata, duke pasur parasysh parashtrimet e palëve, do të përcaktojë çështjet për sa i përket zbatimit të nenit 6/1, shterimin e mjeteve juridike të brendshme dhe respektimin e afatit gjashtëmujor.

1. Zbatimi i nenit 6§1

a) Parashtrimet e palëve

234. Qeveria pranoi që neni 6/1 i Konventës aplikohet në aspektin e tij civil. Për shkak të natyrës administrative të procedurave të rivlerësimit, qeveria nuk pranoi aplikimin e nenit 6/1 të Konventës në aspektin e tij penal.

235. Edhe kërkesja u shpreh, gjithashtu, që neni 6 aplikohet në aspektin civil të tijin. Ajo më tej argumentoi, duke iu referuar çështjes *Matyjekë kundër Polonisë* (dec.), nr. 38184/03, GJEDNJ 2006 VII, se neni 6 aplikohet në aspektin penal për arsyet e mëposhtme: i. KPK-ja, i cili kishte kryer hetimin paraprak dhe kishte dhënë një vendim në shkallë të parë, i ishin dhënë kompetenca të ngjashme me ato të një prokurori publik; ii. pozicioni i tij në procesin e rivlerësimit kishte qenë i njëjtë me atë të një të akuzuarit në një proces penal; iii. natyra e shkeljes, përkatësisht dhënia e deklaratave të pavërteta në deklarinimin e pasurisë, ishte e njëjtë me atë të dëshmisë së rreme, me pasojë ndjekjen penale; dhe iv. natyra dhe shkalla e së dënimit në fjalë, përkatësisht shkarkimi nga detyra, pretendohet se ka sjellë një ndalim të pacaktuar për të aplikuar për një numër të madh postesh publike.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Aplikimi i nenit 6/1 nën aspektin civil të tij

236. Gjykata vëren se palët nuk kundërshtuan aplikimin e nenit 6/1 të Konventës nën aspektin civil. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin midis nëpunësve civilë dhe Shtetit nuk bien nën aspektin civil të nenit 6, nëse plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative. Në radhë të parë, shteti në legjislacionin e tij të brendshëm duhet të ndalojë shprehimisht aksesin në gjykatë për pozicionet ose kategorinë e personelit në fjalë. Së dyti, ky ndalim duhet të justifikohet për arsye objektive në interes të Shtetit (*shih, për shembull, çështjen Vilho Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës [GC], nr. 63235/00, paragrafi 62, GJEDNJ 2007 II, në vijim “testi Vilho Eskelinen”*).

237. Edhe pse sistemi gjyqësor nuk është pjesë e shërbimit të përgjithshëm civil, ai konsiderohet pjesë e shërbimit të zakonshëm publik. Prandaj, neni 6/1 ka gjetur zbatim në proceset për shkarkimin e gjyqtarëve, kryesisht për faktin se gjyqtarët kishin të drejtë aksesin në gjykatat kombëtare për të kundërshtuar shkarkimin e tyre (*shih, për shembull, Olujić kundër Kroacisë, nr. 22330/05, paragrafët 42–43, 5 shkurt 2009; Oleksandr Volkov kundër Ukrainës, nr. 21722/11, paragrafët 90–91, GJEDNJ 2013; Poposki dhe Duma kundër ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 69916/10 dhe 36531/11, paragrafi 37, 7 janar 2016; dhe Sturua kundër Gjeorgjisë, nr. 45729/05, paragrafi 27, 28 mars 2017*).

238. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, dhe për sa i përket kushtit të parë të përcaktuar në testin *Vilho Eskelinen*, Gjykata vëren se, institucionet e procesit të rivlerësimit, KPK-ja në shkallën e parë dhe KPA-ja në shkallën e apelit, e shkarkuan kërkuesen nga pozicioni i saj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese. Dhe në fakt, ligji i brendshëm nuk ia mohoi të drejtën kërkueses për të kundërshtuar shkarkimin e saj.

239. Megjithatë, duke qenë se Gjykata si fillim duhet të përcaktojë nëse KPK-ja dhe KPA-ja konsiderohen si “gjykatë e themeluar me ligj”, ajo çmon se aplikimi i nenit 6/1 të Konventës nën aspektin civil të tij, duhet t’i bashkëngjitet themelit të këtij ankimi.

ii. Aplikimi i nenit 6/1 nën aspektin e tij penal

240. Gjykata vëren se palët nuk ishin dakord nëse aspekti penal i nenit 6/1 mund të gjente zbatim në këtë rast.

241. Gjykata thekson se të dyja aspektet, civile dhe penale, të nenit 6/1 nuk janë domosdoshmërisht përjashtuese në mënyrë reciproke (*shih Albert dhe Le Compte kundër Belgjikës, 10 shkurt 1983, paragrafi 30, seria A nr. 58*). Koncepti i një “kallëzimi penal” sipas nenit 6/1 është një koncept autonom. Praktika gjyqësore e vendosur e Gjykatës përcakton tri kriteret, të njohura në përgjithësi si “kriteret e Engel-it”, për t’u marrë në konsideratë e për të përcaktuar nëse pati apo jo një “akuzë penale” (*shih Engel dhe të tjerët kundër Holandës, 8 qershor 1976, paragrafi 82, seria A nr. 22*). Kriteri i parë është klasifikimi ligjor i veprës penale sipas ligjit të brendshëm, i dyti është vetë natyra e veprës penale, dhe i tretë është shkalla e ashpërsisë së dënimit që personi në fjalë rrezikon të marrë. Kriteri i dytë dhe i tretë janë alternative, dhe jo domosdoshmërisht kumulative.

Megjithatë, kjo nuk përjashton një qasje kumulative kur analiza e veçantë e secilit kriter nuk bën të mundur arritjen e një konkluzioni të qartë për ekzistencën e një akuze penale (*shih, ndër autoritetet e tjera, Ramos Nunes de Carvalho e Sá kundër Portugalisë [GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, paragrafi 122, 6 nëntor 2018, dhe referencat e cituara në të*).

242. Në çështjen *Matyjek* (cituar më lart, paragrafët 49-58), duke vlerësuar që neni 6 aplikohet nën aspektin penal të tij për proceset gjyqësore të lustracionit sipas ligjit polak, Gjykata kishte parasysh faktin që Kodi Polak i Procedurës Penale ishte i zbatueshëm për proceset gjyqësore, se natyra e veprës për të cilën kërkuesi kishte qenë subjekt i lustracionit, përkatësisht dhënia e një deklaratë të rremë, ishte e ngjashme me veprën penale të dëshmisë së rreme dhe se sanksioni i vendosur ndaj tij, ndalimi i emërimit në një sërë pozicionesh publike për dhjetë vjet, ishte i rëndë.

243. Duke iu kthyer çështjes fjalë, në lidhje me kriteret e para të Engel, përkatësisht klasifikimin e brendshëm të veprës, Gjykata vëren se procesi i rivlerësimit ndaj kërkueses, që ishte i një natyre disiplinore, drejtohej nga ligji nr. 84/2016 bashkë me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Administrative, ligjin për gjykatat administrative ose Kodin e Procedurës Civile, sipas rastit. Asnjëherë nuk u referua apo u përmend zbatimi apo interpretimi i Kodit Penal ose Kodit të Procedurës Penale.

Procedurat e rivlerësimit u zhvilluan nga një organ i krijuar posaçërisht për këtë qëllim, KPK-ja, që i nënshtroheshin më vonë ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit dhe në përcaktimin e rezultatit të tyre nuk ishin të përfshirë as autoritetet e ndjekjes penale dhe as gjykatat penale. Për më tepër, neni Ç, pika 5 e aneksit të Kushtetutës parashikon vetëm kalimin e barrës së provës në procesin e rivlerësimit, duke u përjashtuar shprehimisht gjatë çdo procesi penal më vete, dhe neni DH, pika 2 e aneksit të Kushtetutës ndalon në mënyrë të qartë përdorimin e deklaratave të pastërtisë së figurës në çdo proces penal (*shih paragrafët 107 dhe 109 më lart*). Për këto arsye, Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e kërkuësës se pozicioni i saj kishte qenë si ai i një të akuzuari në një proces penal ose se kompetencat e KPK-së ishin të ngjashme me ato të një prokurori publik.

244. Sa i përket kriterit të dytë – natyra e veprës – Gjykata vëren se dispozitat ligjore në fuqi u hartuan vetëm për një kategori të veçantë zyrtarësh, veçanërisht, gjyqtarët, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë, dhe jo për publikun e gjerë. Dispozitat u krijuan për të mbrojtur sjelljen, nderin dhe reputacionin e profesioneve dhe për të ruajtur besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Ato ishin thjesht të një natyre disiplinore dhe nuk ishin të veshura me elemente të natyrës kriminale. Që kërkuësja t'i nënshtrohet procedimit penal në të ardhmen për shkak të deklaramit të rremë të pasurive, nuk mjafton për ta shtrirë procesin e rivlerësimit edhe në aspektin penal. Në lidhje me këtë, fakti që një veprim i cili mund të çojë në një sanksion disiplinor, gjithashtu, përbën një veprë penale nuk është i mjaftueshëm për ta bërë një person përgjegjës sipas ligjit disiplinor si “të akuzuar” për një krim (*shih Müller-Hartburg kundër Austrisë, nr. 47195/06, paragrafi 44, 19 shkurt 2013, dhe Biagoli kundër San Marino (dek.), nr. 64735/14, paragrafi 56, 13 shtator 2016*). Që neni 6/1 të mund të gjente aplikim nën aspektin penal të tij do të ishte vetëm në kontekstin e ndonjë procedimi penal më vete në të ardhmen, i cili mund të ngrihet kundër kërkuësës.

245. Në lidhje me kriterin e tretë, që është, shkalla e ashpërsisë së dënimit, Gjykata vëren se shkarkimi i kërkuësës është një sanksion karakteristik i një veprë disiplinore dhe nuk mund të ngatërrohet me një dënim penal. Ndaj saj nuk u vendos asnjë gjobë pas shkarkimit të saj. Gjykata më tej vëren se ligji nr. 84/2016 nuk ka parashikuar ndalim të përhershëm të aplikimit për pozicionet në sistemin e drejtësisë. Sidoqoftë, ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve ka ndaluar që gjyqtarët dhe prokurorët të cilët janë shkarkuar nga detyra të bëhen sërish pjesë e sistemit të drejtësisë (*shih paragrafin 206 më lart*). Sido që të jetë, ky ndalim, në çdo rast, nuk do të ishte në vetvete vendimtar për ta konsideruar procesin e rivlerësimit si penal për arsyet e mëposhtme. Ky ndalim nuk është parashikuar në Kodin penal dhe nuk mund të konsiderohet si një sanksion me natyrë kriminale. Qëllimi i ndalimit për t'u ribërë pjesë e sistemit të drejtësisë nuk duket të jetë vendosja e një ndëshkimi për shkarkimin nga detyra, por më tepër ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Edhe pse, në vetvete, ky ndalim duket sikur është një pasojë mjaft e rëndë, shumë masa jopenale të një natyre parandaluese mund të kenë një ndikim thelbësor mbi personin në fjalë. Fakti i thjeshtë që ndalimi është i një natyre të përhershme nuk mjafton ta konsiderojmë atë si një ndëshkim (*shih, mutatis mutandis, Rola kundër Sllovenisë, nr. 12096/14 dhe 39335/16, paragrafi 66, 4 qershor 2019*). I njëjti konstatim do të zbatohet edhe për pretendimin që kërkuësja nuk ka të drejtë të jetë pjesë e shërbimit civil, një pretendim spekulativ të cilin ajo nuk e ka kundërshtuar përpara gjykatave vendëse.

246. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se elementet e mësipërme, të marra në mënyrë alternative ose kumulative, janë të pamjaftueshme për të arritur në një përfundim se neni 6 është i zbatueshëm nën aspektin e tij penal (*shih, ndër autoritetet e tjera, Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafët 124-27; Kamenos kundër Qipros, nr. 147/07, paragrafi 51, 31 tetor 2017; Ivanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, nr. 29908/11, paragrafi 121, 21 janar 2016; dhe Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafët 93-95*).

2. Shërbimi i mjeteve juridike

247. Qeveria parashtrroi që kërkuësja nuk kishte paraqitur ankim përpara KPK-së apo ankim përpara KPA-së që KPK-ja kishte hartuar “akuzën” dhe kishte vendosur mbi themelin e “akuzës”.

248. Kërkuesja pohoi se ajo i kishte përdorur të gjitha mjetet juridike të brendshme dhe kishte paraqitur ankimin e saj pranë Kolegjit të Apelimit.

249. Gjykata vë në dukje se qëllimi i rregullit të shterimit të mjeteve juridike është t'i japë një Shteti kontraktues mundësinë e adresimit, dhe në këtë mënyrë, të parandalimit ose rregullimit të shkeljes në fjalë të Konventës që pretendohet kundër tij. Është e vërtetë që sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës nuk është gjithmonë e nevojshme që Konventa të përmendë qartazi në proceset e brendshme me kusht që pretendimi të shqyrtohet "të paktën në përmbajtje". Kjo do të thotë që kërkuesi duhet të ngrejë argumente ligjore me të njëjtin efekt ose të ngjashëm në bazë të ligjit të brendshëm, në mënyrë që t'u japë gjykatave vendëse mundësinë për të ndrequr shkeljen e pretenduar. Sidoqoftë, siç shpjegohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës, për t'i dhënë vërtet një Shteti nënshkruar të Konventës mundësinë e parandalimit ose korrjigimit të shkeljes së pretenduar, kërkohet që të merren parasysh jo vetëm faktet, por edhe argumentet ligjore të kërkuesit për të përcaktuar nëse ankimi i paraqitur në Gjykatë me të vërtetë ishte ngritur paraprakisht, në thelb, përpara organeve vendëse (*shih Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë [GC], nr. 37685/10 dhe 22768/12, paragrafi 117, 20 mars 2018 dhe referencat e cituara në të*).

250. Duke iu kthyer rrethanave të çështjes në fjalë, Gjykata vëren se më datë 9 qershor 2018, kërkuesja paraqiti një ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit kundër vendimit të KPK-së, duke parashtruar pretendime të shumta me natyrë procedurale dhe materiale. Në të vërtetë, ankimi vuri në dukje dështimin e pretenduar nga ana e KPK-së për të ofruar garancitë procedurale dhe problematikat me rolet e tij paralele, atë të mbledhjes së provave dhe informacionit dhe vendimmarrjes mbi themelin e çështjes. Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruara në ankimin e kërkueses janë të ngjashme me argumentet me të njëjtin efekt ose të ngjashëm me ato që ajo ka ngritur para kësaj Gjykate për mungesë paanshmërisë nga ana e KPK-së me arsyetimin se Komisioni edhe kishte ngritur "akuzën" edhe kishte vendosur mbi themelin e çështjes së saj. Sipas mendimit të Gjykatës, ajo ngriti këtë shkak ankimi "të paktën në thelb" përpara Kolegjit të Apelimit, i cili, duke iu referuar nenit F të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63 të ligjit nr. 84/2016 (*shih paragrafët 112 dhe 152 më lart*), është një mjet/zgjidhje për t'u shteruar për qëllimet e nenit 35/1 të Konventës.

251. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se kundërshtimi i qeverisë në këtë drejtim nuk duhet të pranohet.

3. Pajtueshmëria me afatin gjashtëmujor

252. Nga shqyrtimi i saj mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes, të paraqitura më datë 10 janar 2020, kërkuesja u shpreh se: i. tre anëtarë të trupit gjykues të KPA-së nuk përmbushnin kriteret ligjore të pranueshmërisë për t'u përzgjedhur dhe, më pas, për t'u emëruar si anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; dhe ii. njëri prej anëtarëve të KPA-së nuk kishte deklaruar konfliktin e interesit në lidhje me dënimin e vëllait të atij anëtari në vitin 1997 nga një gjykatë apeli, në të cilën babai i kërkueses kishte qenë pjesë e trupit gjykues. Kërkuesja pretendoi se ajo kishte mësuar për konfliktin e interesit më datë 25 nëntor 2019, pasi i ishte sjellë në mendje nga një gjyqtar tjetër i Gjykatës Kushtetuese i cili ishte shkarkuar nga detyra si rezultat i procesit të rivlerësimit.

253. Gjykata vëren se edhe pse nga ana e qeverisë nuk pati ndonjë kundërshtim në lidhje me mosrespektimin e afatit gjashtëmujor nga ana e kërkueses, nuk është në dorën e Gjykatës të shpërfillë zbatimin e rregullit gjashtëmujor mbi këtë bazë (*shih Blečić kundër Kroacisë [GC], nr. 59532/00, paragrafi 68, GJEDNJ 2006 III, dhe, më pas, Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafi 98*). Prandaj, Gjykata duhet të konstatojë nëse ato pretendime ishin pjesë e ankimit fillestar, parashtrimi i të cilave ndërpreu afatin e periudhës gjashtëmujore.

254. Në ankimin fillestar, kërkuesja pretendonte se organet e vetingut nuk kishin qenë të pavarura dhe të paanshme, për arsytet e paraqitura në paragrafin 230 më lart. Ajo nuk e ngriti në thelb apo edhe në mënyrë të nënkuptuar pretendimin se tre anëtarë të Kolegjit të Apelimit nuk përmbushnin kriteret ligjore të pranueshmërisë. Ajo nuk pretendoi se kishte hasur ndonjë vështirësi në marrjen e informacionit të besueshëm – dhe zyrtar – mbi përzgjedhjen e këtyre anëtarëve sipas kriterëve ligjore, përpara se akuza të tilla të dilnin në dritë, dhe në çdo rast, pas publikimit të çështjes *Sevdari kundër*

Shqipërisë (nr. 40662/19) më datë 22 nëntor 2019, në të cilën palët u pyetën në mënyrë specifike në lidhje me rezultatin e proceseve të brendshme kundër anëtarëve të caktuar të Kolegjit mbi pretendimin për mospërmbushje të kriterëve ligjore të pranueshmërisë. Në rrethana të tilla, Gjykata nuk është e bindur që kërkesja kish pasur pengesa për të gjetur një material të tillë gjatë proceseve të brendshme dhe të shprehte ndonjë dyshim ndaj KPA-së në lidhje me përputhshmërinë e anëtarëve të tij me kriteret ligjore të pranueshmërisë. Për më tepër, ajo nuk ndërmori asnjë hap për të kundërshtuar mospërputhjen e pretenduar të anëtarëve të caktuar të KPA-së me kriteret ligjore për pranueshmërinë para autoriteteve përkatëse kombëtare pas paraqitjes së kërkesës së saj në Gjykatë dhe përpara se Gjykata të merrte një vendim mbi pranueshmërinë. Për më tepër, procedurat e brendshme të verifikimit për sa i përket përmbushjes së kriterëve ligjore të përzgjedhjes për këta anëtarë, janë aktualisht në proces e sipër nga organet vendëse.

255. Kërkesja, gjithashtu, në kërkesën fillestare nuk pretendoi se anëtari i katërt i trupës gjyqesore të Kolegjit nuk kishte deklaruar konfliktin e interesit dhe të hiqte dorë nga procesi. Pretendimi se ajo u vu në dijeni të këtij fakti më datë 25 nëntor 2019, pa vërtetuar faktin se ajo nuk mund të kishte dijeni për vendimin e gjykatës së apelit të vitit 1997 para asaj date, nuk mund të justifikojë shmangien e saj nga detyrimi për të vepruar me kujdesin e duhur gjatë procedurave të brendshme, të merrte informacion zyrtar dhe të kundërshtonte pjesëmarrjen e këtij anëtari në trupën gjyqesore të KPA-së. Bazuar në këtë situatë, Gjykata nuk është e bindur se ishte e pamundur që kërkesja të mësonte për këtë gjë gjatë mbajtjes së proceseve të brendshme.

256. Fakti që kërkesja i është referuar nenit 6 të Konventës në kërkesën e saj dhe se Qeveria e paditur u njoftua për këtë kërkesë po sipas këtij neni, nuk mjafton për të justifikuar paraqitjen e pretendimeve që pasuan bazuar në këtë dispozitë, kur nuk kishte asnjë tregues faktik në shkaqet e ankimit të paraqitura fillimisht në formularin e aplikimit. Duke qenë se fushëveprimi i nenit 6 të Konventës është shumë i gjerë, shqyrtimi i Gjykatës do të kufizohet detyrimisht në shkaqet specifike të ankimit që kërkesi ka paraqitur fillimisht (*shih Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafët 103–04*).

257. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesja i ka ngritur për herë të parë këto shkaqe më 10 janar 2020, më shumë se gjashtë muaj pas shpalljes së vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit më datë 23 nëntor 2018 (*shih paragrafin 59 më lart*). Gjykata ka konstatuar edhe më parë një pretendim të ri në parashtrimet e kërkeses mbi pranueshmërinë dhe themelin e çështjes që ishte paraqitur jashtë afatit gjashtëmujor, në kundërshtim me nenin 35/1 të Konventës (*shih, ndër autoritetet e tjera, Fábíán kundër Hungarisë [GC], nr. 78117/13, paragrafi 98, 5 shtator 2017 dhe Majski kundër Kroacisë, nr. 33593/03, paragrafi 34, 1 qershor 2006*). Si pasojë, ky pretendim është paraqitur jashtë afatit ligjor dhe nuk duhet të pranohet në përputhje me nenin 35/1 dhe 4 të Konventës

4. Përfundime në lidhje me pranueshmërinë

258. Gjykata vëren se, me përjashtim të shkakut të ankimit të kërkeses sipas nenit 6/1 të deklaruar i papranueshëm në paragrafin 257 më lart, shkaqet e tjera në ankim nuk janë qartësisht të pabazuara apo të papranueshme për ndonjë arsye tjetër të renditur në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ato duhet të deklarohen të pranueshme.

B. Themeli i çështjes

259. Në funksion të pretendimeve të shumta të kërkeses, Gjykata së pari do të shqyrtojë shkakun e ankimit sipas të cilit ajo pretendon se organeve të rivlerësimit u mungonte pavarësia dhe paanësia. Më pas, gjykata do të shqyrtojë ankimin që lidhet me parregullsitë gjatë procesit dhe ankimin në lidhje me mosmbajtjen e seancës publike nga Kolegji i Posaçëm i Apelit dhe do të përfundojë duke shqyrtuar shkakun e ankimit me anë të cilit ajo pretendon se ka pasur shkelje të parimit të sigurisë ligjore.

1. *Pajtueshmëria me parimin e “një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj”.*

a) Parashtrimet e palëve

i. *Sipas kërkeses*

260. Kërkuesja parashtroi që, në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në një sërë dokumentesh ndërkombëtare, të tilla si Karta Evropiane për Statutet e Gjyqtarëve dhe Magna Carta e Gjyqtarëve, organet e rivlerësimit përbëheshin nga (pothuajse tërësisht) anëtarë jogjyqtarë. Askush nga anëtarët nuk ka përvetësuar përvojën dhe aftësitë e nevojshme ligjore dhe/ose gjyqësore për shqyrtimin e çështjeve komplekse të fakteve dhe të ligjit.

261. Anëtarët e organeve të rivlerësimit u zgjodhën tërësisht nga Parlamenti, pas një procesi parazgjedhor të kryer nga një komision parlamentar *ad hoc*, pa përfshirje të sistemit gjyqësor. Sipas këndvështrimit të kërkueses, roli i ONM-së në mbikëqyrjen e procesit të aplikimit, në dhënien e rekomandimeve për kandidatët dhe duke paraqitur listën e kandidatëve për miratim nga Parlamenti, ishte i kufizuar. Kishte mungesë transparence në procesin e përzgjedhjes pasi kandidatët nuk kishin bërë publike kualifikimet dhe kompetencat e tyre profesionale. Për më tepër, disa kandidatë ishin punësuar në institucionet shtetërore ose të përfshirë në politikë.

262. Për më tepër, mandati i anëtarëve të organeve të rivlerësimit ishte i kufizuar në pesë vjet për anëtarët e KPK-së dhe nëntë vjet për anëtarët e KPA-së. Sipas kërkueses, ky mandat i kufizuar i bëri ata të cenueshëm nga ndikimet e jashtme, gjë që vë në dyshim pavarësinë e tyre. Ajo deklaroi më tej se puna e organeve të rivlerësimit ishte nën vëzhgimin e vazhdueshëm të Qeverisë, e cila, në vitin 2018, u kishte dhënë atyre një “shpërblim për performancën”. Ligji nuk parashikon formalisht mosheqjen e tyre nga detyra.

263. Kërkuesja argumentoi se rezultati përfundimtar i hetimit paraprak që KPK-ja kishte kryer, kishte qenë paragjykes për çështjen e saj. Kjo u theksua edhe nga fakti se barra e provës i kishte kaluar automatikisht dhe ekskluzivisht asaj.

264. Më tej, ajo pretendoi se, që nga marrja e detyrës në vitin 2013, Qeveria nisi të sulmonte drejtpërsëdrejti dhe në mënyrë të ashpër sistemin gjyqësor, duke akuzuar shpesh dhe publikisht gjyqtarët për korrupsion dhe paaftësi profesionale, si dhe duke i quajtur ata “kriminelë”. Madje Kryeministri ishte përfshirë edhe në çështjen e përbërjes së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi. Ajo paraqiti një lajm nga një faqe interneti e një televizioni të datës 2 maj 2018 duke cituar Kryeministrin duke thënë si më poshtë:

“Procesi i rivlerësimit ka filluar tashmë. Çdo ditë [...] ju keni qenë dëshmitarë të rezultateve të cilat do të vazhdojnë të intensifikohen. Gjyqtarët dhe prokurorët e korruptuar do të hiqen nga sistemi. Kushdo që nuk është në gjendje të justifikojë ligjshmërinë e pasurisë së tij ose të saj, që nuk është në gjendje të demonstrojë integritetin e vendimarrjes së mëparshme, që nuk është në gjendje të provojë aftësinë për të qëndruar në sistemin e ri të drejtësisë, nuk do të jetë më pjesë e tij. Kjo është një arsye e mirë për të qenë optimist për të ardhmen.”

265. Kërkuesja pretendoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk kishte ndonjë kompetencë shqyrtimi kushtetues, këto kompetenca i përkisnin ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.

ii. Sipas qeverisë

266. Qeveria u shpreh se procesi i rivlerësimit bazohej në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016. Fakti që krijimi i organeve të rivlerësimit parashikohej në Kushtetutë ishte një garanci e pavarësisë së tyre nga ndërhyrjet e padrejta të pushtetit ekzekutiv dhe atij legjislativ.

267. Anëtarët e organeve të rivlerësimit u zgjodhën me konkurs sipas një procedure transparente, në përputhje me kriteret e parashikuara nga ligji. Kufizimet e vendosura nga kriteret e përzgjedhjes ishin një garanci tjetër për të përjashtuar gjyqtarët aktualë, prokurorët dhe këshilltarët ligjorë të cilët kishin një konflikt të qartë interesi, ose individë të tjerë që kishin mbajtur funksione publike në administratë ose kishin qenë në poste drejtuese në parti politike në dhjetë vitet e fundit, për t'u bërë pjesë e organeve të rivlerësimit.

268. Anëtarët e këtyre organeve u zgjodhën sipas procedurës së përcaktuar me ligj duke garantuar një proces emërimi të paanshëm dhe konsensual. Procesi u monitorua nga Avokati i Popullit dhe ONM-ja, ndërsa komisioni *ad hoc* parlamentar ishte i përbërë nga deputetë si nga partia në pushtet ashtu edhe nga opozita. Përfshirja e organeve kushtetuese në përzgjedhjen e kandidatëve kishte për qëllim shmangien e politizimit të procesit dhe sigurimin e pavarësisë dhe paansisë së tyre. Përfshirja e

Parlamentit në përzgjedhjen e tyre ishte në përputhje me rolin e tij sipas Kushtetutës në zgjedhjen e anëtarëve të organeve kushtetuese, siç kishte qenë rasti edhe më parë. Kryerja e detyrave nga ana e tyre nuk përputhej me asnjë funksion tjetër. Ligji nr. 84/2016 kishte futur detyrimin që anëtarët e organeve të vetingut duhet të deklaronin dhe shmangin çdo konflikt interesi gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar. Kërkesja nuk kish parashtruar apo përmendur ndonjë konflikt të tillë interesi dhe ajo nuk kishte paraqitur asnjë ankim apo të kish bërë kërkesë për përjashtimin e ndonjë anëtari të trupit gjykues. Përbërja e trupave gjykuese në të dy instancat caktohej me short, po ashtu edhe kryesuesit dhe relatorët e çështjeve.

269. Qeveria argumentoi se KPK-ja nuk kishte paragjykuar rezultatin e çështjes së kërkeses. Komisioni nuk e kishte informuar kërkesen për caktimin paraprak ose të parakohshëm të sanksionit disiplinor. Gjetjet paraprake të Komisionit ishin shqyrtuar së bashku me provat që kërkesja kishte paraqitur, duke siguruar kështu kontradiktorialitetin. Anëtarët e tij nuk kishin ndërmarrë ndonjë veprim që do të ngrinte dyshime për paanësinë e tyre. Për më tepër, KPK-ja, në funksion të natyrës specifike të procesit të rivlerësimit, nuk ishte një organ i zakonshëm disiplinor që heton shkeljet e pretenduara disiplinore të kryera nga gjyqtarët dhe prokurorët. Në vend të kësaj, ai kreu një vlerësim të pavarur të tri kritereve të përcaktuara në Kushtetutë dhe ligjin nr. 84/2016. Komisioni nuk ndërmori hapa për të ngritur ndonjë akuzë. Përfshirja e KPK-së dhe fusha e tij e hetimit është e përcaktuar me ligj, duke përfshirë mënyrën e marrjes së informacionit. Aktiviteti i tij është i njëjtë me atë të një organi pothuajse gjyqësor. Fakti që KPK-ja kishte kompetenca vendimmarrëse, pasi shqyrtoi të gjitha provat në dosjen e çështjes, ishte një tipar i qenësishëm i këtij lloji të procedurës së veçantë disiplinore administrative. Në asnjë rrethanë, KPK-ja nuk kishte paracaktuar rezultatin e çështjes së kërkeses. Kërkesja paraqiti një ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, i cili nga ana tjetër, kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e faktit dhe ligjit.

b) Palë të treta

270. Më poshtë do të gjeni parashtrimet e marra nga palët e treta të cilat u lejuan të ndërhyjnë në çështje, pa qenë nevoja për t'i ndarë ato sipas shkaqeve të ankimit të kërkeses.

i. Komisioni Evropian

271. Komisioni Evropian, që përfaqëson Bashkimin Evropian, u shpreh se reforma gjithëpërfshirëse e drejtësisë e miratuar nga Shqipëria në vitin 2016, e cila synonte rikthimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, përbëhej nga dy shtylla: së pari, ristrukturimi institucional i të gjithë shërbimeve të sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë dhe, së dyti, nisjen e procesit të rivlerësimit me anë të ndryshimeve në Kushtetutë dhe duke miratuar ligjin nr. 84/2016.

272. Qëllimi i procesit të rivlerësimit ishte lufta kundër korrupsionit të përhapur, mungesa e profesionalizmit dhe lidhjet me krimin e organizuar në radhët e gjyqtarëve dhe prokurorëve, rivendosi një sistemi gjyqësor të pavarur dhe të paanshëm dhe rikthimin e besimit të publikut në të. Përfshirja e komunitetit ndërkombëtar u konsiderua thelbësore për besueshmërinë e procesit, i cili ishte përcaktuar në Kushtetutë. Ndërsa vuri në dukje se procesi i rivlerësimit mund të krijonte një tension të konsiderueshëm brenda sistemit gjyqësor të një vendi, Komisioni Evropian konsideroi se natyra e tij e përkohshme ishte e justifikuar duke pasur parasysh përmbushjen kumulative të rrethanave të mëposhtme: niveli i korrupsionit dhe ndikimi politik në gjyqësor ishte jashtëzakonisht i lartë, masa e propozuar gëzonte mbështetje të gjerë politike dhe publike dhe mjetet dhe mekanizmat ekzistues për të siguruar integritetin dhe luftën ndaj korrupsionit të mbartësit e funksioneve gjyqësore ishin shteruar. Për ato arsye, Komisioni Evropian u shpreh se procesi i rivlerësimit ishte i domosdoshëm për procesin e reformës dhe duhej të ndiqej plotësisht deri në përfundimin e tij, nën mbikëqyrjen e vazhdueshme, të ngushtë dhe të pavarur të ONM-së.

273. Sipas Komisionit Evropian, procesi i rivlerësimit ishte i ndërtuar nga tri elemente bazë: i. KPK-ja përbëhej nga një personel i pavarur dhe i kualifikuar dhe kishte kompetencat e nevojshme hetimore dhe vendimmarrëse për të kryer funksionet e tij; ii. Kolegji i Posaçëm i Apelit u krijua si një gjykatë e ligjit dhe veprroi si një gjykatë e pavarur, përgjegjëse për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të KPK-së për çështje faktesh dhe ligji; dhe iii. ONM-ja dhe vëzhguesit ndërkombëtarë

ishin në gjendje në pavarësi të plotë të vëzhgonin dhe raportnin mbi procesin e rivlerësimit.

274. Komisioni Evropian u shpreh se procesi i rivlerësimit ofronte garanci të mjaftueshme për kryerjen e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave themelore për katër arsytet e mëposhtme. Së pari, kuadri ligjor, përkatësisht neni 179/b i Kushtetutës dhe nenet 4, pika 5, 47 dhe 55 të ligjit nr. 84/2016, përcaktonin parimet për të siguruar respektimin e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe për të drejtat themelore të personave që do të rivlerësohen. Së dyti, si Kushtetuta ashtu edhe ligji nr. 84/2016 u dhanë pavarësi të gjerë organeve të rivlerësimit. Kolegji i Posaçëm i Apelit iu bashkëngjiti Gjykatës Kushtetuese dhe anëtarët e KPK-së gëzonin statusin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë. Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 u dha atyre një nivel të lartë mbrojtjeje personale ndaj kërcënimeve për jetën, shëndetin dhe pronën. Anëtarët e organeve të rivlerësimit ishin subjekt i procedimeve disiplinore, të cilat, për hir të shmangies së presionit të jashtëm të padrejtë, do të kryheshin nga Kolegji i Posaçëm i Apelit. Së treti, kuadri ligjor parashikonte të drejtën e ankimit në KPA kundër gjetjeve të KPK-së, i cili ishte i vetmi organ gjyqësor përgjegjës për shqyrtimin e ankimeve për çështje fakti dhe ligji. Proceset gjyqësore nga Kolegji i Posaçëm i Apelit mbahen sipas dispozitave të ligjit për gjykatat administrative. Së katërti, krijimi dhe roli i ONM-së, sekretariati i të cilit u financua nga Komisioni Evropian, siguroi masa mbrojtëse shtesë të rëndësishme për sigurimin e respektimit të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të të drejtave themelore.

275. Së fundmi, Komisioni Evropian u shpreh se, pavarësisht nga konformiteti i përgjithshëm me garancitë e një gjykimi të drejtë dhe respektimit të të drejtave themelore, çdo mangësi që mund të identifikohet gjatë zhvillimit të proceseve gjyqësore në çështje individuale nuk do të vinte në pikëpyetje elementet thelbësore të procesit të rivlerësimit.

ii. Respublica

276. Respublicas, një organizate joqeveritare që promovon mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, i është dhënë leja për të ndërhyrë në të gjitha kërkesat që kanë të bëjnë me procesin e rivlerësimit, për të cilën Qeveria është vënë në dijeni. Vëzhgimet e paraqitura për kërkesën në fjalë, ishin një vazhdim i komenteve me shkrim që ata kishin dorëzuar edhe për dy çështje të tjera të ngjashme, të pashqyrtuara ende: *Gashi dhe Gina kundër Shqipërisë* (nr. 29943/18, bërë njoftimi më 7 shtator 2018) dhe *Nikebasani kundër Shqipërisë* (nr. 58997/18, bërë njoftimi më 25 janar 2019). Për këtë arsye, të gjitha komentet me shkrim që ata paraqitën në lidhje me këto kërkesa janë përmbledhur më poshtë.

277. Respublica pretendoi se Qeveria, përveç mbështetjes në një sërë sondazhesh nga perceptimi publik, ku shumica e të anketuarve ishin përgjigjur se ata e konsideronin korrupsionin në radhët e sistemit gjyqësor si endemik, si dhe gjetjet e konstatimet nga institucionet ndërkombëtare, nuk kishte paraqitur argumente të qarta dhe bindëse duke dëshmuar nevojën për një rregullim kaq drastik të sistemit të drejtësisë. Modeli i rivlerësimit duket se ishte parashikuar në premisën e gabuar se një numër i madh zyrtarësh të sistemit të drejtësisë ishin të korruptuar, pa marrë parasysh nivelin e lartë të politizimit të gjyqësorit, i cili ishte shumë problematik dhe ishte bërë kërcënimi i tij kryesor.

278. Respublica parashitroi se vetëm tre anëtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit kishin punuar si gjyqtarë në të kaluarën (e largët), anëtarët e tjerë kishin qenë ose avokatë, ose ndihmës ligjorë apo këshilltarë ligjorë. Do të kishte qenë e preferueshme që të paktën gjysma e anëtarëve të saj të kishin pasur një formim të fortë dhe të qëndrueshëm gjyqësor. Dukej se asnjëri prej anëtarëve të Kolegjit nuk kishte ekspertizë në fushën e ndërlikuar dhe tejet teknike të proceseve disiplinore kundër gjyqtarëve. Sipas këndvështrimit të Respublicas, proceset disiplinore ndaj gjyqtarëve duhet të kryhen nga organe gjyqësore, pasi kjo do të garantonte që anëtarët e organeve të vetingut të kishin përvojën e duhur profesionale. Për më tepër, Respublica shprehu shqetësime nëse mandati i kufizuar i anëtarëve do të ngrinte dyshime për cënueshmërinë e tyre nga ndikime të jashtme politike, veçanërisht nën dritën e natyrës shumë të politizuar të të gjithë procesit të rivlerësimit. Një vendim i qeverisë në vitin 2018 për dhënien e një shpërblymimi në fund të vitit për anëtarët e organeve të vetingut ngriti dyshime të mëtejshme për paanshmërinë e tyre objektive.

279. Sipas këndvështrimit të Respublica, kishte një mungesë udhëzimesh të qarta nga organet e rivlerësimit se si të zbatohet koncepti i të ardhurave dhe pasurive të ligjshme. Ligji nr. 84/2016 nuk arrin të përcaktojë një standard kuptimplotë që do t'u mundësonte subjekteve të rivlerësimit të parashikonin kalimin e barrës së provës mbi ta. Si rezultat, organet e rivlerësimit vendosën një barrë të pamundur të provës te subjektet e rivlerësimit pa përcaktuar provat që kishin çuar në gjetjet e tyre. Ajo shprehet më tej se organet e rivlerësimit nuk kishin arritur të krijojnë një linjë koherente të praktikës gjyqësore në lidhje me çështje të tjera, të tilla si mosjustifikimi i pasurive nga ana e personave të lidhur. Ajo argumentoi se për sa i përket kësaj çështjeje, duhet shtuar edhe dështimi i legjislativit për të siguruar një gamë sanksionesh në mënyrë të përshkallëzuar në vend të rezultatit me dy drejtime (konfirmim në detyrë përkundrejt shkarkimit nga detyra).

c) Vlerësimi i Gjykatës

280. Para se të përcaktojë nëse organet e rivlerësimit janë të pavarura dhe të paanshme, Gjykata do të duhet të përcaktojë nëse ato përbëjnë një “gjykatë të krijuar me ligj” në të cilën kërkuesi kishte qasje në bazë të testit të *Vilho Eskelinen* (shih paragrafin 239 më lart).

i. Nëse organet e vetingut përbëjnë një ‘gjykatë të krijuar me ligj’

α) Parime të përgjithshme

281. Gjykata përsërit parimet e përgjithshme mbi parimin e një “gjykate të krijuar me ligj” siç përcaktohet në vendimin e fundit të Kolegjit të Lartë në çështjen “*Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës*” ([GC], nr. 26374/18, paragrafët 124–27, 211–13, 219–21, 223 dhe 229, 1 dhjetor 2020).

282. Gjykata më tej përsërit se një organ i cili nuk është klasifikuar si një nga gjykatat e vendit, për qëllimet e nenit 6/1, mund të klasifikohet brenda konceptit të një “gjykate” në kuptimin material të kësaj shprehjeje. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, një “gjykatë” karakterizohet në atë kuptim thelbësor të termit nga funksioni i saj gjyqësor, që do të thotë, të vendosë për çështjet brenda kompetencës së saj në bazë të rregullimeve ligjore dhe pas procedurave të zhvilluara në një mënyrë të përcaktuar. Ajo, gjithashtu, duhet të përmbushë një sërë kushtesh të mëtejshme, “të tilla si pavarësia, në veçanti nga pushteti ekzekutivi, paanësia, kohëzgjatja e mandatit të anëtarëve të saj ...” (shih *Guðmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 219, dhe referenca cituar aty*). Fuqia e vendimit buron nga vetë nocioni i “gjykatës” (shih *Mutu dhe Pechstein kundër Zvicrës, nr. 40575/10 dhe 67474/10, paragrafi 139, 2 tetor 2018, dhe referencat e cituara në të*).

β) Zbatimi për çështjen në fjalë

283. Gjykata vëren se, në vijim të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, autoritetet shqiptare prezantuan një numër ndryshimesh kushtetuese dhe miratuan një sërë aktesh ligjore të rëndësishme për të zbatuar reformën në drejtësi. Si pasojë, të gjithë gjyqtarët, prokurorët, këshilltarët ligjorë dhe ndihmësit në detyrë do t'i nënshtroheshin një procesi rivlerësimi kalimtar, i cili do të kryhej nga KPK-ja në shkallën e parë dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit në nivel apeli.

284. Krijimi dhe funksionimi i KPK-së dhe KPA-së janë parashikuar në nenin 179/b të Kushtetutës, plotësuar më tej nga nenet C dhe F të aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, të miratuar nga Parlamenti. Sipas mendimit të Gjykatës, ato ofrojnë një bazë ligjore mjaft të qartë për krijimin e organeve të rivlerësimit, përgjegjëse për kryerjen e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, prokurorëve, këshilltarëve dhe ndihmësve ligjorë (shih paragrafët 103, 106, 112 dhe 122–128 më lart). Fakti se organet e rivlerësimit u krijuan vetëm me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar, u parashtrua edhe në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese (shih paragrafin 169 më lart). Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se, për qëllimet e nenit 6/1, një gjykatë nuk ka nevojë të jetë një gjykatë e integruar brenda mekanizmit standard gjyqësor. Ajo mund të krijohet për të shqyrtuar një çështje specifike e cila mund të administrohet në mënyrë të përshtatshme jashtë sistemit të zakonshëm të gjykatës (shih *Mutu dhe Pechstein, cituar më lart, paragrafi 139*).

285. Gjykata vëren më tej se, në bazë të ligjit nr. 84/2016, KPK-ja ka autoritetin të trajtojë të gjitha çështjet e fakteve dhe ligjit. Ky Komision i zhvillon proceset në përputhje me ligjin nr. 84/2016, Kodin e Procedurës Administrative dhe ligjin për gjykatat administrative (shih paragrafët 145, 152, 153 dhe 178 më lart). Në përfundim të procesit, ai merr një vendim mbi themelin e çështjes. Vendimi bëhet

përfundimtar dhe i detyrueshëm në rast mosapelimi. Nëse personi që i nënshtrohet rivlerësimit apo Komisioneri Publik ushtron ankim kundër vendimit të KPK-së, Kolegji i Posaçëm i Apelit shqyrton ankimin dhe vendos për të, duke marrë parasysh të gjitha çështjet faktike dhe ligjore të ngritura në shkaqet e ankimit. Kjo gjë u ritheksua më tej nga Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017 (*shih paragrafin 176 më lart*).

286. Në çështjen në fjalë, trupat gjykuese të KPK-së dhe KPA-së u krijuan në përputhje me ligjin, domethënë më anë shortimi. Kërkesja nuk ka paraqitur ndonjë kërkesë specifike në lidhje me procedurën e formimit të trupave gjykuese. Pas shqyrtimit të të gjitha çështjeve të faktit dhe ligjit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit vendosi për çështjen e kërkeses. Në shkallën e dytë, atë të apelit, KPA-ja shqyrtoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga kërkesja dhe kishte juridiksion të plotë mbi çështjet e fakteve dhe ligjit.

287. Së fundmi, si neni 179/b i Kushtetutës ashtu edhe ligji nr. 84/2016, siç edhe evidentohet më tej në vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, parashikon që KPK-ja dhe KPA-ja ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të pavarur (*shih paragrafët 103, 125 dhe 169 më lart*).

288. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se, duke pasur parasysh faktin se si KPK-ja ashtu dhe KPA-ja ishin krijuar dhe formuar në një mënyrë legjitime duke përmbushur kërkesat e një “gjykate të krijuar me ligj”, kërkesja i ishte adresuar “Gjykatës”, sipas kuptimit të kushtit të parë të testit *Vilho Eskelinen*. Për këtë arsye, neni 6/1 i Konventës gjen zbatim nën aspektin civil të saj.

ii. Për sa i përket “pavarësisë dhe paanshmërisë së organeve të rivlerësimit

α) Parime të përgjithshme

- Në lidhje me pavarësinë

289. Gjykata vëren se termi “i pavarur” i referohet pavarësisë ndaj pushteteve të tjera (pushtetit ekzekutiv dhe parlamentit), si dhe përkundrejt palëve. Në mënyrë që të përcaktohet nëse një gjykatë mund të konsiderohet “e pavarur” në kuptimin e nenit 6/1, duhet të merret parasysh, ndër të tjera, mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe kohëzgjatja e detyrës së tyre, ekzistenca e garancive kundër presionit të jashtëm dhe pyetjes nëse ky organ demonstroi shfaqje të pavarësisë (*shih, midis autoriteteve të tjera, Kleyn dhe të tjerët kundër Hollandës [GC], nr. 39343/98 dhe 3 të tjerë, paragrafi 190, ECHR 2003 VI; Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 103; dhe Denisov kundër Ukrainës [GC], nr. 76639/11, paragrafi 60, 25 shtator 2018*).

290. Gjykata thekson se ekziston një marrëdhënie shumë e ngushtë midis garancive të një gjykate “të pavarur dhe të paanshme” dhe së drejtës për një “gjykatë të krijuar me ligj”. Ndërkohë që ato shërbejnë për qëllime specifike si garanci të veçanta të procesit të rregullt ligjor, Gjykata vëren një ndërlidhje të përbashkët që përshkon kërkesat institucionale të nenit 6/1, në atë që ato drejtohen nga qëllimi i mbështetjes së parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe ndarjes së pushteteve. Gjykata vëren se nevoja për të ruajtur besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe për të mbrojtur pavarësinë e saj përkundrejt pushteteve të tjera qëndron në themel të secilës prej këtyre kërkesave (*shih Guðmundur Andri Astráðsson, cituar më lart, paragrafët 231 dhe 233*).

291. Në këtë drejtim, “pavarësia” i referohet pavarësisë së domosdoshme personale dhe institucionale që kërkohet për vendimmarrje të paanshme, dhe është kështu parakusht për paanshmëri. Ajo karakterizohet nga: i. një gjendje të brendshme, e cila tregon mosndikimin e një gjyqtari ndaj presionit të jashtëm si çështje integriteti moral; dhe ii. një sërë rregullimesh institucionale dhe procedurale – që përfshijnë si procedurat me të cilat gjyqtarët mund të emërohen në një mënyrë që të sigurojnë pavarësinë e tyre ashtu dhe kriteret e përzgjedhjes bazuar në merita – të cilat duhet të sigurojnë masa mbrojtëse kundër ndikimit të panevojshëm dhe/ose gjykimit të pakufizuar të kompetencave të tjera shtetërore, si në fazën fillestare të emërimit të një gjyqtari ashtu edhe gjatë ushtrimit të detyrave (*po aty, paragrafi 234*).

- Në lidhje me paanshmërinë

292. Gjykata vë në dukje se paanshmëria normalisht tregon mungesën e paragjyqimeve ose gjykimit të njëanshëm dhe se ekzistenca apo mosekzistenca e tyre mund të testohet në mënyra të ndryshme. Sipas praktikës gjyqësore të vendosur të Gjykatës, ekzistenca e paanshmërisë për qëllimet e

nenit 6/1 duhet të përcaktohet sipas: i. një testi subjektiv, ku duhet të merret parasysh bindja personale dhe sjellja e një gjyqtari të caktuar, që është, nëse gjykatësi ka pasur ndonjë paragjykim personal ose anshmëri në një çështje të caktuar; dhe ii. një testi objektiv, që do të thotë të konstatohet nëse vetë gjykata dhe, sidomos përbërja e saj, ofrojnë garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në lidhje me paanshmërinë e saj (*shih, për shembull, Kyprianou kundër Qipros [GC], nr. 73797/01, paragrafi 118, GJEDNJ 2005-XIII dhe Micallef kundër Maltës [GC], nr. 17056/06, paragrafi 93, ECHR 2009*).

293. Megjithatë, nuk ekziston një ndarje absolute midis paanshmërisë subjektive dhe asaj objektive, pasi sjellja e një gjyqtari jo vetëm që mund të shkaktojë qëndrime të dyshimta dhe objektive për sa i përket paanshmërisë së gjykatës nga këndvështrimi i vëzhguesit të jashtëm (testi objektiv), por mund të shkojë deri te bindja personale e gjyqtarit (testi subjektiv) (*shih Kyprianou, cituar më lart, paragrafi 119*). Në disa raste kur mund të jetë e vështirë për të marrë prova me të cilat mund të kundërshtohet paanshmëria e pretenduar subjektive e gjyqtarit, kushti i paanshmërisë objektive ofron një garanci të mëtijshme të rëndësishme (*shih Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar, 10 qershor 1996, paragrafi 32, raportet e aktgjykimeve dhe vendimeve 1996 III dhe Otegi Mondragon kundër Spanjës, nr. 4184/15 dhe 4 të tjerë, paragrafi 54, 6 nëntor 2018*). Në lidhje me këtë, edhe dukja mund të jetë e një rëndësie të caktuar, ose me fjalë të tjera, “drejtësia jo vetëm duhet të jepet, por gjithashtu duhet të duket”. Ajo që vihet në rrezik është besimi që duhet të frymëzojnë në publik gjykatat në një shoqëri demokratike (*shih Morice kundër Francës [GC], nr. 29369/10, paragrafi 78, GJEDNJ 2015*).

β) Zbatimi për çështjen në fjalë

294. Lidhur me çështjen në fjalë, duke marrë parasysh ankimin e kërkuësës për mungesë pavarësie dhe paanshmërie nga ana e organeve të rivlerësimit (*shih paragrafin 230 më lart*), Gjykata do të analizojë nëse dy organet e sipërpërmendura të rivlerësimit përmbushin kërkesat e një gjykate “të pavarur dhe të paanshme” (*shih, për shembull, Clarke kundër Mbretërisë së Bashkuar (dec), nr. 23695/02, 25 gusht 2005, dhe Rustavi 2 Broadcasting Company Ltd dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafët 329–64*). Për më tepër, Gjykata do të përcaktojë nëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit ishte një organ gjyqësor që kishte juridiksion të plotë.

- Komisioni i Pavarur i Kualifikimit

295. Duke filluar me pavarësinë e KPK-së, kërkuësja pati parasysh mënyrën e emërimit të anëtarëve të këtij Komisioni, përkatësisht zgjedhjen e tyre në bllok nga parlamenti. Gjykata konsideron se ka një larmi sistemesh të ndryshme në Evropë për përzgjedhjen dhe emërimin e gjyqtarëve, në vend të një modeli të vetëm që do të aplikohet nga të gjitha vendet. Në lidhje me këtë, gjykata thekson se megjithëse parimi i ndarjes së pushteteve midis organeve politike të qeverisë dhe gjyqësorit ka pësuar rritje në praktikën e saj gjyqësore, përzgjedhja ose emërimi i gjyqtarëve nga pushteti ekzekutiv ose legjislativ është i lejueshëm sipas Konventës, me kusht që, pasi të përzgjidhen ose emërohen, ata të jenë të lirë nga ndikimi ose presioni dhe të ushtrojnë veprimtarinë e tyre gjyqësore me pavarësi të plotë (*shih Sacilor-Lormines kundër Francës, nr. 65411/01, paragrafi 67, GJEDNJ 2006 XIII; Flux kundër Moldavisë (nr. 2), nr. 31001/03, paragrafi 27, 3 korrik 2007; Thiam kundër Francës, nr. 80018/12, paragrafi 80, 18 tetor 2018; dhe Gudmundur Andri Ástráðsson, cituar më lart, paragrafi 207*).

296. Edhe pse në përgjithësi, Gjykata nuk ka asnjë arsye të vërë në pikëpyetje mënyrën në të cilën u emëruan anëtarët e KPK-së, përsëri i mbetet asaj të vlerësojë nëse, në çështjen në fjalë, KPK-ja kishte “shfaqjen/dukjen e pavarësisë” që kërkohet nga praktika gjyqësore e Gjykatës në lidhje me masat mbrojtëse kundër presionit të jashtëm. Kërkuësja nuk arriti të provojë se anëtarët e KPK-së që shqyrtuan çështjen e saj kishin marrë ndonjë udhëzim ose kishin qenë nën presion nga pushteti ekzekutiv. Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e çështjes, nuk rezultoi të ketë ndonjë provë të një udhëzimi të tillë ose presioni që i është ushtruar trupit gjykues nga pushteti ekzekutiv. Për shkak se përpara se KPK-ja të jepte njoftimin mbi dispozitat përkatëse për çështjen e saj, Kryeministri i vendit dha një deklaratë të përgjithshme në lidhje me ecurinë e procesit të rivlerësimit në përgjithësi, pa ndonjë lidhje specifike apo të përmendte çështjen e saj, nuk mund të merret si udhëzim ose presion i ushtruar nga ekzekutivi mbi organet e rivlerësimit (*shih paragrafët 22 dhe 264 më lart*). Deklarata

e Kryeministrit përmbante vërejtje të përgjithshme në lidhje me zhvillimet në vazhdim të procesit të rivlerësimit dhe nuk i adresojë ndonjë çështje apo individë në mënyrë specifike.

297. Në lidhje me kohëzgjatjen e mandatit të anëtarëve të këtyre organeve, Gjykata vëren se, në përputhje me ligjin e brendshëm, anëtarët e KPK-së kanë një mandat pesëvjeçar pa të drejtë riemërimi. Sipas Gjykatës, kohëzgjatja e caktuar e mandatit të anëtarëve të organeve të rivlerësimit nuk përbën asnjë problem. Duke supozuar që periudha kohore e përcaktuar ishte relativisht e shkurtër, kjo është e kuptueshme, duke pasur parasysh natyrën specifike të procesit të rivlerësimit, siç vihet në dukje edhe më tej nga vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese (*shih paragrafin 164 më lart*).

298. Gjykata thekson më tej se ajo që ka rëndësi, është mosheqja nga detyra e anëtarëve gjatë mandatit të tyre, e cila konsiderohet të jetë rezultat i pavarësisë së tyre (*shih Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar, 28 qershor 1984, paragrafi 80, Seria A nr. 80, dhe Maktouf dhe Damjanović kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [GC], nr. 2312/08 dhe 34179/08, paragrafi 49, GJEDNJ 2013 (ekstrakte)*), edhe pse në kontekstin e një çështjeje penale; shih, gjithashtu, parimet e përgjithshme që burojnë nga vendimet e GJDBE-së në paragrafin 224 më lart). Mungesa e parashikimit zyrtar të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve në ligjin nr. 84/2016 nuk nënkupton në vetvete mungesën e pavarësisë, përderisa ajo të njihet në gjendje faktike dhe të ekzistojnë garancitë e tjera të nevojshme (*shih Sacilor-Lormines, cituar më lart, 67*). Mund të shihet nga vetë dispozitat e ligjit nr. 84/2016 se me të vërtetë ky është rasti. As pushteti legjislativ dhe as ai ekzekutiv nuk mund të kërkojnë dorëheqjen ose largimin nga detyra të anëtarëve të organeve të vetingut. Neni 17 i ligjit nr. 84/2016 përcakton rastet specifike kur ata mund të hiqen nga detyra (*shih paragrafin 127 më lart*). Fakti që anëtarët e institucioneve të rivlerësimit mund të hiqen nga detyra vetëm në rast të kryerjes së një shkeljeje disiplinore, në përputhje me procedurën e parashikuar nga ligji, nuk vë në dyshim garancitë e nevojshme për mosheqjen e tyre nga detyra, të cilat janë të pranishme në çështjen në fjalë.

299. Për sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në detyrë në KPK, Gjykata në fakt ka theksuar nevojën për përfaqësim thelbësor të gjyqtarëve brenda organit përkatës disiplinor (*shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 109*). Kjo nevojë është edhe më e rëndësishme në procedurat e zakonshme disiplinore kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve. Sidoqoftë, Gjykata duhet të marrë parasysh natyrën e posaçme të procesit të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri. Ky proces mori jetë në përgjigje të nevojës urgjente, siç vlerësohet nga legjislatura vendëse, për të luftuar nivelin e lartë të korrupsionit që kish pushtuar sistemin e drejtësisë. Ky proces përbëhet nga rivlerësimi i tri kritereve dhe ka për qëllim rivlerësimin të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri është *sui generis* dhe duhet të dallohet nga çdo proces i zakonshëm disiplinor ndaj gjyqtarëve apo prokurorëve.

300. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti që anëtarët e KPK-së nuk vinin nga radhët e gjyqtarëve profesionistë në detyrë, ishte në përputhje me frymën dhe qëllimin e procesit të rivlerësimit, domethënë për të shmangur çdo konflikt individual interesi dhe për të siguruar besimin e publikut në këtë proces. Gjykata u referohet më tej kërkesave të rrepta të përzgjedhjes që anëtarët e KPK-së pritej të përmbushnin (*shih paragrafin 123 më lart*). Ajo vëren se këto anëtarë u përzgjedhën nga Parlamenti në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj (*shih paragrafin 124 më lart*). Për më tepër, statusi i anëtarëve të KPK-së është i njëjtë me atë të gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 106 më lart*).

301. Fakti që Qeveria i akordoi Komisionit një shpërblim në fund të vitit 2018 si mirënjohje për punën e tij nuk është në vetvete i mjaftueshëm, sipas opinionit të Gjykatës, për të vënë në dyshim pavarësinë e anëtarëve të tij. Gjykata vëren se KPK-ja ka detyrimin me ligj për të vendosur në mënyrë të pavarur për themelin e secilës çështje (*shih paragrafët 103 dhe 125 më lart*), dhe se, siç u tha më lart, kërkesja nuk demonstroi që anëtarët e saj nuk kishin vepruar në mënyrë të pavarur në çështjen e saj.

302. Gjykata thekson më tej rëndësinë e garancive të parashikuara në legjisacionin e brendshëm, konkretisht, që KPK-ja ka diskrecion të plotë në marrjen e vendimeve për strukturën e saj organizative dhe personelin; nuk merr udhëzime ose orientime nga ekzekutivi. Për më shumë, është

vetë KPK-ja që i propozon Parlamentit buxhetin e saj vjetor, pa asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi (*shih paragrafin 128 më lart*).

303. Së fundmi, Komisioni i Venecias dhe Gjykata Kushtetuese arritën në përfundimin se KPK-ja mishëron karakteristikat e një organi të pavarur gjyqësor (*shih paragrafët 158 dhe 169 më lart*).

304. Duke pasur parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes së kërkuesit, Gjykata nuk sheh prova të mungesës së pavarësisë nga ana e KPK-së.

305. Në lidhje me paanësinë e saj, GJEDNJ-ja vëren se kërkuesja nuk e kontestoi paanësinë subjektive të anëtarëve të KPK-së. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të vendosur ndryshe. Sipas kërkueses, frika për mungesën e paanësisë ishte bazuar në faktin se KPK-ja kreu hetimin paraprak dhe më pas vendosi për themelin e çështjes. Gjykata vlerëson që kjo situatë mund të ketë ngritur dyshime të caktuara nga ana e kërkueses në lidhje me paanshmërinë e KPK-së, dhe vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet nga këndvështrimi i testit të paanësisë objektive. Më konkretisht, ajo duhet t'i përgjigjet pyetjes nëse pretendimi i kërkueses për mungesë paanshmërie nga ana e KPK-së mund të konsiderohet objektivisht i justifikuar në rrethanat e çështjes së saj.

306. Gjykata vëren se, ndryshe nga procedurat e zakonshme disiplinore, procesi i rivlerësimit nuk fillon me paraqitjen e një ankimi ose akuze për shkelje [disiplinore]. Si rezultat i funksionimit automatik të ligjit nr. 84/2016 (*shih paragrafin 144 më lart*), KPK-ja inicion hetimin për të tria deklaratat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit (*shih paragrafin 12 më lart*), sesa në bazë të gjetjeve të tij që duhej të fillohej procedura disiplinore. Në fakt, Komisioni nuk mori rolin e prokurorit duke ngritur akuza ose padi ndaj kërkueses (në krahasim me *Kamenos*, cituar më lart, paragrafi 105). Detyrat e tij ishin të kufizuara në mënyrë ekskluzive në rivlerësimin e tri kritereve të përcaktuara në aneksin kushtetues dhe ligjin nr. 84/2016. Në përfundim të hetimeve, KPK-ja bëri gjetjet paraprake, pa dalë në ndonjë konkluzion, dhe u ballafaqua me kërkuesen për ato gjetje, në përgjigje të së cilave ajo u ftua të paraqesë mbrojtjen e saj.

307. Në momentin që KPK-ja mori vendimin, në përfundim të procesit, ai vlerësoi nëse provat e marra, përfshirë argumentet dhe dokumentet e parashtruara nga kërkuesja si përgjigje, mjaftonin për ta konfirmuar atë në postin e saj ose për të vendosur një sanksion disiplinor në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (*shih paragrafin 150 më lart, dhe krahaso me Kamenos, cituar më lart, paragrafi 107*). Konstatimet paraprake të bazuara në informacionin e disponueshëm, jo në përfitim të mbrojtjes së kërkueses, nuk mund të konsiderohet se sjellin në vetvete ndonjë paragjykim për rezultatin përfundimtar që do të merret pas parashtrimeve të argumenteve të kërkueses në seancë publike. Ajo që është e rëndësishme është që vendimi përfundimtar të merret në bazë të të gjitha elementeve në dispozicion, përfshirë provat e paraqitura dhe argumentet e parashtruara në seancë (*shih, për shembull, Hauschildt kundër Danimarkës, 24 maj 1989, paragrafi 50, seria nr. 154, dhe Morel kundër Francës, nr. 34130/96, paragrafi 45, Gjykata 2000-VI*).

308. Prandaj, nuk ka asnjë ngatërrese mes detyrimit ligjor të KPK-së për të hapur hetimin, në të cilin nuk u bënë akuza ose konstatime të shkeljeve disiplinore të kërkueses, dhe detyrës së tij për të marrë një vendim në lidhje me përgjegjësinë disiplinore të kërkueses. Një rregullim i tillë procedural nuk është i pazakontë në proceset disiplinore apo procese të tjera administrative në sistemet ligjore evropiane. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, vetëm fakti i thjeshtë që KPK-ja konstatoi gjetje paraprake në çështjen e kërkueses nuk është i mjaftueshëm për të nxitur ndonjë frikë të justifikuar objektivisht në lidhje me paanësinë e KPK-së.

- *Kolegji i Posaçëm i Apelit*

309. Në lidhje me Kolegjin e Posaçëm të Apelit, Gjykata vëren se kërkuesja paraqiti pranë KPA-së një ankim kundër vendimit të KPK-së. Në vijim, ajo bëri parashtrime shtesë të hollësishme duke kundërshtuar çdo gjetje të KPK-së. Në vendimin e tij, Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke pasur parasysh parashtrimet e kërkueses, trajtoi secilin nga shkaqet e ankimit së saj. Ai madje rrëzoi disa nga gjetjet e KPK-së, pas vlerësimit të ri të provave të dosjes së çështjes dhe shqyrtimit të parashtrimeve të kërkueses, duke zëvendësuar kështu gjetjet e veta të fakteve

me ato të KPK-së. Ligji nr. 84/2016 dhe aneksi kushtetues i kanë dhënë kompetenca KPA-së për të prishur një vendim të KPK-së në tërësinë e tij (*shih paragrafët 112 dhe 154 më lart*). Në këto rrethana, Gjykata krijon bindjen që KPA-ja, pas shqyrtimit të ankimit me shkrim dhe parashtrimeve të kërkueses, kishte juridiksion të plotë për shqyrtimin e çështjes dhe mori një vendim të hollësishëm që adresonte secilin nga shkaqet e ankimit të saj.

310. Së fundmi, Gjykata do të shqyrtojë nëse KPA-ja përmbush kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë.

311. Për sa i përket “paraqitjes së pavarësisë” së KPA-së, kërkuësja nuk paraqiti ndonjë fakt në gjendje të vinte në pikëpyetje pavarësinë e tij nga ekzekutivi dhe legjislativi.

312. Gjykata vëren se, në përputhje me procedurën e përshkruar nga ligji nr. 84/2016, anëtarët e KPA-së emërohen për një mandat të parinovueshëm prej nëntë vjetësh, i cili është më i gjatë se mandati i anëtarëve të KPK-së. Anëtarët e KPA-së gëzojnë të njëjtin status si gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (*shih paragrafin 106 më lart*). Ligji i brendshëm garanton më tej që në fund të mandatit të tyre anëtarët e KPA-së të emërohen gjyqtarë të gjykatave të apelit (*shih paragrafin 207 më lart*).

313. Mosheqja nga detyra e anëtarëve të KPA-së, pavarësisht nga mungesa e ndonjë pranimit zyrtar të kësaj të fundit, garantohet, gjithashtu, nga ligji nr. 84/2016 në të njëjtën mënyrë si për anëtarët e KPK-së. Ata mund të shkarkohen nga detyra, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj, në rast të shkeljeve disiplinore. Fakti që anëtarët e KPA-së i nënshtrohen procedimeve disiplinore dhe i nënshtrohen rregullave të disiplinës gjyqësore dhe etikës nuk është në vetvete një shkak për të dyshuar në pavarësinë e tyre (*shih, gjithashtu, parimet e përgjithshme që burojnë nga vendimet e Gjykatës në paragrafin 224 më lart*).

314. Sa i përket mospërfaqësimit të gjyqtarëve në Kolegj, Gjykata u referohet gjetjeve të saj në paragrafët 299–300 më lart. Ajo u referohet, gjithashtu, gjetjeve të saj në paragrafin 301 më lart në lidhje me shpërblimin e fund-vitit të dhënë në vitin 2018. Për më shumë, ajo merr parasysh masat mbrojtëse ligjore të cilat vlejné gjithashtu edhe për KPA-në, përkatësisht, që: i. vendos në mënyrë të pavarur për themelin e çdo çështje, ii. ka diskrecion të plotë për të vendosur për strukturën organizative dhe personelin e tij; iii. nuk merr udhëzime ose instruksione nga ekzekutivi; dhe iv. propozon buxhetin vjetor të alokuar nga Parlamenti, pa asnjë ndërhyrje nga ekzekutivi (*shih paragrafin 128 më lart*). Zhvillimi i proceseve gjyqësore monitorohet më tej nga vëzhguesit ndërkombëtarë, të cilët duket se përbëjnë një mbrojtje shtesë (*shih paragrafët 105, 129 dhe 130 më lart*). Është e vetëkuptueshme që anëtarët e organeve të rivlerësimit i nënshtrohen ligjit në përgjithësi dhe në veçanti rregullave të etikës profesionale (*shih paragrafin 125 më lart*).

315. Në lidhje me një mungesën e pretenduar të paanësisë, kërkuësja dështoi të paraqesë ndonjë argument në gjendje për t’u shqyrtuar në themel.

316. Duke marrë parasysh sa më sipër, dhe duke pasur parasysh rrethanat specifike të çështjes së kërkueses, Gjykata nuk sheh prova të mungesës së pavarësisë dhe paanësisë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

- Përfundim

317. Nga kjo rrjedh se si KPK-ja ashtu edhe KPA-ja ishin të pavarura dhe të paanshme. Prandaj, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në këtë drejtim.

2. Përputhshmëria me kërkesën e rregullsisë [së procesit]

a) Parashtrimet e palëve

318. Kërkuësja pretendoi që nga ana e KPK-së procesit i mungonin masat minimale mbrojtëse procedurale: ajo nuk ishte informuar si duhet për “akuzën” e bërë nga KPK-ja dhe nuk kishte pasur kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e përshtatshme. KPK-ja nuk kishte përmendur ndonjë çështje në lidhje me pasaktësinë e deklarimeve vjetore të pasurive ose fshehjen e mundshme të pasurive si pjesë e gjetjeve të hetimit administrativ.

319. Si pikë kryesore e parashtrimeve të ankimit të saj në lidhje me të ardhurat e ligjshme të bashkëjetuesit të saj për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 101 m², kërkuësja i kishte bashkëlidhur ankimit të saj pranë KPA-së dy prova, përkatësisht, një vërtetim të lëshuar nga

kompania shqiptare me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur një kontratë shitje me kusht në vitin 2003 dhe një vërtetim të lëshuar nga ish-punëdhënësi italian i bashkëjetuesit të saj ku vërtetohet se ai kishte punuar për të nga viti 1995 deri në vitin 2001 (*shih paragrafin 52 më lart*). Edhe pse të dyja provat ishin domethënëse për zgjidhjen e çështjes, Kolegji kishte refuzuar të pranonte provat në dosje, duke dhënë shkaqe të paqarta dhe të pamjaftueshme në vendimin e tij.

320. Së fundmi, kërkuësja pretendoi se duket që KPK-ja se kishte pyetur përfaqësuesit e kompanisë me të cilën bashkëjetuesi i saj kishte lidhur kontratën e shitjes me kusht të vitit 2003, por nuk e kishte treguar këtë gjatë procesit, duke shkaktuar kështu shkelje të parimit të barazisë të armëve.

321. Qeveria parashtroi që provat e reja të kërkuësës nuk ishin pranuar për t'u përfshirë në dosje pasi ato nuk ishin në përputhje me dispozitat e nenit 49 pika 2 të ligjit për gjykatat administrative. Ajo, gjithashtu, kishte dështuar të argumentonte sipas nenit 47 të ligjit për gjykatat administrative përse ajo nuk kishte qenë në gjendje të paraqiste provat para KPK-së. Për më shumë, KPA-ja kishte refuzuar marrjen e provave, në përputhje me nenin 49, pika 6 të ligjit për gjykatat administrative.

322. Sipas këndvështrimit të Qeverisë, KPA-ja kishte juridiksion të plotë si për faktet ashtu dhe për ligjin. KPA-ja kishte juridiksion jo vetëm për të shqyrtuar çështjen e vendosur nga KPK-ja, ajo gjithashtu, kishte ushtruar kompetenca të shqyrtimit kushtetues në mënyrë që të garantonte të drejtën e kërkuësës për një ankim efektiv përpara një gjykate. Duke pasur parasysh kompetencat e saj, KPA-ja mund të lërë në fuqi ose të prishë vendimin e KPK-së, duke dhënë një vendim të arsyetuar me shkrim. Si Komisioni i Venecias ashtu edhe Gjykata Kushtetuese e kishin theksuar këtë rol të saj.

323. Qeveria u shpreh se kërkuësja ishte përfaqësuar para KPA-së nga një avokat i zgjedhur prej saj. Ajo nuk kishte paraqitur asnjë argument para KPA-së se i kishte munguar koha e duhur ose mjetet e mjaftueshme për të paraqitur mbrojtjen e saj. Ajo nuk kishte bërë ndonjë kërkesë për t'i dhënë kohë shtesë për t'u njohur me provat ose për të paraqitur prova të reja.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parimet e përgjithshme

324. Gjykata përsërit se nuk është detyra e saj të zërë vendin e gjykatave vendëse. U takon kryesisht autoriteteve kombëtare, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet e interpretimit të legjislacionit të brendshëm (*shih, midis autoriteteve të tjera, Nejdet Şabin dhe Perihan Şabin kundër Turqisë [GC], nr. 13279/05, paragrafi 49, 20 tetor 2011*).

325. Neni 6 i Konventës nuk përcakton asnjë rregull mbi pranueshmërinë e provave ose mënyrën e vlerësimit të tyre, që për këtë arsye janë kryesisht çështje për rregullim nga legjislacioni i brendshëm dhe gjykatat vendëse (*shih, mes shumë autoriteteve të tjera, García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata 1999 I*). U takon gjykatave vendëse të vlerësojnë rëndësinë e provave të parashtruara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (*shih Centro Europa 7 Srl dhe Di Stefano kundër Italisë [GC], nr. 38433/09, paragrafi 198, Gjykata 2012, dhe Lady SRL kundër Republikës së Moldavisë, nr. 39804/06, paragrafi 27, 23 tetor 2018*).

326. Gjykata vëren se e drejta për një proces të drejtë ligjor siç garantohet nga neni 6/1 i Konventës përfshin të drejtën e palëve në proceset gjyqësore për të paraqitur çdo parashtrim që ata e konsiderojnë të rëndësishëm për çështjen e tyre. Qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta teorike ose imagjinare, por të drejta praktike dhe efektive, e drejtë kjo që mund të shihet të jetë efektive vetëm nëse parashtrimet “dëgjohen” me të vërtetë, domethënë, konsiderohen siç duhet nga gjykatat vendëse. Me fjalë të tjera, efekti i nenit 6 është, ndër të tjera, për ta detyruar “gjykatën” për të kryer shqyrtimin e duhur të parashtrimeve, argumenteve dhe provave të paraqitura nga palët, pa paragjykuar vlerësimin e saj nëse ato janë apo jo të rëndësishme (*shih, midis autoriteteve të tjera, Perez kundër Francës [GC], nr. 47287/99, paragrafi 80, GJEDNJ 2004-I*).

327. Ndërkohë që neni 6 kërkon që gjykatat vendëse të shprehin në mënyrën e duhur arsyet në të cilat bazohen vendimet e tyre, ai nuk kërkon një përgjigje të hollësishme për çdo argument të

paraqitur nga një kërkues. Ky detyrim presupozon gjithsesi që një palë në një proces mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtrime që janë përcaktuese për përfundimin e procesit në fjalë (*shih, mes shumë autoriteteve të tjera, Ruiz Torija kundër Spanjës, 9 dhjetor 1994, paragrafët 29–30, seria A, nr. 303-A*).

328. Në funksion të këtyre parimeve të përgjithshme, Gjykata do të përcaktojë nëse procesi, i marrë si një i tërë, ishte i rregullt.

ii. Zbatimi në çështjen në fjalë

329. Gjykata vëren se për shkak të përfshirjes së kërkueses në një listë prioritare të individëve që do t'i nënshtrohen rivlerësimit kalimtar, KPK-ja inicioi hetimin administrativ për tri deklaratat që kërkuesja kishte paraqitur në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (*shih paragrafin 12 më lart*). Fillimi i hetimit ishte në përputhje me ligjin nr. 84/2016 (*shih paragrafin 144 më lart*). Në përfundim të këtij hetimi, KPK-ja informoi kërkuesen për gjetjet e tij paraprake. Raporti përmban shprehimisht se gjetjet paraprake ishin bërë për faktin se mes të tjerash ajo kishte pasur: i. mospërputhje në lidhje me burimin e të ardhurave të pasurive, ii. mungesë të dokumenteve mbështetëse në lidhje me burimet e fondeve të përdorura për blerjen e pasurive, iii. të ardhura të pamjaftueshme të ligjshme për të justifikuar sasinë e madhe të likuiditeteve në vite të caktuara; dhe iv. mospërputhje në lidhje me pjesën takuese të kërkueses në pasuri të caktuara (*shih paragrafin 15 më lart*).

330. KPK-ja konstatoi gjetjet paraprake pas shqyrtimit të të gjithë dokumentacionit të marrë nga institucione të ndryshme si dhe nga shpjegimet dhe informacionet e dhëna nga kërkuesja në përgjigje të pyetjeve të tij. Për më shumë, raporti iu referua dokumenteve që kishin shërbyer si bazë për ato gjetje. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, informacioni që kërkuesja mori pas përfundimit të hetimit administrativ duhet t'i kishte mundësuar asaj që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme.

331. Pretendimi nga ana e kërkuese se KPK-ja kishte fshehur prova të caktuara është thjesht hamendje e cila është paraqitur me vonesë dhe nuk është mbështetur nga ndonjë provë.

332. Gjatë gjithë procesit pranë KPK-së, në veçanti pas kalimit së barrës së provës kërkuese për të rrëzuar gjetjet paraprake, ajo parashtroi argumente të gjera për mbrojtjen e saj dhe paraqiti parashtrime të shumta me shkrim. Asaj iu dha akses në dokumentacionin e çështjes dhe në metodologjinë e përdorur për të përlllogaritur shpenzimet në mënyrë që të përgatiste mbrojtjen. Asaj iu dha kohë të paraqesë kërkesat e saj (*shih paragrafin 16 më lart*). Nuk ka asnjë indikacion që asaj i mungonte koha dhe mundësitë për të përgatitur një mbrojtje të përshtatshme, sepse duket se ajo nuk bëri asnjë kërkesë ose ngriti këto çështje për këtë qëllim para KPK-së ose KPA-së.

333. Së fundmi, Gjykata vëren se KPK-ja kishte juridiksion të plotë për të gjitha çështjet faktike dhe ligjore. Ajo u krijua posaçërisht për të interpretuar dhe zbatuar ligjin nr. 84/2016. Vlerësimi i fakteve kërkonte vërtet njohuri të specializuara ose përvojë specifike profesionale, prandaj ligji nr. 84/2016 tregon institucionet ndihmëse që do të ndihmonin KPK-në në kryerjen e detyrave të tij (*shih paragrafët 135–142 më lart*). Kjo theksohet, gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese, e cila shtoi më tej se vendimmarrja përfundimtare do t'i takonte KPK-së (*shih paragrafët 169–70 më lart*). Në çështjen e kërkueses, KPK-ja mori vendimin duke parashtruar shkaqet për shkarkimin e saj nga detyra.

334. Pas njoftimit të vendimit të KPK-së, kërkuesja, e cila vazhdoi të përfaqësohej nga një avokat të zgjedhur prej saj, paraqiti një ankim të gjerë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, duke kundërshtuar, ndër të tjera, provat faktike që kishin shërbyer si bazë për shkarkimin e saj. Ajo paraqiti, gjithashtu, parashtrime të mëtejshme me shkrim. Është e qartë nga vendimi i Kolegjit që ai shqyrtoi një më një shkaqet e ankimit dhe shqyrtoi me hollësi gjetjet faktike dhe ligjore të bëra nga KPK-ja, duke respektuar kështu kërkesën e “juridiksionit të plotë” të procesit nga ana e tij, siç parashikohet në mënyrë autonome sipas objektit dhe qëllimit të Konventës (*shih Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafi 177*). Pasi rishqyrtoi faktet dhe materialet në dosjen e çështjes, KPA-ja mbështeti disa nga gjetjet e KPK-së, zëvendësoi vlerësimin e bërë nga KPK-ja me të sajën dhe rrëzoi disa nga gjetjet e tjera të KPK-së. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, Kolegji veprroi në përputhje me nenin F të aneksit

të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, i cili parashikon që ai lë në fuqi, ndryshon ose prish një vendim të KPK-së (*shih paragrafët 112 dhe 154 më lart*).

335. Në këtë drejtim, Gjykata konsideron se Kolegji dha shkaqe të mjaftueshme për vendimin e tij, duke iu përgjigjur secilit nga shkaqet e ankimit të kërkuases. Gjykata është, gjithashtu, e bindur që KPA-ja dha arsyet e duhura për të mos pranuar provat e reja të paraqitura pranë saj nga ana e kërkuases (shih paragrafin 60 më lart). Neni 6 kërkon që gjykatat vendëse të paraqesin në mënyrën e duhur arsyet në të cilat bazohen vendimet e tyre. Ky detyrim presupozon që një palë e procesit mund të presë një përgjigje specifike dhe të shprehur për ato parashtrime që janë përcaktuese për rezultatin e procesit në fjalë (*shih paragrafin 327 më lart*).

336. Nën dritën e të gjitha rrethanave të lartpërmendura, Gjykata arrin në përfundimin se nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me rregullsinë e procesit.

3. Përputhshmëria me kërkesën për mbajtjen e seancës publike nga ana e KPA-së

a) Parashtrimet e palëve

337. Kërkuësja parashtrroi që Kolegji duhej të kishte mbajtur një seancë publike për çështjen e saj në funksion të shkaqeve të ankimit të ngritura nga ana e saj, të cilat kishin kundërshtuar çështje faktike dhe juridike. Ligji nr. 84/2016 nuk parashikonte mundësinë e një seance publike para KPA-së, dhe ajo as nuk mund të paraqiste një kërkesë për këtë qëllim. Nuk kishte pasur rrethana të jashtëzakonshme për të justifikuar mosmbajtjen e një seance publike nga ana e KPA-së.

338. Qeveria argumentoi që kërkuësja nuk kishte kërkuar mbajtjen e një seance publike para KPA-së, e cila, nga ana tjetër, ishte shprehur se duke marrë parasysh rrethanat e çështjes në fjalë mbajtja e seancës publike ishte e panevojshme. Vendimi i KPA-së ishte marrë në përputhje me nenin 51 të ligjit për gjykatat administrative.

b) Vlerësimi i Gjykatës

339. Gjykata ka përcaktuar që e drejta për një seancë publike sipas nenit 6/1 nënkupton të drejtën për një seancë dëgjimore para të paktën një shkalle gjykimi (*shih, mes autoriteteve të tjera, Fischer kundër Austrisë, 26 prill 1995, paragrafi 44, seria A, nr. 312*). Mosmbajtja e një seance publike në shkallën e dytë ose të tretë mund të justifikohet nga aspekte të veçanta të proceseve në fjalë, me kusht që në shkallë të parë të jetë mbajtur më përpara një seancë publike (*shih Salomonsson kundër Suedisë, nr. 38978/97, paragrafi 36, 12 nëntor 2002*). Edhe pse nuk është e rëndësishme për çështjen në fjalë, Gjykata vëren, në mënyrë të anasjelltë, mungesa e një seance publike në shkallën e parë mund të rregullohet nëse seanca publike mbahet në fazën e ankimit, me kusht që fusha e procesit të apelit të shtrihet në çështje ligjore dhe faktike (*shih, për shembull, në një kontekst disiplinor, Buterlevičiutë kundër Lituanisë, nr. 42139/08, paragrafët 52–54, 12 janar 2016*).

340. Ndërkohë që detyrimi për të mbajtur një seancë publike nuk është absolut, Gjykata ka përcaktuar që, në kontekstin e proceseve disiplinore ndaj gjyqtarëve, në funksion të asaj që është në rrezik, d.m.th., ndikimit të dënimeve të mundshme në jetën dhe karrierën e personave në fjalë dhe implikimeve të tyre financiare, mosmbajtja e asnjë seance dëgjimore duhet të jetë një masë e jashtëzakonshme dhe duhet të justifikohet siç duhet nën dritën e praktikës gjyqësore (*shih Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafi 210*).

341. Në lidhje me çështjen aktuale, Gjykata vëren në radhë të parë se KPK-ja, e cila ishte e pavarur dhe e paanshme, mbajti një seancë publike në të cilën kërkuësja u përfaqësua nga një avokat i zgjedhur prej saj, bëri parashtrime verbale dhe paraqiti prova të tjera me shkrim (*për kontrast, Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafi 209*). Për të shqyrtuar këto prova shtesë, KPK-së i është dashur të shtyjë seancën pa marrë vendimin për çështjen e kërkuases.

342. Së dyti, nuk ka asnjë indicie nga ankimi i saj dhe parashtrimet shtesë me shkrim që kërkuësja kërkoj në apel një seancë publike (*për kontrast Ramos Nunes de Carvalho e Sá, cituar më lart, paragrafi 209*). Ndërkohë që ligji nr. 84/2016 nuk parashikon ose ndalon shprehimisht mundësinë e një seance publike para KPA-së, Gjykata vëren se institucionet e rivlerësimit zbatojnë, ndër të tjera, procedurat e përcaktuara në ligjin për gjykatat administrative sa herë që procedura të tilla nuk janë përcaktuar në ligjin nr. 84/2016 (*shih paragrafin 125 më lart*). Në lidhje me këtë, neni 51 i ligjit për gjykatat

administrative rendit kushtet për mbajtjen e një seance publike në apel (*shih paragrafin 196 më lart*). Kolegji i Posaçëm i Apelimit, pavarësisht mungesës së një kërkesë nga kërkuësja për këtë qëllim, dha arsyet e duhura në vendimin e tij për të mos mbajtur një seancë publike për çështjen e kërkuësës (*shih paragrafin 61 më lart*).

343. Së fundmi, Gjykata do të përcaktojë nëse, pavarësisht mbajtjes së një seance publike para KPK-së dhe pavarësisht mungesës së një kërkesë për këtë qëllim nga kërkuësja para KPA-së, natyra e procesit kërkonte që të mbahej një seancë publike në apel. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kërkuësja kishte mundësi të mjaftueshme për të parashtruar me shkrim çështjen e saj para KPA-së (për krahasim *Vilho Eskelinen*, cituar më lart, paragrafi 74). Pjesa më e madhe e shkaqeve të ankimit kishin të bënin me problematika ligjore ose pyetje teknike në lidhje me vlerësimin e pasurive që mund të trajtoheshin në mënyrë të kënaqshme në bazë të dokumentacionit të çështjes (*shih, mutatis mutandis, përkatësisht, Varela Assalino kundër Portugalisë (dek.)*, nr. 64336/01, 25 prill 2002 dhe *Schuler-Zraggen kundër Zvicrës*, 24 qershor 1993, paragrafi 58, seria A, nr. 263). Procesi nuk kërkon dëgjimin e dëshmitarëve ose marrjen e provave të tjera verbale. Duke marrë parasysh sa më sipër, Gjykata nuk konstaton se natyra e procesit kërkonte mbajtjen e një seance publike në apel përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

344. Prandaj nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e një seance publike para përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

4. Përputhshmëria me parimin e sigurisë juridike

a) Parashtrimet e palëve

345. Kërkuësja parashtrroi që ligji nr. 84/2016 nuk parashikonte ndonjë kufizim të veçantë ligjor në lidhje me vlerësimin e pasurive. Kjo i ka lejuar institucionet e rivlerësimit të shqyrtojnë transaksione të kryera në një të kaluar shumë të largët, duke çuar në një transferim të paarsyeshëm të barrës së provës. Në fund të fundit kërkuësja ishte shkarkuar nga detyra për shkak të rrethanave dhe fakteve që datonin në vitet '90, për të justifikuar blerjen e një apartamenti me të ardhurat e bashkëjetuesit të saj. Shtrirja e gjatë kohore e procesit të rivlerësimit e kishte vendosur kërkuësen në një pozitë të pamundur për arsye objektive.

346. Qeveria parashtrroi që KPK-ja kishte filluar një hetim të plotë për deklarimin e pasurisë që kërkuësja kishte depozituar në përputhje me ligjin nr. 84/2016. KPK-ja kishte përdorur si provë deklaratat periodike të pasurive të cilat kërkuësja dhe bashkëjetuesi i saj kishin paraqitur pranë ILDKPKI-së. Verifikimi dhe krahasimi i të gjitha deklaratave të pasurive i kishin mundësuar KPK-së të gjurmonte progresin dhe vërtetësinë e deklaramit të pasurive dhe të nxirrte konkluzione mbi mjaftueshmërinë e deklaramit ose ligjshmërinë e të ardhurave përgjatë viteve, si dhe mbi burimet e përdorura për krijimin e pasurive. Pas mbylljes së hetimit administrativ, KPK-ja konsideroi se provat që kishte marrë kishin vlerë provuese drejt vërtetimit të fakteve dhe rrethanave që lidhen me çështjen e kërkuësës.

347. Në këto rrethana, ai e kishte informuar kërkuësen për gjetjet e tij paraprake dhe ia kishte kaluar asaj barrën e provës për të provuar të kundërtën. Çdo gjetje ishte mbështetur në provat në të cilat ajo bazohej. I takonte plotësisht kërkuësës të përcaktonte se si ajo të përgatiste më mirë mbrojtjen e saj dhe të siguronte çdo dokument në mbështetje të mbrojtjes së saj. Ajo duhej të tregonte se kishte ndërmarrë të gjitha hapat për të marrë ose siguruar prova në mbështetje të pretendimeve të saj, në përfundim të të cilave institucionet e rivlerësimit do të përcaktonin nëse mosmarrja e ndonjë dokumenti mbështetës ishte justifikuar për shkaqe të arsyeshme. Një garanci e tillë procedurale ishte futur për të trajtuar situatën e pas viteve '90 në Shqipëri dhe kishte garantuar, duke respektuar parimin e proporcionalitetit, një vlerësim diskret të secilës problematikë nga institucionet e rivlerësimit, pa penguar ose prishur përfundimin me sukses të procesit të rivlerësimit.

b) Vlerësimi i Gjykatës

348. Gjykata ka përcaktuar që afatet e parashkrimit shërbejnë për disa qëllime të rëndësishme, domethënë për të siguruar sigurinë ligjore dhe përfundimtare, për të mbrojtur të pandehurit e mundshëm nga pretendime të vjetruara të cilat mund të jetë e vështirë për t'u kundërshtuar, dhe

për të parandaluar çdo padrejtësi që mund të lindë nëse gjykatave u kërkohej të vendosnin për ngjarje të ndodhura në të kaluarën e largët në bazë të provave të cilat mund të jenë ose jo të besueshme dhe jo të plota për shkak të kalimit të kohës. Afatet e parashkrimit janë një tipar i përbashkët i sistemeve të brendshme ligjore të Shteteve nënshkruese të Konventës në lidhje me veprat penale, disiplinore dhe veprat e tjera (*shih Oleksandr Volkov, cituar më lart, paragrafi 137*).

349. Sidoqoftë, Gjykata konsideron që duhet të merren parasysh, gjithashtu, tiparet e veçanta të proceseve të kontrollit të pasurive të përdorura gjerësisht. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, duke pasur parasysh që pasuritë personale ose familjare janë akumuluar normalisht gjatë punësimit, vendosja e kufijve të rreptë kohorë për vlerësimin e pasurive do të kufizonte shumë dhe do të cenonte kapacitetet e autoriteteve për të vlerësuar ligjshmërinë e totalit të pasurive të përfituara nga një subjekt gjatë karrierës së tij profesionale. Në lidhje me këtë, vlerësimi i pasurisë manifeston specifika të caktuara, ndryshe nga hetimet e zakonshme disiplinore, të cilat do të kërkonin një shkallë më të lartë fleksibiliteti për shtetin e paditur për zbatimin e kufizimeve ligjore, në përputhje me objektivin e rikthimit dhe forcimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë dhe sigurimin e një niveli të lartë integriteti që pritet nga anëtarët e gjyqësorit. Kjo është edhe më e vërtetë në kontekstin shqiptar ku verifikimi paraprak i deklaratave të pasurisë nuk kishte qenë veçanërisht efektiv (*shih paragrafët 220 dhe 272 më lart*). Së fundmi, mund të jetë, gjithashtu, një çështje interpretimi se kur saktësisht një shkelje e veçantë disiplinore mund të ketë ndodhur në këtë kontekst, domethënë, nëse në kohën kur është blerë fillimisht pasuria ose në një pikë të mëvonshme, në kohën kur pasuria është deklaruar në një deklaratë periodike. Në të njëjtën kohë, një fleksibilitet i tillë nuk mund të jetë i pakufizuar dhe implikimet për sigurinë juridike dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6/1 të Konventës duhet të konsiderohen rast pas rasti.

350. Duke iu kthyer çështjes në fjalë, Gjykata vëren se karriera gjyqësore e kërkueses filloi në vitin 1995 dhe vazhdoi pa ndërprerje deri në shkarkimin e saj nga detyra në vitin 2018. Gjetjet kundër saj u bazuan si në deklarinimin e bërë në deklaratën e saj për rivlerësim ashtu edhe në deklaratat e mëparshme periodike të pasurisë së paraqitura nga ajo dhe bashkëjetuesi i saj. Objektivi i vlerësimit të pasurive ishte kontrolli i ligjshmërisë së burimit të përfitimit të pasurive dhe verifikimi i vërtetësisë së deklaratës për rivlerësim kundrejt deklaratave të mëparshme periodike të pasurive. Kjo ishte arsyeja që institucionet e rivlerësimit do të përdornin si prova deklaratat periodike vjetore të pasurive që ajo kishte depozituar pranë ILDKPKI-së për të siguruar që të gjitha pasuritë, përfshirë burimet e ligjshme financiare të cilat kishin shërbyer si bazë për përfitimin e tyre, që ato të ishin deklaruar dhe justifikuar më mënyrë të saktë.

351. Institucionet e rivlerësimit shqyrtuan pasuritë, burimet fillestare financiare të të cilave ishin siguruar në vitet 1990 ose 2000. Është e kuptueshme që kërkuesja u vendos në një pozicion disi të vështirë për të justifikuar natyrën e ligjshme të burimeve financiare për shkak të kalimit të kohës dhe mungesës së mundshme të dokumenteve mbështetëse. Sidoqoftë, kjo situatë ishte pjesërisht për shkak të dështimit të vetë kërkueses për të deklaruar pasurinë përkatëse në kohën e përfitimit të saj, e cila ishte shumë më afër periudhës gjatë së cilës burimet fillestare financiare ishin siguruar nga ajo dhe bashkëjetuesi i saj. Për më tepër, Gjykata vëren se neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikon rrethana lehtësuese nëse subjekti i rivlerësimit përballet me pamundësi objektive për të paraqitur dokumente mbështetëse (*shih paragrafin 136 më lart*). Në rastin e kërkueses, institucionet e rivlerësimit konstatuan se kërkuesja nuk kishte siguruar ndonjë dokument mbështetës që justifikonte ekzistencën e një pamundësie objektive për të demonstruar natyrën e ligjshme të të ardhurave të bashkëjetuesit të saj nga viti 1992 deri në vitin 2000 (*shih paragrafët 28 dhe 69 më lart*). Për më shumë, Gjykata e konsideron të rëndësishme të mbahet parasysh konstatimi i KPA-së se kursimet e bashkëjetuesit të kërkueses, edhe nëse pranohen ashtu siç pretendohen, nuk do të kishin mjaftuar për të blerë pasurinë në fjalë (*shih paragrafin 70 më lart*).

352. Gjykata përsërit më tej se nuk është *në vetvete* arbitrare, për qëllimet e aspektit “civil” të nenit 6/1 të Konventës, që t’i kalohej barra e provës kërkueses në procesin e rivlerësimit pasi KPK-ja i kishte vënë asaj në dispozicion gjetjet paraprake në përfundim të hetimit dhe i kishte dhënë asaj mundësi për t’u njohur me provat e çështjes (*sibh Gogitidze dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë, nr. 36862/05, paragrafi 122, 12 maj 2015, në kontekstin e procedurave të konfiskimit in rem, dhe, mutatis mutandis, Grayson dhe Barnham kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 19955/05 dhe 15085/06, paragrafët 37–49, 23 shtator 2008, në kontekstin e një urdhri konfiskimi në çështje trafikimi droge*).

353. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, duke pasur parasysh procesin e vlerësimit të pasurive personale ose familjare të grumbulluara gjatë jetës profesionale të gjyqtarës, rrethanat lehtësuese të parashikuara në ligjin nr. 84/2016, dështimin e kërkueses për të paraqitur dokumente mbështetëse që vërtetojnë pamundësinë objektive për të treguar natyrën e ligjshme të të ardhurave të bashkëjetuesit të saj dhe mosveprimin e saj për të deklaruar pasuritë në periudhën përkatëse kur ajo i ka përfutuar ato, nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me pretendimin e shkeljes së parimit të sigurisë juridike.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

354. Kërkuesja pretendoi se kishte pasur shkelje të nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të saj të paligjshëm dhe arbitrar nga detyra dhe ndalimit të përgjithshëm të vendosur për ushtrimin e profesionit të saj.

355. Neni 8 i Konventës parashikon si vijon:

“1. Çdokush ka të drejtë të respektojë jetën e tij... private

2. Nuk do të ketë ndërhyrje nga një autoritet publik në ushtrimin e kësaj të drejte, përveç se kur ajo është në përputhje me ligjin dhe e nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike ose mirëqenies ekonomike të vendit, për parandalimin e prishjes së rendit ose krimeve, për mbrojtjen e shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.”

A. Pranueshmëria

a) Për sa i përket pretendimit në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkueses

a) Parashtrimet e palëve

356. Duke iu referuar vendimit të GJENDJ në çështjen *Denisov* (cituar më lart), Qeveria pretendoi që neni 8 nuk ishte i zbatueshëm pasi kërkuesi nuk kishte arritur të demonstronte që ishte arritur pragu i rëndësisë në lidhje me tri kriteret e trajtuara aty. Për më shumë, vendosja e një sanksioni disiplinor nuk mund të shkaktojë në vetvete prishjen e reputacionit nëse prej tij nuk do të rezultonin pasoja serioze. Qeveria u shpreh më tej që kërkuesja nuk kishte parashtruar përpara KPA-së asnjë shkelje të nenit 8 të Konventës.

357. Kërkuesja u shpreh se shkarkimi i saj nga detyra kishte përmbushur prapun e kriterëve të përcaktuara në çështjen *Denisov* (cituar më lart), si rezultat i të cilave neni 8 ishte i zbatueshëm. Ajo ishte paraqitur ankimin përpara KPA kundër shkarkimit të saj, pasojat e së cilës ishin të dukshme në jetën e saj private. Në këto rrethana, ajo kishte shteruar të gjitha mjetet e brendshme juridike.

b) Vlerësimi i GJENDJ-së

i. Zbatimi i nenit 8

358. Ndërkohë që Qeveria ka kundërshtuar zbatimin e nenit 8 të Konventës për çështjen e kërkueses, Gjykata do të shqyrtojë së pari këtë kërkesë për mospranim.

α) Parimet e përgjithshme

359. Në çështjen *Denisov* (të cituar më lart), Kolegji i Lartë konfirmoi se mosmarrëveshjet në lidhje me punësimin nuk ishin të përjashtuara në vetvete nga fusha e “jetës private” brenda kuptimit të nenit 8 të Konventës. Ekzistojnë disa aspekte tipike të jetës private të cilat mund të ndikohen nga mosmarrëveshje të tilla si shkarkimi nga detyra, ulja në detyrë, mospranimi në një profesion ose masa të tjera të ngjashme të pafavorshme. Këto aspekte përfshijnë: i. “rrethin e ngushtë” të kërkuesit; ii. mundësinë e kërkuesit për të krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie me të tjerët; dhe iii. reputacionin social dhe profesional të kërkuesit. Ekzistojnë dy mënyra në të cilat një problematikë e jetës private

zakonisht ngrihet në një nivel të tillë mosmarrëveshjeje: ose për shkak të shkaqeve fillestare të masave të kundërshtuara (në atë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në arsye) ose – në raste të caktuara – për shkak të pasojave për jetën private (në atë rast Gjykata përdor qasjen e bazuar në pasoja – po aty, paragrafi 115).

360. Nëse zbatohet qasja e bazuar në pasoja, pragu i rëndësisë në lidhje me të gjitha aspektet e lartpërmendura merr një rëndësi thelbësore. Duhet që kërkuesi të tregojë bindshëm se ishte arritur pragu në çështjen e tij ose të saj. Kërkuesi duhet të paraqesë prova që vërtetojnë pasojat e masës së kundërshtuar. Gjykata do të pranojë që neni 8 të jetë i zbatueshëm vetëm kur këto pasoja janë shumë serioze dhe ndikojnë në jetën e tij/saj private në një shkallë shumë domethënëse (*shih Denisov, cituar më lart, paragrafi 116*).

361. Gjykata ka vendosur kritere për vlerësimin e rëndësisë ose seriozitetit të shkeljeve të pretenduara në kontekste të ndryshme rregullatore. Vuajtjet e një kërkuesi duhet të vlerësohen duke krahasuar jetën e tij ose të saj para dhe pas dhënies së masës në fjalë. Gjykata konsideron më tej se gjatë përcaktimit të rëndësisë së pasojave në çështjet e lidhura me punësimin është e përshtatshme të vlerësohen perceptimet subjektive të pretenduara nga kërkuesi përkundrejt kontekstit të rrethanave objektive që ekzistojnë në një çështje të veçantë. Kjo analizë do të duhej të mbulonte ndikimin material dhe jomaterial të masës së pretenduar. Sidoqoftë, i mbetet kërkuetit që të përcaktojë dhe vërtetojë natyrën dhe shkallën e vuajtjes së tij ose të saj, e cila duhet të ketë një lidhje shkakësore me masën e kundërshtuar. Duke pasur parasysh rregullin e shterimit të mjeteve të brendshme juridike, elementet thelbësore të pretendimeve të tilla duhet të jenë paraqitur në mënyrë të mjaftueshme përpara autoriteteve të brendshme që trajtojnë çështjen (*shih Denisov, cituar më lart, paragrafi 117*).

β) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në çështjen aktuale

362. GJENDJ-ja vëren se, gjatë vlerësimit të zbatimit të nenit 8 në çështjen në fjalë, kjo dispozitë nuk mund të zbatohet sipas qasjes së bazuar në arsye: shkarkimi i kërkueses nga detyra gjyqësore në lidhje me detyrën e saj si gjyqtare nuk kishte asnjë lidhje me jetën e saj private. Ndërkohë që përfitimi ose krijimi i pasurive mund të konsiderohet të jetë një aspekt i jetës private, nuk është numri ose madhësia e aseteve ose stili i jetës së një individi ai që mund të shkaktojë përgjegjësi disiplinore, por paaftësia e individit për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të përdorur për përfitimin ose krijimin e tyre dhe për të siguruar besimin e publikut në integritetin e tij ose të saj. Në çdo rast, GJENDJ-ja konsideron se kontrolli i pasurive nuk përfshin një aspekt intim të sjelljes private që trajtohet në vetvete si një shkelje etike (për kontrast, *Özpmar kundër Turqisë*, nr. 20999/04, 19 tetor 2010).

363. Sa i përket qasjes së bazuar në pasoja, GJENDJ vëren si vijon. Kërkuësja u shkarkua nga pozicionin i saj gjyqësor në përputhje me ligjin nr. 84/2016, duke humbur të gjithë pagën e saj me efekt të menjëhershëm (*shih Polyakh dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafët 208–09; për kontrast JB dhe të tjerët kundër Hungarisë (dec.)*, nr. 45434/12 dhe 2 të tjerë, paragrafët 132–33, 27 nëntor 2018 dhe *Camelia Bogdan kundër Rumanisë*, nr. 36889/18, paragrafët 85–86, 20 tetor 2020). Kjo pa dyshim që pati pasoja serioze për “rrethin e saj të ngushtë”, domethënë mirëqenien e saj dhe anëtarëve të familjes së saj. Për më tepër, institucionet e rivlerësimit shqyrtuan edhe aftësitë e saj profesionale dhe konstatuan se ajo kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (për kontrast *J.B. dhe të tjerët (dec.)*, cituar më lart, paragrafi 136). Një pasojë e mëtejshme e këtij konstatimi është se në sytë e shoqërisë, kërkuësja ishte dhe vazhdon të stigmatizohet si e padenjë për të kryer një funksion gjyqësor.

364. Në funksion të këtyre observacioneve, Gjykata konsideron se neni 8 i Konventës zbatohet në çështjen aktuale dhe për këtë arsye ajo rrëzon kundërshtimin e qeverisë.

ii. Shterimi i mjeteve të brendshme

365. Pasi konstatoi që neni 8 është i zbatueshëm për çështjen në fjalë, GJENDJ-ja përsërit se kërkuësja kundërshtoi vendimin e KPK-së duke e ankimuar atë në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Shkaqet në detaje të ankimit kundërshtuan çdo konstatim të bërë nga KPK-ja që kishte çuar në shkarkimin e saj, duke ndikuar në të drejtën e saj për të respektuar jetën e saj private. KPA-ja nuk e refuzoi juridiksionin në këtë çështje, por shqyrtoi çështjen në themel në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

366. Duke pasur parasysh sa më sipër, duke ndjekur rrugën e korigjimit të parashikuar në ligjin nr. 84/2016, Gjykata arrin në përfundimin se kërkesja ngriti në themel ankimin e saj sipas nenit 8 dhe kështu ishte në përputhje me kërkesat e nenit 35/1 të Konventës. Prandaj kundërshtimi i qeverisë për mosshkrimin e mjeteve juridike të brendshme duhet të rrezohet.

iii. Përfundim

367. Gjykata, duke theksuar se ky shkak ankimi nuk është qartësisht i pabazuar dhe i papranueshëm për ndonjë shkak tjetër sipas nenit 35 të Konventës, e deklaroi atë të pranueshëm.

b) Për sa i përket pretendimit në lidhje me ndalimin e përbërshëm për të praktikuar profesionin [e avokatit]

a) Parashtrimet e palëve

368. Qeveria parashitroi që kërkesja nuk kishte ngritur këtë ankim sipas nenit 8 para autoriteteve të brendshme. Ajo nuk kishte iniciuar asnjë proces gjyqësor, një e drejtë kjo e veçantë dhe e pavarur nga rezultati i procesit të rivlerësimit. Qeveria u shpreh më tej se ky pretendim është qartësisht i pabazuar pasi kushtet e parashikuara në ligjin për avokatinë nuk kishin për qëllim të përjashtonin nga ushtrimi i profesionit të avokatit individët e larguar nga drejtësia si rezultat i procesit të rivlerësimit.

369. Kërkesja parashitroi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Thelbi i pretendimit të saj ishte megjithatë se në përputhje me ligjin për avokatinë, rrezikon që asaj t'i hiqet e drejta e avokatisë, pa iu dhënë mundësia për t'u bërë anëtare e Dhomës së Avokatëve.

b) Vlerësimi i Gjykatës

370. Gjykata përsërit se në mënyrë një person të jetë në gjendje të paraqesë një kërkesë sipas nenit 34, ai/ajo duhet të jetë në gjendje të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të përcaktuara në Konventë. Në mënyrë që të pretendojë që të jetë viktimë e një shkelje, një person duhet të preket drejtpërdrejt nga masa e kundërshtuar: Konventa nuk parashikon sjelljen e një *actio popularis* për interpretimin e të drejtave që përmban ose lejon individët të ankohen për një dispozitë të legjislatcionit të brendshëm thjesht, sepse ata konsiderojnë, pa qenë të prekur drejtpërsëdrejti nga ajo, që ajo mund të jetë në kundërshtim me Konventën. Sidoqoftë, çdo person është i hapur të pretendojë se një ligj shkel të drejtat e tij, në mungesë të një mase individuale zbatimi, nëse atij i kërkohet të modifikojë sjelljen e tij ose rrezikon të ndiqet penalisht ose nëse ai është anëtar i një klase njerëzish që rrezikojnë të preken drejtpërdrejt nga ky legjislatcion (*shih, për shembull, Tånase kundër Moldovisë [GC], nr. 7/08, paragrafi 104, Gjykata 2010, dhe referencat e cituara në të, dhe Michaud kundër Francës, nr. 12323/11, paragrafi 51, Gjykata 2012*).

371. Në lidhje me çështjen në fjalë, Gjykata vëren se proceset ishin të udhëhequra dhe përfunduan në zbatim të ligjit nr. 84/2016. Institutcionet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e kërkeses për të ushtruar profesionin e avokatit; ata nuk bënë as ndonjë referencë, qoftë edhe në mënyrë të nënkuptuar, në dispozitat e ligjit për avokatinë. Për më shumë, kërkesja pohoi se ajo kishte një licencë për të ushtruar profesionin e avokatit. Në këto rrethana, Gjykata vëren se ajo nuk mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së të drejtave të saj sipas nenit 8 të Konventës.

372. Fakti që kërkesja pretendon se mund të bëhet viktimë e mundshme në të ardhmen për shkak të rrezikut të heqjes të së drejtës së avokatisë, në përputhje me ligjin për avokatinë (*shih paragrafin 208 më lart*), është thjesht një dyshim ose hamendësim nga ana e saj. Deri më sot ajo nuk është prekur nga një vendim i pafavorshëm individual i marrë kundër saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ajo është e lirë që të kundërshtojë përpara një gjykate çdo vendim të pafavorshëm që Dhoma e Avokatisë mund të marrë kundër saj në të ardhmen, dhe kështu t'i sigurojë Shtetit të paditur mundësinë për të korigjuar çdo shkelje të pretenduar të të drejtave të saj sipas Konventës, siç kërkohet nga neni 35/1 i Konventës. Për më shumë, kërkesja nuk tregoi që fusha e zbatimit e ligjit për avokatinë ishte drejtuar posaçërisht kundër gjyqtarëve ose prokurorëve ndaj të cilëve ishte dhënë një vendim gjatë procesit të rivlerësimit (për krahasim dhe në kontrast *Tånase*, cituar më lart, dhe *Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [GC], nr. 27996/06 dhe 34836/06, GJEDNJ 2009*). Për ta përmbledhur, kërkeses nuk do t'i kërkohet që të modifikojë ndonjë sjellje sipas ligjit për avokatinë; ajo do t'u nënshtrohet kërkesave ligjore të këtij ligji.

373. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se, për rrethanat e çështjes në fjalë, ky pretendim është i papajtuësëm *ratione personae* dhe duhet të rrëzohet në përputhje me nenin 35, paragrafët 3 (a) dhe 4 të Konventës.

B. Themeli

374. Gjykata do të shqyrtojë tani nëse për shkak të shkarkimit nga detyra të kërkueses ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private, dhe nëse po, nëse ndërhyrja ishte e justifikuar.

1. Nëse ka pasur ndërhyrje

a) Parashtrimet e palëve

375. Kërkuesja pretendoi që vendimi për ta shkarkuar atë nga detyra kishte përbërë ndërhyrje sipas nenit 8 të Konventës.

376. Në funksion të parashtrimeve të saj në lidhje me moszbatimin e nenit 8 të Konventës, Qeveria u shpreh se nuk kishte pasur asnjë ndërhyrje në çështjen në fjalë.

b) Vlerësimi i Gjykatës

377. Në funksion të sa parashtruar në paragrafët 363 dhe 364 më lart në lidhje me zbatimin e nenit 8 të Konventës, Gjykata vlerëson se, si rezultat i shkarkimit të saj nga detyra, ka pasur një ndërhyrje në të drejtën e kërkueses për respektimin e jetës së saj private (*shih, për shembull, Özpinar, cituar më lart, paragrafët 47-48 dhe Kulykov dhe të tjerët kundër Ukrainës, nr. 5114/09 dhe 17 të tjerë, paragrafi 138, 19 janar 2017*).

378. Ndërhyrja e sipërpërmendur është në shkelje të nenit 8 të Konventës nëse nuk mund të justifikohet sipas paragrafit 2 të nenit 8 si “në përputhje me ligjin”, duke ndjekur një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura në të dhe duke qenë “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose qëllimet e synuara (*shih Jankauskas kundër Lituanisë (nr. 2), nr. 50446/09, paragrafi 71, 27 qershor 2017*).

2. Nëse ndërhyrja ishte “në përputhje me ligjin”

a) Parashtrimet e palëve

379. Kërkuesja parashtrroi që dispozitat ligjore të ligjit nr. 84/2016 nuk kishin qartësi dhe mundësi qasje në to. Në veçanti, kishte një mungesë qartësie në lidhje me metodën e përdorur nga institucionet e rivlerësimit për të përlogaritur shpenzimet e jetesës dhe udhëtimit. Gjithashtu, ligji nr. 84/2016 nuk përmbante një përkufizim të frazës “ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë”. Interpretimi dhe zbatimi i tij i jep një hapësirë të gjerë diskrecioni institucioneve të rivlerësimit. Në lidhje me marrjen pjesë të saj në trupën e Gjykatës Kushtetuese e cila kishte shqyrtuar ankimin e paraqitur nga një individ, nuk kishte asnjë rrethanë që të shkaktonte konflikt interesi sipas legjislationit të brendshëm. Në rastin e saj, institucionet e rivlerësimit kishin pasur diskrecion të pakufizuar në interpretimin dhe zbatimin e ligjit nr. 84/2016.

380. Qeveria parashtrroi që dispozitat e ligjit nr. 84/2016 ishin të qarta, të mirë përcaktuara dhe të kuptueshme. Ligji nuk përmbante asnjë kontradiktë dhe dispozitat e tij parashikonin siguri, qartësi dhe vazhdimësi. Koncepti i ligjshmërisë së pasurive ishte i mirënjohur në legjislationin e brendshëm, qoftë në ligjet që lidhen me deklarimin e pasurive apo në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave. Që një pasuri të konsiderohet e ligjshme, duhet të përmbushen dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përfitimin e tyre duhej të buronin nga një veprimtari i ligjshme, dhe të ardhurat duhet t'i ishin nënshtruar pagimit të taksave ose detyrimeve përkatëse. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartë në nenin D të Kushtetutës dhe në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.

381. Sipas qeverisë, baza për gjetjen e një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurive ishte deklarata e rivlerësimit kalimtar. Sipas nenit 61, pika 3 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33, një deklarim i pamjaftueshëm i pasurisë ndodh nëse konstatohet se ka pasur mungesë burimesh financiare, fshehje pasurie, deklarim i rremë i pasurisë ose konflikt interesi. Deklaratat e mëparshme të pasurisë mund të përdoren si prova nga KPK-ja dhe KPA-ja.

382. Qeveria parashtrroi që shpenzimet e jetesës llogariteshin duke iu referuar deklaratës së një individi, provave të marra nga institucionet e rivlerësimit nga institucionet kombëtare dhe të huaja,

deklaratat e mëparshme të pasurive dhe provat e mbledhura nga institucionet bankare dhe jobankare. Provat e tilla do t'i nënshtrohen kontradiktoritetit, në përfundim të së cilës subjekti i rivlerësimit ftohet të paraqesë provat e tij ose të saj në mbështetje të pozicionit të tij ose të saj. Të gjitha provat u nënshtroheshin përlogaritjeve matematikore dhe logjike dhe Komisioni merr një vendim të veçantë në lidhje me secilën çështje, duke pasur parasysh specifikat e saj faktike.

383. Qeveria parashtroi që përcaktimi nëse një individ kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë rezultoi nga shqyrtimi i provave nga institucionet e rivlerësimit.

b) Vlerësimi i Gjykatës

384. Shprehja “në përputhje me ligjin” kërkon, së pari, që masa e kundërshtuar të ketë një bazë në ligjin e brendshëm. Së dyti, ajo i referohet cilësisë së ligjit në fjalë, duke kërkuar që ai të jetë i arritshëm për personin në fjalë dhe i parashikueshëm në pasojat e tij (*shih, ndër autoritetet e tjera, Fernández Martínez kundër Spanjës [GC], nr. 56030/07, paragrafi 117, Gjykata 2014 (ekstrakte)*). Në mënyrë që ligji të përmbushë kërkesën e parashikueshmërisë, ai duhet të përcaktojë me saktësi të mjaftueshme kushtet në të cilat mund të zbatohet një masë, për t'i dhënë mundësi personit në fjalë – nëse është e nevojshme, me këshillim të përshtatshëm – të rregullojë sjelljen e tij ose të saj (*shih, si një shembull së fundmi, Altay kundër Turqisë (nr. 2), nr. 11236/09, paragrafi 54, 9 prill 2019*).

385. Gjykata vëren se, pas shqyrtimit të kriterëve të rivlerësimit, kërkesja u shkarkua nga detyra për dy shkaqe kryesore. Së pari, për sa i përket vlerësimit të pasurive, u konstatua se ajo kishte bërë deklaram të rremë dhe kishte fshehur apartamentin me sipërfaqe 101 m². Së dyti, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, kërkesja kishte cenuar besimin e publikut duke mos hequr dorë nga shqyrtimi i një ankimi kushtetues. Gjykata do të shqyrtojë më poshtë secilën nga shkaqet për të përcaktuar nëse ndërhyrja ishte në përputhje me ligjin.

386. Në lidhje me deklaramin e rremë dhe fshehjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 101 m², Gjykata vëren se vendimet e institucioneve të rivlerësimit bazoheshin në ligjin nr. 84/2016 dhe legjislacionin e mëparshëm për deklaramin e pasurive. Ligji nr. 84/2016 jo vetëm që ishte botuar, ai, gjithashtu, i ishte nënshtuar procesit të shqyrtimit kushtetues. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, ndërhyrja përmbushte kërkesat cilësore të qasjes në të dhe parashikueshmërisë.

387. Në lidhje me konstatimin se kërkesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, Gjykata vëren se edhe pse kjo bazë për shkarkimin nga detyra është formuluar në terma mjaft të gjerë, pasja e një dispozitë të tillë në legjislacionin disiplinor dhe rregulloret e disiplinës gjyqësore nuk është e pazakontë. Normalisht kjo dispozitë duhet të lexohet dhe të interpretohet së bashku me rregullat e tjera disiplinore më specifike, në fuqi në atë kohë, duke sanksionuar shkelje të një natyre etike ose profesionale. Në çështjen aktuale, shkaqet e parashikuara në ligjin nr. 84/2016 u plotësuan me dispozitat ligjore në fuqi në kohën përkatëse që rregullojnë përjashtimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarëve të tjerë, përkatësisht neni 36/1/c i ligjit për Gjykatën Kushtetuese dhe neni 72 i KPC-së, të cilit Komisioni dhe Kolegji iu referuan në vendimet e tyre. Në këto rrethana, Gjykata konstaton se ndërhyrja ishte mjaftueshëm e parashikueshme.

388. Gjykata është e bindur që ndërhyrja në jetën private të kërkeses ishte në përputhje me ligjin, siç kërkohet nga neni 8, paragrafi 2 i Konventës. Prandaj, Gjykata do të shqyrtojë më poshtë nëse ndërhyrja e tillë ndiqte një ose më shumë nga qëllimet legjitime të renditura në nenin 8 paragrafi 2 i Konventës, dhe nëse ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike” për të arritur qëllimin ose qëllimet e synuara.

3. Nëse ndërhyrja ndiqte një qëllim legjitim

a) Parashtrimet e palëve

389. Kërkesja pretendoi që ndërhyrja nuk kishte ndjekur ndonjë qëllim të ligjshëm. Qëllimi legjitim i paraqitur në parashtrimet e qeverisë, përkatësisht, pastrimi i gjyqësorit nga korrupsioni, mund të ishte arritur me mjete më pak ndërhyrëse, të tilla si trajnimi i detyrueshëm për gjyqtarët. Komisioni Evropian nuk kishte bërë thirrje për të çrënjësuar korrupsionin me anë të një rivlerësimi të gjerë të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

390. Qeveria, duke iu referuar Raportit të Vlerësimit, parashtroi se ishin identifikuar një sërë problematikash. Këto probleme kishin siguruar nevojën për të futur ndryshime strukturore, të cilat kishin arritur kulmin me ndryshimet kushtetuese dhe miratimin e një sërë ligjesh thelbësore. Qeveria iu referua qëllimeve legjitime që Gjykata Kushtetuese kishte identifikuar në shqyrtimin kushtetues në terma abstraktë të ligjit nr. 84/2016.

b) Vlerësimi i Gjykatës

391. Gjykata vëren se Raporti i Vlerësimit i referohet një numri sondazhesh të perceptimit të publikut dhe të raporteve të shumta, që tregojnë një nivel të lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 4 më lart). Në lidhje me këtë, GRECO-ja kishte theksuar, gjithashtu, shkallën e përhapur të korrupsionit në gjyqësor në raportet e saj që nga viti 2002 (*shih paragrafët 217–20 më lart*).

392. Është e rëndësishme të theksohet se qëllimi i ligjit nr. 84/2016, siç parashikohet në nenin 1, është të “garantojë funksionimin e duhur të shtetit ligjor, pavarësinë e vërtetë të sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” (*shih paragrafët 102 dhe 120 më lart*). Komisioni i Venecias u shpreh, gjithashtu, se rivlerësimi i gjyqtarëve dhe i prokurorëve “ishte jo vetëm i justifikuar, por i domosdoshëm për të mbrojtur [vendin] nga murtaja e korrupsionit, i cila, nëse nuk trajtohet, mund të shkatërrojë plotësisht sistemin gjyqësor” (*shih paragrafin 96 më lart*). Gjykata Kushtetuese shtoi më tej se çdo kufizim i vendosur nga ligji nr. 84/2016 justifikohet nga interesi publik i uljes së nivelit të korrupsionit dhe i rikthimit të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, i cili, nga ana tjetër ishte i lidhur me interesat e sigurisë kombëtare, rendit publik dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve (*shih paragrafin 175 më lart*).

393. Në këto rrethana, GJENDJ-ja nuk sheh asnjë arsye për të dyshuar se qëllimi i ndjekur nga ligji nr. 84/2016 në përgjithësi, dhe ndërhyrja në çështjen e kërkuësës në veçanti, nuk ishte në përputhje me qëllimet e identifikuar në vendimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në interes të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve, siç përcaktohet në nenin 8, paragrafi 2 (*shih, gjithashtu, Ivanovski, cituar më lart, 179*).

4. Nëse ndërhyrja ishte “e nevojshme në një shoqëri demokratike”

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkuësja

394. Kërkuësja parashtroi që shkarkimi i saj nga detyra kishte qenë joproportional. Institucionet e rivlerësimit nuk kishin dhënë shkaqet e duhura për të justifikuar shkarkimin e saj nga detyra. Ata nuk kishin konsideruar që ajo ishte përballur me pamundësi objektive për të demonstruar burimet e ligjshme të të ardhurave që bashkëjetuesi i saj i kishte përfutur më shumë se njëzet vjet më parë. Për më shumë, institucionet e rivlerësimit kishin interpretuar gjerësisht ligjin e brendshëm dhe kishin konstatuar padrejtësisht se ajo kishte qenë palë në kontratat e sipërmarrjeve të viteve 2003 dhe 2005.

395. Sipas saj, shpenzimet e jetesës së bashkëjetuesit të saj në vitet ‘90 ishin përcaktuar gabimisht në bazë të të dhënave të Institutit Italian të Statistikave për vitet 2002 deri më 2004. Disa shpenzime udhëtimi i ishin atribuar asaj në mënyrë arbitrare, edhe pse ato ishin për qëllime pune dhe ishin mbuluar nga institucionet pritëse.

396. Institucionet e rivlerësimit kanë tejkalar kufijtë e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016 dhe e shkarkuan atë, për shkak të deklaratave periodike të pasurive që ajo kishte depozituar pranë ILDKPKI-së, të cilat kishin rezultuar pozitive. Ligji nr. 84/2016 përmbante një përkufizim të frazës “cenimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë”. Interpretimi dhe zbatimi i tij i dha diskrecion të gjerë institucioneve të rivlerësimit. Nuk kishte pasur asnjë situatë që krijonte konflikt interesi sipas legjislacionit të brendshëm. Për më shumë, institucionet e rivlerësimit kishin veçuar vetëm një episod në karrierën e saj 20-vjeçare.

397. Sipas këndvështrimit të kërkuësës, nuk kishte mbrojtje procedurale për të parandaluar një zbatim arbitrar të ligjit. Legjislacioni nuk përcaktonte një shkallë të përshtatshme sanksionesh për shkeljet disiplinore dhe nuk kishte rregulla të përcaktuara për të siguruar zbatimin e tyre në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

ii. Qeveria

398. Qeveria parashtrroi që kërkuesja i ishte nënshtruar procesit të rivlerësimit, që ishte i ndryshëm nga proceset e zakonshme disiplinore. Detyrimet e saj ligjore për deklarimin e pasurive ishin përfshirë tashmë në ligj që nga viti 2003. Koncepti i ligjshmërisë së pasurive ishte i përcaktuar në legjislacionin e brendshëm, qoftë në ligjet që lidhen me deklarimin e pasurive ashtu dhe në ato që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave. Që një pasuri të konsiderohej e ligjshme, duheshin plotësuar dy kushte: të ardhurat e përdorura për krijimin ose përfitimim të saj duhej të buronin nga një aktivitet i ligjshëm dhe të ardhurat duhet t'i ishin nënshtruar tatimit ose detyrimeve përkatëse. Përmbushja kumulative e këtyre dy kushteve parashikohej qartë në nenin D të Kushtetutës dhe në nenin 3 të ligjit nr. 84/2016.

399. Ligjvënësi ka parashikuar ekzistencën e pamundësive objektive në marrjen e provave me të cilën do të përballeshin subjektet e rivlerësimit. Kjo për shkak të: i. trashëgimisë së vendit që doli nga një regjim komunist ku nuk paguheshin taksa; ii. ekonomisë informale, e stimuluar nga situata e vështirë ekonomike dhe paaftësia e institucioneve publike; iii. kultura e dobët fiskale dhe ndërgjegjësimit në vend, i cili nuk kishte mekanizma efektivë të zbatimit të ligjit; dhe iv. mungesa e profesionalizmit nga ana e administratës në zbatimin e ligjit.

400. Sipas Qeverisë, baza për gjetjen e një deklarimi të pamjaftueshëm të pasurisë është deklarata për rivlerësim. Sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, lexuar së bashku me nenin 33, një deklarim i pamjaftueshëm i pasurive do të bëhej nëse konstatohej se kishte mungesë të burimeve financiare, fshehje të pasurive, deklarim i rremë ose konflikt interesi. Deklaratat e mëparshme të pasurive mund të përdoren si prova nga KPK-ja dhe KPA-ja.

401. Së fundmi, sanksioni i vendosur ndaj kërkueses ishte proporcional me konstatimet e bëra nga institucionet e rivlerësimit, konkretisht, se ajo kishte bërë deklarim të rremë dhe kishte fshehur pasuri, kishte bërë deklarim të pasaktë të pasurive të tjera dhe ishte konstatuar se kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Sipas këndvështrimit të Qeverisë, Shteti kërkon që nëpunësit civilë të jenë besnikë ndaj parimeve kushtetuese mbi të cilat ai ngrihet.

b) Vlerësimi i Gjykatës

402. Gjykata përsërit se çdo ndërhyrje në të drejtën për respektimin e jetës private do të konsiderohet “e domosdoshme në një shoqëri demokratike” për një qëllim legjitim nëse i përgjigjet një “nevoje të ngutshme shoqërore” dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur dhe nëse arsyet e paraqitura nga autoritetet kombëtare për ta justifikuar atë janë “të rëndësishme dhe të mjaftueshme” (*shih, për shembull, Fernández Martínez, cituar më lart, paragrafi 124, dhe Dubska dhe Krejzová kundër Republikës Çeke [GC], nr. 28859/11 dhe 28473/12, paragrafi 174, 15 nëntor 2016*). Ndërkohë që u takon autoriteteve të brendshme të bëjnë vlerësimin fillestar të domosdoshmërisë, vlerësimi përfundimtar nëse arsyet e përmendura për ndërhyrjen janë të rëndësishme dhe të mjaftueshme mbetet subjekt i shqyrtimit nga Gjykata për përputhshmëri me kërkesat e Konventës (*shih, për shembull, Polyakh dhe të tjerët, cituar më lart, paragrafi 283*).

403. Gjykata vëren më tej se shkarkimi nga detyra është një sanksion i rëndë disiplinor – nëse jo më i rëndi – që mund të vendoset ndaj një individi. Marrja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon shqyrtimin e provave të qëndrueshme në lidhje me etikën, integritetin dhe aftësinë profesionale të individit në fjalë.

404. Në lidhje me çështjen në fjalë, siç përmendet në paragrafët 391 dhe 392 më lart, Gjykata vëren se ligji nr. 84/2016 është miratuar në kuadër të Raportit të Vlerësimit dhe Strategjisë së Reformës, si dhe me ndryshimet thelbësore kushtetuese. Ai iu përgjigj niveleve alarmante të korrupsionit në gjyqësor, siç vlerësohet nga legjislatura kombëtare dhe vëzhgues të tjerë të pavarur, dhe nevojës urgjente për të luftuar korrupsionin, i theksuar, gjithashtu, në vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Prandaj, Gjykata konsideron se, në rrethana të tilla, një reformë në sistemin e drejtësisë që përfshin rivlerësimin e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë i përgjigjet “nevojës së ngutshme shoqërore”.

405. Pyetja që mbetet për t'u përgjigjur është nëse, në rrethanat e çështjes së kërkuesit, autoritetet vendëse tejkalojnë marzhin e vlerësimit të shtetit të paditur. Si pasojë, Gjykata do të shqyrtojë nëse institucionet e rivlerësimit kanë kryer një vlerësim të individualizuar të shkaqeve që çuan në vendosjen e sanksionit disiplinor të shkarkimit nga detyra, konkretisht, vlerësimin e pasurive dhe aftësitë profesionale.

406. Gjykata vëren se institucionet e rivlerësimit shqyrtuan deklaratën e pasurisë për rivlerësim të kërkueses. Në përputhje me ligjin nr. 84/2016, kërkueses iu kërkua të justifikonte burimet e ligjshme fillestare të cilat kishin shërbyer si bazë për përfitimin e pasurive të saj. Gjykata përsërit, se në përputhje me angazhimet në traktate të Shqipërisë, kërkesa për deklarin e pasurive dhe justifikimin e origjinës së tyre të ligjshme është futur në legjislacionin e brendshëm që nga viti 2003, i cili përmban, gjithashtu, sanksione për mosdeklarimin e pasurive ose deklarimin e rremë të tyre (*shih paragrafët 204 dhe 212 më lart*). Kjo është arsyeja pse ligji nr. 84/2016, siç konfirmohet më tej nga KPA, ka parashikuar përdorimin e deklaratave të mëparshme të pasurive si prova për të verifikuar vërtetësinë e deklaratës së pasurisë për rivlerësim (*shih paragrafët 136 dhe 188 më lart*).

407. Në lidhje me apartamentin me sipërfaqe 101 m², Kolegji mbështeti konstatimin e Komisionit se kërkuesja kishte bërë deklarin të rremë dhe kishte fshehur pasurinë. Në lidhje me argumentet e saj se institucionet e rivlerësimit kishin keqinterpretuar ligjin, Gjykata vlerëson se u takon në radhë të parë autoriteteve kombëtare dhe, veçanërisht gjykatave, për të interpretuar legjislacionin e brendshëm. Në qoftë se interpretimi nuk është arbitrar ose qartësisht i paarsyeshëm, roli i Gjykatës është i kufizuar në verifikimin e përputhshmërisë me Konventën të efekteve të një interpretimi të tillë (*shih, ndër autoritetet e tjera, Radomilja dhe të tjerët [GC], cituar më lart, paragrafi 149*). Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se dy nga pasuritë e kërkuesit ishin përfituar në bazë të një kontrate sipërmarrjeje, e cila, siç interpretohet nga institucionet e rivlerësimit, ishte – dhe vazhdon të jetë – një nga mënyrat për të përfituar të drejta pronësie sipas legjislacionit në Shqipëri. Pas shqyrtimit të kujdesshëm të provave në dokumentacionin e çështjes, institucionet e rivlerësimit arritën në përfundimin se kërkuesja kishte qenë, gjithashtu, palë në kontratat fillestare të cilat kishin shërbyer si bazë dhe kontribuan në përfitimin e apartamentit me sipërfaqe 101 m² të cilën ajo kishte nuk e kishte deklaruar për vite me radhë, deri në vitin 2011 (*shih paragrafët 25 dhe 67 më lart*). Gjykata nuk gjen asgjë arbitrar ose qartazi të paarsyeshme në vendimet e brendshme. Për më shumë, ajo vëren se, sipas Parimeve të Bangalore të Sjelljes Gjyqësore, gjyqtarëve, të cilët, për nga natyra e punës së tyre konsiderohen se janë garantues të sundimit të ligjit, duhet t'u kërkohet të përmbushin standarde veçanërisht të larta integriteti në çështjet e tyre private jashtë gjykatës – “përtej vërejtjeve nga këndvështrimi i një vëzhguesi të arsyeshëm” – në mënyrë që të ruajnë dhe forcojnë besimin e publikut dhe “të rikthejnë besimin e njerëzve në integritetin e pushtetit gjyqësor”.

408. Në lidhje me ekzistencën e të ardhurave të mjaftueshme dhe të ligjshme për blerjen e pasurive fillestare të cilat kishin kontribuar në përfitimin e apartamentit me sipërfaqe 101 m², Gjykata vëren më tej se Kolegji konstatoi që kërkuesja dhe bashkëjetuesi nuk kishin të ardhura të mjaftueshme (*shih paragrafin 71 më lart*).

409. Në lidhje me konkluzionet për situatën financiare të kërkueses, Gjykata vëren se Kolegji kreu një rivlerësim të pasurive dhe detyrimeve të saj dhe të bashkëjetuesit të saj, duke konstatuar se atyre u mungonin të ardhurat e ligjshme për të justifikuar likuiditetet. Meqenëse vlerësimi u përqendrua në fakte specifike për shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e udhëtimit dhe ai u mor në bazë të provave të shqyrtuara nga institucionet e rivlerësimit, detyra e Gjykatës, siç tregohet, gjithashtu, në paragrafin 402 më lart, nuk është të zëvendësojë gjetjet e saj me ato të autoriteteve të brendshme. Gjykata ka marrë parasysh, gjithashtu, konstatimet e Kolegjit për dështimin serioz nga ana e kërkueses për të deklaruar origjinën e parave në llogaritë e saj bankare jashtë shtetit, pasi nuk kishte asnjë provë të ndonjë transferte bankare, si dhe mosdeklarimin në kohë nga ana e bashkëjetuesit të një shume të madhe parash, në kundërshtim me dispozitat ligjore (*shih paragrafët 33, 75 dhe 77 më lart*).

410. Për sa i përket vlerësimit të aftësive profesionale, Kolegji mbështeti konstatimin e Komisionit se dështimi i kërkueses për të hequr dorë nga një sërë procesesh kushtetuese kishte cenuar besimin e

publikut në sistemin e drejtësisë. Duke pasur parasysh vendimet e dhëna nga KPK-ja dhe KPA-ja, si dhe rrethanat e çështjes në fjalë, Gjykata vlerëson se, për shkaqet e dhëna më poshtë, institucionet e rivlerësimit nuk kanë dhënë arsye të përshtatshme për të justifikuar një gjetje të tillë. Në radhë të parë, babai i kërkueses ishte anëtar i një gjykate apeli e cila kishte vendosur për ndjekjen penale të disa individëve të caktuar, të dënuar për falsifikim dokumentesh në shkallën e parë, e cila ishte parashkruar. Për këtë shkak, trupi gjykues i gjykatës së apelit nuk shqyrtoi themelin e çështjes dhe nuk vendosi për akuzën e falsifikimit të dokumenteve. Për sa i përket kërkueses, ajo shqyrtoi një ankim kushtetues në lidhje me një grup të veçantë procesesh civile. Së dyti, meqenëse as ajo dhe as babai i saj nuk kishin ndonjë konflikt tjetër personal interesi në asnjërin prej procedurave, Gjykata nuk është e bindur që institucionet e rivlerësimit demonstruan mjaftueshëm ekzistencën e dyshimeve në lidhje me paanësinë e kërkueses. Gjykata është e ndërgjegjshme që, ndërkohë që Shtetet palë janë të detyruara të organizojnë sistemin e tyre ligjor në mënyrë që të sigurojnë përputhshmëri me kërkesat e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke qenë padyshim paanshmëria një nga më kryesoret mes atyre kërkesave, përjashtimi automatik i një gjyqtari që ka lidhje gjaku me një gjyqtar tjetër i cili ka marrë pjesë në një seri tjetër procesesh në lidhje me një ose të gjithë palët në gjykim nuk kërkohet gjithmonë, veçanërisht për një vend me madhësinë e Shqipërisë (*shih, për zbatimin e këtij parimi, Dorozhko dhe Pozharskiy kundër Estonisë, nr. 14659/04 dhe 16855/04, paragrafi 53, 24 prill 2008; Ramljak kundër Kroacisë, nr. 5856/13, paragrafët 29–42, 27 qershor 2017; Nicholas kundër Qipros, nr. 63246/10, paragrafët 62–65, 9 janar 2018; dhe Koulias kundër Qipros, nr. 48781/12, paragrafët 61–66, 26 maj 2020*). Së treti, nuk ka asnjë indikacion që palët në proceset kushtetuese kundërshtuan pjesëmarrjen e kërkueses në trupën gjyqësore, edhe pse ajo mbante të njëjtin mbiemër me atë të babait të saj.

411. Pavarësisht nga shkaqet e mësipërme, në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të kërkueses, Gjykata konsideron se gjetjet e Kolegjit në lidhje me vlerësimin e pasurisë, siç përshkruhen në paragrafët 407–409 më lart dhe të marra në mënyrë kumulative, ishin mjaftueshëm të rënda sipas legjislacionit kombëtar dhe mund të justifikojnë edhe më vete shkarkimin e kërkueses nga detyra.

412. Gjykata konsideron më tej, se, duke pasur parasysh gjetjet e individualizuara të gjykatave kombëtare në paragrafët 407–409 më lart, shkarkimi i kërkueses nga detyra e saj si gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese ishte proporcional. Në të vërtetë, ligji nr. 84/2016 parashikon dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullim me detyrimin për të ndjekur trajnimin e detyrueshëm. Gjykata ka konsideruar, ndër të tjera, se mungesa e një shkalle të përshtatshme sanksionesh për shkelje disiplinore mund të jetë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit (*shih Oleksandr Volkov, paragrafi 182*). Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të theksojë se ligji për Gjykatën Kushtetuese parashikon një hierarki më të hollësishme sanksionesh disiplinore, siç përshkruhet në paragrafin 200 më lart, i cili vendoset në përfundim të procesit të zakonshëm disiplinor. Sidoqoftë, procesi i rivlerësimit ka natyrë *sui generis*, me gjithë ngjashmëritë që duket se ka me proceset e zakonshme disiplinore. Ai është miratuar në përgjigje të pranisë së perceptuar të përhapur të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në mënyrë që ta largojë elementet e korruptuara dhe të ruajë pjesën e shëndetshme të sistemit. Në rrethanat e jashtëzakonshme që i paraprijnë miratimit të ligjit nr. 84/2016, siç theksohet, gjithashtu, në paragrafët 391, 392 dhe 404 më lart, Gjykata konstaton se është në përputhje me frymën e procesit të rivlerësimit që të ketë një shkallë më të kufizuar sanksionesh, në rast se një person nuk arrin të përmbushë një nga tri kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 84/2016.

413. Gjykata vëren më tej se, sipas ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, shkarkimi i kërkueses nga detyra passjell një ndalim të përjetshëm për t'u rifutur në sistemin e drejtësisë. Në lidhje me këtë, Gjykata përsërit se gjyqtarët, dhe posaçërisht ata që zënë pozicione që sjellin një shkallë të lartë përgjegjësie, siç janë pozicionet në të cilat kërkuesja dëshiron të rifillojë punësimin, kanë një pjesë të pushtetit sovran të Shtetit. Ndalimi i përjetshëm i vendosur ndaj kërkueses dhe individëve të tjerë të shkarkuar, për shkak të shkeljeve të rënda etike nuk është në kundërshtim ose në raport të zhdrejtë me objektivin legjitim të ndjekur nga Shteti për të siguruar integritetin e detyrës gjyqësore dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (*shih, mutatis mutandis, Naidin kundër Rumanisë, nr. 38162/07, 21 tetor 2014, paragrafi 54–55, që kishite të bënte me natyrën absolute të ndalimit të një ish-bashkëpunëtori të policisë politike*

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

për t'u punësuar në shërbimin publik; për kontrast, *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, nr. 55480/00 dhe 59330/00, paragrafi 58, Gjykata 2004 VIII; *Rainys dhe Gasparavičius kundër Lituanisë*, nr. 70665/01 dhe 74345/01, paragrafi 36, 7 prill 2005; dhe *Žičkus kundër Lituanisë*, nr. 26652/02, paragrafi 31, 7 prill 2009, në lidhje me kufizimet e një personi për të gjetur punë në sektorin privat). Kjo është veçanërisht e tillë në kontekstin kombëtar të konsolidimit të vazhdueshëm të shtetit të së drejtës.

414. Duke pasur parasysh shkaqet e mësipërme, Gjykata vlerëson se nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës në lidhje me shkarkimin nga detyra të kërkuesses.

III. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

415. Së fundmi, kërkuësja pretendoi se nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv juridik, siç kërkohet nga neni 13 i Konventës, në lidhje me pretendimin e saj sipas nenit 8.

Neni 13 i Konventës parashikon si vijon:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

416. Gjykata vëren se, në lidhje me çështjen në fjalë, kërkuësja ankimoi vendimin e KPK-së që urdhëronte shkarkimin e saj nga detyra. Kolegji i Posaçëm i Apelimit, që kishte juridiksion të plotë mbi çështje faktike dhe ligjore, shqyrtoi themelin e ankimit të saj, duke përfshirë pretendimin për parregullsi në shkarkimin e saj nga detyra. Fakti që KPA-ja rrëzoi ankimin e saj nuk është e mjaftueshme që Gjykata të vendosë se ky nuk ishte një mjet i efektshëm juridik (*shih, ndër autoritetet e tjera, Amann kundër Zvicrës [GC], nr. 27798/95, paragrafi 89, 16 shkurt 2000*).

417. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se ky pretendim duhet të rrëzohet si haptazi i pabazuar, në përputhje me paragrafët 3/a dhe 4 të nenit 35 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA:

1. Vendosi, në mënyrë unanime, si të papranueshëm ankimin sipas nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e paanshmërisë së anëtarëve të caktuar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe ankimin sipas nenit 13, në lidhje me mungesën e pretenduar të mjeteve juridike efektive përkundrejt shkarkimit nga detyra të kërkuesses.

2. Vendosi, me shumicë votash, si të papranueshëm pretendimin, sipas nenit 8 të Konventës në lidhje me ndalimin e përjetshëm të ushtrimit të profesionit.

3. Vendosi, në mënyrë unanime, si të papranueshëm pjesën tjetër të aplikimit.

4. Vendosi, me gjashtë vota pro dhe një kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës, në lidhje me mungesën e pretenduar të pavarësisë dhe paanësisë së organeve të rivlerësimit.

5. Vendosi, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me parregullsinë e pretenduar të procesit.

6. Vendosi, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me mungesën e pretenduar të seancës publike para Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

7. Vendosi, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 6/1 të Konventës në lidhje me shkeljen e pretenduar të parimit të sigurisë ligjore.

8. Vendosi, me pesë vota pro dhe dy kundër, që nuk ka pasur shkelje të nenit 8 të Konventës.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 9 shkurt 2021, në zbatim të nenit 77, paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores së GJENDJ-së.

Milan Blaško
Sekretar

Paul Lemmens
Kryetar

Në përputhje me paragrafin 2 të nenit 45 të Konventës dhe paragrafin 2 të nenit 74 të Rregullores së GJENDJ-së, këtij vendimi i bashkëlidhen mendimet e mëposhtme të veçanta:

- a) mendim pakice i Gjyqtar Serghides;
- b) mendim pakice i Gjyqtar Dedov.

MENDIM PAKICE I GJYQTAR SERGHIDES

1. Kjo çështje ka të bëjë me shkarkimin e kërkueses nga detyra si gjyqtare, pasi kish shërbyer në pozicione të ndryshme gjyqësore për më shumë se pesëmbëdhjetë vite – pozicioni i saj i fundit ishte në Gjykatën Kushtetuese – pas vendimit të dhënë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) dhe, më pas, në apel, nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në bazë të ligjit të posaçëm për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve (ligji nr. nr. 84/2016) – i njohur si “ligji i vetingut” – duke kundërshtuar aftësinë e saj financiare për të përfituar pasuri të caktuara.

Duket se pasuritë e përfituar nga kërkuesja së bashku me bashkëshortin e saj përbëheshin nga dy apartamente banimi me sipërfaqe rreth 101 m² dhe 59 m², dhe truall prej rreth 222 m², gjithashtu, u konstatua se ata zotëronin një shumë të caktuar pasurish në likuiditete. Megjithatë, duhet të theksohet se si kërkuesja, ashtu edhe bashkëshorti i saj kishin punuar për vite me radhë; kjo nuk do të thotë që kërkuesja, duke qenë gjyqtare, nuk do t'i nënshtrohej ndonjë procesi rivlerësimi.

Duhet të theksohet që në fillim se nuk kishte të dhëna për kërkuesen për sjellje të pahijshme, apo të kish qenë shkaktare e të ndonjë dhënie të gabuar apo mohimit të drejtësisë apo të ndonjë shkeljeje tjetër disiplinore.

2. Me gjithë respektin, por nuk mund të pajtohem me pikat 4–7 të dispozitivit të vendimit që nuk konstaton asnjë shkelje të nenit 6/1 të Konventës dhe deklaroj se ka pasur një shkelje të kësaj dispozite.

3. Ligji i vetingut e shpreh qartë, në veçanti nenet 5, 41 (1), 63 dhe 66, që të dy organet gjyqësore të rivlerësimit, konkretisht, KPK-ja dhe KPA-ja, janë përbërës apo elemente absolutisht të nevojshme dhe të domosdoshme të sistemit të rivlerësimit të krijuar sipas këtij ligji.

4. Me sa duket, hartuesit e ligjit të vetingut kishin për qëllim që si KPK-ja ashtu edhe Kolegji i Apelit të ishin “gjykata të krijuara me ligj”, sipas kuptimit të nenit 6/1, të pajisur me kompetencën për të shqyrtuar çështjet e besuara atyre, duke përfshirë shkarkimin e një gjyqtari nga detyra, siç bënë të dy organet gjyqësore të rivlerësimit në rastin e kërkueses.

5. Në ndryshim nga vendimi dhe gjykimi i bërë, ky mendim pakice do të argumentojë që KPK-ja nuk mund të konsiderohet një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 6/1 të Konventës.

6. Duke vepruar gjithmonë si i njëjti organ rivlerësimi, KPK-ja, përveç funksionit të saj për të shqyrtuar dhe vendosur mbi themelin e një “akuze”, e cila synon të shkarkojë një gjyqtar nga detyra, ka shumë funksione të tjera paralele sipas ligjit nr. 84/2016, të cilat përfshijnë kryerjen e një hetimi paraprak administrativ, inkuadrimit dhe nisjen e procedurave administrative (akuza), duke bërë gjetje paraprake dhe duke ftuar subjektin të vërtetohet të kundërtën e barrës së provës dhe të paraqesë prova për të kundërshtuar rezultatet. Me përlësi pohoj se këto lloj funksionesh, nga vetë natyra e tyre, veçanërisht çelja e procedurave administrative, nuk mund ta bëjnë një organ, i cili, gjithashtu, dëgjon dhe vendos mbi një çështje, me kompetenca të tilla drastike që mund të jenë shkatërruese për karrierën dhe jetën personale të një gjyqtari, një “gjykatë të krijuar me ligj” të paanshme sipas kuptimit të nenit 6/1. Ekziston një parim i përgjithshëm i mirëvendosur ligjor: “*nemo potest esse simul aktor et iudex*” (13 Gjykata e Lartë 327, që do të thotë se askush nuk mund të jetë në të njëjtën kohë edhe paditës edhe gjykatës). Me gjithë respektin e duhur, një organ i tillë, i nisur për të qenë një përbërës i domosdoshëm i procesit të vetingut, që nga krijimi i tij sipas ligjit të vetingut, pra, që nga gjeneza e tij, u “dënuar” me mungesë pavarësie dhe paansie institucionale dhe si rezultat edhe objektive dhe prandaj nuk mund të konsiderohet një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të Konventës.

7. Një organ gjyqësor nuk mund të konsiderohet një “gjykatë e krijuar me ligj” nëse krijimi apo funksionimi i tij është në kundërshtim me Konventën; dhe nëse një organi gjyqësor i mungon pavarësia dhe paansia institucionale, siç bëri KPK-ja në çështjen në fjalë, atëherë kjo bie ndesh me nenin 6/1 të Konventës. Kushtet e “pavarësisë” dhe “paansisë”, duke iu referuar një “gjykate të

krijuar me ligj” në nenin 6/1, nuk janë vetëm kërkesa të veçanta dhe të domosdoshme të së drejtës për një proces të drejtë të parashikuar shprehimisht në atë dispozitë, por, gjithashtu, janë edhe përbërësit e nevojshëm të kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj” në të njëjtën dispozitë. Për ta thënë ndryshe, kushtet e “pavarësisë” dhe “paanësisë” janë cilësi të brendshme dhe të pandara të lidhura ngushtë me vetë ekzistencën e një “gjykate të krijuar me ligj”.

8. Siç edhe është shpalosur në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* ([GC], nr. 26374/18, 1 dhjetor 2020), shprehja “gjykatë e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1 të Konventës “pasqyron parimin e shtetit të së drejtës i cili është i natyrshëm në sistemin e mbrojtjes të vendosur nga Konventa dhe protokollat e saj dhe që përmendet shprehimisht në preambulën e Konventës (po aty, paragrafi 211). Në këtë çështje, Gjykata theksoi vazhdimisht se “ligji”, nën kuptimin e nenit 6/1 të Konventës, përfshin jo vetëm legjislacionin që parashikon krijimin dhe kompetencën e organeve gjyqësore, por edhe çdo dispozitë tjetër të ligjit të brendshëm. Kjo përfshin, në veçanti, dispozitat në lidhje me pavarësinë e anëtarëve të një gjykate dhe paanshmërinë e tyre” (po aty, paragrafi 212). Gjykata theksoi, gjithashtu, se (po aty, paragrafi 232):

“... një organ gjyqësor i cili nuk plotëson kërkesat e pavarësisë ... nuk mund të karakterizohet madje as si një “gjykatë” sipas parashikimeve të nenit 6/1. Po ashtu, kur përcaktohet nëse një “gjykatë” është “krijuar me ligj”, referimi “në ligj” përfshin çdo dispozitë të ligjit të brendshëm – përfshirë, në veçanti, dispozitat në lidhje me pavarësinë e anëtarëve të një gjykate...”.

9. Çështja në fjalë është edhe më e rëndë se ajo e *Guðmundur Andri Ástráðsson* për sa u përket fakteve të saj dhe ndikimit të mungesës së paanësisë dhe pavarësisë në kushtet për një “gjykatë të krijuar me ligj”, sepse ndryshe nga ajo çështje, ku problemi qëndronte te pjesëmarrja e një gjyqtari emërimi i të cilit ishte dëmtuar nga diskrecioni i panevojshëm ekzekutiv pa rishikim dhe korrigjim efektiv nga një gjykatë vendëse, në rastin aktual mungesa e paanësisë dhe pavarësisë së KPK-së nuk ishte diçka që prekte vetëm subjektin dhe faktet e çështjes në fjalë; ishte mungesë paanësie institucionale dhe funksionale.

10. Për më tepër, situata e pakëndshme e përmendur më sipër për mungesë të pavarësisë dhe paanësisë institucionale apo funksionale nga ana e KPK-së, e cila buronte nga vetë ligji nr. 84/2016, nuk mund të korrigjohej ose kompensohej me anë të një vendimi nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për një çështje të caktuar, si, për shembull, për çështjen në fjalë, por vetëm nga ligjvënësi, një herë e mirë, duke lënë jashtë kompetencave të KPK-së çdo pushtet që thjesht nuk ishte në përputhje me kompetencat e tij gjyqësore.

11. Ishte parashtruar se pa një gjykatë të shkallës së parë “të krijuar me ligj”, themeli i të gjithë sistemit të vetingut do të shembej. Në këtë rast do të përdor dy shprehje ligjore latine të cilat mund t’i përshtaten argumentin që parashtrohet këtu: “*parte quacunque integrante sublata tollitur totum*” (nëse hiqet një pjesë përbërëse, tërësia do të priset – shih 9 publikimet e Sir Eduard Coke, 41); dhe “*sublato fundamento cadit opus*” (nëse do të hiqni themelin, struktura do të bjerë – shih Jenkins, *Centuries or Reports*, 106).

12. Si rezultat, shkakut kryesor për konstatimin e shkeljes së nenit 6/1 në çështjen aktuale, për mendimin tim modest, është vetë ligji nr. 84/2016, i cili i mohoi kërkuessit apo çdo kërkuessi me një situatë të ngjashme, të kishin një gjykim të drejtë përpara një “gjykate të krijuar me ligj”.

13. Pa dyshim që, funksioni dhe roli i gjykatës së apelit është të ushtrojë, në apel, kompetencën e saj për të ndryshuar ose jo një vendim të një gjykate të një niveli më të ulët. Kur një sistem ligjor, siç është sistemi i rivlerësimit në Shqipëri, synon të ketë dy nivele gjykatash; një kërkesë e domosdoshme që shkakton ushtrimin e kompetencës ose pushtetit të gjykatës së apelit është paraqitja e një “ankimi”, i cili është i pakonceptueshëm pa ekzistencën e një “gjykate të shkallës së parë të krijuar me ligj”. Për këtë arsye, kam dyshime të forta nëse Kolegji i Posaçëm i Apelimit në çështjen në fjalë apo në sistemin e rivlerësimit në përgjithësi, mund të kishte një funksion, rol dhe kompetencë në boshllëk, ose nëse KPA-ja mund të qëndrojë i vetëm në atë sistem ligjor, nëse nuk do të kishte një “gjykatë të shkallës së parë të krijuar me ligj” sipas nenit 6/1, dhe si rezultat nëse nuk do të kishte asnjë ankim të vlefshëm institucional të paraqitur përpara tij.

14. Do të ishte një paradoks, dhe sigurisht nuk do të ishte roli i një gjykate apeli, të veprojë si gjykatë e shkallës së parë dhe gjykatë e shkallës së dytë në të njëjtën kohë – pavarësisht se mund të ketë ndonjë kompetencë më të gjerë apo juridiksion më të plotë që mund t'ia ketë dhënë ligji.

15. Neni 6/1 nuk i detyron shtetet anëtare të krijojnë një sistem gjykatash apeli (*shih, ndër të tjera, Çështjen “në lidhje me disa aspekte ligjore për përdorimin gjuhësor në sistemin arsimor në Belgjikë” (mbi themelin), 23 korrik 1968, f. 33, paragrafi 9, seria A nr. 6*). Megjithatë, nëse një shtet krijon gjykata të tilla apeli, këto gjykata nuk mund të ekzistojnë dhe të funksionojnë pa ekzistencën e një “gjykate të shkallës së parë të krijuar me ligj”. Kjo sepse, funksionimi i gjykatave të apelit do të ishte në kundërshtim me ligjin që i ka themeluar ato dhe si rezultat edhe në kundërshtim me nenin 6/1 të Konventës.

16. Nëse KPK-ja nuk do të ishte një “gjykatë e shkallës së parë e krijuar me ligj”, jo vetëm që nuk do të kishte asnjë ankim të vlefshëm të paraqitur përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por nuk do të kishte edhe “akuzë” të vlefshme, pasi gjithçka që trajtohet nga KPK-ja do të ishte e parregullt dhe e pavlefshme. Nëse, nga ana tjetër, KPA-ja do të angazhohej, gjithashtu, në ngritjen e “akuzës”, atëherë e njëjta çështje e mungesës së pavarësisë dhe paanshmërisë institucionale si ajo e KPK-së do të ekzistonte edhe për Kolegjin e Posaçëm të Apelimit.

17. Duhet të sqarohet se ky parashtrim i imi nuk nënkupton se Gjykata apo Kolegji i Apelimit nuk ekziston apo nuk funksionon ligjërisht në sistemin gjyqësor shqiptar në përgjithësi. Ajo që unë po argumentoj, është se një gabim rrënjësor apo një parregullsi në paanshmërinë dhe pavarësinë e KPK-së, duke mos e lejuar atë të konsiderohet “një gjykatë e krijuar me ligj” në sistemin shqiptar të rivlerësimit, mund të ketë një ndikim dëmtes në sistemin në tërësi, duke rezultuar në zhveshjen e KPA-së nga funksioni, roli dhe kompetencat brenda sistemit dhe, për këtë arsye, edhe duke mos e lejuar të konsiderohet një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas nenit 6/1. Dhe, natyrisht, një sistem i cili bie, për shkak të mungesës së një “gjykate të krijuar me ligj”, institucionalisht të pavarur dhe të paanshme, nuk mund të jetë një sistem efektiv.

18. Në këndvështrimin tim modest, një sistem rivlerësimi i cili është rrëzuar institucionalisht dhe rrënjësisht, siç edhe është parashtruar më sipër, dhe që ka rezultuar në përfundimin e karrierës profesionale të një gjykatësi të rangut të lartë dhe me përvojë, nuk mund të konsiderohet se është në përputhje me standardet e Konventës.

19. Nga ana tjetër, nëse kërkesat e pavarësisë dhe paansësisë nuk do të konsideroheshin si pjesë përbërëse e kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, siç sugjerohet më lart në çështjen e *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më lart), atëherë asnjëri prej këtyre dy organeve gjyqësore të rivlerësimit, KPK-ja dhe KPA-ja, nuk do të kishte ndonjë problem për të mos qenë një “gjykatë e krijuar me ligj” në bazë të parashikimeve të nenit 6/1. Kështu që Çështja nëse kërkesat e paansësisë dhe pavarësisë janë apo jo elementet përbërëse të kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj”, nuk është vetëm në teori, por mund të kenë pasoja serioze praktike nëse në një çështje të caktuar ka pasur apo jo shkelje të nenit 6/1. Qëndrimi në fjalë, siç edhe është miratuar nga Gjykata në rastin e *Guðmundur Andri Ástráðsson* (po aty) favorizon më shumë të drejtën për një gjykim të drejtë dhe ‘viktimën’ e pretenduar sesa mbajtjen e një qëndrimi të kundërt. Dikush mund të argumentojë se qasja e ndjekur nga Gjykata në atë çështje të Kolegjit të Lartë mund të mbështetet fuqimisht nga parimi i efektivitetit – një parim kryesor i Konventës që mbështet çdo dispozitë të Konventës që siguron një të drejtë njerëzore – si në cilësinë e saj si një normë e së drejtës ndërkombëtare dhe si metodë interpretimi (*shih për këtë parim në të dy cilësitë e tij, paragrafët 15–19 të mendimit tim paralel në çështjen e Mubamed dhe Mubamed kundër Rumanisë [GC], nr. 80982/12, 15 tetor 2020*).

20. Për ta përmbledhur dhe për ta sqaruar më tej, ky mendim argumenton se: a) se parimi i efektivitetit mbështet qasjen e miratuar nga Gjykata në çështjen e *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më lart), ku kërkesat e pavarësisë dhe paansësisë janë komponentët e nevojshëm të kushtit për një “gjykatë të krijuar me ligj” në bazë të parashikimeve të nenit 6/1 të Konventës; dhe b) se parimi i përmendur do të vihej në rrezik nëse kërkesa e nenit 6/1 për një “gjykatë të krijuar me ligj” do të interpretohej dhe zbatohet në mënyrë të tillë që të mbulonte: i. një organ i cili ishte institucionalisht, që nga ligji i themelimit të tij, i predispozuar të mos ishte i pavarur dhe i paanshëm për shkak të faktit

të akumulimit brenda kompetencës së tij, përveç funksioneve gjyqësore, funksione të tjera të pajtueshme me të parën; dhe ii. një kolegji apelimi brenda një sistemi ligjor që synon në mënyrë specifike të vendosë për “ankimet” që vijnë nga një organ gjyqësor që i mungon pavarësia dhe paanësia institucionale.

21. Për më tepër, sipas meje, duke qenë se seanca publike përpara KPK-së nuk mund të konsiderohet si një seancë publike para një “gjykate të krijuar me ligj”, dhe duke qenë se Kolegji i Posaçëm i Apelit – pavarësisht nëse ishte apo jo “gjykatë e krijuar me ligj” – nuk mbajti një seancë publike, kërkesa e nenit 6/1 për një seancë të tillë në çështjen në fjalë nuk u përmbush dhe për këtë arsye ka pasur shkelje të kësaj dispozite bazuar në sa më sipër.

22. Për fat të keq, sipas këndvështrimit tim modest, ndërsa qëllimi i ligjit nr. 84/2016, siç përmendet në nenin 1 të atij ligji, ishte “të garantonte funksionimin e duhur të shtetit të së drejtës, pavarësinë e vërtetë të sistemit gjyqësor, si dhe rikthimin e besimit të publikut në institucionet e [atij] sistemi” (*shih paragrafin 120 të vendimit*), në fund të fundit mund të thuhet se rezultoi se ligji i mungonte në vetvete ajo se çfarë ai synonte të parandalonte. Kjo është një pasojë shumë serioze në një fushë të ligjit që është shumë e ndjeshme në Shqipëri, por, në të njëjtën kohë, mund të ketë, gjithashtu, pasoja për sundimin e ligjit në përgjithësi, duke përfshirë, sigurisht, administrimin e drejtësisë, pavarësinë e gjyqtarëve dhe ndarjen e pushteteve.

23. Pasi kam arritur në përfundimin se nuk pati një “gjykatë të krijuar me ligj” për të dëgjuar dhe vendosur mbi themelin e çështjes së kërkuësës, nuk e konsideroj të nevojshme të merrem me dy shkaqet e tjera të ngritura nga kërkuësja në lidhje me mungesën e pavarësisë dhe paanësinë e KPK-së, që janë, se: i. ishte i përbërë nga anëtarë jogjyqtarë të cilët nuk kishin profesionalizmin dhe përvojën e duhur, dhe ii. se anëtarët e KPK-së u emëruan nga parlamenti pa u përfshirë fare anëtarë nga sistemi gjyqësor.

24. Siç ka bërë edhe kolegu im i nderuar, gjyqtari Dedov, në mendimin e tij të pakicës, bashkëlidhur vendimit për çështjen në fjalë, edhe unë do të doja t’i referohesha asaj që Gjykata vuri në dukje në çështjen *Baka kundër Hungarisë* [GC], 20261/12, paragrafi 172, 22 qershor 2016, që ka të bëjë me parimin e mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve si një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë së tyre.

“Për më tepër, edhe pse kërkuësi qëndroi në detyrë si gjyqtar dhe kryetar i një seksioni civil të ri të *Kúria*, ai u shkarkua nga posti i kryetarit të Gjykatës së Lartë tre vjet e gjysmë përpara përfundimit të afatit të caktuar sipas legjislacionit në fuqi në kohën e zgjedhjes së tij. Kjo vështirë se mund të pajtohet me vëmendjen e veçantë që duhet t’i kushtohet natyrës së funksionit gjyqësor si një degë e pavarur e pushtetit shtetëror dhe parimit të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili – sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe instrumenteve ndërkombëtarë dhe atyre të Këshillit të Evropës – është një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore... Në këtë kontekst, duket se largimi i parakohshëm i kërkuësit nga pozicioni i tij si Kryetar i Gjykatës së Lartë, më shumë sesa i shërbeu, rrëzoi vetë qëllimin e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit”.

25. Referenca duhet t’i bëhet edhe çështjes së *Kamenos kundër Qipros* (nr. 147/07, 31 tetor 2017). Në këtë çështje, Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) në Qipro kishte akuzuar, gjykuar dhe dënuar kërkuësin duke e shkarkuar nga posti i tij gjyqësor. Gjykata konstatoi shkelje të parimit të paanësisë dhe, për këtë arsye, ajo arriti në përfundimin se kishte pasur shkelje të nenit 6/1. Shprehimisht, Gjykata është shprehur (paragrafi 109):

“Për këtë arsye, Gjykata konstaton se duke u bazuar në faktet e çështjes dhe duke marrë parasysh parregullsitë funksionale që ajo ka identifikuar, paanësia e Gjykatës së Lartë ishte qartësisht e dyshimtë. Ajo çka kërkuësi druante në këtë drejtim mund të konsiderohet si objektivisht e justifikuar.

26. Vendimi i *Kamenos* (po aty) mbështet mendimin e propozuar se KPK-ja nuk ishte një gjykatë e paanshme, pasi, përveç gjykimit dhe vendimit mbi çështjen e kërkuësës, ishte, gjithashtu, e angazhuar në ngritjen e “akuzës” kundër saj. Mungesa e paanshmërisë në rastin e KPK-së është në një nivel më të lartë sesa në rastin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë në çështjen *Kamenos*, pasi në çështjen që pasoi, gjyqtari hetues/relator për veprën e pretenduar disiplinore nuk ishte anëtar i KLD-së, por një gjyqtar

tjetër, kryetari i atëhershëm i Gjykatës së Rrethit të Nikosias. Për më tepër, ndryshe nga KPK-ja dhe KPA-ja në sistemin e rivlerësimit në Shqipëri, KLD-ja ishte e vetmja gjykatë në Qipro që merrej me procedimet disiplinore ndaj gjyqtarëve, e përbërë nga të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, duke qenë kështu gjykata më e lartë në vend. Duhet të theksohet se në çështjen *Kamenos* u shqyrtua vetëm Çështja e dyshimit në lidhje me paanësinë e KLD-së. Çështja nëse KLD ishte një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas parashikimeve të nenit 6/1, nuk u ngrit dhe diskutua fare. Kështu që nuk mund ta nënkuptojmë se Çështja *Kamenos* ndan ekzistencën e një “gjykate të krijuar me ligj” nga paanësia dhe pavarësia e tij. Gjithsesi, vendimi dhe gjykimi i dhënë në çështjen *Guðmundur Andri Ástráðsson* (cituar më lart) nga Kolegji i Lartë dhe parimi i tij, siç shpjegohet më sipër, domethënë që një organ gjyqësor nuk mund të karakterizohet si një “gjykatë e krijuar me ligj” në kuptimin e nenit 6/1 nëse nuk përmbush kërkesat e paanësisë dhe pavarësisë, duhet të merret parasysh edhe në rastin konkret.

27. Nën dritën e sa është parashtruar më lart, për mua është e qartë që jo vetëm që nuk janë përmbushur kërkesat e nenit 6/1, kërkesat për një “gjykatë të krijuar me ligj” kërkesat për një “gjykatë të pavarur dhe të paanshme”, si dhe kërkesat për një “seancë publike”, por ka pasur, gjithashtu, mospërmbushje të testit për një “proces të rregullt” dhe për të mbështetur parimin e sigurisë ligjore, gjithashtu, të parashikuar në atë dispozitë. Të gjitha kërkesat e mësipërme mund të konsiderohen si përbërës të domosdoshëm ose aspekte të së drejtës për një gjykim të drejtë sipas nenit 6/1 dhe kurdo që ndonjëra prej tyre nuk përmbushet, e drejta në fjalë do të shkelet. Sa i përket mungesës së sigurisë ligjore, unë mbështes pikëpamjet e kolegut tim të shquar, gjyqtarit Dedov, në mendimin e tij të pakicës për çështjen në fjalë.

28. Pra, duke adresuar ankimin e ngritur ndaj nenit 8, me gjithë respektin, unë nuk pajtohem me pikën 8 të dispozitivit të vendimit në të cilin është shprehur se nuk është konstatuar asnjë shkelje. Sipas mendimit tim, vendimet e KPK-së dhe KPA-së ishin shkatërruese për jetën profesionale të kërkueses me pasoja të rënda edhe për jetën e saj private. Unë mendoj se ka një shkelje të nenit 8 të Konventës pasi nuk u parashtruan shkaqe dhe arsye të mjaftueshme për shkarkimin e kërkueses nga detyra. Si rezultat, për mendimin tim, nuk u zhvillua asnjë test i balancës së drejtë dhe nuk u zbatua parimi i proporcionalitetit. Dhe përsëri, siç edhe kam parashtruar disa herë, shkarkimi i kërkueses nuk është bërë nga një “gjykatë e krijuar me ligj” sipas kuptimit të nenit 6/1 të Konventës në mënyrë të tillë që kjo shkelje e Konventës e ka bërë edhe më të rëndë ndikimin e vendimeve të organeve gjyqësore të rivlerësimit në jetën profesionale dhe private të kërkueses.

29. Unë do të propozoja që kërkueses t’i jepej një shpërblim për dëmin material dhe jomaterial të shkaktuar, si dhe kostot dhe shpenzimet e bëra nga ajo për qëllim të këtij procesi, shumë e të cilave nuk është e nevojshme ta përcaktoj duke qenë se jam në pakicë.

30. Me shpresën se kjo çështje do të ofrojë një mundësi që sistemi i rivlerësimit në Shqipëri të rishikohet dhe përmirësohet duke mbështetur, *ndër të tjera*, pavarësinë dhe paanshmërinë institucionale të KPK-së, dhe në këtë mënyrë ta bëjë atë të jetë në përputhje me kërkesat e nenit 6/1 të Konventës.

MENDIM PAKICE I GJYQTARIT DEDOV

1. Ndjej keqardhje për vendimet e marra kundër kërkueses, e cila u shkarkua nga pozicioni i gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese në vend, në kontekstin e një fushate antikorrupsion ose të ashtuquajturit proces rivlerësimi. Kam dyshime serioze nëse procedura e rivlerësimit, në funksion të rrethanave të çështjes në fjalë, ishte në përputhje me standardet e Konventës.

2. Jam i mendimit se vendimi u mor pa vendosur një ekuilibër midis interesit publik dhe masave mbrojtëse që synojnë mbrojtjen e imunitetit gjyqësor, pavarësinë dhe mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve. Gjykata ka theksuar (*shih Baka kundër Hungarisë [GC], nr. 20261/12, 23 qershor 2016, paragrafi 172*) rëndësinë e “parimit të mosheqjes nga detyra të gjyqtarëve, i cili – sipas jurisprudencës së Gjykatës dhe instrumenteve të Këshillit të Evropës – është një element kryesor për ruajtjen e pavarësisë gjyqësore”.

3. Kërkuesja është një gjyqtare e zakonshme e cila nuk ishte përfshirë në ndonjë skandal apo aktivitet korruptiv. Ajo nuk kishte lidhje apo kontakte të papërshtatshme me krimin e organizuar. Për të nuk kishte ndonjë të dhënë për sjellje të pahijshme, shkaktare të dhënies së gabuar apo mohimit të drejtësisë që mund të ketë cenuar besimin e publikut në Gjykatën Kushtetuese. Për sa u përket aftësive profesionale, karriera e saj gjyqësore prej gati 25 vjetësh dhe emërimi në Gjykatën Kushtetuese të vendit më lejojnë të them se kërkuesja është një ndër specialistet më të kualifikuara në vend.

4. Për më tepër, kërkuesja nuk përfitoi ndonjë pasuri të tepruar, të atillë që të krijonte prova të besueshme dhe dyshime të arsyeshme për korrupsion, të cilat do të lejonin organet ta shkarkonin atë nga funksioni gjyqësor. Pasuria më e vlefshme që kërkuesja përfitoi, së bashku me bashkëjetuesin e saj, që nga fillimi i karrierës së saj si gjyqtare në vitin 1995 ishte apartamenti i banimit prej 101 m² me vlerë 61,050 euro (pjesa kryesore e së cilës u mbulua nga shitja e një apartamenti paraprak në shumën prej 56,000 euro). Meqenëse organet në vend nuk ishin të kënaqur me përputhshmërinë e dokumenteve që tregonin burimet e saj të të ardhurave, atyre iu duk joreale, që dy specialistë të kualifikuar (kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj) të fitonin dhe të kursenin rreth 5,000 euro brenda 13 vjetësh (1992–2005); apo të përfitonin 61,050 euro brenda 25 vjetësh karrierë.

5. Ky përfundim, në kontekstin e mungesës së arsytimit dhe masave mbrojtëse kundërpeshuese, ngre dyshime në lidhje me objektivitetin e procesit të rivlerësimit. Organet rivlerësuese nuk morën parasysh mungesën e një ndryshimi thelbësor midis të ardhurave dhe pasurive si një faktor kundërpeshimi që anon në favor të kërkueses.

6. Arsyeja për akuzën e bërë është paksa e habitshme – deklarimi i rremë dhe fshehja e apartamentit të banimit – pavarësisht se bashkëjetuesi i saj e kish deklaruar këtë apartament menjëherë pas blerjes në vitin 2005 dhe kërkuesja e deklaroi këtë apartament më vonë në vitin 2011 kur titulli i saj i pronësisë u regjistrua zyrtarisht dhe shumë kohë para fillimit të procesit të rivlerësimit në vitin 2018. Siç e dimë, deklarimi i pasurisë nga bashkëjetuesi është një mbrojtje e rëndësishme indirekte për të siguruar që vetë gjyqtarja nuk ishte e përfshirë në korrupsion dhe kjo mbrojtje nuk u mor parasysh nga vendimmarrësit.

7. “Mospërputhje” të tjera të vërejtura nga organet e rivlerësimit janë aq të vogla sa që nuk janë të mjaftueshme për të shkarkuar një gjyqtar nga detyra. Në çdo rast, gjetjet në çështjen në fjalë nuk mbështesin korrupsionin në shkallë të gjerë të deklaruar nga këto organe. Në lidhje me këtë, argumenti se gjyqtarëve u kërkohet të përmbushin standarde veçanërisht të larta integriteti për mënyrën sesi menaxhojnë çështjet e tyre private – ky argument është bërë për të mbështetur vendimin e organeve kombëtare – është i vështirë të pranohet si i rëndësishëm për qëllimin e procesit të rivlerësimit, përkatësisht, për luftën kundër korrupsionit. Duke marrë parasysh vlerësimin e aftësive profesionale të kërkueses dhe gjyqtarëve të tjerë pa pasur nevojë për ndonjë arsye të besueshme, mund të konkludojmë se qëllimi i procesit të rivlerësimit ishte shumë më i gjerë sesa thjesht lufta kundër korrupsionit dhe se organet tejkalojnë marzhin e tyre të vlerësimit. Vlen të përmendet se pothuajse të gjithë gjyqtarët e gjykatave të larta të vendit u hoqën nga pozicionet e tyre. Mos vallë asnjëri prej tyre nuk arriti të përmbushte standardet e larta të integritetit?

8. Më duhet të përmend disa garanci të tjera mbrojtëse që duhen marrë në konsideratë në mbrojtjen e integritetit dhe mosheqjes nga detyra të kërkueses si gjyqtare: siguria ligjore dhe seancat publike. Më shqetëson shumë siguria ligjore dhe vërej një problem sistematik këtu, sepse kërkuesja dhe bashkëjetuesi i saj duhej të paraqisnin dokumente shumë të vjetra – të para 25 viteve – shumica e tyre nga Italia. Për më tepër, një barrë e tillë e ashpër prove iu kalua kërkueses dhe bashkëjetuesit të saj pa ndonjë mbrojtje siç është afati i parashkrimit. Përfundimi i shumicës se nuk ka pasur shkelje të nenit 6 të Konventës nuk është në përputhje me parimet dhe analizën e mëtejshme të bërë nga Gjykata në vendimin Oleksandr Volkov (*Oleksandr Volkov kundër Ukrainës, nr. 21722/11, GJEDNJ 2013, në veçanti paragrafi 137*). Do të sillja ndërmend se në atë rast kërkuesi u mor në pyetje në lidhje me ngjarjet që kishin ndodhur 6–7 vjet para procedimit disiplinor dhe Gjykata gjeti një shkelje në atë rast.

Këtu është propozuar që të arrihet në një përfundim të kundërt edhe pse kërkuesi u vendos në një situatë shumë më të vështirë (kishin kaluar më shumë se 20 vjet, mungesë e dyshimit të arsyeshëm për sjellje të pahijshme).

9. Në vendimin e saj për çështjen *Ramos Nunez De Carvalho e Sá kundër Portugalisë* ([GC], nr. 55391/13 dhe 2 të tjerë, 6 nëntor 2018, në veçanti, paragrafët 179, 190 dhe 191) Gjykata vendosi disa parime dhe evidentoi situata ku seancat publike ishin të nevojshme, për shembull, kur rrethanat kërkojnë që gjykata të krijojë përshtypjen e saj për palët ndërgjyqëse duke u dhënë atyre të drejtën për të shpjeguar situatën e tyre personale. Këta vlejnë edhe për çështjen objekt shqyrtimi, duke marrë parasysh: faktin që Kolegji i Posaçëm i Apelit është i vetmi organ gjyqësor brenda procesit të rivlerësimit; seriozitetin e pasojave për kërkuesin; dhe nevojën për të shpjeguar marrëdhëniet e saj komplekse të pronësisë me bashkëjetuesin e saj. Gjithsesi, KPK-ja nuk mund të konsiderohet një gjykatë e pavarur dhe e paanshme pasi ajo ndërthur në të njëjtën kohë hetimin, akuzën dhe kompetencat vendimmarrëse.

10. Nuk jam kundër një procesi rivlerësimi nëse qëllimi i tij i vërtetë është të luftojë korrupsionin. Megjithatë, Çështja në fjalë mund t'ju tregojë institucioneve të rivlerësimit se ky proces nuk është optimal. Mund të shërbejë, gjithashtu, për të vendosur standarde të rëndësishme për të ardhmen. Komisioni i Venecias në Opinionin e tij nr. 978/2020 i datës 19 qershor 2020 mbi emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese Shqiptare (CDL-AD (2020) 010) ngriti, gjithashtu, disa shqetësime në lidhje me procesin e rivlerësimit (*shih paragrafin 82 të Opinionit*):

“Delegacioni mësoi se herë pas here vështirësitë shkaktoheshin nga nevoja për të justifikuar të ardhurat prej shumë kohësh të bashkëshortëve ... gjithashtu, kishte një zbatim tepër të ngurtë të afateve procedurale shumë të shkurtra (dy javë), në disa raste dokumente të certifikuara duhej të merrej nga jashtë”.

Komisioni i Venecias ngriti më tej shqetësime në lidhje me largimin intensiv të gjyqtarëve nga gjykatat e Larta të vendit, gjë që e bëri të pamundur, për shembull, që Gjykata e Lartë të emëronte kandidatë për Gjykatën Kushtetuese. Të gjithë faktorët e përmendur më lart japin përshtypjen se procesi i rivlerësimit nuk është optimal dhe sigurisht që duhet të korrigjohet.

SEKSIONI I TRETË
“RUCI DHE BEJLERI KUNDËR SHQIPËRISË
DHE 191 KËRKESA TË TJERA”⁶⁷

(kërkesa nr. 56937/10)

VENDIM

(shih listën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë) e mbledhur, më 20 prill 2021, si komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, kryetar

Darian Pavli

Peeter Roosma, gjyqtarë

dhe Olga Chernishova, zëvendësregjistrare e seksionit,

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme të paraqitura në data të ndryshme, të reflektuara në tabelat bashkëngjitur,

Duke marrë në konsideratë vendimin pilot në çështjen Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr. 604/07 dhe 3 të tjerë, 31 korrik 2012.

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Në tabelat bashkëngjitur këtij vendimi (Shtojca) gjendet një listë e detajuar kërkuesish, duke përfshirë përfaqësuesit e tyre dhe datën e paraqitjes së secilës kërkesë.

A. Sfondi i çështjes

2. Në vitin 2012, Gjykata nxori një vendim pilot në lidhje me Shqipërinë, ku konstatohej një shkelje e nenit 6§1 të Konventës, si edhe i nenit 1 të protokollit nr. 1 për sa i përket moszbatimit të tejzgjatur të vendimeve të formës së prerë, të cilat jepnin kompensim në vend të rikthimit të pronës së shpronësuar nga ish regjimi komunist, si edhe një shkelje të nenit 13 të Konventës për shkak të mungesës së një zgjidhjeje të brendshme efektive për këtë aspekt (*shih Manushaqe Puto dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr. 604/07 dhe 3 të tjerë, 31 korrik 2012*).

3. Në vijim të zbatimit të vendimit pilot Manushaqe Puto dhe të tjerët, më 5 dhjetor 2015, Parlamenti shqiptar miratoi ligjin për trajtimin e pronës dhe finalizimin e procesit për kompensimin e pronës (Ligji i pronës 2015), i cili prezantonte një zgjidhje të re për garantimin e zbatimit të së drejtës për kompensim. Sipas zgjidhjes së re, për qëllim zbatimi, të gjitha vendimet e formës së prerë, të cilat njihnin të drejtën për kompensim, pa përcaktuar shumën e kompensimit, do t'i nënshtrohen një vlerësimi financiar. Ky vlerësim do të kryhet nga Agjencia për Trajtimin e Pronës (ATP), e cila u krijua sipas aktit të pronës 2015. ATP-ja përcaktonte vlerën e vlerësimit financiar sipas kategorisë kadastrale të pronës në kohën e shpronësimit. Më pas u miratuan hartat për vlerësimin e pronës, të cilat përmbanin emrat e njësisve administrative, zonat kadastrale, kategorinë kadastrale dhe çmimin respektiv për metër katror.

Vendimet e formës së prerë të paekzekutuar, të cilët përcaktonin shumën e kompensimit, do të ekzekutoheshin të plotë, sipas indeksimit.

4. Më 17 mars 2020, Gjykata lëshoi një vendim historik për çështjen *Beshiri dhe të tjerët kundër Shqipërisë* (vend.), nr. 29026/06 dhe 11 kërkesa të tjera, në të cilin ajo konstatoi se sipas, midis të tjerash, shumës së kompensimit e cila nuk ishte më pak se 10% e vlerës për të cilën ish-pronarët do të fitonin të drejtën, nëse vlerësimi financiar do të kryhej duke iu referuar kategorisë aktuale kadastrale të

⁶⁷ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 105*. Tiranë, 2021.f.9798

pronës së shpronësuar, zgjidhje e brendshme e paraqitur në mbështetje të aktit të pronës 2015 ishte efikas (ibid., §196).

B. Rrethanat e çështjes

5. Kërkesat në fjalë u paraqitën në Gjykatë në harkun kohor 2010–2015, dhe kanë të bëjnë me moszbatimin e tejzgjatur të vendimeve të formës së prerë, të cilat u njohin kërkuessve të drejtat për kompensim në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji në vend të kthimit të pronave të tyre, të shpronësuar nga ish-regjimi komunist. Ato ngrenë çështjet e ngjashme me ato të shqyrtuara nga Gjykata në çështjen *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, vendimi pilot, cituar më sipër.

6. Detajet e vendimeve të formës së prerë dhe zbatimi i tyre, të përditësuar sipas informacioneve të ofruara nga shumica e kërkuessve, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në shtojcë.

C. Ligji dhe praktika përkatëse e brendshme

1. Akti për pronat 2015

7. Akti për pronat i vitit 2015 u përshkrua në detaje në vendimin për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§30–62. Ashtu si nënvizohet në vendim, me anë të shqyrtimit kushtetues *in abstracto*, në janar të vitit 2017, Gjykata Kushtetuese miratoi skemën e re të kompensimit, e paraqitur në seksionet 6(1) dhe (2) të ligjit për pronat 2015. Skema nuk arriti numrin e kërkuar të votave për të vendosur mbi përllogaritjen e vlerësimit financiar parashikuar në seksionin 7, dhe rrjedhimisht, vendosi refuzimin e kërkesës. Pjesët operative të vendimit parashikonin se Gjykata Kushtetuese vendosi refuzimin e kërkesës për shfuqizimin e nenit 6, paragrafi 1, shkronja “b”, si edhe të nenit 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”. Megjithatë, ajo vendosi të rrezonte nenet 6, paragrafët 3 dhe 5, në aktin për pronat 2015, duke theksuar se (sipas vendimit për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, cituar më sipër):

“70.... [Ato] parashikime ‘u interpretuan si një shpronësim i ri, duke qenë se parashikonin një rivlerësim të pronave të cilat i ishin kthyer [ish]pronarëve ose për të cilat ata ishin kompensuar tashmë’. Për këtë arsye, ata ngritën çështje që kishin të bënin me shkeljen e parimit të sigurisë ligjore, veçanërisht në lidhje me qartësinë dhe parashikueshmërinë. Gjykata Kushtetuese nënvizonte se ‘ligjbërësi duhej të mbante në konsideratë masën në të cilën kompensimi në natyrë i parashikuar në nenet [e shfuqizuar] 6§§3 dhe 5 të plotësohet me anë të parashikimeve të tjera për të shmangur mbivendosjen ose mospajtimin midis parashikimeve ligjore”.

8. Pavarësisht vendimit të Gjykatës Kushtetuese, më 7 dhjetor 2017, një kërkesë e re për një shqyrtim kushtetues *in abstracto* i neneve 6, paragrafi 1, shkronja 6 dhe 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, i ligjit për pronat, si edhe i dispozitave të caktuara për zbatimin e vendimeve miratuar nga Qeveria, u paraqit në Gjykatën Kushtetuese me anë të shoqatës së ish-pronarëve (*shih edhe Beshiri dhe të tjerët*, cituar më sipër, §§73, 81 dhe 89).

2. Praktika gjyqësore e brendshme në vijimësi të vendimit të Gjykatës në çështjen *Beshiri dhe të tjerët*

a) Praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese

9. Si përgjigje ndaj kërkesës së dytë për shqyrtim kushtetues të disa dispozitave në ligjin për pronat 2015, dhe vendimet e saj zbatuese (*shih paragrafin 8 më sipër*), në vendimin nr. 4 të datës 15 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese vendosi se përderisa ajo nuk kishte shqyrtuar themelin e kërkesave në lidhje me nenet 6, paragrafi 1, shkronja “b” dhe 7, paragrafi 2, shkronja “a” dhe “b” në ligjin për pronat 2015, dhe nuk kishte marrë një vendim të së prerë në lidhje me përputhshmërinë e tyre me parashikimet kushtetuese dhe Konventën në vitin 2017, parimi *res judicata* nuk zbatohet për konstatimet e saj të mëparshme për këto kërkesa, dhe për pasojë, asaj nuk i ndalohej të shqyrtonte themelin e këtyre kërkesave.

10. Gjykata Kushtetuese ritheksonte se neni 6, paragrafët 1 dhe 2, përmbante parimet kryesore të formulës së kompensimit (ndryshe referuar si vlerësimi financiar në ligjin për pronat 2015). Parashikimi i nenit 6, paragrafi 1, shkronja “b” ishte një element përbërës i formulës së kompensimit parashikuar në nenin 6, dhe rregullonte vlerësimin e pronës e cila ishte kthyer. Pjesa tjetër e parashikimeve të nenit 6 rregullonte situata të tjera në lidhje me zbatimin e formulës së kompensimit (që do të thotë, vlerësimin financiar). Për këtë arsye, ajo arriti në përfundimin se shfuqizimi i neneve 6,

paragrafët 3 dhe 5, nuk kishte ndikim në zbatimin e nenit 6, paragrafi 1, shkronja “b”, dhe e rrëzoi atë pjesë të kërkesës.

11. Në lidhje me nenin 7, paragrafi 2, Gjykata Kushtetuese deklaroi se parashikimet e nenit 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, sanksiononin rastet kur një ish-pronar kishte përfutur kthim të pjesshëm paraprak të pronës së shpronësuar. Gjykata Kushtetuese vërente se, në mbështetje të informacioneve të ofruara nga Qeveria, një numër i konsiderueshëm vendimesh, konkretisht 10120 nga 26091, të cilët i ishin nënshtruar vlerësimit financiar, iu nënshtruan një ndryshimi të kategorisë kadastrale gjatë kohës. Për pasojë, i takonte organit ligjvënës – dhe jo degës ekzekutive të Shtetit – të përcaktonte mënyrën se si pragu minimal prej 10% për shumën e kompensimit që kjo Gjykatë kishte urdhëruar për vendimin në çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, do të zbatohet për këtë kategori, duke përfshirë shitjet ku ish-pronarët kishin përfutur një kthim të mëparshëm të pjesshëm. Për këtë arsye, Gjykata Kushtetuese konstatoi se metoda e përlogaritjes në nenin 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, i cili nuk ishte ndryshuar pas vendimit të Gjykatës *Beshiri dhe të tjerët*, nuk respektonte prapun minimal 10%, dhe arriti në përfundimin se ndërhyrja në të drejtën e ish-pronarëve ndaj pronës ishte e shpërpjesëtimuar. Për këtë arsye, ajo vendosi të shfuqizonte nenin 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit për pronat 2015. Gjykata Kushtetuese e shtyu hyrjen në fuqi të vendimit të saj me gjashtë muaj, dhe e orientoi organin ligjvënës të miratonte legjislacionin e ri, brenda së njëjtës periudhë, për të mbushur vakumin ligjor në ligjin për pronat 2015, i cili vinte prej dispozitave të shfuqizuara.

12. Në vijim, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi disa parashikime të vendimeve zbatuese të miratuara nga Qeveria, duke qenë se sipas ligjit për pronat 2015, organi ligjvënës nuk i delegonte Qeverisë autoritetin për të përcaktuar një urdhër prioritar për format e kompensimit, ose një kombinim formash të ndryshme kompensimi.

b) Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë

13. Nga data 15 maj deri më 8 qershor 2020, trupi gjykues administrativ i Gjykatës së Lartë dha një numër vendimesh në lidhje me kërkesat për vonesën e zbatimit të vendimeve të gjykatave të brendshme të dhëna në çështjet që kishin lidhje me vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja, më konkretisht vendimet nr. 210, të datës 15 maj 2020, nr. 122/462, të datës 1 qershor 2020, nr. 45/327 dhe 56/348, të datës 8 qershor 2020.

14. Trupi gjykues administrativ i Gjykatës së Lartë vendosi se masa për vonesën e zbatimit të vendimeve të dhëna nga Gjykata Administrative e Apelit do të jepej me kushtin që, midis të tjerash, vendimet e kundërshtuara të ishin të formës së prerë. Në këto raste, sipas shqyrtimeve të Gjykatës Administrative të Apelit ndaj vendimeve të ATP-së për vlerësimin financiar si gjykatë e shkallës së parë, dhe pasi në Gjykatën e Lartë ishte paraqitur një apelim ndaj vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit dhe ishte ende pezull përpara saj, kërkesa për vonesën e zbatimit u rrëzua me arsyetimin se vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit nuk ishin të formës së prerë. Vendimet e Gjykatës Administrative të Apelit kishin anuluar vlerësimin financiar të kryer nga ATP-ja dhe e kishin urdhëruar ATP-në që ose të kryente një vlerësim financiar të ri, ose të urdhëronte pagesën e një shume të caktuar parash si kompensim financiar.

Ankesat

15. Pothuajse të gjithë kërkuessit u ankuan për një shkelje të nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës dhe shumica e kërkuessve u ankuan se ishte shkelur neni 13 i Konventës, për shkak se autoritetet nuk kishin zbatuar vendimet e formës së prerë, të cilat u njihnin të drejtën për të marrë kompensim, në vend të kthimit të pronave.

LIGJI

16. Gjykata vëren se kërkuessit u ankuan në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës, vetëm dhe së bashku me nenin 13 të Konventës, i cili, për sa ka të bëjë me rastin në fjalë, parashikon si më poshtë:

“1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë...”

Neni 13 – E drejta për zgjidhje efektive

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që vepronë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 1 i protokollit nr. 1 – Mbrojtja e pronës

“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”

A. Bashkimet e kërkesave

17. Duke pasur në konsideratë lëndën e ngjashme të kërkesave, Gjykata gjykon se është e përshtatshme që t'i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm, në përputhje me rregullin 42§1 të rregullores së Gjykatës.

B. Ankesa në mbështetje të nenit 13 të Konventës, si edhe ankesat në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 të Konventës

1. Në lidhje me vendimin nr. 651, të datës 31 tetor 1994 për kërkesën nr. 24086/15, kërkesa nr. 41685/15 dhe vendimet nr. 210, të datës 7 korrik 1995 dhe nr. 210, të datës 26 shkurt 2008 për kërkesën 56491/15

18. Në lidhje me vendimin nr. 651, të datës 31 tetor 1994, dhënë për kërkesën nr. 24086/15 (*shih rreshtin nr. 15 të shtojcës*), kërkesa nr. 41685/15 (*shih rreshtin nr. 43 të shtojcës*), si edhe vendimet nr. 210, të datës 7 korrik 1995 dhe nr. 210 të datës 26 shkurt 2008 dhënë në lidhje me kërkesën nr. 56491/15 (*shih rreshtin nr. 61 të shtojcës*), Gjykata merr në konsideratë dëshirën e kërkuarve për t'i tërhequr ankesat e tyre. Në këto rrethana, Gjykata arrin në përfundimin se kërkuarët nuk kanë për synim të vijojnë me ankesat e tyre për vendimet në fjalë, sipas interpretimit të nenit 37§1 (a) të Konventës, dhe nuk ka arsye të interesit të përgjithshëm për të drejtat e njeriut, sipas interpretimit të fjalisë së fundit të nenit 37§1, sipas së cilave do të kërkohej shqyrtimi i vazhdueshëm i atyre ankesave.

19. Në vijim, për sa ka të bëjë me ankesat për vendimin nr. 651, të datës 31 tetor 1994, dhënë për kërkesën nr. 24086/15, vendimet nr. 210, të datës 7 korrik 1995 dhe nr. 210 të datës 26 shkurt 2008, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 56491/15, kjo pjesë e kërkesës duhet të hiqet prej listës së çështjeve të Gjykatës. Në lidhje me kërkesën nr. 41685/15, kjo kërkesë duhet të hiqet nga lista e çështjeve të Gjykatës.

2. Në lidhje me pjesën e mbetur të kërkesave

20. Si fillim, Gjykata mendon se nuk është e nevojshme të shqyrtohet aspekti ligjor i kërkuarve apo trashëgimtarëve, pjesët e tyre të pronave të trashëguara, apo e drejta e tyre për kompensim ose ndonjë mospërputhje faktike për vendimet e brendshme, duke qenë se kërkesat janë të papranueshme për arsyet e mëposhtme.

21. Gjykata sjell në vëmendje se si pjesë e zbatimit të vendimit pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, autoritetet kanë paraqitur një zgjidhje të brendshme, duke miratuar ligjin për pronat 2015 (*shih paragrafin 3 më sipër*). Gjykata e shqyrtoi këtë zgjidhje të brendshme në vendimin për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, dhe konstatoi se sipas informacionit të disponueshëm në momentin respektiv, ajo zgjidhje ishte efikase sipas interpretimit të nenit 35§1 dhe nenit 13 të Konventës (*shih paragrafin 4 më sipër*).

22. Gjykata vëren se pas dhënies së vendimit për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, më 15 shkurt 2021, Gjykata Kushtetuese dha vendimin në lidhje me kërkesën tjetër për shqyrtim kushtetues *in abstracto* të disa dispozitave në ligjin për pronat 2015, duke shfuqizuar nenin 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, dhe disa parashikime për vendimet zbatuese. Gjykata është e mendimit se konstatimet e Gjykatës Kushtetuese nuk parashikojnë një shmangie nga gjetjet e saj, se zgjidhja e re kompensuese mbetet ende një zgjidhje efikase, sipas interpretimit të nenit 35§1 dhe nenit 13 të Konventës, për arsyet dhënë më poshtë.

23. Gjykata vëren se Gjykata Kushtetues rikonfirmoi aspektet kryesore të skemës së kompensimit, sipas parashikimit në nenin 4 të ligjit për pronat 2015. Ajo nuk vuri në pyetje referimin në kategorinë kadastrale origjinale të pronës së shpronësuar si baza kryesore për realizimin e vlerësimit financiar.

24. Gjykata plotëson se në vendimin për shfuqizimin e nenit 7, paragrafi 2, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit për pronat 2015, i cili sanksiononte përcaktimin e vlerësimit financiar kur një ish-pronar ka përfutur rikthim të pjesshëm të mëparshëm të pronës së shpronësuar, Gjykata Kushtetuese veçoi me konsistencë, dhe në të vërtetë, u përpoq të zbatonte udhëzimin e Gjykatës se shumica e kompensimit nuk duhej të ishte më pak se 10% e vlerësimit për të cilën ish-pronarët do të kishin të drejtë, nëse vlerësimi financiar kryhej duke iu referuar kategorisë aktuale kadastrale të pronës së shpronësuar (*shih Beshiri dhe të tjerët, cituar më sipër, §196*). Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese udhëzoi zëvendësimin e dispozitave të shfuqizuara brenda një periudhe gjashtëmujore.

25. Gjykata nuk mendon se shfuqizimi i dispozitave të zbatueshme në vendimet zbatuese të miratuara nga Qeveria ngre problematika të reja. Gjykata ka shpjeguar tashmë në vendimin për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, midis të tjerash, se nuk ishte detyra e saj të “përcaktonte hierarkinë e formave të kompensimit që do të duhej të jepeshin nga autoritetet e brendshme”, dhe se kuadri ligjor i brendshëm “duhej të përshkruante dhe përkufizonte me qartësi ushtrimin e diskrecionit nga ATP-ja – ose autoritete të tjera zbatuese – në vendimmarrjen për dhënien e kompensimit” (ibid., §§179 dhe 180). Gjithashtu, Gjykata thekson se për sa i përket barrës së konsiderueshme mbi buxhetin e Shtetit, i cili mbulonte kompensimin financiar, ajo e detyronte Shtetin e paditur në vendimin pilot *Manushaqe Puto dhe të tjerët*, “të konsideronte me prioritet fillimin e përdorimit të formave të tjera alternative të kompensimit, të cilat do të lehtësonin presionin mbi buxhetin, dhe/ose të përdorte forma të tjera kompensimi” (ibid., §113).

26. Gjykata konstaton se, për sa u përket arsyeve të cituara më sipër, më konkretisht rikonfirmimi i detajeve kryesore të skemës së kompensimit, miratimi i shumës së kompensimit që do t’i jepej ish-pronarëve sipas udhëzimit në vendimin *Beshiri dhe të tjerët* dhe parashikimi statutor për forma të ndryshme kompensimi, asnjë problematikë nuk ndikon në efikasitetin e zgjidhjes së parashikuar nga ligji për pronën 2015, ligj i cili vijon të jetë i aksesueshëm dhe efikas për të gjithë ish-pronarët dhe parashikon formën e duhur të korrigjimit. Hyrja në fuqi e vonuar e vendimit të Gjykatës Kushtetuese do t’i lejojë autoritetet, veçanërisht organin ligjvënës, të miratojnë legjislacionin i cili do të garantonte respektim të vendimit të Gjykatës për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, dhe të ruajë efikasitetin e zgjidhjes së parashikuar në ligjin për pronat 2015. Për këtë arsye, Gjykata e vendos se ankesa e kërkuesve sipas nenit 13 të Konventës (*shih paragrafin 15 më sipër*) është dukshëm i pambështetur në fakte dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35§§3 dhe 4 të Konventës (*shih edhe, Beshiri dhe të tjerët, cituar më sipër, §221*).

27. Në lidhje me ankesat e tjera të kërkuesve në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës dhe nenit 1 të protokollit nr. 1 (*shih paragrafin 15 më sipër*), Gjykata vëren se në varësi të fazës aktuale të procedimeve për kërkesën, mund të konstatohen situatat e mëposhtme.

28. Fillimisht, në lidhje me vendimin nr. 110, të datës 29 qershor 1995, dhënë për vendimin nr. 30046/15 (*shih rreshtin nr. 29 të shtojcës*), nr. 241, të datës 12 shtator 1995 dhënë për kërkesën 161/17 (*shih rreshtin nr. 121 të shtojcës*), nr. 67, të datës 6 prill 2006, dhënë në lidhje me kërkesën nr. 35959/17 (*shih rreshtin nr. 126 të shtojcës*), si edhe kërkesat e përshkruara në tabelën 2 (*rreshtat nr. 157–92 të shtojcës*), Gjykata vëren se procedimet e brendshme në lidhje me përcaktimin e shumës së kompensimit janë pezull përpara gjykatave kombëtare. Ajo gjykon se trajtimi i këtyre ankesave do të ishte i parakohshëm. Ato do të duhej të rrëzoheshin sipas nenit 35 §§1 dhe 4 të Konventës (*shih Beshiri dhe të tjerët, cituar më sipër, §219*). Praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë konfirmon se në rastin e paraqitjes së një apelimi me gjykatën më të lartë, vendimet e gjykatave më të ulëta do të ishin të formës së prerë dhe të zbatueshme pa dhënies së vendimit nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafët 13 dhe 14 më sipër*).

29. Së dyti, Gjykata vëren se për sa ka të bëjë me vendimet nr. 43859/13 dhe 18669/16 (*shih rreshtat nr. 5 dhe 97 të shtojcës*), autoritete e brendshme me anë të një vendimi të formës së prerë nuk i njohën kërkuesve të drejtën për kompensim, gjë për të cilën nuk mund të thuhet se ata kanë

“přitshmerinë legjitime” të marrin kompensim, dhe në këtë mënyrë “pronësinë” sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 (*shih Kopecký kundër Slovakia [DHM], nr. 44912/98, §49, GJEDNJ 2004 IX; dhe Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës së Çekisë (vend.), 39794/98, §73, GJEDNJ 2002 VII*). Në lidhje me kërkesën nr. 18669/16, kërkuetit nuk kanë ofruar ndonjë informacion të përditësuar se kanë paraqitur një kërkesë të re për pronën sipas ligjit për pronën 2015, duke kërkuar njohjen e së drejtës së tyre për kompensim. Më tej vijohet se kërkesa sipas nenit 1 të protokollit nr. 1 është e papërputhshme *ratione materiae* me parashikimet e Konventës sipas interpretimit të nenit 35§3 dhe duhet të rrezohet sipas nenit 35§4 të Konventës. Për pasojë, ankesa sipas nenit 6§1 të Konventës për moszbatimin e këtyre vendimeve të brendshme është dukshëm e pambështetur në fakte, dhe duhet të rrezohet në përputhje me nenin 35§§4 të Konventës.

30. Së treti, për aq kohë sa kërkuetit, në kërkesat nr. 11666/20 dhe 22859/20 (*shih rreshtat nr. 186 dhe 155 të shtojcës*), pretendojnë se vendimet e gjykatës që njohin ekzistencën e një fakti ligjor sjellin “pronësinë”, sipas interpretimit të nenit 1 të protokollit nr. 1, Gjykata është e mendimit se kjo ankesë është e papërputhshme *ratione materiae* sipas interpretimit të nenit 35§3, duke qenë se vendimet gjyqësore nuk përmendnin të drejtat e kërkuetve ndaj pronës apo ndonjë të drejtë tjetër cilado qoftë ajo (*shih Bici kundër Shqipërisë, nr. 5250/07, §§46–52, 3 dhjetor 2015, dhe, mutatis mutandis, Marku kundër Shqipërisë, nr. 54710/12, §37, 15 korrik 2014*). Për këtë arsye, kjo ankesë duhet të rrezohet në përputhje me nenin 35 §4 të Konventës. Për pasojë, çdo ankesë për moszbatimin e vendimeve të tilla të brendshme sipas nenit 6§1 të Konventës është dukshëm e pambështetur në fakte dhe duhet të rrezohet sipas nenit 35§§3 dhe 4 të Konventës.

31. Së fundmi, Gjykata konstaton se pavarësisht datës së paraqitjes së kërkesave, pjesa e mbetur e kërkesave në shtojcë, me përjashtim të vendimeve individuale dhënë për kërkesat të cilat janë trajtuar në mënyrë të veçantë në paragrafët 18–19 dhe 28–30 më sipër, u kërkuar ose kërkohen që t’i nënshtrohen zgjidhjes së re të brendshme sipas ligjit për pronën 2015, në përputhje me rregullat e brendshme. Kërkuetit ose nuk kanë mundur të shterojnë mjetet e brendshme, ose nuk kanë informuar Gjykatën për cilindo veprim që kanë marrë për këtë gjë. Kjo zbatohet edhe për ato raste në të cilat ATP-ja nuk ka kryer vlerësimin financiar për shkak të mungesës së dokumentacionit të kërkuar ose për arsye të tjera, ose për ato raste në të cilat ATP-ja ka vendosur se gjykohej se kërkuetit janë kompensuar plotësisht, për të cilat kërkuetve i është kërkuar që të ndjekin procedurat përkatëse të brendshme. Gjykata nuk konstaton asnjë rrethanë të jashtëzakonshme për të përjashtuar kërkuetit nga detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme (*shih Beshiri dhe të tjerët, cituar më sipër, §§216 18*). Më tej vijohet, se këto ankesa duhet të rrezohen në mbështetje të nenit 35§1 dhe 4 të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

32. Pavarësisht konkluzionit të mësipërm, Gjykata sjellë në vëmendje parashikimet e bëra në paragrafin 222 të vendimit për çështjen *Beshiri dhe të tjerët*, cituar më sipër, në lidhje me kushtet të cilat duhet t’i përmbushin autoritetet në mënyrë që zgjidhja të vijojë të mbesë efikase, veçanërisht dhënia e kompensimit për jo më pak se 10% të vlerës për të cilën kanë të drejtë ish-pronarët, nëse vlerësimi financiar është bërë në referencë të kategorisë aktuale kadastrale të pronës së shpronësuar.

C. Shkelje të tjera të pretenduara të Konventës

33. Duke qenë se kërkuetit në kërkesën nr. 18669/16 (*shih rreshtin nr. 97 të shtojcës*) ankohen për padrejtësinë e pretenduar të procedimeve të brendshme gjyqësore, Gjykata vëren se, sipas materialit në dosjen e çështjes, vendimi i fundit i brendshëm është dhënë nga Gjykata e Lartë, më 26 shkurt 2013, më shumë se gjashtë muaj përpara datës së paraqitjes së kërkesës më 31 mars 2016. Më tej vijohet se kjo ankesë sipas nenit 6 §1 i ka kaluar afatet dhe duhet të deklarohet e papranueshme sipas nenit 35§§1 dhe 4 të Konventës.

34. Duke ruajtur në konsideratë të gjithë materialin e zotëruar dhe duke qenë se ankesat janë në kompetencën e saj, Gjykata konstaton se ankesat, sipas nenit 6§1 të Konventës për padrejtësinë e pretenduar në procedimet e brendshme gjyqësore në lidhje me kërkesat nr. 7645/16, 9833/16 dhe 14390/20 (*shih rreshtat nr. 86, 89 dhe 95*) dhe ankesat në mbështetje të nenit 14 të Konventës për kërkesat nr. 21990/16, 24962/16, 27133/17 dhe 32114/17 (*shih rreshtat nr. 98, 172, 177 dhe 178 të*

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

shtojcës) nuk përbëjnë shkelje të të drejtave dhe lirive të parashikuara në Konventë ose në protokollet e saj. Më tej vijaohet, se kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet si dukshëm e pambështetur në fakte, sipas nenit 35§§3 dhe 4 të Konventës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos t'i bashkojë kërkesat;
- Vendos të heqë nga lista e çështjeve ankesat në lidhje me vendimin nr. 651, të datës 31 tetor 1994, dhënë për kërkesën nr. 24086/15, vendimet nr. 210, të datës 7 korrik 1995 dhe nr. 210, të datës 26 shkurt 2008 dhënë për kërkesën 56491/15 dhe kërkesën nr. 41685/15;
- E deklaroi pjesën e mbetur të kërkesave të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 3 qershor 2021.

Olga Chernishova
Zëvendësregjistrare

Dmitry Dedov
Kryetar

SHTOJCË Tabela 1

Nr.	Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuarit	Neni	Përshkrimi i vendimeve të brendshme të formës së prerë	Detajet e zbatimit	Përfaqësuar nga
1	56937/10 dorëzuar më 21.7.2010	Gani Ruçi Fazilete Bejleri (lindur Ruçi)	Nenet 6 §1 dhe 13 si edhe neni 1 i protokollit nr. 1	Me anë të vendimit nr. 1007, të datës 21 prill 2003, Komisioni i Gjyrosuesve njohu të drejtat e kërkuarve për pronën e trashëguar me një sipërfaqe prej 40 000 m ² , e cila do të kompensohej me anë të bonove shtetërore në shumën prej 976 000 lekë shqiptarë ("ALL" - afërsisht 7 776 euro "EUR").	Kërkuarët nuk i janë përgjigjur një shkresë dërguar nga Regjistrimi më 21 janar 2020, me anë të së cilës kërkohet informacion për përcaktimin e autoriteteve të vlerësimit financiar.	Artan Hajdari
2	60985/12 dorëzuar më 17.9.2012	Zamira Marku	Neni 6 §1 si edhe neni 1 i protokollit nr. 1	Me anë të vendimit nr. 742, të datës 4 mars 1996, Komisioni i Tiranës, duke plotësuar vendimin e tij nr. 400 të datës 2 tetor 1995 i njohu kërkuarët të drejtat e pronës së trashëguar, për një sipërfaqe prej 69 400 m ² , e cila ishte zënë nga godina të ndërtuara në mënyrë të paligjshme, nga të cilat 5 000 m ² do të kompensoheshin në natyrë dhe pjesa e mbetur prej 59 400 m ² do të kompensohej sipas ligjit.	Kërkuarët nuk i është përgjigjur një shkresë dërguar nga Regjistrimi më 2 janar 2020, me anë të së cilës kërkohet informacion për përcaktimin e autoriteteve të vlerësimit financiar.	Spiro Dodbiba
191	21585/20 Lodged on 24/04/2020	Minerva Kotherja	Nenet 6 §1 dhe 13 si edhe neni 1 i protokollit nr. 1	Kjo kërkesë është e njëjtë si kërkesa nr. 70211/13, e cila u deklarua e papranueshme nga Gjykata në vendimin e saj në çështjen <i>Gjergji dhe të tjerët kundër Shqipërisë</i> (vend.) [Komisioni] (nr. 13618/10 dhe 76 kërkesa të tjera, 8 shtator 2020).	ATP-ja ka kryer vlerësimin financiar të vendimit të brendshëm, dhe apelimi i kërkesve në kasacion ndaj vendimit të ATP-së është pezull në Gjykatën e Lartë.	Endri Kotherja

SEKSIONI I TRETË
“SOKOL SHETI KUNDËR SHQIPËRISË
DHE MERITA GJASHTA KUNDËR SHQIPËRISË”⁷⁵
(kërkesat nr. 13514/16 dhe 52735/20)

VENDIM
(*shih tabelën bashkëngjitur*)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 23 shtator 2021, si një komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, kryetar

Peeter Roosma

Andreas Zünd, gjyqtarë

dhe Viktoriya Maradudina, zëvendëssekretare e përkohshme e seksionit

Në lidhje me kërkesat e mësipërme paraqitur në data të ndryshme, të reflektuara në tabelën bashkëlidhur,

Në lidhje me deklaratat formale për pranimin e një zgjidhjeje miqësore për çështjet,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Lista e kërkesave është paraqitur në tabelën bashkëlidhur.

Ankesat e kërkesave, në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me moszbatimin ose zbatimin e vonuar të vendimeve vendëse, iu komunikuan Qeverisë Shqiptare (Qeveria). Ankesat, mbështetur në të njëjtat fakte, u komunikuan edhe sipas parashikimeve të tjera të Konventës (*shih tabelën bashkëlidhur*).

Gjykata mori deklaratat për zgjidhje miqësore, nënshkruar nga palët, sipas së cilave kërkesit binin dakord të hiqnin dorë nga pretendime të tjera kundrejt Shqipërisë për sa u përket fakteve që sollën këto kërkesa, pas një sipërmarrjeje nga Qeveria për t’i paguar atyre shumat e detajuara në tabelën bashkëlidhur. Këto shuma do të konvertohen në vlerën monetare të Shtetit të paditur, në normën e zbatueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhen brenda tre muajsh nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se këto shuma nuk paguhen brenda periudhës së sipërpërmendur tremujore, Qeveria ndërmerr të paguajë interesin e thjeshtë kundrejt tyre, nga momenti i përfundimit të asaj periudhe deri në kompensim, në normën e barabartë me normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit plus tri pikë përqindjeje. Gjithashtu, Qeveria ndërmerr të garantojë zbatimin e vendimeve vendëse në fjalë për çështjet konkrete (*shih tabelën bashkëngjitur*) brenda së njëjtës periudhe tremujore, si edhe të paguajë çdo kosto për procedimet vendëse të ekzekutimit.

Pagesa dhe ekzekutimi i vendimeve vendëse për çështjet në fjalë do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjeve.

LIGJI

Duke pasur në konsideratë lëndën e njëjtë të kërkesave, Gjykata e konsideron të përshtatshme që t’i shqyrtojë ato së bashku në një vendim të vetëm.

Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo mbështet faktin se zgjidhja respekton të drejtat e njeriut, sipas parashikimit të Konventës dhe të protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye të justifikojë vijimin e shqyrtimit të kërkesave.

Për sa më sipër, është me vend që çështjet të përjashtohen nga lista.

⁷⁵ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 170*. Tiranë 2021, f. 15335

Përmbledhje e vendimeve të GJEDNJ-së kundër Shqipërisë, 2010-2021

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos t'i bashkojë kërkesat;
- Vendos t'i përjashtojë kërkesat nga lista e çështjeve, sipas nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 14 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
Zëvendëssekretare e përkohshme

Dmitry Dedov
Kryetar

Shtojcë

LISTA E KËRKESAVE QË NGRENË ANKESA NË MBËSHTETJE TË NENIT 6§1 TË KONVENTËS (moszbatimi i ekzekutimit të vonuar të vendimeve vendëse)

Nr.	Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuarit, viti i lindjes	Ankesa të tjera sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar	Vendimi përkatës vendës	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së deklaratës së ankuarit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar për kërkuar (në euro) ⁷⁶
1	13514/16 5.3.2016	Sokol Sheti 1956	Neni 13 – mungesa e mjetit efikas në ligjin vendës në lidhje me moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse. Prot. 1 Neni 1 – ndërhyrje në gëzimin e paq të zotërimeve si rezultat i moszbatimit të vendimit në favor të kërkuarit	Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 3670, datë 3.11.2015	22.7.2021	15.7.2021	2,500
2	60743/16 6.10.2016	Merita Gjashta 1958	Neni 13 – mungesa e mjetit efikas në ligjin vendës për moszbatimin ose ekzekutimin e vonuar të vendimeve vendëse.	Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 01524/13, i datës 7.4.2016	22.7.2021	17.5.2021	2,100

⁷⁶ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarve.

SEKSIONI I TRETË
“ILIR BEQJA KUNDËR SHQIPËRISË”⁷⁷
(kërkesa nr. 26512/12)

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 23 shtator 2021, si një komision i përbërë nga:

Dmitry Dedov, kryetar

Peeter Roosma

Andres Zünd, gjyqtarë

dhe Viktoriya Maradudina, zëvendëssekretare e përkohshme e seksionit,

Për sa i përket kërkesës së mësipërme dorëzuar në datë 5 prill 2012,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Kërkuesi, z. Ilir Beqja, ka lindur në Tiranë.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron aktivitetin e tij në Tiranë.

Ankesa e kërkuesit për një shkelje të nenit 3 të protokollit nr. 1 të Konventës, për shkak të diskualifikimit të tij për mbajtjen e mandatit parlamentar, iu komunikua Qeverisë Shqiptare (Qeveria).

Me anë të shkresave të datës 20 nëntor dhe 15 dhjetor 2020, vërejtjet e Qeverisë me shkrim, në shqip dhe në anglisht, iu dërguan përfaqësuesit të kërkuesit, me anë të Shërbimit të Komunikimeve Elektronike të Gjykatës (*eComms*), i cili u ftua që deri më 4 janar 2021 të paraqiste me shkrim çdo vërejtje që dëshironte të bënte si përgjigje në emër të kërkuesit, së bashku me pretendimet për kompensim të drejtë. Nuk është dërguar asnjë përgjigje, edhe pse përfaqësuesi i kërkuesit i shkarkoi shkresat më 7 dhjetor 2020, dhe 5 janar 2021, respektivisht.

Me anë të një shkrese të datës 4 shkurt 2021, përfaqësuesi i kërkuesit u bë me dije se mosdorëzimi i një përgjigjeje mund të rezultonte në përjashtimin e kërkesës sipas nenit 37§1 (a) të Konventës. Përfaqësuesi i kërkuesit e shkarkoi shkresën më 8 shkurt 2021, dhe më pas më 11 shkurt, 17 maj, 8 qershor dhe 29 korrik 2021. Megjithatë, nuk erdhi asnjë përgjigje. Ai nuk ka kërkuar të kontaktojë Gjykatën për të raportuar për ndonjë çështje teknike, ose për ndonjë çështje tjetër.

LIGJI

Për sa më sipër, dhe në mungesë të rrethanave të veçanta në lidhje me respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa dhe Protokollet në të, Gjykata, në mbështetje të nenit 37§1(a) të Konventës, gjykon se nuk justifikohet që të vijohet më tej me shqyrtimin e kërkesës,

PËR KËTË ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 14 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
Zëvendëssekretare e përkohshme

Dmitry Dedov
Kryetar

⁷⁷ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 170*. Tiranë 2021, f. 15337

SEKSIONI I TRETË
“RENALDO BREGU KUNDËR SHQIPËRISË
DHE NATASHA NOKSHIQI KUNDËR SHQIPËRISË”⁷⁸
(kërkesat nr. 41411/11 dhe 58014/16)

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 28 shtator 2021, si komision i përbërë nga:

María Elósegui, kryetare

Frédéric Krenc

Darian Pavli, gjyqtarë

dhe Olga Chernishova, zëvendësregjistrare e seksionit

Pasi morën në konsideratë kërkesat e mësipërme të paraqitura më 30 qershor 2011 dhe 30 shtator 2016, respektivisht,

Duke marrë në konsideratë parashtrimet e paraqitura nga Qeveria e paditur, dhe parashtrimet paraqitur si përgjigje ndaj të parave nga kërkuesit,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET

1. Kërkuesi në çështjen e parë (kërkesa nr. 41411/11), z. Renaldo Bregu, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1979, i cili jeton në Tiranë (kërkuesi i parë). Kërkuesi në çështjen e dytë (kërkesa nr. 58014/16), znj. Natasha Nokshiqi, është një shtetase shqiptare, e cila ka lindur në vitin 1972 dhe jeton në Tiranë (kërkesa e dytë). Kërkuesit u përfaqësuan përpara Gjykatës nga z. T. Aleksandridis dhe z. D. Matlija, avokatë, të cilët e ushtrojnë profesionin në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjentët e saj të asaj periudhe, znj. A. Hicka, z. A. Metani, znj. E. Muçaj dhe më pas nga znj. B. Lilo, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

A. Rrethanat e çështjes

Faktet e çështjeve, sipas parashtrimeve të palëve, mund të përmbliidhen si më poshtë:

1. Kërkesa nr. 41411/11: Bregu kundër Shqipërisë

3. Në periudhën kur u paraqitën ankesat, kërkuesi i parë merrte një shumë mujore prej 6,340 ALL si i papunë (lekë shqiptarë – rreth 55 euro, EUR). Pas pagesës së shumës së fundit si i papunë, në një periudhë të caktuar midis muajit dhjetor 2010 dhe janar 2011, kërkuesi i parë dëshironte ta kundërshtonte shumën e ulët përpara gjykatave vendase, dhe të ankohej për faktin se shumata kishte ndaluar së paguari pas një viti.

4. Megjithatë, për shkak të taksës së padisë, e cila ishte 12,000 ALL (rreth 98 EUR), dhe duhej të paguhej në periudhën e dorëzimit të padisë, kërkuesi nuk paraqiti asnjë padi për këtë gjë.

2. Kërkesa nr. 58014/16: Nokshiqi kundër Shqipërisë

5. Më 30 nëntor 2014, kërkuesja e dytë u shoqërua në një stacion policie në Tiranë, me pretendimin se kishte bërë një lidhje të paligjshme elektrike. Ajo mori vajzën e saj, minorene në moshë, në stacionin e policisë, pavarësisht udhëzimeve të oficerëve të policisë së ajo nuk duhej ta merrte vajzën me vete. Më 1 tetor 2015, prokuroria e Tiranës vendosi t'i ndërpriste procedimet penale kundër kërkueses.

6. Në një datë të papërcaktuar, kërkuesja paraqiti një kërkesë për dëmshpërblim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë (Gjykata e Shkallës së Parë), ku kërkonte kompensim për dëm psikologjik të shkaktuar ndaj vajzës së saj nga policia. Pas një kërkesë për ndihmë juridike falas, më 8 shkurt 2016, Komisioni Shtetëror për Ndihmë Juridike (KSHNJ) e pranoi kërkesën, në mënyrë

⁷⁸ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 181*. Tiranë 2021, f. 16285

që kërkuesja të mund të përfitonte nga ndihma juridike në formën e përfaqësimit ligjor përpara gjykatave vendase. Kostot e përfaqësimit ligjor do të mbuloheshin nga KSHNJ-ja.

7. Gjatë seancës paraprake, më 17 shkurt 2016, Gjykata e Shkallës së Parë konstatoi të meta në kërkesën për dëmshpërblim, pasi kërkuesja nuk kishte paguar taksën e padisë, dhe e ktheu kërkesën, në mënyrë që kërkuesja të mund të korigjonte të metat. Pas pagesës, Gjykata e Shkallës së Parë rifilloi procedimet.

8. Më 17 mars 2016, Gjykata e Shkallës së Parë caktoi dy ekspertë, kostot e të cilëve do të duhej të mbuloheshin nga kërkuesja, për të vlerësuar shëndetin fizik dhe psikologjik të vajzës së kërkueses.

9. Më 31 mars 2016, kërkuesja kërkoi që të tërhiqte kërkesën për dëmshpërblim për shkak të pamundësisë së saj për të paguar tarifën e ekspertëve. Në të njëjtën datë, Gjykata e Shkallës së Parë e pranoi kërkesën dhe vendosi pushimin e çështjes. Vendimi parashikonte se një apelim i posaçëm mund të paraqitej kundër tij (*shih edhe paragrafin 13 më poshtë*). Konstatohet se, ndaj këtij vendimi nuk u paraqit asnjë apelim.

B. Ligji dhe praktika përkatëse e brendshme

1. Kodi i Procedurës Civile (KPC)

10. Neni 102 parashikon se tarifat gjyqësore përbëhen nga taksa mbi aktet, si edhe kosto e shpenzime të tjera ligjore. Sipas nenit 104, i cili u shfuqizua në vitin 2017, taksa mbi aktet u përcaktua në mbështetje të vlerës së padisë, e përcaktuar nga paditësja, dhe do të paguhej në kohën kur do të paraqitej padia (*shih edhe nenin 156*). Në rastin e mospagesës, gjyqtari i vetëm e kthen padinë te paditësja pa ndërmarra hapa të tjerë, sipas nenit 154/a, duke përcaktuar se të metat duhet të korigjohen brenda afatit të parashikuar. Vendimi mund të apelohej me anë të një apeli të posaçëm.

11. Neni 105/b, hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon se individët të cilët përjashtohen nga pagesa e taksës së akteve, do të përjashtohen nga pagesa e kostove dhe e shpenzimeve të tjera. Sipas nenit 158/a, gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë ta përjashtojë një paditës nga pagesa e taksës së akteve për rastet e parashikuara nga ligji.

12. Neni 105 parashikon se tarifat për ekspertët duhet të paguhet paraprakisht nga pala e cila kërkon raportimin e një eksperti. Megjithatë, gjykata mund të urdhërojë palën tjetër të paguajë tarifat e ekspertit, ose ato mund të paguhet midis palëve në procedime, nëse rrethanat e çështjes dhe situata financiare e palëve e kërkojnë një gjë të tillë.

13. Neni 158/a parashikon se një apelim i posaçëm mund të paraqitet ndaj vendimit për pushimin e çështjes. Sipas nenit 443, apelimi i posaçëm do të duhej të paraqitej brenda pesë ditëve nga vendimi për pushimin e çështjes.

2. Ligji për ndihmën juridike 2008, i ndryshuar (ligji nr. 10039, i datës 22 dhjetor 2008, i ndryshuar nga ligjet nr. 143/2013 dhe 77/2014)

14. Ligji për ndihmën juridike, 2008 ishte në fuqi deri më 1 qershor 2018, kur u shfuqizua nga ligji për ndihmën juridike (ligji nr. 111, i datës 14 dhjetor 2017). Neni 11 parashikon dy lloje të ndihmës juridike: ndihma juridike parësore (informacion për legjislacionin dhe sistemin ligjor, të drejtat dhe detyrimet e individëve, dhe ndihma në përgatitjen e dokumenteve ligjorë), dhe ndihma juridike dytësore (këshilla ligjore dhe përfaqësim në procedimet penale, civile dhe administrative). Sipas nenit 12, i ndryshuar në vitin 2013, ndihma juridike falas mund të ofrohej edhe në formën e përjashtimit nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe e kostove e shpenzimeve të tjera, si për shembull tarifa e ekspertit.

15. Ligji për ndihmën juridike 2008, parashikon krijimin e KSHNJ-së, i cili është përgjegjës për, midis të tjerash, shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike (neni 6 dhe 10). Sipas nenit 16(4) dhe (6), ndryshuar në vitin 2014, një formular i posaçëm aplikimi do të duhej të përgatitej për ndihmën juridike në formën e përjashtimit nga pagesa për tarifën gjyqësore dhe kostot e shpenzimeve të tjera. Neni 21/1, shtuar në vitin 2013, parashikon se KSHNJ-a duhet t'i shqyrtojë kërkesat për ndihmë juridike në formën e përjashtimit nga taksa mbi aktet dhe kostot e shpenzimeve të tjera brenda dhjetë ditëve nga marrja e ndihmës. Nëse KSHNJ-a nuk merr një vendim ose e rrëzon kërkesën, gjykata, në një seancë paraprake, mund të vendosë për përjashtimin e të paditurit nga taksa mbi aktet dhe kostot e shpenzimeve të tjera, në rast se plotësohen kushtet sipas seksionit 13(1)(c). Nëse KSHNJ-a gjykon se

paditësi nuk ka mundësi të paguajë taksën mbi aktet për shkak të situatës së tij financiare, KSHNJ-a mund të urdhërojë që të shtyhet afati për pagesën, ose që pagesa të bëhet me këste, edhe nëse nuk përmbushen kushtet e parashikuara në nenin 13(1)(c).

16. Neni 13(1)(c), i ndryshuar me nenin 2014, parashikon se një person mund të përfitojë nga ndihma juridike falas, nëse ai ose ajo nuk ka mjetet e duhura për të paguar taksat mbi aktet dhe kostot e shpenzimet e tjera, dhe është përfitues i asistencës sociale, ose i përmbush kërkesat për ta përfituar një ndihmë të tillë, ose nëse ka qenë viktimë e dhunës në familje ose e trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Praktika gjyqësore e brendshme

17. Më 27 shkurt 2013, përpara miratimit të ndryshimeve të vitit 2013 dhe 2014, në Ligjin për Ndihmën Juridike, Gjykata Kushtetuese vendosi me shumicë se respektimi i parashikimit në ligjin vendas për shlyerjen e taksës mbi aktet në momentin e paraqitjes së kërkesës, edhe nga njerëzit pa mjete financiare, nuk përbën një shkelje të të drejtave të njeriut për akses në një gjykatë. Më tej në vendim përcaktohet se paditësit/es që paraqet një padi i kërkohej të paguajë taksën mbi aktet paraprakisht si përqindje e vlerës së padisë. Një gjyqtar i zakonshëm, në mbështetje të rrethanave të çështjes dhe situatës financiare të paditësit/es, mund të vendos, sipas çështjes përkatëse, ta përjashtojë atë nga taksa mbi aktet për të garantuar të drejtën e aksesit në gjykatë, në një rast të tillë, taksa mbi aktet paguhet nga buxheti i Shtetit. Në vijim, Gjykata Kushtetuese gjykon se KSHNJ-ja do të duhet të ofrojë ndihmë juridike për disa kategori të caktuara individësh, sipas Ligjit për Ndihmë Juridike.

18. Opinioni kundërshtues përcakton se ka pasur një shkelje të të drejtës së individit për akses në gjykatë, për sa i përket kërkesës për të paguar taksën mbi aktet, sepse legjislacioni i brendshëm nuk parashikon përjashtimin nga pagesa e taksës mbi aktet gjyqësore për personat pa mjete financiare. Ajo gjykon se kërkesa për të paguar taksën mbi aktet është *sine qua non* për vijimin e procedimeve. Gjithashtu, ajo përcakton se interpretimi i shumicës, në lidhje me dispozitat e KPC-së dhe Ligjit për Ndihmën Juridike lë hapësirë për arbitraritet, në mungesë të një kuadri të qartë ligjor për kriteret e përjashtimit.

ANKESAT

19. Kërkuesit u ankuan në mbështetje të nenit 6§1 të Konventës, duke pretenduar se e drejta e tyre për akses në gjykatë ishte kufizuar në mënyrë të pajustificueshme për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar tarifën gjyqësore.

LIGJI

A. Bashkimi i kërkesave

20. Në mbështetje të rregullit 42§1 të Rregullores së Gjykatës, Gjykata vendos të bashkojë kërkesat, duke marrë në konsideratë kuadrin e tyre të ngjashëm faktik dhe ligjor.

B. Ankesat e kërkuesve

21. Në ankesën e tyre për shkelje të së drejtës së tyre për akses në gjykatë, kërkuesit u mbështetën në nenin 6§1 të Konventës, në pjesët përkatëse të cilat parashikojnë si më poshtë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ..., çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, ... nga një gjykatë ...”.

1. Parashtrimet e palëve

a) Në lidhje me kërkesën nr. 41411/11

22. Qeveria ngriti tre kundërshti në lidhje me pranueshmërinë e ankesës së kërkuesit të parë. Fillimisht, Qeveria parashittoi se kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit. Së dyti, ata u shprehën se kërkuesi i parë nuk kishte statusin e viktimës, duke qenë se nuk ishte e qartë se si ishte prekur personalisht nga parashikimet ligjore që po kërkonte të kundërshtonte. Së treti, Qeveria shtonte se kërkuesi i parë nuk kishte iniciuar kurrë procedime përpara gjykatave vendase për të kundërshtuar shumën për papunësinë, dhe as nuk kishte kërkuar përjashtimin nga taksa mbi aktet për shkak të pamundësisë së tij financiare për ta paguar.

23. Kërkuesi i parë u përgjigj se ai e kishte paraqitur kërkesën brenda afatit gjashtëmuor, i cili kishte nisur të përlogaritej ose më 10 janar 2011, kur i ishte paguar kësti i fundit i shumës për statusin e të papunit, ose në datën kur u parashkrua e drejta e tij për të paraqitur një padi përpara gjykatave

vendase. Për më tepër, ai parashtrori se ishte ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga zbatimi i ligjit të brendshëm që parashikon dhënien e shumës për papunësinë. Detyrimi statutor për të paguar tarifën mbi aktet e kishte penguar të kundërshtonte ligjin e brendshëm, përpara gjykatave vendase. Së fundmi, përpjekjet e tij për të paraqitur një padi do të kishin qenë të kota, pasi nuk ekzistonte një praktikë gjyqësore, në të cilën të ishte garantuar përjashtimi nga taksa mbi aktet.

b) Në lidhje me kërkesën 58014/16

24. Qeveria parashtrori se kërkesja e dytë nuk kishte bërë kërkesë për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve. Pavarësisht pretendimit të saj se e kishte bërë diçka të tillë verbalisht, në procesverbalet e të gjitha seancave nuk u gjet asnjë e dhënë e tillë. Gjithashtu, ajo nuk kishte paraqitur asnjë provë për të vërtetuar varfërinë e saj. Mosparaqitja e një kërkesë të tillë nga kërkesja e dytë e kishte bërë të pamundur për Gjykatën e Shkallës së Parë të vlerësonte situatën e saj dhe ta vlerësonte kërkesën sipas ligjit vendas.

25. Kërkesja e dytë parashtrori se ajo kishte bërë një kërkesë verbale që të përjashtojë nga tarifa e ekspertëve. Kërkesa e saj për ta tërhequr kërkesën për shpërblim mbështetëj në varfërinë e saj, dhe kjo nënkuptonte se ky fakt i ishte bërë i ditur gjykatës. Edhe nëse hamendësohej se një kërkesë e tillë nuk ishte bërë verbalisht nga përfaqësuesi i saj ligjor, duke qenë se ai ishte një avokat i ndihmës juridike, përgjegjësia i mbeste Shtetit. Sipas këndvështrimit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë duhej të kishte shqyrtuar situatën e saj financiare me iniciativën e vet, përderisa fakti se kërkesja përfitonte nga ndihma juridike ishte tregues i varfërisë së saj. Kërkesja e dytë parashtrori se nuk kushte mjet efikas në praktikën gjyqësore.

2. Vlerësimi i Gjykatës

26. Si fillim, Gjykata vlerëson se për sa i përket kundërshtimeve të ngritura nga Qeveria, dhe përpara se të merret në shqyrtim themeli i ankesave të kërkesve, do të duhet të përcaktohet nëse kërkesit kanë respektuar nenin 35 të Konventës, dhe veçanërisht, kërkesën për shterimin e mjeteve të brendshme të parashikuar në nenin 35§1 të Konventës. Për këtë arsye, ajo do ta shqyrtojë këtë çështje si më poshtë, për çdo kërkesë.

a) Parime të përgjithshme

27. Gjykata thekson se sipas praktikës së saj gjyqësore të mirëpërcaktuar, periudha gjashtëmujore fillon që prej vendimit të formës së prerë në procesin e shterimit të mjeteve të brendshme (*shih Paul dhe Audrey Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr. 46477/99, GJEDNJ 2002-II*).

28. Në lidhje me shterimin e mjeteve të brendshme, Gjykata ka përcaktuar se ata persona të cilët dëshirojnë të mbështeten në juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës, për sa ka të bëjë me ankesat kundër Shtetit, janë të detyruar të përdorin fillimisht mjetet e parashikuara nga sistemi i brendshëm ligjor (*shih për shembull Akdivar dhe të tjerët kundër Turqisë, 16 shtator 1996, §65, Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve 1996-VI*). Atëherë, detyrimi për të shteruar mjetet e brendshme parashikon që një kërkesë të përdorë normalisht përdorimin e mjeteve, të cilat janë të disponueshme dhe të mjaftueshme, sipas ankesave të tij ose të saj në mbështetje të Konventës. Ekzistenca e mjeteve në fjalë duhet të jenë mjaftueshëm të sigurta jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, sepse në të kundërt, ato nuk do të kenë aksesueshmërinë dhe efikasitetin e nevojshëm (*ibid.*, parag. 66).

29. Në mënyrë që një mjet të jetë efikas, ai duhet të kompensojë në mënyrë të drejtpërdrejtë shtetin e kundërshtuar dhe duhet të garantojë perspektiva të arsyeshme suksesi. Megjithatë, ekzistenca e dyshimeve për perspektivën e suksesit të një mjeti të caktuar, i cili nuk është dukshëm i pavlerë, nuk është një arsye e vlefshme për të mosshtruar mjetin e korrigjimit (*shih Pasquini kundër San Marinos, nr. 50956/16, §119, 2 maj 2019*).

30. Është detyrë e Qeverisë, që pretendon mosshterimin, t'i parashtrorë Gjykatës se mjeti ka qenë efikas, i disponueshëm në teori dhe në praktikë në periudhën në fjalë. Pasi një aspekti i tillë të jetë justifikuar, i mbetet kërkesit të provojë se mjeti i parashtruar nga Qeveria në fakt është shteruar, ose për disa arsye ka qenë i papërshtatshëm dhe jo efikas për rrethana të caktuara të çështjes, ose se kanë ekzistuar rrethana të caktuara që e çlirojnë atë nga kjo kërkesë (*shih Vučković dhe të tjerët kundër Serbisë (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerët, §77, 25 mars 2014*).

b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në kërkesat në fjalë

i. Në lidhje me kërkesën nr. 41411/11

31. Gjykata thekson se kërkuesi i parë dëshironte ta kundërshtonte shumën mujore si i papunë. Megjithatë, ai nuk ndërmori asnjë procedim ku të argumentonte se shuma e taksës mbi aktet ishte penguese.

32. Gjithashtu, Gjykata argumenton se neni 105/b i KPC, i hyrë në fuqi në vitin 2001, parashikon mundësinë që paditësi të përjashtohet nga taksa gjyqësore pasi të paraqesë padinë. Kur ky nen lexohet së bashku me nenin 158/a të KPC-së, gjykata e zakonshme mund të vendosë në një seancë paraprake ta përjashtojë paditësin nga taksa mbi aktet pas paraqitjes së padisë (*shih paragrafin 11 më sipër*). Megjithatë, kërkuesi nuk ia mundësoi vetes një mjet të tillë, pasi ai nuk ndërmori asnjë procedim.

33. Gjykata nuk mund të pranojë argumentin e kërkuetit se, në mungesë të një praktikë të qartë gjyqësore të brendshme, ky mjet ishte jo efikas. Në një sistem ligjor ku të drejtat themelore mbrohen nga Kushtetuta dhe ligji, është detyrë e individit të pakënaqur të testojë shtrirjen e asaj mbrojtjeje dhe të lejojë gjykatat e brendshme t'i venë në zbatim ato të drejta, dhe, aty ku është e mundur, t'i përdorin ato në ushtrimin e fuqisë së tyre për interpretim (*shih A, B dhe C kundër Irlandës [DHM], nr. 25579/25, §142, GJEDNJ 2010*). Nëse kërkuesi i parë do të kishte dyshime për mundësinë e marrjes së një vendimi gjykate, në lidhje me përjashtimin e tij nga taksa gjyqësore, i mbetej atij të adresonte këto dyshime duke iu drejtuar gjykatave vendase. Gjykata përsërit se ajo nuk mund të zërë vendin e gjykatave vendase, pasi ato janë në pozita më të mira të shqyrtojnë dhe të vlerësojnë rrethanat specifike që kanë të bëjnë me pretendimet e kërkuetit. Është detyra kryesore e autoriteteve vendase, më konkretisht e gjykatave, që të interpretojnë dhe zbatojnë ligjin e brendshëm, duke qenë se, për sa i përket natyrës së gjërave, autoritetet kombëtare janë të kualifikuara për të zgjidhur problematikat që dalin në lidhje me këtë situatë (*shih Radomilja dhe të tjerët kundër Kroacisë [DHM], nr. 37685/10 dhe 22768/12, §149, 20 mars 2018*).

34. Në të tilla rrethana, për sa i përket mjetit të parashikuar në nenet 105/b dhe 158/a të KPC-së, i takon kërkuetit të parë të paraqesë një padi në gjykatat vendase dhe të testojë masën e atij mjeti. Në fakt, kërkuesi nuk mori asnjë hap në mënyrë që të kundërshtonte shumën e mbështetjes financiare që i jepej si i papunë, veçanërisht që t'i mundësonte gjykatave vendase të vlerësonin varfërinë e tij *vis-a-vis* kërkesës ligjore për të paguar taksën mbi aktet.

35. Në vijim, kërkesa e kërkuetit të parë duhet të rrëzohet sipas nenit 35§§1 dhe 4, të Konventës për mosshkrim të mjeteve të brendshme.

ii. Në lidhje me kërkesën nr. 58014/16

36. Gjykata vëren se kërkuetsja e dytë, së cilës i është ofruar ndihmë juridike në formën e përfaqësimit ligjor dhe pagesën e taksës gjyqësore, paraqiti një kërkesë për shpërblim. Në vijim, ajo e tërhoqi kërkesën për shkak të pamundësisë së saj për të paguar tarifën e ekspertëve, pa kërkuar përjashtimin nga pagesa e saj. Kështu, Gjykata do të gjykojë nëse ligji i brendshëm ofronte një mjet në rastin e kërkuetes së dytë.

37. Gjykata vëren se, sipas ligjit për ndihmën juridike, 2008, KSHNJ-ja kishte fuqinë që t'i shqyrtonte kërkesat për ndihmë juridike në formën e, midis të tjerash, përjashtimit nga pagesa e kostove dhe shpenzimeve, si për shembull tarifa e ekspertit. Megjithatë, në çështjen në fjalë, nuk ka indicie që kërkuetsja të ketë ndërmarrë hapa për ta paraqitur një kërkesë të tillë për ndihmë juridike te KSHNJ-ja, i cili e ka pranuar tashmë kërkesën e saj për ndihmë juridike në formën e përfaqësimit ligjor.

38. Në çdo rast, Ligji për Ndihmën Juridike i vitit 2008, parashikon se gjykata, mund të vendosë në një seancë paraprake, në lidhje me përjashtimin e kërkuetes nga kostot dhe shpenzimet gjyqësore, si për shembull tarifa e ekspertëve, nëse KSHNJ-ja nuk ka marrë një vendim ose ka rrëzuar kërkesën për ndihmë juridike. Detyrimi i gjykatës së brendshme buron nga neni 105 i Kodit të Procedurës Civile (*shih paragrafin 12 më sipër*). Në çështjen konkrete, palët nuk dakordësohen për faktin nëse kërkuetsja ka bërë një kërkesë verbale për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve përpara Gjykatës së Shkallës së Parë. Pasi shqyrtoi dokumentet në dosjen e çështjes, Gjykata nuk ka gjetur të

dhëna që të bëjnë të besosh te pretendimi i kërkueses se ajo e ka bërë një kërkesë të tillë. Duke mos e bërë një kërkesë, kërkuësja nuk i ka dhënë Gjykatës së Shkallës së Parë mundësinë që të vlerësojë situatën e saj financiare, edhe në mbështetje të nenit 105 të KPC-së, i cili parashikon se gjykata e zakonshme, për sa i përket rrethanave të një çështje dhe të situatës financiare të palëve, mund të urdhërojë, midis të tjerash, që pagesa e tarifës së ekspertëve të mbulohet nga pala tjetër në procedime.

39. Në vijim, Gjykata i referohet vendimit të Gjykatës Kushtetuese, i cili u lëshua në vitin 2013, dhe sqaron se gjykatat e zakonshme mund të shqyrtojnë kërkesat për përjashtim nga pagesa e taksës mbi aktet, dhe *mutatis mutandis*, tarifa e ekspertëve. Mungesa e pretenduar e praktikës gjyqësore përkatëse mund të jetë edhe për faktin se problematika është paraqitur rrallë përpara gjykatave vendase për shqyrtim. Gjykata kë nënvizuar ekzistencën e dyshimeve në lidhje me perspektivën e suksesit të një mjeti të posaçëm, i cili dukshëm nuk është i kotë, ose nuk është një arsye e vlefshme për të mos e ndjekur atë (*shih paragrafin 29 më sipër*). Në çështjen konkrete, nëse kërkuësja ka pasur dyshime për mundësinë se mund të përjashtohet nga pagesa e tarifës së ekspertëve sipas fuqisë së ligjit për ndihmën juridike 2008, dhe nenit 105 të KPC-së, i takonte asaj t'i kalonte ato dyshime duke i paraqitur një kërkesë KSHNJ-së dhe/ose Gjykatës së Shkallës së Parë. Nisur nga fakti se kërkueses i është dhënë ndihmë juridike me anë të përfaqësimit ligjor, Gjykatës nuk i takonte të spekulonte për situatën e saj financiare, dhe aq më tepër pasi ajo kishte paguar taksën gjyqësore. Së pari, i takon Gjykatës së Shkallës së Parë të përcaktonte një çështje të tillë, duke qenë se gjykatat vendase janë, nga vet natyra e gjerave, veçanërisht të kualifikuara për të zgjidhur një çështje që ngrihet përpara tyre.

40. Së fundmi, edhe nëse mendohet se kërkuësja ka bërë një kërkesë verbale për përjashtim nga pagesa e tarifës së ekspertëve, i takonte kërkueses të apelonte kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë që e pushoi çështjen e saj (*shih paragrafët 9 dhe 13 më sipër*).

41. Si përfundim, Gjykata është e mendimit se kërkuësja e dytë nuk u dha gjykatave vendase mundësinë që të korrigjonin shkeljen e hamendësuar me anë të sistemit ligjor të Shtetit të Paditur. Si pasojë, edhe kërkesa në lidhje me kërkuesen e dytë duhet të rrëzohet sipas nenit 35§§1 dhe 4, të Konventës për mosshfrytëzim të mjeteve të brendshme.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos t'i bashkojë kërkesat,
- I deklaron, kërkesat të papranueshme.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 21 tetor 2021.

Olga Chernishova
Zëvendësregjistrare

Marta Elósegui
Kryetare

SEKSIONI I TRETË
“MYSLYM NELA KUNDËR SHQIPËRISË”⁷⁹

(kërkesa nr. 47401/15)

VENDIM

(shih tabelën bashkëlidhur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë) e mbledhur më 7 tetor 2021, si komision, i përbërë nga:

Dmitry Dedov, kryetare

Peeter Roosma

Andreas Zünd, gjyqtarë

dhe Viktoriya Maradudina, zëvendësregjistrare e përkohshme e seksionit

Pasi morën në konsideratë kërkesën e paraqitur më 21 shtator 2015;

Duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit paraqiten në tabelën bashkëngjitur.

Ankesat e kërkesit sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile të pushuara dhe mungesa e një mjeti efikas të brendshëm në këtë aspekt, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë (Qeveria).

LIGJI

Pas përpjekjeve të pasuksesshme për të arritur një zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën se propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme për zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga kërkesa.

Në deklaratë, Qeveria pranoi kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve civile të pushuara dhe mungesën e një mjeti efikas të brendshëm, në lidhje me këtë aspekt. Qeveria parashtrroi se në nëntor 2017, kishte hyrë në fuqi një mjet parandalues dhe efikas, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve. Qeveria ofronte t'i paguante kërkesit shumën e detajuar në tabelën bashkëngjitur, shumë e cila do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rastin e mospagimit të asaj shume brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, Qeveria ndërmerre të paguante interesin e thjeshtë, që nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në normën e barabartë me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje, për sa më sipër, Qeveria ftoi Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës.

Kërkuesi nuk pranoi kushtet e deklaratës të njëanshme të Qeverisë, duke u ankuar se shuma e propozuar ishte shumë e vogël.

Gjykata parashtron se neni 37§1(c) i jep mundësinë ta nxjerrë çështjen nga lista e saj, nëse “... për ndonjë arsye të parashikuar nga Gjykata, nuk justifikohet të vijohet shqyrtimi i kërkesës”. Për këtë arsye, ajo mund t'i përjashtojë kërkesat sipas nenit §1(c), në mbështetje të një deklaratë të njëanshme të Qeverisë së paditur, edhe nëse kërkuesi dëshiron të vijojë shqyrtimi i çështjes (*shih, veçanërisht, vendimin Tahsim Acar kundër Turqisë (kundërshtimet paraprake)* [DHM], nr. 26307/95, §§75–77, GJEDNJ 2003-VI. Gjithashtu, Gjykata ka një praktikë gjyqësore të mirëpërcaktuar dhe të qartë, në lidhje me kohëzgjatjen e tepruar të procedimeve civile (*shih, midis të tjerash, Scordino kundër Italisë (nr. 1)* [DHM], nr. 36813/97, §134–227, GJEDNJ 2006-V, dhe *Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë nr. 64480/09 dhe 5 të tjerë, §88–92, 1 prill 2014*).

⁷⁹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 181*. Tiranë 2021, f. 16290

Vëllimi III, 2020-2021

Duke pasur në konsideratë parashtrimet në deklaratën e Qeverisë, si edhe shumën e kompensimit të propozuar – i cili është në përputhje me shumën e dhëna në çështje të ngjashme – Gjykata gjykon se nuk është e justifikuar që të vijojë më tej me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1(c)). Për më tepër, Gjykata merr në konsideratë mjetin e ri në legjislacionin shqiptar, në lidhje me kohëzgjatjen e paarsyeshme të procedimeve. Kështu, ajo nënvizon se respektimi i të drejtave të njeriut, sipas përkufizimit të Konventës dhe të Protokolleve në të, nuk parashikon vijimin me shqyrtimin e kërkesës (neni 37§1 *in fine*).

Së fundmi, Gjykata thekson, se, nëse Qeveria nuk respekton kushtet në deklaratën e tyre të njëanshme, kërkesa mund të rikthehet në listë, sipas nenit 37§2 të Konventës (*shih Josipović kundër Serbisë (vend.)*, nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Mban në konsideratë kushtet e deklaratës së Qeverisë së Paditur dhe organizimet për garantimin e përputhshmërisë me masat e marra si më sipër.
- Vendos ta përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 37§1(c) të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 28 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Dmitry Dedov
Kryetar

Shtojcë

KËRKESË E CILA PARASHTRON ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS (kohëzgjatje e tepruar e procedimeve civile)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot e shpenzimit për kërkuar (në euro) ⁸⁰
47401/15, 21.9.2015	Myslym Nela 1951	2.7.2021	2.300

⁸⁰ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuarit.

SEKSIONI I TRETË
“EDMOND ZHUPA KUNDËR SHQIPËRISË”⁸¹

(kërkesa nr. 3824/16)

VENDIM

(*shih tabelën bashkëlidhur*)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 7 tetor 2021, si komision i përbërë nga:

Dmitry Dedov, kryetar

Peeter Roosma

Andreas Zünd, gjyqtarë

dhe Viktoriya Maradudina, zëvendësregjistrare e përkohshme e seksionit

Pasi morën në konsideratë kërkesën e paraqitur më 11 janar 2016,

Duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur, e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve dhe përgjigjen e kërkuarit si përgjigje ndaj këtij parashtrimi,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuarit paraqiten në tabelën bashkëngjitur.

Ankesat e kërkuarit sipas nenit 6§1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë (Qeveria).

Qeveria parashtrroi një deklaratë me fokus zgjidhjen e problematikave të ngritura nga këto ankesa. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës të përjashtonte kërkesën.

Në deklaratë, Qeveria pranonte kohëzgjatjen e tepërt të procedimeve civile të ndërprera. Qeveria parashtrroi se në nëntor 2017 kishte hyrë në fuqi një mjet i ri parandalues dhe detyrues në lidhje me kohëzgjatjen e procedimeve. Qeveria ofronte t’i paguante kërkuarit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe e ftonte Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve, sipas nenit 37§1 (c) të Konventës. Shuma do të konvertohej në vlerën monetare të Shtetit të Paditur, në normën e aplikueshme në datën e pagesës, dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagesës së kësaj shume brenda periudhës së sipërpërmendur tremujore, Qeveria ndërmerre të paguante interesin e thjeshtë mbi shumën, që nga përfundimi i periudhës deri në pagesën e saj të plotë, në një normë të barabartë me normën huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës kur shumata nuk është paguar, plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuari informoi Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkuarit, për kushtet e parashtrimit të bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve.

Për këtë arsye, Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo gjykon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas përkufizimit të Konventës dhe Protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për shqyrtimin e justifikuar të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista.

⁸¹ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 181*. Tiranë 2021, f. 16292

Vëllimi III, 2020-2021

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, NË MËNYRË UNANIME:

- Vendos ta heqë kërkesën nga lista e saj e çështjeve sipas nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 28 tetor 2021.

Viktoriya Maradudina
Zëvendësregjistrare e përkohshme

Dmitry Dedov
Kryetar

Shtojcë

KËRKESË E CILA PARASHTRON ANKESA SIPAS NENIT 6§1 TË KONVENTËS

(Kohëzgjatje e tepruar e procedimeve civile)

Kërkesa nr. data e paraqitjes	Emri i kërkuesit Viti i lindjes	Data e marrjes së deklaratave të Qeverisë	Data e marrjes së dakordësimit të kërkuesit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot, dhe shpenzimet për kërkues ⁸²
3824/16 11.1.2016	Edmond Zhupa 1958	2/7/2021	7.9.2021	2.300

⁸² Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesit.

SEKSIONI I TRETË
“DORIAN MATLIJA KUNDËR SHQIPËRISË”⁸³
(kërkesa nr. 616/16)

VENDIM

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 5 tetor 2021, si komision, i përbërë nga:

María Elósegui, kryetare

Darian Pavli

Frédéric Krenc, gjyqtarë

dhe Olga Chernishova, zëvendësregjistrare e seksionit

Pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme të paraqitur më 14 dhjetor 2015,

Duke marrë në konsideratë deklaratat formale, në të cilat pranohet një zgjidhje miqësore për çështjen,

Pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

1. Kërkuesi, z. Dorian Matlija, është një shtetas shqiptar, lindur në vitin 1976, i cili jeton në Tiranë.

2. Qeveria shqiptare (Qeveria) u përfaqësua nga agjenti i saj i asaj periudhe, z. E. Muçaj, dhe më pas nga znj. B. Lilo, nga Zyra e Avokatit të Shtetit.

3. Qeverisë iu komunikuan ankesat e kërkuetit, në mbështetje të neneve 6§1, 10 dhe 13 të Konventës për mosrespektimin nga ana e autoriteteve të një vendimi të formës së prerë të brendshëm, sipas së cilit autoritetet urdhëroheshin të paraqisnin dokumente që vërtetonin se kryetari dhe anëtarët e Komisionit të Prokurimit Publik përmbushnin kriteret statutorë për emërimin e tyre në një zyrë publike.

4. Gjykata mori deklaratat për një zgjidhje miqësore, të nënshkruara nga palët, sipas së cilave kërkuesi binte dakord të hiqte dorë nga pretendime të mëtejshme ndaj Qeverisë së paditur, në lidhje me faktet që sollën këtë kërkesë, me kusht që Qeveria t'i ofronte atij brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës, informacionet që u urdhëruan të jepeshin në vendimin e gjykatës vendëse, të ruajtura në arkivat e institucioneve përkatëse shtetërore, duke përfshirë, por pa u kufizuar, arkivat e kryeministrisë dhe të Komisionit të Prokurimit Publik, me përjashtim të certifikatave të gjendjes gjyqësore, të cilat ishin shkatërruar për shkak të periudhave të kufizuara për ruajtjen e tyre.

5. Gjithashtu, Qeveria pranoi t'i paguante kërkuetit 5,000 EUR, për të paguar dëmin jomonetar, së bashku me kostot dhe shpenzimet, plus ndonjë taksë që mund t'i tarifohet, të cilat do të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur në normën e zbatuar në datën e pagesës, dhe do të paguhet brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast se kjo shumë nuk paguhet brenda periudhës tremujore përmendur më sipër, Qeveria pranon të paguajë interesin e thjeshtë ndaj saj, nga përfundimi i asaj periudhe deri në zgjidhje, në një normë të barabartë me normën marginale të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre pikë përqindje.

⁸³ Qendra e Botimeve Zyrtare. *Fletore Zyrtare nr. 187*. Tiranë 2021, f. 16891

LIGJI

6. Gjykata mban në konsideratë zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo pranon se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut, sipas parashikimit në Konventë dhe në Protokollet e saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye që justifikojnë një shqyrtim të mëtejshëm të kërkesës. Për sa më sipër, është me vend që çështja të hiqet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë anonime:

Vendos, ta heqë kërkesën nga lista e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 4 nëntor 2021.

Olga Chernishova
Zëvendësregjistrare

Marta Elósegui
Kryetare

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Qendra e Botimeve Zyrtare

Përmbledhje e vendimeve të Gjykatës Europiane për të
Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë, 2010-2021 / Qendra
e Botimeve Zyrtare. – Tiranë : QBZ, 2022

Vol. 3 ; ... cm.

Vol. 3 : (2020-2021). - ... f.

ISBN 978-9928-01-140-4 (Kolana)

ISBN 978-9928-01-143-5 (V.3)

1.Gjykata evropiane 2.Të drejtat e njeriut 3.Vendime gjyqësore
4.Evropë 5.Shqipëri

341.645.2(4:496.5) "2020/2022"

341.231.14